

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**Seria e kërkimeve politike
BOTIM I VEÇANTË**

RAPORTI KOSOVAR

KONFLIKTI

REAGIMI NDËRKOMBËTAR

LEKSIONET E MËSUARA

**KOMISIONI I PAVARUR NDËRKOMBËTAR
PËR KOSOVËN**

qershor, 2005

KIPRED

The logo for KIPRED features the word "KIPRED" in a bold, white, sans-serif font. To the right of the text is a stylized graphic consisting of a yellow circle with a white dot in the center, and a blue swoosh that curves around the circle and extends upwards.

RAPORTI KOSOVAR


KONFLIKTI

REAGIMI NDËRKOMBËTAR

LEKSIONET E MËSUARA

**KOMISIONI I PAVARUR NDËRKOMBËTAR
PËR KOSOVËN**

qershor, 2005



OXFORD
UNIVERSITY PRESS
Great Clarendon Street, Oxford ox2 6 DP

Oxford University Press është departament i Universitetit të Oksfordit. Ky e shpie përpara synimin e Universitetit për të shkëlqyer në hulumtim, shkollim dhe arsimim duke botuar anembanë botës në:

Oxford, New York,
Athens, Auckland, Bangkok, Bogota, Buenos Aires, Calcutta, Kape Town, Chennai, Dar es Salam, Delhi, Florence, Hong Kong, Istanbul, Karachi, Kuala Lumpur, Madrid, Melbourne, Mexiko City, Mumbai, Nairobi, Paris, Sao Paolo, Singapore, Taipei, Tokyo, Toronto, Warsaw

me kompani të bashkangjitura në Berlin, Ibadan
Oxfordi është shenjë e regjistruar tregtare e Oxford University Press në Mbretërinë e Bashkuar dhe në disa vende të tjera.

Ky libër është përkthyer nga botimi në SHBA i Oxford University Press Inc., New York, me lejen dhe me ndihmën e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën.

© Oxford University Press 2000

Të drejtat morale të autorit janë të pranuar.
E drejta e të dhënave: Oxford University Press
Botimi i parë në vitin 2000

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet në cilëndo trajtë apo përmes cilave do mjete, pa lejen paraprake me shkrim nga Oxford University Press, apo ashtu si lejohet me ligj, ose në bazë të kushteve të rregulluara në mënyrë adekuate me Organizatën e të drejtave reprografike. Kërkesat për riprodhim jashtë kushteve të theksuara më lart duhet të dërgohet në Departamentin e të Drejtave, Oxford University Press, në adresën e shënuar më lart.

Ju nuk bën ta qarkulloni këtë libër në çfarëdo mbështjellësi apo kopertine tjetër, dhe këto kushte duhet t'ia veni secilit të interesuar.

Përkthimi dhe redaktimi i këtij botimi është financuar tërësisht nga Olof Palme International Center (Qendra Ndërkombëtare Olof Palme), Suedi.

Përkthimi: Avni Spahiu
Përgatitja dhe redaktimi: Mentor Agani
Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39

Prishtina, Kosovo (UNMIK)

Phone and Fax: +381 38 555 887

kipred@hotmail.com

www.kipred.net

PËRMBAJTJA	iii
Përmbledhje Ekzekutive	1
Fjala e ish-Presidentit Nelson Mandela	11
Hyrje	14
PJESA I: ÇFARË NDODHI?	21
Parathënie	22
1. Origjina e Krizës Kosovare	24
2. Konflikti i Brendshëm i Armatosur: Shkurt 1998 – Mars 1999	49
3. Shpërthimi i Luftës Ndërkombëtare: Mars 1999 – Qershor 1999	64
4. Kosova nën Udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara	76
PJESA II: ANALIZA	101
5. Dimensioni Diplomatik	102
6. E Drejta Ndërkombëtare dhe Intervenimi Humanitar	129
7. Organizatat Humanitare dhe Roli i Mediave	160
8. Kosova: Dimensioni Rajonal	182
9. Statusi i Ardhsëm i Kosovës	208
PJESA III: PËRFUNDIM	227
10. Përfundim	228
SHTOJCAT	241
1. Dokumentimi i Shkeljes së të Drejtave të Njeriut	243
2. Kosova – Fakte dhe Shifra	269
3. Marrëveshja e Rambujesë – Përmbledhje	271
4. Marrëveshja Ahtisaari-Chernomyrdin – Përmbledhje	277

5. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit	279
6. Puna e Komisionit	288
7. Fusnotat	302
8. Literaturë mbi Kosovën dhe Krizën	330
9. Shkurtesat	336

Përmbledhje ekzekutive

Konstatimet kryesore

PARANDALIMI Origjina e konfliktit duhet kuptuar në kontekstin e valës së re të nacionalizmit, i cili e sollti ngritjen e Millosheviqit dhe miratimin zyrtar të agjendës ekstreme nacionaliste serbe. Heqja e autonomisë së Kosovës nga Beogradi më 1989 u vijua nga një politikë që e kishte për qëllim ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës dhe krijimin e një shoqërie të ngjashme me apartheidin.

Qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare ishin të vetëdijshme për rrezikun e konfliktit në Kosovë që nga fillimi i vitit 1990 e më tutje. Shenjat për këtë ishin të mjaftueshme, e pos kësaj ky konflikt do të ishte vetëm një pjesë më tepër e tragjedisë e cila ishte duke u shpalosur me shpërbërjen e Jugosllavisë. Megjithëkëtë, para vitit 1998, Bashkësia Ndërkombëtare dështoi për ta ndërmarrë ndonjë veprim të duhur parandalues. Në fakt, ishin disa nisma diplomatike, në veçanti gjatë periudhës 1992-3, mirëpo ato ishin të paqarta dhe pa ndonjë mbështetje të fuqishme nga nivelet e larta. Ç'ishte më e keqja, lëvizjes së rezistencës paqësore, e cila i krijoi institucionet e veta paralele dhe arriti që në Kosovë ta parandalojë shpërthimin e ndonjë dhune të përmasave më të mëdha deri në vitin 1997, nuk iu ofrua mbështetje e mjaftueshme. Vendimi për ta përjashtuar çështjen e Kosovës nga negociatat e Dejtonit, si dhe mungesa e rezultateve nga strategjia paqësore, bëri që shumë shqiptarë të Kosovës të vijnë në përfundimin që dhuna ishte mënyra e vetme për ta tërhequr vëmendjen ndërkombëtare. Është pikërisht kjo periudha gjatë së cilës u shfaqën grupet e para të UÇK-së. Deri nga fundi i vitit 1997, këto ishin grupe të vogla të rezistencës, të cilat vepronin me strategjinë godit e terhiq, që bënin luftë guerile të nivelit të ulët, dhe që e shpresonin ndërhyrjen ndërkombëtare. Reagimi i Serbisë ndaj sulmeve të para të UÇK-së, ashtu siç edhe ka mundur të pritej, ishte mizor dhe i drejtuar po ashtu edhe kundër qytetarëve. Masakra serbe e 58 banorëve të Prekazit, në shkurtin e vitit 1998, ishte pikë kthese. Lufta e brendshme u përshkallëzua.

Konstatimi i përgjithshëm që mund të nxirret nga kjo përvojë është se për parandalim nevojiten përpjekje shumë më të mëdha. Nuk mjafton vetëm paralajmërimi i hershëm: nevojitet edhe vullneti politik, gatishmëria për të dhënë mjete dhe për të qenë i pranishëm në terren.

Konflikti i armatosur

Konflikti i armatosur ndërmjet UÇK-së dhe RFJ-së zgjati nga shkurti i vitit 1998, e deri në qershor të vitit 1999, dhe përshkallëzimin më të madh e pati pas marsit të vitit 1999, kur edhe filloi fushata ajrore e NATO-s. Ky mund të karakterizohet edhe si kryengritje e armatosur dhe luftë kundër kryengritjes, por, po ashtu, edhe si një luftë për spastrim etnik (d.m.th., kundër popullatës civile).

Komisioni ka mbledhur të dhëna nga burime të ndryshme dhe të shumta me qëllim të vlerësimit të saktë të shkallës së krimeve. Në fazën e parë të konfliktit, ajo nga shkurti i vitit 1998 e deri në marsin e vitit 1999, numri i viktimave ishte relativisht i ulët: deri në muajin shtator ishin vrarë rreth 1.000 qytetarë, ndonëse të dhënat janë të pasigurta; numri i viktimave ndërmjet shtatorit e marsit nuk dihet, mirëpo supozohet të ketë qenë më i vogël. Gjatë kësaj periudhe me shumë se 400.000 njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre, ku rreth gjysma e tyre ishin të zhvendosur. Shumica e këtyre refugjatëve të brendshëm u kthyen nëpër shtëpitë e tyre pas marrëveshjes Hollbruk-Milloshëviq, të tetorit të vitit 1998. Gjatë kësaj periudhe pati arrestime dhe burgosje të shumta. Për periudhën nga 24 marsi e deri më 19 qershor të vitit 1999, Komisioni vlerëson që numri i të vrarëve është përafërsisht 10.000, shumica dërrmuese e të cilëve janë shqiptarë kosovarë të vrarë nga forcat e RFJ-së. Rreth 863.000 civilë u arratisën ose u detyruan në mënyrë të dhunshme që të strehohen jashtë Kosovës, ndërkaq 590.000 të tjerë ishin të zhvendosur përbrenda Kosovës. Po ashtu, ka të dhëna për dhunime e tortura përmasash të mëdha, si dhe për plaçkitje, djegie e shfarosje.

Mënyra e organizimit logjistik e përpiluar për deportim, si dhe koordinimi i aksioneve të ushtrisë jugosllave, të grupeve paramilitare dhe të policisë, e tregon qartë që ky dëbim masiv i shqiptarëve të Kosovës ishte sistematik dhe i planifikuar. Fushata ajrore e NATO-s nuk i provokoi sulmet mbi popullatën civile kosovare, ndonëse bombardimet krijuan rrethana në të cilat këto operacione ishin të realizueshme.

Angazhimi diplomatik

Rasti më i mirë dhe më shpresëdhënës diplomatik ishte para vitit 1998. Në secilën fazë të mëtejme të konfliktit mundësitë diplomatike vinin duke u ngushtuar. Megjithkëtë, vullneti politik për të vënë në lëvizje përpjekjet diplomatike madhore arriti të mobilizohej vetëm pasi konflikti u përshkallëzua në përmasat e veta të plota të dhunës.

Angazhimi diplomatik gjatë tërë vitit 1998 i cili u kurorëzua në Rambuje, karakterizohej nga hutia dhe nga shenja të përziera. Përballë strategjisë së skajshme shtypëse të Millosheviqit dhe kërkesave maksimaliste të LDK-së e të UÇK-së, gjasat që diplomacia do të fitonte ishin të pakta. Marrëveshja Hollbruk-Millosheviq e tetorit të vitit 1998, solli vëzhgues të paarmatosur ndërkombëtarë dhe pati sukses në zvoglimin e shkallës së dhunës. Megjithatë, njësitet e UÇK-së përfituan nga ky moment i pushimit të luftimeve për ta ripërtëritur kontrollin e tyre në shumë pozita të lëshuara nga trupat serbe. Dhuna u përshkallëzua përsëri pas rikthimit të forcave serbe në rajon, në dhjetorin e vitit 1998.

Komisioni është i besimit që mund të nxirren mësimet të rëndësishme lidhur me rolin e vëzhguesve të paarmatosur në uljen e shkallës së vuajtjeve të popullatës civile, edhe po qe se nuk arrihet shmangia e katastrofës humanitare.

Treguesit e gjithmbarshëm të reagimit ndërkombëtar janë në thelb të ngatërruar dhe prandaj edhe pa “rezultate” të qarta, pos vëzhgimeve të kujdesshme në favor të angazhimit të hershëm dhe të vëmendjes më të madhe për opsionet paqësore. Këtu e vlen të theksohen disa konkludime kyçe:

Diplomacinë efektive e kanë penguar agjendat e shumëllojshme dhe të ndryshme, si dhe shpresat dhe sinjalet e përziera nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Përvojat e Bashkësisë Ndërkombëtare me Millosheviqin si një njeri i cili rëndom ishte i papërgjegjisi në negociata, kanë krijuar vetëm mëdyshje. Gjuha e vetme diplomatike të cilën duket se negociatorët e kanë përdorur, ishte ajo e forcës dhe e kërcënimit. Kjo solli te problemet ligjore e diplomatike – një diplomaci e tillë kërcënuese e cenon Kartën, ndërkohë që vështirë se është në pajtim me zgjidhjen paqësore. Kredibiliteti i kërcënimit duhet, tekefundit, të mbështetet në përdorimin e mirëfilltë të forcës.

Edhe përkundër të gjitha këtyre dobësive, është e pamundur të përfundohet që zgjidhja diplomatike do t’i jipte fund betejës së brendshme për të ardhmen e Kosovës. Madje edhe vetëm qëllimet minimale, si të shqiptarëve kosovarë, ashtu edhe të Beogradit, ishin të papajtueshme fare.

Kontributi i Rusisë në këtë proces ishte i dykuptimtë. Raportet e saj të veçanta me Serbinë pamundësuan hapa qenësorë diplomatik, ndërkohë që angazhimi ngulmues i saj për të vënë veto në përdorimin e forcës ishte shkaktari kryesor që e shtyri NATO-n në një aksion pa mandat.

Fushata ajrore e NATO-s

Komisioni konstaton që ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte jolegale, mirëpo legjitime. Ishte jolegale sepse nuk e kishte miratimin paraprak nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Megjithëkëtë, Komisioni konstaton që ndërhyrja ishte e justifikueshme, meqë ishin shpenzuar që të gjitha mundësitë diplomatike, dhe meqë ndërhyrja e pati si efekt çlirimin e popullatës shumicë të Kosovës nga shtypja e rëndë dhe e gjatë nën sundimin serb.

NATO-ja ishte e bindur që një fushatë relativisht e shkurtër e bombardimeve do ta bindte Millosheviqin që ta nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë. Ky ishte një gabim i madh. NATO-ja po ashtu e nënvlerësoi rrezikun potencial që qeveria serbe do të vendoste të ndërmirte sulme kundër popullatës shqiptare të Kosovës. NATO-s iu desht që fushatën ajrore ta zgjeronte edhe në caqet strategjike në vetë Serbinë, gjë kjo që e rriti rrezikun për humbjen e jetëve të civilëve. Megjithë faktin që NATO-ja bëri përpjekje substanciale për t'i shmangur humbjet e jetëve të civilëve, ishin edhe disa gabime serioze. Janë të dokumentuara rreth 500 raste të vdekjes së civilëve. Komisioni, po ashtu, ka qëndrim kritik ndaj përdorimit të bombave kasetore, dëmtimeve të ambientit të shkaktuara nga uranumi i varfëruar në predhat kundër blindave si dhe në raketa, rrjedhjeve toksike të shkaktuara nga bombardimi i komplekseve industriale dhe i rafinerive në disa qytete, si dhe ndaj sulmit në Televizionin Serb më 17 prill 1999. Komisioni e përkrah raportin përfundimtar të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), sipas të cilit, mbështetur në të dhënat ekzistuese, nuk ka mbështetje për ta akuzuar ndonjë individ për shkelje penale të ligjeve të luftës gjatë fushatës së NATO-s. Sidoqoftë, disa raste është vështirë të mbrohen nga akuza që ka pasur shkelje të tilla, dhe për vlerësimin përfundimtar këto varen nga faktet të cilat do të mund të gjenden më vonë.

Komisioni angazhohet për shkallën me të lartë të standardeve mbrojtëse në secilin angazhim të ardhshëm dhe e propozon konsultimin e “Protokolit III,” për ta bërë këtë eksplicite dhe mandatore.

Si përfundim, lufta e NATO-s nuk ishte as sukses dhe as dështim; në të vërtetë, kjo i përmbante që të dyjat. Kjo e detyroi qeverinë serbe që ta tërheqë ushtrinë dhe policinë e saj nga Kosova, dhe ta nënshkruaj një marrëveshje të modeluar përafërsisht si marrëveshja e dështuar e Rambujesë. Ajo e ndali dhunën sistematike kundër shqiptarëve të Kosovës. Nga ana tjetër, ndërhyrja dështoi që ta arrinte qëllimin e lartë të parandalimit të spastrimit etnik masiv. Millosheviqi mbeti në pushtet edhe më tutje. Populli serb ishte humbësi më i madh: Kosovën e kishte të humbur. Shumë serbë ikën

ose u dëbuan nga rajoni. Serbia pësoi humbje të konsiderueshme ekonomike si dhe shkatërrim të infrastrukturës publike. Mediat e pavarura dhe OJQ-të janë të kontrolluara edhe më tutje, dhe represioni i gjithmbarshëm në Serbi vetëm që është shtuar.

Reagimi ndaj krizës humanitare

Si organizatat qeveritare, ashtu edhe ato joqeveritare, ishin të papërgatitura për përmasën e fluksit të refugjatëve në shtetet fqinje, Shqipëri dhe Maqedoni. Është e qartë që nga NATO-ja nuk iu bënë paralajmërime as UNHCR-it dhe as organizatave të tjera për përmasën e mundshme të fluksit të refugjatëve. Mungesa e planifikimit pjesërisht mund t'i mvishet financimit të pamjaftueshëm të UNHCR-it. Trupat paqeruajtëse të NATO-s të vendosura në Maqedoni u angazhuan nga qeveritë e tyre për të ndihmuar rreth krizës së refugjatëve. Mungesa e bashkëpunimit dhe e koordinimit ndërmjet ushtrisë, agjencioneve të shumta dhe OJQ-ve kryesore humanitare, të cilat u vërsulën në rajon për ta ofruar ndihmën e tyre, ishte një pengesë e theksuar në angazhimin humanitar.

Edhe përkundër këtyre vështirësive fillestare, Komisioni e vlerëson lart shkallën e efikasitetit të reagimit humanitar, dhe e propozon një numër masash, siç është vlerësimi i OJQ-ve dhe bashkëpunimi më i mirë i organizatave ushtarake e civile, me qëllim të një planifikimi e koordinimi më të mirë në të ardhmen. Për të siguruar reagim të nivelit të duhur në krizat humanitare, si dhe për ta afirmuar gatishmërinë për bashkëpunim, Bashkësia Ndërkombëtare duhet të japë me shumë fonde për UNHCR-in.

Nivel jashtëzakonisht i lartë i reagimit humanitar ndodhi në kohën kur buxhetet humanitare në tërë botën zvogëloheshin. Kjo e ka kompromituar përcaktimin për paanshmëri dhe universalitet në dhënien e përkrahjes dhe të ndihmës humanitare.

Roli i mediave

Si NATO-ja, ashtu edhe qeveria në Beograd, bënë luftë propagandistike dhe shprehën qëndrime ekzagjeruese. Sidoqoftë, marrë në përgjithësi, gazetaret nuk lejuan që të mashtrohen. Madje edhe në Beograd, ku qeveria kishte kontroll të rreptë mbi mediat e pavarura, kishte gazetarë të guximshëm të cilët vazhduan ta shprehin mendimin e tyre.

Ashtu siç ka konstatuar që operacionet ushtarake gjatë ndërhyrjeve humanitare duhet të bëhen sipas rregullave strikte dhe të veçanta të angazhimit, komisioni po ashtu e konstaton që veprimet e mediave duhet të bëhen sipas rregullave të domosdoshme të punës së hapur. Komisioni e beson fuqimisht që qasja e hapur e të dyja palëve në çfarëdo ndërhyrje humanitare është qenësore, po qe se synohet që veprimet ushtarake të të dyja palëve të mbahen nën mbikëqyrje efektive publike. Komisioni e beson, po ashtu, që në kurfarrë rrethanash nuk bën të ketë kufizime për gazetarët në të vepruarit e tyre në zonat e konfliktit ku ndodhin intervenimet humanitare. Komisioni i dënon fuqimisht përpjekjet e qeverisë serbe për ta kufizuar gazetarinë e vet në pasqyrimin e luftës dhe të kohës së pasluftës, dhe në veçanti burgosjen e Miroslav Filipoviçit, për intervistat e tij me ushtarët e RFJ-së që kishin marrë pjesë në operacionet në Kosovë, si dhe për botimin e atyre që përmbanin pranimet e ushtarëve për vrasje dhe krime të luftës.

Administrimi i UNMIK-ut

Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara e autorizoi vendosjen e forcave të armatosura, KFOR, në Kosovë, si dhe vendosjen e administratës civile, UNMIK. Dr. Bernard Kushner u emërua nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për ta drejtuar këtë mision.

Pas verës së vitit 1999, Kosova shquhej me një nivel të lartë të krimit dhe të dhunës, një pjesë e madhe e të cilave ishin të drejtuara kundër popullatës minoritare, në veçanti kundër serbëve. Paaftësia për ta ndaluar valën e re të spastrimit etnik në Kosovë, megjithë praninë e 40.000 ushtarëve të armatosur, ishte dështimi më i madh i Bashkësisë Ndërkombëtare. Me shumë se gjysma e popullatës serbe, ose e lëshuan Kosovën bashkë me forcat serbe, ose u detyruan të arratiseshin më vonë. Popullata serbe e mbetur vazhdon të jetojë nëpër enklava ose në qytete të ndara. Ndarja e pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës, e paraqet, në veçanti, një vatër për ripërtëritjen e mundshme të konfliktit. Pos kësaj, lufta i forcoi edhe më shumë në mesin e popullatës shqiptare ato forca politike të cilat e kanë përkrahur dhunën.

Ndonëse autoritetet ndërkombëtare mund të krenohen me disa rezultate në vendosjen e administratës, si dhe me fillimin e zgjidhjes së disa problemeve të ekonomisë dhe të vendosjes së rendit dhe të ligjit, ato ende ballafaqohen me sfida serioze. Vendosja e UNMIK-ut ishte e ngadalshme, dhe puna e tij është e vështirësuar me pengesa të shumta, si nga mungesa e policisë dhe e personelit gjyqësor, ashtu edhe nga

tempoja e ngadalshme e donatorëve në realizimin e premtimeve të tyre financiare. Edhe pse KFOR-i mirrej edhe me angazhime civile, vetëm një pjesë e kontigjentëve nga disa nga shtetet ishte e gatshme që ta mirrte mbi vete punën e karakterit policor. Për më tepër, karakteri kontradiktor i Rezolutës 1244, e cila njëkohësisht përmbante si përcaktime për “autonomi substanciale e për vetëqeverisje të mirëfilltë” në Kosovë, ashtu edhe për sovranitetin e integritetin territorial të RFJ-së, e ngatërron në masë të madhe efikasitetin politik për një varg të çështjeve çfarë janë siguria, valuta, tregtia, etj.

Mësimet që mund të nxirren nga qeverisja e UNMIK-ut për misionet e tjera të OKB-së e përfshijnë nevojën për krijimin e një strukture të aftë policore ndërkombëtare, për shtimin e fondeve për misionet e pasluftës, si dhe rëndësinë e përkrahjes dhe të forcimit të grupeve politike të moderuara dhe demokratike.

Efektet në rajonet përreth

Konflikti në Kosovë nuk mund të kuptohet ndryshe, pos në kontekstin më të gjerë rajonal. Ky konflikt shkaktoi dridhje me një ndikim të fuqishëm në shtetet fqinje, si rezultat i fluksit të refugjatëve, të dëmeve ekonomike të shkaktuara nga ndërprerja e rrjedhave tregtare dhe prodhuese, të rritjes së kriminalitetit, si dhe me ndikimin politik në shtetet e brishta si Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Komisioni e përshëndet iniciativën e Paktit të Stabilitetit, e cila ofron mundësi të reja që në zonën paskonfliktuale të krijohet stabiliteti, dhe që të mundësohet bashkëpunimi në të tërë rajonin e Evropës Juglindore. Ky pakt ofroi shpresa të mëdha, mirëpo në vitin e vet të parë ka arritur relativisht pak. Kombinimi i kushtëzimeve të tepërta dhe i burokracisë së Brukselit, shkallën e efikasitetit e ka mbajtur në një nivel fare të ulët. Nëse ky edhe më tutje mbetet vetëm një koncept i cili, në thelb të vetin, rajonit i imponohet nga lart, pa ndonjë kontribut përkatës dhe identifikim me të, ekziston rreziku i dështimit të tij të plotë ose i shndërrimit në diçka irrelevante. Ky do të jetë i suksesshëm vetëm po qe se dëshira për bashkim me Evropën do t'i mbizotërojë agjendat nacionaliste dhe veprimet e korruptuara. E ardhmja e Ballkanit si tërësi duhet medoemos të jetë integrimi evropian.

Dy pengesat kryesore për integrimin rajonal janë institucionet e dobëta shtetërore dhe përmasat e mëdha të kriminalizimit të ekonomisë. Është me rëndësi që shoqëria civile të forcohet në të tërë rajonin dhe që të ndihmohen proceset e ndërtimit shtetëror. Po ashtu, është e nevojshme që të ketë më shumë bashkëpunim ndërkombëtar për ta

luftuar krimin e organizuar, përfshirë këtu ligjet përkatëse dhe kapacitet më të mira ekzekutive.

Komisioni është thellësisht i brengosur me keqësimin e gjendjes politike në Serbi, si dhe me rrezikun e konfliktit të ri të dhunshëm ndërmjet Serbisë e Malit të Zi. Ky rekomandon mbështetje më të lartë politike dhe ekonomike për Malin e Zi, si dhe një prani më të madhe në këtë vend. Po ashtu, ky e rekomandon një projekt afatgjatë të afirmimit të shoqërisë civile në Serbi, duke përfshirë OJQ-të, mediat alternative të pavarura, bashkësitë dhe universitetet, mirëpo krejt këto, duke i mbajtur në fuqi njëkohësisht sanksionet e caktuara ndaj regjimit të Beogradit.

Statusi i ardhshëm

Rezoluta 1244 e ka krijuar një hibrid të veçantë institucional, një protektorat të OKB-së me pushtet të pakufizuar, qëllimi i të cilit është që ta përgatisë vendin për autonomi dhe vetëqeverisje - mirëpo në kuadër të RFJ-së. Gjithashtu, është një plasaritje e theksuar në Këshillin e Sigurimit lidhur me atë se a duhet dhe si duhet të jetësohet kjo Rezolutë. Sidoqoftë, është plotësisht e qartë që pas tërë asaj të cilën shqiptarët e Kosovës e kanë përjetuar nga dora e pushtetit të RFJ-së, ata kurrsesi nuk do të jenë të gatshëm që ta pranojnë çfarëdo lloji të sovranitetit të RFJ-së, qoftë ai i plotë apo madje edhe simbolik.

Komisioni e konstaton që optionsi më i mirë i mundshëm për të ardhmen e Kosovës është “pavarësia e kushtëzuar.” Kjo e nënkupton zgjerimin e autonomisë dhe të vetëqeverisjes së premtuar me Rezolutën 1244, me qëllim që sistemi në Kosovë të shndërrohet në një vetëqeverisje efektive jashta RFJ-së, por përbrenda një kornize ndërkombëtare. Bashkësia Ndërkombëtare do ta merrte përsipër që ta garantojë sigurinë fillestare dhe ta mbikëqyrë mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, si dhe që ta integrojë Kosovën në një pakt të suksesshëm stabiliteti.

Statusi i “pavarësisë se kushtëzuar” do të arrihej përmes një “marrëveshjeje të brendshme” ndërmjet përfaqësuesve të Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë dhe shumicës kosovare, si dhe përfaqësuesve të minoriteteve etnike, dhe të një “marrëveshjeje të jashtme” të arritur me fqinjët e Kosovës. Këtu përfundimisht do të duhej të përfshihet edhe vetë Qeveria e Serbisë, mirëpo refuzimi i saj për t’u angazhuar në dialog nuk duhet ta ketë fuqinë e vetos për vetë procesin.

Ardhmëria e ndërhyrjes humanitare

Përvojat nga ndërhyrja e NATO-s në Kosovë e dëshmojnë nevojën për kapërcimin e hendekut ndërmjet të legalitetit dhe legjitimitetit. Komisioni është i besimit se janë pjekur kushtet për ta formuluar një kornizë parimore për ndërhyrjet humanitare, e cila do të përdorej si udhërrëfyese për të ardhmen në qëndrimet ndaj katastrofave imamente humanitare, dhe e cila, po ashtu, do të përdorej edhe për t'i vlerësuar kërkesat për ndërhyrje humanitare. Ne shpresojmë që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së mund ta miratojë një kornizë të tillë në ndonjë formë të modifikuar, çfarë është Deklarata, dhe që Karta e OKB-së do t'i përshtatet kësaj Deklarate, qoftë përmes amandamenteve përkatëse, qoftë përmes trajtimit rast më rast në Këshillin e Sigurimit. Ne po ashtu e sugjerojmë forcimin e shkallës së mbrojtjes të të drejtave të njeriut të para para me Kartën e OKB-së - ndonëse jemi plotësisht të vetëdijshëm për rrjedhën e problemeve politike në zbatimin e ndryshimeve të tilla.

Korniza e parimeve që e propozojmë i përmban tri parimet themelore që duhen respektuar në secilën kërkesë legjitime për ndërhyrje humanitare. Këto parime i përfshijnë vuajtjet e popullatës civile si pasojë e metodave të skajshme të shkëlqes së të drejtave të njeriut apo të shkaktuara nga rënia e qeverisë, angazhimin e mirëfilltë për mbrojtjen e drejtpërdrejtë të popullatës civile, si dhe vlerësimin e saktë që ndërhyrja ka gjasa reale për t'i dhënë fund katastrofës humanitare. Krahas kësaj, korniza i përfshin edhe tetë parime plotësuese kontekstuale të cilat mund të përdoren për ta vlerësuar shkallën e legjitimitetit gjatë përdorimit të forcës.

Korniza jonë e nënkupton, po ashtu, që qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare duhet t'i posedojnë mjetet përkatëse për zbatimin e këtij lloji të operacioneve. Kjo e nënkupton zgjerimin e kapaciteteve paqeruajtëse ndërkombëtare për ta mbrojtur popullatën civile në terren.

Komisioni është i vetëdijshëm që në shumë vende të botës ka shumë me tepër angazhim për mbrojtjen e sovranitetit të tyre sesa që ekziston aktualisht në Perëndim. Duke e patur parasysh dualizmin historik të kolonializmit dhe të Luftës së Ftohtë, është një brengosje e gjerë lidhur me ndërhyrjen perëndimore. Forca globale dhe në rritje e NATO-s e krijon ndjenjën e cenueshmërisë në pjesët e tjera të botës, veçanërisht në ndonjë rast të ngjashëm me Kosovën, ku NATO-ja e ka marrë të drejtën për ta anashkaluar Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Komisioni, ashtu siç përbëhet nga qytetarë të shoqërive të shumta jovevropiane dhe joperëndimore, i jep rëndësi të madhe vazhdimësisë së rolit të Kombeve të Bashkuara.

Ai kërkon më shumë fonde dhe e vlerëson se duhet të kërkohej rrugë për reformimin e organeve kryesore të OKB-së, veçanërisht të Këshillit të Sigurimit, në mënyrë që ato t'u përshtaten më mirë rrethanave të pas-Luftës së Ftohtë.

Propozimi për kornizën e re për intervenim humanitar nuk duhet ta zhvleftësojë nevojën për t'i parandaluar katastrofat humanitare në të ardhmen. Komisioni po ashtu përpqet për shumë më tepër angazhim politik si dhe burime ekonomike që duhet të dedikohen si për situatat para konfliktit ashtu edhe për ato të pas konfliktit. Në rastin e Kosovës, shumë më tepër vëmendje dhe kapital është shpenzuar gjatë intervenimit sesa para ose pas tij. Komisioni gjithashtu kërkon me shumë vëmendje për dimensionin gjinor të ndërhyrjes humanitare. Në rastin e Kosovës nuk i është kushtuar vëmendje e duhur pasojave të konfliktit ndaj femrave, veçanërisht përdorimit të dhunimeve si armë e luftës, si dhe shtimit të trafikimit të femrave në periudhën pas konfliktit. Gratë, pos kësaj, e luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit dhe të rindërtimit pas konfliktit.

Dhe, së fundit, Komisioni është plotësisht i vetëdijshëm që bota nuk ia ka kushtuar të njëjtin prioritet katastrofave humanitare jashtë Evropës siç ia ka kushtuar Kosovës. Komisioni shpreson se pas përvojës së Kosovës, do të jetë e pamundur të injorohen tragjeditë çfarë ishte gjenocidi në Ruandë dhe në pjesë të tjera të botës, dhe se mësimet nga konflikti në Kosovë do të na ndihmojnë të gjejmë përgjigje më efektive ndaj katastrofave të ardhshme humanitare, kudo që ato të ndodhin.

Fjala e ish-presidentit Nelson Mandela

E lexuar para Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar në Seminarin Përfundimtar për Kosovën, në Universitetin e Uituatërsrandit, Afrikë e Jugut, 25 gusht, 2000

Në fjalën e tij të hapjes në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në shtator 1999, Sekretari i Përgjithshëm, Kofi Anan, u angazhua për ndërhyrje të Kombeve të Bashkuara në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Ne e dimë se vetëm disa shtete i përkrahën qëndrimet e Sekretarit të Përgjithshëm, për më tepër, edhe më pak e mbështetën qëndrimin e Suedisë që “ndërgjegjja kolektive e njerëzimit kërkon veprim.”

Ngurrimi i një numri shtetesh mund të jetë mbase edhe i kuptueshëm, kur të mirret parasysh lodhja nga intervenimet e bëra me lehtësi; por ne të gjithë duhet të shprehim admirim për vendosmërinë e Sekretarit të Përgjithshëm Anan dhe të Suedisë për ndalimin e konflikteve që vazhdojnë të pllakosin aq shumë rajone të botës sonë. Prandaj, nuk është për befasi që të dyja palët i dhanë përkrahje Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën - Komision ky i krijuar për t'i vlerësuar zhvillimet në Kosovë. Si Kryeministri Person ashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm Anan janë të besimit që për t'i dhënë fund një konflikti, atë duhet ta njohim më mirë.

Ne duhet t'i bëjmë me dije Sekretarit të Përgjithshëm Anan, që në kohën kur angazhimi për paqe kërkon më shumë përgjegjësi në radhët e disa shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për veprimet e tyre, ne e konsiderojmë fat atë që në krye të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e kemi një njeri si ai. Dhe, në veçanti ne afrikanët, mburremi me të.

Përpjekja për paqe e ka krijuar nevojën për edhe më tepër dialog në planin ndërkombëtar. Raporti i Komisionit për Kosovën do të ofrojë një vlerësim të pavarur të konfliktit e të intervenimit, i cili do të ndihmojë në përparimin e dialogut ndërmjet të gjithë udhëheqësve, dijetarëve dhe palëve të interesuara. Është me rëndësi jetike që ne marrim pjesë në një diskutim të një diskursi të këtillë. Shekulli që jemi duke e lënë pas ishte përplot me luftra dhe konflikte të mëdha. Duke e filluar shekullin e ri, këto konflikte duhet t'i kuptojmë më mirë, ashtu që të nxjerrim mësim për të ardhmen tonë.

Ne e vlerësojmë si shumë me vend që Komisioni për Kosovën ka vendosur që mbled-

hjen dhe seminarin përfundimtar për Kosovën t'i mbajë pikërisht këtu, në Afrikë të Jugut. Po ashtu, është me vend që si temë e këtij seminari u zgjedhën mësimet që duhet nxjerrë nga rasti i Kosovës, ashtu që ato të përdoren për raste të konflikteve në rajonet siç janë Afrika e Azia. Meqë nuk e besojmë atë që është vetëm mungesa e njohurive në Bashkësinë Ndërkombëtare ajo e cila e shkakton ngurrimin për të vepruar në ndaljen e konflikteve në Afrikë, ky trajtim jo i njëjtë medoemos kërkon vëmendje të veçantë. Prandaj, Komisioni për Kosovën mund ta luajë në rol të rëndësishëm duke e trajtuar edhe këtë çështje.

Tash është bërë aq e rëndomtë të flitet për dështimin e Bashkësisë Ndërkombëtare për të ndërhyrë dhe për ta ndaluar gjenocidin në Ruandë, sa që pothuaja harrohet që kjo mospërfillje relative e Afrikës në këto çështje është shumë më e përgjithshme sesa vetëm në rastin e Ruandës. Për shembull, në kohën kur NATO-ja po bëhej gati për intervenimin në Kosovë, Sierra Leone dukej faktikisht si një vend i lënë pa vëmendje ndërkombëtare fare. Deri sa në Sierra Leone po bëheshin krime, Nigeria, duke u mbështetur në mandatin paqeruajtës - ECOMOG i dërgoi trupat e saj, mirëpo armatimet, fondet, komunikimet dhe të dhënat e inteligjencës, të premtuara nga fuqitë perëndimore nuk u materializuan.

Madje edhe pas përfundimit të gjenocidit në Ruandë, Bashkësia Ndërkombëtare kishte dhe ka më tepër mundësi që të ndërmarrë diçka, në vend që vetëm të pendohet për dështimin e saj. Dinamikat që e ndezën gjenocidin në Ruandë, edhe sot e tutje vazhdojnë të jenë aktive në konfliktet e vendeve fqinje, si në Burundi dhe në Republikën Demokratike të Kongos.

Ne nuk jemi duke e thënë që këto konflikte, si dhe konfliktet e tjera afrikane, duhet të zgjidhen sipas një mostre të njëjtë për zgjidhjen e konflikteve, apo që aksioni që u ndërmor në Kosovë duhet të transplantohet në konfliktet e këtij kontinenti. Megjithkëtë, ne në Afrikë dhe në Azi duhet ta shprehim admirimin për gatishmërinë dhe vullnetin e një pjese të Bashkësisë Ndërkombëtare për intervenim dhe për dhënien e mjeteve për rindërtimin e shoqërisë kosovare.

Andaj edhe është në veçanti inkurajuese për ne që ta theksojmë interesimin e Bashkësisë Ndërkombëtare për procesin paqësor në Burundi, ku ne e kemi rolin kryesor që nga fillimi i këtij viti, dhe ku jemi duke u angazhuar të frymëzuar nga vepra e shquar e Mwalimu Julius Nyereres. Një numër i udhëheqësve nga Afrika edhe nga Bashkësia e gjerë Ndërkombëtare, e kanë ndarë një pjesë të kohës së tyre që të marrin pjesë në disa nga sesionet plenare të procesit paqësor të mbajtur në Arusha. Të hënën, më 28 gusht, do ta kemi edhe një mbledhje të tillë plenare tjetër, kësaj here me shpresë

për ta nënshkruar marrëveshjen paqësore. Edhe njëherë disa kryetarë të shteteve dhe të qeverive, ose përfaqësues të tyre, do të mblidhen bashkërisht për ta bërë të qartë interesin e ripërtëritur të botës për çështjet e Afrikës.

Edhe më inkurajuese janë paralajmërimet nga udhëheqësit perëndimorë, të cilët tashmë e kanë shprehur vullnetin e tyre për ta ndihmuar në mënyrë aktive rindërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë së Burundit, menjëherë pasi të nënshkruhet marrëveshja paqësore. Ne do t'i vazhdojmë në mënyrë aktive përpjekjet për mobilizimin e Bashkësisë Ndërkombëtare rreth këtij projekti. Ne dëshirojmë që Burundi të bëhet një shembull i paqes e cila vjen si rezultat i arritur përmes veprimeve të Bashkësisë Ndërkombëtare.

Në të kaluarën, shpesh herë kemi komentuar se në botën bashkëkohore të globalizimit, ne vërtet jemi duke u përkujdesur përsëri për vëllaun apo për motrën. Fshati global nuk mund të jetë hiç më tepër sesa depërtim dhe qasje në tregje; ai gjithsesi duhet ta përfshijë edhe atë që sëmundjet dhe fatkeqësitë e njerit të jenë shqetësim për të gjithë.

Fjalët që po i themi sot këtu janë për t'i dhënë mbështetje Komisionit për Kosovën, si një vegël potencialisht e fuqishme për ta afirmuar dhe konsoliduar ndjenjën e unitetit mes nesh. Duke arritur ta kuptojmë atë pjesë destruktive të njerëzimit që ka shkakuar aq shumë dhembje e vuajtje përgjatë tërë historisë sonë, ne mund të përparojmë drejt të kuptuarit se kemi aq shumë gjëra të përbashkëta, si të mira ashtu edhe të këqija. Bashkërisht, dhe vetëm bashkërisht, ne mund ta bëjmë botën një vend me të mirë për fëmijët tanë.

Ju uroj shëndet, dhe ju falënderoj për mundësinë për pjesëmarrje në këtë debat. Dhe, në veçanti ju falënderoj, kur në paraqitjet tuaja të mendoni për Afrikën.

Ju Falemnderit!

Hyrje

Lufta në Kosovë është tragjedia me e re e konfliktit në Ballkan - konflikt ky që zgjati një dekadë pas shpërthimit të brendshëm të Federatës së vjetër jugosllave, që e la një çerek milioni njerëz të vdekur, me qindra mijëra të zhvendosur, dhe pjesën më të madhe të rajonit të rrënuar. Sidoqoftë, kjo luftë do të mbahet në mend si moment kthese: nevoja për intervenim të armatosur kolektiv me qëllimin të zbatimit immanent të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB), mirëpo pa autorizimin e KSKB. NATO-ja, duke i dërguar për herë të parë forcat e armatosura në një luftë, e nxori para syve të botës doktrinën kontraverse të “intervenimit humanitar.”

Nuk është për befasi që me këtë intervenim disa çështje ndërkombëtare me peshë janë futur përbrenda kornizave: pajtueshmëria e angazhimit për mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke e respektuar sovranitetin kombëtar dhe pengesat ligjore që e kufizojnë përdorimin e forcës për qëllime jombrojtëse; vazhdimësia e ligjësive së rendit botëror pas Luftës së Dytë Botërore, e paraparë me Kartën e Kombeve të Bashkuara; si dhe aftësia e Kombeve të Bashkuara për të vepruar si paqeruajtës global dhe shtrirja e të drejtës për vetëvendosje. Por, po ashtu, rrjedha e luftës i ka provokuar në veçanti edhe disa çështje fundamentale për mënyrën se si do të trajtohen konfliktet në të ardhmen. Pse Bashkësia Ndërkombëtare nuk ishte e aftë të veprojë më herët për ta parandaluar përshkallëzimin e konfliktit? Pse dështoi diplomacia? A ka vepruar drejt NATO-ja duke e nisur fushatën ushtarake pa miratimin e Këshillit të Sigurimit? A mund të garantohet marrëveshja vetëm përmes ndërhyrjes së armatosur? Si mund ta sigurojë Bashkësia Ndërkombëtare paqen dhe sigurinë në të ardhmen e rajonit?

Këto pyetje e kanë tërhequr vëmendjen globale dhe kanë shkaktuar debate të nxehta. Ato kërkojnë studime të kujdesshme dhe analiza të detajuara. Formimi i Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën dhe hartimi i këtij raporti janë pasojë e njohjes së kësaj nevoje.

Për ta kuptuar aksionin e ndërmarrë në Kosovë është e nevojshme që konflikti të shikohet përbrenda kontekstit të vet. Ky ndodhi në fundin e një dekade të mbushur

me konflikte mizore. Popullata civile, dhe jo ushtarët, ishin caku më e shpeshtë, kryesor, dhe viktime e luftës moderne; shkaktimi i vuajtjeve të civilëve shpesh herë ishte qëllimi kryesor i veprimeve ushtarake. Lufta në Bosnje, me kulmin e vet më të lartë në masakrën e Srebrenicës, është një tregues-emblemë i kësaj mizorie. Vrasjet me përmasa gjenocidi në Ruandë e dëshmuar që popullata civile ishte shenjëstra kryesore e të gjitha sulmeve. Këto ngjarje ishin tragjike, jo vetëm për vuajtjet e shkaktuara, por edhe për pasivitetin dhe mosintervenimin e një pjese të Bashkësisë Ndërkombëtare. Kosova, nga ana tjetër, është rast i intervenimit kolektiv, mirëpo është një që i ka edhe dilemat e veta.

Gjatë vitit të kaluar janë dhënë dy raporte të përgatitura nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara. I pari, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm, sipas Rezolutës të Asamblesë së Përgjithshme 53/35 (1998), e dokumenton mënyrën si dhe shkaqet e dështimit të Kombeve të Bashkuara në parandalimin e sulmit në Srebrenicë nga serbët e Bosnjës, në korrik 1995, në të cilin rast u masakruan 8.000 burra e djem myslimanë. I dyti, Raporti mbi hetimin e pavarur lidhur me veprimet e Kombeve të Bashkuara gjatë gjenocidit në Ruandë, 1994, është drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Kofi Anan, me mandat nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit. Secili nga këto raporte përqendrohet në rrethanat në të cilat Kombet e Bashkuara janë akuzuar se kanë bërë më pak nga ajo që kanë mundur të bëjnë për t'i parandaluar tragjeditë. Asnjëri raport nuk e mohon përgjegjësinë përkatëse të organeve të caktuara të Kombeve të Bashkuara. Këto raporte e treguan dëshirën e sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për t'i shqyrtuar seriozisht mangësitë e veta. Raporti i tretë, ai i hartuar nga Paneli mbi Operacionet Paqësore të Kombeve të Bashkuara, i publikuar në gusht të vitit 2000, e vë në pah nevojën për një doktrinë më të fuqishme paqeruajtëse, duke përfshirë këtu edhe mandate më realiste.

Ky raport, i hartuar nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, nuk është produkt i punës së një komisioni të emëruar nga ndonjë qeveri apo organizatë joqeveritare. Anëtarët e Komisionit kanë marrë pjesë vetëm në cilësi personale. Komisioni është formuar në bazë të nismës së Kryeministrit të Suedisë, Goran Persson, i cili ishte i shqetësuar nga mungesa e analizave të pavarura rreth konfliktit në Kosovë, dhe nga mungesa e ndonjë synimi real për t'i hulumtuar mësimet e nxjerra nga ky konflikt. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Kofi Anan, me të cilin ai e kishte diskutuar joformalisht këtë çështje, e ka dhënë pëlqimin për këtë projekt.

Kryeministri Persson ka njoftuar për formimin e Komisionit më 6 gusht, 1999.

Përfshirja e Qeverisë Suedeze në punën e Komisionit është shtrirë vetëm deri te ftesa Richard Goldstone-it nga Afrika e Jugut dhe z. Karl Tamit, Sekretar i Përgjithshëm i Qendrës Ndërkombëtare “Ulof Palme” nga Stokholmi për t’u angazhuar si drejtues, përkatësisht si bashkëdrejtues.

Emërimi i dy anëtarëve të tjerë të Komisionit është bërë me ftesën dërguar individëve të caktuar nga ana e z. Goldstone dhe z. Tami. Për shkak të natyrës së ndjeshme të kësaj nisme - në shqyrtim nga Komisioni janë marrë shumë figura ndërkombëtare - përzgjedhja është bërë duke u mbështetur në aftësitë e dëshmuara profesionale, duke e marrë parasysh si përbërjen gjinore ashtu edhe atë gjeografike të Komisionit.

Njëmbëdhjetë anëtarët e emëruar janë:

Dr. Hanan Ashrawi nga Palestina

Profesori Grace d’Almeida nga Benini

Senatori Akiko Domoto nga Japonia

Profesori Richard Falk nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Ambasadori Oleg Grinevsky nga Federata Ruse

Z. Michael Ignatieff nga Kanadaja

Profesor Mary Kaldor nga Mbretëria e Bashkuar

Profesor Marta Minow nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Profesor Jacques Rupnik nga Franca

Z. Theo Sommer nga Gjermania, dhe,

Z. Jan Urban nga Republika Çeke.

Raporti do t’i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Kofi Ananit. Komisioni i është mirënjohës Sekretarit të Përgjithshëm për zotimin e tij që ta pranojë raportin. Komisioni është i bindur që Kombet e Bashkuara janë vendi më i përshtatshëm për të implementuar dhe për të nxjerrë mësim nga përvojat e shumta të konfliktit në Kosovë. Megjithatë, nuk mund të thuhet se Kombet e Bashkuara janë në qendrën e vëmendjes së këtij raporti. Përkundrazi, raporti e ka një përqendrim shumë më të gjerë, i cili e përfshin vlerësimin e veprimeve të aktorëve më kryesorë të involvuar në konflikt, duke e përfshirë këtu edhe OKB-në, mirëpo duke mos u përqendruar vetëm në angazhimin e OKB-së; dhe as që e ka patur ndonjëherë për qëllim që mësimet e nxjerra t’i destinohen vetëm Kombeve të Bashkuara. Komisioni shpreson që Raporti do të ketë shumë lexues, që do të diskutohet gjerësisht, dhe që përfundimet e tij do të shqyrtohen seriozisht.

Gjatë dymbëdhjetë muajve që nga emërimi, Komisioni është takuar pesë herë: në Stokholm, më 21 nëntor 1999, në Nju-Jork, më 5-6 dhjetor 1999, në Budapest, më 5-

6 prill 2000, në Firencë, më 26-30 qershor 2000, dhe në Johanesburg, më 27-28 gusht të vitit 2000. Para takimeve në Nju-Jork, Budapest dhe Johanesburg janë mbajtur seminare për informim dhe për lehtësimin e punës së Komisionit, duke mbledhur një numër të madh ekspertësh që mund të ofronin të dhëna thelbësore për krizën e Kosovës.

Puna e anëtarëve të Komisionit ka vazhduar gjatë tërë vitit. Dy delegacione të Komisionit e kanë vizituar Kosovën, ku janë takuar me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe të atij shqiptar, të cilët kanë dëshmuar për konfliktin, si dhe me administratorët ndërkombëtarë të ngarkuar për mbikëqyrjen e operacioneve paqeruajtëse. Drejtuesi dhe Bashkëdrejtuesi janë takuar me përfaqësues të shteteve pjesëtare të Aleancës së NATO-s dhe jashtë saj. Pjesëtarë të tjerë të Komisionit ishin po ashtu të ftuar në këto mbledhje dhe në disa raste edhe kanë marrë pjesë në to. Nga shtetet e ftuara vetëm dy qeveri kanë refuzuar të bashkëpunojnë me Komisionin. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuara nga zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit, kanë qenë të gatshme të japin përkrahje vetëm me kusht që Komisioni ta kufizojë punën e tij hetimore në shkeljet e të drejtave të njeriut të bëra nga Republika Federale e Jugosllavisë gjatë kohës së konfliktit. RFJ nuk kishte vullnet të bisedonte me anëtarët e Komisionit, duke e akuzuar gjyqtarin Goldstone për qëndrim antiserb të manifestuar gjatë punës së tij si kryeprokuror i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, si dhe për shkak se ata në parim, siç e thanë, ishin kundër komisioneve.

Lufta në Kosovë ka nxitur komente jashtëzakonisht të shumta: libra, artikuj, website dhe dokumente zyrtare lidhur me krizën. Faktet dhe shifrat shpesh herë janë kontradiktore dhe të dykuptimta. Komisioni nuk ka provuar të shërbehet me të dhëna nga burime sekrete. Punën e vet e ka bazuar tërësisht në dokumente publike dhe e ka marrë përsipër që të paraqesë vetëm të dhëna të verifikuara. Komisioni i ka vënë në pah rastet e pasqaruara. Përpjekje e veçantë është bërë për t'i siguruar faktet më të besueshme lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe për këtë qëllim ka patur bashkëpunim të ngushtë me grupe të ekspertëve për të drejtat e njeriut dhe në mbledhjen e të dhënave për to. Dokumentet e tyre janë paraqitur në Aneksin I të këtij Raporti, ndërkaq zbulimet më të rëndësishme janë dhënë në vetë raport. Puna e Komisionit ka zgjatur deri me 28 gusht 2000, dhe nuk i përfshin zhvillimet apo informatat pas kësaj date.

Armiqësitë në Kosovë në pjesën e vet me të madhe kanë ndodhur ndërmjet dy grupeve të identifikuara etnike - serbëve dhe shqiptarëve - ku secili prej tyre e ka gjuhën e vet. Çdo vlerësim i konfliktit i cili mbështetet mbi identitetin etnik, kërkon një tra-

jitim të kujdesshëm të gjuhës, prandaj edhe çdo analizë për Kosovën do të jetë e mangët po qe se nuk e merr parasysh ndjeshmërinë gjuhësore. Komisioni ka synuar ta përdorë një sistem i cili është njëkohësisht praktik dhe jo-ofendues. Në raport përdoret shprehja “Kosovo,” meqenëse kjo është mënyra në të cilën përdoret në gjuhën angleze. Për emrat e vendeve të Kosovës, raporti i jep të dyja versionet - shqip dhe serbisht (p.sh. Pejë/Pec), dhe sipas Konventës së miratuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, nuk përdoret asnjë theks.

Raporti është produkti final i punës së Komisionit. Ai i paraqet përpjekjet kolektive të të gjithë anëtarëve të Komisionit. Janë bërë përpjekje maksimale që analizat të paraqesin diskutimet e anëtarëve pjesëmarrës të Komisionit. Megjithatë, Kryesuesi dhe Bashkëkryesuesi i Komisionit e mbajnë përgjegjësinë për pjesën përmbyllëse të këtij raporti.

Platforma lidhur me Misionin e Komisionit ka qenë udhërrëfyese për strukturën e raportit. Në deklaratë thuhet:

Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën do t’i shqyrtojë zhvillimet më kryesore të para-, gjatë- dhe të pas-luftës në Kosovë, duke i përfshirë edhe shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në rajon. Komisioni do të paraqesë një analizë objektive dhe të detajuar për opsionet të cilat Bashkësia Ndërkombëtare i kishte në dispozicion për t’u ballafaquar me krizën. Ky do të përqendrohet në origjinën e krizës së Kosovës, përpjekjet diplomatike për ndaljen e konfliktit, rolin e OKB-së dhe për vendimin e NATO-s për intervenim ushtarak. Do të analizohet kriza e refugjatëve, duke i përfshirë këtu edhe veprimet e Bashkësisë Ndërkombëtare për zgjidhjen e saj. Do të shqyrtohet, po ashtu, edhe ndikimi i konfliktit në shtetet e rajonit dhe në shtetet e tjera. Komisioni do ta vlerësojë edhe rolin e punëtorëve humanitarë, të OJQ-ve dhe të mediave gjatë kohës së luftës. Dhe, së fundit, Komisioni do t’i identifikojë normat e të Drejtës Ndërkombëtare dhe të diplomacisë, të cilat dolën në pah gjatë luftës në Kosovë, si dhe përshtashmërinë e normave dhe të institucioneve ekzistuese për të reaguar dhe për t’i parandaluar krizat e ngjashme në të ardhmen. Pos kësaj, Komisioni do të bëjë fjalë edhe për statusin e ardhshëm të Kosovës, për mësimet e nxjerra për Kosovën, si dhe për mësimet e nxjerra për të ardhmen.

Raporti është i ndarë në tri seksione: narracioni, analiza dhe konkludimi. Kjo strukturë është menduar si një mënyrë për ta thjeshtësuar paraqitjen; megjithatë, një përsëritje e herëpashershme e gjërave është e pashmangshme. Pjesa I, “Çfarë ndodhi?,” e dokumenton kronologjinë faktike të krizës së Kosovës, duke filluar që nga burimi. Lufta në Kosovë është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë e përfshin vorbullën ogurzezë të

dhunës dhe të rezistencës: pjesa e dytë fillon nga intervenimi i NATO-s dhe përfundon me marrëveshjen paqësore të qershorit 1999. Kapitulli i fundit e paraqet në trajtë narrative Kosovën e sotme - të administruar nga Kombet e Bashkuara në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Pjesa II e ofron një analizë të atyre aspekteve të intervenimit që janë objekt i kontestimeve të ashpra. Kjo e shqyrton dështimin e diplomacisë në parandalimin e konfliktit, në veçanti të asaj të provuar në Rambuje, si dhe alternativat e intervenimit. Çështjet që kanë të bëjnë me të Drejtën Ndërkombëtare, në veçanti legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare - si për nga forma ashtu edhe për nga përmbajtja - janë të analizuar deri në detaje. Kapitulli i tretë në këtë seksion, përmes një shqyrtimi të gjithanshëm e trajton rolin e organizatave për ndihmë humanitare si dhe rolin e mediave në konfliktin e Kosovës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar saktësisë së dëshmimeve të dhëna nga qindra mijëra refugjatë, të cilët pasi që e kishin braktisur Kosovën u dyndën në kufijt e Shqipërisë, Maqedonisë, Italisë, dhe të Malit të Zi. Pasojat e konfliktit në rajon, megjithatë, janë më të mëdha sesa thjesht pranimi i refugjatëve. Një kapitull i është kushtuar ndikimit politik dhe atij ekonomik që e ka shkaktuar kriza në rajon, veçanërisht pozita dhe perspektiva e Serbisë, si dhe përpjekjet e ripërtëritura për rindërtimin e bashkëpunim rajonal, që janë duke u bërë nga Pakti Evropian i Stabilitetit. Kapitulli i fundit në këtë seksion është një udhërrëfyes për më tutje: shqyrtimi i opsioneve për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Pjesa III e Raportit i përmban konkludimet e Komisionit. Këto konkludime janë formuluar duke e patur garantimin e paqes së qëndrueshme dhe të sigurisë për Kosovën si qëllim kryesor, në veçanti, dhe për rajonin e Ballkanit, në përgjithësi. Mirëpo Komisioni e beson që shumë nga këto konkludime mund të jenë të dobishme për t'u zbatuar edhe në rastet e konflikteve të tjera, në të tërë botën. Pikërisht për këtë qëllim, Komisioni i ka shtruar konstatimet e veta në kontekst me të gjerë historik e politik. Gjithashtu, me një përqëndrim të veçantë, ai ka synuar që nga Kosova të nxirren mësim të cilat mund të përdoren për zgjidhjen e konflikteve në Afrikë dhe në Azi - rajone këto të cilat tepër gjatë i kanë vuajtur pasojat e përçarjes botërore në të zhvilluarit dhe në ata në zhvillim.

PJESA I

ÇFARË NDODHI?

Parathënie

Karakteri i ndryshueshëm i dhunës politike bashkëkohore i konteston disa nga mënyrat tradicionale për kategorizimin e trajtave të dhunës. Dallimi tradicional ndërmjet “kohës së paqes” dhe “kohës së luftës” është zbehur me të madhe, dhe e njëjta mund të thuhet edhe për dallimin ndërmjet konfliktit të “brendshëm” dhe të atij të “jashtëm.” Disa faza të konfliktit në Kosovë bëjnë që këto çështje të shtrohen në mënyrë të ngutshme.

Sipas konceptit tradicional, shkelja e të drejtave të njeriut korrespondon me kohën e paqes, ndërkaq shkelja e të drejtës ndërkombëtare humanitare me atë të luftës. Nëse konflikti që ka ndodhur në Kosovë vështrohet sipas kriterëve të tilla, atëherë mund të vijmë në përfundime të gabuara. Qeveria e Beogradit për vite të tëra në Kosovë e kishte imponuar një pushtet të vetin represiv, përmes mekanizmit të shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, të cilat shkonin deri në ato përmasa sa që lirisht mund të thuhet se ishte vënë në pikëpyetje e drejta për ekzistencë e minoritetit të vënë në shënjestër. Në fakt, reagimet kundër krimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut e përshkojnë rezistencën e shqiptarëve, qoftë në formën e aktiviteteve jo të dhunshme të LDK-së, apo, me vonë, në trajtë të luftës së armatosur të UÇK-së. Sa i përket fazës së mëvonshme të luftës së armatosur, si dhe përdorimit të dhunës kundër kryengritjes nga ana e RFJ-së, është e mundur që faktet të përshkruhen edhe nga këndvështrimi i shkeljes së të drejtave të njeriut, por edhe nga ai i të drejtës humanitare ndërkombëtare, ku kjo e dyta është më e përshtatshme për atë gjendje të raportit ndërmjet të shtetit dhe të shoqërisë i cili vlerësohet si “konflikt i armatosur.” Me ndërkombëtarizimin e konfliktit, dhe, mbi të gjithat, me fillimin e fushatës së NATO-s, shfaqet edhe kushti i “luftës,” dhe sjelljet e papranueshme të të dyja palëve mund të kuptohen më lehtë nëse trajtohen në kuadër të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare (që njëfjet si Ligjet e Luftës).

Në këtë mënyrë, këto elemente ngrejnë për diskutim përshtatshmërinë e përkufizimeve tradicionale. Këtu ekzistonin dy lloje të konfliktit. Njëri ishte konflikti i armatosur i brendshëm, i cili zhvillohej brenda në Kosovë, dhe ku strategjia ushtarake e kishte formën e shkeljeve masive dhe sistematike të të drejtave të njeriut. Ky konflikt ka zgjatur nga shkurti 1998 deri në qershor 1999, ndonëse përshkallëzimin më të fuqishëm e ka patur pas marsit 1999. Mirëpo, ekzistonte edhe konflikti i një lloji

tjetër, ai ndërkombëtar, ndërmjet NATO-s dhe Jugosllavisë, i cili zgjati nga 24 marsi 1999, deri më 10 qershor të po të njëjtit vit.

Kapitulli 1 e trajton periudhën që nga shfuqizimi i statusit të autonomisë së Kosovës më 1989, e deri në shkurt të vitit 1998. Këtu bëhet fjalë për shkëljen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Kapitulli 2 e trajton fazën e parë të organizimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, nga shkurti 1998 e deri në mars 1999, ku ishin të përfshira forcat e RFJ-së dhe UÇK-ja. Sjelljet e gabuara të që të dyja palëve janë trajtuar në bazë të Protokolit II të Konventës së Gjenevës, i cili e kodifikon të drejtën humanitare ndërkombëtare për “viktimat e konflikteve të armatosura jo-ndërkombëtare,” dhe sipas standardeve të aplikueshme të ligjeve të përgjithshme të luftës. Frenimi i qeverive sovraane në këto rrethana është minimal, ashtu siç e parasheh Protokoli I, dhe shtetet vazhdojnë të ngurrojnë për ta pranuar përgjegjësinë e tyre.

Kapitulli 3 e trajton vazhdimin dhe përshkallëzimin e konfliktit të brendshëm të armatosur deri në shndërrimin e tij në konflikt të armatosur ndërkombëtar, kur NATO-ja i filloi sulmet. Të katër Konventat e Gjenevës lidhur me Ligjet e Luftës janë relevante, me plotësimet e bëra me Protokolin I, të nënshkruar më 1977, të zbatueshëm për Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Ndërkombëtare.¹

Ky raport po ashtu ka të bëjë me nivelin më të lartë të standardeve mbrojtëse në secilin intervenim të ardhshëm ndërkombëtar i cili do të cilësohet si “intervenim humanitar,” dhe propozon që të fillojnë negociatat për “Protokolin III,” që kjo të bëhet eksplicite dhe e detyrueshme. Ndërkohë, raporti e fton Asamblenë e Përgjithshme që ta miratojë Deklaratën lidhur me parimet e intervenimit humanitar. (Shih kapitullin “E Drejta dhe Intervenimi Humanitar” për diskutim të mëtejshëm).

Kapitulli 4 e trajton periudhën e pushtetit të KFOR-it/UNMIK-ut deri në gushtin e vitit 2000. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit në aspektin juridik i ngjan periudhës së trajtuar në Kapitullin 1, ndonëse roli i institucioneve ndërkombëtare, pas ndodhjes së luftës, krijon dykuptimësi në ndërtimin e paqes.

1. Origjina e krizës kosovare

Shpesh herë thuhet që konfliktet etnike e kanë zanafillën me qindra vjet më parë. Protagonistët thirren në migrimet e mëdha, në betejat epike dhe në vendet e shenjta. Konflikti për Kosovën nuk bën përjashtim nga kjo. Ndonëse është e vërtetë që rrëfimet dhe mitet mbi Kosovën janë ruajtur me shekuj nëpër balada dhe legjenda, vetëm në shekullin nëntëmbëdhjetë ato u ringjallën si pjesë e narrativit të lëvizjeve rivale serbe dhe shqiptare. Historia e Kosovës e shekullit njëzet ka qenë e përgjakshme, me episode të dëbimeve masive dhe të krimeve të bëra si nga sllavët ashtu edhe nga shqiptarët. Megjithëkëtë, qarku i fundit i dhunës nuk mund të shpjegohet vetëm duke u thirrur në këtë histori.

Burimet e krizës së tanishme duhen kuptuar si një valë e re nacionalizimi në vitet '70 e '80, që u ushqye nga kjo histori. Ndonëse Kosova ishte e popullzuar kryesisht me shqiptarë, ajo ishte simbol i aspiratave nacionaliste si për shqiptarët, ashtu edhe për serbët. Lëvizja kombëtare shqiptare filloi në Prizren më 1878, ndërkaq, përfshirja e Kosovës në Serbi më 1912, ishte njëri nga kujtimet më të hidhura për shqiptarët në vitet që erdhën më pas. Serbët e kundronin Kosovën si vend i shenjtë për kombin e tyre, vend ku ushtria serbe u mposht nga turqit në betejën e famshme të Fushë Kosovës, në qershorin e vitit 1389, dhe, po ashtu, si vend ku janë shumë nga kishat historike të Serbisë. Po ashtu, intelektualët nacionalistë të Beogradit e shfrytëzojnë diskriminimin e serbëve që jetonin në Kosovë gjatë viteve '80.

Nacionalizmi ishte ai që e solli në fuqi Sllobodan Millosheviqin dhe miratimin zyrtar të një agjende ekstreme të nacionalizmit serb. Sapo kjo agjendë nacionaliste u bë politikë qeveritare, lufta u shndërrua në një mundësi reale. Në të vërtetë, mbase është më tepër për kureshtje se si ndodhi ajo që lufta nuk shpërtheu deri në vitin 1998, dhe se a ka mundur Bashkësia Ndërkombëtare të bëjë diçka për ta shfrytëzuar këtë kohë të dhënë falas për ta parandaluar atë.

Konflikti në Kosovë duhet kuptuar edhe në kontekstin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Kosova ishte një nga njësitë përbërëse të Jugosllavisë: ishin gjashtë republika (Serbia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnia e Hercegovina), si dhe dy krahina autonome në Serbi (Vojvodina dhe Kosova). Heqja e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës më 1989, ishte momenti kyç në një vargan ngjarjesh që

shpunë drejt kërkesave për pavarësi nga republikat e tjera, si dhe drejt luftrave në Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë dhe, së fundit, edhe në vetë Kosovë. Zgjidhja përfundimtare për ish-Jugosllavinë ende nuk është përcaktuar.

Ngritja e Milosheviqit

Pas Luftës së Dytë Botërore, udhëheqja e re komuniste e Jugosllavisë e shpalli Kosovën si “pjesë konstituive” autonome të Serbisë. Nën sundimin e Titos, shqiptarët kosovarë përjetuan si përndjekje të egra ashtu edhe rreze lirie. Pasojat e tri dekadave të kolonizimit të pothuaj gjysmës së tokës së punueshme të Kosovës, i cili kolonizim udhëhiqej nga qeveria serbe, u zbutën kur Titoja, pas vitit 1945, ua ktheu një të tretën e tokës pronarëve shqiptarë. Po ashtu u hoqën disa nga masat e paraluftës, të zbatuara me qëllim të ngulfatjes së gjuhës shqipe. Mirëpo, periudha menjëherë pas luftës në Jugosllavi ishte periudhë dhune, dhe pas prishjes së Titos me Moskën në vitin 1948, shqiptarët kosovarë përjetuan masa në veçanti mizore dhune, pasi që dyshoheshin se kishin simpati për kryetarin e Shqipërisë dhe stalinistin besnik, Enver Hoxha.

Njëri nga aktet më publike të represionit gjatë kësaj periudhe, ishte procesi i montuar i mbajtur në Prizren më 1956, në të cilin udhëheqës komunistë shqiptarë u akuzuan si pjesëmarrës të një rrjeti spiunësh të cilët kinse ishin infiltruar në Kosovë nga Shqipëria, dhe të cilëve iu shqiptuan dënime të gjata burgimi. Gjatë kësaj periudhe islamizmi shtypej, dhe shqiptarët e sllavët myslimanë inkurajoheshin ta shpallnin vetën turq dhe të emigronin për në Turqi. Serbët dhe malazezët dominonin në administratë, në forcat e sigurimit dhe në punësimin industrial. Investimet publike ishin të pakta, dhe nivelet e prodhimit dhe të të ardhurave rriteshin më ngadalë sesa në pjesët e tjera të Jugosllavisë.

Kjo gjendje filloi të ndryshojë në vitet 1960. Më 1966 Aleksandar Rankoviçi, personi më i ndërlidhur me politikën e serbizimit, përjashtohet nga Komiteti Qendror.¹ Më 1968 ndodhën demonstratat e studentëve, si edhe në pjesët e tjera të Evropës. Një generatë e re e evropianizuar kërkonte liri më të mëdha në përgjithësi, ndonëse disa prej parullave ishin “Kosova - Republikë,” “Duam Universitet,” “Poshtë politika koloniale në Kosovë” dhe “Rroftë Shqipëria.” Ndonëse demonstratat u shtypën në mënyrën më të vrazhdë, gjatë kësaj periudhe u ndërmorën një varg masash të cilat e përmirësuan dukshëm pozitën e shqiptarëve kosovarë. Ato përfshinin themelimin e një universiteti në Prishtinë, një afrim me Shqipërinë, shfrytëzimin e profesorëve shqiptarë dhe të teksteve shqipe për mësimin e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare, shqiptarizimin e shpejtë të administratës dhe të sigurisë, si dhe investime të shtuara publike.

Kulmi i këtyre përmirësimeve ishte Kushtetuta e vitit 1974, sipas të cilës Kosova, sikurse edhe Vojvodina, u shpallën krahina autonome të Serbisë. Statusi i krahinës autonome ishte pothuaj i njëjtë me statusin e republikës. Si krahinë autonome, Kosova e kishte administratën e vet, kuvendin dhe pushtetin juridik dhe bënte pjesë edhe në institucionet e Serbisë edhe në ato federale - në Kryesinë kolektive dhe në Parlamentin federal, në të cilin e kishte të drejtën e vetos. Dallimi kryesor midis krahinës autonome dhe republikës ishte se krahinat nuk e kishin të drejtën e shkëputjes nga federata dhe nuk konsideroheshin bartëse të sovranitetit jugosllav, siç ishin republikat. Ky dallim shpjegohej me faktin se shqiptarët, sikurse edhe hungarezët e Vojvodinës ishin klasifikuar si kombësi, dhe jo si komb. Kjo me gjasë ishte bërë meqë kombet e tyre e kishin një atdhe dikund tjetër. Kombet kishin të drejtë për republikën e tyre, por kombësitë këtë të drejtë nuk e kishin. Në rendin kombëtar të ndjeshëm ishte madje edhe një kategori më e ulët e pakicës kombëtare, e cila zbatohet kryesisht për romët, vllahët dhe hebrenjtë.

Kur studentët dhe demonstruesit e tjerë dolën në rrugë më 1981, çështja që argumentohej kishte të bënte më shumë me statusin sesa me dëshirën për pavarësi. Ishte e vërtetë që rritja e shpejtuar e Universitetit dhe ndikimi nga Tirana i kishin ushqyer aspiratat nacionaliste; më 1978 u organizua kremtimi në të tërë Kosovën për ta shënuar njëqindvjetorin e formimit të Lidhjes së Prizrenit - e ashtuquajtura “Rilindja Kombëtare” shqiptare. Por emocioni dominues që përshkonte kërkesën për status të republikës shihej të ishte pezmi që kombësitë, d.m.th. shqiptarët apo hungarezët, ishin disi inferiorë ndaj kombeve, d.m.th. ndaj serbëve apo kroatëve. Me fjalë të tjera, ata e ndjenin veten si qytetarë të rendit të dytë. Në mesin e demonstruesve kishte anëtarë të grupeve klandestinë radikale, kryesisht të atyre që e shpallnin vetën marksiste-leniniste, e të cilat ishin në favor të bashkimit me Shqipërinë. Por intervistat dhe komentet sugjerojnë se ata ishin marginalë.²

Demonstratat e vitit 1981 u shtypën në mënyrë mizore. Njësite policore dhe ushtarake, madje edhe njësite të sapoformuara të mbrojtjes territoriale nga e tërë Jugosllavia, u sollën në Kosovë, ku tashmë ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme. Qindra njerëz u arrestuan, gjykuan dhe burgosën.³ U ndërmor një spastrim i Partisë Komuniste, i emërtuar me eufemizëm si “diferencim.” Mijëra profesorë universiteti dhe mësime të ndryshme u përjashtuan. Ardhja e profesorëve dhe e teksteve shkollore nga Shqipëria u ndalua.

Kjo ishte periudhë e pasigurisë politike, pikërisht pas vdekjes së Titos, që edhe mund të jetë arsyeja kryesore për vrazhdësinë e reagimit nga ana e Serbisë dhe e federatës ndaj

demonstratave. Periudha e mbarimit të viteve 1960 dhe e atyre 1970, të cilat shpesh konsiderohen si apogjetë të periudhës së Titos, të cilën si shqiptarët ashtu edhe serbët do ta përkujtojnë me nostalgji, kishte marrë fund. Si pasojë e kësaj, në Kosovë gjatë viteve 1980 u krijua një polarizim i rëndë midis komunitetit shqiptar dhe atij serb.

Ishte kjo po ashtu një periudhë e ashpërsimit të masave në të tërë Jugosllavinë, kur edhe u inicuan reformat, si pjesë e pakos së shtyrjes së borxheve. Kosova gjithmonë ishte rajoni me i varfër i Jugosllavisë. Përkundër nivelit të lartë të investimeve publike pas vitit 1957, dhe përkundër marrjes së një përqindjeje të madhe nga Fondi për Rajonet e Pashvilluara, hendeku midis Kosovës dhe pjesës tjetër të Jugosllavisë gjatë kësaj periudhe u rrit. Më 1952, bruto prodhimi material i Kosovës (GMP)⁴ për kokë banori ishte 44% nga ai i mesatares jugosllave. Ai më 1980 kishte rënë në 29%, dhe në 22% më 1990.⁵ Papunësia më 1980 kishte arritur në 27%, dhe do të rritej në 40% më 1990. Numri i studentëve po ashtu u shtua me shpejtësi; numri i lartë i studentëve thuhej se ishte një lloj “rubineti sigurie” për papunësinë, por ky po ashtu ishte edhe burim i agjitacionit politik.

Masat e ashpra të viteve 1980 i kontribuan drejtpërdrejt tendosjeve të mëtejme, meqë mënyra sipas të cilës shpërndaheshin resurset u bë pjesë e debatit nacionalist. Është tipike që ekonomitë e drejtuara nga burokracitë karakterizohen nga konkurrenca për resurse dhe jo nga konkurrenca për tregje. Kështu Serbia dhe republikat e tjera veriore ishin të pakënaqura me mënyrat e tatimit për ta ndihmuar zhvillimin e Kosovës. Shumë kohë para ngritjes së Millosheviqit, debati politik serb i përfshinte edhe kërkesat për kontroll të ricentralizuar e të drejtpërdrejtë të politikës ekonomike dhe të resurseve buxhetore në Beograd, larg Vojvodinës dhe Kosovës - paralelisht me reformat për të tërë vendin në programin e IMF-it dhe në rekomandimet politike të reformatorëve të tregut. Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës korrespondonte me trysinë për reformë qeveritare drejt një ekonomie të tregut dhe të programit investues të eksport-importit. Në të njëjtën kohë, aktivistët shqiptarë ishin të bindur që moszhvillimi i tyre, papunësia dhe varfëria, ishin rezultat i kontrollit të pamjaftueshëm që ata e kishin mbi jetën e tyre ekonomike. Statusi i republikës me siguri se do t'u jipte më shumë kontroll ekonomik, e me të cilin ata do të mund të iniconin politikë më të favorshme. Aftësia e tyre për të mobilizuar mbështetje në vija etno-nacionale, duke shfrytëzuar strukturat familjare, kulturën rurale, mjetet e jashtme (nga punëtorët që punonin jashtë), dhe studentët universitarë të ballafaquar me papunësinë, nuk mund të kuptohet ndryshe, pos në kontekstin e strukturës shoqërore të krijuar nga rregullimi administrativ i kombinuar me liberalizim.

Një faktor tjetër kritik në zhvillimin e konfliktit ishin rrjedhat demografike në Kosovë. Gjatë periudhës 1961-81, përpjesa e shqiptarëve në popullsinë e Kosovës është rritur nga 67% në 78%. Kjo ishte pasojë si e shkallës së lartë të lindshmërisë në mesin e shqiptarëve, ashtu edhe e largimit të serbëve dhe të malazezëve. Mes viteve 1961 dhe 1981 popullsia serbe dhe malazeze u zvoglua për afër 30.000 veta, dhe gjatë viteve 1980 ra edhe për 20.000 më shumë. Emigrimi i vërtetë i serbëve dhe i malazezëve mes viteve 1961 dhe 1981 ishte mbase rreth 100.000, ndonëse në Beograd qarkullonin shifra shumë më të larta. Në fakt, emigrimi në mesin e të gjitha komuniteteve ishte i lartë kryesisht për shkaqe ekonomike: Kosova po stagnonte, ndërkohë që pjesët e tjera të Jugosllavisë po lulëzonin. Mirëpo në mesin e serbëve kishte edhe shkaqe shtesë; shumë prej tyre ankoheshin për keqtrajtim dhe diskriminim. Komuniteti serb pa dyshim po zvogëlohej, si absolutisht ashtu edhe relativisht, dhe ishte në humbje e sipër të privilegjeve. Anketat dhe intervistat dëshmojnë se serbët që u zhvendosën, e që kryesisht ishin të gjeneratës së vjetër, vërtetë kishin frikë nga dhuna fizike dhe nga dëmi që u shkaktohej pasurisë së tyre; ata po ashtu përjetuan diskriminim institucional dhe ideologjik. Nëpër intervista ata sugjeruan që kërcënimet fizike vinin nga shqiptarët më të rinj, shpesh herë imigrantë nga Shqipëria, dhe jo nga miqtë e fqinjët.⁶ Në të njëjtën kohë, disa nga pohimet më të egra që qarkullonin nëpër Beograd, sidomos ato lidhur me dhunimet e vrasjet, nuk mund të mbështeten nga shifrat zyrtare. Shkalla e kriminalitetit në Kosovë, përfshirë këtu edhe shkallën e dhunimeve, ishin në masë të konsiderueshme më të ulëta sesa në pjesët e tjera të Jugosllavisë. Po ashtu, argumenti nacionalist serb që shkalla e lartë e lindshmërisë shqiptare ishte e motivuar politikisht përgënjeshtërohet nga fakti që shkalla e lindshmërisë e shqiptarëve nëpër qytete ishte e njëjtë me shkallën e lindshmërisë në pjesët e tjera të popullatave urbane – vetëm në fshatra, ku niveli i varfërisë ishte i lartë ndërkaq niveli i arsimimit i ulët, shkalla e lindshmërisë ishte e lartë (shih Tabelën 1).

Nga mesi i viteve 1980, intelektualët serbë filluan të publikonin hapur trakte nacionaliste dhe ta diskutonin “gjenocidin” ndaj serbëve në Kosovë. Më 1983 varrimi i radikalit serb Rankoviq u shndërrua në një ngjarje nacionaliste. Serbët dhe malazezët e Kosovës filluan të bënin protesta publike nga mesi i viteve 1980, dhe këta mbështeteshin nga intelektualët e Beogradit. Këto ndjenja u ndezën më tej nga rasti Martinoviq, kur një serb 56-vjeçar i Kosovës, Gjorgje Martinoviq pohoi të ishte sulmuar nga dy shqiptarë, të cilët ia kishin futur një shishe në rektum.⁷

Në janar 1986, 216 intelektualë të njohur serbë, duke e përfshirë këtu edhe Dobrica Qosiqin, të cilët ishin përjashtuar nga Komitetit Qendror më 1968 për shkak të përkrahjes së politikës së Rankoviqit ndaj Kosovës, e paraqitën një peticion para

kuvendit serb dhe atij jugosllav. Aty ata deklaruan që “rasti i Gjorgje Martinoviçit ishte një paralajmërim për të gjithë serbët në Kosovë.” Më vonë, gjatë po këtij viti, një memorandum i botuar nga Akademia Serbe e Arteve dhe e Shkencave shkaktoi tronditje në të tërë Jugosllavinë. Memorandumi bënte fjalë për “gjenocidin fizik, politik, ligjor dhe kulturor” ndaj serbëve në Kosovë, dhe argumentonte që “pjesa e mbetur e kombit serb (...) e ballafaquar me një mbretërim terrori fizik, moral e psikologjik (...) ishte para ekzodit përfundimtar.” Po ashtu, memorandumit e sugjeronte që pozita e serbëve në Kroaci ishte e “rrezikuar” dhe po qe se “nuk gjenden zgjidhje, pasojat mund të jenë shkatërrimtare jo vetëm për Kroacinë, por për të tërë Jugosllavinë.”⁸ Pohohej po ashtu se rasti Martinoviç “i përkujtonte ditët më të errëta të praktikës turke të nguljes në hunj.”⁹

Tabela 1: Pjesëmarrja e popullsisë serbe në popullsinë e përgjithshme të Kosovës.

	Popullsia e përgjithshme	Popullsia serbe	Pjesëmarrja e serbëve [%]
1948	728,436	171,911	23.6
1953	804,530	189,869	23.6
1961	966,026	227,016	23.5
1971	1,247,344	228,264	18.3
1981	1,585,333	209,498	13.2
1991	1,961,515	194,190	9.9

Burimi: Marina Blagojevic, “Kosovo Invisible Civil War” në Thanos Veremis dhe Evangelos Kofos, Kosovo: Avoiding Another Balkan War, ELIAMEP, Universiteti i Athinës, 1998.

Këto ide nacionaliste u kritikuan nga autoritetet jugosllave, dhe në veçanti nga Kryetari i Lidhjes Socialiste të Serbisë Ivan Stamboliq, mirpo asnjëra nga masat e ashpra që u imponuan ndaj nacionalistëve shqiptarë nuk u ndal. Pika e kthesës ishte vizita në Kosovë e Sllobodan Millosheviçit, atëbotë zëvendës-president i partisë serbe, më 24 prill 1987. Millosheviç arriti në vendtakim në Fushë Kosovë gjatë një zënke në mes të serbëve dhe policisë. Ai atëbotë ua shqiptoi serbëve fjalinë tashmë të famshme: “Askush nuk do të guxojë të ju rrahë,” dhe vazhdoi me fjalimin lidhur me të drejtat e shenjta të serbëve. Brenda natës, Millosheviç u bë hero kombëtar. Me përkrahjen e Radio Televizionit të Beogradit, si dhe me tubimet masive në të tërë vendin, që ishin të njohura si “tubimet e të së vërtetës,” ai ishte në gjendje t’i mobilizonte ndjenjat e popullit si dhe ta merrte kontrollin e udhëheqjes partiake. Së pari, ai e shkarkoi mikun dhe patronin e tij të vjetër, Stambolliqin. Pas kësaj, e detyroi dorëheqjen e udhëheqjes partiake në Vojvodinë dhe në Mal të Zi; dhe në fund, i hoqi dy liderët kryesorë partiakë në Kosovë. Një incident në vitin 1987 i cili e ndihmoi kauzën e tij ishte rasti i një ushtari shqiptar, i cili në një gjendje të krizës nervore i

vrau katër ushtarë të tjerë (dy boshnjakë, një kroat dhe një serb) dhe mëpastaj bëri vetëvrasje. Rasti u konsiderua si një sulm i drejtpërdrejtë mbi Jugosllavinë, dhe tetë shqiptarë u akuzuan se e kishin planifikuar sulmin. Incidenti i kontribuoi sjelljes së APJ-së - atëbotë, Armatës Popullore të Jugosllavisë - e cila iu bashkangjiti Millosheviqit.

Gjatë një tubimi në Beograd në nëntorin e vitit 1988, në të cilin morën pjesë 350.000 njerëz, Millosheviqi deklaroi: "Secili komb e ka një dashuri e cila përjetësisht e ngroh zemrën e tij: për Serbinë, kjo është Kosova".¹⁰ Më vonë, në qershor 1989, me rastin e shënimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, Millosheviqi para një milion njerëzve deklaroi: "Gjashtë shekuj më vonë, ne përsëri jemi në beteja dhe zënka. Këto tash nuk janë beteja të armatosura, ndonëse gjëra të tilla nuk mund të përjashtohen".¹¹ Kjo u vijua nga një varg hapash, duke e përfshirë këtu edhe atë të vitit 1989, kur Kuvendi i Serbisë mori më shumë kontroll të drejtpërdrejtë mbi sigurinë, sistemin juridik, financat dhe planifikimin shoqëror,¹² gjë që në qershorin e vitit 1990 shpuri përfundimisht në revokimin e autonomisë së Kosovës. Gjatë vitit 1989 dhe fillimit të vitit 1990, qeveria serbe kishte miratuar një varg dekretesh me qëllim të ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës: këto përfshinin kufizimet në shitjen e pasurisë shqiptarëve, nxitjet për kthimin e serbëve dhe të malazezëve, planifikimin familjar për shqiptarët si dhe inkurajimin e tyre për të kërkuar punë gjetkë nëpër Jugosllavi. Në korrik Kuvendi i Kosovës u shpërnda, përkundër dispozitave të Kushtetutës së vitit 1974 sipas të cilave për shpërndarjen e Kuvendit kërkohesh pajtimi i vetë Kuvendit. S'do mend që ky veprim e shënoi fundin e Kushtetutës së vitit 1974, dhe, sipas shumëkujt, edhe shpërbërjen e Jugosllavisë.

Revokimi i autonomisë së Kosovës e shkaktoi një shtim të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe një fuqizim të politikës qeveritare diskriminuese që e synonte serbizimin e krahinës.¹³ Kjo përfshinte edhe politika diskriminuese gjuhësore: mbylljen e gazetave në gjuhën shqipe, të Radios dhe të Televizionit, mbylljen e Institutit Albanologjik, si dhe ndryshimin e emërtimeve të rrugëve nga shqipja në serbisht.¹⁴ Dhe, në veçanti, futja e planprogrameve të reja serbe për universitetet dhe shkolla e cila:

rezultoi në mbylljen e administratës arsimore në Kosovë (...) dhe të institucioneve dhe subjekteve të tjera në fushën e arsimit (...) Më se 18.000 mësimgdhënës dhe punonjës të tjerë për klasët në gjuhën shqipe (...) u larguan nga puna në mënyrë masovike kur i refuzuan tekstet shkollore sipas planprogrameve unike.¹⁵

Mijëra shqiptarë u larguan nga vendet e punës në sektorin publik. Sipas Sindikatave të Pavarura Shqiptare të Kosovës, 115.000 veta, prej 170.000 gjithsej, i humbën vendet e punës. U bënë edhe përpjekje për ta kolonizuar krahinën. Serbëve që vendoseshin

apo që ktheheshin në Kosovë ju dhanë privilegje të shumta, përfshirë këtu edhe kredi dhe troje falas.¹⁶ U miratuan ligje që ua ndalonin shqiptarëve të Kosovës blerjen e pasurisë nga serbët, kurse refugjatët nga Kroacia vendoseshin në Kosovë kundër dëshirës së tyre. Mbi të gjithat, kishte shkelje masovike të të drejtave të njeriut - arrestime arbitrare, torturime, burgosje pa gjyq. Shqiptarët akuzoheshin për “delikte verbale” dhe merreshin në stacione policore për “biseda informative”. Shkalla e këtyre shkeljeve është dokumentuar nga Amnesty International, Human Rights Watch dhe nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë.¹⁷ Thuhet se të paktën nga një anëtar i çdo familjeje shqiptare ishte thirrur në stacion policor, kishte kaluar një kohë në burg, apo priste për t’u gjykuar.

Rezistenca e shqiptarëve

Shumë komentatorë, veçmas nga mesi i shqiptarëve kosovarë, kanë pritur që lufta në Jugosllavi do të fillonte në Kosovë. Shumë shqiptarë kosovarë e kanë paraparë spastrimin etnik në kontekstin e një konflikti të dhunshëm. Dhe vërtet, në Kosovë ka pasur provokime të hapura, duke përfshirë vrasje të kohëpaskohshme të fshatarëve në Kosovën qendrore dhe helmimin e supozuar të nxënësve, gjatë marsit dhe prillit të vitit 1990.¹⁸

Para vitit 1990, shumica e shqiptarëve e përkrahnin kornizën jugosllave. Kërkesat e tyre kishin të bënin kryekëput me të drejtat kushtetuese. Në nëntor 1988, minatorët e Trepçës, në një të ftohtë acari, ecën 55 kilometra nga Mitrovica për në Prishtinë, për të protestuar kundër shkarkimit të liderëve partiakë. Në Prishtinë atyre iu bashkangjitën edhe punëtorët e fabrikave dhe studentët. Ata bartnin flamuj jugosllavë dhe shqiptarë, si dhe fotografi të Titos, dhe brohorisnin për Kushtetutën e vitit 1974; ata, po ashtu, brohorisnin parulla titiste si “Vëllazërim-Bashkim,” madje edhe “Rroftë populli serb!” (si dëshmi që nuk ishin antiserbë). Më pas, në shkurt 1989, minatorët e Trepçës u hodhën në grevë urie për të protestuar kundër imponimit të zyrtarëve krahinorë. Këto demonstrata ishin mbase demonstratat e fundit titiste në Jugosllavi. Presidenti slloven Kuqan u shprehu mirënjohje minatorëve shqiptarë që u përpoqën ta shpëtonin Jugosllavinë.

Në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte edhe një rrymë politike e vogël enveriste, që përbëhej nga grupe të vogla klandestine marksiste-leniniste. Personi më i njohur në mesin e tyre ishte Adem Dumaçi, i cili gjatë viteve 1960 e themeloi Lëvizjen

Revolucionare për Bashkimin Shqiptar. Ai u arrestua më 1964 dhe kaloi vite të shumta në burg.

Njëra nga arsyt pse lufta nuk filloi në Kosovë, qëndronte në zhvillimet në pjesët e tjera të Jugosllavisë, dhe veçmas në ato në Slloveni dhe Kroaci. Në të vërtetë, deri më 1995, Millosheviqi ishte i preokupuar me luftërat në Kroaci dhe në Bosnje. Arsyet tjetër ishte përvetësimi i strategjisë së mosdhunës - diçka që ishte në kundërtënie të plotë me traditat e shqiptarëve të Kosovës. Sipas fjalëve të Rugovës, i cili ishte figura dominante në lëvizjen shqiptare “Serbët vetëm e presin pretekstin për ta sulmuar popullatën shqiptare dhe ta zhdukim fare. Besojmë se është më mirë të mos bëjmë asgjë dhe të mbesim gjallë, se sa të masakrohemi.”¹⁹

Më 1990 rrymat e ndryshme të lëvizjes politike shqiptare - ish-zyrtarët dhe ish-revolucionarët - u bashkuan për ta formuar një lëvizje masive e cila synonte që në Kosovë ta vinte në jetë një sistem të vetëorganizimit paralel. Më 2 Korrik 1990, tri ditë para shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës, 114 nga 123 deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës u tubuan në shkallët e ndërtesës së Kuvendit, e cila ishte e mbyllur. Ky numër ishte i mjaftueshëm për kuorum, dhe ata e miratuan një deklaratë e cila shqiptarëve ua jipte statusin e kombit me të drejtë për republikën e tyre. Më 7 Shtator këta deputetë u tubuan përsëri në Kaçanik, ku u pajtuan që ta shpallnin ligjin kushtetues për “Republikën e Kosovës,” përfshirë këtu edhe dispozitat për një asamble të re dhe kryesi të zgjedhur. Pas shpalljeve sllovene dhe kroate të pavarësisë në qershor 1991, kërkesa për republikë ishte shndërruar në kërkesën për pavarësi. Në shtator 1991 u organizua një referendum për pavarësinë. Thuhet se 87% e votuesve morën pjesë, duke përfshirë edhe disa minoritete, dhe se vota ishte 99% në favor të pavarësisë. Më vonë, në maj 1992, u mbajtën zgjedhjet kosovare për një qeveri dhe kuvend republikan, duke i shfrytëzuar shtëpitë private si vendvotime.

Karakterit i mosdhunës i kësaj lëvizjeje nuk ishte vetëm taktik; ai ishte edhe parimor. Para së gjithash, idetë e opozitës demokratike në Evropën Lindore e kishin një ndikim të thellë në qarqet intelektuale. Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë, kryetar i së cilës ishte dr. Ibrahim Rugova, Shoqata e Filozofëve dhe e Sociologëve dhe Dega e Prishtinës e Unionit për Iniciativën Demokratike Jugosllave, kryesues i së cilës ishte Veton Surroi, mbajtën shumë takime publike më 1988 dhe 1989, dhe e organizuan një peticion “Për Demokraci, Kundër Dhunës” i cili i mbledhi 400.000 nënshkrime. Ideja e sistemit paralel apo e një qeverie “në hije” ishte e ndikuar thellë nga nocionet e autonomisë dhe të vetëorganizimit në mesin e intelektualëve të Evropës Qendrore dhe sidomos nga Solidariteti polak.

Së dyti, ishte një reagim spontan në mesin e shqiptarëve të rëndomtë, që donin të dëshmonin se ishin ndryshe nga stereotipi “primitiv dhe i paqytetëruar,” që u mvishej nga serbët. Në pikën më të lartë të tendosjes, në fillim të viteve 1990, shqiptarët e Kosovës vendosën ta zhduknin praktikën tradicionale të gjakmarrjes. Rreth 2.000 familje u pajtuan dhe rreth 20.000 njerëz tash ishin të lirë që të lëviznin jashtë shtetpive të tyre. Një “Këshill i Pajtimit” u themelua për t’i gjurmuar familjet shqiptare që ishin në armiqësi (madje edhe ato që jetonin jashtë vendit), dhe që t’i sillnin ato në pajtimet masive. Kjo ngjarje mëpastaj shpuri deri tek krijimi i Lëvizjes Gjithëshqiptare për Pajtimin e Gjaqeve.²⁰ Një faktor shoqëruës ishte vetidentifikimi gjithnjë e më në rritje i shqiptarëve kosovarë si evropianë. Rreth një e treta e popullsisë shqiptare e kishte kaluar një kohë jashtë vendit, kryesisht në Evropën Perëndimore. Shumë shtëpi kishin dhe kanë antena satelitore, të cilat ua mundësonin ndjekjen jo vetëm të transmetimeve të diasporës në gjuhën shqipe nga Gjeneva, por edhe shikimin e MTV-së, Eurosportit, etj. Pasi që udhëtimi për në Shqipëri tashmë ishte më i lehtë, dhe njerëzit u bënë të vetëdijshëm për realitetin depresiv të jetës në Shqipëri, aspiratat për tu bërë evropianë e kishin zëvendësuar ëndrrën e kthimit kah Shqipëria. Megjithëkëtë, nuk duhet harruar se ishin shqiptarët kosovarë në diasporë ata që u bënë pjesa më radikale e komunitetit shqiptar të Kosovës, dhe se ishin ata të cilët edhe e krijuan UÇK-në.

Organizata politike dominuese ishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Gjatë viteve 1990 dhe 1991 ajo u zgjerua shumë shpejt: në pranverë të vitit 1991, ajo pohonte se i ka 700.000 anëtarë. LDK-ja tërhoqte organizatat fshatare dhe strukturën tradicionale klanore të shoqërisë së shqiptarëve kosovarë. Ajo po ashtu ishte në gjendje që ta plotësonte vakuumin të cilin e la rënia e lëvizjes së mëparshme politike shqiptare, Lidhjes Socialiste. Në zgjedhjet e majit 1992, LDK-ja fitoi 96 nga 100 vendet elektorale. (Nga 4 vendet e tjera, 2 u fituan nga të pavarur që ishin anëtarë të LDK-së, 1 nga SDA, e cila ishte parti boshnjake, dhe 1 nga Partia Popullore Turke). 42 vende të tjera u ndanë me përfaqësim proporcional, ku 12 vende i mori Partia Turke, 7 vende Demokristianët, 1 vend Social-Demokratët, dhe 3 vende SDA-ja; 13 vendet e rezervuara për serbët e malazezët mbetën të zbrazëta.

Nën udhëheqjen e Rugovës, LDK-ja ia filloi zhvillimit të një aparati paralel shtetëror i cili historikisht ishte unik. Qeveria u formua më 19 tetor, 1991. Në fillim ajo ishte e vendosur në Lubjanë, mirëpo më 1992 kaloi në Bon. Kryeministër ishte Bujar Bukoshi. Nga të gjithë shqiptarët e Kosovës u kërkuan tatime “vullnetare”. Kornizat e sugjeruara ishin 5% për individët e punësuar, midis 8% dhe 10% për bizneset, ndërkaq për pronarët e tokave varësisht nga prodhimtaria e tyre. Punëtorët në dias-

porë duhej të kontribuonin me 3% të të ardhurave. U krijua një bazë e të dhënave kompjuterike me qëllim të mbajtjes së shënimeve për “tatimet” e familjeve individuale, dhe mosrespektimi i tyre ishte fare i vogël.²¹ Sa i përket shpenzimeve, 90% e fondeve shkonin për sistemin paralel të arsimit, ndërkaq pjesa tjetër për sporte, disa aktivitete kulturore, administratën e LDK-së dhe një pjesë për shëndetësinë. Më 1993, sistemi paralel arsimor punësonte 20.000 mësime dhënë, ligjërues, profesorë dhe personel administrativ. Në të përfshiheshin 5.291 nxënës parashkollorë, 312.000 nxënës të shkollave fillore, 65 shkolla të mesme me 56.920 nxënës, dy shkolla speciale për fëmijët me të meta, 20 fakultete dhe shkolla të larta me rreth 12.000 studentë, si dhe disa institucione të tjera arsimore, si Enti për Botimin e Teksteve Shkollore. Shkollat fillore u lejuan të shfrytëzonin ndërtesat e tyre, por nuk kishin financim; 204 objekte të tjera, si shtëpi dhe garazhe jipeshin nga vetë shqiptarët e Kosovës.

Organizata të tjera të afërta me LDK-në dhanë po ashtu kontribut të rëndësishëm. Shoqata Nëna Tereze, e themeluar më 1990, ofronte ndihmë humanitare dhe kujdes shëndetësor për shqiptarët që kishin frikë të shfrytëzonin objektet e dominuara nga serbët, sidomos pas helmimit të supozuar masiv. (Si pasojë e kësaj, shumë fëmijë nuk vaksinoheshin, kështu që rastet e sëmundjeve si lia, tetanusit dhe tuberkulozi u shtuan). Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e krijoi një sistem vëzhgimi për të grumbulluar informata të hollësishme lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut. Një organizatë tjetër me peshë ishte Sindikata e Pavarur. “Këshilli i Pajtimit” e paraqiste njëfarëloj sistemi paralel juridik, dhe po ashtu kishte edhe organizata për kulturë dhe për sport. Gjatë kësaj periudhe u themeluan edhe një numër organizatash joqeveritare (OJQ) të cilat merreshin me çështjet e grave dhe të rinisë. Në të vërtetë, ashtu si edhe Këshillat e Pajtimit, këto OJQ e pasqyronin një interesim, madje edhe në nivele fshatare, për shkëputje nga tradita dhe për mbjelljen e “farës së një shteti të një tjetër lloji”.²² Me ndihmën e Grupit të Gruas nga Beogradi u themelua edhe një Grup për Studime të Gruas, dhe po ashtu filloi edhe botimi i revistës Kosovarja. Në mesin e grupeve rinore, më i njohuri ishte Klubi i Post-Pesimistëve.

Revista e vetme shqipe që u lejua ishte revista bujqësore Bujku, dhe ajo u bë zëdhënëse e LDK-së. Më vonë me ndihmën e Fondacionit për Shoqëri të Hapur u themeluan media të tjera të pavarura, duke përfshirë këtu gazetata Zëri, Koha Ditore dhe Forumi, (fletushkë kjo e themeluar nga Adem Demaçi), si dhe disa revista të gruas dhe të rinisë.

Krahas zhvillimit të aparatit paralel shtetëror vazhdoi edhe rritja e ekonomisë joformale. Shumë prej shqiptarëve që kishin humbur vendet e punës vendosën të fillonin biznese private. Maliqi e përshkruan se si brenda vetëm disa javësh “punëtorët e për-

jashtuar shqiptarë, ish-nëpunësit publikë dhe policët e mëparshëm, regjistruan disa qindra taksi, kamionë e minibusa (dyfishi i atyre që punonin pa u regjistruar), dhe kështu e morën në duar të veta transportin urban. Nisma e tyre e bëri transportin aq të lirë dhe efikas sa që kompanitë kryesore shtetërore u ballafaquan me falimentim, dhe, si pasojë e kësaj, pas gjashtë muajsh Beogradi e ndaloi transportin alternativ dhe taksitë.²³ Nisma të tjera kishin të bënin me agjenci turistike, kafene dhe ndërmarrje të tjera të vogla. Deri më 1993, numri i ndërmarrjeve të regjistruara private ishte gjithsej 27% (nga 20% më 1990), kurse ekonomia joformale llogaritej se e përbënte 70% të tërë ekonomisë së Kosovës.²⁴

Gjatë kësaj periudhe, afro 400.000 shqiptarë llogaritet të kenë emigruar nga Kosova për në Evropën Perëndimorë, shumë prej tyre për t'i ikur rekrutimit në ushtrinë jugosllave. Përvojat që ata i fituan në Evropën Perëndimore, si dhe paratë që i dërgonin, i kontribuan në masë të madhe krijimit të ekonomisë në hije. Shumë prej tyre emigruan edhe në Shtetet e Bashkuara. Megjithëkëtë, varfëria ishte ende mjaft e përhapur, siç dëshmohet edhe nga numri i shtuar i atyre që vareshin nga Shoqata Nëna Tereze. Për më tepër, barra e tatimitit të dyfishtë, nga LDK-ja dhe nga autoritetet serbe, ishte e rëndë për shumicën e familjeve.

Qëllimi kryesor i LDK-së ishte pavarësia e Kosovës. Strategjia për ta arritur këtë qëllim ishte të ndikohet tek Bashkësia Ndërkombëtare duke e mohuar legjitimitetin e institucioneve të Beogradit, si përmes sistemit paralel ashtu edhe përmes bojkotimit të zgjedhjeve - duke refuzuar, siç e pat thënë dikush "t'i jap dinjitet Millosheviqit me votën time".²⁵ Rugova bënte më shumë trysni për vënien e një protektorati të përkohshëm nën mbikëqyrjen e OKB-së, i cili do të mund ta mbikëqyrte kalimin në pavarësi.

Ishte, për shembull, një mundësi e vogël për veprim më të drejtpërdrejtë, si nga LDK-ja ashtu dhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, për të ndërhyrë më aktivisht në trajtësimin e një kompromisi politik në Kosovë, kur Milan Paniqi u bë kryeministër i Serbisë, në korrikun e vitit 1992. Paniqi u takua me Rugovën në Londër gjatë gushtit, dhe e premtoi "rikthimin e vetëqeverisjes për shqiptarët e Kosovës, ripranimin e studentëve në Universitetin e Prishtinës, rikthimin e profesorëve shqiptarë, lirinë e shtypit shqip dhe zgjedhje të lira".²⁶ Në tetor, Paniqi e vizitoi Kosovën dhe u përpoq të merrej vesh me Rugovën në shkëmbim për mbështetjen në zgjedhjet presidenciale. Por përpjekjet e tij dështuan dhe në zgjedhjet e dhjetorit 1992 ai u mund nga Millosheviqi; sikur shqiptarët të kishin votuar, ata kanë mundur ta prishnin balancin. Sipas Fehmi Aganit, nënkryetar i LDK-së, dhe mbase intelektualit më i respektuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës, i cili u vra gjatë luftës së vitit 1999:

*Sinqerisht, është më mirë (për ne) të vazhdojmë me Millosheviqin. Millosheviqi ka qenë shumë i suksesshëm në shkatërrimin e Jugosllavisë, dhe nëse vazhdon në të njëjtën mënyrë, ai do ta shkatërrojë edhe vetë Serbinë (...) Paniqi po na e ofron një hegjemoni të ndritshme (...) Ai mendon se ne do ta pranojmë atë meqë ai është kundërshtar i Millosheviqit. Mirëpo kjo nuk mjafton. Ai është duke na ofruar të marrim pjesë në zgjedhje, por pa na ofruar asgjë konkrete. Në jemi kundër Millosheviqit, mirëpo ne po ashtu e dimë se ai duhet të bjerë, me apo pa Paniqin.*²⁷

Edhe nëse shqiptarët e Kosovës e besonin se ata kishin më shumë gjasë që t'i arrinin qëllimet përfundimtare me Millosheviqin në pushtet, duke sikur edhe Millosheviqi ishte i kënaqur me një status-kuo të tillë - një tolerim përplot dhunë i lëvizjes së mosdhunës. Ky rezultat përfundimtar ishte ai që quhej "botëra të ndara" - një sistem apartheidi në të cilin nuk kish pothuaja fare komunikim midis dy palëve.²⁸ Siç ia kishte thënë një serb kosovar Tim Judah-ut,

*Janë dy sisteme paralele këtu. Secili e ka organizuar arsimin e vet. Ata e kontrollojnë sektorin privat, dhe ne serbët sektorin publik. Është madje edhe një sistem i dyfishtë tatimimi. Ata i kanë tatimet e veta joformale. Fëmijët tanë nuk lozin bashkë më (...) Dhe mbrëmjeve, kur njerëzit shëtisin në rrugë, ata e kanë njërën anë të rrugës kryesore, ndërkajq ne e kemi anën tjetër.*²⁹

Mirëpo, natyrisht, ky ishte një paralelizëm jo i barabartë. Njëri nga faktorët që shqiptarët kosovarë mbase nuk e kanë patur parasysh, ka qenë çmimi që kjo e tëra e merite në jetën e përditshme, si dhe vështirësia e mbajtjes së shtetit në hije për shumë vite. Konflikti rreth Kosovës, shkruante Maliqi më 1996, "është shndërruar në një lloj lufte intensive të nervave, në të cilin njëra palë nuk ndalet nga asgjë, duke i bërë shkeljet më mizore të të drejtave të njeriut dhe të lirive qytetare, duke i injoruar plotësisht protestat e organizatave ndërkombëtare, të cilat për një kohë i mbajtën ekipet vëzhguese në Kosovë, kurse ana tjetër e grumbullon poshtërimin, dëshprimin, zemërimin dhe urrejtjen - por edhe për sa kohë vallë, para se të shpërthejë?"³⁰

Rënia në luftë

Gjendja zuri të keqësohej nga mesi i viteve 1990. Në ato momente kur shumë shqiptarë kosovarë të rëndomtë kishin filluar ta humbnin durimin me strategjinë e rezistencës pasive dhe dalngadalë po moliseshin nga lufta për mbajtjen e sistemit paralel në rrethana aq të rënda, erdhi deri tek nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit për Bosnjën, e në të cilën Kosova nuk përmendej fare. Shumë shqiptarëve të Kosovës iu

duk sikur strategjia e tyre kishte dështuar. Përfundimet që mund të nxirreshin nga Dejtoni - ta citojmë Veton Surroi - ishin se “territoret e fituara etnike kanë legjitimitet” dhe se “vëmendja ndërkombëtare mund të fitohet vetëm me luftë.”³¹ Disa intelektualë të njohur kosovarë, si Adem Demaçi dhe profesor Rexhep Qosja i cili ishte i afërt me politikanët në Tiranë, zunë ta kritikonin Rugovën për pasivitet të tepruar. Qosja fliste për nevojën e një rezistence aktive të mosdhunës, kurse Demaçi ftonte për padëgjueshmërinë qytetare.

Një rreze shprese ishte marrëveshja e arsimit, e arritur më 1996 nga përfaqësues të LDK-së dhe nga Ministria e Arsimit e Beogradit, e cila ishte ndërmjetësuar nga organizata katolike italiane, Communita di Sant’Egidio. Ishte arritur pajtimi që shqiptarët të mund të ktheheshin në ndërtesat shkollore dhe universitare, dhe që të mund t’i përdornin planprogramet e periudhës para vitit 1990. Ndërkaq, nuk ishte arritur marrëveshje lidhur me pagat e mësimdhënësve dhe të profesorëve. Rëndësia e kësaj marrëveshjeje qendron në faktin që negociatorët shqiptarë në mënyrë implicite u njohën si përfaqësues legjitimë. Kjo njohje e sugjeronte negociimin si një shteg të mundshëm, ndonëse edhe të pasigurtë, për normalizimin e gjendjes në Kosovë.

Gjatë viteve 1996-7, në mesin e intelektualëve, si në Beograd ashtu edhe në Prishtinë, ishte në qarkullim një numër i propozimeve për një zgjidhje kompromisi të çështjes së Kosovës, dhe ky edhe ishte konteksti në të cilin duhet kuptuar marrëveshjen për arsim. Propozimi më i njohur ishte ai i kryetarit të Akademisë së Shkencave Aleksandar Despiq, i cili e propozoi copëtimin dhe secesionin paqësor të Kosovës. Ai propozoi që bisedimet të fillonin “me ata që insistojnë për secesion të Kosovës lidhur me ndarjen dhe demarkacionin paqësor dhe të qytetëruar.”³² Propozime të tjera përfshinin atë për “tri republika,” sipas të cilit Kosovës do t’i jepej status i barabartë me Malin e Zi. Shqiptarët kosovarë në këtë periudhë ftoheshin nga presidenti Berisha në Tiranë që të ishin më të pajtueshëm dhe t’i nisin bisedimet me Beogradin. Sikur Bashkësia Ndërkombëtare gjatë këtyre viteve të ishte më e vëmendshme, ajo ka mundur të bëjë trysni në Millosheviqin për të negociuar seriozisht me LDK-në. Sikur fuqitë e Perëndimit ta kishin trajtuar LDK-në me më shumë respekt, atëherë ato - sikurse edhe Berisha - do të mund ta kishin inkurajuar këtë diskutim në lindje të opsioneve politike lidhur me autonominë gati në pavarësi.

Marrëveshja e arsimit, megjithëkëtë, nuk u zbatua kurrë. Komentatorët sugjerojnë që të dyja palëve u interesonte status-kuoja, nga që i druanin zgjidhjes kompromise. Status-kuoja e vazhduar “ua mundësonte që të dyja palëve të vazhdojnë t’i ushqejnë iluzionet për epërsinë e vet; serbëve për vazhdimin e kontrollit policor-ushtarak, dhe

shqiptarëve për vazhdimin e udhëheqjes së shoqërisë.”³³ Përkundër mospajtimin të Rugovës, në shtatorin e vitit 1997, studentët ia filluan protestave kundër dështimit të zbatimit të marrëveshjes, pikërisht në kohën kur po fillonte viti shkollor. Demonstruesit u trajtuan në mënyrë mizore dhe edhe sot e kësaj dite disa nga liderët studentorë janë duke u mbajtur nëpër burgjet serbe.

Pikërisht në këtë periudhë, UÇK-ja e bëri paraqitjen e vet të parë. Përndryshe, UÇK-ja doli nga një parti marksiste-leniniste-enveriste e formuar në diasporë, në fillimin e viteve 1980, e cila quhej LPK (Lëvizja Popullore e Kosovës). Më 1992 dhe 1993, LPK-ja e luajti një rol udhëheqës në formimin e një grupi gueril në takimet e fshehta në Prishtinë dhe në Tetovë (Maqedoni). Aksioni i parë i dhunshëm i ndërmarrë ishte vrasja e një polici serb më 1995. Por vetëm në vitin 1996 një organizatë me bazë në Zvicër, e cila e quante vetën UÇK, e mori përgjegjësinë për këto sulme të para. Në këtë kohë, shumica e shqiptarëve nuk kishin dëgjuar për UÇK-në, dhe shumë ishin të bindur që sulmet ishin provokime artificiale nga ana e autoriteteve serbe.

Për UÇK-në thuhet se fondet i mirrte nga tregtia e paligjshme me drogë. Pos kësaj, shumë kosovarë në diasporë e bartën mbështetjen e tyre nga LDK-ja në një fond që quhej “Vendlindja Thërret,” i cili ishte formuar nga UÇK-ja. Figurat dominante në UÇK dukej të ishin një brez i ri njerëzve, si Thaçi (tani Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të formuar nga UÇK-ja), e të cilët kishin qenë studentë në mbarimin e viteve 1980, dhe më vonë kishin punuar apo studiuar jashtë. (Thaçi, për shembull, e ka një titull magjistrature në marrëdhëniet ndërkombëtare nga Universiteti i Cyrihut). Strategjia e UÇK-së dukej po ashtu t’i drejtohej Bashkësisë Ndërkombëtare. E papërgatitur për luftë, UÇK-ja dukej sikur ta kishte një strategji të qëllimshme të nxitjes së ndërhyrjes ndërkombëtare.

Në të vërtetë, deri në mbarimin e vitit 1997, grupet aktive të armatosura të rezistencës në Kosovë ishin fare të vogla, dhe pa ndonjë bazë të përhershme brenda krahinës. Këto kishin fare pak armë, dhe nuk linin përshtypje sikur ta kishin ndonjë strukturë të qartë udhëheqëse. Operacionet individuale ishin në trajtë të sulmeve terroriste “sulmo dhe tërhiq” mbi postbolloqet policore serbe, dhe ato kundër “bashkëpunëtorëve” të supozuar shqiptarë. Këto operacione komandoheshin dhe planifikoheshin nga anëtarë të UÇK-së që vinin nga jashtë, me luftëtarë vendorë që kishin fare pak përgatitje ushtarake. Shembja në vitin 1997 e sistemit shtetëror dhe e institucioneve në Shqipëri, e ndryshoi këtë situatë në mënyrë dramatike. Magazinat dhe depotë e Ushtisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme u plaçkitën, dhe armatimi e municioni erdhën në dispozicion të UÇK-së. Për shkak të rënies së sistemit të sigurisë dhe

për shkak të paligjshmërisë e cila e pllakosi Shqipërinë, për herë të parë u bë e mundur që të organizoheshin trajnime në Shqipërinë Veriore, pranë kufirit me Kosovën. Kjo u dëshmuar të ishte parakushti më i rëndësishëm për krijimin e objekteve të rekrutimit dhe të trajnimit, për gjetjen e shtigjeve furnizuese për në Kosovë, si dhe për përpjekjet e para për koordinimin e grupeve të ndryshme rajonale dhe madje edhe lokale të luftëtarëve. Si gjetkë, në luftërat pas-jugosllave, krimi i organizuar e luajti një rol të rëndësishëm në organizimin dhe në financimin e konfliktit. Kombinimi i emigracionit të gjerë politik dhe ekonomik shqiptar nga Kosova, kolapsi i shtetit shqiptar dhe natyra kriminale e shtypjes policore dhe paramilitare serbe, që të gjitha këto i kontribuan imazhit të vetëshpallur të “Robin Hudit” të krimit të organizuar shqiptar.

Me ngritjen e UÇK-së, keqtrajtimet policore, që edhe më parë ishin masovike, vetëm që u shtuan. Qeveria serbe e shpalli UÇK-në organizatë terroriste, duke i justifikuar kështu bastisjet, burgimet dhe proceset politike. Qendra e Ligjit Humanitar (HLC) dokumentoi raste të panumërta të keqtrajtimit policor të shqiptarëve etnikë, duke përfshirë këtu arrestimet arbitrare, burgosjet, keqtrajtimet fizike, bastisjet e paligjshme si dhe vrasjet jashtaligjore.³⁴ Organizata të tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që i përfshinin Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Amnesty International, Human Rights Watch dhe Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, e dëshmonin mbizotërimin e rrahjeve masive, duke e përfshirë edhe përdorimin e tronditjeve elektrike.³⁵ Shqiptarët e ngarkuar për pjesëmarrje në UÇK raportonin për torturimet që u bëheshin për të nxjerrë pranime të rrejshme. Pos kësaj, mbrojtja e të akuzuarve raportonte se nuk kishte qasje të lirë tek klientët apo në informatat e domosdoshme.³⁶ Një sjellje e tillë e policisë drejtohej jo vetëm kundër pjesëtarëve të UÇK-së, por edhe ndaj anëtarëve të LDK-së, aktivistëve dhe qytetarëve të tjerë.

Meqë po e shohim që status-kuoja kishte filluar të sfidohej nga pala shqiptare, është e dobishme të spekulohet lidhur me mënyrën në të cilën ajo po sfidohej nga Beogradi. Gjatë viteve 1996-7 pozita e Millosheviqit ishte duke u sfiduar si nga opozita demokratike ashtu edhe nga e djathta ekstreme. Në zgjedhjet komunale të nëntorit 1996, koalicioni i opozitës “Zajedno” i fitoi zgjedhjet për kryetarët e bashkive në 15 qytete të mëdha, dhe e mori kontrollin edhe mbi Kuvendin e Beogradit. Elita sunduese u përpoq që t’i anulonte rezultatet e zgjedhjeve, mirëpo kjo shkaktoi demonstrata të mëdha në Beograd dhe në qytete të tjera. Në shkurt 1997, autoritetet më në fund u tërhoqën. Në po të njëjtën kohë partia në pushtet në Mal të Zi doli nga kontrolli, dhe pushtetin e mori një qeveri e re e përkushtuar për demokratizim. Mobilizimi i studentëve dhe përhapja e një radio-rrjeti të pavarur dukej sikur e

ofronin një shpresë të mirëfilltë për lëvizje drejt demokratizimit, duke e përfshirë këtu edhe një qasje më pajtuese ndaj çështjes së Kosovës. Në të vërtetë, studentët në Beograd po bënin kontakte me studentët e Prishtinës. Klubi i post-pesimistëve, për shembull, krijoi degë në të tërë Jugosllavinë.

Partia e Millosheviqit i humbi votat edhe në zgjedhjet parlamentare serbe të shtatorit 1997, ndërkaq Partia Radikale Serbe e Vojislav Sheshelit shënoi përfitime të rëndësishme. Shesheli, grupi paramilitar i të cilit i njohur si “çetnikë,” ishte përgjegjës për disa nga krimet më të shëmtuara të bëra në Bosnje, e kishte mbajtur gjithmonë një pozitë ekstreme ndaj Kosovës. Që nga viti 1991 programi politik i Sheshelit e përfshinte edhe dëbimin “pa vonesë” të atyre që pohohej se ishin 360.000 imigrantë të pasluftës në Kosovë nga Shqipëria dhe të “pasardhësve të tyre.” Ai propozonte që prej kosovarëve të spastrohej një brez prej “20 deri në 30 km, sa fluturon sorra, përgjatë kufirit shqiptar,” pasi që “është bërë e qartë që Shqipëria është një shtet vazhdimisht armiqësor ndaj Serbisë.” Ai po ashtu kërkonte që në Kosovë të mos ketë zgjedhje parlamentare “përderisa të mos ritkhehet struktura e popullsisë në përpjestimin që kishte ekzistuar para 6 prillit 1941.”³⁷ Në shkurtin e vitit 1998, u formua një koalicion i ri qeverisës për Serbinë i cili e kishte në përbërje të veten edhe Partinë Radikale, me vetë Sheshelin si Zëvendëskryeministër.

Komentatorët në atë kohë sugjerorin që fitorja e Sheshelit “nuk nënkuptonte mbështetje të gjerë për nacionalizmin e “Serbisë së Madhe” të Sheshelit, por vetëm e pasqyronte forcën e ndjenjës kundër regjimit të Millosheviqit në mesin e një pjesë të hidhëruar dhe të përjashtuar të popullsisë, duke i përfshirë këtu edhe qindra mijëra refugjatë dhe familjet e tyre të cilët ishin ndër humbësit më të mëdhenj të tronditjeve të dekadës së fundit në ish-Jugosllavi.”³⁸ Megjithëkëtë, sukcesi i Sheshelit dhe futja e tij në qeveri dukej sikur të kishte qenë rënie e këmbanave të alarmit për qarqet ndërkombëtare. Për më tepër, mund të argumentohet se një atmosferë me tendosje në rritje e sipër ka qenë mënyra e preferuar përmes së cilës Millosheviqi gjithmonë e neutralizonte opozitën e tij, si atë progresiven, ashtu edhe atë ekstremen. Dhe, pos kësaj, si fuqia e Millosheviqit ashtu edhe ajo e Sheshelit, vareshin nga rrjetet e kriminalizuara të cilat përfitonin nga dhuna dhe dukuritë që lidheshin me të, si dhe nga veprimtaritë që kishin të bënin me thyerjen e sanksioneve. Prandaj në atë kohë kishte elemente ekstremiste në qeveri dhe në shoqëri, të cilat u rezistonin lëvizjeve kompromise dhe që i kishin interesat vetiake (si politike, ashtu edhe ekonomike) në përhapjen e dhunës, e që ishte e domosdoshme që ata të mund t’i mbanin pozitat e tyre.

Fundi i krejt kësaj ishte më 28 shkurt 1998, kur serbët vendosën ta arrestonin Adem

Jasharin, një trim vendor nga Prekazi, i cili i ishte bashkuar UÇK-së. Brenda një jave u vranë 58 veta nga familja e tij e ngushtë dhe e gjerë. Në këtë pikë, milicinë fshatare anembanë Kosovës u paraqitën për t'i mbrojtur fshatrat e tyre. Shumë prej tyre ishin të lidhur me strukturat paralele, por e quanin vetën UÇK, ndonëse një numër prej tyre ende e konsideronin Rugovën si president të tyre.

Ishte ky fillimi i luftës.

Roli i bashkësisë ndërkombëtare

Përpjekjet e para dhe të fundit për ta gjetur një zgjidhje të përgjithshme të negociuar për shthurjen e Jugosllavisë ishin marrëveshja e Brionëve, e ndërmjetësuar nga BE-ja në korrikun e vitit 1991, si dhe plani i Lordit Kerington i paraqitur në tetor të po atij viti. Shkatërrimi i qytetit të Vukovarit në Kroaci nga armata jugosllave në nëntor 1991, dhe, më vonë, njohja e pavarësisë së Kroacisë dhe të Sllovenisë, u dhanë fund përpjekjeve për ta gjetur ndonjë qasje globale ndaj krizës jugosllave. Që nga atëherë, për secilën nga krizat e njëpasnjëshme propozoheshin zgjidhje të ndara dhe të shkëputura.

Para vitit 1998, Kosova nuk ishte ndonjë prioritet për Bashkësinë Ndërkombëtare. Problemet e krahinës dukeshin pothuaj si një bezdi e cila vetëm që u shtonte edhe më shumë ndërlikime negociatave lidhur me luftat në Slloveni, Kroaci dhe në Bosnje. Kosova thuaja se shikohet si dytësore në krahasim me këto konflikte, çështja e të cilave kishte urgjencë. Sikur Bashkësia Ndërkombëtare gjatë atyre viteve, d.m.th. para mëkëmbjes së UÇK-së, të kishte treguar më shumë interes dhe përkushtim, lufta në Kosovë ka patur gjasë të shmangej. Në këtë dritë, përshkallëzimi i dhunës së armatosur më 1998-9 e tregon një dështim të mjerë të mësimëve të “paralajmërimit me kohë.”

Një deklaratë e fortë që është bërë nga qarqet zyrtare gjatë kësaj periudhe, ishte vërejtja e Kërshëndellave e Presidentit Bush. Më 24 dhjetor 1992, ambasadori i SHBA-ve në Beograd ia dha Millosheviqit mesazhin se “në rast të konfliktit në Kosovë të shkaktoar nga ndonjë veprim serb, SHBA-të do të jenë të gatshme ta përdorin forcën ushtarake kundër serbëve si në Kosovë ashtu edhe në vetë Serbi”.³⁹ Ky mesazh u përsërit më vonë edhe nga Madeline Albright në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në gusht të vitit 1993.⁴⁰

Niveli kuantitativisht i ulët i dhunës vdekjeprurëse në Kosovë në fillim të viteve 1990,

u keqinterpretua në masën më të madhe nga Bashkësia Ndërkombëtare. Millosheviqi e kishte lejuar LDK-në ta krijonte rrjetin e saj paralel, duke ndërhyrë vetëm në mënyrë sporadike, sa për ta penguar sfidimin e drejtpërdrejtë të pushtetit të Beogradit, ashtu siç ndodhi, për shembull, gjatë përpjekjes për ta vendosur një forcë policore paralele. Strategjia pasive e LDK-së i shërbeu qëllimit të Millosheviqit për arsye të dukshme dhe konvergjente, pasi që ai, sikur që dukej, kishte dëshirë t'i ikte një konfrontimi tjetër gjatë kohës së armiqësive në Bosnje. Në vend që Bashkësia Ndërkombëtare ta kuptonte natyrën e përkohshme dhe ende shpërthyesë të këtij armëpushimi të qartë, si dhe mundësinë e angazhimit që e ofronte veprimi i LDK-së, ajo u përgjigj me vetekënaqësi duke e shtytur kështu Kosovën larg e më larg, në prapavijë fare.

Asnjëri nga aktorët kryesorë ndërkombëtarë, duke i përfshirë këtu Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICFY), Bashkimin Evropian (BE), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) dhe Kombet e Bashkuara (OKB), nuk i dha Kosovës ndonjë vëmendje tjetër pos asaj sporadike. Vëmendja e vogël që i drejtohej Kosovës nga organizatat ndërqeveritare, ishte përqendruar në periudhën gjatë viteve 1992-93, kur qeveritë kishin frikë që lufta në Bosnje e Hercegovinë mund të përhapej edhe në Kosovë.

Kjo mënyrë e veprimit vetëm që u sforcuua nga Konferenca e Bashkimit Evropian (BE, atëbotë Bashkësia) mbi Jugosllavinë, e cila kryesohej nga Lordi Kerington, dhe e cila u mbajt më 1991 në Hagë. Kjo konferencë shkoi aq larg sa që Kosovën e përkufizoi si një problem “të brendshëm” të Jugosllavisë, duke e dekurajuar në këtë mënyrë interesimin dhe involvimin ndërkombëtar. Në takimin e saj të dytë në Londër, në gusht 1992, Keringtoni dha sinjale shumë të përziera, gati duke e ftuar Rugovën – por jo edhe në tërësi - që të merrte pjesë.⁴¹

Në ndërkohë, Rugova dhe udhëheqësit e tjerë të LDK-së po ia arrinin ta tërhiqnin një vëmendje më të shtuar të komunitetit të OJQ-ve ndërkombëtare, dhe ia arritën madje edhe t'i aranzhojnë disa takime diplomatike të nivelit më të lartë me qeveri të huaja. Mesazhi ndërkombëtar që iu dha Rugovës ishte pothuajja njëzërit lavdërim për lëvizjen e tij, dhe në veçanti për karakterin e saj të mosdhunës, mirëpo ky lavdërim nuk u shndërrua asnjëherë në ndonjë mbështetje konkrete.

Në ndërkohë, Konferenca e BE-së u shndërrua në Konferencë Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICFY), nën kryesinë e përbashkët të Dejvid Ovenit dhe të Sajrus Vensit. Në gushtin e vitit 1992, nën mbikëqyrjen e ICFY-së u formua një Grup Punues mbi komunitetet etnike dhe nacionale, i kryesuar nga Geert Ahrens, dhe ky Grup Punues e themeloi një Grup Special për Kosovën. Ky Grup Special arriti në përfundimin se

ishite me rëndësi që gjendja në Kosovë të normalizohej dhe u përpoq të ndërmjetesonte; si pasojë e kësaj në tetor 1992 u dha një Deklaratë e Përbashkët nga shqiptarët e Kosovës dhe nga Qeveria Federale. Mirëpo dialogu dështoi pasi që rektori i Universitetit paralel Ejup Statovci u arrestua nga fundi i vitit 1992. Grupi Punues vazhdoi të ekzistonte edhe më tutje, dhe më vonë u shndërrua në Këshillin Implementues Paqësor të Dejtonit dhe më vonë të Grupit të Kontaktit,⁴² mirëpo arritjet i pati fare të pakta.

Rëndësia e vogël që i jipej çështjes së Kosovës u reflektua po ashtu edhe në debatet e BE-së lidhur me njohjen e Sllovenisë dhe të Kroacisë, në vjeshtën e vitit 1991. Qeveritë evropiane e njohën dallimin në mes të republikave dhe krahinave, apo në mes të kombeve dhe kombësive, të paraqitur në Kushtetutën jugosllave. Rugova i kishte bërë thirrje BE-së për njohjen e pavarësisë në dhjetor 1991, kur BE-ja po e diskutonte çështjen e njohjes së pavarësisë së Sllovenisë dhe të Kroacisë. Komisioni i Badinterit, në raportin e fillimin të vitit 1992, propozoi që republikat e Jugosllavisë duhej ta kishin të drejtën të bëheshin të pavarura, me kusht që të përmbusheshin disa kushte. Krahinave autonome mundësia për një gjë të tillë nuk iu pranohej. Në nëntor 1993, Bashkimi Evropian e pranoi një propozim për rikthimin e autonomisë së Kosovës në Programin e Aksionit Evropian mbi Jugosllavinë. Mirëpo politikanët kryesorë, përfshirë edhe Dejvid Ovenin si bashkëkryesues i ICFY-së, vazhduan të këmbëngulnin në integritetin e Jugosllavisë. Natyrisht, ekzistonte frika nga një proces i pambarim i copëzimit politik që tashmë referohej si ballkanizim. Është një pyetje që duhet shtruar medoemos, lidhur me atë se a mos vallë vetë Badinteri e bëri mëkatën fillestar gjatë lejimit të shpërbërjes së Jugosllavisë, dhe kjo është ajo se a e kishte ai të drejtën t'i trajtonte krahinat ndryshe nga republikat në kohën kur kishte vendosur ta pranonte shthurjen e Jugosllavisë në pjesët e saj përbërëse.

Në korrikun e vitit 1992, Samiti i Helsinkit i OSBE-së së sapokrijuar e miratoi një Deklaratë mbi krizën jugosllave, duke ftuar për “veprim të menjëhershëm parandalues,” si dhe duke kërkuar nga autoritetet në Beograd “të përmbahen nga represioni i mëtejshëm dhe të angazhohen në një dialog serioz me përfaqësuesit nga Kosova në praninë e një pale të tretë”.⁴³ Në gusht 1992 u vendos që të krijoheshin misione afatgjata në Kosovë dhe në Vojvodinë. Këto misione u përpoqën ta hapnin dialogun themelor, në veçanti atë lidhur me arsimin. Mirëpo më 1993, Millosheviqi e refuzoi ripërtëritjen e vizave për anëtarët e këtyre misioneve, dhe ata u detyruan ta lëshonin vendin më 28 korrik. Kjo mund të ketë qenë përgjigje ndaj suspendimit të anëtarësimit të Jugosllavisë në OSBE. Sipas raportimeve, niveli i shkeljeve të të drejtave të njeriut ishte më i ulët gjatë kohës kur misionet ishin të pranishme, dhe ky u ngrit men-

jëherë pas tërheqjes së këtyre tyre.

Që të dy raportuesit specialë të OKB-së për të drejtat e njeriut, Tadeush Mazowiecki, dhe më vonë Elizabeth Ren, i kishin dërguar raportet e tyre për gjendjen në Kosovë. Mazowiecki u përpoq pa sukses ta themelonte një zyre në Kosovë. Rezoluta të ndryshme u miratuan nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kurse në korrik 1993, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi një rezolutë që ftonte për kthimin e Misionit të OSBE-së. Përpjekjet e tjera të OKB-së i përfshinin tentimet e UNESKO-s për të ndërmjetësuar në marrëveshjen e arsimit dhe, më 1996, një nismë të përbashkët të UNICEF-it dhe WHO-së për ta realizuar një program të vaksinimit kundër polios së bashku me qeverinë e sistemit paralel.

Shumica e këtyre përpjekjeve u bënë në vitet 1992-93. Pa dyshim, kundërshtimi i vendosur i regjimit të Beogradit e pengoi secilën përpjekje ndërkombëtare për t'u marrë me Kosovën. Megjithatë, deri në mbarimin e vitit 1997, përpjekjet për t'iu kundërvënë këtyre pengesave ishin të pakta. Përkundrazi, në dëshprimin e shkaktuar nga mossuksesi në përpjekjet për ta ndaluar luftën në Bosnje e Hercegovinë, Kosova u anashkalua qëllimisht. Kosova nuk u përfshi në negociatat e Dejtonit, meqë Tuxhmani dhe Izetbegoviqi nuk ishin të interesuar për të, kurse Millosheviqi do të kishte refuzuar ta pranonte atë si çështje për tu negociuar. Millosheviqi kundrohej si lojtari kyç, dhe Bashkësia Ndërkombëtare nuk dëshironte t'i rrezikonte gjasat e arritjes së marrëveshjes. Mirëpo si rezultat i këtij moskujdesi erdhi deri te legjitimimi i tërthortë i rolit të Millosheviqit në Kosovë, si dhe dhënia e një sinjali të qartë, si Millosheviqit, ashtu dhe shqiptarëve të Kosovës, që Kosova ishte definitivisht jashtë agjendës së rrjedhave ndërkombëtare.

Ky mesazh i pati tri pasoja serioze në përshkallëzimin e konfliktit: ia la RFJ-së duart e lira në Kosovë; e demoralizoi dhe e dobësoi lëvizjen e mosdhunës në Kosovë, e cila e ndjeu veten të tradhëtuar nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe filloi të dyshonte në efektshmërinë e taktikës së saj; dhe, në fund, shpuri drejtpërdrejt në një gufim vendimtar të bindjes në mesin e kosovarëve se rruga e rezistencës me forcë ishte shtegu i vetëm politikisht real drejt pavarësisë.

Pas Dejtonit, BE-ja e njohu edhe formalisht Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), duke e përfshirë edhe Kosovën në përbërjen e saj, dhe Gjermania madje i riatdhesoi 130.000 shqiptarë të Kosovës. Sipas Bukoshit, "Kjo ishte një tronditje. Ne nuk e prisnim këtë, dhe ky ishte një gabim fatal."⁴⁴

Pas kësaj u bënë përpjekje për ta zbtuar goditjen e cila iu dha kosovarëve në Dejtton. Shtetet e Bashkuara, duke e njohur RFJ-në, insistuan në mbajtjen e një muri të jashtëm

të sanksioneve kundër RFJ-së për shkak të gjendjes në Kosovë. Po ashtu, më 1996 Shtetet e Bashkuara e themeluan një Zyre të Shërbimit Informativ (USIS), dhe kjo e kishte një vlerë simbolike të konsiderueshme. Në fakt, prania e USIS-it ishte pjesërisht rezultat i trysnisë e cila u ushtrua në Dejton. Megjithëkëtë, procesi i Dejtonit e përshpejtoi acarimin e problemit të Kosovës. Edhe pse gjasat që Dejtoni do të kishte qenë në gjendje të kontribuonte për përmirësimin e gjendjes kanë qenë fare të pakta, megjithëkëtë, kanë mundur të gjenden mënyra për këtë. Për shembull, përkundër rolit të supozuar konstruktiv të Millosheviqit në negociatat lidhur me Bosnjen, mesazhi i mëparshëm i presidentit Bush, “duart larg nga Kosova,” ka mundur të ripërsëritej në ndonjë farë mënyre; apo, Dejtoni ka mundur të shfrytëzohej si një forum për ta inkurajuar pranimin nga ana e RFJ-së të një pranie më të madhe të OJQ-ve në Kosovë - e madje edhe gjetkë në Serbi.

Në të vërtetë, aktorë të vetëm të rëndësishëm gjatë periudhës 1993-7 ishin OJQ-të. Mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut i bënin Human Rights Watch, Mercy Corps dhe Amnesty International, si dhe grupe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si në Kosovë ashtu edhe në Beograd, çfarë ishin Fondacioni i Ligjit Humanitar dhe Kryqi i Kuq i Jugosllavisë.⁴⁵ Një numër i organizatave të tjera jipnin deklarata lidhur me Kosovën, duke ftuar për protektorat apo mbikëqyrje të OKB-së, si për shembull Organizata e Popujve e Kombeve të Bashkuara, Fondacioni Transnacional në Suedi, Asambleja e Qytetarëve e Helsinkit dhe Avokatët e Minesotës për të Drejtat e Njeriut. Mirëpo dy OJQ-të pa dyshim më të rëndësishme ishin Komuniteti Shën Exhidio, i cili edhe e negocioi marrëveshjen e arsimit më 1996, dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur i Beogradit (OSF) i cili e luajti një rol unik në mbështetjen e sistemit paralel dhe në sforcimin e dialogut midis shqiptarëve dhe serbëve. OSF-ja e filloi punën me programet për fëmijë në mbarimin e vitit 1992. U themeluan klasë të para të anglishtes si për fëmijët shqiptarë ashtu edhe për ata serbë, kurse më 1994 në Prishtinë u themelua një Klub i Hapur për të rinjtë shqiptarë e serbë (ndonëse ata mëtonin të vinin në grupe të ndara). OSF-ja e mbështeti po ashtu Shoqatën Nëna Tereze, OJQ-të e gruas dhe të rinisë, mediat e pavarura si dhe aktivitete të ndryshme kulturore - nga mesi i viteve 1990 në Prishtinë u hap galeria e parë e artit, ndërkaq një ekspozitë e piktorëve shqiptarë u hap në Beograd në qershor të vitit 1997. Posaqërisht i suksesshëm ishte programi i pasurimit arsimor, në kuadër të të cilit u ngritën qendra kompjuterike anembanë Kosovës, e të cilat vetëm gjatë dy viteve të para i tërhoqën më se 15.000 pjesëmarrës.

Problemi për OSF-në ishte se donatorë të tjerë pothuaj mungonin fare dhe se ishte gati e pamundur të merrej mbështetje dhe përkrahje zyrtare ndërkombëtare për këto

aktivitete, gjë kjo e cila do ta kishte shtuar dukshëm efektshmërinë e tyre. Ndihma e Popullit Norvegjez (Norwegian Peoples Aid) i mbështeti “Post-Pesimistët,” ndërkaq Ndihma Zvicerane për Fatkeqësi (Swiss Disaster Aid) dhe Komiteti Amerikan Ndërkombëtar i Shpëtimit (American International Rescue Committee) ndihmuan në rindërtimin fizik të shkollave; mirëpo këto ishin më tepër përjashtime sesa ndonjë rregull. Sistemi paralel praktikisht ishte i kufizuar dhe nuk mund të mbahej në një afat më të gjatë si një alternativë e një sektori publik funksional. Vështirësitë dhe frustrimet e jetës së përditshme, dhe në veçanti ato të të rinjve, të cilëve u mohohet arsimimi formal, ishin pothuaj të parapërcaktuara që ta përshkallëzonin tendosjen. Kur, për shembull, nga mbarimi i vitit 1997, autoritetet më në fund u pajtuan që ta hapnin Fakultetin Teknik të Universitetit për studentët shqiptarë, përnjëherësh u “zbulua” se të gjitha gjërat nga ai Fakultet ishin paketuar dhe ishin marrë; Fakulteti nuk ishte hiç më shumë pos një ndërtesë e zbrazët, ndërkaq, nuk kishte ndonjë donator në dispozicion i cili do të investonte në paisjet e domosdoshme.

OSF-ja përpiquej të krijonte lobi nga qeveritë dhe nga donatorë të tjerë, por sipas drejtoreshës së OSF-së Sonja Licht, kjo ishte thuaja sikur “ta sulmoje Murin Kinez.” Në nëntor 1997, një zyrtar i Departamentit të Shtetit i kishte thënë se qeveria e SHBA-ve “nuk mund ta mbështesë shoqërinë civile, meqë kjo do të shpiente kah secesioni.” Ajo i ishte përgjigjur thjesht se “po që se nuk mbështetet shoqëria civile, atëherë secesioni do të arrihet përmes terrorizmit.”

Konkludim

Që nga vitet 1980 e tutje, Kosova i shfaqte të gjitha shenjat e një katastrofe e cila ishte në pritje e sipër. Këtu ishte një shoqëri autoritare e cila nuk u nënshtrohej trysnive për liberalizim dhe demokratizim. Papunësia ishte tepër e lartë, në veçanti në mesin e të rinjve të arsimuar, ndërkaq kriminaliteti ishte në rritje. Propaganda nacionaliste, në veçanti ajo nga ana e serbëve, ishte duke u fryrë si nga mediat ashtu edhe nga intelektualët. Në anën shqiptare, diaspora aktive po bëhej gjithnjë e më radikale. Këto janë pikërisht ato kushte të cilat ushqejnë “luftëra të reja.”⁴⁶

Për më tepër, askush nuk mund të pohojë që Bashkësia Ndërkombëtare nuk ishte e njoftuar me zhvillimet në Kosovë. Përpos raporteve nga intelijenca dhe nga mediat, një numër i OJQ-ve të njohura si dhe Raportuesit Special të OKB-së për të drejtat e njeriut e bënë rregullisht mbikëqyrjen e gjendjes. Megjithatë, Bashkësia

Ndërkombëtare përgjigjej me një vargan sinjalesh të përziera. Lëvizja e mosdhunës e mori bekimin dhe lavdërimin ndërkombëtar, por pa ndonjë përkushtim të qëndrueshëm. Zyrtarët e SHBA-ve organizonin pritje për Rugovën, mirëpo Dejttoni më pas e injoroi Kosovën në tërësi. Përfundimi vazhdoi ta njëjto Rugovën edhe pas Dejttonit, mirëpo nuk kishte ndonjë përpjekje të dukshme për ta inkurajuar LDK-në që ta zhvillonte një qëndrim më të pranueshëm politik lidhur me statusin e Kosovës, dhe, po ashtu, nuk kishte lëvizje për ta rikthyer çështjen në tavolinën diplomatike. Ndërkaq Millosheviqi, të cilit vërejtja lidhur me Kosovën i ishte tërhequr edhe më herët, më vonë u sigurua që statusi i saj brenda REF-së ishte jashtë sfidës, dhe se administrimi i saj ishte një çështje e brendshme.

Nga përvoja e kësaj periudhe mund të nxirren tri mësimë të përgjithshme. Para së gjithash, dështimi për të reaguuar në mënyrë adekuate në një etapë të hershme të zhvillimit të konfliktit, krijon vështirësi në etapat e mëvonshme. Në secilën etapë të konfliktit, opsionet diplomatike ngushtoheshin. Vendimi për të mos u marrë seriozisht me çështjen e Kosovës më 1991, krijoi pengesa për veprim në vitet 1992-3. Vendimi për të mos u konfrontuar me vendosmërinë e Millosheviqit më 1993, dhe, mbi të gjithat, injorimi i plotë i Kosovës gjatë negociatave të Dejttonit, i kontribuuan zhvillimeve që do të përshkallëzoheshin në konflikt më 1996-7. Përpjekjet joadekuate diplomatike në periudhën 1997-8 në fund e arritën kulmin në Rambuje, ku hapësira për manovrim ishte për së tepërmi e kufizuar.

Së dyti, gjatë kësaj periudhe ishte me më tepër rëndësi të krijohej një prani ndërkombëtare në terren dhe të mbështeteshin përpjekjet për normalizimin e situatës sesa të kërkohesh ndonjë zgjidhje për çështjen e statusit. Çdo kompromis lidhur me statusin medoemos do të ishte për së tepërmi i vështirë, pasi që kosovarët këmbëngulnin në pavarësi, ndërkohë që autoritetet e Beogradit ngulmonin në integritetin e Jugosllavisë. Parandalimi i konfliktit do të duhej të ishte i përqendruar në krijimin e një pranie në terren për ta ofruar një mbrojtje nga shkeljet e të drejtave të njeriut, për t'i mbështetur dhe ndihmuar institucionet paralele dhe për ta inkurajuar dialogun. Ndikimi përmbajtësor i pranisë civile, të një OJQ-je ndërkombëtare apo ndërqeveritare (OKB-së apo OSBE-së) kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut është dëshmuar qartë në konflikte të shumta. Përpos nëse situata acarohet deri në atë pikë në të cilën edhe vetë prania ndërkombëtare është në rrezik të madh, një prani e paarmatosur e ka një ndikim jo vetëm në jetën e përditshme të popullsisë së shtypur, por shpesh mund ta krijojë një pajtueshmëri me preokupimet shtetërore mbi cenimin e sovranitetit. Prania e një misioni afatgjatë duket që e ka zbutur situatën më 1992-3. Është dashur të bëhen më shumë përpjekje në drejtimin e sigurimit të një pranie të fortë ndërkombëtare brenda

Kosovës, duke i përmirësuar kështu kushtet e jetesës së përditshme dhe duke e forcuar komunikimin në mes të serbëve dhe shqiptarëve brenda Kosovës, si dhe me vetë popullin serb në Serbi.

Së treti, shumë më tepër ka mundur të bëhet nga Bashkësia Ndërkombëtare në mbështetjen e nismave të shoqërisë paralele.⁴⁷ Për shembull, universitetet nga vendet e tjera kanë bërë fare pak për t'i ndihmuar përpjekjet alternative arsimore të zhvilluara si rezistencë pasive, pas përjashtimit të studentëve kosovarë nga fakultetet dhe nga Universiteti i Prishtinës nga zyrtarët serbë. Vite me radhë, LDK-ja i bënte thirrje Bashkësisë Ndërkombëtare që ta mbështeste në ballafaqimin me tendosjet dhe me dhunën e vazhdueshme e cila mbretëronte në Kosovë. LDK-ja e ofroi veten si një aleat legjitim dhe të gatshëm për nivelet diplomatike, politike dhe të tjera të trysnive jo të dhunshme apo të intervenimeve që kanë mundur të ndërmerren. Natyra e paarmatosur e konfliktit (të paktën nga njëra anë), ofronte mundësi të një involvimi civil ndërkombëtar i cili do të ishte më pak imponues dhe jo gjithaq kanosës për sovranitetin dhe preokupimet e sigurisë së RFJ-së, sesa që do të ishte prania e armatosur.

Ndonëse askush nuk mund të japë përgjigje në pyetjet “çfarë sikur,” të cilat bëhen në vlerësimet nga retrospektiva, mbështetja ndërkombëtare për këto sisteme paralele ka mundur ta përmbante rezistencën paqësore në një masë të mjaftueshme sa për ta ndër-tuar një shteg tjetër për Kosovën. Për më tepër, dështimi për t'i marrë më seriozisht kërkesat e lëvizjes së mosdhunës në një etapë të hershme, shpuri në konkludimin se dhuna sjell rezultate dhe është një strategji më efektive politike. Kjo kishte implikime të thella edhe në kulturën politike të pasluftës. Strukturat paralele që u krijuan në këtë periudhë ekzistojnë ende dhe gëzojnë besnikëri të gjerë, sidomos jashtë Prishtinës. Mirëpo kjo besnikëri rrezikohet përditë nga veprimet e atyre që kanë mësuar se dhuna është një mënyrë efektive për t'i arritur objektivat politike.

2. Konflikti i brendshëm i armatosur

shkurt 1998 – mars 1999

Në fillimin e vitit 1998, Kosova ishte buzë konfliktit të hapur. Demonstratat e studentëve në gushtin e vitit 1997 e kishin bërë të qartë që LDK-ja nuk e kishte edhe më tutje kontrollin mbi aktivitetin politik të shqiptarëve kosovarë. Iniciativa ishte duke u marrë nga taktika më konfrontuese. Në shtator, studentët protestues ndërmorën hapa të tjerë që nuk ishin në pajtim me politikën e LDK-së, duke e refuzuar thirrjen e Rugovës për të ndaluar protestat në rrugë dhe për të krijuar kontakt me grupet e ndërlidhura me UÇK-në.

Më 1 tetor 1997, policia serbe i sulmoi 20.000 studentë që ishin duke bërë protestë paqësore në Prishtinë, dhe filloi t'i burgoste kundërshtarët në të tërë Kosovën. Në tetor dhe nëntor 1997, UÇK-ja për herë të parë filloi të paraqitej publikisht në varrimet e ushtarëve dhe të përkrahësve të vet. Në këto ngjarje merrnin pjesë me dhjetëra mijëra njerëz. Gjatë kësaj periudhe kohore, UÇK-ja filloi t'i kundërvihej hapur policisë serbe në rajonet e Drenicës dhe të Pejës, duke i shpallur këto “rajonet e para të çliruara” në Kosovë. Si reagim ndaj këtyre sulmeve, numri i përleshjeve të armatosura në Kosovë u rrit në përmasa dramatike, me 66 raste vetëm gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 1998, nga 55 gjatë të tërë vitit 1997, dhe 31 gjatë atij 1996.¹

Përkundër thirrjeve ndërkombëtare për përmbajtje dhe dialog,² forcat serbe i përshpejtuan aksionet e tyre të dhunshme kundër kryengritësve. Në fillim të janarit 1998 forcat speciale të policisë serbe i filluan manovrimet në rajonin e Drenicës, si dhe afër Pejës e Lipjanit, me gjasë për të mbjellur frikë në popullatën shqiptare të Kosovës. Në të njëjtën kohë, qytetarët serbë u armatosën, dhe grupe të shumta paramilitare hynë në Kosovë nga Serbia.

Më 27 shkurt 1998, forcat jugosllave e sulmuan me armatim të rëndë fshatin Likoshan në Drenicë, duke përdorur njësi të blinduara dhe mitroloza helikopterësh. Me këtë rast u vranë katër policë jugosllavë dhe një numër i panjohur shqiptarësh. Luftimet në rajonin e Drenicës vazhduan për disa ditë. Si përgjigje, me 2 mars në Prishtinë u organizua një protestë në rrugë. Forcat jugosllave e shpërndanë protestën në mënyrë të dhunshme, duke përdorur topa uji, gaz lotësjellës dhe shkopinj, dhe duke i plagosur të paktën 289 veta.³

Një varg i aksioneve mizore u ndërmorën kundër anëtarëve të familjes Jashari, të cilët ishin frymëzuesit kryesorë të rritës lokale të UÇK-së në rajonin e Drenicës. Policia ishte orvatur ta arrestonte Adem Jasharin më 22 janar, mirëpo rezistenca të cilën e hasi nga UÇK-ja e kishte detyruar të tërhiqej. Më 5 mars, pas një javë luftimesh në Drenicë, në Prekaz u ndërmorr një aksion i armatosur i fuqishëm dhe i përqendruar kundër shtëpive të familjes Jashari. Duke përdorur artileri kundër shtëpive, dhe snajperë kundër atyre që arratiseshin, masakra përfundoi me 58 të vdekur, duke e përfshirë këtu edhe vetë Adem Jasharin, i cili në këtë mënyrë u shndërrua në një martir të kauzës së UÇK-së.⁴

Organizata Human Rights Watch (HRW) ndërmori hetime të gjera lidhur me ngjarjet që kishin të bënin me dhunën në Drenicë, dhe erdhi në përfundim që këto ngjarje ishin një “pikë kthimi në krizën e Kosovës”.⁵ Pas analizës së aksioneve serbe në Likoshan dhe në fshatin e afërt Qirez, HRW konkludonte:

Pa e marrë parasysh se çfarë e shkaktoi incidentin, nuk ka dyshim fare që forcat policore speciale vepruan në një mënyrë të shpejtë dhe të organizuar mirë, gjë që bën të kuptohet se policia këtë sulm fare lehtë mund ta ketë planifikuar më parë. Po ashtu, nuk ka dyshim fare që policia kundër fshatarëve ka përdorur forcë arbitrare të tepruar për një kohë të gjatë pasi që rezistenca kishte pushuar.⁶

Raporti vazhdon me vështrimin e aksioneve në disa fshatra të tjera, dhe e nxjerr përfundimin se gjatë konflikteve jetën e kishin humbur edhe një numër i madh i civilëve, përfshirë këtu me dhjetëra gra e fëmijë. Përpos vrasjeve, raporti e jep një kronikë të një vargani të shkeljeve të të drejtave të njeriut të bëra nga forcat dhe autoritetet serbe, duke i përfshirë sulmet e ndërmarra kundër punëtorëve humanitarë dhe kufizimin e punës së tyre, arrestimet dhe burgosjet arbitrare, kufizimin e punës së mediave si dhe zhdukjet.⁷ Po ashtu jipen në mënyrë të detajuar edhe disa keqtrajtime nga ana e UÇK-së, të cilat kryesisht ishin rrëmbime. Keqtrajtimet e raportuara nga ana e UÇK-së ishin të përqendruara kundër serbëve, por herë-herë edhe kundër shqiptarëve që konsideroheshin si “bashkëpunëtorë”.⁸

Qeveria jugosllave vazhdoi ta përshkruante situatën si një konflikt i brendshëm i cili ishte nën kontroll. Pas operacionit katërditësh të luftimeve dhe të spastrimeve që u bënë në Drenicë, zëvendëshefi serb i krahinës së Kosovës Velko Odallovic e shpalli se “Operacioni për ta likuiduar shpirtin e terrorizmit në Kosovë ka marrë fund.” Që nga ky moment e më tutje zyrtarët jugosllavë filluan t’i fusnin reporterët zyrtarë nëpër autobusa të cilët i dërgonin nëpër fshatrat ku ishin zhvilluar këto operacione.⁹ Në të njëjtën kohë, rajoni mbeti tërësisht i mbyllur, dhe në këtë mënyrë 5.000 njerëz që llog-

ariteshin si të zhvendosur të brendshëm ngelën pa ushqime dhe pa furnizime mjekësore.¹⁰ Njëkohësisht, agjencia jugosllave e lajmeve Tanjug, e citonte Millosheviqin që të kishte thënë se “Republika Federale e Jugosllavisë është vendosmërisht kundër të gjitha përpjekjeve për t’i ndërkombëtarizuar problemet e brendshme të cilitdo vend.”

Megjithëkëtë, tash ishte e pamundur të mohohet që problemi ishte ndërkombëtarizuar.¹¹ Shtetet e Bashkuara i tërhoqën disa koncensione të caktuara diplomatike. Shtypi amerikan i raportonte vërejtjet e CIA-s që ushtria jugosllave ishte duke u vendosur në kufirin me Kosovën. Më 9 mars Grupi i Kontaktit e nxiti nismën për një embargo të armëve. Më 10 mars Louise Arbour, kryeprokurore e Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve në ish-Jugosllavi (ICTY), publikisht e pohoi juridiksionin e Tribunalit mbi shkeljet e ligjit ndërkombëtar humanitar në Kosovë.¹² Më 31 mars, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi Rezolutën 1160, me vota 14-0, me abstenim të Kinës, e cila Rezolutë impononte embargo në armë për Jugosllavinë dhe kërkonte autonomi dhe “vetëadministrim kuptimplotë” për Kosovën.¹³ Këshilli e tërhoqi vërejtjen se është e mundur të ndërmerren “masa plotësuese,” po qe se nuk arrihet ndonjë përparim drejt një zgjidhjeje paqësore. Ambasadori i Jugosllavisë në OKB Vladislav Jovanović përpigëj ta përgënjeshtronte nevojën për këto masa duke deklaruar: “Nuk ka dhe as që ka pasur ndonjë konflikt të armatosur në Kosovë. Prandaj nuk ka rrezik për përhapje, nuk ka rrezik për paqe, dhe nuk ka rrezik për siguri.”¹⁴

Dhuna në Drenicë dhe brutaliteti policor kundër protestave paqësore të studentëve në Prishtinë i patën edhe pasojat e brendshme. Deri në këtë pikë, UÇK-ja nuk e kishte ndonjë program politik, nuk kishte përfaqësim të pranuar, ishte pa njohje ndërkombëtare dhe nuk kishte nën kontroll forca ushtarake me mundësi të mëdha. Mirëpo lajmet mbi masakrat si dhe mitet mbi dëshmorët e kombit, papritur e bënë UÇK-në forcë nxitëse të çlirimit kombëtar në sytë e një numri gjithnjë e në rritje të shqiptarëve kosovarë. Për herë të parë UÇK-ja mund të pohonte se ishte shndërruar në faktor të rëndësishëm politik. Me shtimin e numrit të shqiptarëve kosovarë që e shikonin dhe i bashkangjiteshin UÇK-së me shpresë për çlirim, mbështetja për strategjinë e mosdhunës dhe të shtetit paralel të LDK-së zuri të zbehej.

Pothuaj brenda natës, në një mënyrë në tërësi të pavarur, në shumë fshatra të Kosovës u krijuan milici vetëmbrojtëse. Ky proces mbase edhe nuk kishte ndonjë lidhje me organizatën kombëtare të UÇK-së, por ishte më parë pasojë e asaj që shqiptarët i rrokën armët me qëllim të mbrojtjes së vetvetes. Ndonëse këto milici ishin mjaft të përhapura, atyre u mungonte si koordinimi ashtu edhe struktura logjistike. Rugova si kundërpërgjigje i paralajmëroi zgjedhjet të cilat u mbajtën më 22 mars, dhe në të cilat

ai e fitoi një shumicë dërrmuese të votave. Në këtë mënyrë, dukej sikur shqiptarët e Kosovës ende shikonin drejt LDK-së dhe Rugovës për udhëheqje politike, por tash shikonin edhe në UÇK-në si një mbrojtje nga agresioni serb.

Përshkallëzimi i konfliktit

Pas ngjarjeve në Drenicë, që të dyja palët në konflikt e rritën gjerësinë e aktiviteteve të tyre. Disa qindra bashkatdhetarë të shqiptarëve kosovarë filluan të vinin në Kukës, qytet ky i Shqipërisë Veriore në të cilin ata filluan të ushtroheshin dhe të organizoheshin për luftë. Thuhet që UÇK-ja ishte e papërgatitur për ta pranuar një numër aq të madh të vullnetarëve që e kalonin kufirin për në veri të Shqipërisë, apo që përpiqeshin t'i bashkoheshin grupeve lokale në brendi Kosovës. Shtigjet e furnizimit të krahinës me armë dhe municion organizoheshin duke filluar nga Shqipëria Veriore. Pranvera e vitit 1998 e solli një valë të re të gjerë të sulmeve të vogla të pakoordinuara ndaj pozitave të policisë serbe, e në disa rajone edhe luftime në mes të fshatrave të armatosura serbe dhe shqiptare. Thuhet që në këtë kohë UÇK-ja e kishte zgjeruar kontrollin përtej fshatrave, duke i lënë forcave serbe mundësinë që t'i kontrollonin vetëm qytetet dhe rrugët kryesore. Mirëpo në po të njëjtën kohë, disa grupe të pavarura rajonale të UÇK-së bënin gara për ndikim dhe shpesh herë refuzonin t'i ndanin informatat dhe resurset që i kishin. Përçarja në mes të fraksioneve të UÇK-së ishte një faktor i cili ndikoi deri në fillimin e intervenimit të armatosur ndërkombëtar.¹⁵ Njëkohësisht, forcat e RFJ-së e zgjeruan fushatën e tyre të dhunës. Zyrtarë të ushtrisë jugosllave shpallnin vrasjet e shqiptarëve kosovarë që po përpiqeshin të kalonin në Kosovë nga Shqipëria.¹⁶ Tash konflikti kishte filluar të përshkallëzohej në të tërë krahinën, duke përfshirë këtu si rajonet kufitare ashtu edhe ato të brendshmet.

Përhapja e dhunës në Kosovë në pranverën e vitit 1998, si dhe shtimi i trysnisë ndërkombëtare kundër regjimit të tij, mund t'i kenë shërbyer legjitimitimit të Millosheviqit në sytë e opinionit të tij të brendshëm. Vetëm një vit më parë, tre muajt e protestave të opozitës serbe atë e kishin sjellë buzë përmbysjes. Tani ai mund ta shfrytëzonte krizën e Kosovës për ta fituar mbështetjen e domosdoshme të brendshme. Më 24 prill 1998, Millosheviqi e thirri një referendum kombëtar lidhur me atë se a do të duhej pranuar apo jo ndërmjetësimi ndërkombëtar në krizën e Kosovës. Politika e tij gjithnjë e më shoveniste ndaj shumicës shqiptare të popullsisë së Kosovës, mori mbështetje të plotë nëpër anketa, duke i grumbulluar 95% të votave. Mirëpo, pjesëmarrja në referendum ishte e ulët.

E ballafaquar me një prani të UÇK-së e cila po zgjerohej me shpejtësi, ushtria jugosllave hyri në Kosovë me përforcime masive dhe e filloi një fushatë ushtarake të një shkalle të gjerë, me koordinim të njëjësive policore dhe të atyre paramilitare. Kjo fushatë e kishte për qëllim jo vetëm pengimin e zgjerimit të aktiviteteve të UÇK-së, por, për më tepër, këtë synonte ta arrinte duke e vënë në shënjestër të drejtpërdrejtë popullsinë civile të shumicës shqiptare në rajonet rurale.

Duke filluar nga prilli e deri në verë të vitit 1999, filloi të raportohej një shtim i numrit të sulmeve mbi civilë, dhe atë ndaj të gjitha palëve pjesëmarrëse në konfliktin gjithnjë e më të gjerë. Qendra e Ligjit Ndërkombëtar (HLC) filloi ta regjistronte një varg keqtrajtimesh të bëra kundër serbëve, e në disa raste edhe kundër romëve, duke përfshirë këtu zhdukjet, rrëmbimet dhe burgosjet arbitrare. Në një numër të rasteve keqtrajtimet lidheshin drejtpërsëdrejti me aktivitetet e UÇK-së, nga të cilat banorët serbë detyroheshin t'i lëshonin shtëpitë dhe fshatrat e tyre. Për shembull, më 21 prill 1998, UÇK-ja e mori Ratishin e Epërm, ndërkaq më 22 prill ajo e mori edhe Dashinovcin. Në që të dyja rastet, shumica e serbëve lokalë u arratisën, dhe kishte raporte edhe për zhdukje të pashpjeguara.¹⁷

Ndonëse filloi të vërehej, shtimi i numrit të keqtrajtimit nga UÇK-ja ishte ende i vogël fare në krahasim me numrin e keqtrajtimit të ushtruar nga forcat e sigurisë dhe të atyre paramilitare të RFJ-së. Ekzekutimet pa gjyq, përdorimi i tepruar i forcës dhe zhdukjet ishin të shpeshta, dhe këto nga Amnesty International përshkruheshin si një model tashmë e trajtësuar në tërësi.¹⁸ Për këto lloje të keqtrajtimit u grumbulluan raporte specifike dhe të detajuara, siç janë, për shembull, ato për sulmet e policisë serbe kundër Lubeniqit, më 25 maj 1998, dhe kundër Poklekut të Ri, më 31 maj 1998. Në të parin, forcat e armatosura policore i ekzekutuan aty për aty tetë burra dhe mëpastaj i dogjën shtëpitë, ndërkaq në të dytin, tetë burra “u zhdukën,” pasi që më parë ishin marrë nga policia.¹⁹ Përshkallëzimi vazhdoi gjatë tërë muajit. Nga fundi i majit, 300 veta llogariteshin të jenë vlarë që nga fillimi i fushatës jugosllave në shkurt. Pos kësaj, afro 12.000 refugjatë ishin arratisur për në Shqipëri.²⁰

Ky shtim i aktiviteteve ushtarake dhe i dhunës kundër civilëve, e shkaktoi në qershorin e vitit 1998 shqyrtimin e parë publik nga ana e Aleancës së NATO-s të mundësisë së intervenimit ushtarak. Një zyrtar i lartë i NATO-s citohej të kishte thënë: “Është një ndjenjë e re e urgjencës, dhe debati tash është i përqendruar në goditjet ajrore.”²¹ Më 10 qershor 1998, kryeministri britanik Toni Bler e theksoi nevojën për veprim ushtarak, po që se diplomacia nuk do të ishte në gjendje t'i japë fund krizës.²² Sipas zëvendësprokurorit të ICTY-së, Graham Blevit, “këtu është duke ndodhur një konflikt i armatosur.”²³ Pas kësaj, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së e shpalli Vendimin

218, duke e autorizuar krijimin e stacioneve vëzhguese përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri.²⁴ Këto pika u bënë në tërësi funksionale nga mbarimi i qershorit 1998. Menjëherë pas krijimit të tyre, vëzhguesit kufitarë të OSBE-së filluan të raportonin për një nivel substancial të aktivitetit ushtarak dhe të luftimeve përgjatë kufirit. Këto raporte e tërhoqën vëmendjen e diplomatëve perëndimorë të nivelit më të lartë. Në javën e dytë të korrikut, Ministri gjerman i Punëve të Jashtme Klaus Kinkel, e bëri një vizitë në rajon për të marrë një raportim nga vendi i ngjarjes nga vëzhguesit kufitarë të OSBE-së lidhur me gjendjen e konfliktit.²⁵ Që nga kjo pikë e tutje, OSBE-ja e mbahti një prani aktive në kufi.

Në një zhvillim tjetër të rëndësishëm, takimi Jelcin-Milloshëviq i cili u mbajt në qershor e hapi rrugën për instalimin në korrik të Misionit Diplomatik Vëzhgues të OKB-së në Kosovë (KDOM), i cili u përpoq t'i bashkonte fraksionet e ndryshme të UÇK-së.²⁶ Zyra e KDOM-it ia arriti ta mbushte një zbrazëti: siç e tha një gazetar, “më në fund është një vend ku mund të kontaktohet udhëheqja e UÇK-së.”²⁷ Në veprimin e KDOM-it morën pjesë disa vende evropiane dhe Rusia, si dhe ambasadat e tyre përkatëse, të cilat i filluan një vargan të takimeve të rregullta vëzhguese në Beograd.

Gjatë tërë korrikut dhe gushtit, cenimet serbe të territorit dhe të hapësirës ajrore shqiptare ishin të rëndomta, siç ishin edhe bombardimi dhe djegia e fshatrave në rajonin e Prizrenit dhe të Gjakovës. Sulmet e UÇK-së në Kosovë ishin po ashtu të shpeshta, dhe forcat serbe përgjigjeshin me një varg taktikash të ndryshme, duke e përfshirë përdorimin e minave tokësore dhe të pritave. Humbjet e UÇK-së ngandonjëherë ishin substanciale.²⁸ Human Rights Watch intervistoi refugjatët në Mal të Zi dhe në Shqipëri, e të cilët parreshtur raportonin për granatimin arbitrar serb të fshatrave kosovare, si dhe për sulmet mbi civilët e arratisur.²⁹

Konflikti nuk kufizohej vetëm në rajonin kufitar. Raportet e korrikut i përshkruanin në hollësi pikat kritike të konfliktit që ishin shfaqur edhe në brendi të Kosovës. Dy shembuj janë beteja e Rahovecit dhe aksionet serbe në Vushtrri. Sikurse edhe në rajonet kufitare, edhe në këto konflikte më së rëndi e pësoi popullata civile.

Më 17 korrik 1998, forcat e UÇK-së e pushtuan Rahovecin. Pasant luftime të rrepta, dhe më 21 korrik forcat serbe arritën ta detyrojnë UÇK-në të tërhiqet dhe sërish e morën kontrollin. Pas kësaj serbët shkatërruan shumë shtëpi, kurse disa raporte dëshmonin që ata edhe vranë civilë të arratisur. UÇK-ja po ashtu i zuri 55 serbë, duke përfshirë këtu edhe personelin mjekësor, gjë që rezultoi në “zhdukjen” e tyre. Më vonë, të paktën 35 serbë u liruan.³⁰ Dhuna u raportua po ashtu edhe në rajonin e Vushtrrisë, afër Mitrovicës.³¹

Ndonëse detaje të hollësishme për periudhën deri në fillimin e gushtit mungonin, raportet tregonin që dikund rreth 200.000 deri në 300.000 shqiptarë të Kosovës ishin zhvendosur nga shtëpitë e tyre si pasojë e sulmeve të parreshtura jugosllave, e të cilat përfshinin edhe granatimet e qyteteve dhe të fshatrave.³² Këto shifra përfshijnë të zhvendosurit e brendshëm, si dhe ata që u arratisën si refugjatë në Mal të Zi, Shqipëri dhe në Maqedoni. Dëmi në pasuri i cili u shkaktua nga këto sulme ishte po ashtu shumë i madh.

Gjatë kësaj periudhe, diplomatët evropianë i referoheshin shkatërrimit si përdorim i tepruar i forcës ushtarake. Si përgjigje ndaj këtij përshkallëzimi i cili ndodhi gjatë tërë verës, kryetari i Këshillit të Sigurimit të OKB-së në mbarim të gushtit e dha një deklaratë në të cilën thirrte për një ndërprerje të përnjëhershme të zjarrit.³³

Shifrat mbi të zhvendosurit nga UNHCR-ja për muajin gusht 1998, dëshmojnë që brenda Kosovës ishin 260.000 njerëz të zhvendosur (IDP), dhe se 200.000 ishin refugjatë të arratisur jashtë Kosovës. Ajo se a i braktisën të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit e brendshëm shtëpitë e tyre për t'u ikur luftimeve, apo mos ndoshta kjo ishte pasojë e fushatës për dëbimin e tyre, mbetet temë për t'u debatuar.

Më 7 korrik 1998, Zyra e Prokurorit të ICTY-së e shpalli përcaktimin e vet të paralamëruar më parë mbi ekzistimin e një "konflikti të armatosur."³⁴ Për më tepër, e njëjta kumtesë deklaronte qëllimin e ICTY-së për t'i dedikuar mjetet shtesë të nevojshme për zhvillimin e hetimeve.³⁵ Me ekipin e vet të hetuesve të trajnuar dhe me përvojë, hollësitë e sakta të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut dhe të ligjit humanitar mund të dokumentoheshin dhe të klasifikoheshin, dhe kryesit e këtyre shkeljeve mund të ndiqeshin. Mirëpo, nga mesi i shtatorit filloi një kritikë e gjerësisë së angazhimeve të ICTY-së, së bashku me një kritikë publike të faktit që kryeprokurorja Arbour nuk e kishte marrë një rol më të theksuar, duke e përfshirë edhe udhëtimin në Kosovë.³⁶ Në një përgjigje publike, kryeprokurorja sugjerimin e "rolit thellësisht politik" të saj e quajti si "të pabazë."³⁷

Gjatë tërë muajit të shtatorit 1998, vëzhguesit kufitarë të OSBE-së në kufirin e Shqipërisë raportonin për granatimin e fshatrave në rajonet e Prizrenit dhe të Gjakovës. Djegiet e shtëpive ishin ngjarje të rëndomta. Rrjedhat e refugjatëve në rajonin e Shqipërisë Veriore mbeteshin relativisht konstante - herë-herë kufirin e kalonin edhe nga 100 veta në ditë - ndërkaq, në javën e fundit të muajit, u dëbuan edhe 3.500 refugjatë nga Mali i Zi.³⁸

Më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi Rezolutën 1199, e cila thirrte në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së dhe kërkonte armëpushim dhe tërheqje

të forcave jugosllave “të cilat përdoren për të ushtruar dhunë mbi civilë.”³⁹ Tri ditë më vonë, me 26 shtator 1998, u raportua që forcat jugosllave e kishin granatuar fshatin Obri e Epërme, duke i vrarë të paktën 18 gra, fëmijë dhe të moshuar.⁴⁰

Një armëpushim jostabil

Fushata ushtarake e RFJ-së e verës së vitit 1998 në Kosovë, në shumë aspekte ishte e suksesshme. UÇK-ja ishte çrrënjësuar në mënyrë efektive si forcë ushtarake, dhe ishte dëshmuar si e paaftë që t’i mbronte civilët në të gjitha rajonet e kontestuara. Njësitë e ushtrisë jugosllave dhe trupat e oficerëve e bënë atë që disa e konsideronin si një fushatë jokushtetutare ushtarake kundër popullatës së vet civile. Nga aspekti ushtarak, reagimi ndërkombëtar u kufizua në manovrimet ajrore mbi Shqipëri dhe Maqedoni.

Mirëpo më 13 tetor 1998, autoritetet e NATO-s votuan për t’i autorizuar goditjet ajrore po qe se forcat jugosllave të sigurisë nuk do të tërhiqeshin nga Kosova brenda 96 orësh. Pas një periudhe të negociatave intensive, Përfaqësuesi Special i SHBA-ve Riçard Hollbruk, i cili e përfaqësonte Grupin e Kontaktit, dhe presidenti serb Slllobodan Millosheviq e arritën një marrëveshje e cila mbështetej në kërkesat e Rezolutës 1199, dhe e cila u bë qartazi nën kërcënimin e urdhërit për aktivizimin e NATO-s. Ndonëse marrëveshja nuk u botua asnjëherë, pikat e saj kryesore kishin të bënin me redukimin e forcave dhe me vendosjen e vëzhguesve.⁴¹ Kjo marrëveshje u prezentua Këshillit të Sigurimit të OKB-së për miratim, dhe Millosheviqi u pajtua me negociatorët që t’i tërhiqte forcat e sigurisë, që t’u lejonte qasje grupeve humanitare dhe ta pranonte Misionin e OSBE-së të Verifikimit në Kosovë (OSBE-KVM); ishte ky një ekip prej 2.000 vëzhguesish civilë të cilët do ta vëzhgonin zbatimin e marrëveshjes. Kjo përpjekje vëzhgimi do të plotësohej me fluturime të NATO-s. Edhe përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, autoritetet e NATO-s e mbajtën të hapur mundësinë e urdhërit për fillimin e sulmeve, duke i lejuar Komandantit Suprem të Aleancës së NATO-s në Evropë, Gjeneralit amerikan Uesli Klark, të ndërmerre goditje ajrore në rast të mosrespektimit të marrëveshjes nga ana e RFJ-së.⁴²

Më 24 tetor 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi rezolutën 1203, e cila e afirmonte marrëveshjen midis negociatorëve të Grupit të Kontaktit dhe të Qeverisë jugosllave që e parashihte vendosjen e OSBE/MVK-së dhe tërheqjen e trupave jugosllave.⁴³ Nga fundi i tetorit, një numër i madh i trupave jugosllave ishin tërhequr dhe vëzhguesit e MVK-së ishin pozicionuar. Hollbruku deklaroi: “Sipas mendimit

tim, secili njeri i gjallë tani është jashtë rrezikut, e kjo nuk ka mundur të thuhet para disa javësh.” Ishte përcaktuar që numri i trupave jugosllave të reduktohej nga 18.000 në 12.500 veta, dhe që policia speciale të kufizohej në 6.500. Po ashtu, ishte paraparë inicimi i një vargu të hapave drejt autonomisë, duke i përfshirë këtu edhe zgjedhjet që duhej të mbaheshin brenda nëntë muajsh si dhe zhvillimin e forcave policore të shqiptarëve të Kosovës.⁴⁴

Po ashtu, më 24 tetor Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1207, e cila i thirrte autoritetet jugosllave që t’i përmbushnin kërkesat e ICTY-së, duke e përfshirë këtu edhe arrestimin e disa individëve.⁴⁵

Në fillim të tetorit Ministria e Jashtme jugosllave refuzoi që ta njihte jurisdikcionin e ICTY-së për Kosovë, duke pohuar që ky ishte një cenim i sovranitetit kombëtar. Në pajtim me këtë pozicion, autoritetet jugosllave ua refuzuan vizat hetuesve të ICTY-së, dhe u kërcënuan se do ta ndërprisnin bashkëpunimin me Zyren Ndërlidhëse të ICTY-së në Beograd. Kryeprokurorja deklaroi që këto veprime jugosllave ishin “në tërësi të papranueshme.”⁴⁶ Me rezolutën 1207, Këshilli i Sigurimit e hudhi poshtë argumentin jugosllav mbi sovranitetin, dhe e vendosi fuqimisht autoritetin hetimor të ICTY-së.

Dhuna kundër popullatës civile në Kosovë gjatë tërë vitit 1998 u shoqërua edhe nga shkelje të tjera sistematike dhe institucionale të të drejtave qytetare nga ana e autoriteteve serbe dhe të atyre të RFJ-së, duke e krijuar kështu një ambient armiqësor për popullatën civile. Dy shkeljet më të shpeshta ishin gjykimet politike pa proces të duhur, dhe përpjekjet për të shtypur çfarëdo media të lirë dhe të pavarur.

Human Rights Watch raportonte se që nga 3 tetori 1998, 1.242 shqiptarë etnik ishin paditur për “akte terroriste” kundër shtetit.⁴⁷ Gjatë tetorit dhe nëntorit arrestimet ishin të rëndomta. Llogaritej që nga fundi i vitit 1.500 njerëz ishin në arrest. Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) iu refuzua qasja tek shumë të burgosur. Raportet e keqtrajtimit që shkonin nga përdorimi i dhunës e deri tek mungesa e procesit të duhur gjyqësor ishin të panumërta, kurse gjykatës të shumtë u transferuan nga Kosova për në Serbi për t’u marrë me rastet e shumta.⁴⁸

Në këtë periudhë, HLC-ja e dha një raport mbi shkeljet e lirisë së shtypit gjatë vitit 1998. Masat shkonin nga censura e deri te dhuna policore ndaj gazetarëve. Qeveria serbe e bënte një aktivitet gjithëpërfshirës në fusha të caktuara. Për shembull, në tetor, pasi që kërcënimet për veprim nga ana e NATO-s u materializuan, Ministria Serbe e Informatave urdhëroi që të gjitha stacionet të cilat e ritransmetonin Zërin e Amerikës, BBC-në dhe Dojçe Vellen t’i ndërprisnin transmetimet e tyre.⁴⁹

Pas marrëveshjes Millosheviq - Holbruk

Në fillim Serbia e zbatoi marrëveshjen dhe i tërhoqi forcat, ashtu siç edhe u kërkua nga ajo.⁵⁰ Për dallim, duke përfitur nga situata e krijuar rishtaz, UÇK-ja i ripërtëriti veprimet e veta ushtarake. Në fakt, forcat e UÇK-së i morën ato pozita të cilat forcat serbe i kishin braktisur. OKB-ja, si dhe NATO-ja dhe OSBE-ja, ishin të alarmuara nga këto veprime të UÇK-së. Sipas vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së:

Sulmet e fundit nga ana e njësiteve paraushtarake të shqiptarëve të Kosovës e dëshmuar gatishmërinë, aftësinë dhe synimin për të përfitur nga tërheqja e pjesërishme e policisë dhe e formacioneve ushtarake (...) Njoftimet për armë të reja, municion dhe pajisje, e tregojnë se aftësia e këtyre njësiteve për ta mbrojtur vetveten është ende mjaft e lartë. "Këto janë zhvillime shqetësuese".⁵¹

Në qëndrimin e publikuar më 8 dhjetor, NATO-ja e theksoi se që të dyja palët "edhe autoritetet e Beogradit, dhe edhe elementet e armatosura të Kosovës, nuk iu janë përmbajtur kërkesave të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1160, 1199 dhe 1203. Kërkojmë nga grupet e armatosura në Kosovë që t'i ndërpresin aksionet provokative, dhe po ashtu kërkojmë nga autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë që ta reduktojnë, si numrin, ashtu edhe praninë e dukshme të policisë speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë, dhe që të heqin dorë nga sjelljet frikësuese."⁵² Në të njëjtën kohë, UÇK-ja po përpiquej që ta forconte ndikimin e vet politik përmes kërcënimeve ndaj përfaqësuesve politikë të LDK-së në zonat rurale. Ajo kidnapoi, e në disa raste edhe ekzekutoi, si civilë serbë ashtu edhe shqiptarë.

Gjendja u keqësua në dhjetor. Me 14 dhjetor, rreth 100 ushtarë të UÇK-së që po bartnin armë u zunë në një pritë të rregullt të ushtrisë serbe në kufirin me Shqipërinë: në këtë rast u vranë 36 prej tyre. Në të njëjtën natë, dy persona të maskuar hynë në një kafene në Pejë dhe vranë 6 të rinj serbë. Për këtë ngjarje Misioni Vëzhgues në Kosovë nuk ndërmorri hetime fare. Më 17 dhjetor, zëvendëskryetari serb i komunës së Fushë Kosovës u kidnapua dhe me vonë u gjet i vdekur. Përgjigja ushtarake serbe pasoi disa ditë me vonë. Në dhjetor vëzhguesit e OSBE-së në kufi filluan të njoftojnë për rritjen e tensioneve përgjatë kufirit. Sulmet e RFJ-së ndaj fshatrave dhe depërtimet kufitare sërish u bënë dukuri e zakonshme.⁵³ Situatat e konfliktit dhe dimri që po fillonte krijuan kushte shumë të vështira për fshatarët e zhvendosur.⁵⁴

Në bazë të raportit të 24 dhjetorit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së:

Njësitë paraushtarake të shqiptarëve të Kosovës përfituan nga situata e pushimit të luftimeve për ta rivendosur kontrollin e tyre mbi shumë fshatra të Kosovës, si dhe në disa zona në afërsi të

qendrave urbane dhe të rrugëve kryesore. Këto aksione (...) pushtetit serb i kanë shërbyer vetëm për ta theksuar atë se nëse Misioni Verifikues për Kosovën nuk mund t'i kontrollojë këto njësi, atëherë Qeveria e tyre ka mundësi ta bëjë këtë.

Kështu që, tash e kemi:

Një cikël të ri të armiqësive të mëdha dhe, sipas disa njoftimeve, numri i forcave jugosllave në Kosovë mund të jetë më i madh nga ai që parashihet sipas marrëveshjes.⁵⁵

OKB-ja e bënte të ditur po ashtu se ndërmjet 1.500 e 2.000 shqiptarë janë burgosur që nga marrëveshja e tetorit, dhe se vlerësohej që rreth 150 civilë janë kidnapuar nga UÇK-ja.⁵⁶ Duke bërë shkelje të qartë të marrëveshjes së tetorit, ushtria jugosllave i kishte pozicionuar 24 njësi me madhësi batalioni, me mbi 12.000 trupa përgjatë kufirit me Kosovën. Në fund të muajit kjo ushtri e urdhëroi futjen e tyre brenda Kosovës, përgjatë rrugës së Podujevës, duke i goditur përsëri fshatrat nga tanket dhe nga auto-blindat. Autoritetet e Serbisë po ashtu po e sfidonin vendosmërinë e Bashkësisë Ndërkombëtare për hetime të pavarura, dhe në disa raste ato e kishin penguar punën e ekspertëve të mjekësisë ligjore.⁵⁷

Ndërkohë që besueshmëria e angazhimeve të Millosheviqit për zbatimin e marrëveshjes së tetorit me siguri se mund të vihet në pikëpyetje, kundërthënia evidente në mes të garancave të supozuara të Hollbrukut dhe të aksioneve të UÇK-së asnjëherë nuk i ka ofruar bazë të mjaftueshme RFJ-së për të dyshuar në sinqeritetin e “Perëndimit.” Aksionet e UÇK-së gjithsesi ndikuan në shtimin e presionit të brendshëm për siguri në Beograd për t'i ripërtëritur veprimet kundër kryengritësve me çdo kusht.⁵⁸

Tashmë po shihej qartë që, megjithë suksesin fillestar të cilin e patën marrëveshja Millosheviq-Holbruk dhe prania e Misionit Vëzhgues për mbrojtjen e e popullatës civile, Misioni Vëzhgues për Kosovën nuk ishte i aftë edhe më tutje që ta zgjidhte çështjen e domosdosë së paqeruajtjes. Në bazë të vëzhgimeve të rajonit nga ajri, NATO-ja ishte e vetëdijshme për shkeljet e armëpushimit gjatë kësaj periudhe.

Gjatë 11 ditëve të para të janarit 1999, në luftimet ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe u vranë 21 njerëz. Ushtria serbe hyri në Kosovë me një numër të madh ushtarësh. Me ndihmën e njësiteve speciale policore, kjo ushtri i kishte krijuar të paktën tri zona të mbyllura përgjatë rrugës kryesore Veri-Jug, duke e përdorur artilerinë dhe granatimet nga tanket, ashtu që ta detyronte popullatën të largohet nga fshatrat. Megjithkëtë, për dallim nga vera e vitit 1998, gratë, fëmijët dhe pleqtë e popullatës e cila u zhvendos tash, nuk u lejuan të largohen nga këto zona të mbyllura. Në një zonë të tillë të mbyllur afër Vushtrrisë nuk pati fare përlëshje të armatosura, apo të paktën nuk kishte

çfarëdo qoftë të dhënash për veprimet e UÇK-së. Këto taktika të “zonave të mbyllura” nga disa analistë u përdorën si dëshmi nga të cilat shihej një plan i avancuar për spastrim etnik. Veprimet e ushtrisë jugosllave, pohojnë me tutje analistët, ishin pjesë e strategjisë për ta siguruar çdo zonë dhe, më vonë, në një moment të caktuar, për t’i zbrazur të gjitha këto zona nga popullata civile shqiptare, duke e penguar kështu UÇK-në që të formonte ndërlihdje të “zonave të çliruara” në Kosovë.

Në fundin e janarit 1999, forcat serbe vunë pozicione të përhershme të tankeve dhe të automjeteve të blinduara përgjatë kufirit të Kosovës me Maqedoninë. Qëllimi i tyre kryesor strategjik ishte bllokimi i kufirit me Maqedoninë, dhe pas pak kohe edhe i atij me Shqipërinë, ashtu që të pengohej ndonjë sulm tokësor i NATO-s.⁵⁹ Pas kësaj, njësitë e vendosura përgjatë kufirit me Shqipërinë u ndihmonin njësiteve speciale të policisë për t’i ndërprerë shtigjet e furnizimit të UÇK-së. Grupe të shumta paramilitare nga Serbia ishin futur në Kosovë dhe ishin vendosur në kazermat e Ministrisë së Brendshme në afërsi të Pejës, Podujevës, dhe të Shtërpces. Po ashtu, kishte njoftime për dërgesa plotësuese të armëve të lehta në fshtarat serbe të këtyre rajoneve, si rritje e aftësive të tyre mbrojtëse në kuadrin e Ligjit të Mbrojtjes Territoriale të Jugosllavisë.⁶⁰ Nuk ka dyshim fare që secili nga këto veprime ishte shkelje e Marrëveshjes se Tetorit.⁶¹

Nga data 12 e deri me 15 janar 1999, forcat serbe sollën armatime të rënda në komunën e Shtimes, duke i përforcuar kështu pozitat e tyre të përhershme.⁶² Me 15 janar 1999, forcat jugosllave e sulmuan fshatin Reçak të kësaj komune; këtu ato i ekzekutuan 45 shqiptarë. Me 16 Janar 1999, MVK i OSBE-së arriti për t’i bërë hetimet në vendin ku kishte ndodhur masakrimi. Ekipi erdhi në përfundim që kishte gjetur “të dhëna për burgosje arbitrare, vrasje pa procedurë ligjore, dhe masakrime të civilëve të paarmatosur.”⁶³ Udhëheqësi i MVK i OSBE-së, Ambasadori Uilliam Uoker, ishte në vendin e ngjarjes së bashku me ekipin e vet, për t’u bindur drejtpërsëdrejti për këto të dhëna. Menjëherë pas kësaj, ai e dënoi publikisht masakrën, duke i bërë thirrje Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë që ta hetonte këtë veprim mizor, si dhe kërkoi që autoritetet serbe t’i japin emrat e oficerëve të cilët e kishin udhëhequr këtë aksion. Autoritetet serbe filluan ta mohonin se kanë vrarë civilë, duke e theksuar që ky ishte thjesht një aksion kundër UÇK-së.⁶⁴ Faktori vendimtar i cili ndikoi në përgjigjen e shpejtë ndërkombëtare lidhur me këtë incident, ishte shpejtësia me të cilën ekipi mbikëqyrës i Misionit Vëzhgues të OSBE-së ia arriti ta dokumentojë këtë ngjarje.

Më 18 janar 1999, Kryeprokurorja e ICTY-së nuk u lejua të hynte Kosovë në vendkalimin kufitar me Maqedoninë. Komandanti i NATO-s, Gjenerali Klark, kërkoi

menjëherë nga autoritetet serbe që Kryeprokurores t'i mundësohej hyrja në Kosovë. Në të njëjtën kohë, Kryeprokuroria ia kishte theksuar Ministrisë serbe të Drejtësisë garancat që Zyrja e saj nuk do ta interpretonte lejen për të hyrë në Kosovë “si pranim nga ana e RFJ-së që ICTY-ja e ka jurisdiksionin mbi këtë çështje”.⁶⁵ Edhe pëkundër këtyre përpjekjeve, vizita nuk u lejua, kështu që Kryeprokuroria u desht të kthehej në Hagë.⁶⁶

Disa ditë më vonë, Qeveria e RFJ-së e shpalli Ambasadorin Walker si persona non grata. Kryetari i Këshillit të Sigurimit, si dhe ai i Treshit Ministror të OSBE-së bënë protesta të menjëhershme kundër këtij vendimi, duke e dënuar vendosmërisht si masakrën e Reçakut, ashtu edhe refuzimin e Serbisë për ta lejuar qasjen e ICTY-së.⁶⁷ Që të dyja këto organizata, bënë thirrje për ndërprerjen e menjëhershme të armiqësive dhe për dialog.⁶⁸ Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, shpallja e Walker-it si persona non grata u pezullua.⁶⁹

Pas kësaj ftese për dialog, anëtarët e Grupit të Kontaktit e organizuan fillimin e bisedimeve paqësore në Rambuje të Francës, duke filluar që nga 6 shkurti. Për pjesëmarrje në këto bisedime u ftuan si udhëheqësit serbë e shqiptarë të Kosovës (duke i përfshirë këtu edhe ata të UÇK-së, edhe të LDK-së), ashtu edhe përfaqësuesit e RFJ-së. Thelbi i planit të Grupit të Kontaktit e përfshinte çarmatosjen e UÇK-së dhe tërheqjen e plotë të forcave serbe, duke e ofruar mbikëqyrjen nga “një forcë adekuate” e NATO-s e cila do të përbëhej nga 30.000 trupa.⁷⁰ Plani e parashihte rivendosjen e autonomisë së Kosovës dhe të institucioneve të saj ta pavarura, mirëpo e linte të hapur çështjen e statusit të saj të ardhshëm (d.m.th. të pavarësisë), për ta rishqyrtuar pas tri vitesh. Në këtë proces, i cili do të shqyrtohet më gjerësisht në kapitullin vijues, Grupi i Kontaktit në fund nuk ia arriti ta hartonte një plan me të cilin do të pajtoheshin që të dyja palët, edhe RFJ-ja edhe negociatorët kosovarë. Rundi i dytë i bisedimeve u mbajt në Paris, nga 15 e deri më 19 mars. Më 18 mars, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës e nënshkroi propozimin e ofruar; ndërkaq, delegacioni i RFJ-së/Serbisë refuzoi që ta nënshkruante atë. Në këtë mënyrë, negociatat dështuan.

Më 19 Mars 1999, kryesuesi i radhës i OSBE-së, Ministri i Jashtëm i Norvegjisë Knut Vollebek, vendosi që Misionin Vëzhgues të OSBE-së ta tërhiqte nga Kosova. Duke iu referuar gjendjes së përkeqësuar të sigurisë, Ministri i Jashtëm Vollebek deklaroi se “si kryesues i radhës i OSBE-së, dhe si përgjegjës për rreth 1.400 verifikues të vendosur në vende të shumta në Kosovë, në momentin e pikërisht nuk e kam në dispozicion ndonjë zgjidhje tjetër pos tërheqjes së personelit të OSBE-së.” Autoritetet e RFJ-së, vëzhguesit i përcollën deri në kufi.

UNHCR-ja e vlerësonte se në Kosovë midis 150.000 e 200.000 refugjatëve të ri ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre që nga janari e deri në mesin e marsit 1999. Më 15 mars, në kulmin e bisedimeve të Parisit, ushtria serbe hyri në rajonin e Podujevës me njësi të shumta të blinduara. Ky veprim i krijoi edhe 25.000 deri në 40.000 refugjatë të ri.

Është me rëndësi të theksohet se gjatë tërë periudhës në të cilën zhvillohej lufta e brendshme, që nga marsi i vitit 1998 e deri në marsin e vitit 1999, periudhë kjo e cila i parapriu fushatës së bombardimeve, Komisioni ka patur vështirësi të konsiderueshme në mbledhjen e të dhënave të sakta për shkallën e veprimeve vdekjeprurëse që u ndërmorën kundër popullatës civile në Kosovë. Përcaktimi i saktë i përmasës së shkeljeve, dhe në veçanti i numrit të vrasjeve, ishte i vështirë, nëse jo edhe i pamundur fare, meqë ishte e pamundur të siguroheshin të dhëna të detajuara dhe të verifikuara. Shumë grupe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në një mënyrë konsistente e shprehnin nevojën për kritere me të rrepta gjatë mbledhjes dhe paraqitjes së të dhënave. Siç u tha më lart, UNHCR-ja njoftonte se 300 njerëz ishin vrarë ndërmjet shkurtit dhe majit 1998, ndërkohë që Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut e theksonte që 750 njerëz ishin vrarë ndërmjet majit dhe gushtit 1998. Mirëpo asnjëri nga këto grupe të të dhënave nuk e saktësonte se sa nga të vrarët ishin pjesëtarë të UÇK-së dhe sa ishin civilë. Komisioni e pati të pamundur t'i identifikonte të dhënat e sakta për vrasjet ndërmjet shtatorit 1998 dhe marsit 1999, me gjithë vëzhgimin përmbajtësor të OSBE-së, e cila ishte e pranishme pothuaj gjatë tërë kësaj kohe. Sidoqoftë, nëse nuk e marrim parasysh masakrën e tmerrshme të Reçakut, ka arsye të supozohet se gjatë kohës sa ishin të pranishëm vëzhguesit e Misionit Verifikues për Kosovën, numri i civilëve të vrarë ka qenë shumë më i vogël sesa gjatë muajve të mëparshëm.

Kriza tashmë kishte lëshuar rrënjë për një kohë të gjatë. Dukej pothuaj e mynxyrshme që heqja e autonomisë së Kosovës më 1990 kishte qenë fillimi i vorbullës ogurzezë të veprimit e të kundërveprimit, të dhunës e të rezistencës, të forcimit të kokëfortësisë së Serbisë e të shtimit të armatimit tek shqiptarët, dhe se të gjitha këto ishin duke shpурë në një luftë në të cilën gjithsesi do të përfshihej edhe Bashkësia Ndërkombëtare. Të ballafaquar me strategjinë e dhunës së skajshme të Millosheviqit, të moderuarit e Kosovës që ishin të mbledhur rreth Rugovës nuk patën gjasa për sukses. Kur u kup-tua kjo, elemente me militante e morën iniciativën përmes rezistencës së armatosur, dhe kjo vetëm që e shtoi dhunën e RFJ-së kundër popullatës civile. Diplomacia perëndimore dështoi në shuarjen e konfliktit i cili në fillimin e vitit 1999 ishte shndërruar në një luftë të përgjithshme qytetare. Kjo luftë qytetare ishte e paracaktuar që të vazhdonte edhe më tutje, dhe madje edhe që të intensifikohej edhe me tepër,

mirëpo kjo e tëra u mbizotërua nga përmasat e mëdha të luftës ndërkombëtare të NATO-s kundër Jugosllavisë.

3. Shpërthimi i luftës ndërkombëtare

mars 1998 – qershor 1999

Më 22 dhe 23 mars, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Anan, kërkoi që forcat e armatosura jugosllave ta ndërpresin menjëherë ofensivën e tyre në Kosovë. Më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Dr. Javier Solana, në letrën dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, e njoftonte atë për një varg incidentesh të cilat e shprehnin një përkeqësim të shpejtë të gjendjes në Kosovë. Ai e theksonte në veçanti shtimin dramatik të veprimeve ushtarake të RFJ-së pas largimit të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s po ashtu e tërhiqte vërejtjen për katastrofën humanitare e cila ishte në ndodhje e sipër, si pasojë e përdorimit të tepruar të forcës nga RFJ-ja. Në po të njëjtën ditë, Qeveria e Jugosllavisë e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme. Më 24 mars, në orën 20 sipas kohës lokale, aeroplanët e NATO-s e filluan fushatën e bombardimeve të Jugosllavisë.

Presidenti Clinton i shpjegoi qëllimet e fushatës së NATO-s në fjalimin e tij televiziv me 24 mars: në këtë fjalim ai e dëshmoi seriozitetin e reagimit të NATO-s kundër agresionit dhe për ndaljen e sulmeve të shfrenuara të Millosheviqit në Kosovë, si dhe për t'i dëmtuar seriozisht kapacitetet ushtarake të Jugosllavisë për të bërë luftë në të ardhmen.¹ Udhëheqësit evropianë u shprehën pakashumë në të njëjtën frymë, mirëpo ata e theksuan me fuqishëm që ndërhyrja e NATO-s ishte e domosdoshme për ta penguar katastrofën humanitare. Klintoni e bëri po ashtu të qartë që qeveria e SHBA-ve nuk e kishte në plan futjen e trupave tokësore në zhvillimin e luftës. Qeveritë e tjera të NATO-s e kishin po të njëjtin qëndrim. Ndërkaq, Komiteti i zgjedhur i Dhomës së Komunave Britanike e theksonte që “çështja se a vepronte NATO-ja para se gjithash për ta mbrojtur kredibilitetin e vet apo mos si qëllim parësor e kishte shmangien e katastrofës humanitare (...) nuk ndihmonte në shpjegimin publik të aksionit të NATO-s, por më tepër e tregonte që NATO-ja nuk e kishte të qartë se çfarë synonte të bënte.² Qëllimet e NATO-s u sqaruan në mënyrë edhe më të detajuar më 12 prill, dhe këto qëllime u përkrahën nga kryetarët e shteteve anëtare të NATO-s, në mbledhjen e mbajtur me 23 prill në Washington.

Supozimi themelor i NATO-s ishte që një fushatë relativisht e shkurtër e bombardimeve do ta bindte Millosheviqin të kthehej për ta nënshkruar marrëveshjen e

Rambujesë.³ NATO-ja e kishte nënçmuar po ashtu rrezikun e qartë që qeveria e Beogradit, në një apo në ndonjë tjetër mënyrë, do të përgjigjej duke i sulmuar shqiptarët e Kosovës. Përkundër të gjitha të dhënave nga shërbimet e inteligjencës perëndimore, nuk ekzistonte ndonjë plan i qartë për refugjatët e mundshëm.

Komisioni nuk ka patur qasje në planet e qeverisë së Beogradit lidhur me qëllimet e saj të luftës, mirëpo mund të supozohet se aty përfshiheshin: mbajtja e NATO-s jashtë RFJ-së; ruajtja e kontrollit mbi Kosovën; shtypja e UÇK-së, dhe me në fund përdorimi i luftës si pretekst për dëbimin e të tërë popullatës shqiptare të Kosovës, përgjithmonë, ose të paktën si një kartë me të cilën do të luante në negociatat e ardhshme. Shihet qartë, po ashtu, që Millosheviqi, ka llogaritur në përçarjen e aleancës së NATO-s, dhe se ka shpresuar në më tepër përkrahje nga Rusia.

Natyrisht që superioriteti ushtarak i NATO-s ishte i jashtëzakonshëm; tekefundit, NATO-ja i kishte aftësitë më të sofistikuar ushtarake në botë. Sidoqoftë, Ushtria Jugosllave ishte e organizuar dhe e ushtruar mirë për ta penguar një superfuqi ushtarake. Faktori kyq ishte mbrojtja kundërajrore, dhe ushtria e RFJ-së i kishte studiuar me kujdes përvojat irakiane nga lufta e vitit 1991. Edhe pse mbrojtja ajrore e RFJ-së ishte e vjetëruar dhe joefikase, ajo megjithatë mjaftoi për t'i mbajtur forcat ajrore të NATO-s në lartësi mbi 15.000 fita (përafërsisht 5.000 metra), duke i zvogëluar në këtë mënyrë dukshëm mundësitë e NATO-s për t'i goditur forcat ushtarake të RFJ-së.⁴

Në fillimin e fushatës së bombardimeve të NATO-s, forcat ushtarake të Jugosllavisë e kishin një përparësi të qartë ndaj forcave të UÇK-së, me 40.000 trupa luftarake, të cilave iu ishin të bashkangjitura policia me grupet e posaçme të forcave paramilitare, e të cilat i kishin 300 tanke, si dhe njësi të tjera të artillerisë tokësore dhe kundërajrore të vendosura në të tërë Kosovën dhe përgjatë kufijve të saj. Ndërkaq, UÇK-ja para mesit të marsit 1999, ende nuk ishte forcë me një organizim të centralizuar. Rezistenca shqiptare në Kosovë përbëhej nga 8.000-10.000 pjesëtarë me armatim të lehtë të cilët e kishin një stërvitje të paktë, dhe nga 5.000-8.000 pjesëtarë të tjerë të cilët ishin në stërvitje e sipër në Shqipërinë Veriore. Këta pjesëtarë u përkisnin grupeve të ndryshme të rezistencës së armatosur. Shumica e grupeve i kishin disa lidhje me UÇK-në, por ata e ruanin edhe identitetin e tyre. Vetëm në këtë periudhë, përballë ofensivës së gjerë të RFJ-së, UÇK-ja filloi ta ndërtonte një strukturë të komandës së bashkuar, nën drejtimin e Agim Çekut, një ish-oficer i ushtrisë kroate.⁵

Nga pikëpamja ushtarake, UÇK-ja ishte ende e papërgatitur, dhe ajo ende nuk ishte në gjendje që ta pranonte ndonjë konfrontim të një shkalle më të gjerë. Strategjia dhe ideologjia e saj ishte për "ta krijuar Vietnamin serb në Kosovë."⁶ UÇK-ja shpresonte

që zgjatja e luftës molisë kundër RFJ-së do t'i shkaktonte regjimit të Beogradit humbje politike të pakompensueshme. Përparësia e vetme të cilën UÇK-ja e kishte në krahasim me RFJ-në ishte, natyrisht, përkrahja që asaj i jipej nga NATO-ja.

Madje edhe po të kishte ndonjë gatishmëri të qeverive të vendeve anëtare të NATO-s për dërgimin e trupave tokësore, në marsin e vitit 1999 NATO-ja ishte me muaj të tërë larg nga ajo që ta krijonte çfarëdo qoftë mundësie për fillimin e ndonjë sulmi tokësor.⁷ Gjatë kësaj kohe NATO-ja në rajon i kishte 8.000 trupa në Maqedoni, si dhe 27.000 trupa të Forcës Stabilizuese të Bosnje e Hercegovinës (SFOR). Trupat në Maqedoni ishin atje për t'i dhënë mbështetje ndihmëse MVK-së të OSBE-së, të autorizuar me marrëveshjen e tetorit. Ndërkaq, trupat e SFOR-it nuk e kishin autorizimin për t'u angazhuar jashtë Bosnës e Hercegovinës.

Përbërja dhe mënyra e vendosjes së forcave të posaçme të Ushtrisë Jugosllave në Kosovë e qartësonte atë që muajt e parë të vitit 1999 ishin shfrytëzuar për ta ngritur aftësinë e mbrojtjes territoriale në Kosovë deri në një shkallë e cila do të ishte e mjaftueshme për ta penguar kërcënimin e ndërhyrjes tokësore të NATO-s. Për këtë qëllim, Ushtria Jugosllave përfitoi mjaft nga koha e negociatave në Rambuje dhe në Paris.

“Spastrimi” i Kosovës

Lufta mori flakë me aq vrull sa që kjo e befasoi dhe e tronditi të tërë botën. Forcat ushtarake dhe paramilitare të RFJ-së e nisën një fushatë të egër kundër popullatës shqiptare të Kosovës. Qeveria e RFJ-së gjatë konfliktit e mbronte qëndrimin se po ndërmirte veprime ushtarake kundër UÇK-së, dhe të gjitha fajet për shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti ato për zhvendosjen e dhunshme të shqiptarëve të Kosovës, ia mvishte NATO-s dhe UÇK-së. Por në fakt, secila organizatë ndërkombëtare, qoftë qeveritare apo joqeveritare, e cila është marrë me studimin e situatës së krijuar atëbotë e konstatonte të kundërtën. Është një bindje e përgjithshme që forcat e RFJ-së e zbatonin një fushatë të parapërgatitur për t'i terrorizuar dhe dëbuar shqiptarët kosovarë.⁸ Kjo fushatë më së shpeshti është cilësuar si fushatë e “spastrimit etnik,” dhe e kishte për qëllim që t'i dëbonte jashtë Kosovës shumicën, nëse jo edhe të gjithë shqiptarët kosovarë, dhe që t'i shkatërronte themelet e shoqërisë së tyre si dhe ta pengonte kthimin e tyre.⁹

Lidhur me këtë aspekt, dy çështje ishin temë e debateve të shpeshta. E para, ajo se a

ekzistonte një plan ushtarak i RFJ-së (i ashtuquajtur “Operacioni Patkoi”) për dëbimin e popullatës shqiptare. Janë zhvilluar debate intensive nëse ka ekzistuar një plan i tillë apo jo, dhe nëse po, çfarë rëndësie ka patur. Kjo çështje është ende e hapur, por është shumë e qartë që janë bërë përpjekje të planifikuara dhe të organizuara mirë për dëbimin e një pjese të madhe të popullatës shqiptare të Kosovës, dhe se një operacion i tillë dhe aq masiv nuk ka mundur të bëhet pa ndonjë plan dhe përgatitje para-prake. Çështja e dytë e lidhur me këtë qëndron në pohimet që ishte fushata ajrore e NATO-s ajo e cila, në fakt, e nxiti këtë fushatë të RFJ-së, dhe se, rrjedhimisht, pikërisht NATO-ja e ka shkaktuar katastrofën humanitare, në vend që ta parandalonte atë.

Pohimi i fundit është shumë i vështirë për t’u dëshmuar. Ne nuk mund ta dimë se çfarë do të kishte ndodhur sikur NATO-ja të mos i fillonte bombardimet. Mirëpo, është e sigurt që kurrsesi nuk mund të jetë e vërtetë që NATO-ja i ka nxitur sulmet mbi popullatën civile të Kosovës – përgjegjësia për këtë fushatë në tërësi i bie qeverisë në Beograd. Sidoqoftë, ka të ngjarë që fushata e bombardimeve si dhe largimi i vëzhguesve të paarmatosur e ka krijuar një rrethanë të brendshme në të cilën një operacion i tillë ishte i realizueshëm. Forcat e RFJ-së nuk mund ta godisnin NATO-n, por mund t’i godisnin shqiptarët të cilët e kishin kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e NATO-s. Në këtë mënyrë ata u hakmerreshin shqiptarëve, dhe kjo ishte një strategji e planifikuar e tyre.

Mirëpo, pikërisht kjo fushatë ishte ndër gabimet me të mëdha të bëra nga Millosheviqi. Udhëheqësit e RFJ-së ndoshta kanë menduar që fluksi i refugjatëve i cili do shkaktohej në këtë mënyrë do ta krijonte një krizë politike në vendet fqinje, ose që qeveritë evropiane do t’i humbnin nervat nga qindra mijëra refugjatët e rinj të cilët do të trokitnin në dyert e tyre. Ata ndoshta edhe kanë menduar që do të mund ta krijojnë një fait accompli – në bazë të të cilit në negociatat e mëvonshme me ndonjë marrëveshje do të mundësohej që një pjesë e shqiptarëve kosovarë të mbetej jashtë Kosovës. Por, çfarëdo llogaritjesh që t’i kenë bërë, ato kanë qenë llogari për së tepërmi të gabuara. Qeveria jugosllave, e izoluar nga Bashkësia Ndërkombëtare, kishte gabuar në parashikimin e reagimit ndërkombëtar ndaj kësaj zhvendosjeje masive dhe të dhunshme të popullatës; ajo nuk e kuptoi që në këtë mënyrë ajo ishte duke e rikthyer kujtesën mbi ditët më të zymta të historisë evropiane. Me këto veprime ajo i ofroi NATO-s argumentin me të fuqishëm për ta vazhduar luftën me edhe më tepër vendosmëri, dhe e mundësoi që të gjitha qeveritë e Aleancës të angazhohen edhe më shumë për ta detyruar qeverinë e RFJ-së që të dorëzohet. Qëllimi i NATO-s, po ashtu, i përshtatej gjendjes së krijuar rishtaz: premtimi që iu dha, dhe i cili shumë herë iu përsërit refugjatëve, ishte “ne do t’u kthejmë prapa.” Dhe ky ishte një premtim

konkret, të cilin NATO-ja nuk do ta shkelte kurrë. Drama e refugjatëve e pati ndikimin më të fuqishëm në opinionin publik, dhe jo vetëm në Evropë. Pa këto veprime, nuk do të mund të shpresohej që fushata e NATO-s do të vazhdonte, qoftë edhe 78 ditë, sa edhe vazhdoi.

Në të njëjtën kohë, vendet anëtare të NATO-s po ashtu bënë gabim serioz kur nuk e parashikuan që bombardimet do të mund të shkaktonin sulme të vrazhda ndaj popullatës shqiptare. Raporti i Dhomës së Komunave Britanike bën fjalë për këtë gabim serioz të NATO-s, dhe Komisioni pajtohet me këtë raport.¹⁰

Tmerri dhe shkatërrimet të cilat popullata shqiptare e Kosovës i përjetoi ndërmjet marsit dhe qershorit 1999, janë të dokumentuara detajisht nga organizata të shumta. Në Aneksin 1 të këtij raporti është bërë përpjekje që të të gjitha të dhënat ekzistuese të përfshihen në një analizë të vetme. Aneksi 1 e përfshin, po ashtu, edhe një numër vërejtjesh metodologjike për të cilat shpresojmë që do ta lehtësojnë mbledhjen e saktë të të dhënave në krizat e ardhshme.¹¹

Një përmbledhje e shkurtër, megjithatë, e ka një rëndësi thelbësore. Gjatë zhvillimit të fushatës ajrore të NATO-s, përafërsisht 863.000 civilë kërkuan ose u detyruan me forcë të arratiseshin si refugjatë jashtë Kosovës. Ndërkaq, vlerësohet që 590.000 të tjerë ishin të zhvendosur të brendshëm. Këto të dhëna e dëshmojnë që numri i përgjithshëm i shqiptarëve kosovarë që u detyruan të zhvendosen jashta shtëpive të tyre ishte mbi 90%.

Shumica e shqiptarëve të Kosovës të cilët u detyruan të dalin jashtë shtëpive të tyre, u ngarkuan mëpastaj nëpër autobusa dhe u bartën deri në kufirin me Maqedoninë; në rastet e tjera banorët lejoheshin t'i merrnin veturat dhe traktorët e tyre, dhe urdhëroheshin të shkonin rrugës së caktuar, e cila shpiente për në kufi. Shumë banorë të komunave në pjesën lindore të hekurudhës Veri-Jug detyroheshin të ecnin këmbë deri në stacionet e trenit, prej nga mëpastaj me tren barteshin deri në kufirin me Maqedoninë. Planifikimi dhe koordinimi substancial i këtyre deportimeve masive dëshmohet nga fakti që para marsit linjë të rregullt me tren në relacionin Prishtinë - kufiri me Maqedoninë, kishte vetëm dy herë në ditë, dhe këta ishin trena që rëndom i kishin vetëm nga tre vagonë. Gjatë deportimeve u shtuan dy deri në tre trena në ditë, dhe që të gjithë këta i kishin nga 13 deri në 20 vagonë. Në njërin nga raportet flitet për një tren me 28 vagonë të stërmbushur me njerëz, të cilët e kishin lënë Prishtinën dhe ishin nisur për në Maqedoni.¹²

Informatat nga rrëfimet e refugjatëve tregojnë se faktikisht të gjithë këta të zhvendosur nga shtëpitë e tyre, ishin dëbuar me forcë nga pjesëtarët e forcave të armatosura

jugosllave, policia serbe ose njësitet paramilitare, sipas një skenari që rëndom fillonte me granatime dhe mëpastaj vazhdonte me keqtrajtime, rrëmbime dhe vrasje. Përpos kësaj, Asociacioni Amerikan për Përparimin e Shkencës (AAAS), duke e studiuar ndërvarsinë e informatave për largimet e refugjatëve me raportet e bombardimeve të NATO-s, e dëshmoi qartë që fluksi i refugjatëve nuk ishte në përputhje as me bombardimet e NATO-s dhe as me çështjen e vrasjeve masive; studimi i AAAS-së shpie në përfundimin se të dhënat faktike nuk janë në pajtim me mundësinë që refugjatët të jenë “larguar,” por, përkundrazi, me atë që ky ishte dëbim i organizuar.

Një debat tjetër, i cili vazhdon edhe sot e kësaj dite, ka të bëjë me numrin e saktë të vrasjeve gjatë kësaj periudhe. Për shembull, deri më sot, në ekshumimet e bëra nga ICTY-ja në Kosovë, janë gjetur 2.788 trupa në 345 varreza masive.¹³ Megjithatë, në këtë vlerësim të ekspertëve të mjekësisë ligjore nuk janë të përfshira edhe rastet e vrasjeve individuale. Konstatimet që janë përfshirë në Aneksin 1, tregojnë se numri i të vrarëve është rreth 10.000, shumica dërrmuese e të cilëve janë shqiptarë të Kosovës të vrarë nga forcat e RFJ-së.

Në listat e të zhdukurve, mëtutje, janë të evidentuar 3.000 persona. Në nëntorin e vitit 1999, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) e vlerësonte që në burgjet serbe ndodhen rreth 1.700 veta. Konsiderohet se të zhdukurit e tjerë janë të vrarë. Qendra e të Drejtës Humanitare thotë se numri i të zhdukurve është në mes 2.000 dhe 2.150, dhe se shumica e tyre janë të vrarë.¹⁴

Plaçkitjet, grabitjet dhe rrëmbimet ishin po ashtu një dukuri shumë e shpeshtë. OSBE-ja ka dokumentuar po ashtu edhe raste të shumta të torturës. Që të gjitha këto sulme kundër popullatës shoqëroheshin me shkatërrime masive fizike.

Një sukses i rëndësishëm në lehtësimin e pasojave për viktimat e këtij konflikti të armatosur ishte njohja e padiskutueshme e konsekuencave penale të ndryshme për krimet më të rënda të bëra gjatë konfliktit ndaj grave dhe burrave. Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare e parasheh që dhunimi, robëria seksuale, prostitucioni i dhunshëm, shtatzënia e dhunshme, sterilizimi i dhunshëm si dhe format e tjera të dhunës seksuale, janë krime lufte sa herë që të kryhen në kontekstin e konfliktit të armatosur. Gjatë tre muajve të shkatërrimit në Kosovë, dhunimi ishte mjeti më i shpeshtë i terrorit politik seksual. Megjithatë, është e vështirë që dhunimi të saktësohet në aspektin statistikor, për shkak të ngurrimeve dhe pengesave shoqërore që hasen gjatë raportimit të tij. Sidoqoftë, krahas të dhënave të përmendura në Aneksin 1, Komisioni ka marrë raporte të shumta për dhunime të femrave shqiptare të Kosovës gjatë kohës së krizës nga ana e pjestarëve të forcave të RFJ-së. Këto dhunime dëshmo-

hen, po ashtu, edhe nga shtimi dramatik i kërkesave për aborte pas përfundimit të luftës, si dhe nga problemet tejet të rënda të fëmijëve të padëshiruar në vitin vijues.

Të arriturat e fushatës ajrore të NATO-s

Fushata ajrore e NATO-s kundër Jugosllavisë u zhvillua nga 24 marsi 1999 deri më 10 qershor 1999. Gjatë kësaj fushate aeroplanët nga 13 shtete anëtare të NATO-s i bënë 38.400 fluturime, nga të cilat në 10.484 fluturime u bënë bombardime, dhe në të cilat nga ajri u hodhën gjithsej 26.614 projektele.¹⁵

Kjo fushatë ishte një operacion tejet kompleks, i cili pandërprerë evoluonte. Vendimmarrja gjatë fushatës ishte nën ndikimin e mikromenaxhimit dhe vlerësimeve politike të disa prej qeverive të shteteve kyqe anëtare të NATO-s. Nevoja për konsensus në mesin e 19 shteteve anëtare të Aleancës, duke i përfshirë këtu edhe tri shtetet që në ndërkohë u bënë anëtare të reja - Polonia, Republika Çeke dhe Hungaria - si dhe të atyre shteteve, si Greqia, të cilat historikisht ishin të lidhura me Serbinë, kërkonte përpjekje plotësuese gjatë procesit të vendimmarrjes ushtarake.

Kohezioni politik i Aleancës u ruajt gjatë tërë kohës së fushatës, me gjithë disa debate dhe mosmarrëveshjeve serioze ndërmjet vendeve anëtare. Në këtë fushatë, SHBA-të i bënë mbi 60% nga numri i tërësishëm i fluturimeve dhe mbi 80% nga numri i tërësishëm i goditjeve. SHBA-të po ashtu e kishin rolin dominues në realizimin e aspekteve më moderne të fushatës ajrore.

Siç u theksua edhe me herët, NATO-ja e filloi fushatën ajrore duke llogaritur që qeveria jugosllave pas disa ditësh do të propozonte armëpushim dhe rifillim të negociatave. Si pasojë e kësaj pikënisjeje të gabuar, në mënyrë të pashmangshme pasuan dy probleme të mëdha.

Meqë fushata ajrore ishte planifikuar të zgjaste vetëm disa ditë, dhe ishte e përqendruar në një numër të kufizuar të caqeve ushtarake, qeveritë e vendeve anëtare të NATO-s përnjëherë e kuptuan që opinionin publik të tyre nuk e kishin përgatitur për një konflikt intensiv me një kohëzgjatje 78-ditëshe.

NATO-ja e kishte llogaritur gabimisht që një fushatë e shkurtër bombardimesh nuk do të kishte ndikim në përshkallëzimin dramatik të zhvendosjeve dhe të dëbimeve të popullatës shqiptare të Kosovës.

Gjatë ditëve të para të fushatës ajrore goditeshin caqet ushtarake, duke i përfshirë këtu forcat ajrore, mbrojtjen kundërajrore dhe instalimet komunikuese. Ndonëse bombardimet patën sukses që forcat ajrore jugosllave t'i mbajnë të lidhura për toke, ato nuk ia arritën ta shkatërrojnë në tërësi mbrojtjen e saj kundërajrore, ndonëse në mbarimin e luftës edhe ajo ishte e dëmtuar seriozisht. Pilotët e NATO-s e kishin urdhërin për të fluturuar në mbi 15.000 fita lartësi (përafërsisht 5.000 metra), për ta shmangur kërcënimin e vazhdueshëm nga sistemi i mbrojtjes kundërajrore jugosllave. Ky ishte vendimi që më së shumti është kritikuar nga kundërshtarët e mënyrës se si fushata e NATO-s u zbatua, meqë ky urdhër i kufizonte mundësitë e pilotëve për ta përcaktuar qartë natyrën ushtarake të caqeve të planifikuara. Një numër i madh i goditjeve të maketave, të cilat ishin vënë për ta lënë përshtypjen se ishin caqe ushtarake, tregon që pilotët nuk e kishin mundësinë për ta bërë identifikimin e qartë vizuel, para se të godisnin.

Në bazë të një numri të madh të raporteve, sulmet e NATO-s në Kosovë forcave tokësore të RFJ-së u kanë shkaktuar relativisht pak dëme.¹⁶ Edhe përkundër bombardimeve, forcat ushtarake të RFJ-së ia kanë arritur që aktivisht ta sulmojnë UÇK-në në Kosovë. Po ashtu, për forcat e NATO-s ishte e pamundur që ta ndalnin dëbimin dhe vrasjet e popullatës civile shqiptare.

Pas katër javë bombardimesh, udhëheqja jugosllave ende nuk po jipte asnjë shenjë të gatishmërisë për bisedime. Në samitin e NATO-s në Washington, të mbajtur me 23 prill 1999, udhëheqësit e NATO-s vendosën të vazhdojnë edhe më tutje me fushatën ajrore, dhe atë me intensitet të shtuar, duke e zgjeruar tani numrin e caqeve të përcaktuara për t'u goditur edhe në infrastrukturën ushtarake-industriale, në media, si dhe në caqe të tjera brenda Serbisë. Nga bombardimet u shkatërruan 59 ura (7 sosh vetëm mbi Danub), 9 autostrada (ndër të cilat edhe ajo Beograd-Nish si dhe ajo Beograd-Zagreb), si dhe 7 aeroporte. Shumica e transmetuesve kryesorë të telekomunikimit u dëmtuan, ndërkaq, dy të tretat e komplekseve industriale u shkatërruan pothuajë në tërësi. Sipas NATO-s, u arrit të paralizoheshin 70% të kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike, dhe 80% të rafinerive të naftës.¹⁷ Megjithëkëtë, goditja e këtyre caqeve pati edhe pasoja politike: vuajtjet e përjetuara nga popullata civile serbe ishin në kundërshtim me garancat paraprake të NATO-s që lufta nuk ishte e drejtuar kundër popullit serb. Një zgjatje e fushatës me shkallë të lartë të shkatërrimeve në Serbi, me siguri se do të kritikohet ashpër në shumë vende anëtare të NATO-s.

Në ketë luftë numri i viktimave ushtarake ishte fare i vogël. NATO-ja viktimë nuk pati fare, e që është rasti i parë i shënuar në historinë e luftrave. Në bazë të burimeve

të RFJ-së, në luftë kanë vdekur të paktën 600 ushtarë të RFJ-së, nga të cilët 300 janë vrarë në luftë me UÇK-në. Ndërkaq numri i ushtarëve të vrarë të UÇK-së nuk dihet.

Viktimat civile të shkaktuara nga fushata e bombardimeve të NATO-s

NATO-ja bëri përpjekje të mirëfillta për të shmangur shkaktimin e viktimave civile. Megjithë këto përpjekje, kanë ndodhur disa gabime serioze. Bombardimi i ambasadës kineze më 7 maj shkaktoi përplasje të mëdha politike, të cilat e trimëruan Millosheviqin për të pritur e shpresuar që nga ky gabim do të mund të kishte përfitime. Gabim tjetër katastrofik ishte bombardimi i Korishes, ku u vranë mbi 80 kosovarë: kanë qenë edhe disa gabime të tjera gjatë fushatës ajrore të NATO-s, kur nga bombat e NATO-s janë vrarë apo plagosur persona civilë. Ndër këto raste janë edhe dy incidente brenda një dite, i pari kur NATO-ja e goditi një kolonë të personave të zhvendosur, dhe i dyti kur u bombardua një tren udhëtarësh.

Në raportin e quajtur 'Vdekjet e Civilëve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s,' Human Rights Watch (HRW) i dokumenton rreth 500 raste të vdekjes se civilëve që ndodhën në 90 incidente të ndryshme. Në raport konstatohet se "më së paku 488, e deri në 527 civilë jugosllavë janë vrarë si pasojë e bombardimeve të NATO-s. Ndërmjet 62 e 66 për qind të numrit të përgjithshëm të civilëve të regjistruar në listat e të vdekurve janë vrarë në vetëm dymbëdhjetë incidente." HRW e konstatonte, po ashtu, se të dhënat e paraqitura në publikimin e Ministrisë së Jashtme të RFJ-së - krimet e NATO-s në Jugosllavi - në masë të madhe janë të besueshme, si në bazë të hulumtimeve të veta ashtu edhe në bazë të burimeve të tjera. Ky publikim flet për një numër të tërësishëm prej rreth 495 civilëve të vrarë dhe 820 civilëve të plagosur, në raste të veçanta dhe të dokumentuara.

Përfundimi i luftës

Pasi që fushata e bombardimeve dështoi në qëllimin e vet për ta kthyer Millosheviqin në tryezën e bisedimeve, shtetet anëtare të NATO-s përfunduan se disa nga supozimet që i kishin bërë kanë qenë të gabuara. Pyetja e cila në fundin e prillit ishte në qarkullim dhe e cila po shkaktonte gjithnjë e më shumë nervozizëm në shumë kryeqytete të shteteve anëtare të NATO-s ishte "Si do ta përfundojme këtë luftë?" Në kohën kur

pasiguria lidhur me mundësinë e arritjes së qëllimit të dëshiruar përmes fushatës së bombardimeve ishte në rritje, në prill qeveria gjermane e filloi iniciativën e parë të rëndësishme diplomatike. Ky plan e vlerësonte që OKB-ja duhej të përfshihej në këtë proces dhe se ajo duhej të kishte rolin e vet në administrimin e Kosovës. Rusia këtu ishte faktori kyç. Rusët ishin vendosmërisht kundër luftës, mirëpo ata ishin edhe më tepër të interesuar për gjetjen e një zgjidhjeje diplomatike për përfundimin e saj. Në mbledhjen e G-8-she¹⁸ në Bolonjë, u arrit marrëveshja ndërmjet Rusisë dhe vendeve të G-7-she për planin paqësor prej shtatë pikësh, e i cili ishte përafërsisht vazhdim i iniciativës gjermane. Kjo përpjekje shërbeu si kornizë për përpjekjet diplomatike dhe për diskutimet që u bënë në vazhdim ndërmjet të dërguarit rus Viktor Çernomirdin dhe Slobodan Millosheviqit, e që u mbajtën me 19 maj në Beograd.

Po ashtu gjatë prillit, në selinë e NATO-s filluan përgatitjet për invazionin tokësor. Ekspertët e NATO-s, të udhëhequr nga Gjenerali Wesley Clark, ua tërhoqën vërejtjen politikanëve se për ta bërë invazionin në javën e parë të shtatorit, ashtu që t'i ikej ardhjes se dimrit, urdhëri për fillimin e përgatitjeve do të duhej të jipej gjatë javës se parë të qershorit.¹⁹

Edhe përkundër kësaj, në disa vende anëtare të NATO-s, në mes tjerash edhe në vetë SHBA, kishte një rezistencë të fortë politike kundër dërgimit të trupave tokësore. Debatimi rreth dërgimit të trupave tokësore e kishte po ashtu edhe qëllimin e shtimit të trysnisë mbi Millosheviqin; që nga fillimi i këtij debati, ishte e qartë që dërgimi i trupave tokësore ishte vetëm një mundësi e largët, dhe se do të ishte vështirë për ta arritur konsensusin e nevojshëm politik për këtë qëllim.

Rundi përfundimtar i bisedimeve i cili u mbyll në fillim të qershorit, e hodhi poshtë nevojën për invazionin tokësor. I dërguari i BE-së, Martti Ahtisaari, së bashku me të dërguarin rus, Viktor Çernomirdin, e sollën në Beograd propozimin i cili mbështetej në parimet e G-8-she. Në bazë të këtyre parimeve kërkohet përfundimi i menjëherëshëm dhe i verifikueshëm i represionit dhe i dhunës në Kosovë; tërheqja e forcave ushtarake, policore e paramilitare të RFJ-së; dërgimi i një pranije ndërkombëtare efikase civile dhe të sigurisë; si dhe kthimi i të gjithë refugjatëve. Në këtë plan theksohej se “populli i Kosovës do ta gëzonte një autonomi substanciale në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë,” mirëpo në marrëveshje nuk përmendej as ndonjë afat dhe as ndonjë mekanizëm për zgjidhjen e statusit afatgjatë të Kosovës.²⁰

Më 1 qershor 1999, qeveria e Jugosllavisë e njoftoi qeverinë gjermane se do t'i pranonte parimet e G-8-she.

Më 3 qershor, Parlamenti i Serbisë formalisht e miratoi planin paqësor i cili

mbështetjesh në parimet e G-8-she. Pas vonësive të shkaktuara nga vështirësitë teknike gjatë përpilimit të marrëveshjes, NATO-ja i pezulloi sulmet e veta ajrore më 10 qershor. Po atë ditë, pas konfirmimit se forcat e RFJ-së e kishin filluar tërheqjen sipas planit paqësor, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e miratoi Rezolutën 1244, e cila e përcaktoi kornizën për vendosjen e administratës civile të OKB-së në rajon, si dhe për vendosjen e një pranije ndërkombëtare e të sigurisë.²¹

Ne nuk mund ta dimë me saktësi se pse Millosheviqi u pajtua me këtë marrëveshje për tërheqjen e forcave të RFJ-së nga Kosova. Mirëpo, sipas të gjitha gjasave, shtimi i intensitetit të bombardimeve mbi infrastrukturën e Serbisë mund ta ketë patur ndikimin vendimtar në qarqet vendimmarrëse në Beograd. Ato ndodheshin para perspektivës së shkatërrimit total të ekonomisë së Serbisë, dhe njëkohësisht edhe para pasojave të kritikave të brendshme. Këto qarqe, po ashtu, mund të jenë frikësuar për pozitat e tyre në pushtet si dhe për pasurinë e tyre private. Perspektivat e tyre politike ishin tepër të zymta. Aleanca e NATO-s e ruajti unitetin e saj. Qeveria ruse e bëri të qartë që mbështetja e saj për RFJ-në i kishte kufijt e vet. Në të njëjtën kohë, marrëveshja përfundimtare, sipas pikëpamjeve të qarqeve udhëheqëse të RFJ-së, i kishte edhe disa pjesë pozitive: Kosovën do ta merrte përsipër OKB-ja, në vend të NATO-s, dhe për dallim nga plani i Rambujesë, trupat e NATO-s nuk do të kishin mundësi të hynin në territorin e Jugosllavisë, por vetëm në Kosovë. Nga aspekti formal, Kosova do të ishte edhe më tutje pjesë e RFJ-së; dhe trupat ruse, po ashtu, do të ishin pjesë e forcave ndërkombëtare në Kosovë.

A ishte fushata e NATO-s sukses apo dështim? Nuk ka përgjigje të lehtë në këtë pyetje, sepse, në fakt, kjo njëkohësisht ishte edhe sukses edhe dështim. Kjo e detyroi qeverinë e RFJ-së që ta tërhiqte ushtrinë dhe policinë e saj nga Kosova, dhe që ta nënshkruante marrëveshjen e cila u përpilua ngjashëm me marrëveshjen e dështuar në Rambuje. Kjo, po ashtu, e ndali dhunën sistematike ndaj shqiptarëve të Kosovës. NATO-ja e demonstroi forcën e vet ushtarake, si dhe aftësinë për ta ruajtur kohezionin politik, përballë një sfide e cila ka mundur lehtë ta prishte Aleancën.

Mirëpo, ndërhyrja dështoi në arritjen e qëllimit të saj sublim për ta penguar spastrimin etnik. Me shumë se një milion shqiptarë të Kosovës u shndërruan në refugjatë, rreth 10.000 e humbën jetën; shumë sish u lënduan, u dhunuan ose u dëmtuan në mënyra të tjera. Shkatërrimet që u bënë, u bënë në një shkallë shumë të gjerë. Popullata shqiptare e Kosovës përjetoj vuajtje të rënda para se ta arrinte lirinë. Millosheviqi edhe më tej ngeli në pushtet, edhe pse është i akuzuar për krime të luftës.

NATO-ja ia doli të fitojë pas fushatës 78-ditëshe. Është çështje që do të mund të disku-

tohej se a do të arrinte Aleanca që ta ruante kohezionin e vet, sikur Millosheviqi të vazhdonte të bënte ballë për një kohë edhe më të gjatë. Për luftë tokësore angazhoheshin disa politikanë perëndimorë dhe shumë analistë ushtarakë; mirëpo përkrahja e opinionit publik perëndimor, me përjashtim të Francës dhe Britanisë, që të fillohej me luftë tokësore, në kohën kur RFJ-ja me ngulm refuzonte të dorëzohej, ishte e vogël. Arsyetimi ishte ai që një luftë ajrore e intensitetit të lartë dhe me viktima të pakta, do të zëvendësohej me një luftë tjetër, në të cilën do të kishte viktima ushtarake shumë më të mëdha. Për më tepër, as intensifikimi i fushatës së bombardimeve nuk e kishte ndonjë përkrahje më të gjerë në opinionin perëndimor. Çfarëdo “kundërvlere strategjike” e ndonjë goditjeje hakmarrëse të shkallës më të lartë kundër Serbisë, me të drejtë do të mund të konsiderohej si një bombardim i neveritshëm terrorizues - i cili do të ishte i papranueshëm, njëlloj sikurse edhe rrafshimi i Groznit nga ana e Rusisë.

Për fat të keq, shumë nga problemet themelore që ndikuan në përsheptimin e konfliktit, vazhdojnë ta trazojnë rajonin edhe më tutje. NATO-ja e fitoi luftën. Tani Kombet e Bashkuara duhet ta fitojnë paqen.

4. Kosova nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara

Në të njëjtën ditë në të cilën NATO-ja e ndërpreu fushatën ajrore kundër Jugosllavisë, më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (KS i OKB) e miratoi Rezolutën 1244.¹ Kjo Rezolutë i përcaktonte orientimet themelore në mbështetje të të cilave Bashkësia Ndërkombëtare do të vepronte në Kosovën e pasluftës.

Rezoluta 1244 e parashihte që “në Kosovë do të vendoset një prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë, nën autoritetin e Kombeve të Bashkuara,” dhe kërkonte që Sekretari i Përgjithshëm ta emëronte një Përfaqësues Special që ta mbikëqyrte praninë civile ndërkombëtare, si dhe që t’i koordinonte aktivitetet e saj me veprimet e forcës ushtarake të sigurisë e cila ishte nën komandën e përgjithshme të NATO-s. Kjo e parashihte themelimin e një administrate të përkohshme për Kosovën, kërkonte nga prania ndërkombëtare civile që t’i krijonte kushtet për procesin politik të përpiluar për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, bënte thirrje për kthimin e sigurtë dhe të lirë të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur, si dhe e kërkonte demilitarizimin e UÇK-së. Krahas kësaj, kjo e mirëpriste “punën e cila i takonte Bashkimit Evropian,” dhe e cila do të ishte e orientuar në:

Zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e rajonit të goditur nga kriza e Kosovës, duke e përfshirë edhe zbatimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Rezoluta 1244, megjithatë, krijoi paqartësi të shumta lidhur me disa çështje edhe ashtu kontradiktore. Teksti flet për angazhimin e të gjitha shteteve anëtare për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë, në të njëjtën kohë që angazhohet “për autonomi substanciale dhe vetëqeverisje të mirëfilltë për Kosovën.” Në kushtet e tashme nuk mund të flitet për integritetin territorial të Jugosllavisë – thjesht, sepse ekziston ndarje fizike, politike dhe ekonomike ndërmjet Kosovës dhe pjesës tjetër të vendit. Sido që të jetë, Kosova – edhe pse juridikisht ende pjesë e RFJ-së – në këtë moment është pa dyshim protektorat. Çështja është, protektorat i kujt? Protektorat i Kombeve të Bashkuara apo i NATO-s? I shteteve që marrin pjesë në KFOR, apo i Bashkimit Evropian? A është kjo një krijesë e ligjshme e Bashkësisë Ndërkombëtare, cilado që të jetë ajo, apo është, thjesht një jetim lufte?²

Paqartësitë janë të pranishme po ashtu, edhe në mënyrën e ndarjes së pushtetit ndërmjet të OKB-së dhe të institucioneve të sapokrijuara vetëqeverisëse. Rezoluta 1244 e

autorizon Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) që ta mbikëqyrë krijimin e “institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes demokratike,” duke e lënë të hapur zgjidhjen politike. Zgjedhjet lokale janë të planifikuara për vjeshtën e vitit 2000, ndërkaq ato të përgjithshmet për vitin 2001. PSSP do të vazhdojë ta ketë pushtetin përfundimtar në Kosovë, por një pjesë e kompetencave do të fillojë të bartet në organet e zgjedhura në nivelet komunale dhe në ato të Kosovës gjatë viteve të ardhshme. Po ashtu, nga zyrtarët e qeverive të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit është hartuar një kushtetutë e përkohshme. Edhe pse mund të përfundohet që detajet e saj u morrën nga Marrëveshja e Rambujesë, natyra e vërtetë e kushtetutës së përkohshme është ende një çështje e hapur.

Teksti i Rezolutës 1244 i parasheh “katër shtylla” në të cilat Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) do ta mbështesë punën e vet:

Shtylla I: Çështjet humanitare, të drejtuara nga UNHCR-i;

Shtylla II: Administrata civile, e drejtuar nga vetë UNMIK-u;

Shtylla III: Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, i drejtuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); dhe,

Shtylla IV: Zhvillimi ekonomik, nën mbikëqyrjen e Bashkimit Evropian.

Këto katër fusha të përgjegjësisë nuk mundën gjithnjë të dallohen lehtë njëra nga tjetra. Pashmangshmërisht do të shfaqen ndërhyrja në kompetenca, dyfishimi i punëve si dhe fërkimet burokratike. Vështirësitë qëndrojnë në praninë e një spektri të gjerë prej rreth 500 organizatash joqeveritare, të cilat bëjnë gara njëra me tjetrën, e shpeshherë madje vijnë edhe në situata konfliktuoze. Kjo ka shkaktuar që nga fillimi i misionit angazhimi civil në Kosovë të duket më pak mbresëlënëse në krahasim me veprimet e KFOR-it (ndonëse edhe KFOR-i, si forcë ushtarake e përbërë nga ushtarë të shumë vendeve, nuk ishte pa fërkime). Megjithëkëtë, mandati i ushtrisë ishte i përcaktuar në një mënyrë më të qartë: dhe ky ishte që ta pengonte ripërtëritjen e armiqësive, ta bënte mbrojtjen, dhe, në raste të domosdoshme, ta impononte zbatimin e armëpushimit; po ashtu, ky e përfshinte demilitarizimin e UÇK-së, si dhe krijimin e një ambienti të sigurt në Kosovë. Pos kësaj, ushtarët e kishin edhe një përparësi tjetër: ata kishin arritur të parët.

KFOR-i e merr kontrollin

Kushtet e vendosjes së një pranie ushtarake ndërkombëtare si dhe qëllimet e saj u përcaktuan në Marrëveshjen Tekniko - Ushtarake (MTU) ndërmjet të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë (KFOR), dhe të qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së Serbisë, e cila u nënshkrua me 9 qershor 1999. Më 10 qershor, menjëherë pas miratimit të Rezolutës 1244, Këshilli i Aleancës së Atlantikut e autorizoi hyrjen në Kosovë të trupave të KFOR-it, në aksionit që u kodua si “Operacioni Mbrojtësi i Përbashkët.” Data e hyrjes së trupave u caktua për 12 qershor.

Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e cila hyri në fuqi menjëherë pasi që u nënshkrua i përmbante dy anekse. I pari e përcaktonte tërheqjen e forcave ushtarake, paramilitare dhe të atyre të sigurimit të Jugosllavisë. Sipas asaj që parashihej në Aneksin e parë, forcave jugosllave iu dhanë 11 ditë për tërheqjen e plotë nga tri zona të Kosovës, ndërkaq për tërheqjen e forcave ajrore dhe të mbrojtjes kundërajrore jugosllave mjaftuan vetëm tri ditë.

Aneksi i dytë e përcaktonte mandatin e veprimeve të KFOR-it në Kosovë. Ky mandat e kishte pësuar një ndryshim të vogël në krahasim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila kërkonte nga KFOR-i që:

Ta vendosë dhe ta ruajë një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe ta zbatojë misionin e tij;

Të kontribuojë për një mjedis të sigurtë për praninë civile implementuese ndërkombëtare, si dhe për organizatat e tjera, agjencionet dhe organizatat joqeveritare;

Ta ushtrojë kontrollimin përkatës të kufijve të RFJ-së në Kosovë me Shqipërinë dhe IRJM (Maqedoninë), deri në arritjen e misionit civil të OKB-së.³

Edhe pse teoretikisht, Rezoluta 1244 i lejonte secilit shtet anëtar të OKB-së të vendosë trupa në Kosovë, praktikisht nënkuptohej që KFOR-i ishte e vetmja forcë e pranishme ndërkombëtare. Forcat ruse të vendosura në Bosnje i bënë një sfidë dramatike këtij supozimi, duke u vendosur me shpejtësi në aeroportin e Prishtinës, dhe atë para arritjes së KFOR-it. Konfrontimi i mundshëm megjithatë nuk ndodhi, dhe atë duke i falënderuar marrëveshjes së nënshkruar në Helsinki, më 18 qershor, e në të cilën u përcaktuan kriteret e pjesëmarrjes së rusëve në operacionet e KFOR-it. Kjo marrëveshje e kufizonte kontigjentin rus në 2.850 trupa, si dhe 750 trupa të tjerë të aeroportit dhe të bazës së veprimeve logjistike; këto njësi vepronin në kuadër të sektorit gjerman, amerikan dhe të atij francez. Falë këtij mirëkuptimi, pjesëmarrja e rusëve në KFOR u realizua me fërkime relativisht të pakta.

Mirëpo nuk mund të thuhet që një konstatim i tillë vlen edhe për marrëdhëniet diplomatike ndërmjet Rusisë dhe fuqive Perëndimore. Rusia ankohej që pas ndërhyrjes së NATO-s gjendja e sigurisë ishte shumë më e keqe, e kritikonte Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për mungesën e hetimit të krimeve të UÇK-së kundër popullatës joshqiptare, dhe i akuzonte autoritetet e OKB-së në Kosovë, në veçanti Bernar Kushnerin, për shkelje të vazhdueshme dhe të vetëdijshme të Rezolutës 1244. Më tutje, Rusia e vlerësonte që ringjallja ekonomike e Kosovës ishte shumë më e ngadalshme sesa ajo në pjesën tjetër të Jugosllavisë; që ndihma e premtuar nga BE-ja dhe nga SHBA-të nuk po realizohej; dhe që sanksionet kundër RFJ-së u treguan kontraproduktive, kështu që duhej të ndërpriteshin. Kërkesë e veçantë e tyre ishte që të ndërrohej Kushneri, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, dhe që UNMIK-u të vinte lidhje zyrtare me Beogradin. Ankesa të veçanta bëheshin lidhur me dokumentat e identifikimit dhe me tabelat e automjeteve, e të cilat nuk i përmbanin fare simbolet shtetërore të Jugosllavisë; mëpastaj, ankesa bëheshin lidhur me projektet e privatizimit të cilat e tjetërsonin pronën shtetërore të RFJ-së pa pëlqimin e Beogradit, me futjen e markës gjermane si valutë qarkullimi, si dhe me faktin që nuk po ndërmerreshin kurrfarë masash për kthimin në Kosovë, sipas marrëveshjes, të një numri të personelit ushtarak të Jugosllavisë dhe të Serbisë. Dhe, së fundi, rusët insistonin që të niseshin negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës – një çështje kjo të cilës deri tash fuqitë Perëndimore iu janë shmangur.⁴

Në fazën e parë të Operacionit Joint Guardian, trupat e NATO-s u vendosën në Kosovë dhe i mëkambën shtabet e KFOR-it në Prishtinë. Për ta lehtësuar ruajtjen e paqes, KFOR-i e bëri ndarjen e territorit në pesë zona, ku secila ishte nën kontrollin e një shteti të vetëm të NATO-s. Veriu, në rajonin e Mitrovicës, u vu nën kontrollin e Francës, e cila i kishte dhënë 7.000 trupa. Jugu, në rajonin e Prizrenit, ishte nën përgjegjësinë e Gjermanisë (me 8.000 trupa). Rajoni i Pejës, në Perëndim, ishte vënë nën kontrollin e Italisë (6.000 trupa). Dhe, në fund, zona qendrore përreth Prishtinës, si dhe pjesa lindore rreth Gjilanit, do të ishin nën përgjegjësinë e Mbretërisë së Bashkuar (8.000 trupa) dhe të Shteteve të Bashkuara (6.000 trupa).⁵

Gjatë hyrjes në Kosovë nga Maqedonia dhe nga Shqipëria, njësitet paqeruajtëse të KFOR-it hasën vetëm në një rezistencë të papërfillshme serbe: ishin vetëm disa raste të veçanta të fërkimeve me njësitet serbe të sigurimit. Forcat ushtarake dhe paramilitare jugosllave u tërhoqën nga Kosova brenda afatit të paraparë në MTU. Mirëpo, kur KFOR-i e vuri territorin nën kontrollin ushtarak, gjendja ende ishte jostabile.

Forcat jugosllave nuk e paraqisnin ndonjë sfidë të mirëfilltë. NATO-ja dhe Kombet e

Bashkuara u ballafaquan me një situatë të veçantë, të cilën nuk e kishin provuar ndonjëherë më parë. OKB-ja kishte mbikëqyrur tranzicione edhe më parë, mirëpo këtë e kishte bërë duke e respektuar tërësinë e shteteve, si në Namibia, Kamboxhia dhe në Mozambik, ku kishte vepruar në mbështetje të një mandati të kufizuar në kohëzgjatje. Situata që më së shumti i kishte përngjasuar asaj në Kosovë ishte ajo në Bosnje e Hercegovinë. Mirëpo madje edhe Bosnja dallonte në shumëçka: ajo, në bazë të marrëveshjes së Dejtonit ishte shtet, dhe, ndonëse e ndarë me kufij etnik, e kishte një infrastrukturë administrative.

Në Kosovë, administrata ishte e shpërbërë. Serbët që ishin pjesë e administratës së pushtetit të mëparshëm kishin ikur. Në kohën kur njësitet e KFOR-it ishin ende duke i ngritur tentat e tyre, për plotësimin e vakuimit të krijuar në garë kishin hyrë dy politika të ndryshme. Qeveria e Republikës së Kosovës - e ashtuquajtura “qeveria paralele,” e drejtuar nga “Presidenti,” Ibrahim Rugova i LDK-së, mund të thirrej në legjitimitet në bazë të zgjedhjeve jozyrtare të mbajtura në fillim të 90-tave, dhe të asaj që i kishte ngelur nga rrjeti i gjerë i veprimit në terren, i ndërtuar gjatë një dekade, e i cili ende ishte substancial. Qeveria e Përkohshme e Kosovës, nën “Kryeministrin” dhe Komandantin e UÇK-së, Hashim Thaçin, i kishte kompetencat e nxjerra nga delegacioni shqiptar në Rambuje, i cili u formua në mars të vitit 1999, si dhe në pushtetin popullor të dhënë për shkak të rolit të cilin e pati gjatë luftës. Kishte momente kur këto struktura, si dhe fraksionet rivale të UÇK-së, dukej të ishin pothuajja buzë një konflikti të armatosur brendashqiptar.

Në ndërkohë, në përmasa madje edhe më shqetësuese, serbët e Kosovës si dhe romët e dyshuar për kolaboracionizëm u vunë në shënjestër të sulmeve hakmarrëse. Edhe pas ndërprerjes formale të armiqësisë ndodhi një mori shqetësuese e vrasjeve gjakftohta. Shumë nga serbët që nuk u larguan së bashku me forcat jugosllave, tani filluan dëboheshin me forcë nga shtëpitë e veta.

Shihej qartë që KFOR-i në ditët e para të vendosjes nuk ishte në gjendje t’i ndalonte veprimet hakmarrëse të shqiptarëve. Vrasja e serbëve dhe e pjestarëve të minoriteteve të tjera si dhe shkatërrimi i shtëpive të tyre, e cila ndodhte para hundëve të ushtarëve ndërkombëtarë, e paraqet një dështim të madh të Bashkësisë Ndërkombëtare në zbatimin e atyre parimeve që ishin forca nxitëse kryesore në përpjekjet kundër luftës. Parimi për krijimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët ishte pjesë e Rezolutës 1244. Duke i ditur përvojat e Bosnjës, KFOR-i, megjithatë, është dashur të ishte i përgatitur më mirë për këtë lloj dhune. Është dashur të bëhej më tepër për ta penguar mllëfin. Trupat e KFOR-it është dashur që paraprakisht të alarmohen, dhe që t’u tre-

gohet se çfarë duhej të bënin para se të vinin në Kosovë, dhe ato, po ashtu, është dashur të kishin autorizime dhe urdhëra që t'i përdorin armët kundër atyre që e kërcënonin në mënyrë agresive jetën e njerëzve të tjerë. Mirëpo, gjatë ditëve të para të sulmeve, trupat e KFOR-it si dhe infrastruktura e tyre ende nuk ishin të vendosura në tërësi, dhe, nga ana tjetër, preokupim kryesor ishte siguria e vetë KFOR-it.

Siç më vonë edhe u pa, KFOR-i e kuptoi heret që misioni i tij, megjithatë, ishte shumë më i gjerë sesa kontrollimi ushtarak i rajonit të çliruar. Gjatë dy muajve të parë nuk kishte ndonjë ndihmë të dukshme civile as nga Kombet e Bashkuara dhe as nga OSBE-ja. Kështu, detyra për ruajtjen e rendit dhe të ligjit, riparimi i infrastrukturës lokale dhe administrimi i rajonit u mbeti barrë ushtarëve. Ata i bënin edhe punët e policit, edhe ndërtonin rrugët, urat dhe shtëpitë, edhe i administronin burgjet e spitalet, dhe, po ashtu, i kryenin punët e deminimit përgjatë rrugëve kryesore. Në të njëjtën kohë, ata e filluan realizmin e detyrës për demilitarizimin e UÇK-së dhe të shpërberjes së strukturave të saja ushtarake.

Shikuar në përgjithësi, pjesa më e madhe e misionit të KFOR-it duket të ishte e sukseseshme, por, megjithatë, veprimet e tij nuk ishin pa probleme. Interesat dhe përvojat e ndryshme kombëtare pasqyroheshin në fërkime - në disa raste duke e vu në rrezik madje unitetin e veprimit. Procedurat tepër strikte dukeshin të demoduara. Gjenerali gjerman Klaus Reinhard, që ishte në krye të komandës së KFOR-it nga tetori 1999 e deri në prill të vitit 2000, e shprehte hapur zemërimin e vet duke thënë se për dallim nga pamja e jashtme, ai si komandant i KFOR-it “nuk ka asgjë për të komanduar.” Propozimet që ai ua bënte drejtuesëve ushtarakë të kontigjenteve të ndryshme kombëtare të vendosura në Kosovë, vazhdimisht u dërgoheshin për miratim qeverive të tyre. Atij iu deshtën katër muaj negociata për ta arritur marrëveshjen që, të paktën në parim, në Mitrovicë të vendosen edhe forca të tjera përpos atyre franceze. Shpesh herë, njësitet deklarorin se kanë detyra shumë më të vogla sesa mundësitë e tyre të vërteta, dhe madje edhe që shtetet anëtare të NATO-s disa herë i kanë tërhequr kontigjentet e tyre pa kurrfarë koordinimi. Planet e NATO-s për zëvendësimin e personelit të përherëshëm të KFOR-it në Kosovë me oficerë të huazuar, e të cilat do të bëheshin post për post, dhe jo me ndërrime të tërësishme të personelit, mund të dukeshin si dobësim i mëtutjeshëm i efikasitetit të operacionit ushtarak.⁶ Kësaj liste të vështirësive mund t'i shtohet edhe mungesa e kapaciteteve të duhura të cilat KFOR-it i nevojiteshin për mbledhjen e të dhënave të intelgjencës.

Ndërtimi i shtetit për një joshtet

Mandati

Projekti i OKB-së për paqe në Kosovë i shprehur në Rezolutën 1244, i përmban si qëllimet afatshkurtëra ashtu edhe ato afatgjatë. Lidhur me administrimin e Kosovës, kjo e parasheh një proces në tri faza:

- Ushtrimi i administratës civile themelore përmes një pranie ndërkombëtare, ku dhe për aq kohë sa do të jetë e domosdoshme;
- Administrimi nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, në periudhën para se të mbaheshin zgjedhjet; dhe,
- Administrimi nga institucionet e formuara me zgjedhje.

Ligji civil dhe rendi fillimisht do të ishin në kompetencë e personelit të policisë ndërkombëtare, ndërsa qëllimi përfundimtar ishte formimi i një force policore lokale. Refugjatët dhe personat e zhvendosur kthimin në shtëpitë e tyre duhet ta kishin të sigurtë dhe të papenguar. Ndër nismat e parapara me Rezolutë, e të cilat kërkojnë përpjekje të qëndrueshme dhe afatgjatë janë mbrojtja dhe afirmimi i të drejtave të njeriut si dhe mbështetja për rindërtimin e infrastrukturës kryesore dhe të ekonomisë.⁷

Arritja e UNMIK-ut

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ishte i ngadalshëm si në arritjen e vet, ashtu edhe në bërjen e pranisë së vet të dukshme. I ndodhur përballë obligimit të madh të përzgjedhjes dhe të vendosjes së një administrate të tërë civile, ky shpesh herë është kritikuar për fillim të ngathë të veprimtarisë së vet. Bernard Kushner u emërua Përfaqësues Special i OKB-së me 2 korrik 1999,⁸ ndërkaq detyrën e mori me 15 korrik. Deri në qershorin e vitit 2000, administrata civile ndërkombëtare i kishte 292 pjestarë të personelit profesional, nga 435 sa ishte numri i tërësishëm i lejuar. Nivelet e plotësimit të personelit arritën në 86% të numrit të paraparë nëpër selitë kryesore, në 42% në ato rajonalet, dhe në 60% në komuna. Shtylla për ndërtimin e institucioneve e OSBE-së, nga numri i përgjithshëm i paraparë prej 751 punëtorësh, i kishte 564 pjesëtarë të personelit ndërkombëtar, ndërkaq shtylla e rindërtimit ekonomik i kishte gjithsej 63. Përveç këtyre, ishin edhe 547 vullnetarë të OKB-së nga 83 vende.⁹

Sekretari i Përgjithshëm, Anan, e ka nënvizuar listën e gjatë të arritjeve të UNMIK-ut:

Gjatë muajve të parë, mbi 700.000 refugjatë u kthyen nëpër shtëpitë e tyre, filloi rindërtimi, dhe përgatitjet për dimër ishin në rrugë të mbarë. Kjo mundësoi që, përkundër frikës së madhe, të mos ketë viktima nga të ftohtit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u demilitarizua dhe filloi procesi i gjatë i transformimit të ushtarëve në civilë, përmes formimit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Policia e UNMIK-ut ka bërë përparime të mëdha në vënien e rendit nëpër rrugët e Kosovës, dhe trajnimi e zhvillimi i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), përmes rekrutimit të kuadrove lokale, është në realizim e sipër. Ekonomia ka filluar të japë shenja të lehta të ringjalljes, ndërkaq, po vazhdojnë përgatitjet për revitalizimin dhe reformimin e sektorit privat, si dhe për zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Udhëheqësit politikë vendorë tani e kanë një pjesë të përgjegjesive për udhëheqjen e Kosovës, dhe është formuar administrata e përbashkët dhe e përkohshme, e cila u mundëson vendësve pjesëmarrje në administrimin e rajonit...

Shumë analistë të skenës kosovare kanë konstatuar që ky vlerësim është për së tepërmi pozitiv. Është e vërtetë se që nga qershori 1999 janë bërë përparime, por këto ende dukeshin të brishta për t'u quajtur një ndryshim kuptimplotë. Dr. Kushner e thekson se që "shtypi ka heshtur meqë nuk ka krizë të madhe, sepse femijët po e vijnë në mësimin, sepse shtëpive u janë vënë pullazet dhe sepse numri i vrasjeve ka zbritur nga 50 në javë në gjithsej 6;"¹⁰ mirëpo prapëseprap kishte ende brenga serioze.

Gjendja e sigurisë

Parandalimi i dhunës ndëretnike, ashtu siç edhe pritej, ishte një punë e vështirë. Mbi 90% të popullatës së Kosovës janë shqiptarë. Para dhe gjatë luftës, ata nga serbët përjetuan persekutim, zhvendosje dhe akte rrënjëqethëse kriminale. Pas ndërprerjes së armiqësisë dhe tërheqjes së ushtrisë serbe nga Kosova, shumë shqiptarë morën turr që të hakmirren. Disa nacionalistë radikalë shqiptarë e dëshironin një "spastrim" të Kosovës nga të gjitha grupet e tjera. Në raportin e tij të datës 6 qershor, Sekretari i Përgjithshëm, Anan e pohonte:

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në Kosovë nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Pjesëtarët e bashkësive minoritare kanë vazhduar të jenë viktima të frikësimeve, sulmeve dhe kërcënimeve në të tërë Kosovën.¹¹

Statistikat lidhur me krimet, të publikuara nga UNMIK-u, tregojnë që shkalla e

përgjithshme e krimeve ka qenë në rënie, por rritja e krimeve me motivacione etnike vazhdon të jetë brengosëse. Në një disproporcion të veçantë janë të viktimizuar serbët. (Shih Tabelën 2)

Tabela 2: UNMIK CIVPOL, "Statistikat e krimeve"		
	Qershor 1999 - Dhjetor 1999	2 Janar 2000 - 30 Qershor 2000
Vrasje	454	146
Kidnapime	190	94
Zjarrvënie	1,327	362
www.civpol.org/unmik/statistics.htm, 7 gusht 2000		

Para luftës në Kosovë kanë jetuar përafërsisht 200.000 serbë. Përderisa një pjesë e tyre janë larguar vullnetarisht, shumë janë larguar nga frika ose janë detyruar të largohen përmes sulmeve hakmarrëse të drejtpërdrejta. Pas verës së vitit 1999, kishte ngelur vetëm gjysma e tyre. Serbët e tjerë, 100.000 sa kishin mbetur, ishin përqendruar në disa enklava (për shembull në veri të Mitrovicës, Ulqianë, Graçanicë, Rahovec, etj.). Gjetkë, KFOR-i kujdesej që ta siguronte përcjelljen dhe mbrojtjen fizike të serbëve, romëve dhe të minoriteteve të tjera, të cilët përballeshin me armiqësi etnike të pamëshirshme. Kishat ortodokse ruheshin pa ndërprerë. Në disa fshatra të largëta ka ngelur aty-këtu nga ndonjë plakë. Aktualisht, një pjesë e madhe e ushtarëve të KFOR-it është e angazhuar në mbrojtjen e minoriteteve.

Qyteti i Mitrovicës është bërë vatër e nxehtë e konfliktit ndëretnik. Qyteti është i ndarë në pjesën veriore serbe, si një çerdhe e sigurtë për serbët nga pjesët e ndryshme të Kosovës, dhe në pjesën jugore të banuar me shqiptarë. Lëvizja e shqiptarëve nga veriu në jug, si dhe e serbëve nga jugu në veri, është duke vazhduar ende. Në pjesën veriore është metalurgjia e Trepçës dhe Fakulteti Teknik i Universitetit të Prishtinës, dhe ky fakultet është shndërruar në një universitet serb. Shqiptarët e Kosovës kurrë nuk do ta pranojnë humbjen e Mitrovicës veriore, dhe vazhdimi i ndarjes së Mitrovicës është një rrezik i përhershëm për ripërtëritjen e dhunës.

Një gabim i madh, i bërë në fazat e hershme, qëndronte në mosgatishmërinë e KFOR-it francez për të këmbëngulur që qyteti të mos ndahej. Në bazë të përvojave nga misionet e mëparshme paqeruajtëse, në veçanti të atyre nga Bosnja, strategjia e cila u ndoq e kishte pikënisje ndarjen e serbëve dhe të shqiptarëve, duke u mbështetur në bindjen se kjo ishte mënyra më e mirë për ta arritur sigurinë. Mirëpo tash është shumë më e vështirë që kjo strategji të ndërrohet. E ardhmja e Mitrovicës varet nga e ardhmja e Kosovës dhe nga Rezoluta 1244. Zgjidhja e këtij problemi do të jetë së tepërmi e

vështirë, përderisa serbët e veriut të Mitrovicës të mos e pranojnë se janë pjesë e Kosovës, dhe jo e Serbisë.

Kufizimet në liri të lëvizjes së minoriteteve e pengojnë qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore, në shkollim dhe në ndihma sociale. Lidhur me këtë përkeqësim të gjendjes së sigurisë, Sekretari i Përgjithshëm ua tërhoqi në mënyrë të rreptë vërejtjen si udhëheqësve ashtu edhe banorëve të Kosovës, duke thënë se: “Bashkësia Ndërkombëtare nuk ka ndërhyrë në Kosovë ashtu që ta bëjë atë vend ku lulëzon krimi dhe hakmarrja.”¹² Mbështetja e vazhdueshme dhe angazhimi, porosiste ai, janë të kushtëzuara me bashkëpunim të plotë të të gjitha partive politike dhe të të gjitha bashkësive. Po ashtu, edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i këshillonte shqiptarët e Kosovës që të bashkëpunojnë me KFOR-in dhe me UNMIK-un.¹³

Ndonëse dhuna në Kosovë ka shënuar rënie, minoritetet ende jetojnë në një gjendje pasigurie. Numri i shqiptarëve që janë përgjegjës të drejtpërdrejtë për dhunë është shumë i pakët, mirëpo dënimi publik që i bëhet dhunës është i vogël. Ka zëra të guximshëm - për shembull, Veton Surroi në gazetën e përditshme shqipe Koha Ditore, ose të rinjtë e Prishtinës që me qirinj morën pjesë në demonstratat për tolerancë, në dhjetor 1999. Mirëpo është e vështirë të shpresohet për krijimin e një shoqërie më demokratike; për momentin, mënyra e vetme që serbët e kanë në dispozicion për të mbijetuar, është që ta pranojnë mbrojtjen e armatosur që ju ofrohet, me disa kufizime në lëvizje si pasojë e kësaj, e që në fakt është humbje e lirisë.

Ardhja e ngadalshme: Forca policore ndërkombëtare

Planet e qershorit 1999 e parashihnin një vendosje të shpejtë në Kosovë të 3.000 policëve ndërkombëtarë. Mirëpo KFOR-it iu desh të realizojë vetë detyrat e zbatimit të ligjit dhe të vendosjes së rendit edhe për dy muaj të plotë. Njësitet e para të policisë ndërkombëtare arritën vetëm me 8 gusht, kur edhe i filluan patrollimet e tyre të para, dhe atë kryesisht në Prishtinë. U nevojitën tre muaj të plotë për vendosjen e 1.400 policëve të parë. “Pse NATO-ja mundi t’i sillte 30.000 trupa, ndërkaq OKB-ja nuk ia arrin t’i sjellë as 1.000 policë?,” ishte një pyetje e bërë nga Agron Bajrami, njëri nga redaktorët e Kohës Ditore. Nga mesi i shtatorit, në Prishtinë u vendosën 500 policë ndërkombëtarë (e në të cilën ishin 20.000 serbë), në Mitrovicë 49 (12.000 serbë), në Prizren 35 (150 serbë), në Gjilan 35 (3.500 serbë), në Pejë 26 (450 serbë), ndërkaq, në detyra që kishin të bënin me çështjet e kufirit ishin të angazhuar edhe 78 policë të

tjerë. Nëntë muaj më vonë, në rajon ishin të vendosur 3.626 policë ndërkombëtarë, në mesin e të cilëve edhe 207 pjesëtarë të policisë kufitare, nga numri i përgjithshëm i paraparë prej 4.718 policësh. Në kuadër të këtij numri të tërësishëm ishte edhe një njësitë pakistanez (me 115 pjesëtarë të policisë speciale), dy njësite jordaneze (240 pjesëtarë) dhe dy njësite indiane (me 214 pjesëtarë). Në qershor të vitit 2000, forca policore ndërkombëtare mezi që kishte arritur t'i kishte 77% të numrit të kërkuar të policëve.¹⁴

Jo vetëm që zyrtarët e policisë së OKB-së arritën ngadalë, ata për më tepër edhe ishin të papërgatitur për t'i kryer detyrat të cilat i prisnin. Disa njësite madje u desht që të kthehen, për shkak të trajnimit joadekuat. Një numër i konsiderueshëm i tyre nuk ktheheshin fare pas pushimit me leje, ose ktheheshin prapa në vendet e tyre para afatit të paraparë. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, policia e UNMIK-ut ia arriti që gjithnjë e më tepër t'i mirrte përgjegjësitë e parapara. Ajo e zbatonte ligjin në rajonin e Prishtinës dhe të Prizrenit, si dhe në aeroportin e Prishtinës, mëpastaj, i kishte kompetencat e hetuesisë në Gjilan, Mitrovicë, Pejë si dhe në vendkalimet kufitare në Bllacë e Gllloboçicë. Ajo, po ashtu, i udhëhiqte objektet e burgut në Prishtinë dhe në Prizren. Megjithëkëtë, në rajonet e tjera, detyrat me karakter johetues zbatoheshin edhe më tutje nga ana e KFOR-it. Veprimet e përbashkëta të policisë së UNMIK-ut dhe të ushtarëve të KFOR-it, në veçanti në Mitrovicë, u jepnin forcë përpjekjeve të OKB-së.¹⁵

Formimi i shërbimit të ardhshëm vendor të policisë (SHPK), ishte përgjegjësi e UNMIK-ut. Trajnimi në shkollën e SHPK-së të drejtuar nga OSBE-ja, bëhej në koordinim dhe në veprim të përbashkët praktik me policinë e UNMIK-ut. Në janarin e vitit 2001, mbi 3.500 policë vendës të trajnuar do të jenë në gjendje të shërbejnë si pjesë integrale e forcave policore të UNMIK-ut. SHPK-ja, tash për tash, është institucioni i vetëm i shërbimit publik në Kosovë.

Siç shihet nga këto të dhëna, Bashkësia Ndërkombëtare nuk ia arriti ta ndërtojë një forcë policore prej 4.718 pjesëtarësh, ashtu siç ishte kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Në disa vende, qeveria qendrore e ka të ndaluar me Kushtetutë që ta dërgojë policinë e vet gjatë. Në disa vende të tjera, policia nuk është e stërvitur për përdorim të armëve të zjarrit, e kjo, nga ana tjetër, mund të jetë domosdoshmëri në situatat si ajo e Kosovës, ku ka ndasi të theksuara etnike dhe kriminalitet bandash. Në variantin më ideal, policia e OKB-së do të duhej t'i kishte disa stërvitje të specializuara, si përgatitje e tyre për të shërbyer në kuadër të OKB-së, në vendet kultura e të cilave është e ndryshme nga ajo e vendeve të tyre.

Forcat policore u ballafaquan me disa nga sfidat me të theksuara në Kosovën e pasluftës. Bashkësitë vendëse janë të mbërthyer në grackën e spirales së krimit.

Strukturat e mafias shqiptare janë duke vepruar në mënyrë aktive: ato arrijnë deri në Itali, e madje edhe në vende të Evropës Veriore. Trafiku i drogës dhe i prostitucionit të detyrueshëm është veprimtaria e tyre kryesore kriminale. Kjo është një çështje e cila duhet të futet në agjendat më të larta të OKB-së, dhe në veçanti të BE-së. Është e qartë që si UNMIK-u ashtu edhe KFOR-i, kanë nevojë për shërbime më të fuqishme të intelgjencës në terren.

Përvojat e Kosovës, dhe në veçanti mëkëmbja e ngadalshme dhe e mundimshme e policisë, e dëshmon nevojën për formimin e njësiteve policore të OKB-së, të cilat do të jenë në gatishmëri të përhershme, që do të bartin shenjat e qeverive të tyre, dhe që do të jenë në shërbim të Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo nuk është një ide e re. Komisioni konsideron që kjo është një çështje për së tepërmi urgjente, dhe ju bashkangjitet atyre që kërkojnë nga shtetet anëtare dërgimin e oficerëve dhe të njësiteve speciale të policisë, të domosdoshme që UNMIK-u ta realizojë mandatin e vet.

Sistemi efikas gjyqësor: Ende në mungesë

Njëri nga qëllimet kryesore të UNMIK-ut është krijimi i një administrate gjyqësore adekuate për Kosovën. Gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 2000, mbi 400 gjyqtarë, prokurorë dhe gjyqtarë porote e kanë dhanë betimin, mirëpo procesi i krijimit të sistemit gjyqësor është ende duke lëvizur me një shpejtësi kërmilli. Kjo vlen si për krimet ordinere, të cilat e kanë shënuar një rritje dramatike, ashtu edhe për krimet e luftës dhe për ato të kryera me motive etnike.

Deri më tash janë formuar Gjykata Supreme, pesë gjykata të qarkut, 17 gjykata komunale, një gjykatë ekonomike dhe 13 zyra të prokurorëve publikë. Ato janë furnizuar me automjete, tavolina, karrige, dollape, gjeneratorë, si dhe me regjistra, vula, letër dhe formularë. Deri në qershor të vitit 2000, sistemi gjyqësor i Kosovës i kishte 274 gjyqtarë, 40 prokurorë dhe 238 gjyqtarë porote, që ishin përzgjedhur nga një komision juridik këshilldhënës. Megjithatë, për shkak të konfliktit të vazhdueshëm etnik dhe të mungesës së prokurorëve e të gjyqtarëve ndërkombëtarë, nga njëra anë, si dhe për shkak të paqartësive lidhur me atë se cilat ligje duhet zbatuar, vështirë që mund të pretendohet që puna e sistemit gjyqësor është efikase dhe korrekte. Po ashtu, pagat e ulta kanë ndikuar që disa porofesionistë të kësaj fushe të korruptohen dhe të fillojnë të marrin rryshfete.

Krijimi i një sistemi demokratik të gjyqësisë penale është penguar, po ashtu, edhe nga

ngurrimi i pjesëtarëve nga radhët e minoriteteve që të hyjnë në ekipe, si dhe nga animet e shprehura hapur tek shumë gjyqtarë shqiptarë. Gjykimet korrekte të ngatërrese ndëretnike janë pothuaja të pamundshme. Shpesh herë është dashur që të arrestuarit të lirohen pas vetëm disa ditësh - në të shumtën e rasteve për shkak të mungesës së objekteve dhe të personelit. Në pothuaj 40% të rasteve, të arrestuarit lirohen menjëherë, dhe në këtë mënyrë përpjekjeve për vendosjen e rendit publik u jipet një goditje tepër e rëndë. Numri i të gjykuarve në shkurtin e vitit 2000 ishte 24, ndërkaq në majin e po të njëjtit vit ky u rrit në 367. Mirëpo, ende ka pengesa të shumta: objektet e dëmtuara të gjykatave, mungesa e laboratoreve të mjekësisë ligjore, si dhe mungesa e burgjeve. Shqetësimi lidhur me mundësinë që kriminelët dhe përdhunuesit e të drejtave të njeriut do të kalojnë pa u dënuar është në rritje e sipër.¹⁶

Që të gjitha këto vështirësi burojnë nga fakti se Rezoluta 1244 nuk e specifikonte se cili është ligji që duhet zbatuar në Kosovë në këto rrethana. Në fillim UNMIK-u vendosi që t'i aplikojë ligjet e Serbisë dhe të RFJ-së, ashtu që ta respektojë sovranitetin e RFJ-së në bazë të Rezolutës 1244. Shqiptarët e Kosovës reagueshan për ndaj këtij veprimi, duke kërkuar rikthimin e ligjeve që kishin qenë në fuqi deri më 1989, e të cilat ishin miratuar nga legjislatura e asaj kohe e cila përbëhej nga shumica shqiptare. Kjo shkaktoi që UNMIK-u ta ndryshojë përkushtimin, dhe ta marrë vendimin për aplikimin e ligjeve të Kosovës ashtu siç ato ishin deri më 1989. Pas kësaj, gjyqtarët serbë kishin edhe me pak gatishmëri që të hyjnë në shërbim. Shumë nga ligjet e vjetra ishin përpiluar në bazë të koncepteve socialiste, dhe, po ashtu, ishin edhe disa lloje të ligjeve që kishin hyrë në fuqi më 22 mars 1989, duke i përfshirë këtu edhe ligjet e RFJ-së.

Duke e synuar kthimin e besimit tek gjykatat e Kosovës, në shkurtin e vitit 2000, UNMIK-u e kërkoi emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve ndërkombëtarë. Gjatë shtatorit të vitit 2000, u emëruan gjashtë gjykatës dhe dy prokurorë të jashtëm. Kjo u bë me shpresë që në këtë mënyrë do të tejkalohet ngadalsia dhe njëanshmëria e sistemit gjyqësor, mirëpo efektet e këtij veprimi do të mund të shihen vetëm në të ardhmen. Po ashtu, është edhe një mungesë serioze e avokatëve të specializuar - numri i avokatëve për mbrojtjen e të dyshuarve nuk është më i madh se 150. Çfarëdo përpjekje e ndonjë OJQ-je për të ofruar ndihmë juridike në aftësimin e këtyre avokatëve do të ishte e mirëseardhur.

Plani i Dr. Kushnerit për formimin e një gjykatë speciale e cila do të mirrej me krimet e luftës nuk mund të realizohet, po qe se Kombet e Bashkuara nuk e miratojnë buxhetin e nevojshëm prej 5 milionë dollarësh, si dhe 10 milionë dollarë shtesë për shpenzimet operationale.

Imponimi i ligjit dhe i rendit

UNMIK-u pati sukses në zëvendësimin e kaosit të cilin e gjeti në fillim të veprimit të vet me diçka që i përngjasonte rendit. Rregullorja e parë e Administratës e cila u miratua në korrik 1999, “të tërë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, duke e përfshirë edhe administratën e gjyqeve,” ia jipte Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Në bazë të këtyre kompetencave, Dr. Kushneri e bëri demobilizimin e UÇK-së si dhe shpërndarjen e strukturave paralele të përkohshme të vetëqeverisjes të krijuara nga UÇK-ja dhe udhëheqja e saj politike, menjëherë pas hyrjes së forcave të NATO-s.

UNMIK-u është një eksperiment unik në çështjet ndërkombëtare. Ka më shumë pushtet se çdo mision tjetër i mëparshëm i OKB-së, shumë më tepër sesa pushteti që i ishte dhënë Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje e Hercegovinë. Kushneri dhe zyrtarët e tij mund ta përdorin këtë pushtet sipas pikëpamjeve të tyre, t’i emërojnë e t’i shkarkojnë zyrtarët shqiptarë, të vendosin se cilat ligje mund të aplikohen dhe cilat jo, dhe të japin veto, nëse ketë e shohin të arsyeshme, në vendimet që do të mirren nga organet e zgjedhura në të ardhmen. Kur tërë kësaj i shtohet kompleksiteti i shoqërisë bashkëkohore, është pothuaj e pamundur të zbatohet politika dhe të ruhet legjitimiteti, pa ndonjë bashkëpunim dhe mirëbesim nga ekspertët vendës dhe nga personat me ndikim.

Udhëheqësit politikë lokalë u përfshinë në procesin politik, mirëpo vetë ky proces ishte i pasigurtë. UNMIK-ut, me një personel të pakët të cilin e kishte kur erdhi, në fillim iu desht të ballafaqohet me strukturat e fuqishme të UÇK-së. Drejtuesit e përkohshëm të komunave kundërshtonin t’u nënshtroheshin të huajve. Në tetorin e vitit 1999, UNMIK-u e kishte vetëm nga një zyrtar të OKB-së në çdo komunë. Aty ku zyrtarët e OKB-së e kishin një qëndrim më të kujdesshëm dhe këshilldhënës përnga natyra dalngadalë erdhi deri tek bashkëpunimi; ndërkaq, kur ata kishin qëndrim të patundur, si pasojë shfaqej konfrontimi. Ndodhte madje që të vihej në pyetje përshatshmëria e ndonjë nëpunësi të OKB-së për ta administruar ndonjë qytet, dhe në këtë mënyrë shkaktroheshin fërkime edhe me të mëdha sesa ato politike a personale. OKB-ja e kishte një atu të fuqishëm që buronte nga fakti se ajo ofronte rrugë drejt fondeve dhe kontakteve me botën e jashtme. Kjo atu shpeshherë ka qenë vendimtare në rastet kur paraqiteshin konflikte rreth pushtetit administrativ.

Me qëllim të realizimit të mandatit të UNMIK-ut për zhvillimin e “institucioneve të përkohshme demokratike të vetëqeverisjes,” Kushneri e themeloi Këshillin Tranzitor të Kosovës (KTK), një komitet ekzekutiv ky, i përbërë nga figurat udhëheqëse politike

vendëse. Ndonëse i tërë pushteti ishte në duart e udhëheqësit të UNMIK-ut, ky Këshill kishte funksion keshilldhënës, duke e përfshirë në këtë mënyrë udhëheqjen politike të Kosovës në procesin e dialogut dhe të ndërtimit të paqes. Përbërja e zgjeruar, 36-anëtarëshe, e KTK-së, takohej secilën javë nën drejtimin e PSSP. Bashkësia serbe ngurronte të mirrte pjesë, ndonëse serbët e Ulpianës dhe të Graçanicës, të përfaqësuar nga Peshkopi Artemije bashkëpunonin dhe merrnin pjesë në mbledhje. Megjithëkëtë, serbët e Graçanicës kohë pas kohe tërhiqeshin, për të protestuar kundër sulmeve të vazhdueshme që u bëheshin pjesëtarëve të grupit të tyre etnik. Serbët e Mitrovicës veriore refuzuan t'i bashkoheshin Këshillit, mirëpo udhëheqja e tyre takohej ndaras me përfaqësuesit rajonalë të UNMIK-ut, si dhe me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar të pjesës jugore të Mitrovicës.

Më 15 dhjetor 1999, UNMIK-u e themeloi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative (SPPA). Kjo strukturë ishte një kornizë e cila i ndante përgjegjësitë rreth administrimit të përkohshëm me përfaqësuesit e të tërë shoqërisë kosovare. Nga ky organizëm u themelua, mëpastaj, Këshilli i Përbashkët i Përkohshëm Administrativ (KPPA), i cili funksiononte si organ ekzekutiv. KPPA-ja e miratoi themelimin e 20 departamenteve, secili prej të cilëve udhëhiqej nga dy drejtues, njëri ndërkombëtar dhe tjetri vendës. Në bazë të Marrëveshjes se Dhjetorit, të gjitha strukturat paralele, qoftë ekzekutive, legjislativ apo gjyqësore, do të shpërbëheshin më 31 janar 2000. Kjo kërkesë u plotësua në muajin shkurt. Në vazhdim, KPPA-ja e themeloi Komisionin Qendror Zgjedhor, Regjistrin Civil, si dhe Komisionin për zbulimin dhe identifikimin e viktimave.

Një tipar i rëndësishëm i përparimit të vendësve në iniciativat demokratike në periudhën pas konfliktit, ishte gjithsesi përfshirja e femrave në vendimmarrje dhe në procesin udhëheqës. Ky ishte, në fakt, një pjesë e theksuar qartë në mandatin aktual të OKB-së. Në “Rekomandimet për Zbatimin e Mëtejme të Platformës për Veprim të Pekinit,” dokument ky i Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Gruan që u mbajt në vitin 2000, dhe të asaj Pekini + 5, e cila u mbajt në qershor 2000 në Nju Jork, nga OKB-ja dhe anëtarët e saj, si dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare, kërkohej që të “ofrojnë mbështetje dhe ta aftësojnë gruan, e cila e ka një rol të rëndësishëm në familje, që të jetë një faktor stabiliteti gjatë konflikteve si dhe në situatat pas konflikteve.” Pos kësaj, kërkohej që OKB-ja t'i inkurajojë shtetet e saj anëtare si dhe pjesën tjetër të Bashkësisë Ndërkombëtare që “ta përmirësojnë dhe ta forcojnë aftësinë e femrave të goditura në situatat e konflikteve të armatosura, duke i përfshirë këtu, në mes tjerash, edhe refugjatet dhe femrat e zhvendosura, duke i angazhuar ato në përpilimin dhe në udhëheqjen e aktiviteteve humanitare, ashtu që ato të përfitojnë nga këto

aktivitete po aq sa edhe meshkujt.” Komisioni është i bindur që një politikë e tillë duhet të reflektohet edhe në punën e UNMIK-ut, si dhe në të gjitha situatat e tjera të përgjigjeve ndaj konflikteve të armatosura në të ardhmen.

Është arritur, po ashtu, një përparim i konsiderueshëm edhe në formimin e organeve administrative. Deri në fund të majit 2000, u formuan 27 këshilla komunale, nga gjithsej 30, dhe po aq borde administrative komunale. Në këtë proces, si edhe në shumë të tjerë, çështja më brengosëse ishte pjesëmarrja e kufizuar e bashkësive minoritare. Serbët, turqit, romët dhe boshnjakët e Kosovës nuk janë të gatshëm të angazhohen në pozitat komunale administrative. Krijimi i strukturave përfaqësuese komunale ishte posaqërisht i vështirë në Mitrovicë.

U themelua, po ashtu, një Institut i Administratës Civile, si institucion i cili e kishte për detyrë aftësimin për punë në sektorin publik. Pesë qendra partiake e ofrojnë qasje në infrastrukturën themelore si dhe komunikimet më të lehta për të gjitha partitë e tjera. Përgatitjet për zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen në vjeshtë kanë filluar që nga prilli 2000. Deri me 1 korrik, për pjesëmarrje në zgjedhje janë regjistruar 28 parti politike, fakt ky që është një tregues i trendit kah rritja e pluralizmit ndëretnik në skenën politike të shqiptarëve të Kosovës. Të drejtën e pjesëmarrjes në votime e kanë përafërsisht 1,2 milionë kosovarë. Megjithatë, mosbesimi i serbëve ndaj procesit politik, ka shkaktuar që ata të ngurrojnë për t'u regjistruar për zgjedhje. Zyrtarët e OKB-së dhe të OSBE-së janë duke i vazhduar përpjekjet dhe duke bërë trysni që në zgjedhje të marrin pjesë edhe “serbët e Graçanicës,” dhe edhe “serbët e Mitrovicës,” mirëpo pjesëmarrja e tyre është ende e pasigurtë. Ky ngurrim i serbëve është një parashenjë e zymtë për zgjedhjet e përgjithshme me 2001. Disa zyrtarë të OKB-së shprehin frikë që zgjedhjet mund t'i ngurtësojnë ndasitë etnike, në vend që t'i zbusin ato, ashtu siç ndodhi në Bosnje e Hercegovinë.

Edhe pse Kosova nga aspekti formal nuk ka pasur zgjedhje të lira asnjëherë, shqiptarët e Kosovës tashmë i kishin pas vetes dhjetë vjet përvoja të organizimit të zgjedhjeve dhe të referendumeve për institucionet e tyre paralele. Sot, si protektorat, Kosova e ka një formë të qeverisjes e cila nuk është fare demokratike: megjithëse qytetarët mund t'i zgjedhin si pushtetarët lokal, ashtu edhe ata në nivel të Kosovës, ata nuk e kanë mundësinë ta thonë fjalën e fundit kur të shtrohet çështja e statusit final. Kur Bashkësia Ndërkombëtare erdhi në Kosovë, aty ajo hasi në një entuziazëm të jashtëzakonshëm lidhur me perspektivat për rindërtimin e Kosovës. Tash ky është zëvendësuar me frustrimet në shtresa të gjera të popullatës, të shkaktuara nga pengesat për vetëqeverisje. Këto frustrime nuk do të mund të zvogëlohen, po që se nuk do të arri-

het një përfshirje më e gjerë e kosovarëve (si e shqiptarëve, ashtu edhe e të tjerëve) në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Suksesi më i madh të cilin UNMIK-u e arriti ishte demilitarizimi i UÇK-së. Më 21 qershor 1999, KFOR-i dhe UÇK-ja e nënshkruan Angazhimin për Demilitarizimin e Forcave Shqiptare të Kosovës, të cilat numëronin rreth 20.000 veta. UÇK-ja do të transformohej në një organizatë civile, me emrin Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), dhe e cila do ta kishte për detyrë që të ofrojë shërbime në rastet emergjente si dhe në rindërtim. Iniciativa për demobilizim u ofronte pjesëtarëve individual të UÇK-së mundësinë që t'i bashkangjiteshin TMK-së.

Demilitarizimi përfundoi me 20 shtator 1999. Në po të njëjtën ditë, u themeluan Trupat Mbrojtëse të Kosovës. E modeluar sipas French Securite Civile, TMK-ja parashihet t'i ketë 3.000 pjestarë, si dhe një degë ndihmëse me 2.000 të tjerë. Dhjetë për qind të pjestarëve në përbërjen e saj duhet të jenë pjestarë të bashkësive minoritare. Vetëm 200 pjestarë janë të autorizuar që të bartin armë. TMK-ja nuk do të përdoret në rastet e trazirave, për operacionet anti-terroriste, ose për detyrat që kanë të bëjnë me rajtjen e ligjit dhe të rendit.

Nën mbikëqyrjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM), përzgjedhja për pozita në TMK filloi në vjeshtën e vitit 1999. IOM-i i intervistoi mbi 18.500 ushtarë të UÇK-së. Mbi 500 vendet e parapara për pjestarët e minoriteteve ngelën të zbrazëta, meqë nuk u paraqit asnjë serb. Të gjithë kandidatët i nënshtroheshin provimit për shkathtësi të ndryshme dhe, po ashtu, verifikoheshin për vepra penale. Mëpastaj, IOM-i e koordinoi aftësimin e TMK-së. Luftëtarët e dikurshëm të gueriles filluan të ndiqnin kurse për ndërtimtari, instalime elektrike, transport, furnizim dhe mirëmbajtje, si dhe për udhëheqje të përgjithshme. Njëkohësisht, ata aftësoheshin edhe për aktivitete më të avancuara, si misionet e shpëtimit në rastet e katastrofave, të vetëdijsimit për rreziqet nga minat, mbrojtjes civile, për të drejtat e njeriut dhe për ndihmën e parë.

Me 21 janar të vitit 2000 u bë inaugurimi zyrtar i TMK-së. Deri në fund të majit, numri i pjesëtarëve të TMK-së arriti në 4.542. Vetëm 53 prej tyre ishin nga grupet minoritare. Të gjithë pjesëtarët ishin me status provues prej një viti. TMK-ja përbëhej nga pesë njësi fikse rajonale për reagim të shpejtë, nga një për çdo sektor të KFOR/UNMIK-ut, si dhe nga njësia mobile e reagimit të shpejtë. Mbi 2.000 pjestarë të TMK-së u angazhuan në projekte të ndryshme punuese, çfarë ishin grumbullimi i mbeturinave, riparimi i rrugëve, rindërtimi i shkollave, ndërtimi i furrave të bukës, apo edhe i serrave. Planifikohej që TMK-ja ta përfundonte projektin e aftësimit të

plotë, të furnizohej me paisje dhe të operacionalizohej deri në shtatorin e vitit 2000. Do të kishte qenë naive të pritej që UÇK-ja do të heq dorë lehtë nga ambicja për të qenë ushtri e ardhshme e Kosovës së pavarur. Nga ana tjetër, KFOR-i - nën mbikëqyrjen ditore të të cilit vepron TMK-ja - ka interes të qartë që ta pengojë ish UÇK-në për t'u shndërruar në ndonjë lloj Talibani kosovar, i cili do të mund të kthehej kundër ish-mentorëve të saj. Zbulimi, nga mesi i qershorit, i një bunkerit të madh armësh në Kleçkë, në afërsi të shtabit të ish-gjeneralit të UÇK-së, Çekut, tash kryekomandant i TMK-së, ishte treguesi më i mirë për rrezikun potencial të ndonjë konflikti të ardhshëm.

Kthimi i refugjatëve

Kthimi i refugjatëve ishte njëri nga qëllimet dhe rezultatet kryesore të misionit të UNMIK-ut. Nga 848.000 njerëzit të cilët ishin detyruar me forcë që të largoheshin nga Kosova, shumica u kthyen vetë, duke nxituar pas njësiteve të KFOR-it. Megjithë frikën që një numër i refugjatët do të mund të vdiste, meqë do të duhej të përballeshin me të ftohtit e dimrit që po vinte, përpjekjet të cilat u bënë mundësuan që një rrezik i tillë të shmangej në tërësi.

Viktimat e spastrimit tjetër etnik - rreth 100.000 serbët që u larguan nga rajoni menjëherë, ose që u detyruan të largoheshin pas arritjes së KFOR-it - janë ende në Serbi dhe në Mal të Zi. Është përshtypja që kushtet e sigurta të cilat do ta bënin kthimin e tyre të papenguar të mundshëm, nuk do të mund të krijohen për një të ardhme të afërt. Po ashtu, ende nuk janë krijuar kushtet përkatëse për kthimin e detyrueshëm të refugjatëve nga Evropa Perëndimore.

Pasi që nevojat e ndihmës emergjente u përmbushën me sukses, në fundin e qershorit 2000 pushoi së vepruari shtylla për çështjet humanitare, e cila ishte njëra nga përbërësit formal të strukturës së UNMIK-ut. Megjithëkëtë, UNHCR-i do të vazhdojë edhe më tutje që ta ketë një angazhim të fuqishëm në Kosovë. Koordinatorit për çështjet humanitare do të ndihmojë në kalimin nga programi i ndihmave, në një program më afatgjatë të rindërtimit dhe të zhvillimit. Në dritën e përvojave të Kosovës, Bashkësia Ndërkombëtare duhet që urgjentisht ta rrisë mbështetjen e aktiviteteve të UNHCR-së.

Një numër i madh i refugjatëve janë ende në listat e të zhdukurve ose nëpër burgjet e

Serbisë. Ky mosrespektim ndaj tyre burimin e ka në mospërfshirjen e tyre në Rezolutën 1244. Në bazë të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), numri i shqiptarëve të Kosovës në burgjet e Serbisë më 21 mars të vitit 2000 ishte 1.571, dhe këta po mbaheshin nëpër këto burgje për “veprimtari armiqësore” ose për vepra të tjera të ngjashme. Disa prej tyre ishin gjykuar e denuar, disa e prisnin gjykimin ende, ndërkaq disa ishin liruar pas pagesave që i kishin bërë familjet e tyre. KNKK vlerëson se në listën e të zhdukurve janë 3.000 persona, shumica prej tyre shqiptarë. Vlerësimet e tjera pohojnë që numri i personave të zhdukur është shumë më i madh. Komisioni i UNMIK-ut për Zbulimin dhe Identifikimin e Viktimave është duke punuar që të bëjë diçka për ndriçimin e fatit e tyre.¹⁷

Rrindërtimi i ekonomisë

Bota e mban në mend fare mirë se çfarë gjetën KFOR-i dhe UNMIK-u me të arritur në Kosovë:

Rrugë të zbrazëta. Dyqane të shkatërruara. Pa ujë. Pa punë. Gërmadha në tym. Vrasje në rrugë. Kufoma dhe grumbuj plehërash. S'mund të bleje gazetë, madje as edhe bukë. Nuk kishte fëmijë fare nëpër shkolla. Arat të pasigurta për t'u punuar. Shumica e bagëtisë e humbur. Një vend pa zot.¹⁸

Kosova ishte njëra nga krahinat më të varfëra në njërin nga vendet më të varfëra të Evropës. Sikur edhe në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, pas Titos kjo ka vuajtur nga mungesa e efikasitetit të sistemit të ashpër komunist, i cili u tregua i paaftë që ta reformonte veten, madje edhe pas rënies së Murit të Berlinit. Dhe pas kësaj të tërës, vendi u shkatërrua edhe më tepër nga lufta.

Kur UNMIK-u dhe Bashkëpunimi Civil e Ushtarak (CIMIC), në trajtë të kontigjenteve të ndryshme të KFOR-it, si dhe Grupi Special i BE-së,¹⁹ e bënë një vizitë hulumtuese në Kosovë, këto konstatuan se 120.000 shtëpi ishin ose të dëmtuara ose të shkatërruara nga lufta; 250 objekte shkollore kishin nevojë për riparim; sistemi i kujdesit shëndetësor si dhe sistemi bankar ishin shkatërruar; rrugët ishin të prishura; urat ishin të shkatërruara; nuk kishte rrymë elektrike; nuk kishte shërbime postare, ndërkaq linjat telefonike ishin të rrëzuara.

Pas qershorit 1999, gjendja filloi të përmirësohet dukshëm. Shumë shpejt u bënë përpjekje të mëdha për t'i ngritur pullazet e shtëpive dhe për ta bërë riparimin e tyre, e

po ashtu, edhe për t'i riparuar shkollat dhe spitalet. Një numër i madh i qeverive, i organizatave ndërkombëtare, dhe i OJQ-ve ndau fonde për aktivitetet e rindërtimit dhe kjo bëri që fillimi të jetë mbresëlënës:

Në shkollat e pajisura me dhjetëra mijëra banka, karrike dhe çanta shkollore, tash mësimin e vijnë tetëdhjetë e gjashtë për qind e nxënësve. Tekstet e reja shkollore u botuan në gjuhët shqipe, serbe, boshnjake dhe turke. Kishte filluar, po ashtu, projekti për planprogramin e sistemit arsimor në Kosovë. U bë hapja e Universitetit dhe e shkollave të larta.

Në një masë të madhe është riparuar edhe infrastruktura fizike. Në sektorin e energjetikës u investuan mbi 150 milionë DM, dhe po bëhej, po ashtu, edhe mirëmbajtja e rrjetit të ujit. Megjithatë, në Prishtinë rrymë ka vetëm nga tri orë gjatë ditës, ndërsa ujë vetëm nga katër orë. Rrjeti i telefonisë mobile i mbulon katër qytete dhe aeroportin e Prishtinës; është duke u riparuar edhe rrjeti i vjetëruar telefonik. Televizioni dhe Radioja emetojnë program përsëri.

Shërbimet postare u riaktivizuan me ndihmën e BE-së. Agjencioni Evropian për Rindërtim ka dhuruar automjete të cilat shërbejnë si stacione pune, faks dhe aparate fotokopjimi, orendi të tjera, peshore dhe karroca dore. Pullat postare të UNMIK-ut dolën në shitje më 15 mars 2000. Shërbimi ndërkombëtar postar u riaktivizua në qershor të vitit 2000.

UNMIK-u, FAO dhe Banka Botërore e kanë filluar projektin e madh për revitalizimin e veprimtarisë bujqësore. Për sezonin e mbjelljeve pranverore fshatarëve iu shpërndanë plehëra kimike dhe farëra të grurit, patates, misrit dhe të perimeve. Pritej që rendimentet e grurit në korrik do t'i plotësojnë 65% të nevojave të popullatës.

Është themeluar edhe Autoriteti Qendror Fiskal si dhe Zyra e veprimtarisë Bankare dhe e Pagesave (e cila vepron si Bankë Qendrore). Janë licencuar disa banka komerciale dhe institucione mikro-kredituese. Marka gjermane është legalizuar si valutë zyrtare.

Shprehja "gjallëri," megjithatë, nuk e përshkruan në tërësi as gjendjen ekonomike dhe as disponimin. Megjithë pohimet e UNMIK-ut që rreth 70% të ndërmarrrjeve private e kanë rifilluar veprimtarinë e tyre, e të cilat prodhojnë më shumë prodhime dhe punësojnë më shumë punëtorë sesa që prodhonin e punësonin në vitin 1998, nuk mund të mohohet fakti që ky sektor është mjaft modest. Sektori i vetëm efikas ekonomik është tregu i zi, i cili është në lulëzim e sipër. Privatizimi ka bërë një përparim të ngadalshëm – e kjo ndoshta edhe është e mirëseardhur, megjë nga ky do të përfitonte vetëm struktura ekzistuese mafioze. Pritet që të zhvillohet një sistem efikas

i tatimeve, dhe UNMIK-u duhet të presë një kohë përdërisa të hyrat e brendshme të barazohen me shkallën e lartë të shpenzimeve.

Kriza e vazhdueshme e shkaktuar nga papunësia është njëra nga sfidat më të mëdha të ekonomisë kosovare. Vendi e ka shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë: mbështetur në shumicën e vlerësimeve, kjo shkallë arrin në mbi 50%. Dhe kjo do të vijë duke u rritur gjithnjë e më shumë, sa më i madh që të jetë numri i refugjatëve që do të kthehen nga jashtë. Zhvendosja e popullatës nga zonat rurale nëpër qytete e ka ngatërruar problemin e papunësisë urbane edhe më tepër. Strategjitë për ta luftuar papunësinë në Kosovë duhen hartuar urgjentisht. Një projekt publik për spastrimin e rrënojave të mbetura nga lufta, si dhe për pastrimin e plehërave, do të mund ta siguronte një numër të madh të vendeve të punës për kosovarët e papunë.

Është e natyrshme që një rimëkëmbje më e shpejtë nënkupton përpjekje shumë më të përqendruara dhe më dashamirëse nga ana e bashkësisë së donatorëve ndërkombëtarë, në veçanti nga Bashkimi Evropian. Për momentin, UNMIK-u është në gjendje të dobët sa i përket fondeve.

Mbështetja e jashtme financiare

Bugjeti i konsoliduar i Kosovës për vitin fiskal 2000 e arrin shumën prej 562 milion DM. Premtimet e donatorëve janë përmbushur vetëm pjesërisht – janë premtuar 200 milionë DM, por, në fakt, deri në fillimin e qershorit të vitit 2000 kanë arritur vetëm 149 milionë.²⁰ Është pritur që të hyrat që sigurohen nga burimet e brendshme do të arrijnë deri në 49 milionë DM. Në këtë mënyrë edhe erdhi deri te një mungesë e madhe e mjeteve. Nevojat e kosovarëve për para të gatshme ishin të plotësuara vetëm për periudhën deri në shtator 2000.

Bilanci që ka të bëjë me nevojat e përgjithshme të ndërtimitarisë është po ashtu modest. Vlerësohet që programi i gjithmbarshëm për rindërtim do të kushtojë 2 miliardë DM, pa i llogaritur fare shpenzimet e tjera të domosdoshme. Fondet e premtuara nga donatorët janë 2,6 miliardë DM, ndërsa ato të realizuarat janë 1,2 miliard DM. Këto mungesa janë theksuar edhe në vërejtjet e bëra nga Sekretari i Përgjithshëm:

Një numër i nevojave që e kanë prioritetin më të lartë, kanë ngelur pa mbulesë fondesh, duke i përfshirë këtu rehabilitimin e objekteve të gjykatave, shkollave, spitaleve dhe objekteve të tjera publike; zhvillimin e sistemit dhe të objekteve të ndryshme të nevojshme për grumbullimin e

mbeturinave dhe për pastrimin e ambientit; dhe, po ashtu, të atyre për zhvillimin e resurseve njerëzore vendëse.

Një paqe e qëndrueshme në rajonin e Kosovës varet nga përparimi i saj i ardhshëm. Rimëkëmbja ekonomike është parakusht si për qetësi shoqërore, ashtu edhe për bashkjetesë. Sido që të jetë, pikërisht për këtë edhe nevojitet ndihma e vazhdueshme me fonde ndërkombëtare, qoftë për misionin e OKB-së, qoftë për rindërtimin e vendit.

Shtetet anëtare të OKB-së, për fat të keq, kanë qenë shumë të ngadalshme në përbushjen e obligimeve të tyre për ta paguar pjesën prej 125 milion dollarësh, sa nevojiten për këto veprime. Kjo ka ndikuar në reputacionin e UNMIK-ut, ashtu që ky të duket pothuaj si një operacion josolvent, një i cili mezi arrin t'i paguajë faturat e tij, gjë kjo e cila edhe i ka dobësuar atutë e tij në raport me palët vendase.

Shtetet e Bashkuara kanë preferuar që ndihmën plotësuese ta orientojnë në mënyrë bilaterale, duke u përqendruar në prioritetet e Washingtonit, çfarë ishte transformimi i UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Bashkimi Evropian, nga ana e tij, ka premtuar mjete substanciale – donacionet e përgjithshme për vitet 1999 dhe 2000 arrijnë në 825 milionë euro. Kësaj shume duhet t'i shtohet edhe ndihma bilaterale e shteteve anëtare. Në fakt, BE-ja dhe shtetet anëtare të këtij asociacioni e kanë dhënë pjesën më të madhe të mbështetjes financiare. Javier Solana, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit, si dhe Përfaqësues i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të BE-së, në Këshillin e Sigurimit deklaroi që ata, që nga viti 1991, kanë kontribuar me mbi 17 miliardë euro në të tërë Ballkanin. Vetëm në Kosovë ata kanë shpenzuar mbi 3 miliardë në programet joushtarake, si një mbështetje plotësuese në angazhimet e tyre plotësuese, ku përfshihet provizionin prej 28.000 trupave në kuadër të KFOR-it, si dhe 1.700 policë.

Megjithatë, procedurat e ngadalshme në procesin e miratimit në mekanizmat e BE-së, e kanë penguar në një masë të madhe dërgimin e shpejtë të mjeteve për të cilat nevojat ishin urgjente. Janë premtuar me miliona euro, mirëpo këto nuk janë shpërndarë fare. Vonesat janë shkaktuar pjesërisht edhe për shkak të faktit që ministrat e financave të BE-së ankoreshin se po jipnin kontribute bugjetore për një entitet i cili nuk mund të kuptohet si shtet në kuptimin të cilin shteti e ka. Ky refuzim ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë që UNMIK-u të mos jetë në gjendje t'i përmbushë detyrimet e veta financiare në fondin e vitit 1999. Procedurat e BE-së në ndërkohë u përshpejtuan, duke e bërë procesin e aprovimit më efikas, mirëpo pengesat, megjithatë, ishin të pranishme edhe më tutje. Shkaku i parë ishte që Komisioni Evropian e kishte vlerësuar se nevojat e Kosovës për ushqime deri në vitin 2006 e arrijnë shumën 6 miliardë euro; ndërkaq, kjo shifër nuk pajtohet me shifrën e dhënë nga ministrat e financave

të BE-së. Shkak tjetër është ai që Agjencia Evropiane për Rindërtim kontrollohet nga dy komitete administrative, njëri në Prishtinë, dhe tjetri në Bruksel. Kjo krijon vendime të dyfishta për të njëjtat çështje, dhe, rrjedhimisht, edhe paqartësi rreth asaj se cili prej dy vendimeve është për t'u zbatuar. Për më tepër, qëndrimet e tyre duhet të jenë në pajtim me 80 rregullore të ndryshme të BE-së. Meqë disa nga komitetet takohen hiç më shpesh se vetëm një herë në muaj, është e qartë që kjo shkakton vonësa plotësuese. Udhëzimet e reja të cilat komisionet administrative do të mund t'i kufizonin vetëm në orientimet strategjike, mirëpo jo edhe në aspektin mikroekonomik, janë për së tepërmi të nevojshme. Agjencioni Evropian për Rindërtim, me qendër në Prishtinë, kontrollohet nga një Komitetet Administrativ i cili përbëhet nga pjesëtarë nga të gjitha 15 shtetet anëtare. Në këtë mënyrë, burokracia e Brukselit bëhet pengesë jo vetëm për rindërtimin e Kosovës, por edhe për rimëkëmbjen e të tërë rajonit të Ballkanit. Pakti i Stabilitetit²¹ i ka bërë disa përparime, mirëpo është ende shumë larg nga ajo të cilën popujt e Ballkanit janë duke e pritur prej tij.

Banka Botërore i ka organizuar disa konferenca të donatorëve. Në të parën (28 korrik 1999) u premtuan 2,1 miliard dollarë; 1 miliard tjetër u premtua në konferencën e dytë (17 nëntor 1999). Në mars të vitit 2000, donatorët u pajtuan që t'i japin 2,4 miliard euro, të destinuar për projektet më urgjente. Mirëpo, edhe kësaj here, burokracia e ngathë vazhdoi që ta frenonte efikasitetin e programeve për rindërtim. Siç e tha përfaqësuesi i Bankës Botërore për Ballkanin, Lory O'Sullivan, mjete të mjaftueshme financiare ka, mirëpo: "tash e tutje, çështja është vetëm tek jetësimi."

Sfidat ekonomike janë për së tepërmi të mëdha. Fondet e premtuara për rimëkëmbjen e Kosovës nuk arritën shpejtë, kështu që arsimtarët kosovarë, nëpunësit civil vendës, si dhe punëtorët shëndetsorë ngelën pa u paguar fare. Për stimulimin e ekonomisë nevojiten ndërmarje të reja: në të kundërtën, ekonomia nuk do t'ia arrijë fare që të ngritet në këmbët e veta. Një burokraci me përmasa gjigante është duke e penguar pothuaj çdo nismë ekonomike, e të cilat, nga ana tjetër, janë duke u përkrahur nga vetë Bashkësia Ndërkombëtare. BE-ja në veçanti, duhet t'i rishikojë dhe rishqyrtojë procedurat e saj për aprovimin e granteve, dhe duhet, po ashtu, të lëvizë më shpejt në drejtimin e realizimit të qëllimeve të Paktit të Stabilitetit. Nismat ekonomike duhet ta vënë në pah faktin që problemi i Kosovës mund të zgjidhet vetëm në kuadër të kontekstit më të gjerë rajonal të bashkëpunimit ndërballkanik, duke mundësuar krijimin e lidhjeve më të forta, si ekonomike ashtu edhe politike.

Sfidat më të mprehta ekonomike të Kosovës nuk burojnë nga dëmet e luftës të shkaktuara qoftë nga forcat jugosllave, ato serbe apo edhe nga bombat e NATO-s, por nga

dekada të tëra të ngecjes në zhvillimin ekonomik. Për këtë shkak, politika e Programit të Bankës Botërore e hartuar për Kosovën, në një kohë kur mund të paraqiten probleme, dhe, rrjedhimisht, edhe pakënaqësi të reja të shkaktuara nga moszhvillimi, i pasqyron pikërisht ato reforma ekonomike dhe politike të cilat i nevojiteshin Jugosllavisë në vitet 1980. Shumë nga synimet politike të programit ndërkombëtar kërkojnë me tepër shumëllojshmëri ekonomike, dhe nivel më të lartë menaxherial sesa ky që është i pranishëm tash. Një çorientim i tillë që i shkaktohet ekonomisë vendëse nga veprimet ndërkombëtare - e i cili është i njohur mirë edhe nga misionet paqeruajtëse të organizuara me parë - e bën nevojën për reforma edhe më urgjente.

Shqetësimi më i madh është i shkaktuar nga kriminalizimi i ekonomisë dhe nga rritja e pushtetit të mafias. Kontrabanda, tregtia me drogë dhe trafikimi me njerëz janë që të gjitha veprimtari që kanë marrë hov. Këto zhvillime e dezorientojnë ekonominë kosovare, dhe do të jenë së tepërmi të vështira për t'u eliminuar.

Pos kësaj, çlirimi nga forcat jugosllave të sigurimit nuk e ka ndryshuar logjikën e sjelljes politike: me fjalë të tjera, edhe më tutje është i pranishëm konceptimi që forca mbështetet në kontrollimin e pasurive ekonomike, duke i përfshirë këtu mundësitë për patronazh të vendeve të punës. Dhe, është më me gjasë që kjo lloj gare do të intensifikohet sesa që do të ndërpritet.

Raportet e Kosovës me Serbinë, pavarësisht nga ajo se çfarë do të jetë statusi final i Kosovës, duhet t'i përfshijnë edhe marrëdhëniet ekonomike. Që të dyja vendet gjeografikisht janë të mbyllura. Që të dyjat janë të varfëruara nga politikat e viteve 80-të, si dhe nga luftat dhe sanksionet e viteve 90-të. Megjithë dobësimin aktual të ekonomisë së Serbisë, ajo mbetet fqinji më i pasur i Kosovës. Kjo don të thotë se marrëdhëniet e mira ndërmjet të dy popullatave do të jenë të domosdoshme për një autonomi të mirëfilltë të Kosovës apo për pavarësi. Varësia nga ndihmat e Bashkësisë Ndërkombëtare dhe jo Jugosllavia, nuk do t'përmirësojë perspektivat e Kosovës. Dhe, mbi të gjithat, një politikë ekonomike në tërësi e re për Kosovën do të jetë e domosdoshme për t'i nxitur ndryshimet në strukturën sociale dhe në sjelljet politike, gjë kjo e cila është e një rëndësie shumë të madhe për krijimin e një regjimi tolerant dhe demokratik në Kosovë.

Përfundim

Kosova së bashku me Bosnjen janë edhe me tutje zonat më të ndjeshme në Evropë. UNMIK-u e ka bërë një punë të shkëlqyer, por edhe më shumë mbetet për tu bërë në të ardhmen.²² Siç e theksoi Karl Bildt, i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm për Ballkanin, “atje ende më tepër sundojnë bandat sesa që sundon ligji.”²³ Paqartësitë kryesore politike dhe ekonomike lidhur me të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë, e paraqesin një pengesë tepër të madhe. Aq më tepër, arritja e paqes së mirëfilltë do të jetë shumë e vështirë, për aq kohë sa përbrenda Kosovës do të ekzistojnë enklava të mbrojtura dhe qytete të ndara.

Disa mësimet nga përvojat e UNMIK-ut ia vlejné edhe të thuhet edhe të përsëriten. Në kontekstin e ndërhyrjes humanitare, dështimi i OKB-së/KFOR-it për t'i paraparë dhe reduktuar vrasjet hakmarrëse ka qenë njëra nga dobësitë më kritike të operacionit. Kjo nuk ka ndodhur për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet forcave të NATO-s. Në një afat më të gjatë, mungesa forcave të kualifikuara policore, vendosjen e rendit dhe të ligjit e bën pothuaja të pamundur. Prandaj, është e qartë që OKB-ja ka nevojë për më shumë forca policore, të afta dhe të gatshme për veprim në rastet e operacioneve më ambicioze. Prania e domosdoshme policore e kërkon një përvojë në operacionet antiterroriste, ballafaqim me krimin e organizuar dhe qasje në grumbullimin e të dhënave më të sakta të inteligjencës. Parashtrimi i këtyre, si dhe i dobësive të tjera të administratës, kërkon përmirësim substancial dhe zgjerim të fondeve që do të jenë në dispozicion për veprimtarinë e OKB-së dhe të UNHCR-it.

PJESA II

ANALIZA

5. Dimensioni diplomatik

Gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Bashkësia Ndërkombëtare u ballafaqua me dilemën morale dhe juridike: nevoja për ta mbrojtur popullatën e viktimizuar nga shkeljet më mizore të të drejtave të njeriut si dhe nga shkelje të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, dhe, nga ana tjetër, përgjegjësia për ta shmangur përdorimin e forcës, nëse kjo ishte e mundshme fare. Pasi që zgjidhja e kësaj dileme u bë, vlerësimi se çfarë kjo zgjidhje doli është në thelb i vështirë, meqë ky në vete medoemos duhet të ngërthejë spekulime të shumta të mundshme për rrugët alternative të cilat kanë mundur të ndiqen. Mirëpo, kjo nuk është hera e parë që shfaqet një kësi dileme. Për të ardhmen do të mund të përgatitemi më së miri vetëm nëse të kaluarën e shikojmë në mënyrë kritike dhe pikërisht ashtu si ajo ishte.

Megjithatë, kritika dhe spekulime të tilla duhet të bëhen gjithsesi, duke i patur parasysh faktorët qenësorë, e mbi të cilët Bashkësia Ndërkombëtare ka ndikim mjaft të kufizuar. Për shembull:

Është më se e qartë që qëndrimet dhe veprimet e RFJ-së ishin shkaktari kryesor i dhunës dhe i trazirave në Kosovë gjatë tërë dhjetëvjeçarit të të 90-tave, dhe në veçanti në periudhën ndërmjet viteve 1997 dhe 1999. Regjimi i Millosheviqit me politikën e tij të dhunës dhe me qeverisjen e keqe të Kosovës, e ka marrë mbi vete përgjegjësinë kryesore për nxitjen e krizës së vendosjes në radhët e qeverive të brengosura si dhe tek institucionet ndërkombëtare, dhe në veçanti në Kombet e Bashkuara dhe në NATO. Ai është, po ashtu, përgjegjës për sjelljet kriminale të zyrtarëve serbë në Kosovë.

Qasja e RFJ-së ndaj Kosovës ka qenë e mbizotëruar nga lojrat e forcave të brendshme politike. Natyrisht që me shfrytëzimin e kartës nacionaliste dhe etnike si pjesë e strategjisë së tij për ta grabitur pushtetin, Millosheviqi erdhi e u shndërrua në peng të forcave të brendshme ideologjike të cilat nuk ishin të gatshme për kompromise rreth Kosovës. Në rrethana të brendshme të tilla, ai mund të ketë patur fare pak mundësi për ta pranuar ndonjë kompromis pragmatik, pavarësisht nga ajo se çfarë strategjie diplomatike do ta përdorte Bashkësia Ndërkombëtare.

Udhëheqja kosovare, po ashtu, nuk e ofronte hapësirën e nevojshme për zgjidhje. Kërkesa e pakompromise për pavarësi si e LDK-së ashtu edhe e UÇK-së, e më vonë edhe veprimet provokuese dhe të qëllimshme kryengritëse të UÇK-së, Beogradin e

vunë para një sfide të përshkallëzimit, kërkesat e të cilës shkonin edhe më larg sesa ato qëndrime që përkraheshin nga opozita demokratike e cila e kundërshtonte Millosheviqin. Bashkësia Ndërkombëtare, në fakt, ishte unanime në qëndrimin e saj kundër idesë së Kosovës si shtet i pavarur. Sidoqoftë, ishte strategjia “ndërkombëtarizuese” e UÇK-së ajo e cila e nxiti ndërhyrjen ushtarake të udhëhequr nga NATO-ja, dhe jo kompromisi diplomatik, dhe kjo strategji çonte me gjasë më të madhe drejt pavarësisë e jo kah ndonjë autonomi e tipit të para 1989-tës.

Duke i kombinuar këta faktorë me portretizimin e bërë në kapitullin paraprak për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare në Kosovë, shihet qartë që me të kritikuarit e përgjegjësisë ndërkombëtare, Bashkësia Ndërkombëtare është vënë në një situatë në të cilën nuk ka mundur ta anashkalonte domosdonë morale të veprimit për t’i ndaluar shkeljet masive të të drejtave të njeriut, qoftë edhe në rrethanat e një kryengritjeje të tillë, e cila nga disa është karakterizuar si një “konflikt i armatosur jondërkombëtar.” Nevoja për veprim ishte fare e qartë. Pengesat ishin të jashtëzakonshme. Sidoqoftë, është gjithmonë e rëndësishme që të analizohet rruga e zgjedhur e të vepruarit.

Ndërhyrja e Bashkësisë Ndërkombëtare ishte e vështirësuar edhe nga faktorë që nuk e kishin ndonjë lidhje të veçantë me Kosovën, por të cilët janë tipik për funksionimin aktual të politikës ndërkombëtare. Dobësitë që dalin nga kjo mënyrë e funksionimit nuk duhet të pranohen me fatalizëm. Ç’është e vërteta, krizat siç është kjo të cilën po e shqyrtojmë, e dëshmojnë nevojën e ngutshme për një reformim të gjerë institucional përbrenda OKB-së dhe gjetkë, si dhe për ndryshimin e botëkuptimeve. Ndryshimet e tilla, sado të rëndësishme që të jenë për veprimet në të ardhmen, kanë qenë të pamundura për të ndodhur para luftës së Kosovës. Prandaj, faktorët që do t’i përmendim në vijim, duhet që para së gjithash ta artikulojnë nevojën për bisedime. Përgjigja ndërkombëtare është formuluar nga dymbëdhjetë apo me shumë shtete kyqe, secili me qasjen e vet ndaj interesave kombëtare, me pengesat dhe forcat e veçanta të tyre të brendshme, duke i përfshirë këtu edhe ndryshimet në pikëpamje ndërmjet të udhëheqësve politikë e ushtarakë, si dhe me analizat e veta për të kaluarën dhe të ardhmen e Ballkanit. Pikërisht për këtë arsye këto shtete bashkëpunimin për ta arritur një politikë të përbashkët e kanë bërë në të njëjtën kohë në nga disa grupe të ndryshme që dalloheshin përnga natyra, duke i përfshirë këtu OKB-në, NATO-n, OSBE-në dhe BE-në. Rezultat i logjikshëm i kësaj ishte mungesa e konsistencës për ndërhyrje diplomatike.

Shikuar veçmas, shtetet anëtare si dhe entitetet ndërqeveritare, janë edhe më tutje

shumë të ngurta në bindjet e tyre që të gjitha problemet ndërkombëtare duhet t'i perceptojnë vetëm nga prizmi i interesave të ngushta dhe afatshkurta kombëtare. Kur mbizotëron pikëpamja që zgjidhja e problemit duhet t'i lihet dikujt tjetër, atëherë vendimet e vështira do të shtyhen për aq kohë sa do të jetë e mundur. Nëse ekziston mundësia e mospërfilljes së problemit, atëherë kjo është pikërisht ajo e cila edhe do të ndodhë. Nëse interesat e ngushta kombëtare nuk preken seriozisht, shtetet nuk do të angazhohen fare, dhe atë deri në momentin kur trysnia ndërkombëtare do të rritet aq sa t'i detyrojë që ta bëjnë këtë. Rrjedhimisht, është e pashmangshme që në situatat e luftrave të brendshme dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut, angazhimi efikas është i vonuar.

Ballafaqimi me luftën e brendshme në rritje:

shkurt – shtator 1998

Para vitit 1998, një çështje mjaft e theksuar ishte ajo e lajmeve të ngatërruara nga Bashkësia Ndërkombëtare për aktorët kyq të dramës kosovare. Dështimi i saj për një ndërhyrje më të shpejtë, mungesa e konsistencës, e nganjëherë edhe mungesa e tërësishtme e të vepruarit, ishin ato që edhe e shkaktuan shfaqjen e vështirësive diplomatike të mëvonshme. Sikur të ekzistonte një mbështetje për “shoqërinë paralele,” dhe përpjekje më të mëdha për ta vendosur dhe ruajtur një prani ndërkombëtare në terren, do të mundësohej forcimi i fraksioneve më të moderuara, dhe, në këtë mënyrë, Bashkësia Ndërkombëtare do të ishte në gjendje që të kishte më tepër ndikim në gjendjen në terren. Në këtë periudhë ka qenë e nevojshme një shkallë më e lartë e përpjekjeve diplomatike, ashtu që Kosova të mbahej në agjendën politike ndërkombëtare, dhe që njëkohësisht të ruhej trysnia ndaj Serbisë. Me fjalë të tjera, në periudhën para vitit 1998, gjasat për zgjidhjen pa luftë të problemit kosovar kanë qenë më të mëdha.¹

Madje, është paradoksale që vullneti politik për angazhim diplomatik u shfaq vetëm pasi që konflikti dhe dhuna morën përmasa aq të mëdha, sa që tash vetë kjo dhunë e vështirësonte përgjigjen e duhur të aktorëve lokal ndaj nismave diplomatike. Kështu, me shfaqjen në skenë të UÇK-së, përmes sulmeve të saj kundër policisë dhe civilëve serbë, RFJ-ja u ballafaqua me një kryengritje të armatosur, e cila, shihej qartë, shërbehej me taktika terroriste. RFJ-ja nuk do ta kishte patur të vështirë që ta bindte Bashkësinë Ndërkombëtare që një kryengritje e tillë kërkonte përgjigje nga shteti, madje edhe me forcë. Mirëpo në kohën kur opinioni publik e luan rolin vendimtar

në krijimin e qëndrimit të Bashkësisë Ndërkombëtare, përmasat e ndërhyrjes së RFJ-së, dhe, në veçanti, vënia në shënjestër të drejtpërdrejtë e popullatës civile, e kontestuan legjitimitetin e kërkesave të saj për një arsytim të qëndrueshëm të ndërhyrjes kundër kryengritjes. Dhe aq sa shtoheshin viktimat dhe zhvendosjet e popullatës civile, aq shtohej edhe mobilizimi veprues i Bashkësisë Ndërkombëtare.

Bashkësia Ndërkombëtare tashmë e kishte një përvojë të konsiderueshme me Millosheviqin dhe me Serbinë. Përvojat e Bosnjes i kushtëzuan qëndrimet dhe kalkulimet e të gjithëve lidhur me mundësitë në dispozicion. Kishte mjaft mosbesim dhe skepticizëm, dhe ky ishte plotësisht i qëlluar, dhe Millosheviqi shikohej si diçka që tashmë ishte e njohur. Këto rrethana diplomacinë edhe e ndihmuan, por edhe e penguan. Kurthet “që u bënë gjatë luftës së mëparshme” dolën mjaft relevante.

Nga ana tjetër, udhëheqja e Kosovës para Bashkësisë Ndërkombëtare dilte si një enigmë diplomatike. Gjatë zhvillimeve të vitit 1998 ishte vështirë ta dije se me kë duhej kontaktuar. LDK-ja e kishte një legjitimitet të caktuar në qarqet ndërkombëtare, mirëpo shihej gjithnjë e më tepër që ajo nuk kishte ndikim mbi kryengritjen dhe se ishte duke e humbur rëndësinë që e kishte pasur më parë për popullatën shqiptare të Kosovës. UÇK-ja, e cila para vitit 1998 ishte faktikisht e panjohur dhe fare e vogël, ishte një bashkëdyzim i pakokë grupacionesh të krijuara në mënyrë kaotike dhe me një shpejtësi marramendëse. Pa ndonjë udhëheqje të centralizuar, ajo nuk mund të integrohej në ndonjë proces racional diplomatik.

Formulimi i një qëndrimi diplomatik koherent, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për një luftë të brendshme, kërkon përpjekje për njohjen e motiveve dhe të interesave të të dyja palëve në konflikt. Po qe se zgjidhjet nuk janë përgjigje ndaj këtyre interesave, ato nuk do të jenë të qëndrueshme. LDK-ja dhe UÇK-ja ishin transparente në qëllimin e tyre: ato ngulmonin për pavarësi. Mirëpo pa një komunikim direkt, Bashkësia Ndërkombëtare nuk ka mundur ta përcaktonte se deri në çfarë shkalle do të mund të negociohej ky qëllim. Dhe, deri vonë, strategjia e UÇK-së për ndërkombëtarizimin e konfliktit nuk ka qenë e qartë.

Motivet e theksuara të sjelljes së RFJ-së janë ende të hapura për debat. Nuk ka dyshim që RFJ-ja, duke e vënë në shënjestër popullatën civile, pra, përmes shkeljes masive të të drejtave të njeriut, dhe duke e përdorur dhunën në përmasa shumë më të mëdha sesa që ishte kërcënimi nga kryengritja me të cilën ballfaqohej, është sjellur në mënyrë jologjore dhe jomorale. Mirëpo, pasiguria lidhur me kombinimin e motiveve që e shkakton dhunën, e ka zvarritur reagimin ndërkombëtar, dhe, për një kohë, e ka lënë Bashkësinë Ndërkombëtare pa përgjigje. Në thelb, ishin dy mënyra të mundshme për

t'i interpretuar aksionet e RFJ-së: ose si operacione kundërkryengritëse, të ndërmarra për ta eliminuar si kërcënimin nga UÇK-ja, ashtu edhe mbështetjen e popullit për të, apo edhe si strategji afatgjate e spastrimit etnik, për ta ndryshuar përgjithmonë ekuilibrin ekzistues demografik dhe etnik në Kosovë.

Këto dy motivime kurrsesi nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, dhe asnjëri veç e veç nuk mund ta shpjegojë pjesën më të madhe të dhunës. Zhvendosjet e detyrueshme dhe vrasjet e civilëve e paraqesin një taktikë mizore, e cila përdoret shpesh herë nga pala që e lufton kryengritjen në lufrat e tilla civile. Shkalla e përdorimit të dhunës në Kosovë ishte e krahasueshme me shkallën e disa lufrave kundërkryengritëse që kanë ndodhur kohëve të fundit, si për shembull, në Kolumbi dhe në Turqi. Disa analistë pohojnë që strategjia ushtarake dhe e dhunës e RFJ-së mund të shpjegohet në tërësi si një strategji kundërkryengritëse, por e cila në një masë të madhe i ka kaluar kufijt e moralitetit dhe të së drejtës humanitare.² Mirëpo, në të njëjtën kohë, historia e sjelljeve të RFJ-së gjatë viteve 90, jep arsye për dyshime të bazuara që ajo e ka patur qëllimin e një spastrimi afatgjatë të Kosovës.³ Këto dyshime e gjejnë mbështetjen e vet jo vetëm në veprimet e Millosheviqit në Kroaci dhe në Bosnje, por edhe në qëndrimet e shprehura qartë nga aktorët e tjerë kryesorë të Serbisë, të cilët i kanë dhënë një përkrahje të hapur spastrimit etnik të Kosovës.³ Është e mundur që në radhët e zyrtarëve serbë të ketë patur dallime në pikëpamje sa i përket qëllimit të përdorimit të forcës gjatë veprimeve kundërkryengritëse: disa nën etiketën e luftimit të kryengritjes e shihnin rastin e spastrimit etnik, e për të tjerët, ky mund të ketë qenë vetëm një rast për ta mposhtur sfidën që UÇK-ja ia bëri pushtetit serb. Një lloj i këtillë i luftës, dhe në veçanti në rrethanat e ekuilibrit ekzistues demografik në Kosovë, mbështetet në taktika të zhvendosjes të asaj pjese të popullsisë e cila konsiderohet armiqsore ndaj rendit ekzistues, mirëpo kjo në Kosovë faktikisht e nënkuptonte të tërë popullatën.

Të dhënat për motivin e spastrimit etnik logjikisht e arsyetojnë veprimin parandalues ndërkombëtar me qëllim të mbrojtjes së popullatës së sulmuar dhe, deri në njëfarë mase, këto i shpjegojnë, po ashtu, edhe detyrimet që Bashkësia Ndërkombëtare dëshiron të ia impononte Serbisë, e të cilat ishin më të mëdha sesa në situatat e tjera të lufrave kundër kryengritjeve. Megjithkëtë, aplikimi i qartë i standardeve të dyfishta mund të konstatohet edhe në shumë fushata të tjera që bëhen kundër kryengritjeve kudo nëpër botë, e të cilat nuk kanë përfunduar me ndërhyrje formale ndërkombëtare. Këto kontraste e kanë ushqyer në masë të madhe bindjen e Beogradit se reagonimi ndërkombëtar ndaj përpjekjeve të tyre kundër kryengritjes ishte shprehje e hipokrizisë dhe e konspiracionit global antiserb.

Njëkohësisht, në dinamikën e kryengritjes dhe të luftës kundër saj, procesi i shkallëzimit të provokimeve dhe i veprimeve të të dyja grupeve të armatosura (UÇK-së dhe RFJ-së) - ku që të dyjat përdornin taktika terroriste (ndonëse të intensiteteve të ndryshme) - është dashur ta kushtëzojë edhe qëndrimin dhe qasjen e Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj UÇK-së. Zgjidhja e problemit e ka nënkuptuar medoemos ndërprerjen e armiqësive nga të dyja palët. Megjithë thirrjet që Grupi i Kontaktit ia bëri UÇK-së për bashkëpunim dhe përmbytje, veprimet konkrete në këtë drejtim kanë munguar.⁴

Reagimet e hershme

Aktorët e parë ndërqeveritarë që e bënë ndonjë reagim ndërkombëtar ndaj krizës e cila ishte në thellim e sipër, ishin OKB-ja, Grupi i Kontaktit dhe OSBE-ja, e më vonë edhe NATO-ja. Gjatë kësaj kohe, shtetet anëtare i ndiqnin strategjitë e tyre individuale dhe të pavarura të politikës së jashtme.

Grupi i Kontaktit fillimisht u themelua lidhur me situatën në Bosnje, dhe në te bënin pjesë Federata Ruse, SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania dhe Italia. Ky vazhdoi ta ketë një rol mbizotërues në veprimin diplomatik të Bashkësisë Ndërkombëtare edhe në situatën e ashpërsimit të krizës në Kosovë. Grupi filloi me thirrjet për dialog ndërmjet rezistencës kosovare dhe Beogradit që në shtatorin e vitit 1997, duke e theksuar në secilën komunikatë që “ne nuk e mbështesim as pavarësinë dhe as status quonë.”⁵ Më 28 janar 1998, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e miratoi një rezolutë me të cilën bëhej thirrje për ndërprejen e dhunës ndaj shqiptarëve etnik dhe për fillimin e menjëhershëm të dialogut ndërmjet palëve ndërluftuese, duke e theksuar faktin që Kosova tashmë ishte në prag të luftës civile.⁶ Më 28 shkurt 1998, Grupi i Kontaktit në qëndrimin e tij e theksonte që “Angazhimi ynë për vlerat e të drejtave të njeriut e nënkupton se ne nuk mund të injorojmë metoda të tilla joadekuate të kontrollit. Pushteti qeveritar ka përgjegjësi të veçanta për t’i mbrojtur të drejtat njerëzore e civile të të gjithë qytetarëve, dhe për të garantuar që forcat e sigurisë publike veprojnë në mënyrë ligjore dhe me përmbytje.”⁷

Duke reaguar ndaj ngjarjeve në Drenicë, Shtetet e Bashkuara i tërhoqën në mënyrë të njëanshme disa koncesione diplomatike, duke i përfshirë këtu edhe fluturimet civile me Jugosllavinë. Koncesionet ishin ofruar më parë si shkëmbim për mbështetjen e qeverisë jugosllave për forcat e moderuara në Republikën Serbe të Bosnjes dhe Hercegovinës. Disa nga ndihmësit e Millosheviqit i kanë hedhur poshtë këto veprime si të parëndësishme.⁸

Më 9 mars 1998, Grupi i Kontaktit u takua sërish për t'i shqyrtuar këto zhvillime, dhe vendosi njëzëri për vënien e embargos në armë si dhe ndalesën për transferin e paisjeve të cilat do të mund të përdoreshin për dhunë. Megjithatë, Franca, Italia, dhe Rusia refuzuan të pajtoheshin në tërësi me ashpërsinë e këtyre sanksioneve. Mirëpo në palën amerikane, Sekretarja e Shtetit e SHBA-ve, Madeleine Albright, e vlerësonte që sanksionet janë vetëm të “kënaqshme,” duke konstatuar që përdorimi i forcës është “esencial për të vazhduar më tutje.”⁹ Sekretari i Jashtëm i Britanisë, Robin Cook e theksonte që “Ne nuk e pranojmë që kjo është një çështje ekskluzivisht e brendshme.” Qeveria gjermane propozonte që çështja të shtrohej para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ndërkaq Rusia dërgonte mesazhe të qarta që rezoluta do të bllokohej.¹⁰

Qëndrimet e Grupit të Kontaktit të muajit mars 1998 e paraqitnin bazën e Rezolutës 1160 të KS të OKB-së (e trajtuar më poshtë), por njëkohësisht kishin edhe propozime të cilat nuk ishin në Rezolutë. Rekomandimet e hershme të Grupit të Kontaktit e kërkonin me këmbëngulje një prani më të dukshme ndërkombëtare dhe shumëfunktionale në Kosovë, duke e përfshirë këtu edhe propozimin për misionin e UNHCR-së, kthimin e misioneve afatgjate të OSBE-së, si dhe themelimin e një konzorciumi ndërkombëtar, ku do të ishin edhe OJQ-të, ashtu që të ndihmohej ndërtimi i shoqërisë civile në Kosovë. Dhe, në fund, megjithëse pa pëlqimin e Ruisë, Grupi i Kontaktit u angazhua për mosdhënien e vizave për disa përfaqësues të caktuar të RFJ-së, si dhe për moratorium në mundësitë e Beogradit për eksport, me arsyetimin që nëse nuk do të bëhen përparime në kërkesat e tjera, të paktën për këtë do ta kishte pëlqimin e Ruisë. Në prill 1998, përsëri pa përkrahje të Ruisë, Grupi i Kontaktit e fuqizoi vendimin për ngrirjen e fondeve të RFJ-së jashtë vendit dhe kërcënoi se do t'i bllokonte të gjitha investimet e mëtejme në Serbi.¹¹

Para përfshirjes aktive të NATO-s, Grupi i Kontaktit ishte forumi kryesor për ndërtimin e koherencës në mesin e përgjigjeve të ndryshme që i jipnin SHBA-të dhe shtetet evropiane. Dallimet e mëdha sa i përket qasjes diplomatike, në masë të madhe i ndërllokuan përpjekjet lidhur me Kosovën në periudhën e paraluftës. Dallimet lidhur me mjetet, më shumë sesa me qëllimet dhe me vlerat, i shprehin dallimet në pikëpamje lidhur me atë se si të ushtrohej ndikim në Millosheviqin, si të përdorej diplomacia e forcës, dhe deri në cilën masë zgjidhja diplomatike shihej si opsion real.

Qëndrimi i SHBA-ve, ashtu siç ai u shpreh nga ana e Sekretares së Shtetit Madeleine Albright, duket se ishte ai që e vetmja mënyrë efikase për të ndikuar në Millosheviqin ishte që kërkesat e negociatave, në të gjitha fazat, duhej ta kishin përkrahjen e besueshme dhe serioze të mundësisë së përdorimit të forcës.¹² Cilido verzion më i

lehtë do ta kishte domethënien që nuk janë nxjerrë kurrfarë “mësimesh nga përvojat e Bosnjës,” dhe në masë të madhe do të ishte temë e kritikave përbuzëse nga radhët e krahut të djathtë në Shtetet e Bashkuara. Bombardimi i NATO-s në Bosnje, më 1995, është interpretuar si një veprim efikas i cili e detyroi Millosheviqin të ulëj në tryezën e bisedimeve në Dejton.¹³ Një strategji e tillë kërkonte kërcënim të besueshëm me mundësinë e dëmtimeve serioze, ashtu që një kundërshtar dinak të bindej se nuk bëhej fjalë vetëm për bllof, dhe që të arrihej deri te një zgjidhje e realizueshme, meqë ajo do të garantohej nga një prani përkatëse e armatosur.

Duke i patur parasysh përvojat nga lufta në Bosnje, fuqitë perëndimore ishin të bindura që mënyra e vetme efikase për mbrojtjen e shqiptarëve të Kosovës pa përdorimin e forcës së mirëfilltë, ishte kërcënimi për përdorimin e saj, ndonëse një diplomaci e tillë kërcënuese është në kundërshtim me Kartën e OKB-së. Ata ishin, po ashtu, të interesuar që ta gjenin një zgjidhje, të tillë që zbatimi i saj të mos varej nga vullneti i mirë i Beogradit. Nga një këndvështrim i tillë, mosbesimi për çfarëdo qoftë angazhimi të Millosheviqit nëse ai nuk do të garantohej me forcë, dukej plotësisht i arsyeshëm, dhe atë para së gjithash për shkak të supozimit që ai mund të tërhiqej në momentin e fundit ose, edhe më keq, pas ditëve të para të ndonjë sulmi. Pikërisht për këto arsye, është e një rëndësie të madhe që Millosheviqi të perceptohet si pragmatist, dhe jo si një fanatik.

Një përkrahje e përgjithshme për idenë që Beogradit t'i dërgohet një mesazh, me të cilin do t'i bëhej e qartë që vazhdimi i keqtrajtimit në Kosovë do të jetë shkatërrues për RFJ-në, ekzistonte po ashtu edhe në Evropë. Qasjes së propozuar nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga Franca, për dërgimin e trupave tokësore parandaluese në vendet fqinje, si një kërcënim i nënkuptuar për një zbatim të kombinuar të luftës ajrore dhe të asaj tokësore, iu dha një përparësi më e madhe sesa kërcënimin me forcat ajrore. Vendosja e tillë e trupave ishte me një dykuptimësi më të madhe diplomatike, meqë nuk mbështetej vetëm në kërcënimin e qartë për përdorimin e forcës, por, në të njëjtën kohë, ishte një mesazh shumë i qartë që e tregonte se është fjala për një vendosmëri për ta gjetur zgjidhjen, e jo vetëm për një bllof.

Këshilli i sigurimit i OKB-së

KS i OKB-së nuk ia kushtoi vëmendjen e nevojshme çështjes së Kosovës deri në vitin 1998, kur tashmë kishte ardhur deri te përshpejtimi në shkallëzimin e dhunës. Rezoluta 1169 e KS të OKB-së (31 mars 1998), i referohej drejtpërsëdrejti reko-

madimeve dhe vendimeve formale të miratuara më parë nga Grupi i Kontaktit. Ajo e dënonte, si luftën serbe kundër kryengritjes, ashtu edhe terrorizmin e UÇK-së, dhe bënte thirrje për dialog ndërmjet palëve ndërluftuese. Teksti i saj e përkrahte integritetin territorial të RFJ-së, dhe shprehte mbështetje për “një status të avancuar për Kosovën, i cili do ta nënkuptonte një shkallë më të lartë të një autonomie substanciale si dhe një vetëqeverisje të mirëfilltë.” Çështje më e rëndësishmja, Rezoluta kërkonte të vihej embargo në armatim për RFJ-në dhe për UÇK-në, si dhe të “parandalohet armatosja dhe trajnimi i aktiviteteve terroriste” nga të gjitha shtetet. Si një sinjal plotësues i angazhimit, nga Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Hagës u kërkuar që ta fillonte grumbullimin e informatave lidhur me persekutimet të cilat ishin pasojë e dhunës politike e cila zbatohet në Kosovë.

Po ashtu, Rezoluta i përcaktoi kushtet me respektimin e të cilave mund të mënjanohej sanksionet ndaj RFJ-së, e ndër to ishte edhe fillimi i një dialogu të mirëfilltë, tërheqja e njësiteve speciale policore, hyrja e papenguar në Kosovë e organizatave humanitare, vendosja misionit të UNHCR-së, si dhe leja për kthimin e misionit afatgjatë të OSBE-së.

Edhe pse kjo Rezolutë e KS të OKB-së mbështetej në Kapitullin VII, ishte e qartë që në rrethanat ekzistuese OKB-ja nuk do të ishte zbatuesi kryesor i saj.¹⁴ Për shkak të entuziazmit në rënie, të paktën të një pjesë e shteteve anëtare që i kontribuonin operacioneve paqeruajtëse, ishte një mungesë si e mjeteve, ashtu edhe e vullnetit politik që ato ta mirrinin mbi vete rolin kryesor monitorues. Pikërisht për këtë arsye, çështja e monitorimit u mor përsipër nga një numër i organizatave rajonale, ku secila nga to kishte, si antarësi, ashtu edhe mandate dhe agjenda strategjike të ndryshme, e që në thelb don të thotë se ato shquheshin me mungesë të koherencës. Dallime posaqërisht të mëdha ishin ato ndërmjet të qasjeve të OSBE-së dhe të NATO-s, si dhe lidhur me rolin ambivalent e të paqëndrueshëm të Rusisë. Raportet mujore të Kofi Ananit dërguar KS të OKB-së gjatë vitit 1998 lidhur me gjendjen ekzistuese, fillonin me shprehjen e një rezerve të kujdesshme, duke u theksuar që, megjë OKB-ja nuk kishte prani aktive në rajon, ajo ishte e varur në tërësi nga burime të dorës së dytë. Në gusht ai e tërhoqi vërejtjen edhe një herë që burimet e premtuara për mbikëqyrje të Rezolutës 1160 nuk ishin të mjaftueshme për ta mundësuar funksionimin efikas të regjimit të mbikëqyrjes, ashtu siç ai parashihej në atë Rezolutë. Shihej qartë që koalicioni euro-amerikan, e cili më vonë e paraqiti bërthamën e angazhimit të NATO-s, nuk ishte i mobilizuar seriozisht për mbështetjen e një pranie ndërkombëtare të paarmatosur nën mandatin e OKB-së.

Pas një vere e cila në Kosovë ishte e stërbushur me dhunë shtetërore të RFJ-së, KS i OKB-së më 23 shtator 1998 e miratoi Rezolutën 1199, në të cilën shprehej shqetësimi për zhvendosjen e 230.000 kosovarëve nga shtëpitë e tyre. Është shumë indikative që kjo Rezolutë në disa vende bën aluzion për “katastrofën e pashmangshme humanitare,” duke iu referuar raportit të fundit të Sekretarit të Përgjithshëm.¹⁵ Faktori kyq i kësaj katastrofe kërcënuese ishte dimri i cili vetëm sa s’kishte filluar, dhe pasojat të cilat kosovarët e zhvendosur do të mund t’i kishin nga të ftohtit dhe uria. Rezoluta 1199, po ashtu, e vlerësonte përkeqësimin e gjendjes në Kosovë “si një kërcënim për paqen dhe sigurinë në rajon,” duke i vendosur në këtë mënyrë themelet për veprimet e mundshme të detyrueshme për të ardhmen. Në anën tjetër, Rezoluta i rikonfirmonte elementet kryesore të Rezolutës 1160, duke kërkuar që dhunës serbe t’i jipet fund, që të lejohej mbikëqyrja efikase dhe e vazhdueshme ndërkombëtare, si dhe lehtësimi i kthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në bashkëpunim me UNHCR-në dhe ICRC-në. Ajo, po ashtu, u bënte thirrje të gjitha shteteve që ta ndalonin mbledhjen e fondeve në emër të UÇK-së, duke e konfirmuar në këtë mënyrë sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën. Përfundimisht, më 24 tetor, Rezoluta 1203 e KS të OKB-së e bëri përkrahjen e marrëveshjeve që u arritën në misionin e Hollbrukut, e ndër të cilat ishte edhe marrëveshja OSBE-RFJ për vendosjen e Misionit Verifikues në Kosovë, si dhe marrëveshja NATO-RFJ, e cila i lejonte fluturimet me qëllim të vëzhgimit nga ajri për ta verifikuar zbatimin e marrëveshjes.¹⁶

Thënë në një mënyrë të përmbledhur, në KS të OKB-së konsensusi ekzistonte deri në një shkallë të caktuar. Anëtarët e KS të OKB-së pajtoheshin që RFJ-ja ishte fajtori kryesor për katastrofën humanitare e cila parandjehej se do të ndodhte në Kosovë; që kjo katastrofë e pengonte shfrytëzimin e disa të drejtave të njeriut të cilat ishin ndërkombëtarisht të mbrojtura; që kjo paraqiste kërcënim për paqen dhe për sigurinë ndërkombëtare; dhe që kjo nuk shihej vetëm si “një çështje e cila në thelb i takonte jurisdikcionit të brendshëm” të RFJ-së. Për t’i ikur kësaj situate të papranueshme në Kosovë, përkrahja iu dha idesë për vendosjen e një pranije të paarmatosur ndërkombëtare, madje edhe po qe se kjo nuk do të ishte nën autoritetin e drejtpërdrejtë të OKB-së. Për më tepër, OKB-ja nuk i dha përkrahje UÇK-së si lëvizje çlirimtare, dhe as kërkesës së gjerë për pavarësi të Kosovës, por kjo, po ashtu, nuk e ndërmoi asnjë hap për ta penguar përkrahjen ndërkombëtare për kryengritje.

Në të njëjtën kohë, nuk ekzistonte ndonjë konsensus sa i përket kërcënimit për përdorim apo për vetë përdorimin e forcës. KS i OKB-së asnjëherë nuk e ka autorizuar në mënyrë të qartë përdorimin e saj. Rusia dhe Kina e kishin bërë të qartë që do ta përdornin veton kundër çfarëdo përpjekjeje për ta bërë këtë.¹⁷ Njëherësh, Rezoluta e

mëvonshme 1203, e përkrahte marrëveshjen Hollbruk-Milloshëviq, për të cilën ekziston një bindje e përgjithshme se u mundësua vetëm pas kërcënimit të NATO-s.

Dilemat rreth pjesëmarrjes së Rusisë

Ngurrimi i vazhdueshëm i Rusisë për të ndërmarrë veprime të asaj shkalle çfarë kërkoheshin prej saj nga vendet e tjera, e kishte shkaktuar një frustrim të madh tek anëtarët e tjerë të Grupit të Kontaktit, dhe ky e paraqet njërin nga shkaqet e vendimit të mëvonshëm për veprim të pavarur, si nga OKB-ja, ashtu edhe nga Rusia. Lidhur me këtë, në veçanti ishin kritike SHBA-të dhe Britania e Madhe, të cilat Rusinë e shihnin si një faktor i cili e prishte potencialin për veprim unik dhe efikas të Bashkësisë Ndërkombëtare. Mirëpo Rusia e kishte, po ashtu, edhe potencialin e vënies së urës së bisedimeve ndërmjet Grupit të Kontaktit dhe RFJ-së. Brendapërbrenda Rusisë, Serbinë mundoheshin ta mbronin si elementet pan-sllaviste, ashtu edhe ato që ishin kundër NATO-s, me sa duket, para së gjithash, për shkak të raporteve të politikës së brendshme. Rusia i kishte problemet e veta të secesionizmit etnik, dhe pajtohej me pretendimin e Serbisë për ta trajtuar Kosovën si një çështje “të brendshme.” Është e qartë që Millosheviqi Rusinë e shihte si burimin e vetëm të një përkrahjeje të pjesërishme nga Grupi i Kontaktit.

Mirëpo kjo është vetëm gjysma e rrëfimit. Sjellja e Rusisë e kishte një dykuptimësi të skajshme lidhur me të gjitha eksceset e Serbisë të viteve 90-të, dhe në veçanti lidhur me Millosheviqin. Rusia vazhdimisht bashkëpunoi me Perëndimin për zbatimin e sanksioneve ndaj Jugosllavisë, dhe i përkrahte shqetësimet dhe gjykimet e shprehura nga OKB-ja, por ajo asnjëherë nuk e kishte përkrahur kërcënimin për përdorim të forcës apo edhe vetë përdorimin e forcës. Ministri i Jashtëm Primakov, me sa duket, ishte më tepër i interesuar për përmirësimin e marrëdhënieve me Perëndimin sesa që të përqendrohej në konfrontimet e mundshme me NATO-n, dhe ky ishte i vetëdijshëm që Kosova ishte një çështje tepër e ndjeshme dhe se mund të shpërthente në çdo çast. Po ashtu, dallimet ndërmjet të Rusisë dhe Përndimit lidhur me statusin e dëshiruar final të Kosovës, si një njësi autonome brenda Jugosllavisë, ishin fare të pakta. Një kombinim i këtyre të simpatisë dhe i dykuptimësisë lidhur me qasjen ndaj Beogradit, Rusisë ia jipte një rol të qenësishëm në negociata: Rusia kishte ndikim mbi Millosheviqin, dhe Millosheviqi kishte nevojë për Rusinë, e në të njëjtën kohë, Rusia, marrë në përgjithësi, ishte në pajtim të plotë me qëllimet e Perëndimit.

Duket se Moska në disa raste i ka përdorur qëndrimet ndërmjetesuese në një mënyrë

mjaft frytdhënëse, duke i bërë vërejtje Millosheviqit që të jetë më i matur në veprimet e tij, që ta merr më me seriozitet kërcënimin e NATO-s, dhe që të mos llogarisë në Rusinë si aleat në rast të konfliktit të hapur. Mirëpo, për shkak të raporteve të politikës së brendshme në Rusi, të inercionit burokratik dhe të mungesës së koherencës politike, Rusia, njësoj sikurse edhe pjesa tjetër e Bashkësisë Ndërkombëtare, vazhdoi të dërgonte sinjale të përziera, e të cilat gjithsesi e irrituan dhe e hutuan Millosheviqin, dhe atë deri në atë masë, sa që kjo edhe e shkaktoi një frustrim të theksuar të qeverive të Shteteve të Bashkuara dhe të Britanisë.¹⁸ Dështimi i Rusisë për ta arritur një koherencë politike përballë dhunës serbe e cila shkonte gjithnjë e duke u rritur, mund ta ketë pasur një ndikim shumë të madh në përkeqësimin e procesit diplomatik.

Njëri nga hapat më të theksuar dhe më të rëndësishëm të Rusisë ishte ai i qershorit 1998, kur Presidenti Jelcin u takua personalisht me Millosheviqin në Moskë, ku ai edhe mori garanca që Beogradi do të angazhohej për ta lejuar hyrjen e papenguar në Kosovë të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe të organizatave humanitare, si edhe premimin për ndërprerjen e sulmeve kundër civilëve kosovarë.¹⁹ Siç është bërë e ditur, Jelcini dhe udhëheqësit e tjerë rusë e kishin një qëndrim shumë të vendosur ndaj Millosheviqit, duke ia shprehur atij pakënaqësinë e tyre me veprimet e tepruara serbe.²⁰ Pas këtij takimi, më 16 korrik 1998, Grupi i Kontaktit i përsëriti shqetësimet e veta, dhe njëkohësisht e ofroi gatishmërinë për të ndërmjetësuar në procesin e negociatave, duke e shtuar madje edhe një shpërblim plotësues, e i cili ishte garantimi “i një rruge të qartë dhe të realizueshme të inkuadrimit të Beogradit në Bashkësinë Ndërkombëtare, duke e përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në OSBE.”²¹

Megjithë marrëveshjen e Moskës dhe edhe përkundër pranisë së vëzhguesve, koriku dhe gushti 1998 sollën sulme të furishme të RFJ-së kundër popullatës civile në Kosovë. Ndërmjet qershorit dhe tetorit, kur edhe u bë kërcënimi i parë i NATO-s për mundësinë e sulmeve ajrore, sipas disa analistëve, Rusia ishte anashkaluar fare, apo, mbase, edhe e përjashtuar nga ana e Shteteve të Bashkuara sa i përket mundësisë për ta luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në procesin e negociatave. Qëndrimi i Rusisë shpesh herë është kritikuar nga ana e zyrtarëve të lartë të Amerikës dhe të Britanisë, duke u vlerësuar si një qëndrim proserb, dhe një nga i cili nuk kishte kurrfarë dobie, ndërkohë që në retorikën dhe në veprimet e NATO-s dhe të SHBA-ve nënkuptohej pashmangshmëria e aksionit ushtarak, gjë kjo e cila duhej kuptuar si pjesë përbërëse e strategjisë kërcënuese e cila e kishte për qëllim që ta bënte Beogradin të bindej, dhe që njëkohësisht interpretohej si një bindje se Beogradi nuk ishte i besueshëm për negociatave përpos kur është i ballafaquar me forcë.²²

Urdhëri i mëvonshëm i NATO-s për veprim pati sukses në vertetimin e kundërshtim-

it të hapur të Ruisë. Në parapaskenë, SHBA-të e vazhduan komunikimin e rregullt me Moskën, dhe dukej që ende përpiqeshin ta ndërtonin “frontin e përbashkët” në mbështetje e përdorimit të forcës, mbase duke insistuar që fronti i përbashkët i kërcënimit do të ishte më bindës për Millosheviqin, dhe që kjo aktualisht të ndikonte për ta shmangur nevojën e përdorimit të forcës.

Në tetor, diplomatët rusë shkuan tek Millosheviqi për të kërkuar nga ai që ta pranonte marrëveshjen e Hollbrukut, duke aplikuar në këtë rast diplomaci kërcënuese, por në të njëjtën kohë ata donin që ta inkurajonin Beogradin që ta ndiqte rrugën e negociatave. Rusia e vazhdoi punën me Grupin e Kontaktit gjatë procesit të Rambujesë, dhe në të ajo ishte bashkëkryesuese. Në një farë mënyre, pozita e Ruisë mund të shihej edhe si vetëdefetiste, meqë ajo e kishte kuptuar që NATO-ja punën e kishte marrë me seriozitet, dhe se rrugën e zgjedhur do ta vazhdonte, nëse jo me autorizimin e OKB-së, atëherë edhe pa të. Duke e paralajmëruar veton në KS të OKB-së, pa ofruar asnjë alternativë, Rusia ia arriti që ta shkaktonte një epilog i cili pashmangshmërisht do ta dobësonte rolin e KS të OKB-së, dhe, po ashtu, do t’i kontribuonte “unilateralizmit” të NATO-s, sa i përket çështjes së Kosovës.

Duhet nënvizuar, megjithatë, se edhe sikur Rusia të bindej për domosdonë e përdorimit të forcës, në KS të OKB-së ende nuk kishte gjasa që këte do ta bënte edhe Kina. Kinezët kishin bashkëpunuar, po ashtu, duke i përkrahur disa sanksione kundër Beogradit gjatë të 90-ave. Megjithëkëtë, kur shtrohej çështja e përdorimit të forcës, qëndrimi i tyre nuk ishte i shprehur aq në specifikat kontraverze të Kosovës, sa ishte në shprehjen e bindjes për të drejtat sovrane të shteteve që sfidat e brendshme t’i zgjidhin pa ndërhyrje nga jashtë. Kina ishte, po ashtu, e brengosur për manipulimin e KS të OKB-së nga ana e SHBA-ve dhe aleatëve të saj, prandaj edhe ishte e mendimit që nuk duhej dhënë ndonjë e drejtë për përdorim e forcës përtej kufijve të Kartës.

Dilema e Grupit të Kontaktit ishte ajo që, përderisa Rusia e ofronte urën më efektive për negociata me RFJ-në, në kuptimin e kanaleve komunikuese dhe të vullnetit për t’i mbrojtur interesat sovrane të RFJ-së, zyrtarët rusë shpreheshin fuqishëm kundër çfarëdo intervenimi, duke e dobësuar në këtë mënyrë kërcënimin me forcë. Pikërisht për këtë arsye NATO-ja duhej ta zgjedhte ose njërën ose zgjidhjen tjetër për negociata me Millosheviqin. Procesi i negociatave përmes një komunikimi efikas lidhur me interesat e të gjitha palëve, e kërkonte pjesëmarrjen e Ruisë, si një lidhje esenciale diplomatike me RFJ-në. Negociatat të cilat e nënkuptonin kërcënimin bindës për përdorimin e forcës ushtarake si mjet i fundit, vareshin ose nga miratimi i Ruisë (të cilën SHBA-të tashmë e kishin nxjerrë jashta skenës), ose nga përjashtimi i saj (duke u

mbështetur në NATO-n në vend të OKB-së), meqë kërcënime të tilla nuk do të ishin bindëse përderisa RFJ-ja të llogariste në veton e Rusisë.

SHBA-të, NATO-ja dhe marrëveshja Hollbruk-Milloshëviq

Megjithë tërheqjen e vërejtjes lidhur me Kosovën të cilën Milloshevit ia bënë gjatë viteve 1992-3, Shtetet e Bashkuara e ndoqën një linjë të një politike të ndryshueshme e cila nuk ishte më koherente se ajo e aktorëve të tjerë kyq; kjo zgjati deri më 1998, kur përshkallëzimi i dhunës e parashtrroi domosdonë e një përgjigjeje më konsistente. SHBA-të i kushtuan fare pak vëmendje lëvizjes paqësore të të 90-tave, dhe ato e kishin pjesën më të madhe të fajit që Kosova u la në tërësi jashtë rendit të ditës në procesin e Dejtonit. Edhe pse e luajtën një rol aktiv që nga dita e parë e veprimit të Grupit të Kontaktit, SHBA-të i ndërmoren hapat e parë të rëndësishëm për marrjen e rolit drejtues vetëm më 1998. Që nga ajo kohë vazhdoi dërgimi i sinjaleve të përziera.

Në një konferencë për shtyp, më 23 shkurt 1998 në Beograd, Ambasadori Special i SHBA-ve Gellbart, i dha lavdata të forta Millosheviqit për përkrahjen e dhënë gjatë procesit të Dejtonit, por ky njëkohësisht e shprehu edhe shqetësimin e SHBA-ve për përshkallëzimin e dhunës në Kosovë, si dhe nevojën për një dialog serioz. Ai e dënoi “shumë fuqishëm” dhunën e papranueshme e cila bëhej nga grupet terroriste në Kosovë, dhe në veçanti nga UÇK-ja. “Ajo pa dyshim e paraqet një grup terrorist. Lidhur me këtë, nuk e pranoj asnjë lloj arsyetimi. Duke punuar me vite të tëra në aktivitetet kundërterroriste, unë e di shumë mirë se kur jam duke e parë një grup terrorist, dhe di ta definoj atë; mos ua veni veshin fjalëve, por veprimeve të grupit. Dhe veprimet e këtij grupi flasin vetvetiu.”²³ Rëndësia e zyrtarëve të lartë të SHBA-ve, që në këtë kontekst në mënyrë eksplicite e bënë ndërlidhjen e UÇK-së me terrorizmin, nuk do të duhej nënçmuar në aspektin e politikës së jashtme të SHB-ve në dekadat e fundit. Kjo nga Beogradi mbase u kuptua si një shenjë që RFJ-ja mund të veprojë në Kosovë si të dojë, pa e shkaktuar ndonjë reagim kritik nga Perëndimi, përderisa si cak kryesor të jetë sfida e shtruar nga UÇK-ja, dhe jo popullata civile. Pa kaluar as edhe një javë nga kjo deklaratë e Gelbartit, forcat serbe në Prekaz e sulmuan dhe mëpastaj i masakruan udhëheqësin e famshëm Adem Jasharin, së bashku me anëtarët e tjerë të familjes së tij.

Në majin e vitit 1998, kur lufta civile kishte marrë hov, Shtetet e Bashkuara e dërguan Riçard Hollbrukun për t'i dhënë shtytje dialogut të LDK-së me Beogradin. Hollbruku bisedoi me Millosheviqin, dhe mëpastaj organizoi që Rugova dhe disa udhëheqës të

tjerë shqiptarë të takohen me Millosheviqin – ky ishte një hap kontraverz deri në skajshmëri përbrenda LDK-së, e cila për hir të parimeve më parë iu ishte shmangur të gjitha takimeve me Beogradin pa ndërmjetësim të jashtëm.²⁴ Delegacioni i LDK-së shkoi, po ashtu, edhe në Washington, ku u takua me Klintonin, duke e bërë në këtë mënyrë një veprim të rëndësishëm, mirëpo tepër të vonuar të dhënies së mbështetjes nga nivelet më të larta për opozitën alternative në Kosovë, në krahasim me atë për UÇK-në. Megjithatë, me rritjen e numrit të sulmeve serbe kundër popullatës civile në Kosovë, dhe me rritjen e forcës së UÇK-së, po bëhej e qartë që tashmë ishte tepër vonë për ta zgjidhur konfliktin pa ia dhënë UÇK-së rolin kyq në këtë proces.

Pas ngjarjeve të cilat ndodhën gjatë verës 1998, sa i përket SHBA-ve, çështja e Millosheviqit dhe e UÇK-së vazhdojnë të mbesin të diskutueshme. KDOM-i ishte përqendruar në unifikimin e UÇK-së. Është për tu besuar që serbët dhe Millosheviqi duhet të kenë patur raporte të shumta për këto lidhje të intensifikuara, dhe se, sipas të gjitha gjasave, kanë qenë të zhytur në mëdyshje të thella mbi atë se cili do të duhej të ishte qëllimi i mirëfilltë i kësaj pune. Është e logjikshme që inkurajimi i unitetit të UÇK-së, qoftë edhe nëse kjo ka qenë në interes të diplomacisë së pastër, nga Beogradi do të jetë interpretuar si diçka që do të ketë pasoja ushtarake dhe që do të shpie në dobësimin e përpjekjeve të RFJ-së për ta ruajtur kontrollin në Kosovë.

Për të qenë e tërë kjo befasi edhe më e madhe, në të njëjtën kohë, as SHBA-të dhe as BE-ja, nuk e kritikuan kushedi se sa përshkalëzimin e kundërofensivës serbe, ndonëse kjo kishte shkaktuar trazira të mëdha dhe zhvendosje të dhjetra mijëra shqiptarëve të Kosovës, të cilët tash ishin pa strehë mbi kokë. Kjo e tëra ka nxitur pohime sipas të cilave Perëndimi ishte i interesuar që Millosheviqit t'i lejonte rrugë të tjera për zgjidhjen e problemeve kokëqarëse që ai i kishte me UÇK-në, e që ishte një kontradiktë e vrazhdë e Marrëveshjes së Moskës të muajit qershor, ku Millosheviqi kishte premtuar ndërprerjen e dhunës serbe të drejtuar kundër popullatës civile të Kosovës.

Në shtator, kur vuajtjet e popullatës civile ishin shtuar për së tepërmi, erdhi momenti i befasishtëm i nismës diplomatike. Me 23 shtator 1998, u miratua Rezoluta 1199 e KS të OKB-së, e cila i dënonte sulmet serbe. Menjëherë pas kësaj, Shtetet e Bashkuara organizuan përpjekje diplomatike me një përqëndrim të fuqishëm në të bindurit e shteteve evropiane se, në fakt, kërcënimi i NATO-s për përdorimin e forcës, si dhe kërkesat plotësuese për një prani paqeruajtëse në Kosovë, ishin mjeti i vetëm i mundshëm për ta bindur Millosheviqin që ta garantojë një minimum të të drejtave të njeriut për kosovarët. Përpos disa ngurrimeve ligjore e politike, të gjitha shtetet e NATO-s u pajtuan me këtë qëndrim.²⁵ Ky konsensus shpuri tek urdhëri i NATO-s për

veprim, më 13 tetor 1998, e i cili ishte hartuar si një përgatitje për bombardimet ajrore kundër RFJ-së, në rast se ajo nuk do t'i përmbahej Rezolutës 1199. SHBA-të tani nuk kishin dëshirë që çështja e përdorimit të forcës të vihej para KS të OKB-së, për shkak të vetos së mundshme, sepse kjo gjë do ta vinte NATO-n në një pozitë edhe më të vështirë sesa të përdorurit mospërfillës i forcës. SHBA-të qartazi dëshironin ta evitonin këtë gjendje, e cila shihej si dobësim i bindshmërisë së kërcënimit, dhe ato, po ashtu, e dëshironin një anashkalim të autoritetit të OKB-së, i cili, po ashtu, ka mundur ta dobësonte koherencën në radhët e anëtarëve të NATO-s.

Përpjekja e parafundit për ta gjetur një zgjidhje diplomatike ishte Marrëveshja Hollbruk - Millosheviq, e tetorit 1998. Hollbruku ia arriti ta nxirrte një marrëveshje nga Millosheviqi për zvogëlimin e fushatës kundër kryengritjes në Kosovë, por vetëm duke e ritheksuar kërcënimin e bombardimeve të NATO-s, si dhe garancën e pasigurtë që UÇK-ja do t'i ndërpriste sulmet e saj.²⁶ Fakti, mbase më i rëndësishëm në këtë rast, kur të kihet parasysh mosbesimi i përgjithshëm që mbretëronte në Perëndim për “premtimet” e Millosheviqit, ishte pëlqimi që Hollbruku e siguroi për ardhjen e vëzhguesve në Kosovë, me fjalë të tjera, arritjen e 2.000 vëzhguesve të OSBE-së si dhe fluturimet mbikëqyrëse të NATO-s.

Rezoluta 1203 e KS të OKB-së, dhe kërcënimi për bombardime i bërë në tetor, ishin vazhdimësi e një vargu të gjatë të sinjaleve të përziera. UÇK-ja këtë e kuptoi si premtim për ndërhyrjen e NATO-s, e cila do të ndodhte së shpejti, dhe e intensifikoi përdorimin e dhunës kundër serbëve, me qëllim të ndërkombëtarizmit përfundimtar të konfliktit. Është e qartë që udhëheqja e UÇK-së besonte që vetëm iniciativa intervenuese, me NATO-n të përfshirë në të, do të mund ta shpiente lëvizjen e saj për pavarësi më afër realizimit. Pa ndërhyrje ushtarake, UÇK-ja vetëm, nuk ka mundur të shpresonte që do të mund ta sfidonte epërsinë e padyshimtë të RFJ-së në Kosovë, dhe e tëra që ka mundur ta bënte ishte sfida e një kryengritjeje sporadike, e cila do ta mbante shkallën e tensionit në nivel të lartë, mirëpo duke e paguar një çmim së tepërmi të lartë në vuajtjet e mëdha për shqiptarët e Kosovës. Kështu që, Urdhëri për Aktivizim i NATO-s, u duk që e solli UÇK-në më afër qëllimit të saj.

Millosheviqi, nga ana tjetër, ishte duke u ballafaquar me një vargan të ngjarjeve që i dilnin gjithnjë e më konfuze. Hollbruku e kishte patur më parë një takim sekret me UÇK-në. Gjatë këtij takimi ai ishte shoqëruar nga një ushtar i uniformuar dhe i armatosur i UÇK-së, i cili, në një moment, ishte ulur pranë tij. Ata pak fotoreporterë të pranishëm kishin përfituar nga ky rast i veçantë, dhe Hollbruku doli para botës si një mik i besueshëm i UÇK-së, duke e lënë kështu përshtypjen e një premtimi për

bashkëpunim me UÇK-në. Në të njëjtën kohë, OKB-ja e garantonte Beogradin që statusi i Kosovës si pjesë e RFJ-së do të mbetej i pandryshuar. Rezolutat, si të OKB-së ashtu edhe të Grupit të Kontaktit, vazhdimisht kërkonin kujdes dhe mbrojtje të popullatës civile nga strategjitë “terroriste,” mirëpo asnjëra nuk e ndalonte përkrahjen e jashtme për UÇK-në, e, nga ana tjetër, Hollbruku as që ishte konsultuar ndonjëherë me udhëheqjen civile të LDK-së para takimeve me Millosheviqin.

Prandaj edhe nuk është për t’u habitur fare që UÇK-ja, përkundër garancave të Hollbrukut për të kundërtën, përfitoi nga kjo ndërprerje e luftimeve për t’u riarmatosur dhe për t’i ripërtirre veprimet ushtarake. Në fakt, forcat e UÇK-së u vërsulën për t’i zënë pozicionet e braktisura nga forcat e ripozicionuara serbe. Megjithë retorikën e grupit të Kontaktit për të mos i heshtur sulmet terroriste të UÇK-së, nga Perëndimi nuk ishte bërë as edhe një përpjekje për ta penguar ardhjen e parave dhe të armëve për UÇK-në, apo, madje, edhe për t’i bërë ndonjë sfidë taktikave të saj provokative. Aftësitë e SHBA-ve për ta kontrolluar UÇK-në në këtë periudhë, vërtet, mund të kenë qenë mjaft të kufizuara, mirëpo nuk ka kurrfarë të dhënash që përpjekje të tilla të jenë bërë fare.

Në këtë mënyrë, këtu na paraqitet një konfuzion, apo më mirë ta quajmë kundërtënie, lidhur me raportet e Perëndimit me UÇK-në. Është për t’u besuar, nga njëra anë, që UÇK-ja shihej si një trajtë e trysnisë e cila do ta detyronte Millosheviqin për ta arritur ndonjë zgjidhje, sepse, në të kundërtën do të duhej të ballafaqohej me një sfidë edhe më të fuqishme të kryengritjes kundër sovranitetit të RFJ-së. Nga ana tjetër, ndërlidhja me UÇK-në, mbase e ka forcuar përshtypjen në Beograd që Perëndimi ishte duke e përkrahur variantin e ndarjes së Kosovës, dhe se çfarëdo qoftë marrëveshje e cila do ta lejonte hyrjen e NATO-s në Kosovë, vetëm që do të përdorej për arritjen e qëllimeve të UÇK-së. Në të njëjtën kohë, duket qartë që Millosheviqi bëri llogari të gabuara, duke u besuar efekteve të fushatës serbe kundër UÇK-së në muajt e saj të parë, gjë që e bëri të supozonte që kërcënimi nga UÇK-ja ishte mënjanuar. Ky është një nga ai lloj i gabimeve që janë karakteristike për luftrat kundër kryengritjeve: pasiviteti i sfidës kryengritëse interpretohet si mposhtje e saj, dhe, mëpastaj, shfaqja e sërishtme e rezistencës së armatosur vie si një befasi e papritur.

Ndonëse asnjëra palë nuk e respektoi marrëveshjen e Hollbrukut për ndonjë kohë kushedi se sa të gjatë, edhe pushimi i shkurtër i armiqësive, i shoqëruar me praninë e MVK-së, pati efekte të dukshme në përmirësimin e gjendjes së vështirë të civilëve kosovarë. Ndonëse RFJ-ja e bëri ripozicionimin e trupave, shkalla e dhunës ndaj popullatës civile u zvogëluar në një masë të konsiderueshme gjatë tërë kohës sa vëzhguesit e

MVK-së ishin të pranishëm, kështu që gjatë kësaj periudhe një numër i madh i kosovarëve të zhvendosur filluan të kthehen në shtëpitë e tyre. Katastrofa humanitare e cila parashihej se mund të ndodhte gjatë dimrit të ftohtë, u shmang me sukses, mirëpo kjo ishte vetëm e përkohshme. As marrëveshja e Holbrukut, dhe as prania e MVK-së, nuk e ndryshuan strukturën e sistemit të dhunës apo pasojat e humbjes së autonomisë së Kosovës. Por këto, po ashtu, nuk mund ta kënaqnin kërkesën për vetëvendosje të popullit të Kosovës. Dhe, nga ana tjetër, prania e vëzhguesve, vetvetiu, nuk mund ta ndalte shpërthimin e sërishëm të luftës, në veçanti kur të kihen parasysh kërkesat e papajtueshme të të dyja palëve të armatosura, për pavarësi nga njëra anë, dhe për sovranitet nga ana tjetër. Mirëpo kjo, megjithatë, ia arriti t'i pakësonte vuajtjet e popullatës civile, e kjo nuk ishte pak. Nga këto përvoja mund të nxirren shumë mësimë të rëndësishme lidhur me efikasitetin e misioneve të paarmatosura për ndërprerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe për zvogëlimin, nëse jo edhe parandalimin, e një katastrofe humanitare, madje edhe në rrethana të armiqësive të skajshme.

Rambujsja

Siç e tregoi shqyrtimi i mëparshëm, UÇK-ja nuk ishte e interesuar për ndërprerje të zjarrit. Ajo përfitoi nga tërheqja e pjesërishme e forcave serbe për t'i forcuar pozitat e veta, duke llogaritur, me gjasë, dhe atë në mënyrë plotësisht të saktë, që si rezultat i kësaj do të pasojë kundërveprimi i dhunshëm serb. Verifikuesit e paarmatosur këtë nuk kanë mundur ta parandalonin. Si LDK-ja ashtu edhe UÇK-ja e dëshironin një prani të armatosur të NATO-s në terren, dhe asnjërisht as që i shkonte mendja të hiqte dorë nga synimi politik i arritjes së pavarësisë. Menjëherë pas marrëveshjes Hollbruk - Millosheviq, i ashtuquajturit Shtab i UÇK-së doli me një deklaratë të fortë dhe kërcënuese, e në të cilën thuhej që "UÇK-ja do ta dënonte secilin që do ta mirrte guximin të nënshkruante ndonjë marrëveshje e cila do të ofronte më pak se vendimi i popullit të Kosovës i shprehur me Referendimin e vitit 1991," domethënë nga pavarësia.²⁷ UÇK-ja i ka kritikuar vazhdimisht dhe fuqishëm planet e ndryshme për marrëveshje politike me Beogradin të cilat, në emër të Grupit të Kontaktit, i kishte dhënë Ambasadori Hill. Hilli, nga ana e vet, e bënte të ditur që ishte e pamundur të arrihej ndonjë marrëveshje për statusin e ardhshëm të Kosovës, mirëpo ai po ashtu e shtonte që shpresonte se do të gjendeshin mundësi për ta arritur një mirëkuptim joformal për një periudhë trevjeçare, e cila do të ishte stabile dhe normale, dhe se pas kësaj periudhe duhej që sërish të bëheshin përpjekje për ndonjë zgjidhje. Secili nga projektet e Hillit është kritikuar si nga UÇK-ja, ashtu edhe nga RFJ-ja. Në këtë mënyrë

dukej që procesi paqësor kishte hyrë në një rrugë pa krye. Asnjëra palë nuk e shfaqte ndonjë interes për të biseduar për ndonjë zgjidhje politike. Rambujeja ishte përpjekja e fundit për ta arritur ndonjë përparim.

Kërcënimi i NATO-s për përdorim të forcës e ka patur gjithsesi një ndikim të rëndësishëm për ta bindur Millosheviqin që, të paktën, ta diskutonte çështjen. Mirëpo ky fakt shkaktonte, nga ana tjetër, që UÇK-ja të ishte gjithnjë e më pak e interesuar për çfarëdo negociatash a kompromisesh. Sa më i fortë që ishte kërcënimi, aq më shumë zvogëlohej gatishmëria e UÇK-së për negociata. Kjo ka qenë dilema më e madhe të cilën e ka shkaktuar insistimi për përdorimin e kërcënimit të forcës për t'i arritur negociatat.

Shumë vëzhgues e shprehin dyshimin e tyre që pjesëmarrja e Serbisë në Rambuje u bë me shpresa apo synime për ta arritur një marrëveshje për të ardhmen e Kosovës. Millosheviqi, pohonin ata, e përdorte procesin e negociatave për të blerë kohë, ashtu që të përgatitej për sulmin e radhës në Kosovë. Në fillim ai nuk dërgoi delegacion të ndonjë rangu të lartë në Rambuje, dhe madje edhe ata të cilët i dërgoi dukej sikur nuk angazhoheshin në proces me të tërë kapacitetin që e kishin. Dhe, për më tepër, në momente të caktuara, kur negociatorët evropianë apo edhe ata të SHBA-ve nervozoheshin nga qëndrimi i Beogradit, ata ishin në gjendje ta jipnin ndonjë përgjigje më serioze rreth çështjeve në fjalë, vetëm pasi që t'i kontaktonin me telefon udhëheqësit e RFJ-së në Beograd. Në fazën e mëvonshme, për negociata më të drejtpërdrejta, në Paris ishte dërguar Kryetari i Serbisë Millan Millutinoviç.

Për dallim nga kjo, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës përbëhej nga përfaqësues të rangut më të lartë, si nga UÇK-ja, ashtu edhe nga lëvizja civile. Ky legjitimitet, megjithatë, shoqërohej nga një luftë serioze e brendshme për pushtet, si dhe nga një mungesë e madhe e unitetit sa i përket synimeve dhe strategjisë së negociatave. Perceptimi publik i diplomacisë kosovare e forcoi imazhin se ishte udhëheqja e UÇK-së, dhe jo ajo e LDK-së, ajo e cila ishte opozita kyqe e zëshme.

Grupi i Kontaktit, megjithë unitetin lidhur me parime të caktuara kryesore, edhe më tej ishte vetëm një aleancë e lojtarëve nga shtete të pavaruara me agjenda dhe prioritetet të shumëllojshme, e të cilat nganjëherë ishin edhe konfliktuoze. Shumë evropianë takimin e Rambujesë e shihnin si një "Dejton të Evropës," i cili duhej të rezultonte me një zgjidhje diplomatike e cila do të krijonte gjendje dhe rrethana në të cilat zgjidhja përfundimtare do të bëhej e mundur pa luftë. Disa nga zyrtarët në qarqet e larta politike të SHBA-ve, pajtoheshin hapur me këto qëndrime optimiste. Por shihej qartë se kishte edhe lojtarë të tjerë kyç amerikan, e të cilët procesin në Rambuje e shi-

hnin krejtësisht ndryshe. Njëri nga qëllimet ishte që të ndihmoheshin anëtarët e heshtur evropianë të NATO-s për ta arsyetuar një ndërhyrje të armatosur para elektorateve të tyre kombëtare, ashtu që të ndërtohej një koalicion më i fortë në interes të asaj që filloi të shihej pothuaj si një mbështetje e sigurtë në forcë. Të tjerë në grupin amerikan dëshironin, para së gjithash, që t'i unifikonin qëndrimet e ndryshme të pranishme në palën e shqiptarëve të Kosovës, duke e forcuar në këtë mënyrë anën normative për intervenim, e i cili do të ndodhte pavarësisht nga ajo se çfarë do të ishte qëndrimi përfundimtar i Serbisë. Në disa raste gjatë procesit, Madeleine Albright dhe James Rubin dhanë deklarata të cilat i konfirmonin pikëpamjet e njëanshme të shprehura gjatë këtij procesi. Më 21 shkurt, për shembull, Rubin e dha deklaratën për shtyp në të cilën thoshte se “për t’iu ofruar aksionit të armatosur, duhet të bëhet e qartë që përgjegjës për këtë janë serbët.” Në po të njëjtën frymë, Albright deklaronte: ”tani është në palën shqiptare që ta krijojë një situatë të zezë apo të bardhë (...) ashtu që ta bëjnë të qartë se ajo të cilën ata e duan është forca implementuese e NATO-s.”²⁸

Negociatat në Rambuje filluan me dy dokumente themelore: parimet themelore “të pa negociueshme,” të caktuara nga Grupi i Kontaktit, dhe me projekt-dokumentin e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Serbët i miratuan Parimet Themelore, ndërsa shqiptarët e Kosovës këto nuk i pranuan, ku shkak kryesor për këtë ishte refuzimi i tyre për ta pranuar pamundësinë e negociimit të “integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë.” Nëse çështja e integritetit territorial të RFJ-së nuk do të shtrohej fare, ishte e pamundur ruajtja e qëllimit të tyre për pavarësi. Projekti i Marrëveshjes së Përkohshme ishte produkt i bredhjeve para e prapa disamujore të anëtarëve të Grupit të Kontaktit, dhe në veçanti të diplomatit amerikan Chris Hill. Në diskutimet që pasuan, megjithë mospajtimin e tyre me Parimet Themelore, shqiptarët e Kosovës duket që ishin paksa më fleksibil, kështu që e lehtësuan avancimin e shpejtë të diskutimeve rreth Marrëveshjes së Përkohshme, edhe pse ata asnjëherë nuk dhanë shenja të pajtimit me idenë e autonomisë si alternativë për pavarësi.²⁹ Në ndërkohë, negociatorët e Grupit të Kontaktit duket që kishin arritur përparim në “negociatat” me Beogradin përmes telefonit. Me gjasë, kooperativiteti i shqiptarëve, u interpretua në mënyrë të gabuar si një dobësi, kështu që Grupi i Kontaktit u kthye në tryezën e bisedimeve me një propozim të ri, i cili nga negociatorët shqiptarë u hodh poshtë si një qëndrim që edhe më shumë ishte “pro-Beogradit.”³⁰

Ashtu siç edhe ka mundur të pritej, pjesa më e vështirë e arritjes së marrëveshjes politike kishte të bënte me statusin e ardhshëm, e cila e shtronte pyetjen se çfarë mekanizmi do të përdorej pas tre vjetësh për ta bërë hapin e parë të fazës së ardhshme të

administrimit të Kosovës. Ideja lidhur me referendumin ishte e pranueshme për kosovarët, por jo edhe për Serbinë, e mbase as për NATO-n. As NATO-ja dhe as vendet e Ballkanit të Jugut nuk e pëlqenin idenë e pavarësisë së Kosovës, dhe për këtë arsye Grupi i Kontaktit ishte i vendosur në qëndrimin e vet për mosndryshimin e kufijve. Nga ana tjetër, diskutimet për takime të tjera ndërkombëtare, ose për procese të cilat nuk do të lejonin që vendimi për Kosovën të lihej vetëm në duart e popullatës kosovare, mund të kenë qenë të pranueshme për Serbinë. Të dy palët e kuptuan që Grupi i Kontaktit nuk e përkrahte pavarësinë, prandaj duket se kishte gjasa që marrëveshja mund të ishte arritur vetëm në bazë të ndonjë propozimi i cili do ta linte çështjen e statusit të pazgjidhur dhe të dykuptimtë, duke lënë hapësirë për zhvillime të cilat do të pasonin gjatë tri viteve të ardhshme. Po ashtu, përderisa qëllimet e serbëve dhe të Grupit të Kontaktit esencialisht përputheshin sa i përket çështjes së statusit final, çfarëdo propozimi i negociueshëm padyshim kërkonte që të ushtrohej trysni ndaj palës shqiptare të Kosovës.

SHBA-të tashmë e kishin bërë një trysni të fuqishme mbi UÇK-në për ta pranuar një marrëveshje, si një lloj parakushti për ndërhyrjen e mëpastajme të NATO-s. Për ta ulur UÇK-në në tryezë të bisedimeve, propozimi i janarit i Ambasadorit Hill kishte shënuar hapa të qartë drejt pavarësisë.³¹ Në Rambuje, shqiptarët e Kosovës u kërcënuan që po qe se nuk do të bashkëpunonin me diplomacinë e NATO-s, atëherë vendet perëndimore do të ndërmirrnin veprime të rrepta për ta ndërprerë financimin nga diaspora për UÇK-në, që trupat e vendeve anëtare të NATO-s do të mund të vendosehin përgjatë kufirit të Shqipërisë me Kosovën për ta ndërprerë furnizimin me armatim, si dhe që SHBA-të dhe vendet e tjera do të mund ta ndërronin qëndrimin e tyre, duke e shpallur UÇK-në si grup terrorist.³² Natyrisht, Grupi i Kontaktit kishte kërkuar më shumë se një vit që UÇK-ja të pengohet, por kjo nuk ishte zbatuar në praktikën e vendeve anëtare, prandaj edhe nuk kishte gjasa të mëdha që kërcënimet e tilla të kuptoheshin seriozisht.

Hulumtimet e Komisionit sollën deri te përfundimi që shumica e vendeve të “Grupit Perëndimor” (me përjashtimin, mbase, të SHBA-ve), kanë pritur që Millosheviqi do të pajtohej për ta arritur një marrëveshje, duke u mbështetur në kërcënimin me bombardime. Grupi i Kosovës, apo UÇK-ja, dukej sikur nuk e paraqiste ndonjë problem serioz; tekefundit, supozohej që ata do të nënshkruanin nëse trupat e armatosura të NATO-s do të vendosehin në terren. Për ta bindur Millosheviqin që ta pranonte marrëveshjen, Ambasadori Hill bëri përpjekje të shumta në bisedimet e drejtpërdrejta që i pati me të në Beograd. UÇK-ja protestonte kundër kësaj procedure, dhe këto protesta u bënë edhe më të zëshme kur ata e panë propozimin i cili doli nga këto takime.

Sipas pikëpamjeve të UÇK-së, projekti i ri kishte pësuar ndryshime të cilat ishin pasojë e pajtimit me kërkesat e Beogradit - dhe kjo, në fakt, ishte plotësisht e vërtetë.

Pas shumë diskutimesh të ngatërruara, delegacioni i Kosovës pranoi ta nënshkruante verzionin e marrëveshjes që u dha më 23 shkurt. Paragrafi më i rëndësishëm lidhur me të ardhmen e Kosovës, tani e theksonte që pas tri vitesh do të mbahej një konferencë ndërkombëtare për ta përcaktuar “zgjdhjen përfundimtare për Kosovën,” gjë që do të bëhej duke e respektuar “vullnetin e popullit,” mirëpo, po ashtu, edhe “mendimet e autoriteteve relevante.” Siç e thekson Uelleri, në këtë tekst ka shumëkuptimesi.³³ SHBA-të e bënë përpjekjen e fundit, duket të suksesshme, për t’i bindur kosovarët që ta nënshkruajnë këtë marrëveshje, me një Aneks të veçantë në të cilin konfirmohej që pas tri vitesh Kosova do të mund ta mbante referendumin, por, megjithatë, pa e saktësuar që referendumi do të mund ta vendoste zgjidhjen përfundimtare. Deklaratat që UÇK-ja i dha në fundin e shkurtit, e konfirmonin “qëndrimin e saj për pavarësi.” Bashkësia Ndërkombëtare është ende duke u ballafaquar me këtë dykuptimësi.

Një herë pasi që këto negociata përfunduan, në fazën e vonshme të konferencës së Rambujesë, u prezentua edhe një dokument tjetër qenësor, i njohur si “Aneksi B,” e i cili i përmbante dispozitat implementuese të marrëveshjes, dhe në veçanti dispozitat ushtarake. Megjithëse “Aneksi B” asnjëherë nuk u debatua në tërësi nga palët në Rambuje, rëndësia e dispozitave të tij kishte ndikim të qartë në procesin politik, dhe ky aneks gjerësisht është vlerësuar si një gaf.³⁴ Këtu hynte marrëveshja që NATO-ja, dhe jo OKB-ja, do t’i mbante trupat në territorin e RFJ-së, dhe se këtyre forcave duhet t’u jepet mundësia për të kaluar nëpër të gjitha pjesët e territorit të RFJ-së, dhe atë me shpenzimet që do të mbuloreshin nga Bogradi. Edhe pse këto dispozita u hoqën nga standardet e procedurave të drejta paqeruajtëse të OKB-së, kompetencat imponuese të cilat ato i deleguan në këtë rast tek NATO-ja, jashta ndonjë konteskti të OKB-së, e synonin forcimin e dyshimit dhe të kundërshtimit nga Serbia, me një theks të veçantë në atë që ajo ta kuptonte që NATO-ja tashmë ishte duke e kërcënuar Serbinë me sulme, edhe pa ndonjë mbështetje të autorizimit nga OKB-ja. Millosheviqi po ashtu e përdori këtë kërkesë të padëshiruar për kompetencat e forcave paqeruajtëse të NATO-s, për t’i shpjeguar dhe legjitimuar veprimet e tij. Ai i përdori këto për ta ushqyer frikën paranoike serbe, për të dëshmuar se ekzistonte një plan sekret për përmbysjen e regjimit të tij dhe për ndërhyrje të rënda në integritetin territorial dhe në pavarësinë politike të RFJ-së si një vend sovran.

Edhe përkundër shqetësimeve të tilla, gjatë fazës së fundit të konferencës së Rambujesë pjesëmarrja serbe u shtua me Presidentin e Serbisë, Millan Millutinoviç, i cili

vepronte nga ambasada jugosllave në Paris. Pas takimit të cilin, më 20 shkurt e pati me Millutinoviçin, Madeleine Albright theksoi se ai kishte deklaruar që “serbët mund ta praninin marrëveshjen politike,” por më tutje ajo shtoi që “refuzimi serb, madje edhe për ta diskutuar praninë e forcës implementuese të drejtuar nga NATO-ja (...) e mbarte përgjegjësinë më të madhe të dështimit për arritjen e marrëveshjes.”³⁵

Disa analistë shprehin dyshim që Serbia do të pajtohej me parimet politike, madje edhe sikur dispozitat implementuese të ndryshoheshin. Të tjerët, ndërkaq, dyshojnë që çfarëdo marrëveshje e nënshkruar nga serbët nuk do të kishte sukses pa një prani të fuqishme të udhëhequr nga NATO-ja, dhe atë me një kohëzgjatje të pacaktuar. Ndërkaq, UÇK-ja në këtë kohë e kishte bllokuar çfarëdo lëvizje drejt marrëveshjes nga frika e ndonjë epilogu i cili do ta sillte ndonjë zgjidhje e cila Kosovën do ta linte nën sovranitetin e Beogradit. Mirëpo, megjithë këto kujdesje të tepërta, deklarata e Sekretares së Shtetit Albright ishte një tregues i qartë që ishte hapja e negociatave ajo e cila ka mundur ta tejkalonte bllokadën e ditëve të fundit në Rambuje. Nëse NATO-ja do ta iniconte një ofertë për zbutjen e dispozitave implementuese, Serbia do ta kishte humbur arsyetimin kryesor për mosnënshkrimin e marrëveshjes.

Chris Hill më vonë deklaroi që është e mundur që marrëveshjet të implementohen “mirëpo serbët nuk do të angazhohen.”³⁶ Megjithatë, nuk ka të dhëna të sigurta që NATO-ja është angazhuar rreth kësaj oferte. Në të vërtetë, Albright dhe të tjerët kanë qenë aq të vendosur rreth supremacisë së NATO-s krahasuar me cilindo aktor tjetër ndërkombëtar në kontekstin ekzistues, dhe për këtë arsye aq shumë aspekte në procesin e Rambujesë janë paraqitur qartazi si “të panegociueshme,” sa që Serbia kishte fare pak arsye që ta priste ndonjë fleksibilitet nga NATO-ja. Nëse marrëveshja ishte e mundur ajo do të duhej të ishte inicuar nga forcat e NATO-s.

Chris Hill e vuri në dukje po ashtu edhe atë që Millosheviqi ishte i hapur ndaj marrëveshjes politike të Rambujesë, por dëshironte t’i shmangej elementit ushtarak i cili ishte pjesë e saj, meqë “ai e ndiente se qëllimi i vërtetë i forcës ishte eliminimi i tij dhe/ose shkëputja e Kosovës nga Serbia. Në fakt, në marrëveshjen politike nuk kishte asgjë e cila nuk ka mundur t’u shitej serbëve.”³⁷ Atëherë Shtetet e Bashkuara e vërejtën shqetësimin e thellë të Millosheviqit për pushtetin personal. Angazhimi i OKB-së, dhe në veçanti pjesëmarrja e Ruisë në implementimin ushtarak, do të mund t’i kishte zbutur këto shqetësime. Me sa dihet, një ofertë e tillë nuk është bërë fare.

Shkaqet e mungesës së fleksibilitetit të SHBA-ve dhe të NATO-s nuk kishin të bënin vetëm me çështjen e Kosovës. NATO-ja ishte e interesuar ta qartësonte mandatin e saj afatgjatë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ndërkaq përvjetori i pesëdhjetë, i cili do

të shënohej në prill 1999, do të ishte momenti vendimtar në këtë proces. Në këtë kuadër, mbështetja në diplomaci kërcënuese ishte në shpërputhje me ndonjë lëkundje në radhët e NATO-s. Me fjalë të tjera, kërcënimi për ta përdorur forcën për realizimin e një epilogu që është i panegociueshëm, d.m.th. praninë e forcës paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë, e përjashtonte mundësinë e ndonjë kompromisi alternativ. Çfarëdo diskutimi në trajtë pazarllëku, do të ishte i papajtuueshëm dhe do t'i kushtonte shtrenjtë kredibilitetit të NATO-s si faktor politik. Me angazhimin e NATO-s në diplomaci, kredibiliteti u shndërrua në një çështje të rëndësishme.

Në rrethanat e konfuzionit dhe të dallimeve të mëdha në radhët e shqiptarëve të Kosovës, për palën serbe do të kishte qenë e mundur që ta nënshkruante marrëveshjen e cila do të ishte relativisht e mirë nga pikëpamja e tyre – kuptohet, nëse do të kishte patur interesim të mjaftueshëm për marrëveshje dhe, mbi të gjithat, po të kishin qenë të përgatitur ta pranonin një forcë të armatosur ndërkombëtare në Kosovë. Në disa raste pas përfundimit të bisedimeve, anëtarët e delegacionit të RFJ-së deklaruan se ata ishin të përgatitur të diskutojnë edhe për mundësinë e një force implementuese ndërkombëtare në Kosovë, por a e kishin fjalën për një forcë të armatosur apo jo, kjo është një çështje e cila ende nuk dihet. Dhe, së fundit, Millosheviqi kishte bërë llogari të gabuara të efekteve të mosnënshkrimit të marrëveshjes. Si pasojë, Serbia e përjetoi një shkatërrim të pjesshëm, dhe, pak a shumë, e humbi të tërë ndikimin në zhvillimet e ardhshme në Kosovë, si dhe aftësinë për t'i mbrojtur serbët e atjeshëm (nëse ky ka qenë vërtetë preokupim i saj fare).

Afatet e fundit

Procesi i Rambujesë mund të definohet në bazë të karakteristikave të tij, e që ishin afatet fikse, të kombinuara me ultimatumin e bombardimit. Është e qartë që kjo nuk ishte një qasje e pakuptimtë për ta bindur Serbinë që nuk do të mund ta bllokonte dhe bishtnonte procesin, ose që të bënte koncesione në letër, e të cilat mëpastaj do t'i tërhiqte duke mos i zbatuar në praktikë. Duke u ballafaquar me një bashkëbisedues hipokrit çfarë ishte Millosheviqi, për Albrightin dhe të tjerët ishte e qartë që taktika e vetme e cila do të mund të shkaktonte ndryshime në politikën e Serbisë ndaj Kosovës ishte ajo me afat të fundit - dhe me ultimatum të forcës paqeruajtëse. Megjithatë, kjo strategji po ashtu ishte edhe mjaft problematike. E drejta ndërkombëtare formalisht e përjashton përdorimin e kërcënimit me forcë gjatë bisedimeve ndërkombëtare. Strategjia, përkatësisht hazardi i saj gjatë lojës me zjarr, nuk është një

qasje e mirë për zgjidhjen e problemeve të theksuara, ose që e kanë luftën si mjet të fundit. Për fat të keq, si në Bosnje, ashtu edhe në rastin e Kosovës, u pa që vetëm kërcënimi me forcë dhe afatet e fundit e bënë të mundur mbajtjen e bisedimeve.

Motivet për ndërhyrje

Përmasat e përgjithshme të dhunës në fundin e vitit 1998 dhe në fillimin e atij 1999, në prag të vendimit të NATO-s për t'i filluar sulmet ajrore, duket se kanë qenë për disa shkallë më të ulta se sa dhuna e ushtruar gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998; mirëpo ishte masakra e Reçakut ajo e cila e kishte ndikimin vendimtar në opinionin publik dhe në qarqet diplomatike. Ajo shërbeu si një “këmbanë alarmi” simbolike, duke e sjellë NATO-n në dilemën serioze të ruajtjes së kredibilitetit të vet, pas ultimatumit të tetorit për bombardime. Duke i lënë mënjane opsionet e ndryshme diplomatike, diplomacia kërcënuese e ven kërcënuesin nën presionin e demonstrimit që ajo të cilën e ka deklaruar nuk është vetëm një bllof. Krahas rastit të tendosjeve në Bosnje, si dhe krizës së vetëbesimit në periudhën pas Luftës së Ftohtë, e cila qëndronte si një hije mbi të ardhmen e NATO-s, këta faktorë që kishin të bënin me kredibilitetin, konsideroheshin të një rëndësie shumë të madhe.

Në këtë mënyrë, shkak kryesor i ndërhyrjes ushtarake të NATO-s nuk ishte në shkallën imediate të katastrofës humanitare në fillimit e vitit 1999, por më tepër në shqyrtimin e njëkohsishtëm të përvojave nga e kaluara, me shqetësimet për të ardhmen:

Vendosmëria për të mos e lejuar përsëritjen e shkallës së dhunës dhe të zhvendosjeve që në Kosovë ndodhën më 1998;

Një vendosmëri tjetër për ta parandaluar “përsëritjen e Bosnjës,” duke i dhënë një rëndësi vendimtare politike e simbolike raporteve për masakrën e Reçakut;

Dëshira e cila ishte shfaqur pas tragjeditive të Bosnjes dhe të Ruandës, për të dëshmuar që Bashkësia Ndërkombëtare nën udhëheqjen e SHBA-ve, në përgjithësi ishte sinqerisht e vendosur për të parandaluar dhe dënuar shkeljet mizore të të drejtave të njeriut;

Nevoja e NATO-s për ta ruajtur kredibilitetin, duke i ndjekur interesat e veta dhe duke e dëshmuar një relevancë tjetërfare të aleancës evropiane për siguri dhe mirëqenie pas Luftës së Ftohtë, dhe në veçanti me rastin e aktiviteteve vijuese të 50-vjetorit të themelimit;

Shqetësimi në radhët e shteteve evropiane për t'i parandaluar migrimet masive që mund të shkaktoheshin nga një luftë e zgjeruar civile në rajon;

Bindja e theksuar, e cila mbështetej në përvojën e hidhur të viteve '90, sipas të cilës Millosheviqit nuk është person të cilit mund t'i besosh;

Bindja që vetëm një prani e armatosur në Kosovë, pa mundësi të pengimit me veto në KS të OKB-së, do të mund t'i krijonte kushtet për autonomi substanciale për Kosovën.

Përfundime

Çështja qendrore e shtruar në këtë kapitull është ajo se a ka mundur të shmangët lufta, por që shqiptarët e Kosovës në të njëjtën kohë të mbrohen në mënyrë efektive. Tensionet e shumta dhe të ndryshme kanë shkaktuar që përgjigja diplomatike të jetë e ngatërruar dhe e tillë që vetëm ngatërronte edhe më shumë. Të gjitha palët gabonin, duke bërë secila llogari në mënyrë të veten dhe për hesap të vetin. Vlerësimi i përgjithshëm për reagimin ndërkombëtar është në thelb një nga i cili nuk mund të nxirret ndonjë përfundim i qëndrueshëm, dhe, rrjedhimisht, edhe pa “mësime” të qarta lidhur me vëzhgimet e kujdesshme të situatave të ndryshme, dhe në favor të angazhimeve më të hershme, si dhe të kujdesit më të madh për opsionet paqësore. Megjithatë, ia vlen t'i përmendim disa përfundime kyçe:

Planet e shumta dhe të ndryshme, si dhe shenjat e përziera nga ana e SHBA-ve dhe Bashkësisë Ndërkombëtare, e kanë penguar efikasitetin e diplomacisë;

Përvoja e Bashkësisë Ndërkombëtare me Millosheviqin, si një person i papërgjegjshëm ndaj negociatorëve të rëndomtë, ka krijuar dilema të shumta. Konsiderohej që e vetmja gjuhë diplomatike për negociata të mundshme me të, ishte ajo e shtrengimit dhe e kërcënimit. Kjo shkaktoi probleme ligjore e diplomatike – një diplomaci e tillë kërcënuese ishte në kundërshtim me Kartën, dhe nuk është në përputhje me kërkimin e zgjidhjeve paqësore. Besueshmëria e kërcënimit, në fund të fundit, duhet të përcillet me përdorimin konkret të forcës;

Megjithkëtë, edhe përkundër të gjitha këtyre dobësive, është e pamundur të përfundohet nëse ka ekzistuar fare ndonjë mundësi për ta gjetur një zgjidhje diplomatike e cila do të kishte mundur t'i jipte fund luftës së brendshme për të ardhmen e Kosovës. Qëllimet minimale të shqiptarëve të Kosovës dhe të Beogradit kanë qenë të papajtueshme;

Ndikimi i luftës për zgjidhjen e këtyre kundërthënieve, u shkoi për shtati kryesisht shqiptarëve të Kosovës, duke e sjellur një strukturë evolutive të administrimit të Kosovës e cila de facto mbështetet në pavarësi;

Kontributi i Rusisë gjatë tërë këtij procesi ishte përplot dykuptimësi. Raportet e saj speciale me Serbinë e pamundësonin ndërmarrjen e hapave vendimtar diplomatik, ndërkohë që këmbëngulsia e saj për ta përdorur veton kundër çfarëdo qoftë veprimi me forcë, ishte faktori vendimtar i hyrjes së NATO-s në aksion pa ndonjë mandat;

Qëllimi i UÇK-së për ndërkombëtarizimin e konfliktit ishte konsistent përballë qëllimit të Beogradit për ta shtypur deri në fund sfidën e cila i shtrohej pushtetit të tij në Kosovë. Kjo edhe i mundësoi UÇK-së që ta bënte tryshninë e nevojshme në Bashkësinë Ndërkombëtare për intervenim.

6. E drejta ndërkombëtare dhe intervenimi humanitar

Çfarëdo vlerësimi i legjitimitetit të përdorimit të forcës nga ana e NATO-s në Kosovë dhe në Serbi, duhet t'i ketë parasysh edhe disa specifika të rrethanave ekzistuese. Popullata civile shqiptare e Kosovës ishte duke e përjetuar një katastrofë humanitare, dhe kësaj i bashkangjitej kujtesa ende e freskët dhe e hidhur e zhvillimeve në Bosnje (me fjalë të tjera, një dështim diplomatik i cili sapo kishte ndodhur, dhe atë për shkak të pavendosmërisë për të vepruar në parandalimin e pasojave tragjike). Millosheviqi ishte një kundërshtar me një dosje përplot mashtrime dhe kriminalitet, si dhe një person për të cilin pak kush besonte që do t'i zbatonte marrëveshjet e negociuara. Pas vjeshtës së vitit 1998, u pa që mundësia e veprimit politik të detyrueshëm nën ombrellën e OKB-së ishte e paralizueshme, për shkak se kjo do të pengohej nga vetoja e Rusisë dhe e Kinës.

Krahas këtyre rrethanave të dhëna, rezultatet e veprimit të NATO-s e kanë edhe një dimension tjetër. Ndonëse ndërhyrja përkohësisht e shkaktoi një përkeqësim të theksuar të situatës në të cilën ndodheshin shqiptarët e Kosovës, me kalimin e kohës kjo e zhduki frikën e tyre nga më e keqja, pra nga spastrimi etnik, dhe për ta përfundimisht e pati efektin çlirimtar, duke i zhbërë strukturat e policisë dhe të paramilitarëve serbë. Pjesëmarrja e Kombeve të Bashkuara, pas ndërhyrjes në procesin e negociimit për t'i dhënë fund përdorimit të forcës nga ana e NATO-s (Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit), e lë përshtypjen e një ex post legjitimiteti të OKB-së në këtë operacion. Pos kësaj, në këtë kuadër duhet përmendur edhe faktin që në dinamikën e pasluftës erdhi deri te "spastrimi etnik nga pala tjetër," ku minoritetet serbe dhe rome të Kosovës tash u shndërruan në viktimat kryesore.

Duhet theksuar, po ashtu, se kriza në thelb ishte e nxitur nga shkeljet serbe të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë dekadës së viteve '90, edhe pse kalimi në luftë të armatosur më qëllim të vendosur për shpëputje nga ana e opozitës shqiptare në Kosovë e kishte ashpërsuar reagimin e Serbisë. Dhuna serbe e përfshinte një mori sjelljesh mizore, të cilat duket se e kishin karakterin e krimeve kundër njerëzimit, me tiparet e definuara nga Gjykata e Nyrnbergut më 1945. Këto veprime kriminele u bënë edhe më të tmerrshme gjatë kohës së fushatës ushtarake të NATO-s, dhe zbatoheshin në mënyra të tilla që përjashtojnë çfarëdo justifikimi në bazë të ligjeve të luftës - ose, nga ky aspekt, edhe në bazë të moralitetit ndërkombëtar. Është me rëndësi edhe fakti

që Sllobodan Millosheviqi u akuzua si kriminel lufte nga ana e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë gjatë fushatës së bombardimeve, për shkak të rolit që e kishte në zbatimin e krimeve në ish-Jugosllavi.

Një kompleksitet i tillë i rrethanave e shtron pyetjen më kryesore - a janë kufizimet e parashtruara nga ana e të Drejtës Ndërkombëtare për përdorimin jodefansiv të forcës, adekuate për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botën bashkëkohore? Kjo pyetje ka rëndësi të veçantë, sidomos në rastet e përdorimit të forcës për t'i ardhur në ndihmë popullatës së pambrojtur, kur kjo është e kërcënuar nga ndonjë katastrofë humanitare. Nëse e Drejta Ndërkombëtare edhe më tutje nuk do të ofrojë udhëzime të pranueshme për situata të tilla - atëherë cilat do të jenë alternativat? Duke i dhënë përgjigjet në këto sfida, Komisioni është i mendimit që mospajtimet rreth të Drejtës Ndërkombëtare janë të nxitura nga fushata e NATO-s. Po ashtu, Komisioni këtu e paraqet një interpretim të doktrinës emergjente për intervenimet humanitare. Ky interpretim është i vendosur në zonën e mjegulluar të dykuptimisë, ndërmjet të zgjerimit të së Drejtës Ndërkombëtare, dhe propozimit për një konsensus moral ndërkombëtar. Në thelb, kjo zonë e mjegulluar shkon edhe përtej ideve strikte të legalitetit, për të inkorporuar pikëpamje edhe më elastike të legjitimitetit.

Ky kapitull i ka dy pjesë kryesore:

Shqyrtimi i ligjshmërisë së ndërhyrjes me forcë, duke ju referuar edhe jus ad bellum (e drejta për luftë), edhe jus in bellum (ligjshmëria e veprimeve gjatë luftës);

Një argument në emër të legjitimitetit për një kornizë emergjente të parimeve për ndërhyrje humanitare.

RFJ-ja bënte akuzë që sulmet dhe bombardimet e NATO-s paraqisnin shkelje të së Drejtës Ndërkombëtare, dhe paraqiti ankesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë pranë Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Jugosllavinë, për t'i filluar veprimet formale juridike kundër qeverive të vendeve të NATO-s që mbajnë përgjegjësi. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk e ka vendosur ende se a është kjo çështje nën jurisdikcionin e saj apo jo, edhe pse e kishte hedhur poshtë kërkesën e RFJ-së për Masa Paraprake, dhe se prima facie i kishte përjashtuar nga kontesti SHBA-të dhe Spanjën, duke i lënë dhjetë anëtarët e tjerë të NATO-s për mbrojtje eventuale. Raporti Final i Prokurorit të ICTY-së, përmes Komitetit të formuar për ta shqyrtuar fushatën e bombardimeve të NATO-s, e ka ushtruar një ndikim në qasjen e Komisionit lidhur me çështjen e shtruar.¹ Raporti erdhi në përfundimin që akuzat kryesore për ilegalitetin e përdorimit fillestar të forcës nga NATO-ja është duke u shqyrtuar aktualisht nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, mirëpo, sido që të jetë, kjo çështje nuk është në

kuadër të kompetencave dhe të fushëveprimit të Tribunalit. Ky segment themelor i të Drejtës Ndërkombëtare, megjithatë, do të shqyrtohet nga ana e Komisionit.

Organi kryesor i Raportit Final të ICTY-së, e hulumtoi në disa detaje nëse ankesat kryesore dhe më specifike rreth taktikave dhe metodave të zbatuara nga NATO-ja gjatë luftës kanë të bëjnë vërtet me shkelje të ligjit të luftës, dhe erdhi në përfundimin që akuzat nuk kanë peshë të mjaftueshme, madje, as për t'i filluar hetimet. Komisioni i referohet këtij raporti, megjithëse aty janë disa analiza të pavarura, të bëra krye në vete, të cilat rreth disa çështjeve vijnë në përfundime më pak të besueshme. Për më tepër, Komisioni sygjeron që çfarëdo vlerësimi i metodave dhe i taktikave të NATO-s në veprimet e justifikuar si “luftë humanitare,” duhet t'i nënshtrohen standardeve shumë më të larta sesa ato të cilat tash janë duke e rregulluar të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare në kohë lufte. Në fakt, Komisioni është i bindur që duhen vënë shumë më tepër obligime për palën intervenuese, ashtu që ajo të ketë kujdes të plotë ndaj popullatës gjatë fushatës humanitare. Modalitetet specifike për këto standarde të larta të “domosdoshmërisë ushtarake” nuk ekzistojnë ende në asnjë marrëveshje ndërkombëtare apo në ndonjë deklaratë të Kombeve të Bashkuara, mirëpo Komisioni është i mendimit që standardi duhet të jetë një nocion fleksibil dhe i përshtatshëm për zbatimin e kufizimeve ligjore të përdorimit të forcës në realitetet e fillimshekullit njëzet e një. Komisioni është i bindur që ky propozim duhet ta gjejë vendin edhe formalisht në të Drejtën Ndërkombëtare, mbase në formë të një “Protokoli III” në Konventat e Gjenevës.

Ndërhyrja ushtarake dhe e drejta ndërkombëtare

Analizat e bëra në kapitujt paraprak e tregojnë që negociatat e zhvilluara para 24 marsit 1999, edhe pse ekstensive, ishin të mpleksuara me diplomaci kërcënuese dhe propozime dykuptimshme për bisedime, dhe për këtë arsye edhe dështuan që t'i përmbushnin në tërësi kërkesat lidhur me obligimin për ta gjetur ndonjë zgjidhje paqësore, e cila do të mund të zbatohet në të gjitha konfliktet ndërkombëtare. Një vlerësim i tillë i bisedimeve për Kosovën është i rëndësishëm, meqë veprimet e NATO-s, tekefundit, zbatoheshin në një bazë juridike jostabile, meqë këto bëheshin duke u mbështetur në një vendim për ta zbatuar ndërhyrjen e armatosur jo vetëm pa pëlqimin, por, për më tepër, edhe pa e kërkuar fare pëlqimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe pa e bërë asnjë lloj kërkesë plotësuese në Asambленë e Përgjithshme. Me Rezolutën e Bashkuar për Paqe,² Asambleja e Përgjithshme autorizohet të veprojë në rastet kur KS

i OKB-së nuk mund t'i përmbush obligimet e veta në rrethanat e kërcënimit të paqes dhe të sigurisë. Traktati³ themelues i NATO-s nuk e paraqet ndonjë bazë të fortë juridike për përdorim të forcës, me përjashtim të rasteve të ballafaqimit me ndonjë forcë të jashtme të drejtuar kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të vendeve të saj anëtare.

E Drejta Ndërkombëtare, siç parashihet tekstualisht me Kartën e OKB-së, është një përshkrim i qartë lidhur me shkallën e lejueshme të përdorimit të forcës në jetën ndërkombëtare.⁴ Kërcënimi dhe përdorimi i forcës është kategorikisht i ndaluar me Nenin 2(4). Përjashtimi i vetëm, i rregulluar me Nenin 51, është e drejta për vetëmbrojtje, dhe atë vetëm si reagim ndaj ndonjë sulmi të bërë paraprakisht i cili e cenon ndonjë kufi ndërkombëtar, dhe edhe kjo trajtë lejohet vetëm për kohësisht. Kërkesa për të reaguar në vetëmbrojtje duhet t'i komunikohet menjëherë KS të OKB-së, i cili është i autorizuar për ta dhënë vlerësimin përfundimtar. KS i OKB-së, në kuadër të përgjegjësive të veta për paqe dhe siguri ndërkombëtare, me Kapitullin VII është i autorizuar që ta lejojë përdorimin e forcës. Një interpretim i tillë i lidhur ngusht me kornizën ligjore që e rregullon përdorimin e forcës, është zbatuar në mënyrë strikte nga shumica e drejtuesve në Gjykatën e Drejtësisë, lidhur me rastin e Nikaraguas më 1986.⁵ Vetëm edhe një dispozitë tjetër relevante lidhur me përdorimin e forcës është e përfshirë në Nenin 53, dhe kjo i lejon organizatat rajonale që të marrin pjesë në realizimin e detyrueshëm të aksioneve, por edhe këtu saktësohet që kjo mund të bëhet vetëm me pëlqimin e KS të OKB-së. Megjithëse ka edhe argumente plotësuese lidhur me autorizimin e vetëkuptueshëm për përdorimin e forcës, meqë në mbështetje të Kapitullin VII të Kartës,⁶ konflikti formalisht trajtohej nga KS i OKB-së si kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, edhe më tej është tepër e vështirë që ndërhyrja e armatosur e NATO-s në emër të Kosovës të harmonizohet me kornizën e përgjithshme të të drejtave dhe obligimeve ligjore të cilat e përcaktojnë ligjshmërinë e përdorimit të forcës.

Megjithatë, ka mundësi që të argumentohet se veprimi i cili është bërë për përdorimin e forcës, edhe përkundër kufizimeve të Kartës, është në fakt edhe një përkrahje e cila i bëhet Kartës, dhe atë për afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁷ Nga ky aspekt, është vlerësuar që në katastrofën humanitare e cila ishte duke ndodhur nga skema serbe e dhunës kriminale që zbatohet kundër popullatës shqiptare të Kosovës, përdorimi i forcës nga ana e NATO-s ishte legjitim, sepse ky e paraqiste, në fakt, të vetmen mënyrë të mundshme për t'i mbrojtur shqiptarët e Kosovës nga pasojat e përshkallëzimit të mëtejme të dhunës. Vështirësia kryesore në këtë vijë argumentimi është që kufizimet e Kartës për përdorimin e forcës e përbënin angazhimin thelbësor me

rastin e themelimit të OKB-së më 1945 - një angazhim ky i cili i dha një trajtë të re të Drejtës së përgjithshme Ndërkombëtare.

Për dallim nga kjo e tëra, dispozitat e Kartës të cilat i rregullojnë të drejtat e njeriut janë lënë qëllimisht të paqarta, dhe është evidente se kur janë hartuar nuk e kanë patur për qëllim që të ofrojnë bazë ligjore për ndonjë lloj përdorimi të forcës, dhe edhe më pak, ndonjë autorizim sipas vlerësimit të lirë për ndërhyrje ushtarake edhe pa pëlqimin e KS të OKB-së. Në sistemin e OKB-së të vitit 1945, të drejtave të njeriut iu la një rol i dorës së dytë dhe marginal, një rol që, siç është lënë të kuptohet, mbetet një i trajtës dëshirore.

Çfarëdo kërkesë për intervenim në baza humanitare do të ndeshej me pengesën plotëse juridike të përcaktuar nga Neni 2(7), i cili e ndalon intervenimin, madje edhe nga ana e vetë Kombeve të Bashkuara, në çështjet të cilat esencialisht hyjnë në "jurisdikcionin e brendshëm" të shteteve anëtare. Kur është hartuar Karta shkelje edhe më serioze të të drejtave të njeriut janë konsideruar çështje e juridikcionit të brendshëm, dhe nuk kishte qëllim që të krijohet çfarëdo baze ligjore për intervenime nga jashtë. Anëtarët e OKB-së me një orientim më të theksuar për respektimin e sovranitetit, e ndër të cilat gjithsesi janë Kina dhe Rusia, vazhdojnë ende ta mbajnë të njëjtin qëndrim lidhur me të drejtat e njeriut. Përpos kësaj, ende nuk janë bërë qartësime nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ose nga ana e ndonjë organi tjetër autoritativ, lidhur me përmasën deri në të cilën zhvillimi i ligjeve lidhur me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dëmtohet nga ndalesa e përdorimit të forcës për qëllime jombrojtëse.

Megjithatë, Komisioni e vë në dukje se për më shumë se pesëdhjetë vite të ekzistencës së OKB-së, statusi i të drejtave të njeriut ka ndryshuar rrënjësisht. Kjo vërehet edhe në standardet juridike ndërkombëtare. Respektimit të tyre ia kushtojnë një energji shumë të madhe një numër i madh i OJQ-ve. Gjatë fushatës kundër apartheidit të viteve '80, edhe vetë OKB-ja është angazhuar për zbatimin e të drejtave të njeriut në Afrikën e Jugut, madje ka shkuar aq larg sa t'i hedh poshtë arsyetimet në bazë të së drejtës për sovranitet. Shtetet evropiane kanë treguar vullnet për ta njohur të drejtën e përgjegjësisë së jashtme lidhur me të drejtat e njeriut, duke ua dhënë të drejtën qytetarëve të tyre që të kërkojnë ndihmë përmes peticionit drejtuar Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut. Nëse kërkesa e tyre është e bazuar, atëherë qytetarët e kanë të drejtën që rastin e tyre ta paraqesin para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, Marrëveshjet e Helsinkit të vitit 1975, e hapën rrugën e një procesi të rëndësishëm, meqë vendet e Evropës Lindore u pajtuan që t'i garantojnë të drejtat e njeriut dhe t'i

pranojnë procedurat e vlerësimit rajonal. Me këtë akt u bë një hap i rëndësishëm në pengimin e pushtetit autoritar në Evropën Lindore dhe në përshejtimin e tranzicionit paqësor (me përjashtim të Rumanisë), drejt konstitucionalizmit të tregut në fundin e viteve '80.

Zhvillimet e tilla kanë shkaktuar që Sekretari i Përgjithshëm, Kofi Anan, si dhe dy paraardhësit e tij, Javier Perez de Kuelar dhe Boutros Ghali, të insistojnë që evolimi i standardeve të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe përkrahja që i bëhet zbatimit të tyre, tani kanë arritur në atë shkallë kur normat e mosintervenimit, si dhe pikëpamjet për të drejtën sovraane, nuk e kanë më të njëjtën peshë të cilën e kishin në rastet e mëparshme të shkeljeve të vrazhda të drejtave të njeriut dhe të Drejtës Humanitare.⁸ Duke u nisur nga ky qëndrim, Bashkësia e organizuar Ndërkombëtare tani e ka të lejueshëm opsionin e intervenimit humanitar, si një mënyrë për t'i mbrojtur popujt e rrezikuar nga shkeljet brutale të drejtave të njeriut, nga krimet kundër njerëzimit dhe nga gjenocidi. Sidoqoftë, vlerësimi i kujdesshëm e ndalon ende intervenimin humanitar, veçanërisht në rastet kur për një intervenim të tillë kërkohet ndonjë angazhim serioz ushtarak ose kur ky paraqet rrezik për të nxitur ndonjë luftë përmasash të mëdha. Megjithatë, procesi i zhvillimit tregon që forca intervenuese për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut në rastet ekstreme të shkeljeve të tyre, është më pak konsistente me frymën e Kartës së OKB-së dhe të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare sesa që është vlerësuar nga disa.⁹

Madje edhe përballë një konteksti të tillë, mbetet çështje e hapur se a ishte NATO-ja faktori më i përshtatshëm për ta realizuar intervenimin në Kosovë, në rrethanat e bllokadës politike në KS të OKB-së. Në kohën kur kjo ka ndodhur, më 1999, mbizotëronte bindja se nuk kishte alternativë tjetër realiste për veprim. Ç'është e vërteta, përkrahësit e veprimit të NATO-s e theksojnë që, krahasuar me përgjigjen joadekuate që u dha nga OKB-ja lidhur me spastrimet etnike në Bosnje disa vite më parë,¹⁰ anashkalimi i cili iu bë KS të OKB-së arsyetohet në tërësi. Lidhur me këtë, rëndësi kanë jo vetëm validiteti i kërkesës për intervenim, por, po ashtu, edhe çështja e vullnetit politik, e përpjekjeve dhe e mundësive.

Një argumentim i tillë është, megjithatë, disi, si për t'ia bërë qejfin vetvetes, meqë dështimi i mëparshëm i NATO-s ishte pjesërisht edhe pasojë e refuzimit të vendeve të NATO-s për ta dhënë një përkrahje më energjike dhe më efikase në rastin e Bosnjes. Fuqitë mandatore mendonin që dëmtimi i kredibilitetit të OKB-së ishte pasojë e dështimit të saj në fatkeqësinë e Bosnjës, por jo edhe si një rast i tyre për një angazhim më të madh. Për dallim nga kjo, lidhur me Kosovën, involvimi qendror i NATO-s e

kishte një trajtë tjetër, sepse shtetet e mëdha nuk kishin dëshirë ta pranonin ndonjë epilog tjetër përpos “suksesit” të plotë, meqë dëmtimi i kredibilitetit të NATO-s ishte i papranueshëm.

E Drejta Ndërkombëtare ende nuk i ka përkufizuar këto çështje, dhe fluiditeti i shkakuar nga doktrinën konkurrese shkakton kundërtënie e pasiguri. Në këtë kuadër, “koalicionet e vullnetshme” ofrojnë burime shtesë për mbrojtjen e popujve të rrezikuar, mbrojtje kjo e cila nuk mund t’u ofrohet nga sistemi i OKB-së, mirëpo kjo, nga ana tjetër, ndikon në krijimin e shqetësimit për shmangien e ligjshmërive të luftës dhe të intervenimit. Gjenocidi i Ruandës më 1994, e ka forcuar bindjen që aksioni efikas për ta parandaluar një tragjedi të tillë nuk duhet penguar për shkak të respektit ndaj OKB-së, ose për shkak të kufizimeve të demoduara dhe tepër strikte lidhur me përdorimin e forcës. Një pjesë e madhe e vendeve joperëndimore edhe më tej nuk binden dhe madje edhe dyshojnë në rregullshmërinë e përdorimit të forcës që sponsorohet nga vendet e pasura të Veriut, duke u bazuar nga opsioni i tillë i vendosjes së lirë.¹¹ Ky dyshim nuk ka të bëjë vetëm me intervenimin e NATO-s në Bosnje dhe në Kosovë, por edhe me llojin e mandatit të pacaktuar të dhënë nga KS i OKB-së më 1990/91 për përdorimin e forcës kundër Irakut në shpëtimin e sovranitetit të Kuvajtit, si dhe vazhdimin e pakufishëm të përdorimit të kësaj force pa e bërë ndonjë ripërtëritje të këtij mandati.¹²

Mbrojtësit e opsionit të intervenimit pohojnë, po ashtu, që praktika e OKB-së e ka krijuar një fleksibilitet dhe mundësi më të madhe të veprimit me përdorimin e forcës sesa përmbajtja e pjesës më të madhe të teksteve të së Drejtës Ndërkombëtare, duke e përfshirë këtu edhe vetë Kartën.¹³ Një këndvështrim i tillë i së Drejtës Ndërkombëtare vjen në përfundimin që Karta¹⁴ është strikte për së tepërmi. Ky përfundim sforcohet edhe më shumë pas dështimeve të anëtarësisë së OKB-së, madje edhe pas fundit të Luftës së Ftohtë, për t’i zbatuar dispozitat e Kapitullit VII (përfshirë këtu edhe caktimin e forcave të gatshme, si dhe veprimin aktiv të Komitetit Ushtarak). Si përfundim, të gjitha kërkesat për përdorimin e forcës duhet të shqyrtohen në të gjitha kontekstet e tyre, dhe të vlerësohen në bazë të meritave të tyre se a janë të arsyeshme apo jo.¹⁵ Një pikëpamje e tillë zakonisht shoqërohet nga argumenti që shtetet shpesh herë kanë vepruar në kundërshtim të hapur me kufizimet e Kartës dhe nuk kanë patur kurrfarë pasojash ligjore. Në një farë dore, kjo qasje më elastike në interpretimin e së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me përdorimin e forcës e vërteton arsyeshmërinë e ndërmarrjes së aksionit transnacional edhe kundër terrorizmit ndërkombëtar e edhe kundër sjelljeve gjenocidale. Po ashtu, kjo e pranon domosdonë e veprimit në disa situata edhe pa pëlqim të OKB-së, po qe se ekziston mundësia që një pëlqim i tillë të

mos jipet, për shkak të vetos së paralajmëruar, apo e cila mund të pritet nga ndonjëri nga anëtarët e përhershëm të KS të OKB-së.

Në rastin e përdorimit të forcës nga NATO-ja, do të mund të jipeshin disa shpjegime lidhur me kërkesat e saj, por jo edhe të mbyllën kundërhëniet lidhur me bazën ligjore të këtyre kërkesave. Nuk ka baza faktike mbi të cilat NATO-ja mund të thirret në përdorimin e forcës për një mbrojtje e cila, nga prizmi i së Drejtës Ndërkombëtare do të kualifikohet si vetëmbrojtje. Madje as edhe ndonjë pëlqim i OKB-së nuk do të ishte mbulesë bindëse formale e cila do të mund ta kualifikonte përdorimin e forcës nga NATO-ja si vetëmbrojtje. Shumë më bindëse do të ishte që aksioni i NATO-s të kualifikohet si mbrojtje me forcë e paqes dhe e sigurisë nga një organizatë rajonale, e që parashihet si një opsion me Nenin 53 të Kartës.¹⁶

Baza më bindëse ligjore për fushatën ushtarake të NATO-s është e lidhur me kompetencat e KS të OKB-së për ta vlerësuar ndonjë grumbull të rrethanave si mundësi e kërcënimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ashtu siç është definuar me Kapitullin VII të Kartës, dhe për ta krijuar në këtë mënyrë mundësinë për dhënien e pëlqimit për përdorimin e forcës me qëllim “të ruajtjes apo të kthimit” të paqes dhe të sigurisë.¹⁷ Lufta e Gjirit është bërë sipas kësaj logjike, ndonëse në këtë rast ka ekzistuar edhe një mbështetje e qartë faktike për kërkesën më shumë të pranueshme të vetëmbrojtjes kolektive të integritetit territorial dhe të pavarësisë politike, sipas Nenit 51 të Kartës.¹⁸ Fakti që përkeqësimi i situatës në Kosovë në vitin para fushatës së NATO-s është trajtuar brenda fushëveprimit të Kapitullit VII, është pa dyshim me një relevancë juridike.¹⁹ Dimensioni ndërkombëtar i çështjes së Kosovës në mënyrë të qartë lidhet me rrezikun e rritur për krijimin e një jostabiliteti i cili ka mundur të përhapej edhe në vendet si Maqedonia, Shqipëria dhe Bullgaria, dhe me mundësi të një fluksi prej dhjetëra mijëra refugjatëve për në Evropë.²⁰

Duke diskutuar për ligjshmërinë e fushatës së NATO-s, në pah del edhe një kompleksitet juridik tjetër, e i cili e bën më të justifikueshëm përdorimin e forcës. Kishte arsye të forta për të besuar që kompromisi politik, edhe po të arrihej, nuk do të mund të ofronte garanca të mjaftueshme për mbrojtjen e shqiptarëve të Kosovës, kur të mirrej parasysh personaliteti i Millosheviqit, si për shkak të krimeve të tij të luftës nga e kaluara, ashtu edhe për shkak të premtimeve mashtruese të dhëna më parë, dhe në veçanti kur kësaj i shtohet edhe situata e pasigurtë në Kosovë. Kjo rrethanë ishte edhe një arsye më tepër për të qenë i bindur se nuk ishte me gjasa që të arrihej qëllimi i mbrojtjes efikase të popullatës civile të Kosovës, po qe se do të veprohej nën mandatin e OKB-së. Këto analiza na rikthejnë në vështirësitë e përputhshmërisë së legalitetit dhe

të legjitimitetit në rastin e Kosovës, dhe i zgjojnë kujtimet e llahtarshme të pjesëmarrjes ndërkombëtare në ngjarjet e tmerrshme të Bosnjes, dhe në veçanti në masakrën e Srebrenicës.²¹

Njëra nga mënyrat për analizimin e fushatës së NATO-s duke u mbështetur në të Drejtën Ndërkombëtare, është që të vështrohet legaliteti si çështje niveli. Kjo qasje e nxjerr në pah fluiditetin aktual të së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me intervenimet humanitare, të mbërthyer ndërmjet të ndalimit që e bën Karta për përdorimin e forcës për qëllime jombrojtëse, dhe praktikës më tolerante të shteteve lidhur me intervenimet humanitare dhe përdorimit kundërterrorist të forcës.²² Rezolutat e miratuara pas marsit 1999, e të cilat referohen në Kapitullin VII, janë një mbështetje e fortë e kësaj analize, dhe kjo vlen edhe për refuzimin e njëanshëm të Rezolutës së ofruar nga Rusia për censurë pas intervenimit.²³ Madje edhe më indikative për kuazi-ratifikimin e aksionit të NATO-s, ishte vullneti i KS të OKB-së i shprehur me Rezolutën 1244, për ta pranuar rolin qendror në rikthimin e gjendjes normale në Kosovë mbi bazën e pozicioneve negociuese të NATO-s në Rambuje dhe gjetkë, duke e përfshirë këtu edhe instalimin e regjimit të UNMIK-ut, si një ngritje deri në një de facto pavarësi për ish-krahinën. Këta faktorë përkrahës të “legalitetit” janë pjesërisht në kontradiktë me dykuptimësinë e negociatave të përmendura në kapitullin paraprak, me mbështetjen ekskluzive të luftës nga ajri, dhe me marrëdhëniet ambivalente me UÇK-në.

Një tjetër shqetësim themelor juridik ka të bëjë me llojin e precedentit të bërë përmes intervenimit me forcë në Kosovë dhe në Serbi. Kurorëzimi i fushatës së NATO-s me mbulesë legale, në bazë të pëlqimit “të nënkuptuar” nga KS i OKB-së për përdorimin e forcës, duket si një precedent i padëshirueshëm. Kjo do t’i shtonte gjasat për mbështetje edhe më të madhe në veto nga ata anëtarë të përhershëm të cilët kishin frikë nga interpretimi i gjerë i cili do të bëhej më vonë. Këto shtete mund të kenë qenë të brengosura se vota e tyre e përbashkët, në atë që atëherë dukej se ishte rezolutë preliminare kundër kërcënimit të paqes, do të mund të ishte një mbështetje e cila do të përdorej nga disa shtete për ta justifikuar forcën, gjë e cila do të interpretohej si një ndërhyrje e paautorizuar në të drejtat sovrane. Mbizotëruese është bindja që çdo lëvizje në drejtim të autorizimit të nënkuptuar për ta përdorur forcën, e synon zbehjen e “vijës së kuqe” të cilën e ka vënë Karta lidhur me lejimin e përdorimit të forcës, ndonëse, duhet pranuar, një zbehje e tillë tashmë është duke ndodhur në praktikë.

Disa arsytetime joligjore dhe kuazi-ligjore të intervenimit nga ana e përkrahësve të aksionit të NATO-s, janë paraqitur pas vënies para aktit të kryer. Ndër këto janë edhe vlerësimet që korniza e Kartës është e vjetëruar në kontekstin e gjendjes aktuale të kon-

flikteve ndërshtetërore, dhe se prioriteti moral për t'i parandaluar gjenocidet dhe krimet e rënda kundër njerëzimit e arsyetojnë veprimin, madje edhe në ato raste kur KS i OKB-së nuk mund ta sigurojë konsensusin politik.²⁴ Ky argument me bazë gjeopolitike, tregon që koalicioni i bashkëmendimtarëve, apo, thënë ndryshe, i shteteve "iluministe," duke e përjashtuar këtu grupin bllokues të anëtarëve të përherëshëm, mund ta përdorë ende autoritetin e mjaftueshëm moral të Bashkësisë Ndërkombëtare për ta anashkaluar KS të OKB-së, kur këtë ta kërkojnë rrethanat. Dhe, në fund fare, një argument i tillë kërkon që të demonstrohet se është fjala për skajin tjetër ekstrem të moralit, siç janë çështjet e gjenocidit apo të krimeve të rënda, dhe se asnjë lloj veprimi përbrenda mundësisë të KS të OKB-së nuk është i tillë që lë shpresë se do të mund t'i ndalonte. Përkundër këtij pragu kaq të lartë, dhe të dilemave nëse Kosova i plotësonte këto kushte, pranimi i të drejtës së definuar kaq turbull për "koalicion" e ka ngatërruar çështjen e ardhmërisë së stabilitetit botëror. Nëse lufta e Kosovës përdoret si precedent i cili do t'i lejonte shtetet, individualisht apo si koalicion, që të mos e përfillin apo që t'i kundërvihen KS të OKB-së, duke u nisur nga interpretimet e veta për moralin ndërkombëtar, funksioni stabilizues i KS të OKB-së do rrezikohet seriozisht, ashtu sikurse edhe angazhimet për t'i paraparë kushtet sipas të cilave lejohet përdorimi i forcës nga shtetet.

Në situatën çfarë ishte kriza e Kosovës, megjithatë, pengesa vendimtare për t'u mbështetur në Kombet e Bashkuara, mund të ketë qenë mungesa e përgjithshme e konsensusit përkrahës në radhët e shteteve, dhe më pak varianti i vetos. Në të vërtetë, shtetet anëtare të NATO-s u përkushtuan që të mos e përdorin rolin që e kishte Asambleja e Përgjithshme me rezolutën Të Bashkuar për Paqe, sepse, ndonëse në Asamblenë e Përgjithshme nuk ka veto, ndjeshmëria e shteteve joperëndimore për çfarëdo kërkesë për intervenim, nuk linte vend për të shpresuar që pëlqimi për ta përdorur forcën do t'i siguronte dy të tretat e shumicës së nevojshme. Pra, shihet qartë se në këtë mënyrë Kosova ngeli në një brez të veçantë, ku nuk do të ndodhte as pëlqimi dhe as refuzimi, duke e krijuar kështu atë pikë të dobët e cila e shkaktoi anashkalim e Kombeve të Bashkuara.

NATO-ja dhe përkrahësit e saj shmnagën me mençuri identifikimin me ndonjë kërkesë doktrinale për veprimet veta, qoftë para ose pas luftës. Shumica e përkrahësve të NATO-s në radhët e juristëve ndërkombëtarë, rastin e Kosovës nuk e vlerësuan si precedent, por si një përjashtim fatkeq, mirëpo të pashmangshëm dhe të arsyeshëm. Sidoqoftë, NATO-ja nuk mund t'i pengojë shtetet, dhe veçanërisht organizatat rajonale, që t'u referohen kërkesave të saj për intervenim në Kosovë si precedente. Në teori, NATO-ja mund të deklarojë se në të ardhmen, në situata të ngjashme, nuk do

t'i lejojë vetes që të përsërisë intervenime të tilla të paautorizuara, ndonëse një gjë e tillë do të shihej si distancim nga fushata e saj për Kosovën, e për çka nuk ka asnjë gjasë se do të ndodhë.

Rasti i Kosovës si “përrjashtim” tashmë ekziston, qoftë ai për të mirë apo për të keq, si një precedent i kontestuar i cili duhet të vlerësohet në raport me numrin e shumë të efekteve që do t'i ketë në veprimet ndërkombëtare. Më kryesorja ndër to për NATO-n është që, siç u tha më lartë, shumë shtete joanëtare të saj e vlerësonin që NATO-ja po e bënte në mënyrë të pavarur një luftë jombrojtëse, pa i bërë përpjekjet e mjaftueshme për ta siguruar pëlqimin e duhur, ose për ta gjetur një zgjidhje paqësore. Dykuptimësia e këtyre përpjekjeve, si një mbështetje për vlerësimin “pamjaftueshmëri,” është diskutuar në kapitullin paraprak. NATO-ja as nuk angazhohej për diplomaci kërcënuese dhe as që e konsideronte se përdorimi i forcës do të ndodhte medeo-mos, dhe në çfarëdo rasti dukej e gatshme të vepronte pa OKB-në, për shkak të kundërshtimit të pritur nga Rusia dhe nga Kina, sepse i kishte aftësitë ushtarake e politike, dhe, mbase, edhe për shkak të ndonjë interesi plotësues për ta ngritur një arkitekturë të re të sigurisë në periudhën pas Luftës së Ftohtë në Evropë, dhe e cila do të mbështetej në një NATO të re.

Madje, edhe po të mos i lihet faji diplomacisë së bërë në favor të NATO-s, dështim ishte, po ashtu, që nuk u bënë përpjekjet maksimale në nivelin e OKB-së, ku mosmbështetja në KS të OKB-së, për shkak të vetos së pritur, mund të justifikohet vetëm në mënyrë joformale. Pritja e vetos vetvetiu është subjektive dhe e supozuar, dhe nuk e merr parasysh obligimin për t'i shqyrtuar mundësitë e marrëveshjes me shtetet potencialisht kundërshtuese për ta arritur një konsensus në kuadër të KS të OKB-së. Gjatë vlerësimit të qëndrimeve të palëve, sipas të cilit në rrethanat ekzistuese nuk ka ndonjë alternativë më të arsyeshme, e Drejta Ndërkombëtare i jep përparësi KS të OKB-së, për shkak të përparësisë tjetër të lidhur me këtë - shmangies së luftës.

Dhe, përfundimisht, vlerësimi eventual i “parimit të Kosovës” do të jetë po ashtu i ndikuar fuqishëm nga epilogu përfundimtar në Kosovë - pra nga ajo se a do të del aksioni ndërkombëtar si diçka që sjell stabilitet dhe qeverisje njerëzore, apo të kundërtën.

Diskutimi i mësipërm lidhur me dykuptimësitë që janë pandashëm të lidhura me që të gjitha aspektet e analizës së intervenimit të NATO-s në Kosovë, e shtruan para Komisionit pyetjen qendrore: atë se a e paraqet e Drejta Ndërkombëtare - ashtu siç është konceptuar gjysmë shekulli më parë - në rrethanat e periudhës pas përfundimit të Luftës së Ftohtë një orientim të duhur, dhe atë në veçanti pas mospërfitimit për

financimin e Kombeve të Bashkuara nga ana e shteteve me fuqi dhe aftësi më të mëdha. Duke u përgjigjur në këtë pyetje, Komisioni e ka një ndjenjë të thellë që një obligim i domosdoshëm për t'u ardhur në ndihmë popujve të pambrojtur në një botë gjithnjë e më të globalizuar, nuk duhet të lihet anash gjatë përcaktimit të koncepteve ligjore të ndërhyrjeve ndërkombëtare në rastin e katastrofave humanitare. Duket se efikasiteti i veprimeve shpëtuese do të ketë përparësi në krahasim me formalitetet e imta.

Në këtë kuadër, duhet theksuar se madje edhe një epilog i negociuar i cili do të ishte arritur nga diplomacia e NATO-s, ende do ta kishte lënë mbi 90% të popullatës së Kosovës nën pushtetin e dhunshëm dhe diskriminues të RFJ-së. Fushata ajrore e NATO-s, megjithë ndjeshmërinë ndaj kritikizmit ligjor dhe moral, të paktën e ka efektin e çlirimit të popullatës shumicë nga një dhunë afatgjate, duke i dhënë asaj shpresa për një të ardhme të sigurtë dhe autonomi të mirëfilltë, me sa duket në një proces të pakthyesëm i cili do të shkojë kah pavarësia de facto. Një zhvillim i tillë i volitshëm i rrethanave për shqiptarët kosovarë nuk do të arrihej madje edhe sikur Beogradi do të ishte pajtuar për rikthimin e autonomisë të llojit çfarë ishte para vitit 1989. Autonomia do ta kishte lejuar praninë e vazhdueshme të policisë serbe, dhe, në këtë mënyrë, një mungesë të vazhdueshme të mbrojtjes nga ndërhyrja e armatosur e RFJ-së. Në rrethana të tilla, është për t'u besuar që nën drejtimin e UÇK-së, lëvizja për pavarësinë e Kosovës do të kishte vazhduar edhe më tutje. Natyrisht se aspektet përfituese të epilogut aktual për shqiptarët kosovarë duhet të balancohen edhe me dëshimin për t'i mbrojtur minoritetet joshqiptare pas qershorit 1999, e në këtë vazhde, edhe me gjasat e vogla për ndërtimin e një të ardhme të lirë e demokratike për Kosovën.²⁵

Ligjet e luftës: Metodrat dhe taktikat

E Drejta Ndërkombëtare e rregullon mënyrën e sjelljes në luftë me një varg marrëveshesh ndërkombëtare të cilat e kanë formën e traktateve.²⁶ Traktati që më së shumti është i lidhur me çështjen që po e shqyrtojmë këtu, është Protokoli shtesë I i Konventave të Gjenevës, i cili e rregullon çështjen e luftërave civile. Mbi 150 shtete e kanë ratifikuar Prokolin I, mirëpo këtu nuk hyjnë të gjitha vendet e NATO-s; këtë nuk e kanë ratifikuar Franca, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara.²⁷ Sidoqoftë, pjesa më e madhe e përmbajtjes së këtij Traktati trajtohet gjerësisht si “e drejtë zakonore ndërkombëtare,” që don të thotë, rregulla e standarde që u imponohen shteteve, si

rezultat i pranimit të tyre për një kohë të gjatë si norma, dhe të cilat për këto shtete do të duhej të ishin të obligueshme.²⁸ Kjo është argumentuar me një varg parimesh të së drejtës zakonore lidhur me metodat dhe taktikat e zhvillimit të luftës, duke përfshirë këtu edhe parimin e domosdoshmërisë (përdorimi i forcës duhet të jetë esencial për t'i arritur qëllimet e luftës), parimin e proporcionalitetit (raporti në mes të mjetit dhe qëllimit; shmangia e forcës se tepruar), parimin e diskriminimit apo të dallimit (metodat dhe taktikat duhet të jenë të drejtuara në caqet ushtarake) dhe parimin e humanitetit (metodat dhe taktikat nuk duhet të shkaktojnë vuajtje të tepërta të njerëzve; shmangia e mizorive).²⁹

Këto parime janë interpretuar në një mënyrë të gjerë.

Për aspekte të shumta, Neni 48 i Protokollit I e përmban rregullën themelore lidhur me mbojtjen e personave civil, e që është formulimi i traktatit lidhur me rregullën zakonore të diskriminimit:

Me qëllim të garantimit të respektit dhe të mbrojtjes së popullatës dhe të objekteve civile, palët në konflikt duhet ta bëjnë gjithmonë dallimin ndërmjet popullatës civile dhe luftëtarëve, si dhe ndërmjet objekteve civile e caqeve ushtarake, duke i drejtuar operacionet ushtarake vetëm kundër caqeve ushtarake.

Duke e shpjeguar natyrën e objekteve ushtarake, Neni 52(2) e vlerëson se ato janë “objekte të cilat përngja natyra e tyre, vendi, qëllimi dhe përdorimi u japin një kontribut efikas aksioneve ushtarake, dhe shkatërrimi total apo i pjesërishtëm, marrja nën kontroll apo neutralizimi i tyre, në rrethanat ekzistuese të momentit e paraqet një përparësi të madhe ushtarake.” Neni 51(2) e ndalon idenë e dobësimit të forcës ushtarake duke i sulmuar civilët: “(...) popullsia civile si e tillë, dhe as individët civilë, nuk mund të shndërrohen në objekt sulmesh.” Më tutje, Nenet 51(4), (5), (7) dhe (8) e bëjnë zbatimin specifik të obligimit i cili sapo u përmend.

Duke e analizuar fushatën e NATO-s të vitit 1999, dhe, konkretisht, atë se a ishte ajo në përputhje me këtë traktat dhe me rregullat zakonore të së Drejtës Ndërkombëtare, Komisioni e ka marrë parasysh dhe i ka kushtuar shumë rëndësi Raportit Final të Komitetit të ICTY-së, të punuar me qëllim të vlerësimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë. Pas hetimit në detaje të të dhënave që i janë paraqitur nga RFJ-ja, dhe duke u shërbyer me burimet e veta publike, ICTY-ja ka përfunduar që shumica e akuzave serioze kundër NATO-s lidhur me ligjet e luftës nuk kishin mbështetje të mjaftueshme e cila do ta arsyetonte vazhdimin e hetimeve të mëtejme. Megjithatë, duhet të vihet në dukje që ky përfundim në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte në kundërshtim me rekomandimet e Amnesty International, të cilat në raportin e

mëparshëm me titullin “Shkelja e Ligjeve të Luftës nga NATO-ja gjatë Operacionit ‘Forca Aleate’,” të datës 7 qershor 2000, në mënyrë specifike kërkonin nga ICTY-ja që të bëjë hetime lidhur me “të gjitha dyshimet e besueshme të shkeljeve serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (...), për ta sjellur para gjykatës secilin për të cilin ka prova të mjaftueshme.”³⁰ ICTY-ja mund të argumentojë që hetimet e bëra prej saj ishin në pajtim me këto rekomandime, deri në masën se nuk kishte në dispozicion prova të mjaftueshme të cilat do të arsyetonin një “hetim” të llojit të propozuar nga Amnesty International. Akuzat e RFJ-së kundër NATO-s, vlerësoheshin ose si “pa dëshmi për shkeljen e të Drejtës Ndërkombëtare, të cilat do të ishin të mjaftueshme për ta dhënë bazën ligjore të hetimit,” ose ishin të tilla që “mundësitë për të siguruar prova të mjaftueshme të cilat do të dëshmonin se ishte bërë ndonjë krim nga ndonjë individ i cili meriton të ndiqet nga një forum ndërkombëtar,” nuk ekzistonin fare.³¹

Nuk duhet harruar se ICTY-ja ishte e preokupuar vetëm me një çështje specifike – se a kishte baza për ta ngarkuar ndonjë individ të caktuar me krimet. Ky lloj i hetimit të krimit, ndonëse, pa mëdyshje, i përshtatshëm për ICTY-në, është një koncept i ngushtë dhe i papërshtatshëm për një komision të pavarur ndërkombëtar. Komisioni është marrë me atë se a kishte baza për të besuar që NATO-ja ka bërë shkelje të ligjeve të zbatueshme të luftës, prandaj nuk kishte nevojë ta bënte lidhjen e ndonjë individi me shkeljet specifike, por në vend të kësaj është interesuar që ta hetonte përgjegjësinë e qeverive të përfshira në shkeljet e mundshme. Në këtë mënyrë, përqendrimi i Komisionit ishte më tepër në përputhje me llojin e vlerësimit të bërë nga studimi i Amnesty International. ICTY-ja ka vënë në dukje, po ashtu, që “Prokuroria ka mundësi, sipas diskrecionit të saj, që të vente kusht të lartë për vendim pozitiv lidhur me bazën e mjaftueshme për fillimin e procedurës.”³² Po e theksojmë përsëri atë që, meqë Komisioni nuk është përgjegjës për hetime, ai e ka lirinë që t’i hetojë ngjarjet për të cilat ekzistojnë dyshimet lidhur me ligjet e luftës. Kur është fjala për përgjegjësinë kriminale, është një prirje e fortë që të kërkohet mbështetje për shkeljet e traktatit, por kur hetimi është më i përgjithshëm, dhe i përkohshëm, parimet e të Drejtës Ndërkombëtare zakonore kanë rëndësi më të madhe. Përtej kësaj, kur kërkesa i referohet arsyes së “intervenimit humanitar,” zbatimit të ligjeve të luftës mund t’i bëhet një vlerësim në mënyrë veçanërisht të prerë.

Caqet

Pas fazës së bombardimeve të para, NATO-ja e zgjeroi listën e caqeve të veta duke e filluar shkatërrimin e infrastrukturës civile të Serbisë, duke i bombarduar urat, transmetuesit, furnizuesit elektrikë, zyrat e partive politike dhe objektet e tjera të cilat konsiderohen me rëndësi për jetën e civilëve. Caqet e tilla shkaktojnë dyshim kur të mirren parasysh Konventat e Gjenevës dhe Protokoli I, por duhet të theksohet që praktika shtetërore e bërjes së luftrave, që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej, në mënyrë konsistente i ka zgjedhur caqet duke u mbështetur më tepër në një qasje të lirë, lidhur me “domosdoshmërinë ushtarake,” sesa që i është përmbajtur normave zakonore e konvencionale të cilat i ndalojnë sulmet e qëllimshme në caqet joushtarake. Po kështu, duhet të vihet në dukje që fushata e NATO-s ishte më e kujdesshme ndaj caqeve të zgjedhura sesa çdo aksion tjetër i mëparshëm i zhvillimit të luftës nga ajri. Ky kujdes ndaj caqeve pjesërisht ishte shprehje e politikës së deklaruar, dhe, njëkohësisht, i tregonte mundësitë e teknologjisë së “mençur” dhe aftësitë e precizitetit të saj. Megjithatë, siç ka konstatuar ICTY-ja, janë bërë disa gabime serioze. Mirëpo, nuk ka asnjë të dhënë për marrje në shënjestër të popullatës civile në mënyrë të qëllimshme. Prapëseprap, ka vend për ta diskutuar çështjen e zgjedhjes së caqeve në afërsi të infrastrukturës civile të RFJ-së, ku gjasat e pranisë dhe të vrasjes së popullatës civile ishin mjaft të mëdha. Ka po ashtu pohime dhe të dhëna, që tregojnë se NATO-ja nuk i ka ndaluar sulmet edhe pasi që e kishte konstatuar se kishte popullatë civile në vendin e caktuar të saj, duke e përfshirë këtu rastin e urës në hekurudhën e Gërdelicës, urës automobilistike në Luan dhe të urës në Barbarin.

Bombat kasetore

Human Right Watch e ka dokumentuar që në Serbi dhe në Kosovë rreth 500 persona civilë, d.m.th. joluftëtarë, janë vrarë nga bombat dhe raketat e NATO-s. Një numër i madh i këtyre personave kanë vdekur gjatë sulmeve në caqet e infrastrukturës civile, ndërkaq të tjerët si pasojë e përdorimit të bombave kasetore në caqet që ndodheshin në zonat me popullsi të dendur, ndonëse baza ligjore për përdorimin e këtyre bombave është e dyshimtë. Me mijëra bomba kasetore ende kanë ngelur të pashpërthyer në territoret e Kosovës dhe të Serbisë, dhe e paraqesin një rrezik të ngjashëm me të ashtuquajturat minat kundër këmbësorisë, e të cilat me Traktatin e Otavës janë të ndaluara që nga viti 1998.³³ Edhe pse forca ligjore e kësaj analogjie është e kontestueshme, veçanërisht për shkak të faktit që disa nga vendet e NATO-s këtë traktat

nuk e kanë nënshkruar ende, analogjia merr kuptim nga fakti që fuqia shkatërruese e bombave kasetore shpesh herë është më e madhe sesa ajo e minave, dhe se këto janë shkaktare të vrasjes së 500 personave civilë. NATO-ja ka qenë e ngadalshme për t'i dërguar ekspertët e vet për identifikimin e vendeve dhe për largimin e bombave të pashpërthyer. Në Kosovë me këtë problem janë duke u marrë ekipet e OKB-së dhe OJQ-të, dhe atë kryesisht përmes stafit lokal të trajnuar pas luftës, mirëpo kjo bëhet në përmasa mjaft të vogla për shkak të mungesës së mjeteve. Qëndrimi i ICTY-së është që përdorimi i bombave kasetore nuk ndalohet në mënyrë të qartë nga e Drejta Ndërkombëtare Humanitare, prandaj edhe nuk ka bazë të mjaftueshme për t'i filluar hetimet lidhur me përgjegjësinë e ndonjë personi për përdorimin e tyre. Komisioni nuk e konteston këtë vlerësim, mirëpo, megjithatë, e rekomandon që bombat kasetore nuk duhet të përdoren asnjëherë në cilëndo nga fushatat e ardhshme që organizohen nga OKB-ja, ose në ndonjë fushatë e cila pretendon të jetë "intervenim humanitar."³⁴

Taktikat

Vendimi i NATO-s për organizim të bombardimeve nga lartësi më të mëdha, me qëllim të shmangies së viktimave në radhët e veta, është kritikuar me të madhe. Fakti që numri i viktimave nga radhët e NATO-s ishte zero, edhe përkundër një shtrirjeje aq të gjerë të luftimeve, si dhe shkalla e dëmeve të shkaktuara, këto kritika i bëjnë edhe më të theksuara. Sipas raportit të organizatës "Amnesty International," nevoja që aeroplanët e NATO-s të fluturojnë mbi 15.000 fita (përafërsisht 5.000 metra), e bëri praktikisht të pamundur respektimin e plotë të rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.³⁵ Megjithatë, duhet përmendur se, edhe përkundër 'serisë së gabimeve,' falë saktësisë së shkrepjeve, rekordi i gjithëmbarshtëm i NATO-s ishte i pashembullt në kuptimin e shmangies së viktimave njerëzore. Lidhur me këtë ICTY-ja ka konstatuar:

Në të fluturuarit në lartësitë të cilat janë të paarrtshme nga forcat kundërajrore kundërshtarë nuk ka asgjë të kundërligjshme. Sidoqoftë, komandantët ajrorë të NATO-s është dashur të ndërmarin masa praktike për t'i dalluar qartë caqet ushtarake nga caqet civile, si dhe ushtarët nga civilët. Lartësia minimale prej 15.000 fitash, taktikë kjo e cila është ndjekur gjatë një periudhe të fushatës, e ka nënkuptuar që caqet nuk kanë mundur të identifikohen vizuelisht nga ana e pilotëve.

Megjithatë, u dëshmuua që me përdorimin e teknologjisë moderne, është mundur realizimi i obligimeve për t'i bërë këto dallime në shumicën dërrmuese të rasteve gjatë fushatës së bombardimeve.³⁶

Duket që zbatimi i taktikës së lartësive të mëdha nuk e ka ndonjë rëndësi ligjore, por ky disi e zbeh dimensionin humanitar deri në atë shkallë sa duket që më shumë është çmuar jeta e ushtarëve të NATO-s sesa ajo e pjestarëve të popullatës civile në Kosovë dhe në Serbi, dhe në veçanti jeta e shqiptarëve kosovarë, për mbrojtjen e të cilëve aksioni edhe ishte filluar.

Dëmet mbi ambientin

Vlerësohet, po ashtu, që dëmet të cilat nga fushata e bombardimeve i janë shkaktuar ekologjisë dhe ambientit, do të jenë me pasoja afatgjata për qytetarët si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë. Studimi më i ri i Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambientin (UNWP), i bërë nga Grupi Special për Ballkanin, e vë në dukje që dëmet që i janë shkaktuar ambientit – të paktën ato të cilat mund të dokumentohen – në të shumtën e rasteve nuk janë të mëdha dhe nuk do të jenë afatgjata,³⁷ për dallim nga disa raporte të OJQ-ve të hartuara gjatë dhe menjëherë pas luftës. Megjithatë, UNWP ofron dëshmi për disa raste të rrjedhjeve tepër të rrezikshme toksike, të shkaktuara nga bombardimet e bëra në komplekset industriale dhe në rafineritë e disa qyteteve. Këto rrjedhje e kanë krijuar një gjendje emergjente dhe një rrezik afatgjatë për qytetarët dhe ambientin, dhe kërkojnë ndërhyrje të shpejtë për pastrimin e tyre. Raporti i UNWP-së e vë në dukje që RFJ-ja është ajo që e ka përgjegjësinë për pastrimin e ambientit të saj, dhe e nxjerr përfundimin që ky pastrim mund të has në pengesa serioze nga embargoja ekzistuese. Disa raporte të OJQ-ve, si dhe disa analiza të tjera studimore, e theksojnë që dëmet që i janë shkaktuar ambientit janë aq të mëdha dhe serioze, sa që e lëjnë përshtypjen se është tejkaluar pragu i përgjegjesisë i paraparë me Nenin 35(3) dhe me atë 55 të Protokolit I. Raporti Final i ICTY-së, megjithatë, e vë në dukje anën rigorozë të kriterëve të Protokolit, ku dëmi në bazë të fjalëve kyqe duhet të ketë “shtrirje të gjerë, afatgjate dhe me përmasa të mëdha,” duke e theksuar në veçanti fjalën “dhe,” e që don të thotë se të tri karakteristikat duhet të paraqiten në mënyrë kumulative ashtu që ato të kualifikohen si shkelje.³⁸

Një preokupim tjetër përmasash të frikshme që u shfaq gjatë kohës së luftës, ishte përdorimi i shpeshtë i uranimit të varfëruar të vënë në kokat e raketave dhe të predhave anti-tanke. Gjatë shpërthimit këto raketa dhe predha e lirojnë në atmosferë uranium-dioksidin ngulfatës, e i cili mund të ketë pasoja afatgjata për shëndetin. NATO-ja nuk e ka mohuar përdorimin e këtij lloji të predhave dhe raketave, meqë uraniami i varfëruar merret të jetë mjet mjaft efikas për shkatërrimin e makinave të blinduara. Është mjaft shqetësuese e dhëna që pas këtij raporti, NATO-ja është treguar e ngathtë në

bashkëpunimin me UNWP-në. Raporti i UNWP-së e thirrte Organizatën Botërore të Shëndetësisë për t'i hulumtuar pasojat afatgjata shëndetësore të përdorimit të uraniu- mit të varfëruar. Pesë muaj pas kërkesës speciale që NATO-s iu bë nga Kofi Anan, për të dhënë informata më të hollësishme, NATO-ja e konfirmoi që gjatë konfliktit në Kosovë janë përdorur 31.000 predha me mbushje me uranium të varfëruar, me peshë prej dhjetë tonelatash, por UNWP-ja ende nuk i ka të dhënat e plota të caqeve për t'i filluar hulumtimet mbi shkallën e rrezikut të mundshëm nga rrezatimi. Studimet e tjera ofrojnë garanca që rreziku i shkaktuar nga përdorimi i uraniu- mit të varfëruar nuk është substancial, dhe se, rrjedhimisht, nuk ka rrezik për popullatën civile. Qëndrimi i ICTY-së është që për momentin nuk ka një konsensus të nevojshëm i cili do t'i jpte fuqi idesë për ndalimin e mjeteve të tilla shpërthyes me uranium të varfëruar, ndonëse këtë mundësi e len të hapur për të ardhmen.³⁹ Ky përfundim bëhet edhe më i diskutueshëm kur të kihet parasysh që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk ka mundur të pajtohej madje edhe me atë që armët bërthamore janë të ndaluara në mënyrë të pakushtëzuar, përkundër karakterit të padiskutueshëm të dëmeve së tepërmi të mëdha të cilat ato ia shkaktojnë ambientit.⁴⁰ Ajo që e bën këtë mënyrë rezonimi të diskutueshme është fakti që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e ka shqyrtuar ligjshmërinë e përdorimit të mundshëm të armëve bërthamore pa i analizuar pasojat në mënyrë reale, dhe duke e kufizuar mundësinë e përdorimit të tyre në rastet ekstreme të vetëmbrojtjes, dhe këtë vetëm si mundësi ligjore.

Komisioni rekomandon që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë kontekstit në të cilin bëhet intervenimi humanitar, për t'i shmangur ato caqe që mund të shkaktojnë dëme serioze të ambientit, dhe duke respektuar standarde për kontroll me të madh të veprimeve sesa ato që kërkohen me kushtet e larta të Protokolit I. Është vënë në dukje që Iraku gjatë Luftës së Gjirit është akuzuar për taktikat të cilat e synonin dëmtimin e ambientit, ndonëse aksionet e tij kanë patur të bëjnë me masat të cilat, të vlerësuara nga këndvështrimi i irakienëve, kanë hyrë në kuadër të “domosdoshmërisë ushtarake”.

Diskutimi

Komisioni është i impresionuar me shkallën relativisht të ulët të dëmeve civile, megjithë përmasat e mëdha të luftës dhe kohëzgjatjes së saj. Ekziston bindja që NATO-ja, përmes marrjes selektive në shënjestër, ia ka arritur më mirë se në cilëndo luftë tjetër ajrore në histori, që t'u përmbahet parimeve të diskriminimit, proporcionalitetit dhe të domosdoshmërisë, me vetëm disa shkelje fare të pakta, e të cilat ishin interpretuar, në një mënyrë plotësisht të kuptueshme, si çështje e “domosdosh-

mërisë ushtarake.” Komisioni i pranon pikëpamjet e Raportit Final të ICTY-së që, në bazë të dëshmive me të cilat disponohet, nuk ka mbështetje të mjaftueshme për të ngarkuar individë të caktuar për shkelje penale të ligjeve të luftës gjatë fushatës së NATO-s. Megjithatë, është e vështirë që disa raste të përfshihen në konstatimin se nuk ka patur shkelje, dhe për to vlerësimi përfundimtar mund të jipet vetëm nëse sigurohen dëshmi të reja.

Komisioni rekomandon që ICTY-ja ose ndonjë organ tjetër përkatës i ekspertëve, ta përgatisë një konventë të re lidhur me operacionet ushtarake, duke i përcaktuar ato ose si operacione paqëruajtëse të OKB-së, ose si intervenime humanitare. Një konventë e tillë duhet të vejë më tepër kufizime lidhur me përdorimin e forcës sesa ato të cilat, sipas interpretimit të përgjithshëm, në ligjet e luftës ekzistojnë tani. Një alternativë më pak ambicioze është rekomanduar nga Amnesty International, dhe sipas saj, të njëjtave standarde që tashmë ekzistojnë në të Drejtën Ndërkombëtare duhet përmbytur në mënyrë edhe më strikte, dhe në veçanti pjesës së paraparë me Protokolin I. Ky interpretim është përfshirë në një trajtë kompetente në Raportin Final të ICTY-së. Me këtë propozim Komisioni e ka për qëllim që ta vejë në dukje rëndësinë e efikasitetit në zbatimin e intervenimit humanitar në kushte të vështira dhe me sensin e situatës urgjente, duke mos synuar që theksi të vohet në zvogëlimin e pikëpamjes juridike për “domosdoshmërinë ushtarake.” Kjo çështje është edhe një e balancit delikat, meqë nga shtetet kërkohet që për qëllime humanitare të rrezikojnë, e për të cilën këto mund të mos jenë të gatshme. Ngurrimi i mundshëm e shtron nevojën e gjetjes së ndonjë trajte të ndonjë ushtrie vullnetare profesionale globale, të mbikëqyrjes së paqes dhe të forcave policore përkatëse. Për fat të keq, pengesat aktuale politike për të ecur në një drejtim të tillë të dëshirueshëm, janë tepër të mëdha.

Mbi doktrinën e intervenimit humanitar

Kushtet e rendit të ri botëror të cilat u shfaqën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, i komplikuan prioritetet e mëparshme lidhur me përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Preokupim i periudhës pas vitit 1945 ishte që të parandalohen luftrat ndërkombëtare ndërmjet dy apo më shumë shteteve, dhe në veçanti të atyre ndërmjet shteteve të mëdha. Armatimet bërthamore dhe sistemet me raketa të dirigjuara, këtij angazhimi ia jipnin një karakter urgjent gjeopolitik. Edhe përkundër kësaj, edhe para shembjes sovjetike, shumica e sfidave më serioze që iu bënë paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, u shfaqën përmes krizave brenda-kombëtare të përmasave të mëdha. Karta e OKB-së nuk i përkrah ndërhyrjet në kriza të tilla, duke e mbajtur qëndrimin

që “çështjet e jurisdikcionit të brendshëm” të shteteve janë jashtë kompetencave të saj, me përjashtim të rasteve kur nga KS i OKB-së këto kualifikohen si kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.⁴¹ Edhe pse KS i OKB-së, me kalimin e kohës gjithnjë e më shpesh krizat e brendshme i kualifikonte si kërcënime ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ekziston përshtypja që Karta, ashtu siç ishte hartuar fillimisht, nuk ofron zgjidhje të kënaqshme për rendin e sotëm botëror gjithnjë e më nevojtar për reagime ndaj sfidave humanitare. Ky preokupim u manifestua në mënyrë të qartë edhe para sfidës së Kosovës, mirëpo në rastin e Kosovës ky u manifestua edhe më qartë përmes ndërhyrjes së NATO-s.

Debatimet fillestare të Komisionit lidhur me legjitimitetin e ndërhyrjes së NATO-s u mbyllën pa konkluzione, mirëpo vështirësia e harmonizimit të asaj që ishte bërë për ta mbrojtur popullin e Kosovës me esencën e ndalesës për ta përdorur forcën jo-mbrojtëse pa pëlqimin e Kombeve të Bashkuara, u theksua qartë. Në të njëjtën kohë, Komisioni është i mendimit që represioni serb në Kosovë, përvojat e spastrimit etnik disa vite më parë në Bosnje si dhe mungesa e reagimit ndërkombëtar ndaj gjenocidit në Ruandë më 1994, të kombinuara bashkërisht, e paraqesin një obligim të fortë moral e politik për Bashkësinë Ndërkombëtare për të vepruar në mënyrë efikase dhe për të shprehur solidaritet me shoqëritë civile të viktimizuara nga qeveritë që bëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.⁴² Ky obligim vlen edhe për mbrojtjen e shqiptarëve të Kosovës, e edhe për rivendosjen e autonomisë. Është e qartë që kjo çështje arrin edhe deri tek realizimi i të drejtës për vetëvendosje të popullit të Kosovës. Siç u dëshmuua edhe më heret, diplomacia dështoi që në një mënyrë të bindshme t’i arrijë këto rezultate, duke ngelur në mes të opsioneve për të mos bërë asgjë ose për të ndërhyrë ushtarakisht, nën udhëheqjen e NATO-s. Kjo situatë e dëshmon edhe më tepër përfundimin e përgjithshëm, që fushata e NATO-s ishte jolegale, por megjithatë legjitime. Një përfundim i tillë është i ndërlidhur me idenë kontraverze, sipas së cilës “e drejta” për intervenim humanitar nuk është konsistente me Kartën e OKB-së, nëse ajo merret si tekst juridik, por që megjithatë është e mundur, varësisht nga konteksti, që nga fryma e Kartës të nxirret aspekti i përgjithshëm i nevojshëm për mbrojtjen e popujve nga dhuna e përmasave të mëdha. Në këtë mënyrë, intervenimi humanitar mund të autorizohet në mënyrë legjitime nga OKB-ja, por kjo shpesh herë do të sfidohet nga pozita e obligimeve të Kartës për ta respektuar sovranitetin e shteteve.

Janë disa shkaqe se pse tolerimi i mëtejshëm i këtij boshllëku ndërmjet të legalitetit dhe legjitimitetit është i paarsyeshëm. Të pranuarit e tensioneve në shumicën e interpretimeve të së Drejtës Ndërkombëtare e ka domethënien që ose solidariteti me viktimat civile të nëpërkëmbura në mënyrë mizore nga qeveritë ndalohet fare, ose që themelet

e ndalesës për përdorimin e forcës e cila nga Gjykata Botërore apo edhe autoritete të tjera konsiderohet e drejtë, janë të dëmtuara seriozisht. Një çështje e lidhur ngushtë me këtë konstatim është ajo se përdorimi i forcës pa pëlqimin përkatës të OKB-së, tenton që ta zbeh autoritetin e Kombeve të Bashkuara dhe respektin për të, dhe në veçanti atë për KS të OKB-së në fushën e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Mirëpo, njëkohësisht duhet të vihet në dukje që dështimi për të vepruar në emër të kosovarëve, apo përsëritja e përvojave të Bosnjes dhe të Ruandës, si dëshmi e mandatit dhe e mundësive të pamjaftueshme të OKB-së, këtë Organizatë do ta kishin dobësuar edhe më keq.⁴³ Së këndejmi, ndonëse Komisioni konstaton që përdorimi i forcës nga NATO-ja për të intervenuar në Kosovë arsyetohet nga aspekti i legjitimitetit të angazhimit dhe i efekteve të gjithmbarshme shoqërore, ky megjithatë e ka përshtypjen që do të ishte edhe më e dobishme sikur të punohej me zell edhe më të madh për t'i zvogëluar dallimet ndërmjet legalitetit dhe legjitimitetit në një mënyrë edhe më bindëse në të ardhmen.

Komisioni e shpreh mendimin se mënyra më e përshtatshme për ta bërë këtë, është që të formulohet një doktrinë urgjente e intervenimit humanitar, e cila do të përbëhej nga një proces me tri faza:

Rekomandimi i kornizës së parimeve, të përshtatshme për situatat në të cilat propozohet intervenimi humanitar si reagim ndërkombëtar, atje ku paraqiten nevojat për të;

Miratimi formal i një kornize të tillë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në trajtën e një Deklarate për të Drejtën dhe Përgjegjësinë e Intervenimit Humanitar, e cila do të shoqërohej me interpretimet e Kartës së OKB-së nga ana e KS të OKB-së, gjë kjo e cila do ta krijonte përputhshmërinë ndërmjet të respektimit të të drejtave sovrane dhe respektimit të të drejtave të njeriut me qëllimin e parandalimit të katastrofave humanitare;

Përpilimi dhe miratimi i Amendamentit të Kartës, i cili do të duhej t'i përfshinte ndryshimet lidhur me rolin dhe përgjegjësinë e Kombeve të Bashkuara dhe të aktorëve të tjerë kolektiv të Bashkësisë Ndërkombëtare, për zbatimin e Deklaratës mbi të Drejtën dhe Përgjegjësinë e Intervenimit Humanitar.

Problemet më të mëdha lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe me parandalimin e katastrofave humanitare, janë më tepër të karakterit politik sesa juridik. Në rastet e shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, ose edhe të gjenocidit, apo kur të shfaqet nevoja për parandalimin apo zvogëlimin e përmasave të katastrofës humanitare, intervenim efikas, qoftë të armatosur qoftë të paarmatosur, nuk do të ketë, po që se ai intervenim nuk është në përputhje me interesat e shteteve që e kanë mundës-

inë potenciale për të intervenuar, po qe se ai është në kundërshtim me përpjekjet për ruajtjen e rendit botëror, dhe, mbi të gjithat, po qe se e rrezikon shpërthimin e një lufte të madhe ndërmjet të shteteve me fuqi bërthamore. Për këto arsye, do të ishte joreale të pritet që intervenimi humanitar do të zhvillohet në një asi mënyre që ta merr një karakter të njëfarë lloj ligji, i cili do t'i trajtonte rastet e njëjta në mënyrë të njëjtë. Opsioni i vetëm i realizueshëm është që kërkesat për intervenim ose të ndalohen në tërësi ose të pranohet zbatimi i tyre selektiv, duke e garantuar vetëm atë që në rastet adekuate intervenimi do të bëhet mbi baza parimore, dhe që sa më shumë që të ketë mundësi ky do të jetë në përputhje me arsyet humanitare.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, nuk kishte as vullnet politik, as bazë ligjore dhe as kushte praktike për ta përkrahur një diplomaci humanitare e cila do ta përfshinte edhe përdorimin e një force intervenuese. Për shkaqe të shumta dhe të ndryshme, që të dyja superfuqitë ngurronin që t'i ndiqnin ato qëllime të Bashkësisë Ndërkombëtare të cilat nuk kishin të bënin me rivalitetin në mes tyre, dhe që të dyjat ishin të vetëdijshme se nuk janë në gjendje të ndërmarrin veprime të tilla të cilat do të mund ta provokonin palën kundërshtare për luftë. Bashkimi Sovjetik, sovranitetin e shteteve të Evropës Lindore që ishin nën influencën e tij e trajtonte esencialisht në një mënyrë shtypëse, por ky njëkohësisht edhe e rezistonte në një mënyrë dogmatike çfarëdo shkelje të këtij sovraniteti nga ana e Perëndimit. Shtetet e Bashkuara kishin krijuar aleancë me shumë shtete që kishin bërë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, dhe atë në bazë të kriterit se a kishin miratuar qeveritë e tyre orientim antikomunist dhe sa e përkrahnin kauzën Perëndimore në çështjet ndërkombëtare. I vetmi përjashtim i rëndësishëm vllente për rastin e regjimit të apartheidit në Afrikën e Jugut, ku edhe Lindja e Perëndimi, dhe edhe Veriu e Jugu, ia arritën më 1980 që ta kenë të njëjtin mendim për jolegalitetin⁴⁴ e veprimeve raciste, dhe për një qasje që gradualisht shkonte e bëhej gjithnjë e më detyruese ndaj qeverisë zyrtare e cila atë politikë e ndiqte. Shembulli i Afrikës së Jugut erdhi e u zhvillua në një qasje ndërkombëtare, e cila, ndonëse pa mundësi të përdorimit të lejuar të forcës, ishte një lloj hyrjeje për kërkesat e mëvonshme për intervenim humanitar.

Kishte edhe ndalesa të tjera të cilat Kombet e Bashkuara i pengonin që ta autorizonin përdorimin e forcës. E para, standardet normative që kishin të bënin me të drejtat ndërkombëtare të njeriut nuk ishin pranuar në një mënyrë mjaft serioze si obligim i brendshëm. E dyta, intervenimet e periudhës së Luftës së Ftohtë, në planin gjeopolitik shiheshin si praktika deri në skajshmëri destruktive, të cilat nuk kishin sjellur asgjë të mirë në shoqëritë në të cilat ishte përdorur dhuna, megjithatë që idealet që proklamoheshin nga pala intervenuese ishin të larta dhe fisnike. Kjo trashëgimi e

kishte shkaktuar një dyshim të vazhdueshëm, në veçanti në shtetet që kanë qenë paraprakisht të kolonizuara ose në ato që dominoheshin nga Perëndimi, se “intervenimi humanitar” ishte vetëm një emër i ri për vazhdimin e dominimit perëndimor. Për OKB-në, dhënia e ndonjë legjitimiteti kërkesave të tilla do të thoshte krijim i një “Kali të Trojës,” i cili do të mund të përdorej për ta dobësuar pavarsinë politike, e madje edhe integritetin territorial të shteteve sovraane të vogla. Për këtë arsye, më së shumti që mund të përfundohet lidhur me intervenimin humanitar, është që rolin kryesor e ka disponimi ekzistues për t’iu qasur katastrofave humanitare imanente në bazë të parimit ad hoc, domethënë një qasje veç e veç, varësisht nga rasti konkret. Kjo e forcon edhe më tepër përshtypjen për standardet e dyfishta (ndërmarrja e aksionit në Kosovë, por jo edhe në vendet e tjera me shkelje të njëjta apo edhe më të larta të drejtave të njeriut), por e ruan normën themelore të mosndërhyrjes në çështjet e brendshme. Për shkaqë krejtësisht të kundërta – dëshira për t’ju shmangur presionit për veprim, si në Afrikën sub-Sahariane apo në Azinë Jugore – ato shtete që e bënë intervenimin në Kosovë janë përsëri të prirura për një qasje ad hoc.

Komisioni është i mendimit që fundi i Luftës së Ftohtë i ka shkaktuar disa ndryshime dramatike të kushteve, të cilat përpilimin e një doktrine për intervenime humanitare tani e bëjnë më të mundshëm sesa që ai ishte në të kaluarën. Ka ndodhur një zhvillim mbresëlënës i standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut, dhe është rritur gjasa për respektimin e tyre, si nga Bashkësia e organizuar Ndërkombëtare (siç ishte fushata kundër apartheidit), ashtu edhe përmes iniciativave të organizatave të shoqërisë civile dhe të qeverive përkatëse. Përpos kësaj, është edhe një trend në rritje në këmbënguljen për kërkimin e përgjegjësive të udhëheqësve shtetërorë lidhur me krimet e shteteve, e që u dëshmuar nga kundërthëniet lidhur me rastin e ekstradimit të Gjeneralit Augusto Pinochet, sëndërtimit të ICTY-së dhe me Traktatin e Romës të vitit 1998, si një kornizë për themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Ndërkohë, kërcënimi që veprimet e ndërmarra për qëllime humanitare do të mund ta nxisnin ndonjë luftë strategjike ndërmjet të shteteve të mëdha është zvogëluar. Viteve të fundit, Kombet e Bashkuara dhe aktorët e tjerë të fuqishëm janë kritikuar ashpër për mosangazhimin dhe për mosveprimin e duhur në rastet kur ka patur rrezik për ndodhjen e katasrofave humanitare, apo edhe në rastet kur ato vërtet ndodhnin. Organizata e Bashkimit Afrikan (OBA), në një raport të publikuar së voni, e kritikonte ashpër OKB-në, Francën dhe Shtetet e Bashkuara, për dështimin e tyre për të vepruar në parandalimin e gjenocidit në Ruandë, më 1994.⁴⁵ Situatë e ngjashme është edhe ajo që ka të bëjë me rolin e OKB-së në Bosnje, e cila e arriti kulmin në dështimin për t’i mbrojtur “zonat e sigurta” të krijuara nën autoritetin e OKB-së, dhe kjo

shprehet në kritikën për mbrojtjen e pamjaftueshme që është ofruar.⁴⁶ Me fjalë të tjera, tani ekziston mbështetja politike, morale dhe ligjore për ta krijuar një ekuilibër të ri ndërmjet obligimit të përgjithshëm për mosndërrhyrje në çështjet e brendshme të shteteve, dhe karakterit të intervenimit humanitar në bazë të vendimeve kolektive parimore.

Me qëllim të avancimit të diskutimit dhe të dhënies së rekomandimeve lidhur me këto çështje të rëndësishme, Komisioni e beson që tani është koha për ta paraqitur një kornizë të parimeve, të përshtatshme për vlerësimin e intervenimeve të mëparshme humanitare, ashtu që reagimet e ardhshme në rastet e katastrofave humanitare që mund të ndodhin, të orientohen dhe të udhëhiqen si duhet. Është me rëndësi që të kuptohet se tërësia e kësaj kornize është më e gjerë sesa shpërdorimet e qeverive që e mbyllin çështjen e vuajtjeve të rënda njerëzore me rrëzimin e qeverisë, ashtu siç ka ndodhur, për shembull, në Somali në fillim të viteve '90. Ne shpresojmë që kjo kornizë më vonë do të miratohet në një trajtë të modifikuar si Deklaratë për Intervenimin Humanitar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në këtë drejtim, mund të formulohen dy linja kryesore. Qasja më e preferuar do të ishte që Karta e përshtatur me këtë Deklaratë të Intervenimit Humanitar do ta çonte përpara respektimin e të drejtave të njeriut duke i kushtëzuar të drejtat sovrane me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me ruajtjen e aftësisë për të qeverisur. Një qasje tjetër alternative do të ishte nxitja e KS të OKB-së për një interpretim të tillë të Kartës, i cili në një mënyrë të qartë do ta bënte trajtimin e rasteve veç e veç, duke e mëkëmbur kështu një qasje më autoritative në këtë drejtim, dhe e cila do të ishte në përputhje me Deklaratën për Intervenim Humanitar.

Këto "risi" në interpretimin e Kartës ishin pjesë e të tërë historisë së OKB-së, ndërkaq manifestimin më të theksuar e kanë patur gjatë kohës kur Sekretar i Përgjithshëm ishte Dag Hammarskjöld, dhe atë kryesisht në kontekstin e aktiviteteve paqëruajtëse të OKB-së. Një shembull i mirë i një interpretimi të tillë "legjislativ" ishte Neni 27(3), ku parashihej që vendimet e KS të OKB-së do të merreshin me vota "të përbashkëta" të pesë anëtarëve të përhershëm, e i cili Nen në praktikë u ndryshua duke i trajtuar edhe "abstenimet," domethënë të mosvotuarit, si vota të "përbashkëta".

Megjithatë, mund të jetë joreale që një përfundim i tillë të pritet në një të ardhme të afërt. Një numër i madh shteteve, intervenimin humanitar pa autorizim të Kombeve të Bashkuara vazhdojnë ta shikojnë me një dyshim të madh, dhe nuk janë të disponimit për pranimin e intervenimeve të tilla, madje edhe me autorizimin e OKB-së. Ato shprehin mosbesim ndaj qëllimeve "humanitare," dhe i kundërshtojnë

ndërhyrjet në sovranitetin territorial. Shumica e shteteve në KS të OKB-së e kanë shfaqur vullnetin për t'i pranuar rezultatet e intervenimit në Kosovë si një realitet praktik. Njëkohësisht, shumë prej tyre intervenimit ia kanë dhënë një mbështetje të tërthortë, përmes përkrahjes të cilën ia bëjnë UNMIK-ut, me qëndrimin të cilin e kanë, ose edhe duke e kundërshtuar miratimin e ndonjë rezolute kritikuese. Sidoqoftë, për momentin, në Kombet e Bashkuara nuk janë bërë kurrfarë përpjekjesh të cilat do ta ofronin ndonjë rregullativë parimore, e me të cilën do të “legalizoheshin,” intervenimet e tilla në të ardhmen.

Përpjekjet që intervenimi humanitar të mbështetet në baza parimore është duke hasur në edhe një burim tjetër të rezistencës. Disa vende të rëndësishme nuk kanë kurrfarë gatishmërie që intervenimin humanitar ta heqin nga sfera e diplomacisë ad hoc, ashtu që të krijohet mundësia e të priturit që, sa herë të ndodhë ndonjë katastrofë humanitare, atëherë do të paraqitet edhe obligimi që kriza të parandalohet ose të zbutet. Në këtë drejtim, qëllim i tyre është që ta ruajnë fleksibilitetin diplomatik lidhur me trajtimin e sfidave të tilla në mënyrë selektive, ashtu që të reagojnë, po qe se vullneti politik ekziston, por pa marrë mbi vete detyrime më të mëdha dhe më të përgjithshme të një reagimi konsistent, i cili do të mund të mos ishte në përputhje me interesat ose me pikëpamjet e shoqërive të tyre. Këto shtete aktualisht nuk kanë vullnet që ta marrin mbi vete detyrën e intervenimit humanitar, me përjashtim të momenteve dhe të vendeve për të cilat një intervenim i tillë do t'ju konvenonte.

Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm, që korniza për intervenim është një hap kontradiktor. Njëri nga qëndrimet kundërshtuese e thekson atë se një kornizë e tillë nuk është e domosdoshme, për shkak të frikës se do të mund të humbej interpretimi i ndalimit të forcës, dhe atë deri në shkallën në të cilën “e Drejta Ndërkombëtare” e ka definuar atë që këtu u quajt “legjitimitet.” Qëndrimi tjetër ngulmon që mëkëmbja e parimeve të tilla do t'i kontribuonte edhe më shumë rritjes së diskrecionit gjeopolitik lidhur me forcën, duke e dobësuar, në këtë mënyrë, edhe më tepër, si të Drejtën Ndërkombëtare, ashtu edhe vetë punën e Kombeve të Bashkuara. Ky qëndrim i është theksuar Komisionit nga pjesëmarrësit e seminarit të Johannesburgut në një mënyrë të veçantë.

Megjithatë, gjatë viteve '90, rëndësia e marrëveshjes lidhur me përcaktimin e parimeve për intervenimin humanitar ose për respektimin e detyrueshëm të të drejtave të njeriut, e ka përjetuar një afirmim të shquar. Somalia, Bosnja, Haiti, Ruanda dhe Timori Lindor, janë vetëm disa nga rastet më të spikatura, e në lidhje me të cilat është ushtruar një trysni e madhe morale, si ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare ashtu edhe ndaj sistemit të OKB-së, me qëllim të veprimit me forcë për ndaljen e katastrofave human-

itare në rrjedhje e sipër. Në këto raste, trysnia është ushtruar si rezultat i rrethanave të brendshme. Kosova e paraqet një sfidë, dhe reagimi i NATO-s në këtë rast nga analistë të shumtë është konsideruar si një moment kthese në debatin lidhur me intervenimin humanitar.

Një kornizë për intervenimin humanitar parimor

Instituti Danez për Çështje Ndërkombëtare i propozoi pesë “kritere të mundshme,” e të cilat një intervenim do ta shndërronin në “intervenim humanitar legjitim.” Edhe pse Instituti ngurroi për ta mëkëmbur ndonjë mbështetje për përdorimin e forcës jashtë kornizës ekzistuese të të Drejtës Ndërkombëtare, këto kritere, megjithatë, e paraqitën një pikëmbështetje të dobishme në përpilimin e rekomandimeve të Komisionit për krijimin e një rregullative joformale e cila do të duhej zbatuar gjatë intervenimit humanitar. Kriteret e Insitutit Danez janë:

- Ekzistenca e shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, ose e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare;
- Dështimi për të vepruar i KS të OKB-së;
- Sigurimi i mbështetjes multilaterale për veprim;
- Përdorimi vetëm i forcës së domosdoshme dhe adekuate;
- “Mungesa e interesave,” të shteteve intervenuese.⁴⁷

Korniza e parimeve të rekomanduara nga Komisioni ndahet në dy pjesë. E para i propozon parimet themelore të cilat duhet përmbushur, ashtu që intervenimi humanitar përkatës të jetë legjitim. E dyta i çon përpara ato parime të cilat e rrisin apo e zvogëlojnë shkallën e legjitimitetit të cilën e nënkupton intervenimi me forcë. Këto “parime kontekstuale” mund të aprovohen ose para ndonjë intervenimi, me qëllim të përcaktimit nëse forca duhet përdorur apo jo, ose pas intervenimit, ashtu që të krijohet mundësia për vlerësimin se a ka qenë intervenimi i justifikueshëm apo jo. Përndryshe, këto parime duhet të kuptohen si të lejueshme për t’u zbatuar gjatë intervenimit humanitar me përdorimin e forcës, qoftë nga OKB-ja, qoftë nga ndonjë koalicion i shteteve që kanë gatishmëri për të vepruar me ose pa mandatin e OKB-së, përpos në rastet kur në tekst thuhet shprehimisht që këto parime janë relevante vetëm kur intervenimi bëhet pa mandatin e OKB-së. Më tutje, duhet patur parasysh atë që shprehja “intervenim” nuk është e zbatueshme në situatat kur qeveria në pushtet e jep pëlqimin për prani ndërkombëtare, meqenëse në rastet të tilla nuk ekziston kurrfarë problemi juridik lidhur me legjitimitetin e participimit humanitar.

Parimet fillestare

Ekzistojnë dy shkaqe që e arsyetojnë intervenimin humanitar. I pari ka të bëjë me shkeljet e vrazhda të të drejtave ndërkombëtare të njeriut apo të ligjeve humanitare në një mënyrë të vazhdueshme. I dyti është shtypja e shoqërisë civile në përmasa që shkaktojnë vuajtje të mëdha, dhe të rrezikut për shkak të “dështimit” të shtetit në fjalë, e që mbart me vete edhe rrezikun e shembjes së qeverisjes në nivelin e territorit të shtetit sovran;

Qëllimi themelor i të gjitha fazave të intervenimit, duke e përfshirë këtu kërcënimin me forcë apo edhe përdorimin e forcës, duhet të jetë mbrojtja e drejtpërdrejtë e popullatës së viktimizuar;

Metoda e intervenimit duhet të mendohet në një mënyrë të arsyeshme, ashtu që ajo vërtet t’i jep fund katastrofës humanitare sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe, në mënyrë specifike, duhet ndërmarrë masa për mbrojtjen e të gjithë civilëve, ashtu që të shmangen dëmet anësore ndaj shoqërisë civile, dhe të parandalohen çfarëdo pasoja apo veprime sekondare, qoftë ndëshkuese, qoftë hakmarrëse kundër qeverisë së atij vendi.

Parimet kontekstuale

Duhet të bëhen përpjekje serioze për ta gjetur një zgjidhje paqësore të konfliktit. Zgjidhja duhet të nënkuptojë që konflikti, në një mënyrë të besueshme dhe të përherëshme ka marrë fund, dhe se është duke u zhvilluar procesi i vendosjes së qeverisjes adekuate;

Mbështetja në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo abstenimi nga ai, nuk janë vendimtare. Kjo ndodh po qe se mbështetja në këtë Këshill dështon për shkak të vënies së vetos nga një apo më shumë anëtarë të përherëshëm, apo po qe se abstenimi për të kërkuar mbështetje nga KS i OKB-së bëhet për shkak të parashikimit të sigurt për një veto të tillë, gjë kjo e cila kërkesën Asamblesë së Përgjithshme e bën jopraktike. Në fakt, kjo e fundit tregon që e drejta e vetos duhet zëvendësuar me 2/3, apo, edhe më saktë, me përcaktimin e shumicës së “koalicionit të atyre që e kanë vullnetin” për të vlerësuar që një katastrofë humanitare është duke ndodhur apo pritet që do të ndodhë;

Para se të ndërmerret aksioni ushtarak, duhet dëshmuar që masa të tjera më të buta,

çfarë janë, për shembull, monitorimi dhe masat shtrënguese, duke i përfshirë këtu edhe sanksionet, embargon dhe metodat jo të dhunshme të vëzhgimit paqësor, nuk kanë patur sukses. Zvarritja e mëtutjeshme e procesit, duhet ta nënkuptojë qartë shtimin e rrezikut për ndodhjen e katastrofës humanitare;

Kërcënimi me forcë apo me përdorimin e forcës, çfarëdo qoftë ai, nuk duhet të bëhet në mënyrë unilaterale, por duhet ta ketë një mbështetje kolektive, të shprehur, si në procesin multilateral të autorizimit, ashtu edhe në formën e pjesëmarrjes së më shumë shteteve në aksion;

Nuk duhet të bëhet asnjë akt formal i kundërshtimit apo i dënimit të intervenimit nga ana e organeve kryesore të Kombeve të Bashkuara, dhe veçanërisht jo nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, apo nga KS i OKB-së;

Respektimi i ligjeve të luftës dhe i të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare duhet të bëhet në mënyrë edhe më strikte sesa në rastet e operacioneve ushtarake standarde. Kjo vlen për që të gjitha aspektet e operacioneve ushtarake, duke i përfshirë këtu edhe rastet e mundshme të pushtimit pas arritjes së armëpushimit;

Qëllimet territoriale apo ekonomike janë jolegjitime, dhe këto kurrsesi nuk mund të shërbejnë si arsytime për intervenim. Po ashtu, duhet të ekzistojë një vullnet i besueshëm i shteteve intervenuese për t'i tërhequr forcat ushtarake dhe për t'i hequr sanksionet ekonomike, menjëherë pasi që qëllimet humanitare të intervenimit të arrihen;

Një herë pasi që qëllimet e përdorimit të forcave të armatosura të jenë arritur, duhet të fillohet me një zbatim të fuqishëm të misionit humanitar, përmes dhënies së një mbështetjeje të mjaftueshme në mjetet e nevojshme për ta ndihmuar popullatën e vendit në të cilin është bërë intervenimi, dhe për ta mundësuar një rindërtim të shpejtë dhe sa më human të shoqërisë, me synimin e kthimit të gjendjes normale për të tërë popullatën. Kjo e nënkupton edhe ndërprerjen e sanksioneve ndëshkuese dhe gjithëpërfshirëse të vendosura më parë.

Ndryshimet e propozuara të kartës së OKB-së

Sfida e së ardhmes kurrsesi nuk do të jetë ajo që do të ketë shumë shtete apo grupe të shteteve që do të jenë të gatshme për të intervenuar për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut: kjo sfidë do të jetë pikërisht e kundërta. Përvojat e kohëve të fun-

dit dëshmojnë që shtetet kanë interes dhe prirje për të gjetur arsytetime për mosintervenim. Shikuar nga këndvështrimi optimist, rasti i Kosovës mund ta bëjë paksa më të vështirë si për KS të OKB-së, ashtu edhe për shtetet veç e veç, që në të ardhmen t'i shmangen ndërmarrjes së aksioneve kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që aksionet e tilla duhet ta përfshijnë edhe autoritetin dhe vendimet e KS të OKB-së. Po kështu, është jo vetëm e arsyeshme por edhe e domosdoshme, që në Kartën e OKB-së t'i jepet më shumë rëndësi mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Aktualisht, Karta nuk i jep autorizim të qartë KS të OKB-së që të ndërmerr masa në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Ndarja e kompetencave ndërmjet të organeve të ndryshme të OKB-së, është pjesë e një strukture komplekse politike e juridike, në qendër të së cilës është sistemi i sigurisë kolektive. Nën sistemin e sigurisë kolektive, roli i KS të OKB-së është, ose, të paktën, deri tash ka qenë, që ta garantojë paqen dhe rendin ndërkombëtar. Përbrenda kësaj kornize të KS të OKB-së, çështja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka qenë një çështje e dorës së dytë. Mënyra më ideale që ta arrijmë qëllimin që e kemi, do të ishte që Karta të pësojë ndryshime të cilat do ta rrisin rëndësinë e të drejtave të njeriut përbrenda sistemit të sigurisë kolektive.

Një ndryshim i tillë do të bënte trysni, dhe në këtë mënyrë do ta bënte të mundur që KS i OKB-së të ndërmerr masa të llojeve të ndryshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke iu referuar shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të së Drejtës Humanitare. Rrjedhimisht Këshilli i Sigurimit nuk do të ishte i detyruar që të humbiste kohë në secilin rast duke iu referuar nocionit të “kërcënimit ndaj paqes,” dhe, për më tepër, do ta kishte shumë të vështirë që të qëndronte mënjanë, pa bërë asgjë.

Dispozitat për të drejtat e njeriut do të mund të shtoheshin në nene të shumta ekzistuese të Kartës së OKB-së. Për shembull, në Nenin I të Kartës, lidhur me qëllimet e OKB-së, referenca për të drejtat e njeriut do të mund të shtohet që në fjalinë e parë, në nënparagrafin 1, menjëherë pas “paqja ndërkombëtare dhe siguria.” Fjalja e parë e nënparagrafit 1, në këtë rast do të ishte “për ta ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut (...).”

Në Nenin 24, nënparagrafi 1, që ka të bëjë me funksionimin dhe kompetencat e KS të OKB-së, pasusi “dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut” do të mund të shtohet pas “ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare,” kështu që Neni 24(1) do të ishte:

“Me qëllim që të mundësohet veprim i shpejtë dhe efikas i Kombeve të Bashkuara, anëtarët e saj pajtohen që përgjegjësia parësore e KS të OKB-së është ruajtja e paqes

dhe e sigurisë ndërkombëtare si dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut, dhe, po ashtu, pajtohen që për zbatimin e detyrave nën këtë përgjegjësi, KS i OKB-së do të veprojë në mbështetje të tyre.”

(Aktualisht, përgjegjësinë parësore të punës lidhur me të drejtat e njeriut përbrenda organizatës së OKB-së e ka Asambleja e Përgjithshme. Në vend të përmbyesjes së këtij rregullimi të çështjeve, shprehja “themelore” në amandamentin e propozuar është vënë para “të drejtave të njeriut,” me qëllim që të tregohet se KS i OKB-së do të ndërhyjë vetëm në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.)

Në fund të Nenit 39, po ashtu mund të shtohet edhe referenca “respektimi i të drejtave të njeriut.” Pas ndryshimit, ky Nen do të bëhej: “KS i OKB-së do ta përcaktojë ekzistencën e ndonjë kërcënimi ndaj paqes, shkeljes së paqes, aktit të agresionit apo të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, dhe do të bëjë rekomandime apo do të marrë vendime se cilat masa duhet të ndërmerren në përputhje me Nenin 41 e 42, për ta ruajtur apo rikthyer paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe respektimin e të drejtave të njeriut.”

Është e qartë që ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për rezistencën e fuqishme politike për ndryshimin e Kartës së OKB-së. Mirëpo ka edhe mënyra “më të buta” të veprimit sesa që është ndryshimi i Kartës, siç është, për shembull, miratimi i deklaratave interpretuese lidhur me paragrafe të caktuara të Kartës, apo edhe rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme.

Mirëpo, ekziston, po ashtu, një disponim ndërkombëtar në rritje për reformën e OKB-së, prandaj Komisioni do të kishte dëshirë që të japë një nxitje të këtij procesi. Komisioni konsideron që, përpos një shtimi specifik të dispozitave lidhur me të drejtat e njeriut në Kartë, edhe debatet e tjera që janë duke u bërë lidhur me reformën e KS të OKB-së, e kanë një rëndësi të drejtpërdrejtë për çështjen e intervenimit humanitar. Struktura e OKB-së nuk ka ndryshuar që nga formimi i saj, ndonëse periudha pas Luftës së Ftohtë ka sjellë ndryshime të mëdha në atmosferën politike. Komisioni e konstaton që KS i OKB-së duhet të reformohet, po qe se dëshiron që ta ruajë funksionalitetin dhe legjitimitetin global. Me zgjerimin e numrit të vendeve të përhershme dhe të atyre jo të përhershme në KS të OKB-së, do të mundësohej një gadishmëri më e madhe për veprim dhe një vendimarrje më e suksesshme, si dhe një përfaqësim më i madh nga radhët e anëtarëve të OKB-së. Duke i patur parasysh përvojat e Kosovës, të Ruandës, dhe të rasteve të tjera të ngjashme, ne po ashtu e vlerësojmë që sistemi ekzistues, i cili i bën të mundur secilit anëtar të përhershëm të KS të OKB-së që t'i paralizojë veprimet e tij përmes përdorimit të vetos, duhet të rregullohet në një

mënyrë më të arsyeshme, ashtu që ta mundësojë një veprim më efikas në rastet e krizave ekstreme humanitare. Komisioni dëshiron ta vejë në dukje që ndryshimet e tilla janë urgjente, si për hir të viktimave të ardhshme të krizave humanitare, ashtu edhe për legjitimitetin dhe kredibilitetin e OKB-së si mbrojtës i autorizuar dhe legjitim i sigurisë globale.

Përfundim

Zbatimi i kornizës për intervenimin humanitar në Kosovë e kishte për qëllim më shumë nxitjen e debatit, sesa zgjidhjen e kundërthënies. Marrëdhënia ndërmjet parimeve të shprehura dhe fakteve është komplekse, dhe pikësynim i linjave të ndryshme të interpretimit. Është e kuptueshme që ka mospajtme. Përparësia e një kornize të tillë është se ajo i inkurajon qasjet edhe më gjithëpërshirëse lidhur me intervenimin, dhe i dekurajon pikëpamjet e njëanshme. Po ashtu, kjo e përmban edhe një porpozim para-ligjor për nisma nga qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare, që të bëjnë hapa drejt mëkëmbjes së një doktrine juridike për intervenimin humanitar, e me të cilën do të bëhet ekuilibrimi i nevojës për mbrojtje të popujve, përballë rëndësisë së kufizimit të diskrecionit për përdorim të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

7. Organizatat humanitare dhe roli i mediave

Kriza kosovare e ka shkaktuar zhvendosjen më të madhe të popullsisë në Evropë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Vëzhguesit e bëjnë me dije se ka vlerësime të sigurta për zhvendosjet e brendshme edhe para bombardimeve.¹ Megjithatë, si organizatat qeveritare, ashtu edhe ato joqeveritare, kanë mbetur të befasuara me përmasat e krizës së refugjatëve. Dy ditë pas fillimit të bombardimeve, në një konferencë shtypi në Tiranë, përfaqësuesi i Komisionarit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR), nuk e pat dhënë asnjë shenjë që do të mund të vinte deri te ndonjë krizë masive me refugjatë. Shkrimet që më vonë u paraqitën në shtyp e bënë të ditur që shërbimet gjermane të intelgjencës kishin dijeni për “Operacionin Patkoi,” plan ky i Serbisë (lidhur me ekzistimin e të cilit ka patur mjaft diskutime) i cili e synonte dëbimin masiv dhe të përnjëhershëm të shqiptarëve etnikë jashtë Kosovës. Sidoqoftë, ndonëse UNHCR-i ishte organizata e cila duhej ta bënte punën kryesore në koordinimin e veprimeve në rast të ndonjë krize refugjatësh, asnjë qeveri dhe asnjë burim tjetër nuk i ofroi UNHCR-it informata paraprake lidhur me këtë plan.²

Vendet fqinje kishin frikë nga një fluks masiv i refugjatëve me vite të tëra para se kriza të shpërthente. Grupet humanitare, megjithatë, nuk kishin informata specifike lidhur me shkallën potenciale të krizës, kështu që ato nuk kishin planifikuar fare kontigjente të mjaftueshme për ndonjë mundësi të dëbimeve masive. Përgatitja për t'u përballur me ndonjë situatë emergjente të pritur, e nënkupton edhe përgatitjen për ballafaqimin me të papritura. Grupet humanitare e kanë patur në dijeni që më parë mësimin se kur ka numër të madh të njerëzve të zhvendosur përbrenda territorit, atëherë mund të pritet një fluks i madh i refugjatëve, të paktën sa për planifikim eventual. Për fat të keq, mungesa e vazhdueshme e fondeve, shkaktoi që UNHCR-i t'i ketë të kufizuara kapacitetet për ndonjë planifikim të tillë. Për më tepër, doli që UNHCR-i ishte më pak e pajisur me fonde, në krahasim me organizata të tjera humanitare të shumta, të cilat në një mënyrë në tërësi të pazakontë siguruan fonde të shumta menjëherë pas shpërthimit të krizës. Si pasojë, UNHCR-i u ballafaqua me një sfidë të veçantë në përpjekjet për ta kryer rolin e tij si organizatë kryesore, ndërkohë që përreth kishte organizata të tjera të shumta me mjete të bollshme, të cilat nuk kishin nevojë fare për ta respektuar rolin koordinues të tij.³

Një studim i pavarur i organizuar nga UNHCR-i për vlerësimin e gatishmërisë dhe të

reagimeve të organizatës, erdhi në përfundimin se ai e kishte refuzuar bashkëpunimin me NATO-n rreth planifikimit të ushtrimeve më 1998. Këtë bashkëpunim e kishin penguar brengat e arsyeshme të rrezikimit të misionit dhe të kredibilitetit, ndonëse ky ka mundur të sillte përparësi të shumta për situatën e paparashikuar. Grupet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mund të kenë patur më tepër informata të rëndësishme. Gjatë kohës së bombardimeve, ata nuk e kishin askend brenda Kosovës, dhe përpiqeshin që ta krijonin ndonjë ide për atë se çfarë po ndodhte vetëm përmes intervistave me refugjatët që po vinin.⁴

Angazhimet e mëparshme lidhur me personat e zhvendosur në brendi të Kosovës, e kishin hutuar UNHCR-in, dhe edhe të tjerët që është dashur t'i bënin përgatitjet për fluksin e refugjatëve. Krahas kësaj, askush – duke e përfshirë këtu edhe vetë komandën e NATO-s - nuk e dinte se sa do të zgjasnin bombardimet e NATO-s, kështu që ishte e pamundur të parashihej se çfarë do të ishin pasojat për popullatën civile. Madje, edhe ata të cilët në disa vitet e mëparshme e kishin bërë vëzhgimin e rajonit nga afërsia, kanë mundur të pritnin vetëm zhvendosje të brendshme, por jo edhe një krizë aq masive të refugjatëve.

Punëtorët humanitarë gjatë luftës

Disa grupe humanitare, dhe në veçanti Programi Botëror i Ushqimit (WFP), ishin më të shpejtë në reagim sesa UNHCR-i. Të ndodhur përballë situatës së krizës, udhëheqësit ushtarak në terren, trysninë për një reagim sa më të shpejtë e cila ushtrohej mbi ta, e bartën në udhëheqësat politik. Trupat paqeruajtëse të NATO-s të stacionuara në Maqedoni, u riorientuan menjëherë, ashtu që të mund të merreshin me problemet e refugjatëve. Vetë NATO-ja nuk ishte e përgatitur në tërësi për këtë lloj të angazhimeve humanitare.⁵ Kontigjentet e trupave kombëtare të NATO-s, menjëherë e bënë ndarjen e zonave të vërsuara nga refugjatët në Maqedoni dhe në Shqipëri, dhe ndërtuan kampe të shumta për refugjatë. Komandat ushtarake, megjithë mungesën e përvojave në aktivitete të këtilla, nuk bashkëpunuan me UNHCR-in dhe me Organizatën Botërore të Shëndetësisë të cilat përpiqeshin t'i ofronin këshilla mbi atë se si duheshin ndërtuar kampet për refugjatë.

Gara e cila u zhvillua ndërmjet grupeve qeveritare/ushtarake të NATO-s, si dhe ndërmjet këtyre dhe grupeve ndërkombëtare humanitare, ushtarakisht është perceptuar si e ngadalshme dhe joefikase. Dhe, për më tepër, qeveritë kombëtare kërkonin që kampet e ndërtuara nga kontigjentet ushtarake italiane, gjermane, britanike dhe franceze

të NATO-s, t'u jipeshin grupeve të tyre joqeveritare. Në këtë kontekst, as UNHCR-i dhe as ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare nuk ka mundur ta luaj ndonjë rol koordinues, dhe madje as t'i vlerësojë OJQ-të dhe atë se a e kishin ato aftësinë dhe përvojën e mjaftueshme.

Shfaqja e OJQ-ve në skenë, nga disa komentatorë është vlerësuar si një “furi gllabëruese” e dilerëve të krizës. Disa OJQ ia arritën që të ofrojnë ndihmë pa e demonstruar që e kishin ndonjë përvojë apo kompetencë e cila u nevojitej për tu shërbyer njerëzve të cilëve e kishin për qëllim tu ndihmonin. Në vend se në fillim ta përcaktonin misionin e tyre dhe të mbështeteshin para së gjithash në përvojat e terrenit, disa furnizues ishin të gatshëm të premtinin çfarëdo për të cilën donatorët ishin të gatshëm të paguanin.⁶

Në këto rrethana, aktivitetit iu qasën disa qindra organizata jo qeveritare.⁷ Problemet nuk kishin të bënin aq shumë me mosnjohjen e grupeve, por me dështimin në koordinimin e punës se tyre.⁸ UNHCR-it, si kryesues në radhën e organizatave të OKB-së dhe udhëheqës potencial i grupeve humanitare, me të madhe i është mveshur faji për këtë mungesë koordinimi. Megjithatë, nga pikëpamja e UNHCR-it, vështirësitë janë paraqitur kryesisht për shkak të ushtrisë – me trupat kombëtare, shkonin edhe OJQ-të përkatëse kombëtare. Peter Morris nga organizata ‘Mjekët Pa Kufij,’ e dha komentin që në rastin e Kosovës, më 1999, “shumë qeveri kishin arritur marrëveshje bilaterale për fondimin e OJQ-ve, duke e anashkaluar dukshëm aftësinë e UNHCR-it për t'i përpiluar prioritet programore, dhe për të arritur të bëjë punë efikase.”⁹ Një grup i pavarur ekspertësh deklaroi që UNHCR-i pengohet nga tymnaja e misioneve humanitare dhe ushtarako/politike, nga rivalitetet institucionale, si dhe nga mungesa e personelit udhëheqës të aftë që të ballafaqohet me sfidat e vështira diplomatike gjatë fazës fillestare të emergjencës.¹⁰

Megjithëkëtë, pas periudhës së kaosit fillestar, si organizatat ushtarake ashtu edhe ato humanitare, dhanë ndihmë efikase humanitare. Grupet humanitare gjetën metoda të reja për ta ndihmuar bashkimin e familjeve. Disa përdornin Internetin; të tjerat shërbeheshin me regjistrat jugosllav të numrave telefonik, dhe, po ashtu, krijonin regjistra të rinj. Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit (IRC), përpiqej ta gjente një qasje më të thjeshtë për ta bërë ribashkimin, dhe këtë punë e kryente në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC). UNHCR-ja kishte rol drejtues në këto veprime, mirëpo, meqë ishte më e ngadalshme se ushtria në planifikim dhe në vendosjen e mjeteve, ndihma humanitare fillestare u planifikua nga NATO-ja. Megjithëkëtë, një ekip i ekspertëve të pavarur e konstatoi që UNHCR-ja, lëvizjet e

refugjatëve të cilët ndodheshin jashtë Kosovës i drejtoi me sukses, dhe “me shpejtësi e përmasa të papara.”¹¹

Në Shqipëri, ndihma më e madhe u ofrua nga vetë qytetarët shqiptarë, të cilët u ofruan mikpritje rreth 285.000 refugjatëve. Ushqimi sigurohej nga Programi Botëror i Ushqimit, ndërkaq, shpërndarja bëhej nga 40 OJQ-të bashkëpunëtoresh. Organizata Botërore e Shëndetësisë ofronte ndihma shëndetësore për gra, fëmijë dhe grupe të pambrojtura. OJQ-të e kishin marrë përsipër menaxhimin e kampeve, dhe këtu e bënë sigurimin e ujërave, të pajisjeve higjienike, si dhe shërbime të tjera; në të njëjtën kohë, refugjatët e strehuar nëpër familje merrnin më pak ndihma. UNHCR-ja ofronte para të gatshme për familjet mikpritëse, mirëpo nuk u tregua e aftë që ato t'i shpërndante para momentit të rikthimit. Një karakteristikë tipike e refugjatëve të strehuar nëpër familje, ishte pagesa që ata e bënë për pjesën e vendosjes dhe të ushqimit. Marrëveshja bilaterale ndërmjet qeverisë shqiptare dhe NATO-s, ishte pengesë në përpjekjet e UNHCR-së që ta ketë një rol të përgjithshëm koordinues. Gjatë shpërndarjes paraqiteshin si mungesat, ashtu edhe rastet e ndihmave të dyfishta.

Në Maqedoni, qeveria fillimisht nuk e lejoi hyrjen e refugjatëve. Në këtë mënyrë, gjatë fazës fillestare të emergjencës kufizimet qeveritare e vështirësuan arritjen e ndihmave tek refugjatët. Qeveria maqedonase kërkonte, po ashtu, që nga puna e kampeve të përfitonte komuniteti vendor. Kjo e kufizonte aftësinë e organizatave humanitare që t'i përmbushnin prioritetet e tyre në dhënie të përgjigjes së përkohshme emergjente. Forcat e NATO-s i ndërtuan disa nga kampet e para me tenda. Familjet mikpritëse po ashtu ofruan strehim, ndërkaq, OJQ-të dhe Kryqi i Kuq i Maqedonisë siguronin ushqim dhe dysheqe. UNHCR-ja ndihmoi me pagesat e shërbimeve komunale për familjet mikpritëse.

Standardet e trajtimit në kampet e refugjatëve kosovarë e tejkalonin atë që, marrë në përgjithësi, ju është ofruar, për shembull, refugjatëve në Afrikë. Ka patur pohime për gjëra luksoze, si dhe për shpërdorime të cilat ndodhin nëpër kampe. Pjesëmarrësit afatgjatë në dhënie të ndihmave humanitare bënë kritika lidhur me atë që kampet ishin shumë të mëdha dhe së tepërmi të shtrenjtë, kur të merrej parasysh numri i të vendosurve, ndonëse kjo e kishte edhe një funksion simbolik – në veçanti për qeverinë e Shqipërisë dhe të Maqedonisë – atë të demonstrimit si të kontrollit, ashtu edhe të përpjekjeve stabilizuese. Në kontekstin e mungesës globale të fondeve, çdo reagim i shpejtë ndaj krizës në një rajon, e kërkon zvogëlimin e angazhimeve në ndonjë rajon tjetër. Kështu, vëmendja e madhe ndërkombëtare e cila u përqendrua në Kosovë ishte shenjë e një reagimi të jashtëzakonshëm humanitar, ndonëse kjo i zvogëloi buxhetet

për aktivitetet e ngjashme në nivel botëror. Një trajtim i tillë që privilegjonte, e rrezikonte si në dukje ashtu edhe në përmbajtje, konceptin e angazhimit në të cilin ndihma ndërkombëtare është e paanshme dhe universale.

Pamundësia e UNHCR-së që në fazat e hershme të emergjencës të kishte qasje në kompjutorë, radio dhe telefon, ka ndikuar në zvogëlimin e aftësive të saj për të mbledhur informata, dhe për t'ua shpërndarë ato organizatave humanitare. Numri shumë i madh i organizatave humanitare që erdhën për t'i ndihmuar refugjatët, prania e hershme dhe nismat fillestare të NATO-s, si dhe kërkesat e qeverive lokale, bënë që koordinimi i ndihmës humanitare të realizohej me vështirësi. Udhëzimet adekuate për përgatitjen për emergjencë dhe këmbimi i informatave lidhur me standardet e ndihmave, do ta kishin dhënë një ndihmë të madhe në koordinimin e aktiviteteve të organizatave humanitare, të qeverive nikoqire dhe të donatorëve. Përveç kësaj, UNHCR-ja duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për identifikimin paraprak të OJQ-ve të kualifikuara, ashtu që të mos vijë deri te shpenzimi i paarsyeshëm i fondeve gjatë periudhës së krizës.

Kthimi dhe rivendosja e refugjatëve

Refugjatët kosovarë dëshironin të ktheheshin në shtëpitë e tyre menjëherë pas përfundimit të bombardimeve, shumë më heret sesa koha të cilën vëzhguesit ndërkombëtarë e vlerësonin të sigurt për kthim. Menjëherë pas ndërprerjes së bombardimeve të NATO-s, më 10 qershor 1999, në kuptimin e plotë të fjalës, me qindra mijëra kosovarë i lanë kampet e refugjatëve dhe shtëpitë ku kishin gjetur strehim tek miqtë në Shqipëri dhe në Maqedoni, dhe morën turr drejt kufirit të Kosovës. Shumica u kthyen në shtëpitë e tyre. Në nëntor, 800.000 nga numri i tërësishëm prej 850.000 refugjatëve, tashmë ishin në Kosovë, duke e shënuar në këtë mënyrë kthimin më të madh dhe më të shpejtë të refugjatëve në historinë moderne.

Në shumë lokalitete, mungesa e infrastrukturës dhe e rendit civil ishte një problem edhe më serioz sesa sfidat humanitare të shpërndarjes së ndihmave apo të rindërtimit të shtëpive për të kthyerit. Grupet ndërkombëtare e kishin nënçmuar dëshirën e madhe për hakmarrje të cilën e mbartnin brenda vetes disa nga shqiptarët kosovarë të cilët u kthyen. Gjatë gushtit 1999, Human Rights Watch e theksonte që serbët dhe romët e ngelur në Kosovë, përballeshin me provokime, kërcënime, rrahje, plaçkitje, e madje edhe me disa raste shqetësuese të kidnapimeve dhe të vrasjeve.¹² Masat mbrojtëse nga grupet humanitare ishin të pamjaftueshme, dhe çështja nuk ishte e vënë në

radhën e prioriteteve, ndërkohë që forcat e NATO-s, ose nuk kishin mundësi, ose nuk kishin dëshirë që ta plotësonin boshllëkun të cilin e lente mungesa e policisë civile. Disa pjesë të forcave të NATO-s filluan t'i mirrnin në mbrojtje disa nga serbët e ngelur, por edhe në këtë drejtim kishte dallime të mëdha, e që varej nga ajo se forca ushtarake e cilit komb ishte përgjegjëse për zonën e caktuar, deri në arritjen e stabilizimit të gjendjes. Grupet humanitare iu bashkangjitën grupeve për të drejtat e njeriut në punën e dokumentimit të shkeljeve, si dhe në shprehjen e kërkesave për paqe e rend.

Disa grupe humanitare vazhduan të jenë posaqërisht kritike lidhur me reagimet brenda në Kosovë, menjëherë pas bombardimeve. Vetëm disa OJQ ishin të gatshme që të punonin me serbët. Ishte bërë fare pak punë në terren për krijimin e ekipeve patroluese të këmbësorisë, të cilat do ta kishin detyrën e mbrojtjes së civilëve. KFOR-i ngurronte për të marrë përsipër funksionin mbrojtës, pos atij paqeruajtës, dhe në këtë drejtim përjashtim të dalluar bënte vetëm kontigjenti i trupave nën komandën e gjeneralit britanik, Sir Michael Jackson. Më vonë KFOR-i e mori përsipër detyrën e ruajtjes së enklavave në të cilat ishin përqendruar serbët e mbetur. Në përgjithsi, gjatë periudhës së kthimit dhe të rivendosjes së refugjatëve, grupet humanitare ishin përqendruar më shumë në aktivitetet e dhënies së ndihmave, sesa në ato të mbrojtjes së civilëve. Kjo shkaktoi debate të brendshme dhe rivlerësime të bëra nga disa nga grupet e angazhuara. Në këtë rast, UNHCR-së, për shembull, i është dhënë kompetenca e mbrojtjes si dhe e ndihmës për refugjatët.

Madje edhe në mungesë të ligjeve themelore, të sigurisë dhe të administratës, grupet humanitare kanë bërë përpjekje që të ofrojnë ndihmë, dhe e kanë mbështetur ringjalljen e shtypit të lirë dhe të institucioneve të tjera civile. Gazetari i moderuar, Veton Surroi, e hapi sërish zyrën e gazetës së tij (Koha Ditore) në Prishtinë. Surroi e dënoi me guxim dhunën ndaj serbëve. Për këtë qëndrim, ai mori mbështetje ndërkombëtare, por fare pak ndihmë të brendshme.

Në momentin e hartimit të këtij raporti, grupet humanitare dhe grupet për të drejtat e njeriut ende ballafaqohen me sfidën e mundësisimit të lirimit të 1.500 - 2.000 shqiptarëve të Kosovës, të cilët u rrëmbyen para dhe gjatë luftës, dhe të cilët ende mbahen¹³ nëpër burgjet serbe. Gjendja e tyre nuk u përfill në marrëveshjen e 10 qershorit 1999, me të cilën luftës iu dha fund. Në raportin e vet të dokumentuar mirë, ICG e ka theksuar që zyrtarët e lartë të NATO-s dhe të Pentagonit e kanë konfirmuar që draftet e para të marrëveshjes së Kumanovës - e cila është bazë e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së - përmbanin edhe dispozita lidhur me çështjen e të burgosurve shqiptarë, por ato

janë hequr nga NATO-ja. “Washingtoni, duke qenë i interesuar që t’u japë fund bombardimeve, dhe duke e ditur dëshirën e aleatëve të vet për t’i dhënë fund luftës, vendosi t’i linte mënjane dispozitat lidhur me të burgosurit, e të cilat, ndër të tjerat, serbët i kundërshtonin.”¹⁴ Çështja e të burgosurve u bë pengesë qendrore për bashkëjetesën paqësore të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Shukrije Rexha nga Shoqata e të Burgosurve Politikë, e dha këtë shpjegim: “Nuk mund të ketë ndërtim të jetës civile në Kosovë, pa lirim të të burgosurve tanë.”¹⁵ Zyrtarët serbë as nuk ofronin të dhëna të plota për të burgosurit, dhe as nuk i lejonin organizatat humanitare ndërkombëtare, anëtarët e familjeve apo përfaqësuesit e tyre të zgjedhur ligjorë që t’u bënin vizita. Përpos kësaj, në vend të organizimit të gjykimeve sipas standardeve ndërkombëtare, apo të lirit të atyre që mbaheshin pa të drejtë, shteti serb e kushtëzonte me haraç lirim të të burgosurve, dhe gjykimet i bënte duke u mbështetur në të dhëna të falsifikuara.¹⁶ Kështu, organizatat humanitare dhe ato të të drejtave të njeriut, kishin fare pak mundësi që të bënin angazhime dhe reagime sistematike e të koordinuara. ICG-ja e vlerëson që KS i OKB-së duhet të bëjë thirrje për lirim të të burgosurve, në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare, dhe se duhet të bëhet një trysni e fuqishme ndaj Beogradit për lirim të të burgosurve. Komisioni me këtë pajtohet në tërësi.

Organizatat e ndihmës humanitare duhet të jenë të parapërgatitura për ballafaqimin me shprehjen e dëshirës për hakmarrje në situatat e tilla, duke zhvilluar strategji të afirmimit të bashkëjetesës. Shpërndarja e ndihmës humanitare, tekefundit, nuk duhet të shërbejë për acarimin e ndjenjave të urrejtjes. Njëkohësisht, në punën e përbashkët me faktorët ushtarakë dhe qeveritarë, organizatat humanitare duhet ta kenë mbrojtjen si prioritet kryesor gjatë aktivitetit të tyre në ofrimin e ndihmave.¹⁷

Organizatat humanitare dhe ushtria

Detyra kryesore e misionit humanitar për mbrojtjen e jetës dhe të sigurisë së popullatës civile është pikërisht ajo pjesë e cila është e përqendruar në marrëveshjen ushtarake. Si mund të krijojnë organizatat humanitare bashkëpunim më të mirë dhe të vazhdueshëm me organizatat ushtarake, pa e komprometuar misionin e tyre? A mundet dhe a duhet të vihet një demarkacion më i qartë, për ta shmangur “zvarritjen e misionit” nga ushtria, si dhe nga gabimet politike e etike të bëra nga organizatat joqeveritare?

Raportet ndërmjet organizatave humanitare dhe ushtrive janë komplekse, madje edhe në rastet kur ushtria është e angazhuar në operacione paqëruajtëse, si në Kroaci apo

në Bosnje e Hercegovinë. Meqë NATO-ja ishte palë pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në konfliktin e Kosovës, këto raporte ishin edhe më të ngarkuara dhe më të vështira. Ishte veçanërisht UNHCR-ja ajo e cila e rrezikonte pakësimin e paanshmërisë dhe të neutralitetit të vet, sikur ta krijonte një bashkëpunim më të ngushtë me NATO-n.¹⁸ Disa vëzhgues konstatojnë që parimi humanitar i paanshmërisë gjatë krizës ishte komprometuar.¹⁹

Kufiri ndërmjet aspektit ushtarak dhe të atij humanitar është gjithnjë e më i vështirë për t'u përcaktuar, dhe atë në veçanti në operacionet humanitare. Forcat ushtarake janë duke u anagazhuar gjithnjë e më shumë në operacionet e ndihmave pas fatkeqësive natyrore apo pas konflikteve politike. Aftësia e tyre për të ofruar siguri si dhe ndihmë logjistike, shpesh herë i nxit partnerët ushtarakë që t'i mirëpresin partnerët e tjerë të rëndësishëm së bashku me organizatat humanitare. Që nga fillimi i viteve '90, nocioni i roleve të ndërsjella ka pësuar ndryshime. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), për shembull, kërkon që rregullat e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të zbatohen nga palët në konflikt, apo në luftë, dhe që të bëhen angazhime për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të konfliktit të armatosur.²⁰ Deri më 1988, lidhja e ICRC-së me forcat e armatosura bëhej vetëm përmes veprimeve individuale. Mëpastaj, ICRC-ja e filloi bashkëpunimin me aleanca shtetesh dhe me organizata rajonale. Gjatë konfliktit në Bosnje e Hercegovinë, ICRC-ja pati bashkëpunim më të ngushtë me NATO-n, duke shpresuar se do ta zvogëlonte rrezikun që i kanosej si popullatës civile, ashtu edhe personelit të ICRC-së, dhe se do ta arrinte një siguri më të madhe nga bombardimet nga ajri. Marrëveshja Paqësore e Dejtonit e përcaktoi qartë rolin e secilës organizatë, dhe i ka qartësuar raportet si dhe koordinimin e aktiviteteve të tyre.

ICRC-ja angazhohet për përfshirjen e çështjeve humanitare në planet e NATO-s për ushtrimet dhe aftësimet ushtarake. NATO-ja është e interesuar për bashkëpunim, për shkak të natyrës së re të misionëve ushtarake dhe humanitare, e që nënkupton më shumë rrezik për civilët, përfshirje më të madhe të ushtrisë në paqeruajtje, por edhe më shumë mundësi të veprimit për vetë forcën ushtarake. Organizatat humanitare duhet t'i kenë të qarta implikimet strategjike të refugjatëve dhe të ndihmave, të cilat, që të dyjat, kanë shërbyer si objekt i manipulimeve të shumta dhe janë përdorur si mjet lufte.

Ajo që kërkohet janë definimet më të sakta të detyrave të secilës palë në kuadrin e kornizës e cila e përcakton natyrën e ndërvarshmërisë ndërmjet tyre. Mercieri e përshkruan përvojën kryesore të punëtorëve humanitarë në Bosnjë si frustrim. "Pothuaj

katër vjet luftime në ish-Jugosllavi, e dëshmuar se sa fatal është ngatërimi i detyrave të politikanëve, ushtarëve dhe punëtorëve humanitarë. Bashkimi i këtyre komponenteve nuk shpie në epokën e artë të krijimit të paqes, dhe nuk jep mbështetje për bindjen se do të mund të nënçmoheshin vështirësitë në strukturë, funksion dhe në sjelljen e forcave pjesëmarrëse.”²¹

Kur kontigjentet ushtarake njëkohësisht merren edhe me rolet humanitare edhe me ato të luftës, paanshmëria dhe universaliteti i ndihmës humanitare vihen në rrezik. Udhëheqësit politik shpesh herë përpiqen të sigurojnë përkrahje - ose mbulesë - për ndonjë veprim të planifikuar ushtarak pikërisht nga organizatat humanitare. Para bombardimeve të NATO-s, Presidenti Clinton i mbledhi udhëheqësit e OJQ-ve amerikane që ishin aktive në Kosovë. Shumë nga pjesëmarrësit e kuptuan që plani i tij ishte që grupet humanitare të bashkëvepronin në kuadër të planeve ushtarake të administratës. Mbulesa humanitare mund ta bëjë operacionin ushtarak më të lehtë, ndërkohë që angazhimi ushtarak mund t'i shumëfishojë mjetet në dispozicion për nevojat humanitare, mirëpo, gjatë këtij procesi çështja e paanshmërisë mund ta pësojë fare lehtë.²² Veprimtaria humanitare pëson fragmentarizim dhe dobësim, kur faktorët ushtarakë fillojnë t'i trajtojnë zyrtarët humanitar si zbatues teknik të urdhrave, dhe jo si ekspertë me autoritet të cilët mund ta japin një kontribut të çmueshëm për zgjidhjen politike.²³ Qartësimi i linjave të komunikimit dhe të përgjegjësisë ndërmjet organizatave humanitare e ushtarake gjatë kohëzgjatjes së krizave, është me rëndësi të madhe për ofrimin e një ndihme efikase dhe për mbrojtjen e popullatës civile. Koordinimi mund dhe duhet të bëhet nëse ky është më rëndësi vitale për mbrojtjen e popullatës civile, por dallimet ndërmjet ushtrisë dhe të misioneve humanitare duhen kuptuar, dhe pavarësia e secilës palë duhet respektuar.

Në fillim të bombardimeve, NATO-ja ishte më e përgatitur për t'u marrë me krizën e refugjatëve, e cila u paraqit përnjëherësh. UNHCR-ja dhe grupet private humanitare, plotësisht me të drejtë, në plan të parë e vunë shpëtimin e jetëve të njerëzve dhe bashkëpunuan me NATO-n për t'u ofruar ndihmë refugjatëve. Mirëpo, gjatë kësaj, u shfaqën tri vështirësi specifike:

E para, inkuadrimi i hershëm dhe komandues i NATO-s i mundësoi ushtrisë që të vendoste lidhur me llojet e angazhimeve për ndihma, si dhe destinimin e këtyre ndihmave. Kjo e shkaktoi lënien anash të dijes dhe të përvojës së UNHCR-së. Një zyrtar i UNHCR-së jozyrtarisht deklaroi që, “NATO-ja jo vetëm që po i ndërton kampet dhe po e garanton sigurinë e tyre, por, po ashtu, po e përcakton edhe agjendën humanitare.”²⁴ Roli i NATO-s, edhe si donator edhe si palë ndërluftuese, i vinte grupet

humanitare në një pozitë vërtet të vështirë. Rregullat ndërkombëtare kërkojnë që OJQ-të të mbajnë distancë nga palët ndërluftuese, me qëllim të shmangies së çfarëdo mundësie për zgjatjen e konfliktit, ose të shndërrimit në mjet të palëve në konflikt. Me involvimin e NATO-s, paanshmëria e anagazhimeve humanitare, në fakt, u komprometua. Dallimi ndërmjet detyrave ushtarake dhe humanitare nuk mund të ekzistojë, po qe se masat e sigurisë përreth kampeve të refugjatëve përdoren për luftë kundër Serbisë.

E dyta, e që mbase është edhe më shqetësuese, popullata civile në anën serbe përballej njëkohësisht edhe me rrezikun real, dhe edhe me atë të imagjinuar, duke mos e marrë ndihmën humanitare që e meritonte. Ndërkohë që refugjatët në Shqipëri dhe në Maqedoni kishin madje edhe video-klube dhe, mbase, kujdes shëndetësor të një niveli edhe më të lartë sesa vetë qytetarët e Shqipërisë e të Maqedonisë, Bashkësia Ndërkombëtare nuk kishte mundësi të ofronte ndihmë humanitare për serbët e Kosovës. Njëanshmëria njëkohësisht ishte edhe porosi simbolike e edhe fakt.

Dhe e treta, marrëveshjet bilaterale ndërmjet qeverisë shqiptare dhe kontigjentëve ushtarake të vendeve të NATO-s e bënin përcaktimin e operacioneve duke e lënë UNHCR-në pa informata dhe pa komunikim. Kjo ndërhyrje vazhdoi edhe përmes angazhimeve të OJQ-ve për punë me civilët që kishin pësuar dëme nga bombardimet, si dhe me popullatën minoritare brenda në Kosovë, pas përfundimit të luftës së armatosur. Kontigjentet ushtarake kombëtare, e dëshironin përfshirjen e organizatave të tyre humanitare, në vend që ta konsideronin UNHCR-në si organizatë kryesore.

Forcat ushtarake gjithnjë e më shumë do të involvohen në misionet humanitare, operacionet paqëruajtëse, e madje edhe në shpërndarjen e ndihmave humanitare. Prandaj, këto raporte problematike ndërmjet organizatave humanitare dhe faktorëve ushtarak duhet të rivendosen në baza të reja. Procesi planifikues i NATO-s kërkon që organizatat civile ta kenë rolin drejtues në të gjitha operacionet humanitare.²⁵ Sidoqoftë, çështjet e planifikimit dhe ato të fondeve ushtarake mund të përsëritën sërish në situatat siç ishte kjo e Kosovës, ku UNHCR-ja dhe grupet private humanitare ishin më pak të përgatitura sesa ushtria për t'u ballafaquar me krizën humanitare. Mundësia që ushtria të shihet si përkrahëse nga grupet luftarake lokale, e rrezikon partneritetin e ndihmës humanitare, madje edhe nëse ushtria vetë nuk është palë ndërluftuese. Problemi merr përmasa edhe më të mëdha, nëse angazhimi ushtarak ndërkombëtar nuk e ka pëlqimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ashtu siç në rastin e Kosovës edhe ndodhi.²⁶

Në këtë mënyrë, organizatat humanitare janë duke u përballur me sfida të reja në për-

caktimin e rolit të tyre, dhe të raportit me forcat ushtarake dhe me qeveritë. Duhet gjetur mekanizma të institucionalizuar për bashkëpunim, ashtu që të shmangët përsëritja e situatave si kjo në Kosovë ku “nusja e dhëndrri u njohën në kishë.”²⁷ Përcaktimi i rolit dhe i bashkëpunimit më adekuat e nënkupton ndërtimin e bindjes thelbësore për domosdonë për më shumë komunikim, për krijimin e protokoleve për atë lloj informatash që mund të shkëmbëhen pa i rrezikuar specifikat e misionit të cilësdo palë dhe për shtimin e respektit për përvojat e organizatave humanitare në aktivitetet me të cilat kanë filluar të merren edhe faktorët ushtarak.²⁸ Kjo kërkon më shumë ushtrime dhe planifikime të përbashkëta, si dhe përkrahje në nivelet më të larta politike për një bashkëpunim më të madh ndërmjet ushtrive dhe grupeve humanitare për koordinim në dhënien e ndihmës. Grupet humanitare, logjikisht, janë të kujdesshme lidhur me mungesën momentale të ekuilibrit të forcave në marrëdhëniet e bashkëpunimit me një institucion çfarë është NATO-ja. Ky kujdes sforcohet edhe më tepër nga mungesa e vullnetit të institucioneve ushtarake për të hyrë në bisedime e kompromise me partnerë civilë. Mirëpo, kjo gjendje nuk mund të tejkalohet duke mbetur “i pastër” dhe jashtë lakut, dhe për pasojë, si në rastin e Kosovës, mund të bëhet tepër vonë për ta luajtur rolin qendror lidhur me ofrimin e ndihmave. Aftësimi reciprok dhe sesionet e trajnimit gjatë kohës së paqes, kanë rëndësi jetike për një koordinim më efikas gjatë kohës së krizave.

Përmirësimi i reagimeve pas krizës

Boshllëku i cili u shfaq pas luftës në qeverisjen civile, e i cili i përfshinte mungesën e policisë së zakonshme, të sistemit gjyqësor dhe të sistemit administrativ, ishte kërcënim për sigurinë dhe për tranzicionin drejt paqes. Duket se si organizatat humanitare, ashtu edhe ato për të drejtat e njeriut, në të ardhmen do të duhen të ballafaqohen pikërisht me kësi rrethanash të rivendosjes së refugjatëve, para se të formohet qeveria vendore dhe para se të arrihet siguria e nevojshme. Krahas ndihmës së forcave paqëruajtëse dhe punës për mbushjen e boshllëkut në infrastrukturën themelore, OJQ-të mund ta luajnë një rol të rëndësishëm duke e informuar Bashkësinë Ndërkombëtare lidhur me kushtet e vështira, dhe duke ndihmuar në sigurimin e vullnetit të mjaftueshëm politik dhe të mjeteve për afirmimin e zhvillimit të shoqërisë civile dhe të administratës civile.

Organizatave ndërkombëtare duhet të përgatitën me mirë dhe më herët në planet e tyre për menaxhimin e situatave në periudhat pas konflikteve. Kjo kërkon komunikim ndërmjet vetë organizatave, pjesëmarrje nga ana e refugjatëve dhe bashkëpunim me

aktorët lokalë, ashtu që rivendosja dhe projektet e rindërtimit të realizohen sa më shpejtë. Ajo se cila nga organizatat do ta ketë rolin kryesor në koordinimin e ndihmave dhe të mbrojtjes, duhet të caktohet para kthimit të refugjatëve.

Një përqendrim i ndihmës ndërkombëtare i cili do të ishte shumë i dobishëm, do të ishte përqendrimi në arsimin e lartë në Kosovë dhe për kosovarët. Përpjekjet për një bashkëpunim më të gjerë ndërmjet universiteteve të vendeve të tjera dhe të këtyre që janë duke u rindërtuar në Kosovë, si dhe mundësimi i studimeve jashtë Kosovës për të rinjtë kosovarë - qoftë në rajon, apo edhe në vendet e tjera të botës - do ta jipnin një ndihmë të madhe për një udhëheqje më efikase dhe për një shoqëri civile më të fuqishme në të ardhmen. Po ashtu, programet për të rinj - dhe në veçanti për ata që janë të gatshëm për bashkëjetëse me grupet e tjera etnike - meritojnë përkrahje ndërkombëtare.

Kur ekziston një numër i madh i personave të zhvendosur jashtë shtetpive të tyre, grupet humanitare duhet të presin dhe të përgatiten për rrezikun e mundshëm të fluksit të madh të refugjatëve.

Vëmendja e lartë ndërkombëtare për Kosovën e bëri të mundur një nivel të jashtëzakonshëm të ndërhyrjes humanitare, edhe pse buxhetet botërore për ndihma ishin në rënie e sipër. Si rezultat, ndonëse kjo ndërhyrje ishte e admirueshme në shumë aspekte, angazhimi për paanshmëri dhe ndihmë universale humanitare, u rrezikua në aspekte të shumta, dhe atë si në trajtë ashtu edhe në përmbajtje.

UNHCR-ja nuk ishte në gjendje që t'i mbikëqyrte në mënyrë adekuate organizatat për dhënien e ndihmave, t'i koordinonte veprimet humanitare, dhe ta garantonte paanshmërinë gjatë shpërndarjes, pjesërisht për shkak se u gjet e papërgatitur për t'u ballafaquar me krizën e shfaqur përnjëherësh, e pjesërisht edhe për shkak të angazhimit të ushtrisë, i cili e shkaktoi atë që shumë qeveri bënë marrëveshje bilaterale me OJQ-të.

Për të mundësuar edhe më shumë veprime të paanshme në krizat humanitare, për ta afirmuar përgatitjen dhe koordinimin dhe për të marrë pjesë në zvogëlimin e shpërdorimeve, shtetet donatore nga Bashkësia Ndërkombëtare duhet të ofrojnë më shumë fonde për UNHCR-në, dhe ta ndihmojnë realizimin e rolit koordinues e planifikues të saj.

Mbrojtja e personave të zhvendosur brendapërbrenda meriton të jetë prioritet i lartë, krahas me angazhimin rreth ndihmave. Me qëllim të ofrimit të ndihmës azilkërkuesve të shumtë në rastet e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, organizatat humanitare

duhet ta vendosin një bashkëpunim të ngushtë me vendet donatore.

Po ashtu, OKB-ja dhe grupet e të drejtave të njeriut duhet të angazhohen për lirimin e shqiptarëve kosovarë të cilët janë duke u mbajtur nëpër burgjet serbe, si dhe për identifikimin e personave të zhdukur.

Para se të vijë deri te kthimi i refugjatëve, duhet caktuar dhe autorizuar një organizatë e cila do të jetë kryesorja në koordinimin e ndihmës dhe të mbrojtjes. Pas rivendosjes së refugjatëve, UNHCR-ja dhe organizatat humanitare private duhen ta vazhdojnë punën e mëtutjeshme për afirmimin e bashkëjetesës, si dhe për ta ndihmuar rindërtimin e shoqërisë civile.

KS i OKB-së duhet ta kërkojë lirimin e të burgosurve shqiptarë të Kosovës në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare.

Organizatat ndërkombëtare duhen të ndërmarrin me kohë planifikime më të mira për t'i menaxhuar zhvillimet në periudhën pas konfliktit. Kjo e nënkupton komunikimin ndërmjet organizatave, pjesëmarrjen e refugjatëve, si dhe bashkëpunimin me faktorët lokal për realizimin e rivendosjes dhe të projekteve të rindërtimit.

Në kuadër të përpjekjeve për rindërtimin e shoqërisë, arsimit të lartë dhe programeve për të rinj duhet t'u jipet prioritet.

Organizatat humanitare dhe organizatat ushtarake duhet ta definojnë më qartë, si rolin e tyre, ashtu edhe detyrat në reagimet gjatë krizave humanitare, dhe këto, po ashtu, gjatë kohës së paqes duhet të punojnë për krijimin e besimit thelbësor i cili e forcon komunikimin, këmbimin e informatave dhe respektimin reciprok.

Organizatat e të drejtave të njeriut, sa herë që kjo të jetë e mundur, duhet të bashkëpunojnë në grumbullimin e të dhënave dhe në ndihmën e aktiviteteve hetuese të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe për gjykatat e tjera, dhe atë si për t'i mbrojtur provat dhe dëshmitarët, ashtu edhe për mundësimin e mbledhjes të të dhënave të besueshme. Organizatat e të drejtave të njeriut, organizatat humanitare, dhe ICTY-ja, duhet të bashkëpunojnë për ta gjetur rrugën e përdorimit të një metodologjie transparente dhe, sa herë që kjo të jetë e mundur, për ta koordinuar grumbullimin e të dhënave.

OKB-ja dhe grupet humanitare, po ashtu, duhet ta mbrojnë personelin lokal, në rastet e dëbimit nga vendet e konfliktit.

Roli i mediave

Para se lufta e cila shpërtheu ta arrinte shkallën e plotë të dhunës së vet, vëmendja e medias ndërkombëtare mungonte. Konfliktet që kanë filluar të nxehen janë shumë më pak “lajm” sesa ato të cilat janë duke vluar, kështu që e tërë vëmendja ishte përqendruar në Bosnje e Hercegovinë. Mediat kryesore ishin të prirura që në ish-Jugosllavi t’i mbanin vetëm disa korrespondentë, dhe nuk e bënë as edhe një hap të vetëm përtej Bosnjes dhe Kroacisë, apo për ta dërguar dikend që do ta vizitonte Kosovën. Kjo ishte gjendja para fillimit të vitit 1999, kur mediat Perëndimore filluan t’i shtojnë raportet lidhur me keqtrajtimet ndaj qytetarëve të Kosovës. Madje, edhe vetë masakra e Reçakut zuri pak vend, e shoqëruar me fare pak kontekst historik.

NATO-ja dhe mediat

Një çështje me rëndësi të veçantë është përmasa deri në të cilën media Perëndimore shërbeu si mjet i luftës gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s. Ruajtja e përkrahjes së opinionit publik për fushatën e kishte një rëndësi jetike. Udhëheqësit e NATO-s e kishin të qartë që mediat e tyre si dhe fushata e tyre në marrëdhëniet me opinionin publik nuk ishin në nivel të duhur për angazhimin të cilin e kishin ndërmarrë. Veprimet e zëdhënësit për shtyp ishin fare të vogla, një zhagjitje ndërmjet të disa “incidenteve me dëme anësore” në vendin e operacioneve, ndërkaq, informatat publike nga selia në Bruksel ishin shumë të gjata. Mbi të gjithat, regjimi serb deri në një masë ia arriti që ta kishte një farë suksesi në fushatën e tij informative, dhe në veçanti pas rrëzimit të një aeroplani amerikan gjatë javës së parë të luftës. Përpjekja e regjimit serb për ta paraqitur veten si viktimë të një agresioni të cilin ai vetë nuk e nxiti, dhe si një luftë të Davidit kundër Goliatit, kishte filluar të jpte rezultate, posaçërisht në vendet anëtare të NATO-s në të cilat lufta asnjëherë nuk e kishte ndonjë përkrahje të fuqishme, çfarë ishin për shembull Greqia e Turqia. Të vetëdijshëm që opinionin publik mund të heqë dorë nga mbështetja dhe të deklarohet kundër bombardimeve pas javës së parë të fushatës, udhëheqësit e NATO-s e vendosën që t’i rrisin me të madhe fondet dhe personelin në shërbim të NATO-s, ashtu që t’i formësonin veprimet e shtypit dhe që ta ndërmerrnin një kundërofensivë të pandërprerë informative kundër asaj e cila u quajt “propagandë” serbe. Vëmendja e jashtëzakonshme e cila iu kushtua luftës informative shkaktoi që disa komentatorë të konstatojnë – thënë me fjalët e dokumentarit televiziv të BBC-së lidhur me këtë çështje – se “lufta u fitua duke u bërë tërkuzë.” Çështja kryesore është se a i lejoi vetvetes media Përendimore – e cila supo-

zohet se është e pavarur dhe e paanshme – që me vullnet të bëhet pjesë e betejës informative të NATO-s? Mëpastaj, a iu kushtua kujdesi i duhur verifikimit të pavarur të pohimeve të NATO-s? Dhe, po ashtu, a ishte e lejueshme që përkrahja morale e saj, për shkak të fatkeqësisë së refugjatëve gjatë kalimit të tyre nëpër kufijt ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë e të Shqipërisë, të ishte më pak kritike se sa qëndrimi dhe taktika e operacioneve ushtarake të NATO-s.

Lidhur me këtë, shtrohet edhe çështja nëse zëdhënësit e NATO-s, qoftë me apo pa qëllim, e kishin mashtruar shtypin dhe elektoratin e NATO-s lidhur me fushatën ajrore. Siç duket, janë dhënë deklarata të ekzagjeruara lidhur me saktësinë e fushatës së bombardimeve.²⁹ Statistikat e mëvonshme ushtarake lidhur me përmasat e saktësisë së fushatës së bombardimeve, e dëshmojnë që shtypi dhe publiku perëndimor janë bindur që bombardimet kanë qenë edhe më “kirurgjike” dhe edhe më të sakta, sesa që në realitet ishin. Përpos kësaj, në bazë të studimeve që NATO-ja i bëri pas luftës, u dëshmuua që vlerësimet e efekteve të goditjeve mbi forcat tokësore jugosllave dhe të dëmeve të shkaktuara nga bombardimet kanë qenë jo të sakta. Nga ajri ishin shkatërruar shumë më pak tanke, armë artilerike, si dhe sisteme të tjera të armëve ofansive e defansive, sesa që NATO-ja e kishte deklaruar fillimisht.³⁰

Komisioni nuk ka mundësi ta dijë nëse këto shtrebrime janë bërë me apo pa qëllim, d.m.th. nëse zëdhënësit e NATO-s i ekzagjeronin pohimet lidhur me saktësinë dhe pasojat, duke e ditur që ato nuk ishin të vërteta. Lufta zhvillohet në mjegull, dhe nganjëherë është në pajtim me atë të cilën e dijme lidhur me mënyrën e veprimit, që zëdhënësit e NATO-s janë angazhuar me dëshirë që deklaratat publike t’i japin me sa më shumë saktësi. Natyrisht që zëdhënësit e NATO-s gjatë fushatës kanë ngulmuar që ata nuk janë angazhuar në ndonjë propagandë të vetëdijshme, dhe se janë përpjekur që të vërtetën e plotë ta shpalosin me kohë. Ky ishte si angazhim moral, ashtu edhe i kujdesëm, d.m.th. ata e besonin që ishin duke e thënë të vërtetën, dhe se kanë qenë të vetëdijshëm se nëse nuk është kështu, atëherë e vërteta do të kuptohej gjithsesi, dhe atë para së gjithash për shkak se mediat Perëndimore kishin qasje edhe në burimet e informimit të palës kundërshtare, kryesisht në Beograd. Megjithëkëtë, periudha e pasluftës e tregoi qartë që madje edhe nëse shtrebrimi i së vërtetës është bërë pa dashje, ky e ka lënë një hije të keqe, duke i shtuar ex post facto, dyshimet lidhur me legjitimitetin e veprimeve të NATO-s me media.

Komisioni konkludon që në çdo fushatë të informimit publik lidhur me intervenimin e vetëshpallur humanitar, forcat ushtarake dhe zëdhënësit e tyre e kanë për obligim, edhe më tepër sesa në rastet e operacioneve ushtarake normale, që ta thonë të

vërtetën e plotë për të gjitha faktet të cilat opinioni publik ka të drejtë t'i dijë, dhe se vetëm domosdoshmëria strikt ushtarake mund ta justifikojë ndonjë fshehje apo shtrembërim të informatave për opinionin publik lidhur me operacionet ushtarake. Në të njëjtën mënyrë siç e ka konstatuar që zhvillimi i operacioneve ushtarake gjatë ndërhyrjes humanitare duhet të bëhet sipas rregullave edhe më strikte të angazhimit sesa në operacionet normale ushtarake, Komisioni e konstaton që edhe veprimet e mediave duhet të bëhen sipas rregullave shumë më të rrepta të paraqitjes të së vërtetës së plotë. Arsyet për këtë janë të qarta: legjitimiteti i intervenimeve humanitare varet nga pëlqimi i përhershëm demokratik i elektoratit, i cili i ka zgjedhur udhëheqësit të cilët e kanë autorizuar intervenimin. Është në natyrën e këtyre çështjeve, që intervenimet humanitare janë kontraverze, meqë këto nuk kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare. Kështu që, duket që këto do t'u nënshtrohen debateve të rrepta në shoqëritë të cilat e kanë dhënë pëlqimin për to. Nëse publiku dhe mediat e kanë ndjenjën që kanë qenë të manipuluar, e madje edhe të gënjyer, atëherë pëlqimi dhe mbështetja për këto operacione do të zhduken shpejt.

Komisioni ka vlerësim të lartë për veprimet e NATO-s që kishin të bënin me shtypin sa i përket vetëdijes për rëndësinë specifike të opinionit publik, por bën thirrje që NATO-ja t'i analizojë veprimet e veta duke u nisur nga qëndrimi që pretendimi për saktësi dhe efekte mund të justifikohet gjithmonë vetëm me informatën më të mirë të mundur. Lufta është përcjellur gjithmonë me tendosje sa i përket objektivitetit dhe paanshmërisë së gazetarisë. Gazetarët varen nga luftëtarët sa i përket mundësisë së depërtimit në vendin ku zhvillohen luftimet, dhe kjo varshmëri mund ta rrisë mendjelehtësinë dhe ta dobësojë paanshmërinë gazetareske. Për më tepër, lufta ngjall emocione, dhe gazetarët, duke iu bashkëngjitur njëres palë, e humbin mundësinë për të bërë pyetje kritike që janë në interesin e opinionit publik. Asnjëra nga këto karakteristika nuk janë të reja. Fushata ajrore e Kosovës ishte jashtëzakonisht e vështirë për t'u përshkruar në mënyrë objektive: shumica dërrmuese e gazetarëve perëndimorë që informonin mbi luftën, ishin robër të njoftimeve ditore në selinë e NATO-s, dhe ishin pothuaj në tërësi të varur nga informatat të cilat ua jipte NATO-ja. Të paktë ishin gazetarët që e patën mundësinë e kontaktit me pilotët, dhe ata edhe më të paktë të cilët e patën rastin edhe të fluturojnë në këto misione, nuk mund të bënin asgjë më tepër përpos që t'i admironin shkathhtësitë dhe përkushtimet e ekuipazheve. Pothuaj asnjë gazetar perëndimor nuk ia arriti që të hynte në Kosovë, dhe ata të cilët arritën që ta siguronin këtë mundësi, gjatë tërë kohës ishin të përcjellur nga grupe të organizuara nga qeveria serbe. Një numër i vogël i gazetarëve nga The Los Angeles Times, The New York Times, si dhe disa reporterë të lirë të Jugosllavisë të cilët raportonin

për agjencitë e huaja, megjithatë ia arritën që të dërgonin raporte nga vendi i ngjarjes, madje edhe nga vetë Prishtina, gjatë dhe pas sulmeve të NATO-s, si dhe gjatë dhe pas dëbimeve masive të kosovarëve.

Megjithatë, akuza kryesore - ajo që gazetarët i kanë lejuar vetes, dhe rrjedhimisht edhe opinionit publik, që të ndikohen nga manipulimet mediale nga NATO-ja - duket se nuk qëndron. Është e vërtetë se në vendet anëtare të NATO-s ka pasur debate të rrepta publike lidhur me mënyrën e zhvillimit të luftës, dhe NATO-ja asnjëherë nuk ia arriti që të kalonte lehtë me opinionin publik lidhur me supozimin që lufta u fitua duke u bërë lëmsh. Përkundrazi, me shtimin e “incidenteve dhe të dëmeve anësore,” dhe me kalimin e 78 ditëve të luftës për të cilën ishte dhënë premtimi se do të ishte e shkurtër, fushata e rreptë u shndërrua në një luftë pikëpamjesh e cila zgjati 78 ditë, kështu që, edhe opinionin publik perëndimor u bë, nëse hiç më tepër, të paktën më kritik lidhur me mënyrën e zhvillimit të luftës.

NATO-ja asnjëherë nuk ia arriti që të dominonte në luftën propagandistike, dhe kjo ua bëri të mundur gazetarëve perëndimor dhe opinionit publik në përgjithësi, që ta formonin një pikëpamje të pavarur mbi veprimet e saj. Shkaku kryesor për këtë ishte ai që gazetarët perëndimor vazhdonin të ishin në Beograd gjatë kohës së luftës, kështu që, ndonëse raportet e tyre censuroheshin dhe vizitat e tyre në vendin e ngjarjes ishin shumë të kontrolluara, ata megjithatë ia arritën që të dërgonin raporte kritike për opinionin perëndimor, lidhur me atë se çfarë ishte arritur me bombardimin e këtij qyteti evropian. Kjo prani në “anën e armikut” është parakushti qenësor për mundësinë e mediave që opinionit publik t’ia bëjnë të njohur se si janë duke u zhvilluar operacionet ushtarake. Dhe vërtet, pa pa një qasje të këtillë, “intervenimi humanitar” do t’i shmangej përgjegjësisë para opinionit publik dhe mbikëqyrjes nga ana e tij. Komisioni beson fuqimisht që qasja e hapur te të dyja palët gjatë intervenimit humanitar, është e një rëndësie shumë të madhe po qe se dëshirohet që operacionet ushtarake të që të dy palëve ndërlofuese të jenë nën mbikëqyrjen publike.

RFJ dhe mediat

Beogradi ka bërë shkelje të vazhdueshme të të drejtës për shtyp të lirë. Mbështetja ndërkombëtare për media të pavarura, dhe në veçanti për radiostacione, ka qenë e një rëndësie të veçantë para, gjatë dhe pas luftës. Përmasat e ngulfatjes së mediave nga ana e Beogradit u intensifikuan edhe më tepër pas fillimit të bombardimeve.³¹ Në mars 1999, qeveria jugosllave e mbylli Kohën Ditore, e cila ishte gazeta kryesore dhe me më

së shumti ndikim në gjuhën shqipe në Kosovë (si dhe web-faqen e saj), dhe e cila më vonë, gjatë prillit, ia arriti të vazhdojë të botohet në Maqedoni. Shumica e mediave alternative brenda Serbisë e kishin bindjen se Kosova është “jona,” ose nuk përqendroheshin fare lidhur me çështjen e Kosovës.

Sidoqoftë, në kontekstin e vetë dhunës serbe, gazetarët e kanë mbajtur një qëndrim të mrekullueshëm. Në verën e vitit 1999, qeveria serbe e përqendroi dhunën drejtpërdrejt kundër gazetarëve, veprimtarëve dhe politikanëve serbë të pavarur, dhe megjithëkëtë disa gazetarë edhe më tutje vazhduan ta shprehnin kundërshtimin e tyre, madje edhe nga burgu. Me 25 mars, një ditë pas goditjeve të bombave të para të NATO-s, Serbia i dëboi jashtë saj të gjithë gazetarët nga vendet anëtare të NATO-s. Mëpastaj ajo i shfuqizoi dëbimet, mirëpo në të njëjtën kohë filloi të bënte arrestime dhe largime të disa gazetarëve të caktuar. Shumë reporterë i vizituan kampet e refugjatëve për të dërguar raporte nga atje. Disa të tjerë, si John Kifner nga The New York Times, me mjeshtri e bënë përshkrimin e masakrave përmes të dhënave që i grumbullonin nga refugjatët.³² Sam Kiley nga The (London) Times dërgonte raporte efektive nga Kukësi. Paul Watson nga The Los Angeles Times ishte gazetari i fundit veriamerikan i cili raportonte drejtpërdrejt nga Kosova lidhur me bombardimet, dhe ai i vazhdoi raportimet e veta, megjithë frustrimet që ushtria, e pranishme gjithkund përreth tij, nuk ofronte burime të besueshme të informimit.³³

Komisioni është i mendimit që në rastin e intervenimeve humanitare, gazetarët asnjëherë nuk bënë të pengohen në raportimin nga vendi i luftimeve. Komisioni i dënon fuqishëm përpjekjet e qeverisë serbe që të vinte kufizime në raportimet e mediave të veta që kishin të bënin me periudhën e luftës dhe me atë të pasluftës, dhe e dënon në veçanti rastin e burgosjes së Miroslav Filipoviçit, për intervistat e tij me ushtarët e RFJ-së që kishin marrë pjesë në operacionet në Kosovë, si dhe për botimin e pohimeve të tyre lidhur me shkatërrimet dhe krimet e luftës që i kishin bërë. Komisioni e vlerëson që kjo burgosje është shkelje e normave universale të lirisë së shtypit e cila nuk mund të justifikohet kurrsesi me ndonjë dosmodoshmëri ushtarake apo të sigurisë, dhe në veçanti për shkak të faktit që raportet e tij janë botuar pas përfundimit të luftimeve. Komisioni e kërkon lirimin e menjëhershëm dhe të pakusht të z. Filipoviçit.

Sulmet mbi media

Një çështje tjetër e cila gjatë luftës në Kosovë e kishte një rëndësi jetike lidhur me lir-

inë e shtypit, është ajo se a mund të justifikohen në kuadër të Konventave të Gjenevës sulmet në instalimet e mediave. Televizioni serb u godit në mëngjesin e hershëm të datës 16 prill. Studiot dhe zyrat u shkatërruan, ndërkaq 15 gazetarë dhe punëtorë të tjerë medial e humbën jetën. Për aq sa dihet, asnjëra nga viktimat, as nuk ka qenë në uniformë ose nën komandë të drejtpërdrejtë të ushtrisë, dhe as nuk ka qenë e lidhur me zhvillimin e operacioneve ushtarake në çfarëdo qoftë mënyre tjetër. Ndërkohë që qytetarët serbë u vunë në shënjestër të sulmit, shtetasit e huaj të cilët i transmetonin raportet e tyre nga këto objekte, ishin paralajmëruar me kohë që ta braktisin ndërtesën.

Duke dhënë shpjegime rreth këtij sulmi, NATO-ja e theksoi se nga këto objekte transmetoheshin sinjale ushtarake dhe se popullatës civile serbe i servohej propagandë luftarake. Komisioni nuk është në gjendje që ta përcaktojë të vërtetën rreth pjesës së parë të këtij deklarimi. Sa i përket të dytës, këtu shfaqet çështja kontraverze, sipas së cilës shtetet, të cilat me kushtetutën e tyre e kanë marrë përsipër angazhimin formal për ta garantuar lirinë e shtypit, janë të autorizuar që t'i godasin objektet e vendit kundër të cilit luftojnë, nëse e konstatojnë që përmbajtja e transmetimeve nga ato objekte është propagandistike. Një pikëmbështetje e tillë e mundëson justifikimin e operacioneve ushtarake sipas një vlerësimi subjektiv të propagandës e cila transmetohet. Komisioni konstaton që sulmet në transmetuesit medial në kuadrin e kontekstit të intervenimit humanitar, në aspektin politik janë të pamënçura, dhe njëkohësisht, në aspektin juridik janë të dyshimta. Politikisht janë të pamënçura sepse janë kundërtënëse, dhe e rrezikojnë legjitimitetin e perceptuar të operacioneve ushtarake. Ndërkaq, juridikisht janë të dyshimta sepse nuk godasin caqe strikt ushtarake, dhe përpjekja që atyre t'u mvishet një rëndësi e veçantë ushtarake, duke u mbështetur në përmbajtjen e transmetimeve të tyre, është tendencioze. Komisioni rekomandon që në çfarëdo qoftë operacioni ushtarak në të ardhmen, e i cili do të bëhet me emërtimin e intervenimit humanitar, sulmet e tilla ndaj instalimeve të mediave duhet të shmangen në tërësi.

Mediat dhe OJQ-të

Raportet e mediave perëndimore i kanë injoruar disa çështje praktike, çfarë ishte strehimi, për shembull, në mënyrë që të mund të përqendroheshin kryekëput në detaje të dhunës. Kjo çështje e parashtron pyetjen se deri në cilën masë shtypi i ka lexuar raportet e OJQ-ve apo ka marrë informata nga to dhe nga organizatat humanitare, se a kishte shkëmbim informatash fare, dhe se çfarë efektesh kishin këto informata, po

qe se shkëmbeheshin. Grupet humanitare dhe ato për të drejtat e njeriut, ia arritën të sigurojnë dhe t'i shpërndajnë informatat nga terreni, me anë të lidhjeve direkte telefonike dhe të qasjes në Internet.³⁴ E-mailat nga kontaktet e tyre, u ndihmuan OJQ-ve në gjetjen e gabimeve në raportet e telefonike.³⁵ Edhe përkundër krejt kësaj, ky mjet komunikimi kishte pak ndikim në pasqyrimin më të gjerë medial të ngjarjeve dhe të pikëpamjeve rreth konfliktit.

Gjatë luftës së armatosur, bashkëpunimi i mediave dhe i OJQ-ve e mundësoi përpilimin e raporteve më të detajuara lidhur me dhunën në Gjakovë, Drenicë, dhe gjetkë. Në prill 1999, R. Jeffrey Smith, William Drozdiak dhe të tjerë, filluan të dërgojnë raporte me të dhënat për veprimet serbe në terren pas dëbimeve masive të shqiptarëve të Kosovës.³⁶ Ndërkaq, kur bombat e NATO-s ranë mbi kolonën e refugjatëve në rrugën e Gjakovës, kjo e pati pati një ndikim shumë të madh në vëmendjen e opinionit publik ndërkombëtar. Edhe pas pesë ditësh ushtria nuk ia arriti të jpte informata bindëse, dhë në konferencën për shtyp, zëdhënësi i NATO-s e shprehi një keqardhje të thellë, dhe e pranoi përgjegjësinë për goditjen e gabueshme të kolonës.³⁷

Edhe më vonë, analizat e ofruara nga mediat për aspektet politike dhe të sigurisë të sulmeve ndaj serbëve të Kosovës nga ana e refugjatëve të kthyer, kanë qenë të pamjaftueshme. Deri më sot, në raportet e mediave mungojnë pothuaj në tërësi çështjet e personave të zhdukur dhe të robërve të luftës. Raportet e mediave lidhur me ICTY-në, fatkeqësisht, vetëm që i kanë kontribuar politizimit të aktiviteteve të saj. Vetë Tribunali e kishte humbur një rast të mirë për të përfituar nga interesimi i mediave rreth konfliktit në Kosovë. Ishte ky një rast shumë i përshtatshëm që, përmes medias, publikut t'i shpjegohej rëndësia e punës së Tribunalit, dhe nga ana tjetër, Tribunali do të duhej të bënte edhe më tepër angazhime për ta inkurajuar përqendrimin e raporteve të medias në rolin e normave dhe të institucioneve të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, si lidhur me vetë këtë konflikt, ashtu edhe lidhur me proceset që i paraprijnë punës së Tribunalit.

Çështja e mediave pas luftës

Pas 10 qershorit 1999, kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi angazhimin e Misionit Ndërkombëtar, mbizotëronte bindja që media mund ta ketë një ndikim pozitiv të madh në zhvillimin demokratik. Shtypi i lirë mund të jetë njëra nga shtyllat kryesore të shoqërisë civile dhe demokratike, ndërkaq, kontrolli i mediave nga ana e forcave shoveniste, shumë shpejt mund ta prish stabilitetin e brishtë të tranzicionit.

Nga ky aspekt, është e qartë që UNMIK-u kishte autorizim për të ushtruar kontroll mbi mediat. Megjithëkëtë, menaxhmentin e mediave i cili filloi të ushtrohej nga Misioni Ndërkombëtar, që nga fillimi e karakterizuan keqkuptimet dhe konfliktet e brendshme burokratike. Një debat në veçanti i ngatërruar është bërë rreth asaj se për sa kohë është i domosdoshëm kontrollimi i përkohshëm ndërkombëtar me mundësi të ndikimit edhe në përmbajtje, ashtu që të mund të garantohej arritja e qasjes dhe e standardeve të raportimit korrekt, dhe rreth asaj se a merr karakter censure ky ndikim në përmbajtje me qëllim të përmbushjes së standardeve. Administratori kryesor i OKB-së (PSSP), Dr. Bernard Kushner, dëshironte t'i kontrollonte mediat e shqiptarëve etnik, me qëllim të frenimit të dhunës, dhe ky edhe e mbylli përkohësisht një gazetë ditore, për shkak të nxitjes së hakmarrjes.³⁸

Plani sipas standardeve adekuate të OSBE-së, për tutelazh ndaj mediave vendore të Kosovës është kritikuar rreptësisht nga grupe të caktuara hulumtuese.³⁹ Në shkurt të vitit 2000, PSSP e miratoi një rregullore kundër shprehjes së urrejtjes, e cila parashihte dënime deri në dhjetë vjet burg. Kjo masë kundërthënëse paraqet rrezik për mundësi të manipulimeve politike mirëpo, në esencë, ky vendim nuk u zbatua asnjëherë. Përpjekjet për ta frymëzuar mënyrën e rregullimit të kësaj çështjeje nga vetë gazetarët, u penguan nga konfliktet ndërmjet të PSSP dhe OSBE-së, si dhe nga refuzimi i gazetarëve serbë për pjesëmarrje. Perceptimi i censurës është manifestuar në veçanti në dritën e represionit të vazhdueshëm serb, nga propaganda e pasluftës e ushtruar nga media e pavarur dhe nga media qeveritare.

Misioni Ndërkombëtar i krijoi, po ashtu, mediat e veta për transmetim, përmes radios së UNMIK-ut, Blue Sky, dhe radios së KFOR-it, Radio Galaksia. Kritikët pohojnë që ato u shmangeshin burimeve dhe gazetarëve vendas, duke shkaktuar kështu një pakënaqësi te ta (veçanërisht në Blue Sky). Megjithatë, këto përpjekje e kishin një rëndësi të madhe, sepse duhet theksuar që këto radio kanë krijuar programe kualitative, dhe mbase ambientet e vetme për dialog dhe shkëmbim ndëretnik të informatave (bazuar në Radio Galaksinë e KFOR-it).

Po ashtu, u propozua dhe u kontraktua paisja satelitore nga European Broadcast Union; ndërkaq, qeveria japoneze e mori përsipër që deri më 2001 ta bënte riparimin e sistemit të transmetimit tokësor. Pas situatave të dhunës masive, rindërtimit të medias duhet t'i jepet një rëndësi e madhe nga ana e qeverive ndërkombëtare dhe e OJQ-ve. Roli i donatorëve ndërkombëtarë ka qenë me rëndësi të veçantë në krijimin e medias së pavarur, mirëpo ka pasur edhe probleme serioze rreth koordinimit, për shkak të orientimit të shumë donatorëve që ta ndihmojnë të njëjtën media, ndërkohë

që të tjerat janë lënë anash. Angazhimi i përbashkët i Institutit për Shoqëri të Hapur dhe i OSBE-së ka ndikuar në përmirësimin e situatës, por ende ka vështirësi rreth sigurimit të informatave të sakta lidhur me shpërndarjen e donacioneve.

Cilësia afatgjate dhe e qëndrueshme e shtypit dhe e medias së lirë në Kosovë është e një rëndësie të madhe. Kjo e ka, po ashtu, edhe aktualitetin e momentit, për shkak të zgjedhjeve të ardhshme. Qendra e re e Mediave, në mes të Prishtinës, iu ofron gazetarëve vendorë qasje në Internet dhe në informata. E sponsoruar nga IWPR dhe IPKO-ja (provajder Interneti), si dhe me mbështetje nga Fondacioni Ford, projekti është i hapur si për gazetarët shqiptarë, ashtu edhe për ata serbë. Gazetarët e Kosovës po ashtu e japin kontributin e tyre edhe në web-faqen e Raportit Ballkanik të Krizës, i cili realizohet nga Instituti për Raportimin e Luftës dhe të Paqes (IWPR).⁴⁰

8. Kosova: Dimensioni rajonal

Në Ballkan sapo ka marrë fund lufta dhjetëvjeçare e cila e shkaktoi vdekjen e një çerek miloni njerëzish dhe arratisjen e miliona refugjatëve. Ndër viktimat kryesore, megjithatë, ishin idetë për shoqëri civile dhe për bashkëpunim rajonal. Në fakt, ky mund të jetë momenti më i përshtatshëm për t'i analizuar pengesat e së kaluarës, dhe për t'i parashtruar mundësitë e zhvillimit të një bashkëpunimi rajonal, i cili, në planin afatgjatë, mbetet parakushti më i domosdoshëm për paqe dhe stabilitet në Evropën Juglindore. Siç ky kapitull do ta dëshmojë, Bashkimi Evropian (EU) e ka rolin kryesor për realizimin e tranzicionit nga faza e intervenimit në atë të integritimit.

Luftrat e Jugosllavisë e kanë tronditur të tërë rajonin e Ballkanit.¹ Ashtu siç lufta në Kosovë nuk mund të kuptohet e izoluar nga konteksti më i gjerë rajonal, ashtu edhe suksesi apo dështimi i rimëkëmbjes së pasluftës, varet nga aftësia e aktorëve lokal si dhe e Bashkësisë Ndërkombëtare për krijimin e një qasje koherente rajonale. Peisazhi i pasluftës është shumë i larmishëm. Ka zhvillime inkurajuese në mesin e veriorëve - në Kroaci pas Tugimanit, dhe në Bosnje pas zgjedhjeve lokale të prillit 2000. Por është edhe një përkeqësim i vazhdueshëm në pjesën e mbetur të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) dhe një mozaik i turbullt sa i përket fqinjëve të Kosovës (Shqipëria dhe Maqedonia).

Një vit pas intervenimit të NATO-s, Ballkani është në udhëkryq. Mundësia e konfliktit është ende e pranishme, ndonëse në përmasa më të kufizuara. Mirëpo, në Evropën Juglindore të paskonfliktit ekziston po ashtu edhe mundësia për ta krijuar një zonë të stabilitetit dhe të bashkëpunimit rajonal. Mundësia e dytë e kërkon një involvim të konsiderueshëm ndërkombëtar i cili do ta garantonte dhe stimulonte sigurinë, si dhe do ta nxiste krijimin e kornizës për rimëkëmbjen ekonomike dhe ndryshimet demokratike. Shkalla e involvimit ndërkombëtar më 1999, si dhe bashkëpunimi i qeverive të rajonit gjatë intervenimit, i ka shtuar shpresat në Evropën Juglindore për përkrahjen e Perëndimit. Mirëpo, deri më sot, këto shpresa ende nuk janë përm-bushur.

Gjatë analizës së dy karakteristikave kryesore të politikës ballkanike - ashpërsisë së nacionalizmit dhe pafuqisë së demokracisë dhe të shoqërisë civile - duhet patur parasysh edhe trashëgiminë duale të Perandorisë Otomane dhe të asaj Habsburge, nga

njëra anë, dhe atë të sistemit komunist, nga ana tjetër. Që të dyja këto janë pasqyrim i dështimeve të së kaluarës në përvetësimin e integritimeve mbikombëtare. Trashëgimia pas-perandorake është ende e pranishme, dhe atë deri në atë masë sa që procesi i ndërtimit të kombit-shtet dhe i rikrijimit të kufijve shtetërorë kurrsesi nuk mund të merret si i përfunduar. Trashëgimia post-komuniste është e pranishme në trajtë të alternativave demokratike fare të dobëta përballë nacionalizmit. Që të dyja këto trashëgimi llogarisin - të paktën pjesërisht - në shembjen e tranzicionit demokratik përmes agjendave nacionaliste dhe regjimeve autoritare.

Luftërat e ish-Jugosllavisë i përmbajnë në vete pasojat e mospërfundimit të ndërtimit të kombeve-shtete në periudhën pas vitit 1918, si dhe rolin që elita politike komuniste e luajti përmes shpërdorimit të tendosjeve nacionaliste me qëllim të përjetësimit të pozitës së tyre në pushtet. Gjatë intervenimit në Kosovë, Bashkësia Ndërkombëtare dhe shtetet e rajonit synonin që të merreshin me çështjen e dytë - d.m.th me Millosheviqin - ndërkohë që shqiptarët e Kosovës ishin të interesuar për çështjen e parë - d.m.th. për korrigjimin e kufijve të caktuar më 1912 nga Konferenca e Londrës. Millosheviqi nuk donte të merrej me asnjërën prej këtyre.

Dimensionet rajonale të konfliktit në Kosovë

Shqetësimet për stabilitetin në Ballkan e kanë paraqitur njërin nga motivet më të rëndësishme për intervenimin e NATO-s. Sikurse edhe me rastin e intervenimit në Bosnje, më 1995, intervenimi në Kosovë ia arriti ta shmangte përhapjen e konfliktit në vendet fqinje. Megjithëkëtë, pasojat e drejtpërdrejta të konfliktit e dëshmuuan se në disa prej tyre u shkaktua një destabilizim përmasash të mëdha. Ky destabilizim, deri te i cili erdhi pjesërisht edhe për shkak të strategjisë së zbatuar nga Millosheviqi, mund të përshkruhet në trajtën e tre rrahëve koncentrik:

Grimcimi i pjesës së mbetur nga Jugosllavia (Serbia, Mali i Zi, Vojvodina);

Destabilizimi i drejtpërdrejtë i fqinjëve të parë të Kosovës (Maqedonia, Shqipëria);

Pasqyrimi negativ i konfliktit te aktorët e tjerë të ndërlidhur të rajonit (Bullgaria, Rumania, Greqia, etj).

Lufrat e dhjetëvjetëshit të fundit në Jugosllavi ishin të përqendruara në dy epiqendrat kryesore të konfliktit në Ballkan: konflikti “verior” rreth Bosnjes, i cili i përfshiu Kroacinë dhe Serbinë; dhe konflikti “jugor” në Kosovë, i cili i përfshiu Serbinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë, dhe, po ashtu, në mënyrë të tërthortë, edhe Bullgarinë

dhe Greqinë. Ndonëse ka ekzistuar një shkallë e ulët e ndërvarësisë së drejtpërdrejtë ndërmjet këtyre dy epiqendrave të konfliktit, Serbia e Millosheviqit e paraqiste emëruesin e përbashkët. Zgjidhjet e propozuara apo të imponuara në njërin nga këto epiqendra, e kishin ndikimin e vet në zgjidhjet që do të mund të priteshin në epiqendrën tjetër. Roli stabilizues i Dejtonit për Bosnjën dhe për raportet Serbi - Kroaci, e pati ndikimin destabilizues në Kosovë, sepse ky rast menjëherë u interpretua si një shembull precedent. Për çfarë arsye do të duhej që shqiptarët e Kosovës të pajtoheshin me më pak sesa që u ishte dhënë serbëve të mposhtur të Bosnjës? Nëse Dejtoni e kishte krijuar një shtet të ardhshëm që do të përbëhej nga dy entitete me institucione të ndara, dhe me të drejtën për të mbajtur “marrëdhënie speciale” me shtetin fqinj, nuk kishte se si të pritej që kosovarët do të pajtoheshin me një apartheid faktik, të cilin ua kishte imponuar Millosheviqi me heqjen e autonomisë së tyre më 1989.

Debatet dhe përgjigjet e të së ardhmes lidhur me statusin final të Kosovës, do të kenë pasoja të rëndësishme për fqinjët e saj (në veçanti për Maqedoninë dhe Shqipërinë), dhe mund të trajtohen, po ashtu, edhe si precedent i cili do të mund të përdorej gjatë zgjidhjes së problemit të Bosnjës. Argumenti më i përhapur lidhur me të ashtuquajturën “epidemi rajonale” në Ballkan, shërbehet në thelb me “domino-teorinë”: Po qe se Kosova bëhet e pavarur, atëherë Maqedonia mund të shpërthejë përbrenda. Shqiptarët e atjeshëm do të mund të kërkojnë ose që t’i bashkangjiten shtetit të ri të Kosovës, ose, hiç më pak sesa “federalizimin” e Maqedonisë – ide kjo e cila kundërshtohet energjikisht nga shumica sllave maqedonase. Po qe se Maqedonia shpërthen, atëherë nuk ka gjasa që Serbia, Bullgaria dhe, madje, mbase edhe vetë Greqia të rrinë duarkryq. Dimension i dytë i “domino-teorisë” është ai që Kosova e pavarur do të mund të konsiderohej si një precedent juridik: Po qe se Kosova mund të ndahet nga Jugosllavia, pse atëherë Republika Serbe të mos mund të ndahet nga Bosnja e Hercegovina. Në këtë mënyrë, “domino-efekti” e sforcon procesin e “ballkanizimit,” d.m.th. grimcimin, i cili është pikërisht ai që e dëmton të tërë rajonin. Në të njëjtën kohë që teza e “epidemisë së rajonit” është përdorur me të madhe për ta arsyetuar paralizimin e zgjidhjes së çështjes së statusit final të Kosovës gjatë pjesës më të madhe të viteve ‘90, është përdorur, po ashtu, edhe teza e stabilitetit rajonal, si një pikëmbështetje për vendimin për intervenim, në pranverën e vitit 1999. Një vit më pas, është koha që të bëhet një vlerësim i efekteve dhe i ndryshimeve që i ka sjellur intervenimi i NATO-s.

“Faza përfundimtare” e shpërbërjes së Jugosllavisë

SERBIA * E ardhmja e Serbisë është e rëndësishme për të tërë rajonin e Ballkanit, qoftë si burim potencial i tensioneve dhe konfliktit, siç u dëshmuua me regjimin e Millosheviqit gjatë dekadës së fundit, qoftë si parakusht për një paqe të qëndrueshme dhe bashkëpunim rajonal. Epilogu i intervenimit të NATO-s i ka patur dy kuptime: regjimi i Serbisë u mposht dhe u detyrua të tërhiqej nga Kosova, mirëpo ky edhe më tutje ngeli në pushtet në Beograd. Këtu mund të tërhiqet një paralele historike e përkufizimeve: kjo situatë nuk është e njëjtë me atë kur në Gjermaninë e pas-Luftës së Dytë Botërore, të mposhtur në tërësi, demokracia u imponua nga jashtë, mirëpo është mjaft e ngjashme me atë të Gjermanisë të pas-Luftës së Parë Botërore: jo e mposhtur plotësisht, por e lënë që të stërkeqet përbrenda, duke e hedhur në këtë mënyrë farën potenciale të një konflikti tjetër. E ngjashme me këtë gjendje, është edhe dykuptimësia e tashme e opozitës serbe: ende mbetet e paqartë nëse ajo është duke e kritikuar Millosheviqin për shkak të futjes në luftë, apo për shkak të humbjes së saj.

Njëra ndër karakteristikat e cila, mbase, më së shumti e ka shquar regjimin e Millosheviqit, e dëshmuar edhe në luftën në Kosovë, ishte shkathtësia e këtij regjimi që vetvetes t'i krijonte alternativa të cilat, ose ishin të parrealizueshme, ose ishin fare të dobëta. Përmes dhunës selektive kundër grupeve opozitare dhe mbajtjes nën shtërëngim të mediave, Millosheviqi e ruante pushtetin përmes frikës të cilën e krijonte, nga njëra anë, dhe një ndjenjeje të përzier të apatisë dhe të rraskapitjes, në anën tjetër. Është e padyshimtë që kjo politikë e dhunës nuk e pati zanafillën gjatë intervenimit në Kosovë. Për shembull, ligji i ri për Universitetin i vitit 1998, e paraqet një shqelmmim me që të dyja këmbët, të asaj të cilën regjimi e konsideronte si njërën nga qendrat intelektuale të opozitës. Lufta vetëm që e përshpejtoi këtë praktikë, dhe në veçanti dhunën kundër asaj që kishte mbetur ende e pashkatërruar nga media e pavarur. Ndërhyrja kundër mediave të pavarura u përshkallëzua më 17 maj të vitit 2000, kur policia i mori në shënjestë zyrat e Studios televizive B-92, të Radios B2 - B92, dhe të gazetës Blic. Përshkallëzimi i dhunës në Serbi, përmes një vargani të vrasjeve që tani dalngadalë po i afrohen edhe elitës udhëheqëse, shërbeu, po ashtu, si një mjet tjetër për përhapjen e atmosferës së frikës në radhët e forcave reale apo potenciale të opozitës. Regjimi krijonte me qëllim atmosferë të terrorit arbitrar, për ta krijuar kështu një mbështetje për arsyetimin e miratimit të “aktit antiterrorist” në qershor. Është e padyshimtë që të gjitha këto zhvillime e paralajmëronin avancimin nga autoritarizmi në një diktaturë të plotë.

Përshkallëzimi i dhunës së brendshme, që nga pranvera e vitit 1999, është, po ashtu,

një tregues i kriminalizimit të regjimit dhe të disa segmenteve të tjera të shoqërisë. Gjatë një dekade makina luftarake e Millosheviqit ishte mbështetur në një strukturim “mafioz” të ekonomisë, me qëllim të anashkalimit të sanksioneve. Po kështu, projektimi i përbashkët i armatës, si institucion, dhe i forcave parlamentare, e bëri të mundur si spastrimin etnik, ashtu edhe krimin e organizuar. Që nga fillimi i luftrave në Jugosllavi, në Serbi kanë ndodhur mbi 500 vrasje “të pandrikuara,” ku në radhët e viktimave kishte biznesmenë, paramilitarë, udhëheqës mediash, dhe personalitete të opozitës. Fitohet përshtypja që disa nga këto vrasje ishin qërim hesapesh rreth biznesit fitimprurës të kontrabandës me karburante.² Rritja paralele e kriminalitetit dhe e dhunës së institucionalizuar ndaj mediave të pavarura, bëri që nga qarqet akademike dhe nga forcat politike të tërhiqet vërejtja për mundësinë e shpalesjes së një skenari të rrezikshëm për Serbinë: kalimin nga lufta e jashtme në një luftë të brendshme civile ose në një kombinim të që të dyjave, për shkak të rrezikut që Millosheviqi ta përdorte situatën e krizës në Malin e Zi si një vegël për shpëtimin e regjimit të vet, përmes një “gjendjeje të luftës” si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Ky skenar pesimist duket i mundshëm për shkak të tre faktorëve:

1. I pari, për shkak të dobësisë dhe të grimcimit të opozitës. Kredibiliteti i udhëheqjes opozitare kishte rënë që nga dimri i vitit 1997, kur lëvizja më e fuqishme opozitare kundër Millosheviqit u soll në një rrugë pa krye, për shkak të rivaliteteve, korupcionit, dhe më në fund, edhe të bashkangjites regjimit. Vuk Drashković, njëri nga liderët më të dalluar opozitarë, në fund iu bashkangjiti qeverisë së Millosheviqit. Mirëpo, duhet theksuar, po ashtu, që ishin edhe disa zhvillime inkurajuese në shoqërinë civile. Disa qytete provinciale tashmë ishin duke u administruar nga partitë opozitare. Lëvizja e fuqishme ‘Otpor’ (Rezistenca), e cila në fundin e vitit 1998 u paraqit si një lëvizje studentore, u shndërrua shumë shpejt në një qendër e cila i tubonte ata që e kundërshtonin Millosheviqin, por të cilët nuk kishin besim në udhëheqjet e partive më të mëdha opozitare.³

Këto zhvillime pozitive është dashur të kenë përkrahje nga jashtë. Ato shembëllejnë në një mundësi të ringjalljes politike, nga periferia kah qendra, dhe nga shoqëria civile në shoqërinë politike. Këto zhvillime, duke supozuar që do të kenë përkrahje nga popullata serbe, kërkojnë kohë. Udhëheqësit e ri studentorë në ‘Otpor,’ për shembull, nuk janë entuziastë dhe nuk kanë mundësi ta zëvendësojnë udhëheqjen e diskredituar të opozitës; mirëpo, është një udhëheqje në tërësi e re ajo e cila sot i mungon më së shumti politikës serbe.

2. Fitohet përshtypja që ndonjë opsion më i besueshëm për ndryshime brenda aparatit

të tashëm udhëheqës nuk ekzistonte fare. Në fund të vitit 1998, Millosheviqi e hoqi udhëheqësin e shërbimeve sekrete, Stanishiq, dhe ish-shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Gjeneralin Perishiq, të cilët ishin angazhuar për qëndrime më fleksibile lidhur me konfliktin në Kosovë. Që nga ky veprim e mëtej, garda pretoriane e Millosheviqit përbëhej vetëm nga njerëz plotësisht të bindur ndaj tij, çfarë ishin Pavkoviqi e Ognjanoviqi.

3. Duke qenë i akuzuar për krime lufte nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës, Millosheviqi nuk kishte “strategji dalëse.” Njerëzit e pushtetit që ndodhen përreth tij, do të humbnin çdo gjë, dhe nuk do të kishin se ku të shkonin. Ky regjim me mentalitet bunkerit mund të qëndronte edhe një kohë me ndihmat e Rusisë dhe të Kinës. Po kështu, ekzistojnë ngjashmëri me fin de regne të regjimit të Çausheekut. Për këtë arsye, regjimit të Millosheviqit, edhe pse është plotësisht i dërrmuar, i duhet ende një kohë e gjatë deri në shembje, dhe kjo mund të shkaktojë përtëritje të dhunës në pjesën më të rëndësishme të enigmës së Ballkanit.

Implikacionet e këtij skenari për stabilitetin e rajonit janë vërtet brengosëse. Meqë Perëndimi nuk e ka më asnjë mundësi të ndikimit në Millosheviqin, ai jo vetëm që do ta vazhdojë politikën e tij të dhunës dhe të reprezaljeve të brendshme, por, madje, ka mundësi që ta provojë ngritjen e tensioneve me Malin e Zi, ose në rajonin e Preshevës në Serbinë Jugore, në kufi me Kosovën, ku kryengritësit e përkrahur nga UÇK-ja angazhohen që disa fshatra shqiptare t’i bashkëngjiten Kosovës.

Intervenimi i NATO-s është zhvilluar me një supozim të nënkuptuar, që regjimi i Millosheviqit nuk mund ta mbijetojë disfatën ushtarake. Një vit më vonë, pozicionet dhe ndasitë implicite në mes të evropianëve dhe SHBA-ve, luhaten ndërmjet dy argumenteve kryesore.

I pari e pohon që politika e Perëndimit ka qenë e tejngarkuar me Serbinë e Millosheviqit, dhe për këtë arsye e ka patur vetëm një strategji afatshkurtër: që Serbia të pengohet në përpjekjet që fqinjëve të saj t’u shkaktonte dëme sa më të mëdha, duke shpresuar që ajo do të duhej të bëhej demokratike dhe që Millosheviqi do të detyrohej të largohej, përmes izolimit ndërkombëtar të ekonomisë dhe mbështetjes së heshur për opozitën. (Kështu, për shembull, Madeline Albright e theksonte që nuk mund ta imagjinonte Millosheviqin e mbetur në skenën politike edhe pas zgjedhjeve të ardhshme.) Deklaratat e tilla tregojnë, mbase, për mungesë të imagjinatës ose të informatave lidhur me zgjedhjet e mëparshme të cilat Millosheviqi i fitoi në aleancë me Partinë Radikale ultra-nacionaliste të Vojislav Sheshelit. Dhe, nga ana tjetër, nëse ky përqendrim politik në zgjedhjet e ardhshme nuk tregohet i suksesshëm, çfarë më

tutje? Një qasje më afatgjate do të duhej ta merrte parasysh faktin që opozita, sa i përket çështjes kombëtare, në thelb të vetin nuk dallon nga Millosheviqi. Një qasje e tillë i nënkupton: (1) Ndërprerjen e preokupimeve me Serbinë, përderi sa kjo të mos jetë në gjendje që të shkaktojë konflikte në rajon; (2) Qëndrimin jashta ekuacionit politik të Serbisë; (3) Kujdesin për të mos u mashtruar nga ndonjë sukses iluzor i opozitës së dobët, të përçarë dhe në esencë të dyshimtë; dhe, (4) Braktisjen e plotë të Vuk Drashkoviqit, i cili më shumë është pjesë e problemit sesa që është pjesë e zgjidhjes së tij. Mashtrimet e nacionalistëve serbë, e kërkojnë një “cure de desintoxication” afatgjatë. Nuk duhet pritur më tutje, por duhet lëvizur në drejtim të ballafaqimit më çështjen e statusit final të Kosovës, duke i ofruar njëkohësisht të gjitha trajtat e mundshme të ndihmës për shoqërinë civile në Serbi dhe për rindërtimin dhe zhvillimin e integriteteve rajonale.

Linja e argumenteve të palës tjetër, e cila mbizotëron në radhët e elitës politike evropiane, e mbron qëndrimin që Serbia edhe më tutje mbetet shtyllë e stabilitetit në Ballkan. Sipas kësaj bindjeje, të harruarit e Millosheviqit është i rrezikshëm. Po që se synohet një qasje rajonale në parandalimin e konfliktit, Serbia nuk mund të injorohet. Problemi më i madh është që duke e izoluar një regjim kriminel, pashmangshmërisht izohet edhe një shoqëri e tërë. Sanksionet, sipas këtij argumentimi, nuk sjellin rezultate: ato vetëm që i forcojnë levat e pushtetit të Millosheviqit, duke e zhvilluar mafinë, nga njëra anë, dhe duke e poshtëruar një shoqëri të tërë me varfëri dhe ekzod, si të rinisë, ashtu edhe të elitës së arsimuar, nga ana tjetër (një çerek milioni, që nga viti 1991). Si pasojë, gjatë dekadës së fundit shoqëria serbe është mplakur, është bërë më fshatarake, dhe më e paarsimuar. Sanksionet nuk ndihmojnë që ky trend të ndryshohet, por vetëm e shkaktojnë dobësimin e njerit nga kushtet sociologjike të alternativës demokratike. Për këtë arsye, përgjigja më mirë do të ishte “mënjanim dhe angazhim”: të ndihmohet koalicioni serb i të pakënaqurve, ashtu që ai të nxirret në qendër të vëmendjes përmes përfshirjes në bashkëpunimin rajonal. Vetëm në këtë mënyrë mund të ketë sukses tranzicioni demokratik në Serbi sipas një “skenari kroat.”

Ndërrimi i regjimit në Serbi përfundimisht do të varet nga aftësia e shoqërisë serbe për t’u rimëkëmbur dhe për t’i realizuar ndryshimet demokratike. Për këtë arsye, pavarësisht nga sukseset apo dështimet e partive opozitare, prioritet i ndihmës së jashtme duhet të jetë mbështetja e projekteve afatgjate që kanë të bëjnë me afirmimin e shoqërisë civile serbe, duke i përfshirë këtu edhe OJQ-të, mediat alternative e të pavarura dhe universitetet. Ky do të ishte, njëkohësisht, edhe themeli më i mirë për kontaktet transnacionale në rajon. Pajtimi i pasluftës nuk duhet të presë në sinjal të

gjelbër nga qeveria.

Vërsnimi i shoqërisë serbe me kontakte ndërkombëtare duhet të bëhet paralelisht me vazhdimin e programit të sanksioneve të orientuar për ta goditur regjimin e Millosheviqit, dhe në veçanti palcën e këtij regjimi. Programi i sanksioneve të tashme është reduktuar, duke e bllokuar vetëm naftën, armët dhe paratë. Me faktin që madje edhe embargoja e naftës është hequr për qytetet opozitare, sanksionet janë bërë esencialisht një simbol politik. Heqja e tyre pa kushte do të ishte një ndihmesë e madhe për Millosheviqin. Prandaj, qëllimi është që ato të mbahen të reduktuara, mirëpo edhe të përqendruara më qartë në elitën në pushtet, duke i ndaluar udhëtimet e tyre jashtë vendit si dhe çasjen në llogaritë bankare në Qipro.

MALI I ZI * Pas daljes së Kosovës nga kontrolli i Beogradit, Mali i Zi ngeli “partneri” i fundit i Serbisë në pjesën e Federatës Jugosllave të mbetur në fundin e procesit të shpërbërjes dhjetëvjeçare. Shprehja “partner” mbase edhe nuk i paraqet realisht marrëdhëniet të cilat u krijuan pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 1997, në të cilat Millo Gjukanoviq menjëherë pas fitores kundër pionit të Millosheviqit, Momir Bullatoviq, i filloi reformat demokratike dhe intensifikimin e pavarësisht nga Beogradi. Lufta, nëse hiç më tepër, i përshpejtoi dy trende: ajo e ktheu Malin e Zi në një kala të kundërshtimit të regjimit të Millosheviqit, dhe i dha një dinamikë të re disponimit për pavarësi. Mali i Zi ka rëndësi strategjike për Serbinë, si dalja e vetme në det. Për këtë arsye, qëndrimi neutral i Malit të Zi gjatë intervenimit të NATO-s, ishte një problem tepër i madh për Serbinë. Ky qëndrim nuk e kurseu ketë vend nga bombardimet e NATO-s të disa objekteve të Ushtrisë Jugosllave të cilat ndodheshin në territorin e tij, mirëpo, as Beogradi nuk e shfrytëzoi luftën si një pretekst për ta rivendosur kontrollimin e pushtetit në Podgoricë, me gjasë për shkak të asaj që ushtria ishte e ndarë rreth kësaj çështjeje, dhe, po ashtu, ishte e angazhuar në Kosovë.

Që nga përfundimi i luftës, këtu njëkohësisht filluan dy procese: procesi i “pavarësisë së harlisur” të Malit të Zi, dhe ai i “puçit të harlisur ushtarak” nga ana e Beogradit. Hapat drejt pavarësisë ishin përqendruar në ndarjen e valutës zyrtare - Mali i Zi e zyrtarizoi markën gjermane - dhe në referendumin e ardhshëm për “sovrانيت.” Pyetja e cila do të shtrohej në referendum - “A e përkrahni Malin e Zi sovran, në asociacion me shtetin sovran serb?” - është një e cila anon më tepër kah konfederata sesa kah pavarësia e plotë. Metoda ishte e kujdesshme, mirëpo çështja është e njohur fare mirë nga Sllovenia dhe Kroacia: pavarësia si mënyrë për ta shmangur bllokadën institucionale.

Në ndërkohë, Millosheviqi e shtoi edhe më shumë trysinë, duke u mbështetur në

Ushtrinë Jugosllave të stacionuar në Mal të Zi, si dhe në Batalionin e Shtatë të Policisë i cili e kishte ruajtur besnikërinë ndaj Beogradit, dhe të cilin kryeministri i Malit të Zi e quante “para-ushtri.” Duke e kontrolluar kufirin me Kroacinë, Shqipërinë, dhe me Republikën Serbe të Bosnjes, Beogradi zyrtar e vuri një kuazi-bllokadë, qëllimi i së cilës ishte izolimi ekonomik i Malit të Zi. Gjukanoviçi e tërhoqi vërejtjen në një mënyrë të qartë që Ushtria Jugosllave po përgatitej ta rrëzonte Qeverinë e Malit të Zi, gjë kjo e cila mund ta shkaktonte “luftën e pestë Ballkanike.”⁴ Gjukanoviçi i kishte të gjitha arsytet për ta shmangur një skenar të tillë, duke e ditur (në bazë të zgjedhjeve të fundit komunale⁵) që, megjithë kundërshtimin ndaj regjimit të Millosheviçit, shumica e popullatës së Malit të Zi ishte në një hamendje të thellë për mundësinë e ndarjes nga Serbia. Më 6 korrik të vitit 2000, Millosheviçi e ndërmorri edhe një hap tjetër në drejtim të konfrontimit me Malin e Zi, duke e arritur qëllimin që përmes parlamentit jugosllav t’i fuste në fuqi amendamentet kushtetuese të cilat ia bënë të mundur që të kandidohej sërish për president (përmes zgjedhjeve direkte), gjë kjo e cila do t’i kufizonte mundësitë që Mali i Zi i kishte në federatë. Sipas Kryeministrit të Malit të Zi, Filip Vujanoviçi, ndryshimet që Millosheviçi i dëshironte e kishin për qëllim “shndërrimin e Jugosllavisë në Serbi të Madhe.”⁶ Zhvillime të tilla e pamundësonin që autoritetet e Malit të Zi të mirrnin pjesë në zgjedhjet federale jugosllave të cilat ishin të parapara për vjeshtën e vitit 2000.⁷ Të gjitha këto Millosheviçi i shërbenin si atu dhe “gjasë” për një konflikt të cilin, për shkak të raportit të përmasave në mes të dy republikave, ai do ta “fitonte.”⁸ Me fjalë të tjera, gjatë dekadës së fundit ai zhvilloi lufta kundër të gjithë fqinjve të Serbisë nga ish-Jugosllavia, dhe që të gjithat i humbi. Në Mal të Zi, Millosheviçi e kishte një rast të mrekullueshëm që, më në fund ta mposhte një kundërshtar, meqë ky ishte shumë më i dobët dhe më i vogël.

Përpos tryfnisë ushtarake, Millosheviçi i përshkallëzoi tendosjet po ashtu, duke i shpallur zgjedhjet federale sipas rregullave të reja, të cilat esencialisht e zvogëlonin ndikimin e Malit të Zi brenda federatës. Sipas ligjeve të reja zgjedhore, Mali i Zi nuk konsiderohej edhe më tutje si “partner” i Serbisë në federatë, por, thjesht, si pjesë e numrit të gjithmbarshëm të popullatës së Jugosllavisë, pra, e përfaqësonte vetëm pjesën demografike, gjë kjo e cila nuk i shkaktonte ndonjë telashe të madhe Serbisë.

As SHBA-të dhe as BE-ja në këtë moment nuk e përkrahin pavarësinë e Malit të Zi, për shkak të frikës që kjo do të mund të shpiente në shpërthimin e një dhune përmasash të mëdha, dhe atë në kohën kur nuk ka as mjete të mjaftueshme dhe as vullnet për intervenim. Pavarësia e Malit të Zi, po ashtu, ka pasoja edhe për statusin e Kosovës: po qe se Mali i Zi e shpall pavarësinë, entiteti juridik i quajtur Jugosllavi do

të pushojë së ekzistuari.

Pse Mali i Zi, një vend me më pak se 700.000 banorë, është me kaq rëndësi? E para, sepse (ashtu sikurse edhe Maqedonia) e paraqet një alternativë për politikën konfrontuese të Millosheviqit: bashkëjetesë paqësore e grupeve etnike të malazezëve dhe të serbëve (tri të katërtat e popullatës), dhe të shqiptarëve (7% para ardhjes së refugjatëve, të cilët, ndërkohë, e dyfishuan këtë shifër), si dhe të myslimanëve/boshnjakëve (14%). E dyta, sepse e paraqet një alternativë demokratike dhe demokratizuese për regjimin e Millosheviqit. Kur të mirret parasysh gjendja momentale e opozitës demokratike në Serbi, shpresat demokratike të së cilës përfaqësohen nga një ish-shef policie, e ardhmja e saj demokratike mund të varet më tepër nga elasticiteti i Malit të Zi të vogël dhe më të “prapambetur.” Dhe më në fund, po qe se ndahet Mali i Zi, nuk do të ketë më Jugosllavi, kështu që do të jetë e pakuptimë që shqiptarëve të Kosovës t’u thuhet se e ardhmja e tyre, sipas Rezolutës së OKB-së, do të jetë në Jugosllavi.

Edhe pse Mali i Zi, si pjesë e RFJ-së është nën sanksione të cilat, pos tjerash, e përjashtojnë edhe ndihmën financiare, ky nga BE-ja ka marrë 20 milion Euro, në bazë të vendimit të ministrave të financave të BE-së të miratuar më 8 maj 2000. Jo më pak e rëndësishme është që Mali i Zi duhet të bëhet pjesë integrale e Paktit të Stabilitetit Evropian, si një opsion shtesë për t’i forcuar proceset demokratike dhe aftësinë që t’i rezistojë trysnive ekonomike, ushtarake dhe politike të Serbisë së Millosheviqit.

Po qe se nuk ndërmerren hapa të menjëhershëm nga Bashkësia Ndërkombëtare, për ofrimin e ndihmës ekonomike dhe politike për institucionet dhe sigurinë e Malit të Zi, kjo republikë mund të shkojë në drejtim të konfliktit me Serbinë.

Kosova – Shqipëria – Maqedonia

Marrëdhëniet e Kosovës me dy fqinjët e saj, Shqipërinë dhe Maqedoninë, e kanë një rëndësi tepër të madhe për stabilitetin rajonal. Millosheviqi e shfrytëzoi me qëllim intervenimin e NATO-s, për të provuar (dhe ishte afër asaj që të arrinte sukses) që ta shkaktonte destabilizimin e këtyre dy vendeve të cilat ishin më të voglat, më të varfërat dhe më të pambrojturat nga fqinjët e Kosovës. Po kështu, çështjet thelbësore të debatit lidhur me statusin final të Kosovës, përqendrohen në raportet e saj me Shqipërinë (si shtet etnik i shqiptarëve), dhe me Maqedoninë, një shtet në të cilin vërehet prania e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh të pakënaqur.

Kosova - Shqipëria

Ndër faktorët më me ndikim në konfliktin në Kosovë, ka qenë kollapsi i shtetit shqiptar, i cili ndodhi në fillim të vitit 1997, kur edhe u bë e mundur që sasi të mëdha armësh të hyjnë në Kosovë, pikërisht në çastin kur UÇK-ja po përpiquej të stabilizohej si një faktor me ndikim. Shpërthimi i dhunës në Shqipëri nuk e kishte asnjë lidhje me konfliktin etnik në Kosovë. Ndodhja e saj u shkaktua nga shembja e skemave piramidale (të cilat ishin të lidhura me krimin e organizuar, por edhe me partinë në pushtet të Presidentit Sali Berisha), dhe të cilat e prekën mbi një të tretën e popullsisë. Sidoqoftë, ky konflikt ishte një manifestim i ndasive të thella në shoqërinë shqiptare, të fermentuara nga rivalitetet e vjetra klanore dhe krahinore, polarizimet pas-komuniste dhe nga varfëria. Rrëshqitja në anarki të plotë dhe shpërbërja e shtetit, i mundësoi UÇK-së që në Veri të Shqipërisë ta krijonte bazën për veprimet e veta në Kosovë. Kjo ndikoi edhe në instrumentalizimin e UÇK-së në politikën e Shqipërisë, përmes konfrontimeve ndërmjet ish-komunistëve (Fatos Nano) dhe të të djathtëve (Sali Berisha). Me kalimin e kohës, dhe në veçanti gjatë kulminacionit të krizës në Kosovë, më 1999, fraksionet konkurruese të UÇK-së kishin vënë lidhje “të shumëllojshme” me faktorët politik të Shqipërisë. Duket se Thaçi kishte krijuar marrëdhënie pune me qeverinë aktuale të Tiranës. Rugova, ndërkaq, u kthye në Kosovë nga egzili i tij në Itali, jo përmes Shqipërisë (ku nuk e kishte të garantuar sigurinë e tij), por përmes Maqedonisë.

Në këtë mënyrë, që nga viti 1997, është manifestuar një trend i krijimit të hapësirës politike shqiptare, me një shkallë në rritje të ndërveprimit në mesin e tri komponenteve të saja: Prishtinë (Kosovë), Tiranë (Shqipëri), dhe Tetovë (Maqedoni). Kjo e shtoi frikën, si jashtë, ashtu edhe brenda Ballkanit, që do të bëhen përpjekje për krijimin e “shtetit të madh shqiptar.” Edhe pse në platformën e vet politike të vitit 1998, UÇK-ja e kishte përkrahur idenë e Shqipërisë së Madhe, ka fare pak fakte që këtë synim e ka edhe sot, apo që hapësira politike shqiptare aktuale do të mund të shquhej me këtë qëllim. Ç’është e vërteta, ka shumë më tepër indikacione për të kundërtën – nocioni i Shqipërisë së Madhe duket të jetë braktisur si nga politikanët shqiptarë, ashtu edhe nga popullata e tërësishme.⁹ Ndonëse Shqipëria, sipas të gjitha gjasave, do ta mbështeste pavarësinë e Kosovës, në Tiranë një deklaratë e tillë nuk nënkupton lëvizje drejt krijimit të Shqipërisë së Madhe.

Duke i analizuar marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës, mund të flasësh për dukurinë “një komb – dy shoqëri,” diçka shumë e ngjashme me “Ossies” dhe “Wessies” në Gjermani. Nëse hiç më tepër, shqiptarët e

Kosovës janë të prirur që për veten të mendojnë si Wessies. Ata kanë jo vetëm standard më të lartë jetese, por edhe mbështetje më të fortë nga diaspora, e cila është shpërndarë nëpër Evropën Perëndimore gjatë tridhjetë viteve të kaluara. Dallimet e tilla ekonomike, historike e kulturore ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës dolën në shesh kur që të dyja grupet u mbërthyen bashkërisht nga kriza e refugjatëve e shkaktuar nga lufta në Kosovë.

Kundërargumenti tjetër, i cili është duke u zhvilluar tani, e thekson atë që po qe se Kosova e arrin pavarësinë, atëherë do të jetë ajo e cila do të përpiqet që ta realizojë rolin e saj prijës të unitetit shqiptar.¹⁰ Me fjalë të tjera, në disa qarqe, frika nga “Shqipëria e Madhe” është zëvendësuar (ose është ngatërruar) me frikën nga “Kosova e Madhe.”

Pavarësisht nga ajo se cilat do të mund të ishin agjendat e fshehta të aktorëve politik të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë, janë të paktën dy argumente kryesore të cilat duhet të merren parasysh, para se të fillohet me nxerrjen e përfundimeve lidhur me marrëdhëniet e Kosovës me Shqipërinë. E para, as që është e lehtë, dhe as që është ndonjë mundësi në veçanti tërheqëse të bashkohesh me një shtet të dështuar. Kjo padyshim se e paraqet një dush të ftohtë për ambiciet e atyre që vetveten e konsiderojnë si radikalët dhe nacionalistët më të mëdhenj në Shqipëri dhe në Kosovë. Dhe e dyta, vetëqeverisja e Kosovës (pa e përmendur këtu pavarësinë), në thelb të vetin ka të bëjë me ndërtimin e institucioneve, apo me ndërtimin e shtetit. Ky proces krijon interesa të mëdha politike dhe institucionale, të afta për ta mbrojtur veten, dhe në këtë mënyrë me fare pak disponim për ta kërkuar bashkimin me institucionet e dyshimta shtetërore në vendin “amë” (d.m.th. me Shqipërinë). Në këtë mënyrë, ndërtimi i shtetit të Kosovës, nëse tregohet i sukseshëm, përfundimisht mund të del si argumenti më i fuqishëm kundër projektit të Shqipërisë së Madhe.

Ky diskutim e tërheq vërejtjen për paradokset të cilat në mënyrë qenësore janë të mishëruara në qëllimet e protektoratit në Kosovë, kështu siç ai është i strukturuar aktualisht. Qëllimet e rindërtimit dhe të zhvillimit të demokracisë dhe të ekonomisë së tregut, varen nga aftësia për të vendosur sundimin e ligjit dhe institucionet e tjera jetike për ndërtim të shtetit. Mirëpo, nga ana tjetër, qëllimi i shprehur qartë i protektoratit në Kosovë, nuk është ndërtimi i shtetit, por më shumë pengimi i formimit të tij.

Kosova - Maqedonia

Maqedonia karakterizohet me ndasi etnike të shoqërisë. Kjo e paraqiste një arsye të fuqishme për frikë lidhur me stabilitetin e Maqedonisë pas shpërthimit të konfliktit në Kosovë. Për shembull, ngjashëm me marrëdhëniet shqiptaro-serbe në Kosovë, edhe në Maqedoni nuk ka martesë të përziera ndërmjet të sllavëve dhe të shqiptarëve. Maqedonasit (ashtu sikurse edhe serbët e Kosovës), e kanë frikën që ekuilibri i tashëm demografik do të ndryshojë, dhe se në këtë mënyrë ata, për disa dekada, për shkak të natalitetit të lartë të shqiptarëve do të mund të mbesin minoritet në Maqedoni. Siç është vënë në dukje, në Maqedoni më i rëndësishëm është regjistrimi i popullsisë sesa vetë zgjedhjet. Regjistrimi i vitit 1994 ka treguar që shqiptarët e përbëjnë çerekun e popullsisë: të dhënat e sakta duhet të jenë më të larta kur dihet fluksi i popullatës etnike të shqiptarëve të Kosovës gjatë dekadës së fundit (e të cilët zyrtarisht nuk janë të regjistruar).

Gjatë viteve '90 ka ndodhur një fluks i ngadalshëm, por i vazhdueshëm, i shqiptarëve të Kosovës, të cilët iknin nga politika represive e regjimit të Serbisë në drejtim të Maqedonisë. Një nga rezultatet e kësaj ishte edhe kërkesa militante e vitit 1994, për ta formuar një universitet shqiptar në Tetovë, kërkesë kjo e cila në masë të madhe ishte e nxitur edhe për shkak të mbylljes së Universitetit të Prishtinës në Kosovë. Sipas perceptimit të qeverisë së Shkupit dhe të një numri të madh të maqedonasve, është pikërisht ndikimi i kosovarëve ai që është identifikuar me tendosjet në rritje ndërmjet të sllavëve të Maqedonisë dhe të shqiptarëve etnik.

Në një kontekst të tillë, në pranverën e vitit 1999, në Maqedoni, d.m.th. në një vend me 2 milion banorë, i cili para një dekade madje as që ishte shtet, erdhën 276.000 refugjatë shqiptarë nga Kosova. Edhe pse ky kontekst nuk mund t'i arsyetojë disa nga reagimet kundërshtuese të Maqedonisë ndaj refugjatëve, ai ndihmon për ta shpjeguar frikën e cila e kishte kapluar Maqedoninë. Sllavët e Maqedonisë e kishin dronë e përhapjes së pasojave të luftës nga Kosova (d.m.th., UÇK-në duke e përdorur rajonin e Tetovës si bazë), dhe, mbase edhe më shumë, ndarjes së Kosovës. Kjo, sipas këndvështrimit të tyre, do ta kishte krijuar precedentin për veprime të ngjashme edhe në Maqedoni, ku shqiptarët etnik e kishin bojkotuar referendumin e vitit 1991 për pavarësi.

Megjithë tensionet që u shkaktuan nga fluksi masiv i refugjatëve në Maqedoni, mund të thuhet që Maqedonia iu shmang skenarit më të keq të një destabilizimi të plotë, e i cili mund të ketë qenë pjesë e synimit për dëbime. Siç e vuri në dukje gjatë konfliktit një anëtar i shquar i Parlamentit të Maqedonisë (profesori Nano Ruzin): "Sikur

Maqedonia të mos ishte shtet i pavarur, aty do të kishte ndodhur i njëjti konflikt si në Kosovë, dhe refugjatët do të ishin larguar për në Greqi dhe Bullgari.” Vërtet, nën drejtimin e ish-Presidentit Gligorov (i cili ia arriti të dilte nga Jugosllavia pa bërë luftë me Beogradin), dhe tash – në një mënyrë, paksa të ndryshme – nën drejtimin e qeverisë së VMRO-së, është dëshmuar se me përfshirjen e partive shqiptare në qeveri, Maqedonia mund të funksionojë. U dëshmuua që një lloj koalicioni i partive sllavo-maqedonase dhe i atyre shqiptare mund të jetë alternativë e spastrimit etnik, meqë këto parti shqiptare tashmë disa vite e kishin zënë një pozitë të rëndësishme në politikën e Shkupit, e cila kishte filluar të ofronte një vetëqeverisje në rritje lidhur me çështjet e minoriteteve.

Megjithatë, burimet e problemeve në Maqedoni janë shumë të thella, dhe disa prej tyre janë shkaktuar pikërisht nga kjo vetëqeverisje e shqiptarëve. Sllavët e Maqedonisë do ta parapëlqenin më tepër një “kantonizim” të Maqedonisë, ndërkaq që shqiptarët duan federalizim. Duket që mënyra e vetme për t’i qetësuar shqiptarët e Maqedonisë, është përmes parashtrimit të rezikut politik, i cili, po ashtu, mund të jetë rrezik edhe për ata vetë.

Shpërbërja e Maqedonisë gjithsesi do të reflektohej te faktorët kyq të rajonit. Serbia është dobësuar dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë është e goditur nga pasojat e intervenimit të NATO-s, ndërkohë që partia maqedonase në pushtet VMRO-ja ka lidhje më të ngushta me Sofjen. Në këtë mënyrë, Bullgaria, edhe pa dashje do të involvohej. Njësoj edhe Greqia, e cila qysh më heret e kishte imponuar një bllokadë ekonomike ndaj këtij vendi, dhe e cila, po ashtu, pretendon që e drejta për emrin burimor të “Maqedonisë” i takon vetëm asaj.

Nëse rreth Kosovës janë dy ëndrra nacionaliste, atëherë rreth Maqedonisë janë disa të tilla. Duket që vetë fakti që kjo është mjaft e dobët, vetëdija, pra, për pafuqinë e saj, është shndërruar në arsye për kërkim të kompromisit. Maqedonia iu shmang skenarëve më të këqinj dhe vazhdon të jetë qartazi e përkushtuar kundër pavarësisë së Kosovës. Kështu, për Maqedoninë protektorati ndërkombëtar e ka domethënien e kryerjes së funksionit të cilin Jugosllavia më nuk mund ta kryej vetë: ta kontrollojë fqinjin potencialisht destabilizues, dhe atë kryesisht lidhur me çështjen shqiptare. Në mënyrë paradoksale, çmimi të cilin Maqedonia duhet ta paguaj për t’u stabilizuar si shtet i pavarur, është që të pranojë që edhe vetë të bëhet gjysëm-protektorat, mbijetesa e të cilit është e varur nga përkrahja ndërkombëtare.

Bullgaria, Rumania dhe Greqia

Njëra nga karakteristikat mbase më të shquara të reagimit të gjerë rajonal lidhur me intervenimin e NATO-s kundër Jugosllavisë, ka qenë dallimi i theksuar ndërmjet qendrimeve të elitës politike pro-Perëndimore, dhe të pjesës tjetër të popullatës në Bullgari, Rumani dhe në Greqi. Ndërsa elita politike e shprehte një përkrahje ambivalente dhe ngurrim lidhur me intervenimin, në opinionin publik të që të trija këtyre vendeve, mbizotëronte solidarizimi me Serbinë. Është interesante të vihet në dukje që kundërshtimet më të forta vinin nga Greqia, ku 95% e popullatës ishin kundër intervenimit të NATO-s (dhe ku presidenti i SHBA-ve u detyrua ta shtyente vizitën e tij, përderisa nuk mori garancione nga autoritetet për sigurinë e tij); ndërsa, bazuar në sondazhet e bëra në fillim të intervenimit, 75% e popullsisë në Rumani, 70% në Bullgari, dhe 65% në Hungari ishin, po ashtu, kundër intervenimit. Me zgjatjen e intervenimit, ky kundërshtim vinte duke u shtuar. Siç duket, në bazë të disa vëzhgimeve, edhe në Evropën Qendrore, shumica e popullatës ishte kundër intervenimit të NATO-s. Kjo, për shembull, vlente për Republikën Çeke dhe për Sllovakinë. Nga radhët e të sapopranuarve në NATO, vetëm në Poloni përkrahja e opinionit publik për intervenimin në Kosovë mbizotëroi. Edhe pse në vendet e Evropës Juglindore nuk ekzistonte ndonjë simpati për Millosheviqin dhe për regjimin e tij, intervenimi në Kosovë shikohej në trajtën “fuqitë e mëdha e demonstrojnë forcën e tyre kundër një vendi të vogël.” Në Evropën Juglindore duket që lidhur me këtë intervenim erdhi në shprehje edhe dallimi ndërmjet vendeve ortodokse dhe Perëndimit - vetëm Turqia e mbështeti intervenimin në tërësi.

Kështu, njëra nga pasojat e para të intervenimit ka qenë dobësimi i elitave politike pro-perëndimore, me orientime reformiste, e të cilat në pushtet kishin ardhur, në Rumani nga fundi vitit 1996, dhe në Bullgari në pranverën e vitit 1997. Parlamentet e këtyre dy vendeve e kishin dhënë pëlqimin e tyre që aeroplanët e NATO-s ta shfrytëzonin hapësirën e tyre ajrore (por jo edhe kalimin tokësor), duke shpresuar që në këtë mënyrë do ta përshpejtonin inkuadrimin e tyre në NATO. Në Bullgari, Presidenti Peter Stoljanov dhe Kryeministri Ivan Kostov, ia arritën ta siguronin miratimin e kërkesës së NATO-s për një koridor ajror, megjithë kundërshtimet që u bënë gjatë procedurës legislative nga opozita socialiste (ish-komuniste).¹¹ Në Rumani, Presidenti Emil Konstantinesku dhe qeveria e tij e ndoqën të njëjtën rrugë, megjithë kundërshtimet e partive opozitare kryesore. Që të dyja këto vende, po ashtu, refuzuan t'i jipnin leje Forcave Ajrore Ruse për fluturim nëpër hapësirën e tyre ajrore, në kohën kur intervenimi i NATO-s ishte pak para përfundimit, duke e penguar në këtë mënyrë

planin ushtarak rus për ta grabitur në befasi një zonë të veten në Kosovë.

Çmimi i brendshëm politik të cilin këto vende do të duhen t'ia paguajnë përkrahjes së tyre të NATO-s, mund të jetë mjaft i lartë, në veçanti po qe se nuk do të fitojnë asgjë nga "hisja e paqes." Sekretarja e Shtetit e SHBA-ve, Albright, në deklaratën e saj të bërë në Sofje, në qershor 1999, duke e lavdëruar qëndrimin e Bullgarisë gjatë konfliktit si "manifestim i ndjenjave të tilla, sikur të ishte anëtare e familjes së NATO-s," inkurajoi shfaqjen e shpresave të cilat nuk kanë gjasa të realizohen shpejt. Ndërkohë, janë partitë opozitare, ish-komuniste, dhe në Rumani po ashtu nacionaliste, ato të cilat kanë më së shumti gjasa që të përfitojnë nga kjo e tëra. Në bazë të sondazheve aktuale, partia e ish-Presdientit Iliesku, dhe ajo ultra-nacionaliste 'Romania Mare,' e kanë shumicën para zgjedhjeve që do të mbahen në fund të vitit. Qëndrimet e mbajtura lidhur me intervenimin e NATO-s janë vetëm një aspekt i ndasive të mëdha që u shfaqën ndërmjet elitës politike dhe popullatës. Një sondazh i bërë kohëve të fundit në Rumani e tregon që, sipas vlerësimeve të medias, tri çështjet më të rëndësishme për vendin janë BE-ja, NATO-ja dhe IMF-i. Për këto tri prioritetet janë deklaruar respektivisht 5%, 7% dhe 8% e popullsisë; ndërkaq, çështje prioritare sipas opinionit publik rumun janë konsideruar inflacioni, standardi i jetesës dhe korrupsioni.

Një pjesë e shpjegimit për këtë mund të kërkohet në situatën ekonomike rajonale, e cila është përkeqësuar si pasojë e përçarjeve të shkaktuara nga intervenimi. Për shtetet më të dobëta (Maqedonia dhe Shqipëria), kjo situatë e ka përshpejtuar lëvizjen drejt varësisë nga ndihmat dhe drejt statusit të gjysëm-protektoratit. Në shtetet e tjera, problemet ekonomike e vështirësojnë pozitën e koalicioneve pro-reformiste, të cilat ishin relativisht të suksesshme në përfshirjen e minoriteteve kombëtare në sistemin politik (minoriteti hungarez në Rumani, minoriteti turk në Bullgari). Këto qeveri e treguan orientimin e tyre pro-perëndimor gjatë intervenimit të NATO-s deri në maksimum, ndonëse ishin të vetëdijshme fare mirë për rrezikun e erozionit të mbështetjes së tyre në shoqëri. Tani këto e ndjejnë që nuk e kanë fituar ndonjë shpërblim konkret për këtë përkrahje hazarde. Është e qartë që këto kanë pësuar humbje ekonomike pa ndonjë kompensim adekuat, dhe pa ndonjë përfitim politik substancial. Nëse kjo nuk ndryshon shpejt, është rreziku që ato do ta humbin mbështetjen politike, e që do të shkaktojë që vendet e tyre të kthehen në koalicione të ish-komunisteve dhe të neo-nacionalistëve, gjë kjo e cila do të vështirësonte konsolidimin e demokracisë dhe të stabilitetit në rajon.

Efektet ekonomike të intervenimit të NATO-s

Për ta vlerësuar ndikimin e krizës së Kosovës të vitit 1999 në rajonin e Ballkanit, është me rëndësi të merret parasysh fakti që ky është rajoni më i pazhvilluar i Evropës. Pasojat e luftës janë kombinuar me trashëgiminë e dyfishit të prapambeturisë dhe të tranzicionit të papërfunduar nga ekonomia e centralizuar. Nëse Bruto Produktet Kombëtare (BPK) të Shqipërisë, Bosnjës, Bullgarisë, Rumanisë, Maqedonisë dhe të Kroacisë merren të gjithat së bashku, këto bëjnë vetëm sa ai i qytetit të Hamburgut. Asnjëri nga këto vende nuk i ka arritur ende nivelet ekonomike që i kanë patur në vitin 1989. (Tabela 3).

	Popullsia (Milionë)	BPK / 1989	BPK /1999
Shqipëria	3.8	100	91
Bosnja	4	100	14
Bullgaria	8	100	66
Kroacia	5	100	56
Maqedonia	2	100	22
Rumania	22	100	74
Jugosllavia	8.5	100	10

Burimi: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 1999

Shkatërrimet e urave mbi Danub, të rrugëve transitore dhe të lidhjeve hekurudhore të cilat ndodhën gjatë luftës, e kanë vështirësuar komunikimin rajonal dhe faktikisht e kanë izoluar të tërë rajonin nga furnizimet dhe tregjet potenciale të Evropës Perëndimore. Kushtimi i rrugëve alternative është i papërballueshëm, dhe, si pasojë e kësaj, disa komplekse industriale në Rumania dhe në Bullgari është dashur të mbyllen. (Maqedonia, po ashtu, është dëmtuar shumë, sepse partneri i saj kryesor ekonomik ka qenë Serbia.) Lidhur me gjendjen ekzistuese, vërehet një ndryshim i madh në vlerësimet e dhëna nga ana e institucioneve kryesore ndërkombëtare (IMF, Banka Botërore, BERZH).

Gjatë kohës së intervenimit në Kosovë dhe menjëherë pas tij, shtet fqinje shpesh kanë deklaruar që pasoja më e rëndë ishte humbja e tregut jugosllav për eksportet e tyre, dhe, përgjithësisht, çrregullimi i tregtisë rajonale.

Një vështrim më i përafërt lidhur me çështjet e tregtisë para dhe pas intervenimit, tregon që pasojat e luftës në tregtinë rajonale kanë qenë relativisht të papërfillshme. Për të kuptuar shkaku, është me rëndësi të vihet në dukje që para krizës, partneri krye-

sor tregtar për secilin vend ballkanik ishte BE-ja, dhe se kjo tregti ndër-rajonale u kufizua në masë të madhe. Proporcioni i eksporteve ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe BE-së është si vijon: për Shqipërinë 87.4% me 8.4%; për Bullgarinë 43.2% me 7.0%; për Rumaninë 56.5% me 3%; dhe për Kroacinë 49.1% me 29.5%.¹² Nga Tabela 4, shihet që tregtia ndërmjet të vendeve të Evropës Juglindore është relativisht e parëndësishme.

Tabela 4: Të dhënat mbi eksportin dhe importin e vitit 1998 ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore dhe ish-Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ)

	Importet nga Evropa Juglindore	Eksportet në Evropën Juglindore	Importet nga RFJ	Eksportet në RFJ
Shqipëria	6.3	2.3	0.2	0.1
Bullgaria	3.0	7.0	0.8	10.4
Bosnia	30.8	29.5	-	-
Kroacia	2.8	16.1	-	-
Maqedonia	20.4	19.1	11.4	10.4
Rumania	1.0	3.0	0.0	1.4
Burimi: Statistikat e FMN-së, Maj 2000				

Të dhënat nga Tabela 4 ndihmojnë që të vihet në pah ndikimi i krizës së Kosovës në çështjet ekonomike, dhe këto, po ashtu, i tregojnë dobësitë strukturale të tregtisë rajonale, të shkaktuara nga ndryshimet gjeopolitike të dekadës së fundit. Megjithatë, këto të dhëna, po ashtu, duhet vlerësuar duke u bazuar në dy fakte. E para, vlerësimi i përgjithshëm lidhur me mungesën e tregtisë ndërmjet vendeve ballkanike vlen më pak për vendet e ish-Jugosllavisë, të cilat, me përjashtim të Sllovenisë, faktikisht, edhe më tutje vazhdojnë të bëjnë tregti me njëra tjetrën. “Ish-tregu jugosllav” e merr përafërsisht një të tretën e eksporteve të Serbisë, Kroacisë dhe të Maqedonisë, dhe ky, njëkohësisht, i mundëson dy të tretat e tregtisë së Bosnjes e Hercegovinës. Për të qenë në tërësi të qartë, duhet theksuar që një pjesë e kësaj është “tregti e zorit”: mundësitë për t’i zgjedhur partnerët tregtar janë fare të pakta. Mirëpo, është me gjasë që ndryshime pozitive, ekonomike dhe politike në Serbi, do të mund ta sforconin këtë dukuri në të ardhmen.

Pos kësaj, duhet theksuar që një pjesë e madhe e tregtisë rajonale bëhet pa u regjistruar fare. Një dekadë e luftrave dhe e sanksioneve, ka ndikuar që disa standarde rajonale të prishen, mirëpo kjo, po ashtu, ato i ka zëvendësuar me disa praktika në tërësi të reja, të cilat të shumtën janë jozyrtare. Ndonëse do të ishte vlerësim i stërzmadhuar po të thuhet që kjo është një dukuri që mbizotëron në të tërë tregtinë e rajonit,

megjithatë, nuk është gabim të konstatohet që sektorë të tërë të ekonomisë rajonale janë të kriminalizuar. Këta sektorë nuk figurojnë fare në statistikat zyrtare, mirëpo këta, pa dyshim, kanë pasoja të mëdha ekonomike dhe politike.

Dëmi i drejtëpërdrejtë

Intervenimi i NATO-s i vitit 1999 dëmet më të mëdha ia ka shkaktuar Serbisë, ndërkaq, pjesa tjetër e rajonit ka pësuar vetëm dëme të tërthorta të cilat nuk ishin të përmasave të njëjta. Dëmet që iu bënë RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), të shumtën ishin dëmtime të infrastrukturës dhe të kapaciteteve industriale. Bombardimet i shkatërruan disa dhjetra nga urat kryesore, si dhe mjaft aeroporte, qendra telekomunikuese dhe komplekse industriale. U shkatërruan 70% të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike dhe 80% të rafinerive të naftës.¹³ Në bazë të vlerësimeve të “Grupit 17,” një asociacion ky për hulumtime të pavarura ekonomike nga Beogradi, papunësia gjatë periudhës 1998-1999 shënoi rritje nga 26.8% në 33%. Konstatimi i këtij Grupi ishte që humbjet e përgjithshme ekonomike të Serbisë e kapin shumë prej 30 miliard dollarësh. (Vlerësime të tjera flasin për shifra edhe më të mëdha.) Pasojat e sanksioneve ekonomike dhe të numrit të madh të refugjatëve (vlerësohet që 100.000 serbë nga Kosova iu shtuan mbi gjysmë milion serbëve refugjatë nga Bosnia e Hercegovina dhe Kroacia), e kanë përkeqësuar edhe më tepër shkallën e dëmeve të cilat intervenimi ushtarak ia shkaktoi ekonomisë edhe ashtu të shkatërruar të Serbisë.

Ndërkaq, pasojat që iu shkaktuan ekonomive të vendeve fqinje, ishin më të vogla sesa që është pritur fillimisht.

Tabela 5: Vlerësimet për pasojat e luftës në vendet fqinje (%).

	Importet nga Evropa Juglindore	Eksportet në Evropën Juglindore	Importet nga RFJ	Eksportet në RFJ
Shqipëria	6.3	2.3	0.2	0.1
Bullgaria	3.0	7.0	0.8	10.4
Bosnia	30.8	29.5	-	-
Kroacia	2.8	16.1	-	-
Maqedonia	20.4	19.1	11.4	10.4
Rumania	1.0	3.0	0.0	1.4

Burimi: V. Gligorov dhe N. Sundstrom, “Kostoja e krizës së Kosovës” WIIW Analiza dhe profile shtetesh, Nr.12 (prill 1999).

Pasojat më të rënda i pësuan ato vende të cilat ishin më së shumti të varura nga marrëdhëniet ekonomike me RFJ-në (Bosnia dhe Maqedonia), si dhe ato të cilat e bartën pjesën më të madhe të barrës së refugjatëve (Shqipëria dhe Maqedonia). Megjithatë, kohëzgjatja e shkurtër e qëndrimit të refugjatëve, si dhe efekti të cilin e pati ndihma ndërkombëtare, e luajtën një rol të rëndësishëm në reduktimin e dëmeve. Humbja e të hyrave tregtare dhe e investimeve e ka shkaktuar një përkeqësim të mëtutjeshëm të situatës, e cila për disa vende edhe ashtu ishte për së tepërmi e vështirë, ndërkaq për të tjerat, kjo shkaktoi stagnim, pikërisht në momentin kur këto, pas një vonese tepër të gjatë, më në fund ia kishin filluar me reforma.

Rindërtimi dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkan

Pengesat e bashkëpunimit rajonal

Shpërbërja e Jugosllavisë dhe fragmentarizimi nacionalist i cili këtë shpërbërje e pasoi, e paraqiste, pa dyshim, pengesën kryesore për bashkëpunimin rajonal gjatë viteve '90. Çështja e kufijve të kontestuar, apo edhe e atyre të cilët tash filluan të kontestohen, si dhe çështja e minoriteteve, ndikuan shumë më tepër në ushqimin e agjendave konfliktuoze, sesa në përpjekjet për krijimin e mundësive për ndonjë bashkëpunim. Serbia e mendon veten si një fuqi rajonale, mirëpo pas një dekade nën Millosheviqin, thënë në trajtën më të butë, ajo është shndërruar në një vend të paaftë për ta udhëhequr dhe të papërgatitur për ta ndjekur çfarëdo qoftë plani rajonal. Pa ndryshime demokratike në Beograd, Serbia mund të realizojë vetëm projekte nënrajonale.

Janë edhe dy karakteristika të tjera të rajonit të cilat e paraqesin një pengesë serioze për integrimet rajonale. E para është kriza e shtetit dhe mungesa e sundimit të ligjit. Në përmasa që ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, këtu kemi të bëjmë me shtete të dobëta, me lidhje të dobëta institucionale, dhe me shoqëri të dobëta. Ekzistenca e një regjimi autoritar nuk duhet ngatërruar me fuqinë e shtetit. Zhvillimi i shteteve të dobëta, apo edhe i atyre të dështuara, përcillet me pasojat e veta politike dhe të sigurisë, si dhe me dimensionin socio-ekonomik. Numri më i madh i vendeve të rajonit mund të vlerësohen si shtete hua-marrëse, të cilat krijojnë deficite dhe borje publike të larta, dhe, esencialisht, mbështeten në ndihmat financiare ndërkombëtare.¹⁴ Bosnia, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, mbështeten që të gjithat në këtë sistem të varësisë financiare ndërkombëtare, nga njëra anë, dhe në kriminalizimin e ekonomisë nga ana tjetër (droga, armët, prostitucioni). Rumania dhe Bullgaria i kanë po të njëjtat karakteristika, mirëpo në përmasa pak më të vogla, sepse këto mund të llogarisin në disa

investime të drejtpërdrejta. Serbia pas Millosheviqit ka, po ashtu, gjasa për diçka të tillë, e që është paralajmëruar edhe nga udhëheqësit e opozitës nëpër konferencat ndërkombëtare të donatorëve. Ndonëse, këtu duhet të theksohet qartë që shtetet e dobëta, politikat demokratike i zbatojnë me vështirësi. Pushtetet politike të shteteve të tilla mbështeten në tre faktorë: Bashkësia Ndërkombëtare, mafia dhe votuesit. I pari ofron ndihma financiare; i dyti ka të bëjë me lulëzimin e korrupsionit; dhe, i treti, i cili pa dyshim është edhe më i rëndësishmi, e ka trajtën e klientelizmit. Këtu bëhet fjalë për “demokracitë joliberalë,” të cilat janë në një krizë të përhershme të legjitimitetit.

Për këtë arsye, udhëheqja politike e këtyre vendeve është përcaktuesi thelbësor i asaj se a do të ecin këto shoqëri në përparim, apo do të ngecin. Rasti i Millosheviqit është një dëshmi ilustrative për këtë të dytën. Mirëpo mund të gjenden edhe shembuj pozitiv, çfarë ishte, për shembull, vetpërmbytja e Bullgarisë lidhur me çështjen e Maqedonisë, nën udhëheqjen e Zhelevit. Kryeministri i tashëm, Stojanov, është duke treguar gatishmëri për realizimin e reformave. Ish-Presidenti i Maqedonisë, Kiro Gligorov, është përpjekur që ta gjente një modus vivendi aspak të lehtë ndërmjet sllavëve dhe shqiptarëve, ndërkohë që Presidenti Gjukanoviç është duke e udhëhequr Malin e Zi drejt një demokracie më të madhe.

Një dekadë e luftimeve, duke e përfshirë këtu edhe intervenimin në Kosovë, është njëkohësisht edhe pasojë dhe edhe shkak i krizës së legjitimitetit.¹⁵ Kjo e tëra, bashkëpunimin rajonal e bën tepër të vështirë dhe me gjasa fare të vogla. Ndërkohë që roli i Bashkësisë Ndërkombëtare është duke u zhvendosur nga intervenimi dhe “siguria e fortë,” në drejtim të çështjeve të rindërtimit dhe të “sigurisë së butë,” ajo duhet të jetë gjithnjë e më e përgatitur që të përballet jo vetëm me konfliktin etnik, por edhe me çështje të tjera, çfarë janë kriminalizimi i ekonomisë dhe dobësia e institucioneve të shtetit. Që të dyja këto çështje e kërkojnë një qasje rajonale.

Këto analiza shpiejnë në disa rekomandime të mundshme. Së pari, Bashkësia Ndërkombëtare duhet të bëjë më shumë për t'i ndihmuar aktorët joshtetërorë. Ajo mund ta ndihmojë shoqërinë civile jo vetëm që të organizohet jashtë strukturave të korruptuara të shtetit, por, po ashtu, edhe për të ndihmuar në “ndërtimin e shtetit” (institucionet, sundimin e ligjit, etj). Për më tepër, duhet të arrihet një bashkëpunim më aktiv ndërkombëtar për ta luftuar krimin. Në këtë drejtim, janë me rëndësi fundamentale përpilimi i legjisllacionit adekuat dhe veprimi efikas i mekanizimit shtetëror. Sipas të gjitha gjasave, i vetmi organizim funksional gjatë tranzicionit në këtë rajon është mafia. Në këtë mënyrë, qeverisja e korruptuar, si edhe konfliktet

etnike, e paraqesin pengesën më të madhe për bashkëpunimin rajonal.

Një karakteristikë tjetër e Ballkanit, e cila e bllokoi krijimin e skemave të bashkëpunimit rajonal të pasluftës, është heterogjeniteti i tij, qoftë në aspektin e zhvillimit të brendshëm (nivelet e ndryshme të realizimit të tranzicionit ekonomik dhe politik ndërmjet të shteteve të ndryshme të rajonit), qoftë edhe në aspektin e statusit ndërkombëtar (në veçanti, lidhur me dallimet e raporteve të tyre me BE-në). Serbia është braktisur nga Bashkësia Ndërkombëtare. Kroacisë i është shndërruar në obsesion që të trajtohet si vend i Evropës Qendrore dhe jo ballkanik, dhe për këtë arsye ajo deri më tash ka ngurruar që të angazhohet më tepër rreth bashkëpunimit në Ballkan. Bullgaria dhe Rumania i kanë disa ato politike, por fare pak nga ato ekonomiket, të nevojshme për bashkëpunimin rajonal. Bosnja dhe Kosova janë nën “protektorat ndërkombëtar,” ndërkohë që për shtetet fqinje, Shqipërinë dhe Maqedoninë, mund të thuhet se janë nën një “gjysëm-protektorat.” Greqia, anëtare e NATO-s dhe e BE-së, e ka luajtur një rol të dyfishtë dhe jo kushedi sesa ndihmues gjatë pjesës më të madhe të viteve ‘90. Turqia do të dëshironte që ta merr sërish një rol rajonal, por shumica e vendeve ballkanike atë e shohin si një shtet tepër të madh, dhe madje edhe kërcënues, po t’i jipej një rol i tillë.

Përbrenda vet rajonit, njerëzit e kanë dronë lidhur me projektet më ambicioze të bashkëpunimit, për dy arsye. E para, sepse këto skema shihen si një përpjekje e sfurcuar nga jashtë, për ta rikrijuar një Jugosllavi të re. As në Slloveni, as në Kroaci dhe as në Kosovë, nuk e gjen askend që do të dëshironte madje edhe të dëgjojë për këtë. Arsyeja tjetër se pse njerëzit janë të rezervuar, është ajo që integrimi rajonal, i inkurajuar nga evro-perëndimorët, është një zëvendësim për diçka reale, d.m.th. për integrimin në BE. Ish-Presidenti i Maqedonisë, Kiro Gligorov, njëri nga liderët më me përvojë dhe më të moderuar të rajonit, në marsin e vitit 1998 pat deklaruar:

Marrëdhëniet ndërmjet vendeve të rajonit të Ballkanit duhet të mbështeten në parimet e marrëdhënieve të reja evropiane (...) Mundësitë e bashkëpunimit ekonomik janë të kufizuara. Vendet e Ballkanit janë vende të vogla me tregje të vogla. Lënia e rajonit jashtë Evropës, duke e përkrahur rekomandimin për partneritetin miniaturial për paqe, nuk paraqet zgjidhje fare. Maqedonia nuk ngurron lidhur me bashkëpunimin rajonal. Megjithatë, nuk duhet të kushtëzohet asociimi dhe integrimi me të tërë rajonin, por kjo duhet bërë me secilin vend veçmas, varësisht nga niveli i zhvillimit të demokracisë. Sepse shtetet më pak të zhvilluara – në kuptimin e ekonomisë, sistemeve juridike, demokracisë, të drejtave të minoriteteve – do ta ngadalësonin integrimin e shteteve të tjera.

Një zgjidhje e re: Pakti i Stabilitetit

Në një gjendje të tillë, me përfundimin e luftës në Kosovë, Bashkësia Ndërkombëtare e propozoi Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Risitë e Paktit të Stabilitetit, i cili u përpilua në fundin e korrikut, në Sarajevë, janë të dyfishta: e para, ai e propozon një qasje koherente rajonale, përpos në rastin e udhëheqjes së vatrave të veçanta të krizës, si në Kosovë e në Bosnje. Siguria, rindërtimi ekonomik dhe demokracia, paraqiten si aspekte komplementare të procesit, i cili e ka për qëllim rritjen e stabilitetit në rajon. Dhe, e dyta, ndonëse Pakti i Stabilitetit është një nismë e gjerë ndërkombëtare, BE-ja e ka rolin udhëheqës, jo vetëm në jetësimin e tij, por edhe në mundësimin e ndërlidhjes së qenësishme politike ndërmjet procesit të sigurisë rajonale, nga njëra anë, dhe perspektivës së integritetit evropian, nga ana tjetër. Kjo qasje e re, e cila e ndërlidh rindërtimin e pasluftës, bashkëpunimin rajonal dhe të ardhmen afatgjatë evropiane, pa i përmendur fare këtu fondet e konsiderueshme të premtuara, i rrit gjasat që Pakti i Stabilitetit do të ketë rezultate të suksesshme në rajon.

Është e padyshimtë që pakti e ka pasë një efekt pozitiv në sigurimin e investimeve të nevojshme për së tepërmi për projektet e infrastrukturës dhe për inkurajimin e vetëdijes për ndërvarsi rajonale. Deri më tani, dalja nga Ballkani është shikuar shumë shpesh si rruga më e shpejtë për bashkim me Evropën. Ndërlidhja e bashkëpunimit rajonal me të ardhmen në Evropë, është një hap i rëndësishëm i shkëputjes nga mentaliteti mbizotërues gjatë dekadës së fundit.

Megjithatë, pas një viti u shfaqën problemet e para lidhur me konceptin dhe jetësimin e Paktit të Stabilitetit. E para, që të dy këto procese – ai i stabilizimit politik, dhe ai i rindërtimit ekonomik, nuk bënë të ngatërrohen dhe “nuk janë konvergjente me çdo kusht.”¹⁶ Procesi ekonomik nuk e forcon automatikisht edhe procesin politik, posaqërisht nëse disa nga faktorët kyç të rajonit (p.sh Serbia) lihen jashtë. Dhe e dyta, dhe më e rëndësishmja, ekziston një kundërtënie implicite në përpjekjet për t’i kombinuar strategjitë, dhe e cila bazohet tek rajonalja dhe kushtëzuesja. Pakti i Stabilitetit bazohet në aspektin rajonal si parim, ndërkaq procesi i asociimit me BE-në, bazohet në parimin e kushtëzimit. Parimi i parë e ka pikënisje vlerësimin që problemet rajonale kërkojnë zgjidhje rajonale. Megjithatë, kur të dihet copëzimi politik dhe ekonomik i rajonit, një integrim i tillë rajonal është i pamundur pa një kornizë të përbashkët evropiane. Në anën tjetër, logjika e procesit të zgjerimit të BE-së, e bazuar në kushtëzim, i krijon disa marrëdhënie të reja, dhe në këtë mënyrë edhe diferencime të reja: Sllovenia, Rumania dhe Bullgaria (dhe mbase shumë shpejt, edhe Kroacia), tash-

më i kanë filluar negociatat për t'u pranuar në BE, që i vë ato në një pozitë në tërësi të ndryshme nga ajo e Shqipërisë dhe Maqedonisë, të cilat kanë filluar negociatat lidhur me Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit, pa i përmendur këtu fare Bosnjen dhe Kosovën, për të cilat anëtarësia në BE nuk shihet si mundësi reale. Ekziston rreziku i margjinalizimit të të ashtuquajturit Ballkan Perëndimor si një fuqi baroti, e cila ruhet që të mos shpërthejë vetëm me ndihmën e pranisë së vazhdueshme ushtarake ndërkombëtare. Kështu, sipas disa kritikëve të Paktit të Stabilitetit, “BE-ja de facto është duke e ndarë rajonin me dorën e majtë, në të njëjtën kohë në të cilën e afirmon bashkëpunimin multilateral ndërmjet vendeve të po të njëjtit rajon, me dorën e djathtë.”¹⁷ Në këtë situatë, këtu shfaqet një qasje e dyfishtë: logjika e integritimit dhe e zgjerimit të BE-së, dhe logjika e intervenimit dhe e protektorateve. Për ta bërë Paktin e Stabilitetit të realizueshëm fare, duhet që BE-ja t'i rishqyrtojë marrëdhëniet ndërmjet dallimeve në procesin e para-pranimit dhe të qëllimeve të bashkëpunim-integritimit rajonal.

Njëri nga opsionet për ta kapërcyer këtë kundërthënie, është rishikimi dhe përshejtimi i procesit të zgjerimit të BE-së, duke e respektuar më shumë frymën e premtimeve të bëra gjatë intervenimit të NATO-s, kohë kjo kur Pakti i Stabilitetit edhe u konceptua. Gjatë fjalimit të tij në Sofje, më 17 maj 1999, Toni Bler deklaronte: “Ne do të tregojmë se angazhohemi dhe se e kemi për obligim që ta ndihmojmë këtë rajon që ta arrijë një të ardhme tjetër, atë të anëtarësimit në BE dhe në NATO.” Në këtë mënyrë, në fundin e luftës, në Kosovë janë bërë propozime për një proces të përshejtuar të anëtarësimit të pjesshëm të vendeve të rajonit. Qendra për Studime të Politikës Evropiane e përkrahte një qasje më të guximshme sesa BE-ja, përmes një “anëtarësimi të ri në trajtë të asociimit” për vendet e Evropës Juglindore, duke filluar me aplikimin e Euros në Kosovë.¹⁸ Masat e tjera të propozuara, përqendroheshin në një integrim funksional, dhe e kishin për qëllim që t'i jipnin përmbajtje konceptit të anëtarësisë speciale ose të asociuar. Këtu hyjnë propozimet që nga Zona Ekonomike Evropiane, e deri te qasja preferenciale në tregjet e BE-së për vendet e rajonit.

Kjo qasje përshejtuese, politikisht e paraqet një depërtim të rëndësishëm, meqë i kombinon vullnetin politik me mjetet ekonomike. Megjithatë, janë dhënë edhe disa vërejtje me vend, lidhur me atë të cilën disa e kanë quajtur “dritë zgjerimi” – për shembull, që qasja e përshejtuar do të mund ta diskreditonte vetë procesin e zgjerimit si tërësi, dhe se kjo do të mund të trajtohej si jokorrekte ndaj vendeve të Evropës Qendrore, të cilat me durim janë përfshirë duke i futur nëpër legjislacionet e tyre nga 80.000 faqe të “acquis communautaire,” të domosdoshme për anëtarësim. Mënyra më e mirë për t'i dhënë kredibilitet politikës evropiane në Ballkan, thuhet më tutje në

këtë vlerësim, është që procesi i zgjerimit të përshejtohet në të njëjtën kohë edhe në vendet e Evropës Qendrore, të cilat patën sukses në tranzicionin e tyre demokratik dhe e krijuan një ambient stabil e bashkëpunues rajonal (i ashtuquajtur i Grupi i Vishegradit, i cili i përfshin Poloninë, Republikën Çeke, Hungarinë dhe Sllovakinë).

Pakti i Stabilitetit e synon zhvillimin e një strategjie ekonomike rajonale. Konferenca e donatorëve, e cila u mbajt në Bruksel gjatë marsit të vitit 2000, i premtoi rreth 2 miliardë Euro, për financimin e projekteve të rindërtimit. Programi i “fillimit të shpejtë” të Paktit të Stabilitetit, i kategorizoi këto projekte në tri grupe: 84% ishin të rezervuara për projektet e rindërtimit, 12% për demokratizim dhe 4% për çështjet e sigurisë. Për shkak të rëndësisë së madhe e cila i jipet pjesës ekonomike të programit, është e një interesi të veçantë të theksohen disa nga problemet që kanë të bëjnë me propozimet e dhëna për strategjinë ekonomike të rajonit.

Së pari, në strategjinë që Banka Botërore e propozoi për këtë qëllim, thuhet se “faktor i më kryesor që i ka shkaktuar të arriturat e dobëta ekonomike të rajonit të tërë [të Evropës Juglindore], është mungesa e përparimit në kalimin në ekonomi të tregut.”¹⁹ Ndërkaq, për këtë të fundit, çelës i suksesit është privatizimi. Sidoqoftë, thelbi i tranzicionit në Ballkan, nuk qëndron vetëm në faktin që aty baza fillestare është shumë më e ulët sesa në Evropën Qendrore, por edhe në atë që rajoni duhet t’i tejkalojë, po ashtu, edhe pasojat e tranzicionit të dështuar. Prandaj, sfida kryesore duket se është se si duhet kombinuar qasja e “zhvillimit të rajonit,” ndërtimit të infrastrukturës fizike, si dhe të infrastrukturës së domosdoshme institucionale, gjë që do t’i krijonte kushtet për fillimin e sundimit të ligjit, e që do ta mundësonte “tranzicionin e dytë,” i cili do të ishte më i suksesshëm sesa i pari. Angazhimi vetëm për privatizim në kushtet që mbizotërojnë në Kosovë (apo në Shqipëri e Serbi), e mbart me vete rrezikun e kalimit të një pjese substanciale të ekonomisë nën kontrollin e elementeve kriminale.

Së dyti, projektet kryesore të infrastrukturës janë më se të domosdoshme, dhe në veçanti zhvillimi i komunikacionit. Komunikimi Lindje-Perëndim, rrugët dhe hekurudhat, janë të një rëndësie jetike për ta zvogëluar varshmërinë nga komunikimet Veri-Jug, sepse këto të fundit janë dëmtuar për së tepërmi nga lufta. Nga ana tjetër, për tejkalimin e problemeve të papunësisë duket që mënyra me efikase do të ishte mbështetja në ndërmarrjet e vogla. Ndërkaq, sigurimi i fondeve për projektet e tilla të vogla nuk është përfillur fare.

Dhe, së fundit, po ashtu shtrohet edhe çështja e tregtisë së lirë, si pjesë përbërëse e strategjisë ekonomike rajonale. Krijimi i Zonës së Lirë Tregtare për Ballkanin dhe, hiç më pak e rëndësishme, qasja e lirë e rajonit në tregjet e BE-së, janë pa dyshim kompo-

nentet përbërëse kryesore të një integrimi ekonomik rajonal potencial. Megjithatë, rindërtimi i pasluftës në Kosovë, i dëshmon disa nga kundërthëniet e qenësishme të strategjisë së Paktit të Stabilitetit: nga njëra anë, përkrahet liberalizimi i tregtisë rajonale, ndërkaq, nga ana tjetër, rekomandohet që Kosova t'i përcaktojë obligimet doganore me qëllim të grumbullimit të të ardhurave fiskale të nevojshme për administratën e re të Kosovës.

Është pritur shumë nga Pakti i Stabilitetit, mirëpo, në vitin e parë ky ka arritur rezultate relativisht të pakta. Prandaj edhe është shfaqur rreziku që ky pakt të dështojë, ose të shndërrohet në një faktor irrelevant, nëqoftëse do të vazhdojë të mbetet, në thelb të vetin, një koncept i cili pas përfundimit të intervenimit ushtarak rajonit iu imponua nga lart, pa i patur parasysh të dhënat adekuate mbi rajonin, dhe pa kurrfarë ndjenje të identifikimit me të. Pakti i Stabilitetit do të ngelet, thjesht, vetëm një kështjellë nga letra, po qe se projektet e tij nuk fillojnë të zbatohen nga poshtë, në bazë të identifikimit të nevojave dhe të çështjeve në të cilat duhet të përqendrohen projektet, si dhe të aktorëve lokal të cilët do ta bëjnë jetësimin e këtyre projekteve. Ky do të mund të ketë sukses vetëm po qe se dëshira për t'iu bashkuar Evropës, në radhët e elitës politike dhe ekonomike të Evropës Juglindore, do të jetë më e fuqishme sesa agjendat nacionaliste dhe veprimet e korruptuara.

Në këtë mënyrë, analizat e Paktit të Stabilitetit i parashatrojnë disa çështje të ndaluara. A është e mundur që në Ballkan të bartet modeli i BE-së për siguri të përbashkët e cila mbështetet në ndërvarsi, përmes imponimit nga jashtë i cili i kombinon kushtëzimin me ndihmë? A është e mundur që një model i cili mbështetet në shumëllojshmërinë e interesave, si dhe në kulturën e negociatave dhe të kompromiseve të përhershme, ta mbizotërojë politikën e identitetit dhe të shfrytëzimit të frikës e të epsheve nacionaliste nga elita post-komuniste, e cila është e bindur që logjika e integritimeve e paraqet rrezikun më të madh për pushtetin e saj? Edhe pse zgjidhjet e këtyre dilemave mund të duken të pasigurta, alternativa e tyre është plotësisht e qartë: një rajon i shteteve të dështuara me protektorate afatgjata, një periferi jostabile dhe e marginalizuar e kontinentit, përjetësisht e pakënaqur me Perëndimin, për shkak të një kombinimi të përhershëm të shpresave tepër të mëdha me hidhërimet tepër të mëdha në Evropë. Mbi logjikën e shtrëngimit dhe të ndalimit të konflikteve, dhe të krijimit të protektorateve humanitare, testi real i çështjeve morale të cilat do të mund ta legjitimonin intervenimin në Kosovë, do të jetë aftësia e BE-së për ta ruajtur një angazhim afatgjatë të mbështetjes së krimit të një të ardhmeje evropiane për Ballkanin.

9. Statusi i ardhshëm i Kosovës

Çfarëdo diskutimi lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, duhet t'i ketë parasysh katër elemente thelbësore:

Raportin e saj me RFJ-në;

Raportin e institucioneve kosovare të vetëqeverisjes me vazhdimin e ndonjë pranie administrative të OKB-së, si dhe me praninë e sigurisë së NATO-s, d.m.th. të KFOR-it;

Karakterin e kufijve të Kosovës, si dhe raportet e saj me shtetet fqinje;

Përcaktimin e Kosovës si entitet në kuadër të Bashkësisë Ndërkombëtare.

Pikënisje e çdo diskutimi lidhur me të ardhmen e Kosovës duhet të jetë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, e qershorit 1999. Kjo Rezolutë e ka krijuar një hibrid të veçantë politik dhe institucional, dhe ky është një protektorat i OKB-së me kompetenca të pakufizuara, qëllimi i të cilit është përgatitja e vendit për autonomi substanciale dhe vetëqeverisje. Këtu manifestohet një tendosje ndërmjet pushtetit të pakufizuar që i është dhënë Administratës së OKB-së, dhe synimit të saj për bartjen e këtij pushteti në duart e popullit të Kosovës. Çështja kryesore lidhur me statusin e ardhshëm lidhet me mënyrën se si do të menaxhohet kjo tendosje: a është e nevojshme që OKB-ja të përpiqet që “ta nxjerr veten jashtë lojës,” apo i nevojitet që të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, deri sa populli i Kosovës të bëhet i gatshëm për vetëqeverisje?

Një tendosje e ngjashme përvijohet edhe në mënyrën se si Rezoluta 1244 e sheh statusin e ardhshëm të Kosovës. Kjo rezolutë e riafirmon integritetin territorial të RFJ-së, në të njëjtën kohë në të cilën premton “autonomi substanciale dhe vetëqeverisje” për popullin e Kosovës. Sovraniteti i Jugosllavisë në Kosovë, as nuk është abroguar dhe as nuk është revokuar, ky, thjesht, është pezulluar, dhe në vend të tij, OKB-ja i ka kompetencat për administrimin dhe për përgatitjen e saj për një “autonomi substanciale dhe vetëqeverisje,” duke i lënë pezull negociatat e ardhshme për statusin politik përfundimtar. Në të njëjtën kohë, shprehja e sovranitetit të Jugosllavisë në Kosovë njihet edhe më tutje, ndonëse vetë ky sovranitet është pezulluar. Aneksi 2/6 i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, e lejon praninë serbe dhe jugosllave në provincë, me qëllim të mbajtjes së kontaktit me OKB-në dhe me KFOR-in, të ndihmës në pastrimin e minave, dhe, po ashtu, e lejon këtë prani në vendkalimet kufitare kryesore dhe

me qëllim të mbrojtjes së “vendeve të trashëgimisë serbe,” çfarë janë manastiret në Ulpianë/Graçanicë dhe në Deqan.

Gjatë vitit të parë të mandatit të OKB-së në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) u angazhua që ta siguronte pjesëmarrjen, edhe të përfaqësuesve të shumicës dhe edhe të atyre të pakicës në institucionet tranzitore, me qëllim të bartjes së autonomisë substanciale tek përfaqësuesit e popullit të Kosovës. Ai e proklamoi “agjendën e bashkëjetesës,” dhe u përpoq që t’i bindte edhe bashkësinë shumicë edhe atë pakicë, që vetadministrimi demokratik nga shumica shqiptare e Kosovës duhet të karakterizohet me respektimin e të drejtave të pakicave, dhe me përfshirjen e tyre në procesin politik. Udhëheqja politike e Kosovës e ka dhënë pëlqimin për këtë “agjendë të bashkëjetesës,” por për këtë nuk ekziston dëshira e vetë popullit. Ky ngurrim në përkrahjen e bashkëjetesës, ndihmon për t’i shpjeguar aktet e terrorit që janë duke u kryer kundër pjestarëve të grupeve pakicë. Ekstremistët që janë përgjegjës për këto akte mund të jenë të pakët në numër, mirëpo ata e gëzojnë përkrahjen pasive të një numri të madh përbrenda shumicës. Disa përpjekje të guximshme nga ana e disa udhëheqësve politikë dhe intelektualë të shqiptarëve të Kosovës për denoncimin e këtyre akteve të terrorit, nuk kanë dhënë rezultate në izolimin e grupeve të cilat i kryejnë këto akte.

Sa i përket grupit pakicë, një vit pas disfatës, serbët që kanë mbetur në Kosovë ende nuk po mund të pajtohen me këtë disfatë historike të tyre. Ata janë pakicë, mirëpo ende nuk duan ta pranojnë që janë pakicë. Kushtet në të cilat ata jetojnë nëpër enklava, me mbrojtje të forcave ndërkombëtare, janë tepër të vështira: ata nuk e kanë lirinë e lëvizjes, nuk e kanë mundësinë e punës, dhe vazhdojnë të jetojnë të frikësuar nga sulmet e mundshme. Nuk duhet të jetë befases fakti që udhëheqësit e tyre nuk janë treguar të gatshëm që të marrin pjesë plotësisht në punën e institucioneve të përkohshme.

Me qëllim të bindjes së shqiptarëve, serbëve dhe romëve të Kosovës që të ulen në të njëjtën tavolinë, në një situatë të konfliktit ndëretnik dhe me përplot vështirësi të tjera me të cilat duhej të ballafaqohej, PSSP-së iu desht ta krijonte përshtypjen që hapja e çështjes së statusit përfundimtar është e parakohshme. Do të ishte më mirë që çështjet lidhur me të ardhmen të lihen anash, deri në çastin kur aftësitë rindërtuese për të ardhmen do të rriten deri në atë masë sa që t’iu mundësojnë të gjitha palëve që t’i tejkalojnë më lehtë ngurrimet e tashme për të punuar bashkërisht. Shembujt e tjerë të përparimit të paqes, e dëshmojnë që prolongimi i çështjeve që kanë të bëjnë me statusin final, mund të jetë lehtësim për zgjidhjen përfundimtare. Dialogu ndërmjet

palestinezëve dhe izraelitëve, për shembull, varet nga prolongimi i çështjes së statusit final, deri sa të tejkalohen pengesat e tjera. Me fjalë të tjera, ka raste kur palët në konflikt mund të nxiten që ta bëjnë hapin e parë drejt pajtimit politik, vetëm po që se destinimi final i procesit nuk hapet para kohe.

Ekzistojnë, po ashtu, edhe arsye të jashtme për prolongimin e diskutimit të statusit të ardhshëm. Për momentin, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nuk ka konsensus lidhur me të ardhmën e Kosovës. Ekzistojnë edhe më tutje dallime akute ndërmjet anëtarëve të përhershëm të cilët e përkrahën aksionin ushtarak të NATO-s më 1999, dhe të atyre që ishin kundër. Në qershor 2000, rusët dhe kinezët e miratuan përtëritjen e mandatit të UNMIK-ut, por vetëm për aq sa veprimet e PSSP-së do të jenë në përputhje me Rezolutën 1244. Mirëpo, përkrahja e tyre në të ardhmen nuk mund të merret si një punë e kryer. Rusët tashmë e kanë shprehur publikisht pakënaqësinë e tyre me veprimet e ndërmarra nga PSSP-ja, e të cilat duken si një devijim nga fryma e Rezolutës 1244, me siguri për shkak të miratimit të markës gjermane dhe të dështimit për t'i zbatuar dispozitat e Aneksit 2/6, i cili e parasheh qasjen e personelit të RFJ-së në rajon. Ndonjë propozim, përfshirë këtu edhe ato të këtij Komisioni, i cili do të synonte që të lëvizet përtej kornizës së Rezolutës 1244, mund ta thyejë konsensusin edhe ashtu të brishtë në Këshillin e Sigurimit, e i cili është i domosdoshëm për vazhdimin e mëtutjeshëm të mandatit të UNMIK-ut dhe të KFOR-it.

Komisioni e ka plotësisht të qartë që çështja e statusit përfundimtar është një temë tepër e ndieshme, dhe se ekzistojnë argumente të forta për shtyrjen e diskutimit gjatë kësaj faze.

Komisioni, megjithatë, e beson që kjo çështje duhet diskutuar deri në detaje, sepse një kornizë e mençur dhe e përpiluar me kohë, është një faktor i rëndësishëm nga i cili në masë të madhe do të varet se a do të jetë vetë procesi i tranzicionit i suksesshëm apo jo. Komisioni e beson që, edhe pse Rezoluta 1244 ka shërbyer në mënyrë të dobishme si një emërues i përbashkët për arritjen e marrëveshjes në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, kjo dobi përfundon aty ku do të fillojë përpilimi i kornizës së tranzicionit në autonomi dhe në vetëqeverisje. Procesi i tranzicionit, i inicuar nga PSSP-ja, e krijon një dinamikë e cila shumë shpejt do ta kërkojë qartësimin e caktuar final në drejtimin e proceseve të cilat ky tranzicion do t'i fillojë. Zgjedhjet komunale janë planifikuar për tetor të vitit 2000, ndërkaq, zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës janë paraparë për vitin 2001. Kur zyrtarët e zgjedhur t'i marrin detyrat e tyre, ata do të kërkojnë të dijnë se sa pushtet u takon, dhe se kur do të ndodhë tranzicioni në një vetëqeverisje të plotë. Edhe pse PSSP-ja do të vazhdojë të jetë autoritet formal mbi zyr-

tarët e zgjedhur lokal, OKB-ja nuk do të mund ta prolongojë çështjen e statusit, një herë pasi që Kosova ta ketë udhëheqjen e vet të zgjedhur në mënyrë demokratike. Përderisa në Kosovë të mos hapet një dialog sistematik ndërmjet të bashkësive shumicë dhe pakicë, ekziston një rrezik serioz që i tërë aktiviteti tranzicional do të fillojë të shndërrohet dalngadalë, në një konflikt ndërmjet të administratës së OKB-së me pushtet tranzicional, dhe të udhëheqjes së zgjedhur vendore e cila do të bëjë trysni që të marrë kompetenca të plota. Pikërisht për këtë arsye, Bashkësia Ndërkombëtare duhet të jetë plotësisht e përgatitur që të ballafaqohet me këtë sfidë, duke patur përgjigje të qarta mbi atë se ku synon ta përfundojë procesin e tranzicionit i cili është në zhvillim e sipër.

Edhe nga aspekti i jashtëm, Rezoluta 1244 e ka arritur fundin e jetës së vet të dobishme si një kornizë për menaxhimin e të ardhmes së vendit. Kërkesat e saj thelbësore për sovranitet të RFJ-së dhe për autonomi të Kosovës, mund të mos jenë të papërputhshme në teori, mirëpo këto janë të papërputhshme në praktikë. Pas të gjithë asaj të cilën e kanë përjetuar nën pushtetin e RFJ-së, shqiptarët e Kosovës janë unanim në refuzimin e tyre për ta pranuar çfarëdo shtrirje reale të sovranitetit të RFJ-së në provincë. Kjo është arsyeja kryesore se pse Karl Bild, i dërguar special i Sekretarit të Përgjithshëm në Ballkan, kohë më parë, në raportin dërguar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e kishte konstatuar që një “ndarje e pastër kushtetuese” ndërmjet Kosovës dhe RFJ-së, tashmë është bërë e pashangshme.¹ Këto konstatime e kanë nxitur Komisionin që t’i shqyrtojë opsionet e ndryshme lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, e të cilat e tejkalojnë kornizën aktuale të caktuar më Rezolutën 1244.

Pesë mundësi

Sipas mendimit të Komisionit, ekzistojnë pesë opsione për të ardhmen e Kosovës. Në vazhdim do ta bëjmë një vlerësim të pikave më të forta dhe të atyre më të dobëta për katër nga këto opsione, dhe do ta paraqesim elaborimin e rekomandimit tonë.

Protektorati

Në esencë, ky opsion e paraqet status quonë e tashme, si administrim i Kosovës nga UNMIK-u, i cili do të vazhdojë me një kohëzgjatje të pacaktuar. Ky mandat, në bazë të Rezolutës 1244, do të përtërihet çdo vit, dhe nën mandatin e saj, në kuadër të vazhdimit të sovranitetit të RFJ-së në provincë, administrata e OKB-së do të përpiqet

t'i zgjerojë kompetencat e vetëqeverisjes në nivelin lokal dhe në nivelin e Kosovës. Çështja se a do të mbetet ky sovranitet në tërësi rudimentar, apo do të fillojë të mëkëmbet edhe prania e sigurisë së RFJ-së në kufi dhe në pikat e trashëgimisë së saj brenda Kosovës, do të varet nga vlerësimi i OKB-së lidhur me situatën e sigurisë dhe nga negociatat me regjimin e Serbisë.

Autonomia dhe vetëqeverisja që do të ushtrohen nga zyrtarët e zgjedhur në zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme, do të vijë duke u zgjeruar, dhe UNMIK-u si personel dhe si kompetencë, do të vijë duke u zvogëluar, mirëpo fjalën e fundit të pushtetit edhe më tutje do të vazhdojë ta ketë PSSP-ja dhe administrata ndërkombëtare.

Opsioni i protektoratit, në thelb të vetin, e nënkupton atë që pavarësisht nga ato që i ka premtuar Rezoluta 1244, bashkësitë e shumicës dhe të pakicës në Kosovë nuk janë të gatshme për "autonomi substanciale dhe vetëqeverisje." Regjimi i mëkëmbur me Rezolutën 1244 mund t'i premtojë këto synime, mirëpo ky këto nuk mund t'i përmushë, përpos si të kufizuara dhe të pjesërishme, nën mbikëqyrjen ndërkombëtare nga administrata e OKB-së. Dyshimet dhe armiqësitë ndërmjet grupeve etnike janë aq të mëdha, sa që t'i lejohet shumicës që ta ushtrojë një pushtet të plotë të vetëqeverisjes, pa ndonjë mbikëqyrje nga regjimi i protektoratit, don të thotë që pakicat do të vazhdojnë të jenë në rrezik.

Një vazhdim i pakufishëm i regjimit të Rezolutës 1244 e ka njëfarë mbështetje brenda shumicës së shqiptarëve të Kosovës, në radhët e atyre të cilët dyshojnë në aftësitë e elitës ekzistuese lokale për t'i dalë zot vetëqeverisjes plotësisht. Pos kësaj, një protektorat ndërkombëtar me kohëzgjatje të pacaktuar sjell edhe përfitime ekonomike të mëdha - rroga dhe vende pune për vendorët - dhe këta vendorë, natyrisht se shpresojnë që këto përfitime do të zgjasin sa më shumë që të jetë e mundur. Bashkësitë pakicë mund të mos e mbështesin status quonë e mëkëmbur nga Rezoluta 1244, mirëpo këto kanë frikë se çfarë do të ndodhë me ta po qe se shumica etnike siguron më shumë pushtet, dhe, po ashtu, kanë frikë se çfarë do të ndodhë me sigurinë e tyre po qe se prania ushtarake dhe administrative ndërkombëtare zvogëlohet.

Vështirësia kryesore lidhur me zgjatjen për një kohë të pacaktuar të regjimit të Rezolutës 1244, është që kjo krijon frustrime lidhur me kërkesën pothuaj universale të shumicës, d.m.th. të shqiptarëve të Kosovës, për ta marrë në dorë fatin e tyre. Që nga fillimi i viteve '90, kërkesa për vetëvendosje, e shprehur qoftë si kërkesë për autonomi apo për pavarësi, ka qenë një kërkesë unike e të tërë spektrit politik të shqiptarëve të Kosovës. Ndonjë pjesë e përkrahjes për të ardhmen politike në kuadër të RFJ-së, e cila do të përfshinte qoftë edhe vetëm autonomi në kuadër të RFJ-së, është

zhdukur në mars të vitit 1999, kur forcat e RFJ-së e filluan aksionin e dëbimit të tërë popullatës shqiptare të Kosovës. Madje, edhe zbatimi substancial i vetëqeverisjes autonome, tani shihet si i pamjaftueshëm. Shumica e shqiptarëve të Kosovës e shohin intervenimin e NATO-s të vitit 1999, si një fitore në luftën e gjatë për pavarësi kombëtare. Prandaj, ata edhe e perceptojnë protektoratin e mëkëmbur me Rezolutën 1244 vetëm si një arranzhim “kalimtar,” i cili duhet të shpie në vetëadministrim të plotë nga shumica. Gjuha e Rezolutës 1244, gjithsesi e inkurajon popullatën që të besojë se UNMIK-u është pushtet “tranzicional,” i cili duhet të zëvendësohet me institucionet e përhershme të vetëqeverisjes.

Institucionet tranzicionale do të kenë sukses, për aq sa do ta kenë pëlqimin e heshtur të shumicës kosovare dhe ngurrimin e heshtur të pakicës. Sa më gjatë që Bashkësia Ndërkombëtare do ta mbajë pushtetin kryesor, dhe sa më shumë që ajo ta shtyjë vetëqeverisjen efektive, aq më të mëdha janë gjasat që përfaqësuesit e shumicës do të tërhiqen nga institucionet tranzicionale, ose për t'i krijuar institucionet e tyre paralele, ose për ta katandisur provincën në një gjendje pa qeverisje. Me fjalë të tjera, përkrahja për institucionet tranzicionale nuk mund të jetë e qëndrueshme, po qe se këto nuk shihen si një kalim gradual i kompetencave nga UNMIK-u tek vendorët.

Kjo nuk do të thotë që Bashkësia Ndërkombëtare duhet që, thjesht, të zbrapsset para dëshirave të shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Ajo duhet, po ashtu, t'i përmbushë obligimet e veta lidhur me nevojat dhe frikën e pakicave të Kosovës. Edhe administrata e OKB-së, dhe edhe KFOR-i, e kanë marrë një përgjegjësi substanciale për mbrojtjen e tyre, dhe faktori kyç në bazë të të cilit do të vendoset lidhur me momentin për zgjerimin e vetëqeverisjes së Kosovës është siguria e këtyre pakicave. Frika që vetëqeverisja në trajtë të pushtetit të shumicës do të rezultojë me vrasje dhe dëbime të popullatës së mbetur rome dhe serbe, mbesin arsyeja kryesore e vazhdimin të protektoratit për një kohë të pacaktuar. Nga ana tjetër, zgjatja për një kohë të pacaktuar, në një mënyrë të pashmangshme do ta acarojë shumicën e popullatës. Kjo është kundërthënia thelbësore, e cila, thjesht, e bën të pamundur zgjatjen e regjimit të Rezolutës 1244 për një afat të pacaktuar. Sikur në momentin e tanishëm autonomia dhe vetëqeverisja të barteshin tek shumica, pakica do të shtypej dhe - fare lehtë e mundur - edhe dëbohej. Dhe nga ana tjetër, sikur administrata e OKB-së të mbetej edhe më tutje, duke ia mohuar shumicës autonominë dhe vetëqeverisjen substanciale, me qëllim të mbrojtjes së pakicës, rezistenca e shumicës, atëherë, do ta bënte të pamundur të vepruarit e administratës së OKB-së.

Ndarja

Dhuna e tanishme e cila është duke u ushtruar ndaj pakicave në Kosovë, së bashku me gjendjen emergjente në Veri të Mitrovicës dhe në disa qytete të tjera të Kosovës me enklava serbe, e bën të logjikshëm shqyrtimin e mundësisë për ndarjen e provincës, si njëra nga zgjidhjet afatgjate. Në aspektin normativ, gjatë shqyrtimit të ndarjes duhet të merret parasysh që populli serb është duke u thirrur në histori që të vazhdojë të jetojë në Kosovë. Në aspektin praktik, ndarja formale, e negociuar ndërmjet pushtetit serb në Beograd, dhe të përfaqësuesve të Bashkësisë Ndërkombëtare, do ta ratifikonte ndarjen etnike de fakto të provincës, e cila është bërë pas qershorit 1999. Kjo do të presupozonte që serbët nuk mund të jetojnë njëri pranë tjetrit me shqiptarët e Kosovës, as tash, dhe as në të ardhmen. Ndarja do ta sillte konsolidimin e serbëve të mbetur në provincë në zonën e përbashkët në Veri të lumit Ibër, pra të rajonit që është në afërsi të kufirit me Serbinë. Kjo, po ashtu, do ta lehtësonte divorcin ndërmjet dy bashkësive, duke iu bërë të mundur krijimin e një të ardhmeje politike të pavarur, dhe atë për secilën veçmas. Duke u pajtuar për ndarje, RFJ-ja do të hiqte dorë nga kërkesat e saj për pjesën e Kosovës në jug të Ibrit, dhe kjo do të mundësonte që kjo pjesë e Kosovës në Jug të Ibrit të bëhej në tërësi e pavarur nga RFJ-ja. Gjatë ndarjes, çështja e mbrojtjes së monumenteve kulturore dhe historike, si dhe kompensimi i pronave të humbura apo të braktisura me rastin e transferit të popullatës, do të rregullohej me dispozita të veçanta në një marrëveshje e cila do të bëhej dhe aprovohej nga të dyja palët gjatë ndarjes. Në këtë rast do të ishte e nevojshme edhe një prani ndërkombëtare për ta mbikëqyruar kufirin.

Ndarja formale do t'u shërbente interesave të serbëve që jetojnë në rajonin e Veriut të Mitrovicës, ndërsa serbët që ndodhen në jug të Ibrit do t'i vinte para mundësisë së zgjedhjes për të vazhduar që të jetojnë nën pushtetin e shumicës së shqiptarëve të Kosovës, ose të kalojnë në zonat serbe në Veri të Kosovës apo edhe në vetë Serbi. Po ashtu, një ndarje e tillë, sipas të gjitha gjasave do të rezultonte me kalimin në pjesën jugore të të gjithë shqiptarëve të Kosovës që ende janë duke jetuar në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës. Me fjalë të tjera, ndarja do ta shkaktonte një lëvizje të detyrueshme të një numri të madh njerëzish nga që të dyja bashkësitë. Kjo do t'i krijonte dy territore të veçanta, ku secili do të ishte etnikisht homogjen.

Është vështirë të imagjinohet se si Bashkësia Ndërkombëtare, e cila nuk e miratoi ndarjen e Bosnjes, do të mund të pajtohej ose të niste ndryshime të tilla në Kosovë. Ndarja do të ishte shkelje e bazës normative të Bashkësisë Ndërkombëtare për t'i evituar zhvendosjet e detyrueshme, dhe për ta ruajtur mozaikun e përzier të komu-

niteteve të Ballkanit. Duke i ditur përmasat e ndarjes de fakto, verëhet që ky angazhim normativ ka qenë i vështirë për t'u ruajtur në Kosovë, mirëpo, një braktisje e tanishme e kësaj baze normative do ta detyronte administratën e OKB-së që të pranojë që përpjekjet e saj të gjithmbarshme për të krijuar forma tranzicionale të bashkëpunimit politik kanë dështuar.

Një kundërshtim edhe më i fuqishëm për mundësinë e ndarjes është se ajo është e papranueshme për të gjitha pjesët e popullatës shumicë të shqiptarëve të Kosovës, madje edhe në qoftë se quid pro quo do të ishte njohja serbe e pavarësisë për pjesën tjetër të provincës. Po ashtu, ndarja do t'ia merrte popullatës shumicë pjesën veriore të kompleksit mineral të Trepçës. Edhe pse shfrytëzimi ekonomik i pasurive të Trepçës ka qenë më i vogël sesa që mendohet në opinion, me humbjen e Trepçës, provinca edhe ashtu e varfër do të mbetet pa edhe një burim të punësimit dhe të të ardhurave. Në këtë mënyrë, ndarja do t'i reduktonte kapacitetet ekonomike të Kosovës së pavarur. Edhe pse ndarja do të mund t'u jepte fund pretendimeve serbe ndaj Kosovës, kjo do ta krijonte një burim të përhershëm të pakënaqësive në radhët e popullatës shumicë të shqiptarëve të Kosovës, e që do të mund të ishte shkas për ndonjë konflikt të ardhshëm.

Mbi këto baza, Komisioni beson që ndarja formale është një opsion i padëshiruar. Komisioni po ashtu beson që nuk duhet të pranohet as ndarja ekzistuese de fakto e provincës, dhe se pushteti i Bashkësisë Ndërkombëtare duhet të rivendoset edhe në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës.

Pavarësia e plotë

Sipas këtij opsioni, i cili është dëshirë e shprehur dhe e kahmotshme e mendimit politik të popullatës shumicë, Kosova do të lëvizte me shpejtësi nga pozita e autonomisë dhe e vetëqeverisjes substanciale nën administratën e OKB-së, drejt pavarësisë së njohur ndërkombëtarisht si një komb-shtet. Procesi i pavarësimit do të fillonte me shpalljen e referendumit për pavarësi, nga parlamenti i parë në nivel të Kosovës, i zgjedhur nën administratën tranzicionale të OKB-së. Pasi të merrej vesh rezultati i mundshëm, d.m.th. mandati substancial popullor për pavarësi, pavarësia do të shpallej nga ana e parlamentit të zgjedhur. Pas kësaj, përmes administratës së OKB-së, parlamenti do ta kishte të drejtën që të negocionte për kushtet dhe afatet e pavarësisë me Bashkësinë Ndërkombëtare, me qeveritë e vendeve të Grupit të Kontaktit, dhe më në fund edhe me vetë Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Duke e siguruar pëlqimin ndërkombëtar për

pavarësi, Parlamenti i Kosovës do ta bënte hapin tjetër, duke e formuar Asamblenë Kushtetuese për të hartuar ligje, dhe për t'i formuar institucionet e shtetit të pavarur, qoftë duke i miratuar këto ligje në mënyrë të ngjashme si në kohën e administratës ndërkombëtare, apo duke i bërë de novo. Administrata tranzicionale e OKB-së do të mënjanohej, edhe pse një prani ndërkombëtare e sigurisë do të vazhdonte të mbetej në kufirin e Kosovës me Serbinë, deri në momentin kur Kosova të krijonte mundësi që ta mbrojë vetveten. Sipas këtij skenari, pavarësia e Kosovës do të shpallej nga përfaqësuesit e saj, dhe pastaj do të ratifikohej nga organet autoritative ndërkombëtare. Ajo nuk do të negociohej me serbët.

Përparësia politike e opsionit të pavarësisë së plotë është që ky do t'i kënaqte kërkesat e kamotshme të shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Pavarësia, njëkohësisht, do t'i jipte fund edhe tutelës së OKB-së, dhe do ta zhdukte sovranitetin gjithnjë e më fiktiv të RFJ-së në Kosovë. Kjo do t'i mundësonte popullatës shumicë të shqiptarëve të Kosovës që të jenë zot në shtëpinë e tyre.

Megjithë forcën tërheqëse që e ka ky opsion për shqiptarët e Kosovës, vështirësitë politike praktike që paraqitën si pengesë për pavarësi të plotë të Kosovës janë shumë të mëdha. Dy anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, Rusia dhe Kina, janë fuqimisht kundër këtij opsioni, duke deklaruar që dhënia e pavarësisë do të ishte shpërblim për lëvizjen secesioniste dhe UÇK-në, dhe se do ta ishte një precedent që krijon telashe të shumta për stabilitetin dhe integritetin e shteteve të tyre të mëdha, multi-nacionale dhe civile.

Pavarësia e Kosovës do të shkaktonte, po ashtu, shqetësime në vendet e saj fqinje, të cilat kanë frikë që Kosova e pavarur do të mund të përcillej me ndryshime të shpejta në integritetin territorial si të Shqipërisë, ashtu edhe të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Është shprehur frikë që pavarësia e Kosovës do ta fillonte rrugën për krijimin përfundimtar të shtetit të Shqipërisë së Madhe, e që mund të bëhet vetëm me coptimin e shteteve fqinje.

Dhe më në fund, pakicat serbe dhe rome në Kosovë, në mënyrë energjike e kundërshtojnë pavarësinë, duke pohuar se, heret a vonë, pas pavarësisë do të vinte dëbimi me forcë i të dyja këtyre bashkësive. Pavarësia për Kosovën, nga këndvështrimi i pakicave, duket si një mjet për realizimin e tiranisë së shumicës.

Autonomia në kuadër të RFJ-së demokratike

Çështja e sipërpërmendur - pra pamundësia e mbrojtjes së pakicave në Kosovën e pavarur - e paraqet, po ashtu, arsyen kryesore pse shumë qeveri perëndimore e kundërshtojnë pavarësinë e plotë pa ndonjë mbikëqyrje të Kosovës. Disa prej tyre, po ashtu, pajtohen me pikëpamjet e Ruisë dhe të Kinës lidhur me precedentin i cili do të mund të krijohej duke i krijuar mundësi lëvizjes secesioniste që pavarësinë ta arrijë përmes përdorimit të dhunës.

Kundërshtimi i pavarësisë e mundëson shpjegimin e asaj se pse shumë qeveri perëndimore, pa ndonjë entuziazëm të madh vazhdojnë të mbesin të bindura që regjimi i Rezolutës 1244, d.m.th. autonomia dhe vetëqeverisja substanciale në kuadër të sovranitetit nominal të RFJ-së, mbetet opsioni më i mirë për një të ardhme të parashikueshme. Pos kësaj, ato shpresojnë që më vonë, Serbia e periudhës pas Millosheviqit si dhe federata e rimëkëmbur dhe e demokratizuar e RFJ-së do të mund të bëhen të besueshme për shumicën e shqiptarëve të Kosovës, gjë kjo e cila do të mundësonte që ata të ardhmen ta shohin në kuadër të federatës Jugosllave, si një republikë autonome e vetëadministruar në tërësi nga brenda, por duke lejuar që përfaqësimin e tyre në planin ndërkombëtar ta bëjë federata.

Problemet që e përcjellin këtë skenar qëndrojnë në supozimin e mundësisë që dy popuj të cilët kanë qenë në luftë njëri me tjetrin, një ditë do të jetojnë në kuadër të të njëjtit shtet. Pas asaj të cilën shqiptarët e Kosovës e kanë përjetuar nën pushtetin e RFJ-së, jo vetëm nga marsi e deri në qershor të 1999-ës, por të paktën që nga viti 1989, duket që nuk është perspektivë reale, pavarësisht nga ajo se sa do të mund të ishte e dëshirueshme në teori, që kosovarët ta pranojnë çfarëdo qoftë trajte të sovranitetit të Serbisë apo të RFJ-së, sado fiktiv që ai sovranitet do të mund të ishte. Nuk është e pamundur që shqiptarët e Kosovës, individualisht apo kolektivisht, të përfytyrohen që të kenë vënë marrëdhënie të mira pune me institucionet demokratike të Serbisë së periudhës pas Millosheviqit, apo, madje, edhe me federatën e ripërtëritur të RFJ-së, në të cilën do të ishte edhe Mali i Zi. Mirëpo, mundësia e marrëdhënies të mira, të paktën sipas këndvështrimit të kosovarëve, mund të krjohej vetëm me plotësimin e kushtit të ushtrimit të vetadministrimit nga ana e tyre. Duket në tërësi e pabesueshme që shqiptarët e Kosovës do të pajtohen ndonjëherë, për shembull, me praninë e personelit të Serbisë apo të RFJ-së në tokën e Kosovës, ashtu siç e parasheh Aneksi 2/6 i Rezolutës 1244. Dhe, po ashtu, nuk ekziston kurrfarë gjase që ata do ta ndërrojnë ndonjëherë markën gjermane me dinarin jugosllav. Një përparim i tillë është pa mundësi të kthimit prapa, përderisa të jetë një përparim aq e madhe ekonomike.

Sidoqoftë, Komisioni mendon që do të ishte papërgjegjësi po qe se Bashkësia Ndërkombëtare vendos që ta prolongojë çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, duke pritur që Serbia, Mali i Zi dhe RFJ-ja ta bëjnë tranzicionin e tyre në periudhën demokratike pas Millosheviqit. Në rrethanat çfarë ato në realitet janë, gjasa për një tranzicion të tillë nuk shihen fare, dhe edhe po qe se ky vërtet ndodh, për të do të nevojiten vite të shumta. Në ndërkohë, frustrimet e shqiptarëve të Kosovës lidhur me prolongimin e pacaktuar të zgjidhjes së çështjes së statusit të tyre të ardhshëm, administrimin e vazhdueshëm të provincës nga administrata e OKB-së do ta bëjnë gjithnjë e më të vështirë.

Është pikëpamje e Komisionit që Bashkësia Ndërkombëtare nuk duhet ta prolongojë çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës duke pritur që në RFJ të ndodhin ndryshime pozitive. Një realitet esencial me të cilin Bashkësia Ndërkombëtare duhet të ballafaqohet është ai që, për shkak të shkeljes sitematike të të drejtave të kosovarëve të cilat i ka bërë RFJ-ja, autonomia dhe vetëqeverisja substanciale janë bërë në tërësi të papërputhshme me vazhdimin e sovranitetit të RFJ-së në provincë, dhe se këto do të mbeten të tilla madje edhe sikur Jugosllavia përfundimisht do ta bëjë tranzicionin në një rend demokratik. Është një e vërtetë fare e thjeshtë, që asnjë kosovar nuk do të pranojë kurrë që të jetojë përsëri nën pushtetin e Serbisë, qoftë ai pushtet edhe vetëm nocion.

Pavarësia e kushtëzuar

Komisioni është i bindur plotësisht në atë që të gjithë qytetarëve të Kosovës duhet t'u jipet mundësia që të vendosin vetë për të ardhmen e vet politike. Pasi që të mbahen zgjedhjet lokale dhe ato të përgjithshme të Kosovës, dhe pasi që të fillojë të ushtrohet një vetëqeverisje e kufizuar, zyrtarët e zgjedhur të Kosovës pashmangshmërisht do ta kërkojnë mbajtjen e referendumit lidhur më të ardhmen politike të provincës. Një kërkesë e tillë do të jetë plotësisht legjitime, ndërkaq, koha e mbajtjes së këtij referendumi do të varet nga vlerësimi i sigurisë nga ana e PSSP-së. Vlerësimi lidhur me këtë duhet të bëhet në një mënyrë, sa ekspeditive aq edhe të kujdesshme. Përpilimi i pyetjes e cila do të parashtrohet në referendumin për statusin e ardhshëm, do të jetë, po ashtu, në kompetencën e PSSP-së, dhe vendimi për këtë do të mirret në konsultim me përfaqësuesit e zgjedhur të komunitetit të shumicës dhe të pakicës. Përndryshe, qëllimi i kësaj do të jetë që të mirren në konsideratë një sërë opsionesh të mirëfillta, duke filluar nga vazhdimi i administratës së OKB-së e deri te pavarësia, dhe që pyetja të për-

pilohet me një qartësi të mjaftueshme, përmes të cilës do të arrihet që rezultati të jetë një tregues i qartë i vullnetit të shumicës për të ardhmen politike të provincës.

Nëse do të mbahet një referendum i tillë, atëherë mund të pritët që rezultati i tij sipas të gjitha gjasave do të shkojë në favor të ndonjë trajte të pavarësisë. Duket që nuk do të vijë në shprehje mundësia që Bashkësia Ndërkombëtare ta injorojë një shprehje të tillë të përcaktimit politik, mirëpo përfaqësuesve të saj në Kosovë ju takon në mënyrë legjitime që në bashkëpunim me përfaqësuesit e zgjedhur të shumicës dhe të pakicës, ta përcaktojë saktësisht se cila formë e pavarësisë është e mundshme.

Pavarësia e kushtëzuar është formulimi i cili, sipas bindjes së Komisionit, e definon më së miri statusin e ardhshëm, i cili do të del si rezultat i një procesi të tillë konsultimesh. Pavarësia e plotë, e pakufizuar dhe e pakushtëzuar, është e pamundur për shkak të vetë rrethanave, sepse shteti i pavarur i Kosovës nuk e ka komponenten kyçe të shtetësisë, d.m.th. mjetet për ta mbrojtur vetveten nga sulmi i jashtëm. Kosova është e varur dhe do të vazhdojë të jetë e varur nga prania ushtarake e KFOR-it brenda saj, si dhe nga forca ajrore dhe detare e NATO-s. Për më tepër, siç është bërë fare e qartë nga gjendja e sigurisë në Kosovë pas vitit 1999, Kosovës i mungojnë edhe kapacitete të tjera të shtetësisë: aftësia për ta garantuar rendin e brendshëm, sigurinë e brendshme dhe paqen ndëretnike. Për shak të mungesës së këtyre funksioneve, e që normalisht ushtrohen nga shtetet, Kosova do të mbetet e varur gjatë viteve që vijnë, nga një lloj i pranisë ndërkombëtare të sigurisë, si policore ashtu edhe ushtarake.

Për këtë arsye, në këtë kuptim Kosova mund të pretendojë vetëm për një trajtë të kushtëzuar të pavarësisë. Si siguria e saj e jashtme, ashtu edhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, do të mbikëqyren nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe nga një prani e konsiderueshme ushtarake. Për aq kohë sa pakicat në Kosovë të mos jenë të sigurta dhe të mos e kenë lirinë e lëvizjes dhe mundësinë e një pjesëmarrjeje të plotë në institucionet e Kosovës, një prani ndërkombëtare mbikëqyrëse, administrative dhe ushtarake do të jetë e domosdoshme, me qëllim të mbrojtjes së tyre.

Në këtë mënyrë, po qe se referendumi vendos për pavarësi, atëherë, pas kësaj, do të duhet të fillojnë negociatat ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur edhe të bashkësive të shumicës, dhe edhe të pakicës, dhe të administratës së OKB-së, për ta përcaktuar rendin kushtetues i cili do t'i mbronte të drejtat e pakicave, do ta garantonte një mbikëqyrje të vazhdueshme administrative dhe ushtarake të këtyre të drejtave, ndërkaq, administrimi efektiv i Kosovës do të bartej në duart e parlamentit kombëtar, administratës ekzekutive dhe asaj komunale, dhe do të ushtrohej nga vendorët.

Një rend i tillë kushtetues do të mbështetej në aplikimin dhe respektimin e këtyre

parimeve themelore:

Bashkësia Ndërkombëtare do ta respektojë të drejtën e të gjithë qytetarëve të Kosovës që lirish ta përcaktojnë të ardhmen e tyre politike;

Qytetarët e Kosovës do ta pranojnë rolin e Bashkësisë Ndërkombëtare për të ofruar sigurinë e jashtme dhe mbrojtjen e brendshme të të drejtave të njeriut;

Të gjithë qytetarët e Kosovës së lirë, pavarësisht nga përkatësia e tyre, do të kenë të drejta të plota dhe të barabarta për çasje dhe pjesëmarrje në institucionet e Kosovës së lirë;

Të gjitha pakicat në Kosovë do të kenë të drejta të garantuara ndërkombëtarisht për shërbime qeveritare në gjuhën e tyre, lirinë e besimit dhe mbrojtjen e objekteve fetare, duke e përfshirë edhe udhëtimin e papenguar në dhe nga Serbia;

Pjesëmarrja e garantuar e minoriteteve në judikaturë, polici dhe në qeverisjen lokale dhe nacionale.

Diskutim

Komisioni i vlerëson lartë parimet e Llund-it për të drejtat e pakicave, të formuluar nga Komisioneri i OSBE-së për të Drejtat e Pakicave, dhe beson që ato e paraqesin një mbështetje të qartë e të detajuar për zbatimin e të drejtave kushtetuese të pakicave në Kosovë, e që do ta harmonizonte pushtetin e shumicës me mbrojtjen e detyrueshme të të drejtave të pakicave.² Lloji i regjimit kushtetues të cilin e propozon Komisioni, nuk e nënkupton ndarjen me çdo kusht të pushtetit ndërmjet të bashkësive të shumicës karakteristike vetëqeverisëse apo të pakicës, por me tepër një regjim të të drejtave të pakicave që përpiqet të garantojë korrektësi, barazi dhe pjesëmarrje të plotë në institucionet e krijuara bashkërisht. Qëllimi i regjimit kushtetues do të ishte avancimi i komuniteteve nga enklavat apo kantonet etnikisht homogjene drejt pjesëmarrjes së tyre në instucionet e përbashkëta.

Kërkesa e ratifikimit të pavarësisë së kushtëzuar për Kosovën do të shtrohej para Këshillit të Sigurimit, vetëm po qe se negociatat për vendosjen e një regjimi të tillë kushtetues të vetëqeverisjes do të jenë të suksesshme, dhe vetëm po qe se Bashkësia Ndërkombëtare do të jetë e kënaqur me këtë vetëqeverisje të qytetarëve të Kosovës, e cila do të ishte në harmoni me regjimin e mbikëqyrrur ndërkombëtarisht për të drejtat e pakicave dhe për sigurinë kufitare.

Edhe pse pavarësia e kushtëzuar efektivisht do t'i jipte fund sovranitetit të RFJ-së në Kosovë, kjo subjektivitetin e plotë juridik ndërkombëtar të shtetësisë nuk do ta fitonte menjëherë. Komisioni e ka parasysh që procesi përmes të cilit Kosova do ta fitonte të drejtën për të qenë shtet, duke e demonstruar që qytetarët e saj mund të jetojnë në paqe me njëri tjetrin dhe me shtetet fqinje të rajonit, duhet të jetë gradual. Nëse kjo do të arrihet pas një periudhe disa vjeqare, Bashkësia Ndërkombëtare do të jetë në gjendje që ta reduktojë praninë e saj të sigurisë brenda në Kosovë, kur pakicat do të jenë të mbrojtura nga vetë gjykatat, policia dhe parlamenti i Kosovës. Kosova do ta fitonte njohjen e shteteve të tjera si shtet me pavarësi të plotë dhe i njohur ndërkombëtarisht vetëm kur të plotësohen kushtet e paqes së brendshme dhe të jashtme.

Madje edhe atëherë, si një shteti të vogël, Kosovës do t'i duhej që për shkak të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë ekonomike të vet, të mbante marrëdhënie shumë të ngushta politike, ekonomike dhe të sigurisë me fqinjët e saj në rajon. Pavarësia e kushtëzuar e Kosovës është vetëm një propozim i realizueshëm përbrenda kontekstit të Paktit të Stabilitetit për të gjitha shtetet e vogla të rajonit, në mënyrë që ato të mund ta zhvillojnë infrastrukturën e tyre, lidhjet tregtare dhe partneritetet politike dhe strategjike në kuadër të një kornize të qëndrueshme të paqes. Pakti Evropian i Stabilitetit e paraqet një hap të qenësishëm në drejtim të krijimit të një kornize të tillë, mirëpo Komisioni mendon që ky pakt krahas dimensionit ekonomik, duhet ta ketë edhe dimensionin politik. Ky pakt duhet ta zhvillojë sekretariatit dhe një strukturë të aftë për t'i pajtuar tendosjet politike në rajon, dhe mbi të gjithat, duhet që gradualisht t'i prijë Kosovës drejt vendit që i takon si një shtet funksional në rajonin e Ballkanit. Si i tillë, pakti do të garantonte, ashtu siç e parashohin edhe vetë parimet e tij politike, që të gjithë anëtarët do t'i respektojnë kufijt, integritetin territorial dhe pavarësinë e brendshme të fqinjëve. Kjo e ka një rëndësi të veçantë në rastin e Kosovës, meqenëse pavarësia e saj shkakton shqetësime të konsiderueshme në Maqedoni, Shqipëri dhe në Mal të Zi, sepse merret se kjo, kinse, do të ishte një hyrje për krijimin e Kosovës së Madhe apo të Shqipërisë së Madhe. Kusht thelbësor i realizimit të pavarësisë së Kosovës është që ajo t'i respektojë në tërësi kufijt ekzistues të fqinjëve të saj, dhe që të përmbahet nga çfarëdo lloj ndërhyrjeje në punët e tyre të brendshme. Dimensionin esencial politik i Paktit të Stabilitetit është që të garantojë që Kosova do t'u përmbahet këtyre kushteve të shtetësisë ndërkombëtare. Vetëm pasi që të arrihet kjo, Kosova do ta ketë mundësinë që ta fitojë njohjen nga shtetet e tjera, si një anëtar me të drejta të barabarta në sistemin ndërkombëtar.

Sfida kryesore për të arritur deri të pavarësia e kushtëzuar, dhe mëpastaj edhe deri të pavarësia e plotë e Kosovës, qëndron në marrëdhëniet e saj me Serbinë. Komisioni e

vlerëson se do të ishte e dëshirueshme që pavarësia e kushtëzuar e Kosovës të negociohej me autoritetet e Serbisë, meqenëse njohja e dyanshme paqësore e kufijve dhe e integritetit do ta paraqiste garancën kryesore për paqe në rajon. Mirëpo, as regjimi i tashëm serb, dhe as ndonjë regjim tjetër i cili do të mund të përfytyrohej për të ardhmen, nuk ka gjasa të pranojë të negociojë mbi heqjen dorë nga sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën.

Prandaj është një rrethanë për keqardhje që Serbia nuk ka gjasa as të marrë pjesë në negociatat për pavarësinë e Kosovës, dhe as – të paktën për një kohë – ta njohë atë pasi që ajo të bëhet realitet. Ky fakt, i mpleksur me realitetin e disfatës serbe dhe të largimit të një numri të madh të serbëve nga Kosova, do të mund ta inkurajonte shumicën shqiptare të Kosovës që të mendojë që në rrugën e saj për në pavarësi të kushtëzuar, mund ta injorojë Serbinë.

Komisioni konsideron që do të ishte një guxim i barabartë me marrëzi që Serbia të injorohet apo që të refuzohet ideja që ajo, së pari të angazhohet në dialog, dhe më pas, edhe në negociatat lidhur me të ardhmen e Kosovës. Paqja në Ballkan përfundimisht varet nga integrimi i Serbisë në Paktin e Stabilitetit të rajonit, dhe siguria e jashtme e Kosovës varet në masë të madhe nga vendosja me durim e një modus vivendi me shtetin e Serbisë. Duhet të jemi realistë, dialogu me regjimin ekzistues në Beograd do të jetë edhe i vështirë edhe i pakëndshëm, por pas njëfarë kohe, nuk do të ketë ardhmëri të sigurt as për Kosovën dhe as për Serbinë, po qe se të dyja palët nuk pajtohen me ndarje, dhe nuk pajtohen me kufijt e njëra-tjetrës. Për më tepër, secila palë duhet të zgjidhë edhe probleme të tjera ashtu që paqja e cila do të mëkëmbej në këtë mënyrë të jetë e qëndrueshme. Këtu hyn edhe çështja e mbajtjes së robërve shqiptarë të Kosovës nëpër burgjet serbe. Nga ana serbe, ekzistojnë kërkesat pronësore për pasuritë e uzurpuara të serbëve që u larguan më 1999. Përpos kësaj disa refugjatë serbë që tash janë në Serbi e kërkojnë të drejtën e kthimit nëpër ish shtëpitë e tyre.

Që të dyja palët duhet që sa më shpejt ta fillojë dialogun lidhur me çështjet e përmendura. Dialogu mund të zhvillohet duke u mbështetur në këto parime:

Secila palë duhet të pajtohet me lirimin e të burgosurve politik të palës tjetër, si dhe të robërve të luftës;

Do të themelohet një bord kompensues ndërkombëtar i cili do ta ketë për detyrë që t'i dëgjojë ankesat dhe t'i financojë korrigjimet për humbjet e pasurisë së serbëve në Kosovë, si dhe për shqiptarët e Kosovës të cilët i kanë humbur pronat e tyre gjatë okupimit serb;

Secila palë duhet ta njohë të drejtën e çdo qytetari të cilësdo palë për të kaluar shli-shëm nëpër kufijtë midis dy vendeve, dhe duhet, po ashtu, ta lejojë mundësinë e kthimit nëpër shtëpitë e tyre për ata që dëshirojnë ta bëjnë këtë. Kthimet e tilla do t'i mbikëqyrin, forcat ndërkombëtare të sigurisë;

Dialogu përfundimtar do ta kërkonte caktimin e kushteve për njohje të ndërsjellë të shtetësisë.

Përderisa në Beograd të jetë në pushtet regjimi aktual, negociatat e kësaj natyre janë të pamundura. Mirëpo, ndryshimi i regjimit dhe ndryshimi i disponimit në radhët e elitës politike serbe, do të mund ta bënte të mundur negocimin e kushteve për një paqe të qëndrueshme.

Në një afat më të gjatë, kur Kosova ta dëshmojë që është e aftë që t'i kontribuojë stabilitetit rajonal, kjo do të mund ta fitojë njohjen ndërkombëtare si një shtet sovran. Kjo gjë varet, në fakt, nga ajo se a do të tregojnë udhëheqësit e saj maturinë dhe vetëdisiplinën të nevojshme për t'i krijuar dhe ruajtur marrëdhëniet e mira afatgjate, si me fqinjët e jashtëm, ashtu edhe me pakicat e brendshme.

Komisioni është i vetëdijshëm që pavarësia e kushtëzuar mund të realizohet vetëm po qe se kjo do të pranohet nga më tepër anëtarë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Por theksi politik në të cilin Komisioni dëshiron të insistojë, është që konsensusi i Rezolutës 1244 është i paqëndrueshëm, sepse ai është nisur nga fikcioni që sovraniteti nominal serb mbi popullatën mund të ruhet edhe pasi që pëlqimi për këtë mandat të tërhiqet përfundimisht. Për më tepër, regjimi i Rezolutës 1244, është konceptuar në një asi mënyre që administrata afatgjate e OKB-së do ta shkaktojë një përplasje të pashmangshme ndërmjet të prirjes së shumicës për vetadministrim dhe të përpjekjeve të Bashkësisë Ndërkombëtare për ta ruajtur pushtetin e saj. Fillimi i shqyrtimit të pavarësisë së kushtëzuar, është mënyra më adekuate për daljen nga kjo bllokadë e krijuar me Rezolutën 1244.

Një ide e tillë me siguri do ta krijojë një precedent të rëndësishëm dhe kundërthënës. Kjo do të shkaktojë që Bashkësia Ndërkombëtare të fillojë të angazhohet në propozimin që pakicat kombëtare e kanë të drejtën e shkëputjes meqenëse të drejtat e njeriut u janë shkëllur sistematikisht, dhe, po ashtu, sistematikisht u janë refuzuar të drejtat e tyre për vetëqeverisje. Kjo, po ashtu, do ta angazhojë Bashkësinë Ndërkombëtare në shqyrtimin e parimit korrelativ sipas të cilit shtetet mund t'i humbin të drejtat sovrane mbi pakicat kombëtare, në rastet kur trajtimi që ju kanë bërë këtyre pakicave e shënon një shkallë të shtypjes brutale dhe të vazhdueshme, si të të drejtave individuale, ashtu edhe të të drejtave kolektive të vetëqeverisjes.

Asnjëri nga këto parime nuk është i përfshirë në një mënyrë të sigurt në të Drejtën Ndërkombëtare. Këtu vërtet ekziston një konfuzion real i cili, sipas mendimit të Komisionit, duhet të qartësohet.

Komisioni e ka të qartë faktin që krijimi i precedenteve të tilla nuk është një çështje e lehtë, meqë këto duket sikur i legjitimojnë, apo madje edhe i nxisin, përpjekjet secesioniste të pakicave kombëtare. Megjithatë, është një fakt i pashmangëshëm që pakicat kombëtare, kur të jenë të ballafaquara me shtypjen dhe me brutalitetin, do të angazhohen në përpjekjet për vetëvendosje, pavarësisht nga qëndrimet e së Drejtës Ndërkombëtare. Sipas mendimit tonë, është më e përshtatshme që Bashkësia Ndërkombëtare të krijojë procedura për akordimin dhe vetëqeverisjen e këtyre grupeve sipas kushteve adekuate dhe të arsyeshme, sesa që edhe më tutje të insistohet në ruajtjen e regjimit të vjetruar të sovranitetit të patjetërsueshëm shtetëror. Vërtet, njëri nga mesazhet kryesore të të tërë tragjedisë së Kosovës është ai që, duke e mbrojtur sovranitetin e vet në Kosovë me çdo kusht, dhe duke i hedhur poshtë të gjitha përpjekjet për ndërkombëtarizimin e problemit të të drejtave të njeriut në Kosovë, Serbia ka ardhur në fundin e rrugës në drejtimin e humbjes së provincës.

Rekomandimet e Komisionit lidhur me statusin përfundimtar duhet të shihen në kontekstin e rekomandimeve të mëparshme për intervenimin me kohë. Nuk është fjala vetëm për atë se me një intervenim me kohë ka mundur të parandalohet konflikti tragjik; fjala është për atë që intervenimi me kohë do të mund ta kishte bërë të realizueshme gjetjen e një zgjidhjeje e cila do ta mbante Kosovën në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë. Komisioni e ka preferencën që kërkesat për autonomi dhe vetëqeverisje në secilin rast të veçantë duhet të harmonizohen në kuadër të rendit ekzistues të kombeve-shtete. Prandaj, kur të paraqiten konfliktet, shtetet intervenuese gjithmonë duhet të përpiqen t'u ndihmojnë palëve për gjetjen e zgjidhjes e cila i jep prioritet harmonizimit të sovranitetit shtetëror me të drejtat e pakicave dhe me vetëqeverisje. Vetëm po qe se dëshmohet qartë që këto trajta të kompromisit janë të pamundura, pakicat e kanë të drejtën që të kërkojnë shkëputje. Argumenti i Komisionit është se në Kosovë, pas një momenti të caktuar, harmonizimi paqësor i sovranitetit jugosllav dhe i të drejtave të kosovarëve nuk është i mundur edhe më tutje. Në raste të tilla – dhe Kosmisioni mbetet me shpresë që këto do të jenë të rralla – Bashkësia Ndërkombëtare nuk duhet të ngurrojë në përmbushjen e përgjegjësisë së saj për t'i përcaktuar rregullat e shkëputjes dhe të pavarësisë të cilat do t'ju mundësojnë grupeve të persektuara që ta krijojnë rendin kushtetues i cili do t'ju mundësojë siguri dhe vetëqeverisje. Mirëpo dhënia e pavarësisë nuk duhet të jetë e pakushtëzuar. Komisioni angazhohet për një strategji për pavarësi të mbikëqyrrur e cila, në vend të

subjektivitetit të përnjëhershëm juridik ndërkombëtar për popujt secesionistë, këtë pavarësi do ta kushtëzojë me mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe me respektimin për integritetin territorial të shteteve fqinje.

Procesi i marrëveshjes lidhur me statusin e ardhshëm është i rëndësishëm po aq sa edhe vetë marrëveshja. Për arsye politike të kuptueshme, përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare mund të mos jenë të gatshëm që bisedat e tyre private rreth statusit përfundimtar të Kosovës t'i bisedojnë me vendasit. Kur të mirren parasysh vështirësitë e mëdha për punën e përbashkët nëpër institucione, atëherë është e kuptueshme ajo që përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare duan ta ruajnë hapësirën e tyre manovruese, duke i mbajtur sekrete shumicën e bisedave të tyre sa më gjatë që të jetë e mundur. Në një moment të caktuar në fillimin e vitit 2001, megjithatë, do të ishte e këshillueshme për Bashkësinë Ndërkombëtare që në një mënyrë të kujdesshme, me përfaqësuesit e të gjitha bashkësive të Kosovës ta fillojë debatin lidhur me ardhmërinë. Po qe se mbështetja për statusin e ardhshëm nuk vendoset dhe stabilizohet me vendosmëri në shoqërinë civile kosovare dhe në klasën e saj politike, dhe po qe se kushtet e “marrëveshjes” nuk analizohen dhe nuk diskutohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse, atëherë procesi shumë shpejt do të mund të acarohet në një ndarje të rrezikshme ndërmjet “ndërkombëtarve” dhe “vendorëve.” Aktorët lokal, shumë nga të cilët kanë treguar gatishmëri dhe guxim të madh, duhet të përfshihen në proces sa më shpejt që të jetë e mundur, ashtu që ëndrrat jorealiste të ballafaqohen me realitetin e vështirë, e që do të mund ta krijonte gradualisht një konsensus i cili do ta shpiente procesin e negociatave drejt suksesit.

PJESA III

PËRFUNDIM

10. Përfundim

Në vazhdim janë dhënë disa nga konkludimet e Komisionit, në kuadër të përpjekjeve për t'i venë ato në një kontekst më të gjerë historik, dhe për ta bërë më të qartë lidhmërinë ndërmjet rekomandimeve. Qëllim yni është që t'i ndihmojmë qeveritë në krijimin e kornizës për një angazhim të vazhdueshëm për zhvillimin e një Kosove paqësore, dhe në paraqitjen e konceptit të Komisionit lidhur me Kosovën si një precedent për intervenimet e ardhshme humanitare.

Konflikti në Kosovë duhet të trajtohet si një pjesë e historisë tragjike të grimcimit të shtetit të mëparshëm, dhe të formimit të shteteve të reja në gadishullin Ballkanik pas vdekjes së Titos. Çmimi i këtij procesi katastrofik ka qenë mbi 200 mijë jetëra njerëzish, dhe me miliona të zhvendosur nga shtëpitë e tyre. Kjo krizë e ka pllakosur popullatën shumicë shqiptare të Kosovës nën dominimin serb, për shkak të veprimeve që qeveria e RFJ-së i ka bërë përmes përdorimit të mjeteve të terrorit dhe të represionit. Popullata shqiptare e Kosovës, ndaj këtij represioni reagoi me një mobilizim mbresëlënës paqësor gjatë pjesës më të madhe të viteve '90. Mirëpo, megjithë arritjet e rëndësishme, ky mobilizim dhe organizim paralel i shoqërisë nuk ia arriti që ta ndryshonte kursin shkatërrimtar të RFJ-së në rajon. Kjo rrethanë, e kombinuar me angazhimin e kufizuar të Bashkësisë Ndërkombëtare, dhe posaqërisht me dështimin për ta shtruar çështjen e Kosovës në bisedimet e Dejtonit, krijoi zhgënjime të cilat e shkakton mëkëmbjen e kryengritjes së armatosur nën udhëheqjen e UÇK-së. Që të dyjat, edhe rezistenca e paarmatosur edhe ajo e armatosur, ishin të angazhuara për arritjen e të njëjtit qëllim, për ta realizuar pavarësimin nga RFJ-ja. Në secilën fazë të konfliktit, popullata shqiptare e Kosovës, ka vuajtur nga shkelje të rënda të të drejtave të saj nga forcat e sigurimit dhe nga institucionet civile të RFJ-së.

Që nga viti 1991, Ballkanin e tronditën katër luftra: në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Duke i ditur tendosjet e tashme ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi, si dhe rivalitetet ndëretnike në Maqedoni, fare lehtë mund të ndodh që konflikti i Kosovës të mos jetë i fundit në varganin e luftrave ballkanike. Struktura e shteteve të krijuara në Ballkan është jostabile dhe me gjasa të mëdha që të mbetet e tillë edhe më tutje. Komisioni është plotësisht i vetëdijshëm që qëllim i rekomandimeve të tij, njësoj sikur edhe qëllimi përkatës i të gjitha shteteve të interesuara për rajonin, duhet të jetë një përpjekje efektive që konflikti i Kosovës të jetë i fundit

në luftat ballkanike.

Në këtë frymë, është me rëndësi thelbësore që të kuptohet rekomandimi kryesor i Komisionit – që Kosova të vihet në shtegun drejt “pavarësisë së kushtëzuar” – në kuadër të kornizës së Paktit të Stabilitetit Ballkanik, i cili i ofron segmentet e sigurisë dhe të politikës në kuadrin e angazhimeve eksiztuese ekonomike. Ky është konteksti në të cilin roli ndërkombëtar brenda një Kosove kuazi të pavarur do të ishte kuptimplotë. Kushtëzimi shtrihet përtej dispozitave të garantimit të sigurisë nga trupat e NATO-s dhe të mbikëqyrjes së vazhdueshme ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Sepse, kjo e tëra duhet të rezultojë edhe me integrimin e Kosovës në një pakt rajonal i cili do të mundësonte investime të fondeve për zhvillim, bashkëpunim politik me shtetet fqinje dhe ndërtimin e rrugës për integrimin përfundimtar në Bashkimin Europian.

Është plotësisht e natyrshme që Komisioni e ka të qartë që Kosova e pavarur në momentin e tashëm kundërshtohet nga Serbia, Rusia, si dhe nga shumë shtete fqinje ballkanike. Megjithatë, ne jemi të mendimit që paqendrueshmëria e gjendjes së tashme, si dhe pasojat e një shpërthimi të mundshëm, po qe se kërkesat kosovare për vetëvendosje nuk merren parasysh në mënyrë adekuate, e kërkojnë një rishqyrtim të këtyre qëndrimeve.

E ardhmja e Kosovës varet nga ajo se sa fuqitë që ishin të gatshme për të hyrë në luftë do të jenë në gjendje që ta përkushtojnë veten për një angazhim afatgjatë dhe se sa kohezion këto do të kenë për ndërtimin e një kornize për paqe në të tërë Gadishullin e Ballkanit. Pakti i Stabilitetit është hapi i parë drejt një kornizë të tillë. Mirëpo ai duhet të jetë pak më shumë sesa, thjesht, një fondacion i zhvillimit ekonomik, dhe duhet që medoemos të evoluojë në një forum për bashkëpunim politik dhe diplomatik. Mbi të gjitha, qeveritë evropiane duhet të tregojnë aftësi për një angazhim të vazhdueshëm në zhvillimin e Ballkanit, të paktën edhe për 15 vitet e ardhshme. Po qe se dëshirohet që rajoni ta kapërcejë trashëgiminë e vet të luftës, varfërinë dhe brishtësinë e institucioneve, angazhimi nuk duhet të jetë nën këto përmasa.

Edhe sikur Kosova në fund t'i bashkangjitet Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjes e Hercegovinës dhe Maqedonisë, si një nga shtetet e reja të krijuara nga rrënojat e ish-Jugosllavisë (gjë që edhe rekomandohet nga ky Komision), e ardhmja e saj do të jetë e paqartë, përderisa Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia të mos stabilizohen në kuadër të një strukture demokratike, me shoqëri të pavarur civile dhe me ekonomi të tregut të hapur. Është e nevojshme që Malit të Zi t'i ofrohen garancione për siguri dhe vetëvendosje, duke i preferuar që të vazhdojë në kuadër të federatës me Serbinë demokratike,

apo, nëse është e domosdoshme, edhe jashtë saj. Forcat demokratike në Serbi kanë nevojë urgjente që Bashkësia Ndërkombëtare t'u ofrojë konceptin e rrugës drejt riintegritimit brenda Ballkanit dhe në Evropë. Me këtë skemë para vetes, forcat opozitare në Serbi mund t'i ofrojnë elektoratit të tyre një rrugë të besueshme për ta nxjerrë vendin e tyre nga izolimi dhe nga tatëpjeta.

Synim i Ballkanit si tërësi, duhet të jetë integrimi evropian. Sigurisht që vendet e tjera të Evropës Lindore, të cilat tashmë e kanë zënë radhën, duhet të integrohen të parat. Përmes hapave të sigurt Gadishulli Ballkanik do të duhej ta fitonte përkrahjen e plotë si pjesë e Evropës. Bashkimi i Evropës më 1989, nuk u bë ashtu që të mund të krijohen ndarje të reja brenda saj.

Prandaj, e ardhmja e Kosovës varet nga qendrueshmëria e idesë evropiane dhe e institucioneve të saj përkrahëse. Ndërkohë që Shtetet e Bashkuara duhet ta vazhdojnë angazhimin e tyre ushtarak dhe diplomatik, përgjëgjësia kryesore për integrimin e Kosovës në rajonin paqësor të Ballkanit duhet të bie mbi supet e vet shteteve evropiane. Konflikti në Kosovë ishte sprovë deri në kufi e aftësive të NATO-s dhe të BE-së për ta ruajtur partneritetin ushtarak dhe diplomatik, të domosdoshëm për ta garantuar paqen në krahun juglindor të kontinentit.

Alternativë e integritimit do të ishte dezintegrimi dhe rikthimi i dhunës. Për këtë arsye popujve të Ballkanit duhet t'u ofrohet një perspektivë e cila e kombinon stimulimin për bashkëpunim rajonal me një të ardhme evropiane. Pakti i Stabilitetit është përpjekur që ta bëjë pikërisht këtë, dhe ka ngjallur shpresa të konsiderdushme. BE-ja është përfshirë në këtë përpjekje përmes sponsorizimit të Paktit të Stabilitetit, për ta ndihmuar tejkalimin e varfërisë dhe të jostabilitetit në Ballkan. Ky premtim nuk duhet të ngulfatet nga kufizimet burokratike dhe nga mungesa e angazhimit.

Ne tani ndodhemi në një pikë kritike: ose do të arrihen paqja, rindërtimi dhe korniza e bashkëpunimit rajonal, ose këto përpjekje do të dështojnë, e që do të manifestohet me pasoja katastrofike për Ballkanin dhe për të tërë Evropën. Anëtarët e BE-së duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për forcimin e paqes në rajon. Dështimi për t'i bërë investimet zhvillimore dhe mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut, si dhe për ta ofruar mbështetjen për zhvillimin e shoqërisë civile në këtë rajon, me siguri se do të shpiejnë kah ripërtëritja e konfliktit etnik, e që do të shkaktonte lëvizje përmasash të mëdha dhe, sipas të gjitha gjasave, të pakontrollueshme, të popullatës jashta rajonit.

Tekefundit, populli i Kosovës duhet t'i zgjidhë problemet e veta bashkë me fqinjët e vet. Bashkësia Ndërkombëtare mund ta ofrojë kornizën për Kosovën në paqe, mirëpo, janë qytetarët e Kosovës ata të cilëve u takon që këtë ta shndërrojnë në realitet. Popujt

e rajonit të Ballkanit për një kohë tepër të gjatë kanë pritur që fuqitë e jashtme t'i zgjidhin problemet e tyre, dhe i kanë fajësuar ndikimet dashakeqe të të huajve për katastrofat e tyre.

Ndërkohë që Komisioni e lavdëron përkushtimin dhe punën e madhe të UNMIK-ut, ky është, po ashtu, i bindur që në periudhën pas imperializmit, për shkaqe parimore është e gabueshme që OKB-ja ose cilido autoritet i jashtëm të ushtrojë pushtet protektorati mbi bashkësitë kombëtare kudoqofshin ato, për një afat tepër të gjatë; dhe, nga ana tjetër, në rrethanat komplekse ekzistuese të shoqërisë moderne, një gjë e tillë është vërtet tepër e vështirë për t'u bërë. Qëllimi afatgjatë i Bashkësisë Ndërkombëtare duhet të jetë ndërtimi i kapaciteteve lokale dhe që pas kësaj të largohet nga skena. Populli i Kosovës duhet t'i marrë punët e veta në duart e veta, fillimisht në nivelin lokal e mëpastaj edhe në nivelin e Kosovës. Qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë duhet të inkurajohen që të investojnë në atdheun e tyre, duke kontribuar në këtë mënyrë që atë ta bëjnë një vend i cili e arsyeton çmimin e sakrificës për së tepërmi të lartë që kosovarët e paguan për lirinë e tyre.

Mirëpo, kusht për lirinë është toleranca. Toleranca nuk don të thotë harresë, dhe toleranca nuk është zëvendësim për drejtësinë. Ata të cilët janë përgjegjës për krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë duhet të dënohen, dhe Komisioni i përkrah fuqishëm përpjekjet e Tribunalit Ndërkombëtar në Hagë për ta ndërprerë ciklin e mosdënimit të fajtorëve në Ballkan, dhe, po ashtu, edhe përpjekjet e UNMIK-ut për t'i formuar gjykatat që do t'i gjykojnë ata të cilët akuzohen për veprat penale të kryera për shkak të urrejtjes ndëretnike. Komisioni, po ashtu, e ka të qartë që gjendja e cila ka të bëjë me problemet e sigurisë në Kosovë dhe me vështirësitë për ta krijuar një ambient të sigurt për të gjitha grupet etnike, kërkon si polici ashtu edhe gjyqësi adekuate. Mirëpo, gjyqësia do të jetë e pafuqishme dhe nuk do të mund të garantojë siguri, po qe se nuk shoqërohet edhe me tolerancë.

Në kontekstin e Kosovës, toleranca thjesht do të thotë gatishmëri për të jetuar pranë e pranë me armiqtë e deridjeshëm dhe për të bashkëpunuar me ta politikisht, në mënyrë që të mos lejohet ripërtëritja e dhunës e cila do ta shkatërronte ardhmërinë e Kosovës. Askush në Komision nuk është i mendimit që kjo do të jetë e lehtë për t'u arritur, mirëpo kosovarët duhet ta kuptojnë që Bashkësia Ndërkombëtare nuk ka intervenuar me qëllim që Kosovën ta shndërrojë në një tirani tjetër, tash të shumicës etnike. Me aktin e intervenimit Bashkësia Ndërkombëtare e ka fituar të drejtën për të ngulmuar që Kosova e pavarur duhet t'u japë të drejta të barabarta të gjithë qytetarëve të cilët janë të vendosur që të jetojnë në të, dhe atë pavarësisht nga përkatësia e tyre.

Toleranca është kusht politik dhe moral për vetëvendosje. Po qe se dhuna ndëretnike në Kosovë nuk ndalet, atëherë do të pushojë edhe vrulli për vetëvendosje dhe për pavarësi. Shumica kosovare duhet ta kuptojë realitetin, të tillë çfarë ai është: po qe se ajo nuk pranon që të jetojë në paqe me grupet e tjera etnike, atëherë ajo nuk do ta realizojë lirinë e vet. Po ashtu, popullata pakicë në Kosovë duhet të pajtohet me faktin që shpresa e tyre më e mirë për një të ardhme afatgjate në Kosovë qëndron në pjesëmarrjen e plotë në institucionet e reja të vetëqeverisjes.

Nuk ka gjasa për investime ndërkombëtare afatgjata në rajon, dhe, rrjedhimisht, as edhe për një të ardhme afatgjatë për fëmijet e tyre, po qe se vrasjet dhe kërcënimet, nga cilado anë që të bëhen, të mos ndalen tani.

Komisioni mendon që pajtimi i brendshëm do të jetë tepër i vështirë, përderisa shqiptarët e Kosovës të vazhdojnë t'i provokojnë dhe t'i sulmojnë serbët, përderisa regjimi i tashëm të vazhdojë të mbijetojë në Beograd, dhe përderisa pakica serbe të mos e kuptojë realitetin që Kosova kurrë më nuk do të kthehet nën administratën e Serbisë. Megjithatë, Komisioni beson që dialogu për pajtim ndërmjet Kosovës së pavarur dhe Serbisë demokratike, është me një rëndësi thelbësore për paqen në rajon. Në këtë drejtim grupet më të guximshme të shoqërisë civile duhet t'i bëjnë hapat e parë, dhe kjo mëpastaj do të vazhdohej me kontaktet ndërmjet vetë qeverive. Do të ishte naivitet që të pritët që një dialog i tillë do të japë rezultate brenda një kohë të shkurtër, mirëpo shkaqet aktive të armiqësisë – të burgosurit në burgjet serbe, pronat e uzurpuara në Kosovë – nuk mund të zgjidhen pa bisedime të të dyja palëve ballë për ballë. Nëse shumica kosovare sillet thua se pala tjetër më nuk ekziston fare, kjo do të jetë burim i sigurt i telasheve për të ardhmen. Udhëheqësit e që të dyja palëve duhet të tregojnë guxim për të biseduar dhe përfundimisht edhe për ta pranuar njëri tjetrin.

Është ende heret për të vlerësuar nëse intervenimi ushtarak dhe humanitar në Kosovë më 1999 ishte sukses apo dështim. Thënë shkoqur, çdo qeveri apo parti kosovare që synonon ta destabilizojë Shqipërinë, apo, në veçanti, Maqedoninë, në këtë mënyrë do të veprojë drejt vonimit apo madje edhe zhdukjes së gjasave të Kosovës për pavarësi. Sprova e suksesit është se a do të jetë në gjendje një Kosovë e pavarur të shndërrohet në një shtet demokratik, dhe se a do të jetë në gjendje ajo që të krijojë marrëdhënie paqësore stabile me fqinjët e saj.

Në qoftë se përgjigjja në pyetjen se a ka qenë intervenimi sukses apo jo nuk mund të jipet përderisa Kosova të jetë në një paqe të sigurtë, atëherë mund të jipet përgjigjja në pyetjen lidhur me legjitimitetin e intervenimit, posaqërisht për shkak të asaj që rasti i Kosovës mundet ta ofrojë precedentin për intervenime të tjera në të ardhmen.

Përgjigjja e Komisionit është që intervenimi ishte legjitim, por jo edhe legal, duke e ditur se çfarë thotë e drejta ndërkombëtare ekzistuese. Ishte legjitim sepse ishte i pashmangshëm: të gjitha opsionet diplomatike ishin të shpenzuara, në kohën kur të dyja palët ishin mpleksur në një konflikt i cili kërcënonte të shndërrohet në katastrofë humanitare dhe të shkaktonte jostabilitet anembanë Gadishullit Ballkanik. Intervenimi duhet të vlerësohet duke e marrë parasysh dhe duke e kuptuar mirë se çfarë do të mund të ndodhte po të mos ishte ndërmarrë intervenimi: Kosova do të ishte ende nën sundimin serb, dhe në vllugun e një lufte civile të përgjakshme. Ende do të kishte vdekje njerëzish, ndërkaq, fluksi i refugjatëve do të vazhdonte t'i destabilizonte vendet fqinje.

Në të njëjtën kohë që e përkrah intervenimin, për shkak të asaj që ai ishte i pashmangshëm, Komisioni e kritikon mënyrën në të cilën ai është realizuar. Janë disa aspekte të mënyrës së intervenimit të cilat Komisioni i kritikon, dhe ndër to i veçojmë:

Ishte një vlerësim i gabuar nga ana e NATO-s mospërfillja e mundësisë që bombardimet do të shkaktojnë sulme mizore ndaj shqiptarëve të Kosovës. Si pasojë, mungoi parashikimi dhe përgatitja për një fluks të madh refugjatësh, i cili e shoqëroi shpërthimin e luftës ndërkombëtare.

Pas fillimit të luftimeve, mbështetja ekskluzive vetëm në forcat ajrore u tregua e pamjaftueshme për t'i penguar dëbimet masive të popullatës civile, spastrimet etnike dhe vrasjet.

U tregua kujdes i pamjaftueshëm për mbrojtjen e pakicave etnike gjatë kohës kur po bëhej vendosja e trupave ushtarake në Kosovë.

Të dhënat e shërbimit të inteligjencës dhe shkëmbimi i tyre kanë qenë të pamjaftueshme, gjë kjo e cila e pengoi KFOR-in që t'i zinte kryesit e sulmeve në baza ndëretnike.

Shkurt, Bashkësia Ndërkombëtare e dëshironte një epilog humanitar në Kosovë, mirëpo pa mjete të mjaftueshme dhe adekuate. Pa dashur që ta kritikojmë përdorimin e forcës ushtarake për qëllime humanitare, operacioni i Kosovës i tregoi pikat e dobëta të forcës ushtarake moderne si një instrument humanitar. Kjo nuk është përpjekje për ta zbehur përkushtimin, aftësitë, dhe profesionalizmin e treguar të forcave ushtarake të pozicionuara para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, por vetëm për të argumentuar që përpjekjet e tyre të mëdha nuk mund ta hedhin poshtë faktin që rasti i Kosovës forcën ushtarake të Perëndimit e tërhoqi në fusha të reja dhe të pahulumtuara. Ajo që habit më së shumti lidhur me operacionin ajror ishte karakteri

improvizues i tij. Askush nuk e kishte paramenduar që konflikti mund të zgjasë 78 ditë, dhe askush nuk ka menduar mbi atë se a do të mund të jenë goditjet të cilat mund të bëhen nga lartësitë e mëdha një mjet efikas për parandalimin e spastrimit etnik. Si rezultat, armët, sado bashkëkohore, ishin të pamjaftueshme, u bënë gabime, dhe mbi të gjithat, operacioni ushtarak nuk ishte në gjendje që ta parandalonte ekzodin e afër një milioni refugjatësh dhe vrasjen e mijëra qytetarëve nga dora e pushtuesit serb. Pas vendosjes së trupave tokësore, në qershor 1999, u pa shumë shpejt dhe qartë që as trajnimi për luftime të intensitetit të lartë, dhe as ai për paqeruajtje të intensitetit të ulët, ushtarët nuk i kishte përgatitur sa duhet për sfidat me të cilat ata u ballafaquan në terren.

Sfida kryesore ishte ofrimi i sigurisë për popullatën e cila ishte pakicë etnike, dhe e cila ishte e kërcënuar, si dhe pengimi i ndarjes de fakto të vendit në enklava etnike. Përderisa këto dështime ushtarake të mos shqyrtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qeveritë kombëtare të vendeve intervenuese, arsyet humanitare për shkak të të cilave intervenimi u ndërmorr, do të vazhdojnë të komprometohen nga rregullat jo adekuate të veprimit, pajisjet, taktikat dhe të dhënat e pamjaftueshme të inteligjencës.

Problemet që dolën në shesh në Kosovë nuk kanë të bëjnë, thjesht, me dallimin ndërmjet të mjeteve ushtarake të përdorura dhe të synimeve morale të përcaktuara paraprakisht. Intervenimi e nxori në shesh gjendjen joadekuate të së Drejtës Ndërkombëtare. Intervenimi nuk ishte legal, sepse ishte në kundërshtim me Kartën e cila ndalon përdorim e paautorizuar të forcës. Ky është një fakt shqetësues i cili nuk mund të anashkalohet në emër të domosdoshmërisë dhe të legjitimitetit të aksionit. Ekziston një rrugë pa krye ndërmjet të dy grupeve të papërputhshme të parimeve, të atyre që e mbrojnë integritetin territorial të shteteve dhe që e ndalojnë përdorimin e forcës për qëllime jombrojtëse, përballë atyre që e kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të popullatës së pambrojtur në kuadër të këtyre shteteve.

Komisioni mendon që është e nevojshme që urgjentisht të qartësohen kushtet në të cilat në të ardhmen do të mund të ndërmerret ndonjë intervenim i justifikueshëm humanitar përbrenda ndonjë shteti anëtar të OKB-së. Ndërkohë që sovraniteti i shteteve është element thelbësor, pos tjerash, edhe i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ky shpesh herë është keqpërdorur si mbulesë dhe justifikim pikërisht për keqtrajtime dhe për mospërbushje të normave ndërkombëtare. Ajo që duhet përpiluar urgjentisht, është një kod i shtetësisë për shtetet, i cili njëkohësisht do t'i mbrojë shtetet nga ndërhyrjet e paarsyeshme të fuqive të jashtme, mirëpo edhe do të garantojë zgjidhje për qytetarët, në rast të shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut nga ana e shteteve

të tyre. Kjo përfundimisht e nënkupton ndryshimin e “të metave ekzistuese” të Kartës së OKB-së, duke e ndryshuar të ashtuajturën pacenueshmëri të shteteve sovraane, ashtu që sovraniteti të jetë i kushtëzuar nga respektimi i disa standardeve minimale, por universale dhe të qarta, të sjelljes.

Komisioni e ka plotësisht të qartë që lidhur me këtë çështje nuk ekziston ndonjë konsensus në mes të shteteve, dhe se një konsensus i tillë nuk do të mund të arrihet pa një proces të gjatë debatimi. Komisioni nuk është në pozitë që ta përkufizojë trajtën e një kodi të tillë të shtetësisë në detaje, mirëpo ky vendosmërisht do t'i bashkangjitet një procesi ndërkombëtar të debatit të lirë ndërmjet qeverive anëtare të OKB-së, dhe ndërmjet institucioneve të shoqërisë civile anëmbanë botës, me qëllim të ridefinimit të të drejtave dhe të obligimeve si të qytetarëve ashtu edhe të shteteve në bashkësinë botërore, ashtu që njerëzit e rëndomtë të mund të llogarisin për gjetje të zgjidhjes, nëse jetët e tyre vihen në rrezik nga veprimet e vetë shtetit të tyre. Një kod i tillë i shtetësisë globale tani mund të duket, thjesht, utopi, mirëpo nevoja për të është duke u bërë realitet gjithnjë e më shpejtë.

Komisioni e ka konstatuar, po ashtu, që çështjen e dallimit në rritje ndërmjet të legalitetit dhe të legjitimitetit, i cili shfaqet gjithnjë në rastet e intervenimeve humanitare, duhet ta zgjidhin reforma plotësuese të OKB-së. Për shkak të mungesës së përfaqësimit në strukturën ekzistuese të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, është vënë në pyetje vetë kredibiliteti ndërkombëtar i OKB-së. Zgjerimi i KS të OKB-së dhe i anëtarëve të përhershëm në të, do të jetë një hap thelbësor drejt rikthimit të kredibilitetit për luajtjen e një roli efektiv si mbrojtës i sigurisë botërore.

Sa i përket vetë intervenimit humanitar, qasja e Komisionit ka qenë që të specifikohen si parimet kryesore, ashtu edhe ato kontekstuale, e të cilat do ta justifikonin intervenimin humanitar, kur një numri të madh të njerëzve të popujve të ndryshëm jetët u sillen në rrezik. Komisioni pajtohet që në të gjitha rastet, palët intervenuese duhet që së pari ta sigurojnë pëlqimin dhe miratimin fomal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Mirëpo, mund të ketë raste – dhe Kosova ishte pikërisht një rast i tillë – kur një miratim i tillë nuk do të aprovohet. Në situata të tilla, qeveritë kombëtare duhet të orientohen duke u mbështetur në parimin se a mund t'i bashkohen apo jo intervenimit ushtarak me forcë për t'i ndaluar shkeljet e të drejtave të njeriut.

Korniza e parimeve të rekomanduara nga Komisioni ndahet në dy pjesë. E para i përmban parimet dhe kriteret themelore, e të cilat duhet të përmbushen ashtu që intervenimi humanitar të ketë legjitimitet. Pjesa e dytë i përmban parimet të cilat e rritin apo e zvogëlojnë shkallën e legjitimitetit i cili ka ekzistuar gjatë intervenimit me

forcë. Këto “parime kontekstuale” mund të zbatohen edhe para intervenimit, për të vendosur se a duhet përdorur forca apo jo, ose edhe pas intervenimit, për të vlerësuar se a ishte ai i justifikueshëm. Ky parim duhet të kuptohet si i vlefshëm për t’u zbatuar gjatë intervenimit humanitar me forcë, qoftë nga OKB-ja, apo nga ndonjë koalicion i atyre shteteve që shprehin gatishmëri për të intervenuar me apo pa pëlqimin e OKB-së, përpos në rastet kur është e qartë nga vetë konteksti që parimi është relevant vetëm kur intervenimi bëhet jashtë mandatit të OKB-së. Më tutje, duhet patur parasysh faktin që shprehja “intervenim” nuk vlen për rastet kur qeveria në pushtet e jep pëlqimin e saj për një prani ndërkombëtare, dhe në rastet e tilla nuk ekziston asnjë problem juridik lidhur me legjitimitetin e pjesëmarrjes humanitare.

Parimet themelore

Ekzistojnë dy shkaqe për intervenim humanitar. I pari ka të bëjë me shkeljet e vrazhda të të drejtave ndërkombëtare të njeriut apo të ligjeve humanitare në një mënyrë të vazhdueshme. I dyti ka të bëjë me shtypjen e shoqërisë civile në përmasa të vuajtjeve të mëdha, dhe të rrezikut për shkak të “dështimit” të shtetit të tyre, të cilin e mbart me vete dështimi i qeverisjes në territorin e një shteti sovran;

Qëllimi themelor i të gjitha fazave të intervenimit, duke e përfshirë si atë të kërcënimit me forcë ashtu edhe atë të përdorimit të forcës, duhet të jetë mbrojtja e drejtpërdrejtë e popullatës së viktimizuar;

Metoda e intervenimit duhet të mendohet në mënyrë të arsyeshme, ashtu që t’i japë fund katastrofës humanitare sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe, në mënyrë specifike, duhet të ndërmerren masa për t’i mbrojtur të gjithë civilët, ashtu që të shmangen dëmet anësore ndaj shoqërisë civile, dhe të parandalohet çfarëdo qoftë veprimi sekondar ndëshkues ose hakmarrës kundër qeverisë së vendit në fjalë.

Parimet kontekstuale

Duhet të bëhen përpjekje serioze për të gjetur zgjidhje paqësore të konfliktit. Zgjidhja duhet ta nënkuptojë atë që konflikti ka marrë fund në mënyrë të besueshme dhe të përshërshme, dhe se është duke u zhvilluar procesi i mëkëmbjes së qeverisjes adekuate;

Mbështetja apo abstenimi nga Këshilli i Sugurimit të Kombeve të Bashkuara, nuk janë vendimtare. Kjo bëhet irelevante atëherë kur mbështetja në Këshillin e Sugurimit dësh-

ton për shkak të vënies së vetos nga një apo më shumë anëtarë të përhershëm, ose kur abstenimi për të kërkuar mbështetje në KS të OKB-së është i shkaktuar nga parashikimi i sigurt për një veto të tillë, e cila kërkesën Asamblesë së Përgjithshme e bën jopraktike. Në fakt, kjo e fundit tregon që e drejta e vetos duhet zëvendësuar me 2/3, apo, edhe më saktë, me përcaktimin e shumicës së “koalicionit të atyre që kanë vullnet” për të vlerësuar që një katastrofë humanitare është duke ndodhur apo pritet që të ndodhë;

Para se aksioni ushtarak të fillojë, duhet të dëshmohet që disa masa më të lehta, si monitorimi dhe masat shtrënguese, nuk kanë dhënë fryte, duke i përfshirë këtu edhe sanksionet, embargon dhe metodat jo të dhunshme të vëzhgimit paqësor. Zhagitja e mëtejme duhet ta nënkuptojë qartë shtimin e rrezikut për ndodhjen e katastrofës humanitare;

Kërcënimi me forcë apo edhe përdorimi i forcës, çfarëdo trajte qofshin ato, nuk duhen të bëhet në mënyrë të njëanshme, por duhet ta kenë një mbështetje kolektive, të shprehur edhe nga procesi multilateral i autorizimit si dhe në formën e pjesëmarrjes së shteteve në aksion;

Nuk duhet të bëhet ndonjë akt formal i kundërshtimit apo i dënimit të intervenimit nga ana e organeve kryesore të Kombeve të Bashkuara, dhe në veçanti jo nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë apo KS i OKB-së;

Përmbajtja ligjeve të luftës dhe të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare duhet të bëhet në mënyrë edhe më strikte sesa në rastet e operacioneve standarde ushtarake. Kjo vlen për të gjitha aspektet e operacionit ushtarak, duke e përfshirë edhe ndërhyrjen ushtarake pas arritjes së armëpushimit;

Qëllimet e përfitimeve territoriale apo ekonomike janë jolegjitime, dhe këto nuk mund të përdoren si justifikim për intervenim, dhe, po ashtu, duhet të ekzistojë vullnet i besueshëm i shteteve intervenuese për t'i tërhequr forcat ushtarake, dhe për t'i hequr sanksionet ekonomike sapo të përmbushen qëllimet humanitare të intervenimit;

Pasi që qëllimet e përdorimit të forcave të armatosura të përmbushen, duhet të bëhet një zbatim i fuqishëm i misionit humanitar përmes mbështetjes së mjaftueshme me mjete, për ta ndihmuar popullatën e vendit në të cilin është bërë intervenimi, dhe për ta mundësuar rindërtimin e shpejtë dhe human të shoqërisë së tij, me qëllim që e tërë popullata të kthehet në gjendjen normale. Kjo e nënkupton edhe ndërprerjen e sanksioneve ndëshkuese dhe gjithëpërfshirëse.

Këto parime nuk janë propozuar me qëllim që t'i bëjnë të mundur fantazmës së impe-

rializmit të të drejtave të njeriut që të dalë jashta shishes, por për ta parandaluar që doktrina e intervenimit të shërbejë si një mbulesë për ushtrim joparimor të forcës nga politika e fuqive të mëdha.

Komentet përfundimtare

Komisioni e ndan mendimin që intervenimi ushtarak gjithnjë duhet të jetë si strategji e variantit të fundit, pasi që të provohen të gjitha mjetet e tjera paqësore të reagimit ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut. Komisioni beson, po ashtu, që intervenimi ushtarak është vetëm variant i domosdosë, dhe se format jo-detyruese të angazhimit të shpejtë në shoqëritë që janë në vllugun e krizave humanitare, jo vetëm që kanë përparësi krahasuar me intervenimin ushtarak, por madje mund ta bëjnë përdorimin e forcës të panevojshëm. Njëri nga mësimet më të rëndësishme nga rasti i Kosovës, tregon që një angazhim më i madh dhe me kohë në rajonin e krizës, me qëllim të parandalimit të konfliktit, në mënyrë të padiskutueshme është më efikas sesa intervenimi i vonshëm dhe me përdorim të forcës. Angazhim me kohë do të thotë jo vetëm që përfaqësuesve të qeverive të papërgjegjshme t'u bëhet e qartë se shkelja që ato u bejnë të drejtave të njeriut denohet, por, po ashtu, edhe ofrim i mbështetjes për grupet demokratike dhe jo të dhunshme të shoqërisë civile, të cilat e kërkojnë ndërrimin e qeverive në ato vende. Një mësim tjetër nga rasti i Kosovës është se një prani e jashtme – monitorët, vëzhguesit, forcat paqëruajtëse – që pranohen me pëlqimin e të gjitha palëve, mund ta luajnë një rol së tepërmi të madh në reduktimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke garantuar transparencë dhe përcaktimin e përgjegjësisë në adresë të saktë. Sikur Bashkësia Ndërkombëtare të ishte angazhuar në mënyrë të vetëdijshme në krizën kosovare që nga viti 1989 e mëtej, dhe sikur qeveria e Beogradit të jpte shenja të ndërkombëtarizimit të problemit të saj me të drejtat e njeriut në Kosovë, atëherë ka mundur të shmangej e tërë spiralja e mëtejme e rrokullisjes në drejtim të intervenimit ushtarak tragjik dhe të kushtueshëm. Kjo mund të duket si një këshillë perfeksioniste – dhe si e tillë e kotë – për faktin që qeveritë mund të kenë dobi nga mundësitë e paralajmërimit me kohë, në trajtën e monitorimit të të drejtave të njeriut nga një vargan organizatash joeveritare (OJQ), të cilat para 25 vitesh nuk ekzistonin fare. Sikur qeveritë, që në fazat më të hershme t'i kishin dëgjuar më me vëmendje vërejtjet e bëra nga OJQ-të lidhur me të drejtat e njeriut, dhe sikur ato ta kishin përdorur ndikimin e tyre politik dhe diplomatik në vendet ku ato të drejta të njeriut shkelen, përqendrimi i intervenimit ndërkombëtar do të ishte zhvendosur drejt parandalimit, e që do të ishte në interes afatgjatë për komunitetet e pambrojtura në të gjitha

vendet e botës. Megjithatë, gjithmonë duhet patur parasysh që angazhimi i hershëm preventiv në vendet e përfshira nga kriza në respektimin e të drejtave të njeriut është i mundur vetëm nëse qeveria në fjalë është e gatshme për një angazhim të tillë. Disa regjime, dhe njëri prej tyre është pa dyshim regjimi në Serbi, janë shumë më tepër rezistente sesa të tjerat lidhur me ndërkombëtarizimin e problemeve të tyre. Në afat më të gjatë kjo intervenimin me forcë mund ta bëjë të pashmangshëm.

Nëse, përfundimisht, intervenimi ishte i pashmangshëm, legjitimiteti i tij ishte dhe mbetet i diskutueshëm në sytë e joperëndimorëve. Në shumicën e vendeve të botës ekziston shumë më tepër angazhim për mbrojtjen e sovranitetit të tyre sesa që aktualisht ekziston në Perëndim.

Në një seminar të organizuar nga Instituti për Çështje Ndërkombëtare të Afrikës së Jugut dhe nga Universiteti i Uituatërsrandit në bashkëpunim me Komisionin, të mbajtur më 25 korrik – 6 gusht të vitit 2000 në Johannesburg të Afrikës së Jugut, ish-Presidenti Nelson Mandela i kritikoi standardet e dyfishta gjatë intervenimeve humanitare (vërejtjet e tij janë botuar në fillimin e këtij libri), duke i marrë si shembuj rastin e Kosovës, ku u bë intervenim, dhe atë të Sierra Leones, ku intervenimi nuk u bë. Sidoqoftë, shumë pjesëmarrës afrikanë dhe joafrikanë e vunë theksin tek mbrojtja e sovranitetit, dhe e kritikuan doktrinën e re të intervenimit humanitar si një vegël në duart e fuqive perëndimore.

Për shkak të historisë së dyfishtë të kolonializmit dhe të Luftës së Ftohtë, ekziston një brengosje e përmasave të gjera lidhur me prirjen perëndimore për intervenim. Forca globale e NATO-s, dhe veçanërisht e SHBA-ve, e ka krijuar ndjenjën e pafuqisë në pjesën tjetër të botës, posaçërisht në rastet siç është Kosova, ku NATO-ja e vlerësoi që e kishte të drejtën për ta anashkaluar Këshillin e Sigurimit.

Në të njëjtën kohë, disa aspekte të intervenimit dëshmuar njëanshmërinë e qartë gjatë kinse mbrotjes së normave universale të të drejtave të njeriut. Bashkësia Ndërkombëtare intervenoi në Kosovë më 1999, por nuk intervenoi, për shembull, në Ruandë. Komisioni, me përbërjen që e ka, me anëtarë të cilët janë qytetarë të shumë vendeve joevropiane dhe joperëndimore, e ka të qartë që për joevropianët intervenimi ishte më pak demonstrim i universalizimit moral, dhe më tepër edhe një dëshmi më shumë që jeta e evropianëve dhe liritë e tyre shkaktojnë reagime të menjëhershme dhe më përmbajtësorë të Bashkësisë Ndërkombëtare, sesa kur është fjala për vendet joevropiane.

Të gjitha këto flasin për nevojën e forcimit të mëtejme të Kombeve të Bashkuara. Këto pabarazi e sfancojnë nevojën e krijimit të një ushtrie të përhershme të Kombeve të

Bashkuara, me aftësi të mëdha për të shpëtuar viktimat civile të përdhunimit të të drejtave të njeriut. Një forcë e tillë do të ndihmonte për ta barazuar shpërndarjen aktualisht të pabarabartë të forcave ushtarake në çështjet humanitare. Mirëpo, në rrugën e krijimit të një force të tillë si dhe në vënien e saj nën komandën dhe nën kontrollin e sistemit të OKB-së, ekzistojnë vështirësi të mëdha politike. Derisa këto probleme të mos tejkalohen, intervenimi humanitar do të vazhdojë të jetë i ngulfatur nga problemet e legjitimitetit, të cilat në thelb të vetin burojnë nga pabarazitë në aspektin ushtarak dhe politik në radhët e vendeve anëtare të OKB-së.

Prandaj, nëse ne jemi vënë në mbrojtje të intervenimit në Kosovë, kjo e tregon qartë që nuk është krijuar aq shumë precedenti për intervenime të tjera, sa është ngritur çështja vitale e legjitimitetit dhe e anës praktike të përdorimit të forcës ushtarake për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të vlerave njerëzore në shekullin 21. Në shesh kanë dalë kufizimet e të Drejtës Ndërkombëtare ekzistuese në ekuilibrin ndërmjet të drejtave të qytetarëve dhe të drejtave të shteteve; janë konstatuar vështirësitë të cilat paraqiten madje edhe në ato raste kur forcat më të sofistikuara dhe më profesioniste ushtarake intervenojnë për qëllime humanitare; është konstatuar, përmes rastit të vështirësive administrative të OKB-së në Kosovë, për pengesat tepër të mëdha që dalin në rrugën e krijimit të bashkëpunimit me shoqëritë e tronditura nga lufta. Duke qenë larg nga hapja e një epoke të re të intervenimeve humanitare, duket që përvojat nga Kosova, të paktën sipas bindjes së Komisionit, e ofrojnë mësimin e vlefshëm të skepticizmit dhe të kujdesit. Në disa raste, dhe një i tillë është edhe rasti i Kosovës, përdorimi i forcës ushtarake mund të bëhet i domosdoshëm për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut. Mirëpo bazat për përdorimin e saj, duke u mbështetur në të Drejtën Ndërkombëtare, kanë nevojë urgjente për qartësime, dhe këtu duhet përmirësuar si taktikat, ashtu edhe rregullat e përdorimit të saj. Në fund, legjitimiteti i përdorimit të tillë të forcës do të jetë gjithmonë kontraverz, dhe do të vazhdojë të jetë i tillë, sa herë që ne të intervenojmë për t'i mbrojtur disa popuj të caktuar, por jo edhe të tjerët.

SHTOJCAT

Shtojcat

1. Dokumentimi i Shkeljes së të Drejtave të Njeriut	243
2. Kosova – Fakte dhe Shifra	269
3. Marrëveshja e Rambujesë – Përmbledhje	271
4. Marrëveshja Ahtisaari – Chernomyrdin – Përmbledhje	277
5. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit	279
6. Puna e Komisionit	288
7. Fusnotat	302
8. Literatura Lidhur me Kosovën dhe Krizën	330
9. Shkurtesat	336

Shtojca 1

Dokumentimi i shkeljes së të drejtave të njeriut

Gjatë punës së tij, Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar kërkoi nga ABA/CEELI që ta formojë një ekip ekspertësh për të grumbulluar të dhëna lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare para, gjatë dhe pas përfundimit të fushatës së NATO-s. Ekipi është formuar dhe organizuar nga drejtori ekzekutiv i ABA/CEELI-t, Mark Ellis. Anëtarë të ekipit ishin Scott Carlsson, drejtor i Projektit të Kosovës dhe Dokumentimit të Krimeve të Luftës, në emër të ABA/CEELI-t; Charles Rudnick, dekan ndihmës i të Drejtës Ndërkombëtare në Kolegjin e Drejtësisë në Çikago-Kent; Randy Clark, Kolegji Çikago-Kent i Drejtësisë; dhe, Wendy Betts, ndihmës drejtor i Projektit të Kosovës dhe Dokumentimit të Krimeve të Luftës në emër të ABA/CEELI-t (në vazhdim këta do të quhen Ekipi); Komisioni i shpreh falënderime të ngrohta ABA/CEELI-t dhe Ekipit të tij.

Ky Aneks është raporti i Ekipit. Ky e parashton dokumentimin plotësues për kapitullin dy, 'Konflikti i Brendshëm i Armatosur: Shkurt 1998 - Mars 1999,' për kapitullin tre, 'Shndërrimi në Luftë Ndërkombëtare: Mars 1999 - Qershor 1999,' dhe për kapitullin shtatë, 'Ndihma Humanitare dhe Media.'

Pjesa mbi Grumbullimin e Dëshmimeve e ofron një listë gjithëpërfshirëse të organizatave, informatat e publikuara apo të papublikuara të të cilave janë shqyrtuar nga Ekipi për t'i dëshmuar konstatimet e tij lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut para, gjatë dhe pas konfliktit. Vëmendje e veçantë i është dhënë vështirësive për të ardhur te të dhëna të cilësuaru qartë si shkelje të të drejtave të njeriut, në periudhën para se të fillonte fushata ajrore e NATO-s.

Pjesa mbi Shkeljen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtës Humanitare në Kosovë, e ka për qëllim që ta paraqesë një rishqyrtim të detajuar për shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti të atyre të bëra ndërmjet 24 marsit dhe 10 qershorit të vitit 1999. Kjo pjesë e përfshin edhe diskutimin e metodologjisë të përdorur nga Ekipi, në dokumentimin e një numri të vrasjeve të kryera gjatë kësaj periudhe.

Dhe në fund, në pjesën Nevoja për një Qasje të Re në Dokumentimin e Shkeljes së të

Drejtave të Njeriut, Ekipi bën thirrje për koordinimin e OJQ-ve dhe të entiteteve qeveritare në përvetësimin e një grumbulli të standardeve gjithëpërfshirëse të për-bashkëta të cilat do ta përmirësonin grumbullimin e të dhënave lidhur me të drejtat e njeriut. Kjo e përfshin edhe krijimin e një baze të të dhënave me dokumentimin e mizorive në trajtë të softuerit i cili të gjitha palëve të interesuara do t'u jipej falas. Kjo do t'u krijonte mundësi grupeve të ndryshme që të mbledhin të dhëna të një forme të përshtatshme për analiza më të gjera dhe me saktësi më të madhe.

Grumbullimi i dëshmime

Ekipi i shqyrtoi si informatat e publikuara, ashtu edhe ato të papublikuara, të këtyre organizatave: Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Paqe Përmes Drejtësisë, Qendra për Paqe dhe Tolerancë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Qendra e të Drejtës Humanitare, Komiteti Kosovar i Helsinkit, Shoqata Nëna Tereze, Komiteti Serb i Helsinkit, Instituti i Avokatëve Amerikan për Iniciativën Juridike në Evropën Qendrore e Lindore (ABA/CEELI), Amnesti Internacional, Qendra e Berklit për të Drejtat e Njeriut, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, Mbikëqyrja e të Drejtave të Njeriut, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit, Interights - Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut, IPLS/ Asociacioni Amerikan për Përparimin e Shkencës, Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, Mjekët pa Kufij, Mjekët për të Drejtat e Njeriut (PHR), Shoqata për Popujt e Kërcënuar, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Jugosllavisë, Misioni Vëzhgues Diplomatik në Kosovë (KDOM), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni Verifikues në Kosovë (KVM), UNICEF-i, Komisionari i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara (UNHCR), Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar, Byroja Federale e Hetimeve e SHBA-ve (FBI), Prokuroria Shqiptare, Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi (ICTY), Departamenti i Shtetit i SHBA-ve dhe Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-ve. Edhe pse disa organizata nuk i janë përgjigjur kërkesës së Ekipit për informata, Ekipi është i bindur që mungesa e tyre nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në rrjedhën e qartë të argumentimit të këtij Kapitulli.

Këtu janë paraqitur raporte të shumta nga një numër i madh i organizatave ndërkombëtare, qoftë qeveritare, apo joqeveritare. Shumica prej tyre janë raporte përshkruese,

mirëpo disa përmbajnë edhe analiza statistikore, e ndër to janë edhe Mjekët për të Drejtat e Njeriut, Asociacioni Amerikan për Përparimin e Shkencës (AAAS), Qendrat për Kontrollimin e Sëmundjeve, dhe përpjekjet bashkëpunuese ndërmjet të ABA/CEELI-it, Mbikëqyrjes të të Drejtave të Njeriut, Mjekëve për të Drejtat e Njeriut, AAAS-it, dhe të Qendrës për Paqe Përmes Drejtësisë.

Konstatimet nga këto raporte i vërtetojnë shumë nga përfundimet e nxjerra nga raportet përshkruese. Sidoqoftë, studimet statistikore kanë përdorur edhe teknika çfarë janë vëzhgimi i mostrave shkencore, të cilat e kanë futur rigorozitetin shkencor dhe i kanë hedhur poshtë informatat e njëanshme të cilat shpesh e kanë karakterizuar grumbullimin e të dhënave nga rrëfimet. Pos kësaj, metodologjia e përdorur në këto analiza e mundësoi trajtimin për shkallën e dhunës në nivel të Kosovës, ndërkohë që shumica e përshkrimeve narrative i nënvizonin rastet më tipike.

Duke e patur parasysh kritikizmin sipas të cilit shumica e informatave lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë e jipnin një paraqitje të ekzagjeruar të situatave, Ekipi ka mbledhur informata nga më shumë burime të ndryshme. Duke e peshuar me kujdes çdo vlerësim, analizat e Ekipit lidhur me këto informata janë përpjekur për ta shmangur mbështetjen në ato materiale të cilat në esencë përmbanin pretendime josubstanciale, apo të cilat qartazi ishin në kundërshtim me epërsinë e të dhënave të besueshme. Rastet për të cilat janë paraqitur në mënyrë specifike dallime në mesin e burimeve të besueshme, janë të dhëna në raport dhe në Aneks.

Siç u tha më sipër, Ekipi ka bërë përpjekje serioze për t'i grumbulluar dhe analizuar të gjitha të dhënat relevante për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Shkelje të ndryshme të të drejtave të njeriut ka patur edhe gjatë periudhës para konfliktit të armatosur. Megjithatë, është me rëndësi që këtu të theksohet se është e vështirë, nëse jo edhe e pamundur fare, që të bëhet një paraqitje e saktë dhe gjithëpërfshirëse e rasteve të vrasjeve të kryera para vitit 1998. Vlerësimi i saktë për rastet e dhunës ndaj popullatës civile, gjatë përshkallëzimit të konfliktit në periudhën maj - gusht të këtij viti, është i pamundësuar për shkak se nuk ishte e mundur të sigurohen të dhëna të detajuara dhe të verifikuara.

Duke e patur parasysh këtë, Ekipi po ashtu e nënvizon atë që gjatë mbledhjes së këtyre të dhënave, organizatat e ndryshme për të drejtat e njeriut, shpesh herë nuk janë bazuar në statistika si qëllim parësor. Në të shumtën e rasteve ato kanë qenë të interesuara që ta bëjnë vlerësimin e karakterit dhe të mënyrave të shkeljes së të drejtave të njeriut, me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik. Për ta realizuar këtë qëllim, ato përcaktoheshin për një qasje përshkruese, e cila përpiqej të nxiste ndjenja njerë

zore lidhur me tragjedinë e cila ishte duke ndodhur. Një qasje e tillë është padyshim e rëndësishme dhe e dobishme.

Një temë e përhershme diskutimi në radhët e organizatave për mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut ka qenë nevoja për kritere më të rrepta në mbledhjen dhe prezentimin e të dhënave në Kosovë. Duke filluar që nga 1997, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) e theksonte nevojën për më tepër saktësi në paraqitjen e të dhënave lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut. Kjo bëhej lidhur me raportin nga KMDLNJ:

Nga 2.263 raste të gjithmbarshme të shkeljes së “të drejtave të njeriut,” në periudhën që nga korriku e deri në shtator 1997, ata i përmendin 3 vrasje, tri “diskriminime në baza gjuhësore” dhe 149 “bastisje rutinore.” Duke i sistemuar nën të njëjtin kapitull si shkeljet e lehta ashtu edhe ato të rënda, statistikat dështojnë për të bërë paraqitjen e plotë të situatës.¹

Po kështu, edhe Amnesty International ia kishte kushtuar një raport të tërë çështjes së ashpërsimit të kritereve lidhur me dokumentimin e luftës së korrikut në Rahovec.² Sipas Amnesty International, qëllimi i raportit ishte që të:

Shikonte raportet kundërthënëse, për të cilat thuhet se ishin të mbështetura në pohimet e dëshmitarëve, të gazetarëve, mbikëqyrësve të të drejtave të njeriut dhe të tjerëve, dhe në argumentet lidhur me të vertetën për ngjarjet e gjysmës së dytë të korrikut, të cilat ishin të paraqitura në furinë e raporteve jo të sakta, nga publikimi i të dhënave të paverifikuara, dhe nga dezinformatat e planifikuara nga të dyja palët në konflikt dhe nga përkrahësit e tyre.³

Ky Raport i Amnesty International, i cili u publikua në gusht 1998, mbyllet me një varg rekomandimesh, duke e përfshirë këtu edhe paraalajmërimin specifik që autoritetet serbe duhet të bashkëpunojnë me hetuesit dhe prokurorët e Tribunalit të Hagës, dhe ta lejojnë praninë e një misioni afatgjatë të vëzhguesve të OSBE-së përbrenda Kosovës.⁴

Për situatat e ngjashme në të ardhmen, Ekipi shpreson që si raportet përshkruese ashtu edhe ato statistikore, duhet të përpilohen së bashku, ashtu si është sygjëruar në fund të Aneksit. Teknologjia e re dhe përvojat nga ky konflikt lënë vend për optimizëm.

Shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare në Kosovë gjatë periudhës 24 Mars – 10 Qershor 1999

Gjatë punës së tij Ekipi ka përfituar shumë nga ndihma e rëndësishme e grupit të hulumtuesve të cilët bënë përpjekje maksimale për t'i sistemuar të dhënat mbi shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare para, gjatë dhe pas fushatës së NATO-s.⁵ Njëri nga aspektet më të rëndësishme të këtij procesi ishte në përpjekjet për ta afirmuar bashkëpunimin ndërmjet organizatave të shumta ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, të cilat mund të siguronin të dhëna. Rezultat i kësaj, sipas bindjes sonë, ishte raporti unik më gjithpërfshirës dhe më i detajuar.

Në vazhdim do ta paraqesim një analizë të dëshmimeve përshkruese për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, të mbështetura në të dhënat që i janë dorëzuar Ekipit nga organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare. Gjatë fushatës së NATO-s, grumbullimi i këtyre rrëfimeve, nga burime të ndryshme brenda vetë Kosovës, ishte për së tepërmi i vështirë. Pas tërheqjes së Misionit Verifikues të OSBE-së nga Kosova, më 22 mars 1999, faktikisht përfunduan të gjitha llojet e mbikëqyrjes të shkeljeve të të drejtave të njeriut në terren, e të cilat më parë kryheshin nga organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe nga OJQ-të. Disa OJQ vendore u përpoqën që të vazhdojnë me aktivitetet mbikëqyrëse edhe gjatë kësaj periudhe.⁶ Megjithatë, shumica e rrëfimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë fushatës së NATO-s, janë siguruar nga intervistat me refugjatë, një pjesë e të cilave u bënë jashtë Kosovës, apo me refugjatët të cilët u kthyen pas përfundimit të fushatës së bombardimeve.⁷ Këto intervista, zakonisht u bënë nëpër kampet e refugjatëve apo në familjet mikpritëse në Shqipëri, Maqedoni, në Fort Dix, e Nju Xherisi. Gjatë vlerësimit të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë fushatës ajrore të NATO-s, organizata dhe agjencione të tjera u mbështetën në të dhënat e mjekësisë ligjore të paskonfliktit,⁸ në lajmet e botuara,⁹ në hulumtime të pavarura,¹⁰ apo në të dhënat ushtarake apo të shërbimit të inteligjencës.¹¹ Mirëpo, kishte edhe organizata të tjera, të cilat ia arritën të grumbullojnë të dhëna me rëndësi potenciale, e që nuk janë publikuar në asnjë trajtë.¹²

Shkeljet e shumta të të drejtave të njeriut¹³ në Kosovë, në periudhën 24 mars – 10 qershor 1999, mund të përmblihen në dhjetë kategoritë të cilat janë të dhëna në vijim: zhvendosjet e detyrueshme; vrasjet; përdhunimet/sulmet seksuale; burgosjet arbitrare dhe shkelja e të drejtës për gjykim korrekt; shkatërrimet, plaçkitjet dhe djegiet e pasurisë së qytetarëve; mburoja njerëzore dhe vënia e popullatës civile në rrezik; shkeljet e neutralitetit mjekësor; tortura, trajtimi mizor dhe jonjerëzor; konfiskimi i dokumenteve; dhe, shkeljet nga ana e NATO-s.

Zhvendosjet e detyrueshme

Gjatë kohës së fushatës ajrore të NATO-s,¹⁴ jashtë Kosovës janë dëbuar përafërsisht 863.000 refugjatë, duke bërë që numri i përgjithshëm prej të paktën “një milion” njerëzish të arratiseshin jashtë Kosovës që nga marsi i vitit 1998 e deri në fundin e luftës.¹⁵ Shumica nga këta refugjatë përfunduan nëpër kampet e refugjatëve, ose nëpër familjet mikpritëse në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, dhe në Bosnje e Hercegovinë. Rreth 80.000 u transferuan në vende të tjera të Evropës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjetkë. Pos kësaj, mbi 590.000 veta ishin të detyruar të zhvendoseshin nga shtëpitë e tyre, mirëpo mbetën brenda në Kosovë.¹⁶ Duke i marrë të gjitha këto së bashku, këto të dhëna e dëshmojnë që mbi 90 % e popullatës së tërësishme shqiptare të Kosovës, më 1998 ishin të dëbuar nga shtëpitë e tyre.¹⁷

Planifikimi substancial dhe kordinimi i këtyre deportimeve masive dëshmohej me faktin që para marsit ishin dy trena të rregullt ditor nga Prishtina për në kufirin me Maqedoninë, dhe këta rëndom ishin me nga tre vagonë. Gjatë deportimeve çdo ditë kishte edhe nga tre e katër trena më tepër, secili me nga trembëdhjetë deri në njëzet vagonë. Një raport dëshmon për një tren me njëzetetë vagonë të stërmbushur me njerëz që po largoheshin nga Prishtina për në Maqedoni.¹⁸

Kishte pengesa të mëdha për kuantifikimin e ekzodit. Mirëpo është e qartë që shumica e popullatës shqiptare të Kosovës janë arratisur nga shtëpitë e tyre gjatë kohës së konfliktit, posaçërisht ndërmjet 23 marsit dhe 6 prillit 1999.¹⁹ Grumbullimi i informatave nga refugjatët që arratiseshin nga Kosova vështirësohej nga një numër faktorësh, ndër të cilët më të rëndësishmit ishin kushtet kaotike të kohës së luftës në të cilat ata po arratiseshin, karakteri i ndieshëm i informatave të cilat kërkoheshin në shumicën e rasteve në bisedat me refugjatë, fakti që informatat ishin potencialisht të njëanshme, si dhe fakti që informatat e mbledhura, kur siguroheshin, rëndom ishin traumatike dhe, rrjedhimisht, konfuzë.

Përkundër këtyre faktorëve, shumë organizata ia dolën që me sukses të mbledhin informata të shumta, dhe atë nga refugjatët që po largoheshin, nga ata që ishin nëpër kampe, nga familjet të cilat gjatë kohës së luftës u kishin dhënë atyre strehë jashtë Kosovës, apo edhe nga refugjatët të cilët pas konfliktit u kthyen në Kosovë. Ndër këto organizata ishin OSBE-ja, MVK-ja, Misioni Vëzhgues Diplomatik në Kosovë, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Avokatëve, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive, ABA/CEELI në bashkëpunim me Qendrën për Paqe përmes Drejtësisë (Tiranë), UNHCR-ja dhe shumë të tjera. Informatat themelore siç janë emri, komuna, fshati si dhe data e largimit, janë siguruar nga zyrtarët vëzhgues nëpër doganat dhe kufijt e

vendeve fqinje, pra, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

Nga informatat e grumbulluara mund të nxirren dy lloje të të dhënave; përpilimi i informatave përshkruese, dhe përfundimet statistikore të cilat dalin nga analizat specifike të raporteve për refugjatët. Shumë organizata kanë bërë raporte të tipit të parë, duke i përpiluar rrëfimet sipas datës dhe vendit, si dhe duke e përshkruar, varësisht nga rrëfimet, karakterin e ngjarjeve të cilat kishin ndodhur.²⁰ Akademia Amerikane për Përparimin e Shkencës (AAAS), e ka bërë të vetmen analizë statistikore të përpiluar deri më sot, të informatave që janë fituar nga të dhënat lidhur me refugjatët.

Analizat statistikore të bëra nga AAAS lidhur me zhvendosjet e detyrueshme, i kanë ndriquar deri në një masë shkaqet se pse shumica e refugjatëve dhe e personave të zhvendosur nga Kosova janë arratisur nga shtëpitë e tyre. Raporti e bën një analizë të informatave të mbledhura nga zyrtarët e Qeverisë Shqiptare të cilët i kanë regjistruar refugjatët gjatë kalimit të kufirit Shqipëri/Kosovë në vendkalimin e Morinës. Ekipi ka kërkuar informata të ngjashme edhe nga zyrtarët kufitarë të Maqedonisë për vendkalimin e Bllacës, që t'i ketë në dispozicion me qëllim të përpilimit të analizave sa më gjithëpërfshirëse. Raporti i AAAS-së i analizon korrelacionet ndërmjet momentit të largimit të refugjatëve, të lokacionit të shtëpive të tyre, të caqeve që bombardoheshin nga NATO-ja dhe të vendeve ku janë kryer vrasjet masive. Nga këto korrelacione, raporti e dëshmon që fluksi i refugjatëve nuk kishte të bënte as me bombardimet e NATO-s, dhe as me vendet ku janë kryer vrasjet masive, dhe, rrjedhimisht, ky e dëshmon që as bombardimet dhe as vrasjet masive nuk e kanë shkaktuar në mënyrë direkte fluksin e refugjatëve. Mëpastaj, raporti e bën analizën e vendeve prej nga refugjatët ishin arratisur dhe të datave të arritjes së tyre në kufi. Kjo analizë e dëshmon që refugjatët janë larguar në tri valë të mëdha, dhe nga secili prej tri rajoneve të Kosovës. Trajtat e rregullta në të cilat secila nga këto valë me refugjatë fillonte dhe përfundonte, para se t'ia niste vala tjetër, e dëshmon që popullata shqiptare e Kosovës dëbohej në mënyrë sistematike dhe sipas një plani të përgatitur dhe të zbatuar me kujdes.²¹

Rrëfimet e mbledhura nga një varg i organizatave joqeveritare, hedhin dritë mbi rrethanat në të cilat ishin realizuar shumica e largimeve nga Kosova. Faktikisht, të gjithë të zhvendosurit ishin shqiptarë të Kosovës të cilët ishin detyruar që t'i braktisnin shtëpitë e tyre nga pjesëtarët e Forcave të Armatosura Jugosllave, nga policia serbe, ose nga njësitet e armatosura paramilitare.²² Dëshmitarë nga komuna të ndryshme të Kosovës kanë dëshmuar për raste të ngjashme të dëbimeve.²³ Forcat serbe e rrethonin fshatin apo qytetin dhe sulmonin me mortaja dhe predha artillerike, duke i detyruar në këtë mënyrë shumë njerëz që të strehoheshin nëpër bodrume, apo të arratiseshin

nëpër malet e afërta. Pas kësaj, forcat serbe hynin në fshat, e që përcillej me të shtëna të shumta në ajr, dhe futeshin nëpër shtëpitë e shiptarëve. Në fund, anëtarët e familjeve të cilët i gjenin nëpër shtëpi, i kërcënonin dhe u jipnin një afat të shkurtër kohor - nga disa minuta deri në disa orë - brenda të cilit ata duhej t'i mblidhnin plaçkat dhe të largoheshin. Në shumicën e rasteve, ky proces është shoqëruar me dhunë fizike, djegie dhe vrasje. Pas largimit të banorëve nga fshatrat, forcat serbe vërsuleshin për t'i plaçkitur dhe djegur shtëpitë dhe objektet e tjera, dhe për ta vrarë bagëtinë. Në disa vende, si në Prishtinë, banorët janë detyruar që t'i paguajnë trenat apo autobusat që do t'i shpienin deri në kufi. Të tjerët kanë udhëtuar me traktorë, vetura, qerre, ose edhe këmbë. Në rastet e tjera, qytetarët janë lejuar që t'i mirrnin veturat apo traktorët dhe janë urdhëruar që t'i përmbahen një rruge të caktuar deri në kufi. Shumë banorë të komunave të pjesës lindore të hekurudhës kryesore Veri-Jug janë detyruar të ecnin këmbë deri tek stacionet e trenit, prej nga, mëpastaj, me trena janë dërguar për në kufirin me Maqedoninë.

Vrasjet

Vrasjet e grupeve të mëdha të njerëzve të kryera në mënyrë arbitrare kanë qenë një dukuri mjaft e përhapur në këtë periudhë. Bashkësia Ndërkombëtare nuk ia ka arritur ende që ta saktësojë numrin e personave të vrarë gjatë konfliktit në Kosovë. OSBE-ja nuk e ka dhënë ndonjë shifër të caktuar të këtij numri. Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla Del Ponte, i ka raportuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së që Gjykata ka raporte për 11.000 njerëz të vrarë, dhe se deri në nëntor 1999 është bërë ekshumimi i 2.108 kuformave.²⁴ Departamenti i Shtetit i SHBA-ve e ka vlerësuar që 6.000 njerëz janë vrarë dhe varrosur nëpër varrëza kolektive, dhe se numri i përgjithshëm i personave të vrarë është rreth 10.000.²⁵

Ndërkohë që ekzistojnë raporte të pakta për vrasje të grupeve të mëdha të serbëve nga ana e UÇK-së,²⁶ është raportuar që shumica dërrmuese e vrasjeve të grupeve të mëdha të kryera në mënyrë arbitare janë bërë nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Këto vrasje janë kryer në trajta të shumta. Gjatë dëbimeve të detyrueshme, forcat serbe disa herë kanë ekzekutuar në mënyrë arbitare grupe të shqiptarëve të Kosovës, për t'u dhënë "shembull" bashkëfshatarëve dhe anëtarëve të familjeve se çfarë mund t'u ndodhë edhe atyre. Po ashtu, gjatë dëbimeve të dhunshme, forcat serbe të shumtën i kanë ndarë femrat nga meshkujt. Në shumë raste, grupe të meshkujve janë mbledhur në një vend dhe janë vrarë. Ngjashëm janë vrarë edhe njerëz që nëpër kolona shkonin në

drejtim të kufirit, pasi që ishin larguar me dhunë. Forcat serbe, po ashtu, e kanë patur zakon që herë pas here t'i rrethonin grupet e njerëzve të arratisur nga shtëpitë që fshiheshin nëpër male dhe pyje, dhe i vranin. Po ashtu, një shënjestër e posaçme gjatë vrasjeve kanë qenë edhe fëmijët.²⁷

Krahas vrasjeve arbitare, është vërejtur fare qartë se ka patur pjesë të veçanta të forcave serbe të cilat e kishin për qëllim vrasjen e pjestarëve të shquar të shoqërisë shqiptare të Kosovës. Njëri nga rastet më të shquara të tilla, ishte vrasja e avokatit më të dalluar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Bajram Kelmendit me djemtë e tij. Mirëpo në shënjestër ishin po ashtu, edhe avokatë të tjerë, mjekë e udhëheqës politikë.²⁸

Viktimat arbitrare dhe ato në grupe rëndom janë vrarë me armë zjarri.²⁹ Mirëpo, sipas disa raporteve, vrasjet individuale dhe ato masive janë kryer po ashtu duke i djegur viktimat për së gjalli nëpër shtëpitë të cilat mbylleshin me dry dhe mëpastaj u vihej flaka, apo edhe duke i rrahur deri në vdekje. Pos këtyre mënyrave, shumë qytetarë janë vrarë gjatë granatimeve dhe bombardimeve të fshatrave, si dhe nga të shtënat kuturu, gjatë përdorimit të pakontrolluar të armëve nga forcat serbe.³⁰

Raportet e bëra gjatë kohës së fushatës ajrore të NATO-s e dëshmojnë që forcat serbe janë përpjekur t'i minimizonin të dhënat për vrasjet masive, duke i zhdukur varrezat masive apo edhe duke e bërë zhvarrosjen e kufomave nga to.³¹ Po ashtu ka të dhëna që forcat serbe i kanë lënë kufomat të dekompozohen duke mos e bërë varrosjen me ditë dhe javë të tëra, e nganjëherë edhe i kanë penguar shqiptarët e Kosovës që varrimin e kufomave ta bëjnë sipas zakoneve të tyre fetare.³²

ABA/CEELI dhe Asociacioni Amerikan për Përparimin e Shkencës (AAAS), në bashkëpunim dhe me ndihmën e OJQ-ve me të cilat kishin synime të njëjta lidhur me të drejtat e njeriut, duke i përfshirë këtu edhe Qendren për Paqe përmes Drejtësisë (Qendra), Mjekët për të Drejtat e Njeriut (PHR) dhe Human Rights Watch, kanë bërë analiza statistikore të të dhënave të dokumentuara të vrasjeve të kryera gjatë konfliktit në Kosovë.³³ Secila nga këto organizata ka bërë intervista të shumta dhe të gjata me kosovarët, lidhur me atë që kishte ndodhur gjatë konfliktit. Në tërësi, studimi i ka përfshirë 3.353 intervista.

Ekspertët e AAAS-së e vlerësojnë që në periudhën nga 20 marsi e deri më 12 qershor të vitit 1999, janë vrarë rreth 10.500 shqiptarë të Kosovës. Këto vlerësime janë të përafërta me numrin e dhënë më parë nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve dhe nga ICTY-ja. Për më tepër, këto të dhëna janë fituar me metoda statistikore që tashmë kanë përdorim të gjerë, dhe të cilat mund të mbrohen para gjyqit të ligjit.³⁴

Për shkak se vlerësimi për 10.500 të vrarë është nxjerrë nga mostra e popullatës dhe

jo nga tërë popullata, duhet llogaritur brezi i cili e paraqet marginën e gabimit të vlerësimit për shkak të metodës së marrjes së mostrës dhe për shkak të teknikës vlerësuese. Duke marrë intervalin e besueshmërisë 95% , ekspertët e statistikës të AAAS-ë e vlerësuan që numri i shqiptarëve të Kosovës të vrarë gjatë kësaj periudhe ndodhet në brezin ndërmjet 7.494 dhe 13.627. Ky interval i besueshmërisë tregon që sikur ky studim të përsëritej 100 herë, duke përdorë lista të ndryshme, mirëpo të pavarura të të dhënave, do të mund të pritet se në 95 nga 100 studime, vlerësimi do të jetë në brezin 7.494 – 13.627 vrasje.³⁵

Ky interval i besueshmërisë është më i rëndësishmi, meqë e jep përfundimin që vlerësimi mbi 10.500 të vrarë është në përputhshmëri me konstatimet e tjera të vlerësimeve shkencore për numrin e të vrarëve. Në shtator 1999, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve në Kosovë e bëri një vëzhgim të kategorizuar në dy nivele të popullatës shqiptare të Kosovës. Ata mblodhën të dhëna retrospektive të mortalitetit, përfshirë edhe shkakun e vdekjeve për periudhën nga shkurti 1998 deri në qershor 1999. Raporti i tyre erdhi në përfundimin që gjatë luftës janë vrarë përafërsisht 12.000 kosovarë, duke e fituar intervalin e besueshmërisë nga 5.500 deri në 18.300.³⁶ Krahas kësaj, Mjekët për të Drejtat e Njeriut³⁷ e konstatuan se 9.269 shqiptarë të Kosovës kanë qenë të vrarë një vit para intervistave (ku shumica e këtyre vrasjeve janë bërë gjatë vitit 1999). Intervali i besueshmërisë prej 95% lidhur me numrin e vrasjeve të vlerësuar nga Mjekët për të Drejtat e Njeriut, është i afërt me numrin e të vrarëve nga 6.911 – 11.627. Vërehet që studimi i bërë nga ABA/CEELI-AAAS, me të dhënë për 10.500 të vrarë, është në përputhje edhe sa i përket intervalit të besueshmërisë, edhe sa i përket vetë vlerësimit, me studimet e bëra nga PHR-ja dhe CDC-ja. Në këtë mënyrë, është një konvergencë e përgjithshme e vlerësimeve të ABA/AAAS me vlerësimet e tjera shkencore.³⁸

Përmes këtij krahasimi të gërshetuar, tani është e mundur të theksohet se ekzistojnë të dhëna të forta shkencore të cilat i përkrahin të dhënat e mëparshme të vlerësuara nga ICTY-ja dhe nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve. Ndërkohë që të dhëna të tjera mund të sjellin saktësime edhe më të mëdha në vlerësimin e përgjithshëm, sipas të gjitha gjasave, vlerësimi i bërë nga ABA/CEELI – AAAS, me të dhënat plotësuese mund të shënojë një rritje të vogël dhe jo zbritje. Prandaj, vlerësimi mbi 10.500 të vrarë duhet të mirret si minimumi i numrit të përgjithshëm të të vrarëve.³⁹

Një vlerësim i saktë për numrin e përgjithshëm të të vrarëve është i rëndësishëm në aspektin gjeopolitik, mirëpo, është po ashtu me një rëndësi të madhe edhe vlerësimi i saktë për kohën në të cilën janë bërë vrasjet. Përfundimet mbi këtë çështje e nxjerrin

në pah atë që shumica e vrasjeve të dokumentuara,⁴⁰ janë kryer ndërmjet fundit të marsit dhe mesit të prillit. Kjo kohë është në korrelacion me numrin më të madh në fluksin e refugjatëve. Duke u mbështetur në hulumtimet e mëparshme të AAAS-së lidhur me fluksin e refugjatëve, rezultatet e këtij studimi e sfidojnë përfundimin që ka ekzistuar një fushatë sistematike e organizuar kundër popullatës shqiptare të Kosovës.⁴¹

Analiza e bërë gjatë dokumentimit të vrasjeve, sipas kohës kur ato janë kryer, e tregon që kulminacioni i vrasjeve është shënuar në fundin e marsit, dhe ky është pasuar nga edhe një tjetër në gjysmën e prillit. Disa raporte tregojnë edhe për një pikë tjetër kulminacioni, i cili ishte më i vogël, mirëpo i furishëm, nga fundi i prillit e deri në mesin e majit, e pas të cilës numri i vrasjeve të dokumentuara shënoi rënie. Çështja e momenteve më kritike sa i përket vrasjeve, përputhet me fluksin e refugjatëve i cili ndodhte gjatë të njëjtave periudha. Në studimin e AAAS-së 'Politikë apo Panik' (2000), arratisja e refugjatëve jashtë Kosovës është përshkruar si një e cila ka ndodhur në tri faza kryesore: 24 mars - 6 prill; 17 - 23 prill; dhe 24 prill - 11 maj. Në fillimin e secilës fazë, fluksi i refugjatëve ishte relativisht i ulët. Mëpastaj, numri i refugjatëve që arratiseshin nga Kosova vinte duke u ngritur deri në një pikë kritike, e cila ndodhte kah mesi i fazës, dhe kjo, më tutje, pasohej nga rënia në fundin të fazës (kulminimi, kulmi dhe qetësimi).⁴²

Duke e bërë krahasimin e numrit të vlerësuar të njerëzve të cilët u arratisën nga komunat e tyre gjatë kohës kur kanë filluar bombardimet e NATO-s, studimi i AAAS-së vie në përfundimin se vetëm një pjesë e vogël e shqiptarëve të Kosovës janë larguar nga Kosova si rezultat i drejtpërdrejtë i bombardimeve të NATO-s. Në këtë studim po ashtu konstatohet që ekzodi masiv i refugjatëve kosovarë është bërë në intervale aq të rregullta sa që kjo vetë është një dëshmi që veprimet e forcave serbe duhet të kenë qenë të koordinuara. Po ashtu, edhe në kontekstin e të dhënave kualitative të ofruara nga refugjatët, shpjegimi më i saktë i mundshëm i arratisjes është ai që kjo ka ndodhur si pasojë fushatës së organizuar nga një qendër, me qëllim të spastrimit të së paku disa rajoneve të banuara nga shqiptarët etnik.⁴³

Vlerësimi i fundit sfidohet edhe nga raportet për kohën kur janë kryer vrasjet, e cila është e dhënë në këto analiza. Mostrat e vrasjeve e japin një pasqyrim të fuqishëm të fluksit të refugjatëve. Po qe se vrasjet janë përdorur si mjet tmerrimi për t'i nxitur dhe përshpejtuar largimet e detyrueshme të masës, atëherë përfundohet që edhe flukset e refugjatëve janë rezultat logjik i vrasjeve. Në përputhje të plotë me këtë postulat është vetë ngjashmëria e madhe ndërmjet ngritjes dhe rënies së numrit të refugjatëve që

ishin arratisur nga shtëpitë e tyre, me raportet e vetë vrasjeve. Dhe, nga ana tjetër, fakti që shtimi i numrit të vrasjeve lëvizte paralelisht me fluksin e refugjatëve, është në përputhje të plotë me vlerësimin që ka ekzistuar një fushatë e organizuar dhe e udhëhequr nga qendra, dhe e cila ishte e drejtuar kundër shqiptarëve etnik.⁴⁴

Të dhënat mbi vrasjet e njerëzve në Kosovë, si përnga koha ashtu edhe përnga vendi ku ato kryheshin, përputhen me ato të arratisjes së refugjatëve, e që vetvetiu flet për një koordinim. Raportet nga rrëfimet e refugjatëve të intervistuar nga Qendra, ABA/CEELI, PHR, dhe Human Rights Watch, shumicën dërrmuese të vrasjeve ia atribuojnë Qeverisë Jugosllave dhe forcave paramilitare serbe. Ky vlerësim është në përputhje edhe me informatat e mbledhura nga organizatat e tjera, si Grupi Ndërkombëtar i Krizave⁴⁵ dhe nga OSBE-ja.⁴⁶ Në dritën e burimeve kualitative të cilat vargun e gjatë të shkeljeve të të drejtës humanitare ndërkombëtare ia atribuojnë forcave jugosllave, dhe në bazë të konkludimit ekzistues që vetë mënyra e zbatimit të dhunës tregon për një koordinim qendror, raporti i ABA-AAAS-it e konstaton që vetë të dhënat e bëjnë të kuptohet që forcat jugosllave e kanë bërë koordinim qendror të dhunës së dokumentuar.⁴⁷

Dhunimet/keqtrajtimet seksuale

Rastet e dhunimeve dhe të keqtrajtimeve seksuale të cilat kanë ndodhur gjatë fushatës ajrore, ishin vetëm një vazhdimësi e trendit të filluar nga forcat serbe para një dekade. Shumë OJQ vendore dhe ndërkombëtare kanë raportuar për raste të dhunimeve edhe gjatë periudhës para bombardimeve. Megjithatë, shumica e këtyre rasteve nuk janë paraqitur fare.⁴⁸ Mirëpo, janë dhënë përshkrime të sakta mbi atë se si gjatë periudhës nga 24 marsi e deri më 10 qershor janë dhunuar një numër i madh grash, dhe atë kryesisht për shkak të asaj që njollosja e cila shkaktohet nga kjo lloj dhune në shoqërinë tradicionale shqiptare shkakton që rastet e dhunimit në Kosovë të mos lajmërohen fare. HRW i ka dokumentuar 96 raste të dhunimit, mirëpo këtu duhet theksuar që për shkak të ngurrimit të femrave shqiptare për t'i raportuar keqtrajtimet seksuale, kjo e dhënë e paraqet vetëm një pjesë të imtë të numrit të vërtetë të keqtrajtimeve.⁴⁹ Rastet e raportuara e dëshmojnë që forcat serbe gjatë periudhës prej 24 marsit e deri me 10 qershor kanë bërë dhunime në Kosovë, dhe atë në mënyrat të cilat do të përshkruhen në vijim.

Dhunimet janë kryer më së shpeshti gjatë dëbimeve të dhunshme, kur bëhej ndarja e femrave nga meshkujt. Forcat serbe, herë pas here, i grumbullonin femrat në ndonjë

shtëpi ku ato mëpastaj edhe dhunoheshin.⁵⁰ Kishte raste kur femrat ndaheshin nga familjet e tyre dhe dërgoheshin në ndonjë shtëpi apo edhe në ndonjë fshat tjetër, ku mëpastaj dhunoheshin, dhe shpesh herë ndodhte që të ktheheshin pas disa orësh. Forcat serbe po ashtu kanë dhunuar gra e vajza para familjeve të tyre, dhe këtë e bënin në mënyrë publike, në shtëpitë e tyre, jashtë shtëpive gjatë dëbimeve, ose edhe buzë rrugëve nëpër të cilat po kalonin kolonat e refugjatëve. Është raportuar për disa grupe të femrave të cilat janë dërguar nëpër hotele e kampe ushtarake, e ku janë mbajtur për një kohë të gjatë, duke u bërë në këtë mënyrë viktime të dhunimeve të shumta. Forcat serbe kërcënimin me dhunim e përdornin, po ashtu, si një mjet shantazhi për t'ua marrë paratë familjeve të grave e të vajzave.

Burgosjet arbitare dhe shkelja e të drejtës për gjykim korrekt

Arrestimet dhe burgosjet arbitrare kanë qenë një dukuri e shpeshtë gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, dhe atë posaqërisht pas miratimit të një ligji në procedurën penale nga ana e Qeverisë Jugosllave.⁵¹

Gjatë dëbimeve të dhunshme, kur femrat zakonisht ndaheshin nga meshkujt, forcat serbe shpesh herë i ndalonin meshkujt shqiptarë të “moshës luftarake,” e ku bënin pjesë të gjithë ata që ishin të moshës ndërmjet 14 e 65 vjet. Veprime të njëjta janë zbatuar shpesh herë edhe ndaj meshkujve të cilët nxirreshin nga kolonat e të zhvendosurve. Këta persona në të shumtën e rasteve mbaheshin nëpër objekte të arrestit që zgjidheshin ad hoc, më së shpeshti nëpër shkolla e fabrika, apo, shpesh herë, edhe nëpër burgje. Objektet që janë përdorur më së shpeshti për këtë qëllim ishin ato në Istog, Lipjan, Vushtrri, Prishtinë, Pejë dhe në Gjakovë.

Ata që burgoseshin në këtë mënyrë rëndom rraheshin dhe torturoheshin, si dhe detyroheshin të nënshkruajnë dokumente në të cilat e pranonin që kanë bashkëpunuar me UÇK-në. Pas fillimit të fushatës ajrore të NATO-s, përpjekjet për të organizuar gjykime të rregullta për të arrestuarit kanë qenë fare të pakta. Të drejtat e personave të arrestuar gjatë paraqitjes para gjyqit janë shkelur në mënyrë rutinore.⁵² Shumë prej tyre janë vrarë, ndërkaq, shumë të tjerë, aty nga fundi i fushatës së NATO-s, janë transferuar nëpër burgje në Serbi. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq e ka vlerësuar që gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s janë zhdukur përafërsisht 2.500 persona. Nga ky numër, përafërsisht 2.000 kanë qenë të kidnapuar nga forcat serbe.⁵³

Edhe vetë UÇK-ja është involvuar, po ashtu, në burgosjet dhe arrestimet e serbëve të Kosovës dhe të policëve, dhe e kishte krijuar sistemin e vet gjyqësor për trajtimin e të

burgosurve. Edhe pse nuk është e qartë se çfarë shtrirje ka patur kjo veprimtari gjatë bombardimeve të NATO-s, KNKK-ja e ka vlerësuar që nga numri i tërësishëm i personave të zhdukur gjatë të tërë koknfliktit, 370 kanë qenë të kidnapuar nga UÇK-ja.⁵⁴

Shkatërrimet, plaçkitjet dhe djegiet e pasurisë së qytetarëve

Sulmet mbi pronën e qytetarëve kanë qenë ndër tiparet më të shquara gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s. Shumica dërrmuese e refugjatëve kanë njoftuar për rastet e shkatërrimit të pasurisë së personave civil, për plaçkitje dhe për djegie.⁵⁵ Është raportuar për mbi 500 fshatra të djegura, nga të cilat 54 janë identifikuar si të shkatërruara ose të djegura në pjesën më të madhe apo në tërësi.⁵⁶

Sulmet e tilla janë bërë pothuaj ekskluzivisht nga forcat serbe kundër pasurisë së shqiptarëve kosovarë, dhe atë rëndom gjatë procesit të dëbimit të dhunshëm. Në raste të shumta, shtëpitë e qytetarëve janë shkatërruar gjatë granatimit, i cili ishte veprim që bëhej me qëllim që t'i paraprinte dëbimit të dhunshëm. Edhe më shpesh ndodhte që pas largimit të banorëve të fshatit, forcat serbe futeshin në fshat duke djegur dhe plaçkitur nëpër shtëpitë e braktisura të shqiptarëve kosovarë. Disa raporte e kanë bërë të ditur që forcat serbe shërbeheshin edhe me lista të shqiptarëve kosovarë të pasur, dhe në këtë mënyrë i identifikonin caqet më të mira për plaçkitje.⁵⁷ Nuk ka shpëtuar pothuaj asnjë dyqan apo objekt biznesi i cili u kursye nga këto sulme. Në zonat rurale, një dukuri e cila përsëritej shpesh herë ishte vrasja e bagëtisë,⁵⁸ dhe kërmat shpesh herë hidheshin nëpër puse.⁵⁹ Pas plaçkitjeve e shkatërrimeve, shtëpive dhe bizneseve shpesh herë u vihej flaka. Pos kësaj, raporte të shumta tregojnë që forcat serbe i kanë sulmuar dhe shkatërruar edhe objektet fetare, dhe në veçanti xhamitë, si dhe objektet me rëndësi historike e shoqërore.

Forcat serbe po ashtu konfiskonin edhe pasuri personale, të shumtën para dhe automjete, dhe kjo ndodhte në pikat e kontrollit policor ose duke i nxjerrë viktimat nga kolonat e të zhvendosurve. Ata paratë më së shpeshti i vjedhnin duke u kërcënuar se do ta vrasin apo dhunojnë ndonjë anëtar të familjes.

Mburojat e gjalla dhe vënia e popullatës në rrezik

Gjatë periudhës së fushatës ajrore të NATO-s, forcat serbe, siç është raportuar, në shumë raste i kanë përdorur shqiptarët kosovarë si “mburojë e gjallë.” Disa refugjatë kanë dëshmuar mbi atë se si kanë qenë të detyruar që t'i shoqëronin kolonat ushtarake

serbe, si hakmarrje për sulmet ajrore të NATO-s.⁶⁰ Është po ashtu e mundur që të zhvendosurit të kishin qenë të detyruar që të stacionohen në afërsi të forcave serbe, si caqe potenciale të NATO-s, duke u bërë kështu pa dijeninë e tyre mburojë e gjallë.⁶¹ Është e vështirë që të bëhet një vlerësim i përmasës së saktë të veprimeve të tilla, ndër të tjerat edhe për faktin që viktimat shpesh herë nuk kanë qenë të vetëdijshme se janë në rrezik. Ka patur, po ashtu, edhe incidente në të cilat forcat serbe i shoqëronin grupet e të zhvendosurve, e ku shqiptarët kosovarë nuk janë përdorur si mburojë e gjallë.

Ka po ashtu raporte të cilat e dëshmojnë që forcat serbe i kanë detyruar shqiptarët kosovarë që të vishnin uniforma ushtarake serbe, dhe mëpastaj kanë vendosur grupe të tyre brenda caqeve të mundshme të NATO-s, duke u përpjekur që të shkaktonin viktima në popullatën civile. Forcat serbe i kanë shfrytëzuar po ashtu edhe lokalitetet civile, duke i përfshirë këtu edhe shtëpitë private, për të fshehur municione, armë dhe automjete ushtarake.

Disa raporte njoftojnë për shqiptarë kosovarë të burgosur, të cilët kanë qenë të detyruar që të punojnë në kushte të rrezikshme. Raportet njoftojnë për të paktën dy incidente, në të cilat të burgosurit janë detyruar që të ecnin nëpër zona të caktuara, për të vërtetuar se a ishin ato të minuara apo jo; dihet që në këto raste janë plagosur të paktën katër shqiptarë kosovarë.⁶² Megjithatë, duket që kjo nuk ishte një dukuri e shpeshtë.

Shkelja e neutralitetit mjekësor

Gjatë periudhës së bombardimeve ajrore të NATO-s, nga ana e forcave serbe janë kryer një varg i shkeljeve të parimeve të neutralitetit mjekësor, të drejtuara kundër shqiptarëve kosovarë. Ndër veprimet e tilla bënin pjesë edhe përjashtimi i mjekëve shqiptarë kosovarë nga spitalet; ndjekja dhe vrasja e mjekëve; refuzimi i shërbimit mjekësor për pacientët shqiptarë kosovarë, ndër ta edhe të tillë që ishin të plagosur rëndë;⁶³ provokimi i mjekëve shqiptarë kosovarë; si dhe instalimi i paisjeve ushtarake nëpër kulmet dhe oborret e objekteve shëndetësore.⁶⁴ Forcat serbe, po ashtu, i kanë përdorur spitalet për strehim të municioneve. Ka njoftime sipas të cilave forcat serbe kanë shkatërruar rreth 100 spitale, klinika, dhe barnatore.⁶⁵

Tortura, trajtimi mizor e jonjerëzor

Në periudhën të cilën jemi duke e shqyrtuar, tortura dhe keqtrajtime janë kryer anembanë Kosovës. Intervistat me refugjatë e kanë dëshmuar që faktikisht në secilën komunë qytetarët janë ballafaquar me incidente të tilla, në të cilat ata u nënshtroreshin keqtrajtimit mizor, johumanë dhe degradues.⁶⁶ Raportet e dëshmojnë që incidentet e tilla kanë qenë tipari më i shquar i veprimeve të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë.

Keqtrajtimet e tilla më së shpeshti janë kryer gjatë mbajtjes së viktimave nëpër stacionet e policisë, burgje, apo në objekte të ngjashme ku mbaheshin të arrestuarit. Gjatë marrjes në pyetje, të arrestuarit shpesh herë janë rrahur, qoftë me grushta apo edhe me shkopa policore e shkopa të bejzbollit. Përmes kablllove elektrike janë kryer edhe torturime me tronditje elektrike. Viktimave u nxirreshin thonjtë e gishtërinjëve të këmbëve dhe të duarve, dhe u nguleshin gjilpëra nën thonjë. Është raportuar edhe për raste të vizatimeve me thikë nëpër trupat e viktimave.⁶⁷ Burrat, shpesh herë, janë goditur në pjesët gjenitale, janë urdhëruar të dalin lakuriq në publik, edhe pse ishin të burgosur. Raste të tilla kanë ndodhur edhe gjatë periudhës së dëbimeve të dhunshme, edhe nëpër shtëpitë private, dhe edhe nëpër kolonat e të zhvendosurve. Keqtrajtimi rëndom është pasuar nga plaçkitja e parave dhe të gjësendeve të tjera me vlerë.

Konfiskimi i dokumenteve

Gjatë kësaj faze, në raste të panumërta forcat serbe shqiptarëve kosovarë ua konfiskonin dokumentet, të shumtën pasaportat, letërnjoftimet dhe dokumentet e tjera të identifikimit. Numri i tërësishëm i incidenteve të tilla nuk mund të vlerësohet saktësisht, mirëpo sipas analizës së një mostre me mbi 1.200 refugjatë, është konstatuar që 60% prej tyre ose e kanë pësuar vetë, ose kanë qenë dëshmitarë të konfiskimit apo të shkatërrimit të dokumenteve të identitetit të shqiptarëve të tjerë.⁶⁸

Asgjësimi i dokumenteve të identitetit rëndom ka ndodhur gjatë dëbimeve të dhunshme nga shtëpitë, apo gjatë kalimit të të zhvendosurve nëpër kufirin me Shqipërinë dhe me Maqedoninë. Forcat serbe, po ashtu, e kanë konfiskuar një numër të madh të targave të automjeteve, të dokumentave të regjistrimit, të dokumentave të pronës, si dhe lloje të tjera dokumentesh.

Nevoja për një qasje të re në dokumentimin e shkeljes së të drejtave të njeriut

Duke përdorur lloje të ndryshme të raportimit për të drejtat e njeriut, mund të arrihet qartësi dhe efikasitet më i lartë gjatë shfrytëzimit të raporteve. Në përdorim janë të paktën tri lloje, dhe secili prej tyre e meriton një metodologji të veten të veçantë.⁶⁹ E para është për t'i marrë të dhënat nga dëshmitarët okularë lidhur me shkeljet specifike të të drejtave të njeriut, ashtu që të sigurohen informata përfundimtare, të besueshme dhe të mjaftueshme, për t'ia vënë në dispozicion opinionit publik të brendshëm dhe ndërkombëtar. Shembull për këtë është puna e bërë në Kosovë nga Organizata Human Rights Watch, e cila i ka kërkuar personelit të vet në terren që të ndërtojnë raporte mirëbesimi me dëshmitarët, dhe që të veprojnë me shpejtësi dhe fleksibilitet, ashtu që ta mundësonin raportimin me kohë.

E dyta është që të grumbullohen informata kuantifikuese, në bazë të të cilave do të mund të përcaktohet koha dhe shkalla e shkeljes së të drejtave të njeriut. Sipas kësaj metodologjie të punës, në Kosovë kanë vepruar Mjekët për të Drejtat e Njeriut. Në situata të konfliktit, në të cilat mundësia për të arritur deri te informatat është mjaft e kufizuar, ky proces ndeshet me pengesa të shumta metodologjike. Synimi për të siguruar të dhëna të sakta nga grupe të ndryshme, vështirësohet për së tepërmi po qe se metodat për grumbullimin e të dhënave dallojnë nga njëri grup në tjetrin. Mostrat e rastit ndihmojnë për ta kontrolluar njëanshmërinë, mirëpo këto nuk janë të lehta për t'u zbatuar në situatat e krizës. Vëzhgimet grupore dhe metoda të tjera të bazuara te popullata, kërkojnë standardizim dhe mjeshtri teknike.⁷⁰ Të dhënat nga dëshmitarët dhe nga intervistat nuk i nxjerrin të njëjtat saktësime dhe vlerësime, sikur ato që fitohen me matjet e fluksit të refugjatëve. Njëanshmëria e përzgjedhjes e kufizon vlerën e të dhënave nga intervistat për qëllime epidemiologjike, megjithëse informatat e tilla mund të jenë të një rëndësie jetike për ta analizuar karakterin dhe drejtimin e shkeljeve të veçanta të të drejtave të njeriut.

Në fund, këto të dhëna mund të përdoren për t'i identifikuar deklaratat e dëshmitarëve si ndihmesë për ICTY-në. Kjo lloj metode në Kosovë është zbatuar nga ABA/CEELI dhe nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave, të cilat kanë bashkëpunuar në krijimin e formave standarde të intervistave, si udhërrëfyes për të intervistuarit, duke u mbështetur në informatat që kërkoheshin nga ICTY-ja, dhe të cilat ishin të përpiluara ashtu që të ishin të përputhshme me regjistrin e të dhënave, në të cilin kanë mundur të vendosen informatat e grumbulluara nga grupe të ndryshme, dhe në situata të ndryshme.⁷¹

Informata plotësuese mund të jipen edhe nga grupet humanitare, të cilat pashmangshëm do të mbledhin rrëfime gjatë kohës së ofrimit të ndihmës dhe të mbrojtjes. Megjithatë, nëse këto grupe i shkëmbejnë informatat me grupet të cilat raportojnë për të drejtat e njeriut, neutraliteti i tyre mund të vihet në pyetje. Ndoshta përmirësimi i komunikimit ndërmjet këtyre dy llojeve të grupeve do të mund t'i pakësonte tendosjet, dhe do të mund të krijonte, po ashtu, lidhje më konstruktive. Grupet humanitare duhet që të bashkëpunojnë me grupet për të drejtat e njeriut dhe me ICTY-në, ashtu që të sigurojnë përkrahje të familjeve dhe ndërlidhje me to krahas hetimeve në terren, sepse hulumtimeve të tilla deri më sot u ka munguar një përkrahje e tillë.

Koordinimi i metodave për grumbullimin e të dhënave i ofron disa përparësi reale për secilin nga këto qëllime, mirëpo, janë edhe mjaft arsye të tjera për të ngulmuar që secili grup të mund ta zbatojë metodologjinë e vet. Koordinimi, dhe atë në veçanti kur ai nuk është i vullnetshëm, mund të shndërrohet në çështje burokratike dhe joefikase; ky mund të shndërrohet, po ashtu, në rivalitet dhe në qëndrime egoiste të grupeve të veçanta, kështu që, ky mund t'i vështirësojë për së tepërmi veprimet e misionit në terren, dhe mund t'i zvogëlojë në masë të madhe gjasat për raportim me kohë. Një koordinim i veçantë ndërmjet grupeve të të drejtave të njeriut dhe grupeve humanitare, të cilat ndodhen në terren, dhe i ICTY-së, është i një rëndësie fundamentale, me kusht që burimet potenciale të të dhënave për ndjekje penale të mos ngatërrohen, dhe që dëshmitarët potencial të mos lodhen duke ua treguar po të njëjtin rrëfim një numri më të madh të intervistuesve. Për këtë arsye, është me rëndësi që informata lidhur me atë se si të arrihet deri te ndonjë dëshmitar i cili do të dëshmojë në të ardhmen, të përdoret në një mënyrë konsistente, dhe që të intervistuarit të respektohen si dëshmitarë të mundshëm në Tribunal. ICTY-ja duhet ta qartësojë pozitën e vet lidhur me shfrytëzimin e të dhënave nga organizatat për të drejtat e njeriut, si dhe nga organizatat humanitare, gjatë grumbullimit të informatave të cilat do të përdoren nga Tribunali. Në disa raste Tribunali nuk i ka përfillur organizatat, megjithë ofertën e tyre për të ndihmuar, ndërkaq, në raste të tjera, ky ka bërë përpjekje që të vijë deri te informatat pikërisht nga organizatat të cilat në rastet e tjera i injoronte. Standardizimi i metodave nga ana e hetuesve të ICTY-së, do ta mundësonte tejkalimin e veprimeve të tilla jokonsistente.

Po ashtu, standardet rigorozet të zbatuara nga disa grupe joqeveritare, mund të ndihmojnë për informimin dhe përmirësimin e hetimeve të mjekësisë ligjore nga terreni, të cilat bëhen për nevojat e ICTY-së.⁷²

Thënë në një mënyrë edhe më të përgjithësuar, përdorimi, të paktën, i një fjalori të

njëjtë, mund ta përmirësojë dukshëm raportimin lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut, përmes përpjekjeve për t'i informuar mediat, opinionin publik, qeveritë, dhe gjykatat. Do të ishte ideale që organizatat për të drejtat e njeriut ta gjejnë rrugën për shkëmbimin e burimeve të të dhënave, të përdorin metodologji transparente, dhe sa herë që të jetë e mundur, ta bëjnë koordinimin e të dhënave të grumbulluara në interes të një raportimi sa më efikas dhe sa më të gjerë. Trajnimet e duhura të personelit i cili vepron në terren, në një masë të madhe do ta përmirësonin grumbullimin dhe koordinimin e të dhënave.⁷³

Organizat për të drejtat e njeriut kanë qenë faktori kyq gjatë konfliktit në Kosovë. Raportimi i tyre, siç u dëshmuva, ishte kushti vendimtar për intervenimin ndërkombëtar. Në kohën e përgatitjes së ngadalshme të intervenimit ndërkombëtar, këto kanë dërguar raporte të shumta për shkeljet e të drejtave të njeriut në përmasa të mëdha, mirëpo Bashkësia Ndërkombëtare ka reaguar me kujdes, duke e bërë krahasimin e nivelit të përfshirjes me nivelin e të dhënave të gjithmbarshme për shkeljet e mundshme. Bazuar në debatin lidhur me çështjen e intervenimit ndërkombëtar në përgjithësi, ka të ngjarë që Bashkësia Ndërkombëtare do të vazhdojë të insistojë për një organ gjithnjë e më të sofistikuar, i cili do ta bëjë dokumentimin e shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe në të cilin ajo do të mbështetet gjatë marrjes së vendimeve të veta. Rëndësia politike e masakrës së Reçakut, për shembull, është zmadhuar, për shkak të shpejtësisë me të cilën pala e tretë, MVK i OSBE-së ka qenë në gjendje që t'i regjistrojë dhe t'i raportojë ngjarjet. Menjëherë pas kësaj erdhi deri te manifestimi i vendosmërisë së Bashkësisë Ndërkombëtare për të vepruar.

Sidoqoftë, qasja ndaj informatave më vendimtare të cilat Bashkësia Ndërkombëtare do t'i përdorë gjatë përcaktimit të reagimeve të veta, është vetëm një përfitim nga metodat gjithnjë e më të shumta për mbledhjen e të dhënave lidhur me të drejtat e njeriut. Po ashtu, ekziston nevoja për më shumë të dhëna të besueshme, në mënyrë që ata që kanë bërë krime të përgjigjen për veprat e tyre. Studimet statistikore mund të kenë vlerë të veçantë në këtë drejtim, meqenëse ato mund t'i identifikojnë llojet dhe dukuritë e shkeljeve të cilat nuk është e thënë që do të mblidhen një nga një dhe vetëm nga rrëfimet. Njohja e këtyre çështjeve mund të ndihmojë për të përcaktuar përgjegjësinë e atyre që janë në pozita udhëheqëse, duke mundësuar që të identifikohen shkeljet të cilat bëhen nga politikat zyrtare. Për shembull, në studimin e Asociacionit Amerikan për Përparimin e Shkencës (AAAS), të titulluar 'Politikë apo Panik,' ofrohen pikëmbështetje të fuqishme për të konstatuar që ishin autoritetet jugosllave ato të cilat e kanë zbatuar një program koherent të spastrimit etnik, megjithë kundërshtimet e përsëritura në qëndrimet e tyre zyrtare. Të dhënat mbi konfliktet që do të ndodhin

në të ardhmen, do të ndriqohen më lehtë përmes këtyre llojeve të informatave dhe të analizave.

Analizat gjithëpërfshirëse të çështjes së shkeljes të të drejtave të njeriut nuk mund të arrihen pa bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e organizatave të cilat ju janë përkushtuar mbledhjes të të dhënave, dhe ne u bëjmë thirrje të gjitha organizatave relevante që të punojnë së bashku, në mënyrë që në të ardhmen të mundësohet përpilimi i analizave të tilla. Krahas kësaj, po qe se është e mundur, grupet të cilat bëjnë edhe intervista të detajuara, si dhe ato që përgatisin raporte statistikore, mund ta trajnojnë personelin e tyre për t'i siguruar informatat kontaktuese të dëshmitarit, për ta ndihmuar ICTY-në. Grupet që merren me anën statistikore munden dhe duhet të punojnë së bashku dhe në bazë të standardeve të njëjta, për ta arritur besueshmërinë e duhur në mbledhjen dhe në vlerësimin e të dhënave.

Për t'u siguruar që informatat e tilla do të jenë në dispozicion të të gjithë atyre të cilëve mund t'u shërbejnë, për Bashkësinë Ndërkombëtare është e rëndësishme që t'i përkrah sa më shumë përpjekjet e OJQ-ve në lehtësimin e mbledhjes së këtyre informatave dhe për shtrirjen sa më të gjerë të tyre gjatë kësaj mbledhjeje. Është një fushë premtuese e cila e përfshin zhvillimin dhe përdorimin e të dhënave elektronike. Në fakt, ABBA/CEELI, në bashkëpunim me Kolegjin e Drejtësisë Çikago-Kent dhe me AAAS-in, janë duke e krijuar një regjistër të të dhënave për dokumentimin e krimeve. Përpilimi i kësaj baze të të dhënave është nxitur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përvojat e këtyre organizatave në Kosovë dhe gjetkë. Qëllim i kësaj baze të të dhënave do të jetë që ta ofrojë një pjesë softueri falas, e i cili do t'u mundësonte OJQ-ve të grumbullojnë të dhëna të një formati të përshatshëm për përpunimin statistikor. Pos kësaj, si formati ashtu edhe struktura e këtyre të dhënave, do t'ju mundësojnë grupeve të ndryshme që t'i bashkojnë disa apo edhe të gjitha të dhënat e tyre, në interesin e një analize më të gjerë dhe me saktësi më të madhe. Do të ishte më idealja po qe se në konfliktet e ardhshme, OJQ-të do të arrinin në vendin e ngjarjes të pajisura me softuer përkatës, dhe që këto ta kenë të qartë rëndësinë e bashkëpunimit.

Fusnotat:

1. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Pranvera Kosovare (mars 1998).
2. Amnesty Internacional, Rahovec, Korrik – Gusht 1998, Vdekjet, Zhvendosjet, Burgosjet: Shumë Pyetje pa Përgjigje; në Kosovë Një Dekadë e Vërejtjeve të Papërfillura (maj 1999).
3. Po aty.
4. Po aty.
5. Ekipi është caktuar nga Asociacioni i Avokatëve Amerikan për Iniciativën e Evropës Qendrore dhe Lindore (ABA/CEELI), si dhe nga Kolegji Çikago-Kent i Drejtësisë. Materialet e paraqitura i përmbajnë vlerësimet e hulumtuesve dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të ABBA/CEELI-t apo të Kolegjit Çikago-Kent për Drejtësi, apo edhe të cilësdo organizatë tjetër e cila e ka dhënë kontributin e saj.
6. Për shembull, Qendra e të Drejtës Humanitare me seli në Beograd dhe me një zyre në Prishtinë, gjatë kohës së fushatës ajrore ka vepruar në mënyrë sporadike në Prishtinë.
7. Këto intervista janë bërë nga një numër i madh i organizatave, ndër të cilat edhe Misioni Verifikues në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (MVK i OSBE), Projekti për Dokumentimin e Krimeve të Luftës, i përpiluar nga ABBA/CEELI, UCDP-ja, Mjekët për të Drejtat e Njeriut (PHR), Mjekët pa Kufij, si dhe Qendra për Paqe Përmes Drejtësisë, një koalicion i OJQ-ve të Shqipërisë.
8. Shih Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimet etnike në Kosovë: Vlerësim (1999) (ky punim mbështetet në të dhënat e mjekësisë ligjore të mbledhura nga ICTY-ja dhe nga KFOR-i).
9. Shih, për shembull, raportet e Shoqatës për Popujt e Kërcënuar.
10. Shih, për shembull, raportet nga Human Rights Watch.
11. Shih, për shembull, Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-ve, Raporti para Kongresit lidhur me Operacionin 'Forca Aleate' në Kosovë, i parashtruar pas aksionit (2000).
12. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, dhe Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë.
13. Shprehja "shkeljet e të drejtave të njeriut" është përdorur këtu në kuptimin e shkeljes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të të drejtës humanitare ndërkombëtare, dhe të krimeve të luftës.
14. Shifrat e UNHCR-së.
15. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Përmbledhje të Dhënash Faktike (1999).
16. Vlerësim i UNHCR-së nga maji 1999, duke iu referuar punimit të OSBE-së, Kosova siç u pa dhe siç u tregua 98 (1999). Vlerësimi i UÇK-së për numrin e të zhven-

dosurve të brendshëm ishte 650.000.

17. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë: Raporti 7 (1999); OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, p. IX (1999).

18. OSBE, Kosova ... p. III.

19. Studimi i AAAS-së: 236.201 nga 387.185 veta sa janë arratisur nga Kosova gjatë konfliktit nëpër vendkalimin kufitar të Morinës, u arratisën gjatë kësaj periudhe kohore.

20. Raporti dy-vëllimësh i OSBE-së, "Kosova, siç u pa dhe siç u tregua," është raport i cili kryesisht është mbështetur në informatat nga rrëfimet. Informatat e tjera të këtij lloji janë hartuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, Komiteti i Avokatëve, Qendra për Paqe e Tolerancë, ABA/CEELI, Qendra për Paqe përmes Drejtësisë, (e Tiranës).

21. AAAS, Panik apo Politikë, (2000).

22. Pjestarë të popullatës rome të Kosovës, po ashtu janë identifikuar nga shumë shqiptarë kosovarë, si bashkëpunëtorë të forcave serbe në shumë shkelje të të drejtave të njeriut. Këtu hyjnë dëbimet e dhunshme, plaçkitjet dhe shkatërrimet, transporti dhe varrosja e kufomave nëpër varreza masive. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 39, kap. 20 (1999).

23. Shih Qendra, Paqe përmes Drejtësisë, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, në Raportin dërguar Komisionit të Pavarur për Kosovën 13 (prill 2000) (i përmbledh rrefimet e refugjatëve lidhur me sulmin në fshatin Dobërllukë), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI-it. Shih po ashtu Shoqata për Popujt e Kërcënuar, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën 57 (prill 2000) (i përshkruan dëbimet e dhunshme), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI-it; Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë: Sqarimet 51, 69, 71 (1999); OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, kap. 14 (1999). Po ashtu shih Amnesty International, shërbimi i raportimit të lajmeve: "RFJ - Kosovë: Fatkeqësia e refugjatëve nuk duhet injoruar," 7 Prill 1999; "Republika Federale e Jugosllavisë: Vrasjet në rajonin e Kacanikut, 9 prill 1999;" Vrasje dhe rrahje gjatë rrugës për në Shqipëri - Raportet e Amnesty International nga terreni," 21 prill 1999; "Republika Federale e Jugosllavisë - Kosovë: Raportet e Amnesti International nga terreni," 30 prill 1999.

24. ICTY, Raporti i Prokurorit të ICTY-së për Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 10 nëntor 1999. Shih po ashtu, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti (1999).

25. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë: Raporti 3 (1999). Po ashtu Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut raporton për

7.500 vrasje ndërmjet 1 janarit 1999 dhe 31 dhjetorit 1999, dhe e vlerëson që numri i përgjithshëm i të vrarëve është më së paku 11.000.

26. Shoqata për Popujt e Kërcënuar e ka evidentuar deklaratën e udhëheqësit të UÇK-së Jakup Krasniqi, i cili e ka pranuar që UÇK-ja i ka bërë disa ekzekutime. Shoqata për Popujt e Kërcënuar, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën 58 (prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI. Shih po ashtu Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 15 (1999).

27. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, VIII, 38-9, (1999).

28. Shih, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, Raporti Nr. 52 dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI. Shih po ashtu, OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua VIII, (1999).

29. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve e ka vlerësuar që ekzistojnë përafërsisht 500 varreza masive në Kosovë. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 7 (1999).

30. Shih, Qendra, Paqe Përmes Drejtësisë, Përmbledhje Preliminare e të Dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (prill 2000). (Dëshmitarët kanë parë banorë të Malishevës të vrarë nga granatat gjatë sulmit të forcave serbe në atë qytet), përmbledhje preliminare e të dhënave në dosjen e ABA/CEELI-it.

31. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë: Raporti 4-5 (1999).

32. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua 42 (1999).

33. ABA/CEELI dhe AAAS, Vrasjet Politike në Kosovë, Mars – Qershor 1999 (2000).

34. Po aty.

35. Po aty.

36. Studimi që e bënë Shpigel dhe Sallama i ka përfshirë 1.197 amvisni me 8.605 banorë. Nga shkurti 1998 e deri në qershor 1999, 67 (64%) nga 105 të vrarë në popullatën e anketuar i mvishen pasojave që kishin të bënin me luftën, e që korrespondon me numrin prej 12.000 të vrarëve në të tërë popullatën (sipas propabilitetit 95%, nga 5.500 – 18.300). Numri i përafërt i vdekshmërisë ka shënuar rritje prej 2,3 herë më tepër krahasuar me atë prej 0,72 për 1.000 banorë në muaj, të kohës para konfliktit. Promili i vdekshmërisë e ka shënuar kulmin e vet në prill 1999, me 3,25 vdekje për 1.000 banorë në muaj, e që ka qenë në përputhje me intensifikimin e fushatës serbe të “spastrimit etnik.” Vdekshmëria më e lartë për nga mosha specifike, e shkaktohet nga pasojat e luftës, është shënuar te personat e aftë për shërbim ushtarak (15–49 vjeç), si dhe te burrat e moshës 50 vjeç e më tepër. Këtu gjithsesi duhet theksuar që

grupi i fundit, pra me moshë 50 vjeç e më tepër, kishte tri herë më shumë gjasa të vdekjes si pasojë e luftës sesa grupi i moshës së aftë për luftë (rreziku relativ 3.2).

37. Të dhënat në Studimin e Mjekëve për të Drejtat e Njeriut dallohen nga ato të Human Rights Watch dhe të Qendrës ABA/CEELI, për shkak se aty janë përdorur metodat e mostrave statistikore. Të dhënat e HRU dhe të Qendrës ABBA/CEELI janë mbledhur përmes rrëfimeve, pa aplikuar metodologji të mostrave. Si rezultat, ato është dashur të “pastrohen” dhe të kodifikohen, ashtu që të mund të përdoren në këtë studim.

38. ABA/CEELI dhe AAAS, shënimet e mësipërme 33, në 9.

39. Po aty, në 10.

40. Ndërkohë që mund të vlerësohet numri i përgjithshëm i të vrarëve, mungojnë të dhëna të mjaftueshme të cilat do ta mundësonin vlerësimin e numrit të të vrarëve përnjës komunitat për secilën periudhë të konfliktit. Ka vrasje të cilat nuk iu janë paraqitur hulumtuesve të Qendrës ABA/CEELI, HRU-së, MDNJ, kështu që vlerësimet lidhur me rastet e paraqitura nuk janë të përfshira në të dhënat mbi vrasjet sipas datave dhe vendit.

41. ABA/CEELI dhe AAAS, shënimet shtesë 33, në 10 - 16.

42. Po aty, në 10 - 12.

43. Po aty, në 11.

44. Po aty, në 15.

45. Shih, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Kërkesat Reale: Dokumentimi i Shkeljes së të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Kosovë (1999).

46. Shih, OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua (1999).

47. ABA/CEELI dhe AAAS, shënimet shtesë 33, në 15.

48. Human Rights Watch, Kosovë: Dhunimi si Armë e “Spastrimit Etnik,” (2000).

49. Human Rights Watch, Kosovë: Dhunimi si Armë e “Spastrimit Etnik,” (2000).

Kjo shifër i përfshin rastet e raportuara në OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, dhe të cilat janë konfirmuar nga Human Rights Watch.

50. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 11 (1999) (citohen intervistat me refugjatë, nga të cilat kuptohet që femrat janë dërguar në hotelin Karagaq të Pejës, dhe në kazermën e ushtrisë serbe në afërsi të Gjakovës). Amnesty International e raporton, po ashtu, të paktën një incident në të cilin forcat serbe në një fshat të Suharekës i kanë ndaluar femrat dhe i kanë dhunuar tri ditë me radhë. Shih po ashtu, OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 58, 9 (1999) (e përmban edhe një raport lidhur me rrëmbimin e një grupi vajzash nga fshati, dhe mbajtjen e tyre në robëri seksuale).

51. Dekreti për Zbatimin e Ligjit të Procedurës Penale në Kushtet e Jashtëzakonshme

- të Luftës, Gazeta Zyrtare e Republikës Federale të Jugosllavisë, vëll. VIII, nr. 21, 4 prill 1999, cituar nga OSBE-ja në, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 74 (1999).
52. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua 66 (1999). Shih, po ashtu, Shoqata për Popujt e Kërcënuar, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 57 (prill 2000), paraqitje preliminare në dosjen e ABA/CEELI-it.
53. Kërkesa e Kryqit të Kuq për t'u informuar lidhur me 3.300 të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë (7 qershor 2000) <www.cnn.com>.
54. Kërkesa e Kryqit të Kuq për t'u informuar lidhur me 3.300 të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë (7 qershor 2000) <www.cnn.com>.
55. OSBE-ja e ka evidentuar që “nga rreth 800 deklarata të refugjatëve sa MVK i OSBE-së i kishte regjistruar në këtë periudhë, vetëm në disa sosh nuk janë përmenduar përvoja të tilla.” OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 91 (1999). Shih, po ashtu, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Përpilimi Preliminar i të Dhënave, Raport i dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 21 (Prill 2000) (këtu theksohet që mbi 41.000 shtëpi dhe banesa janë shkatërruar ose djegur), përpilim preliminar i të dhënave në dosjen e ABA/CEELI-t.
56. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 2 (1999).
57. Shih për shembull, OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 91 (1999), (dëshmitarë okular pohonin që një grup civilësh dhe ushtarësh serbë e kishin rrahur dhe plaçkitur dajën e të intervistuarit, meqë e kishin me vete listën në bazë të së cilës atë e identifikuan si njëri nga njerëzit e pasur).
58. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 91 (1999). Shih po ashtu Qendra, Paqe përmes Drejtësisë, në përpilimin preliminar të të dhënave, Raporti për Komisionin e Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën 12 (Prill 2000), përpilimi preliminar në dosjen e ABA/CEELI.
59. Ka, po ashtu, raporte sipas të cilave forcat serbe përdorën kufoma njerëzore për t'i helmuar burimet e ujit të pijshëm. Shih, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 28 (1999).
60. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 10 (1999).
61. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 94, (1999) (këtu jipet vlerësimi që kufizimi i lëvizjes së të zhvendosurve nga forcat serbe “të paktën e linte përshtypjen e mbrojtjes së objekteve, lokaleve apo të personelit ushtarak”).
62. Këto incidente, sipas pohimeve të të intervistuarve, kanë ndodhur në Tërnoc dhe në Ferizaj. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 96, (1999).
63. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 86, (1999).
64. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, kapitulli II, (1999). Departamenti i Shtetit

i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 5, (1999). Shih, po ashtu, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, në përpilimin preliminar të të dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 52, (prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI.

65. Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Spastrimi Etnik në Kosovë, Raporti 12 (1999). Shih, po ashtu, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, në përpilimin preliminar të të dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 51, (prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI.

66. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 47, (1999) (“Raste të torturës dhe të keq-trajtimit mund të gjesh në secilën pjesë të evidentuar të ngjarjeve nëpër komunat e Kosovës.”). Shih, po ashtu, Qendra, Paqe Përmes Drejtësisë, në përpilimin preliminar të të dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, nr. 8, (Prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI. Shoqata për Popujt e Kërcënuar, në përpilimin preliminar të të dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 56, (Prill 2000), përpilimi preliminar në dosjen e ABA/CEELI.

67. OSBE, Kosova siç u pa dhe siç u tregua, 46, (1999).

68. Shih, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, në Përpilimin Preliminar të të Dhënave, Raport dërguar Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, 53, (Prill 2000), përpilim preliminar në dosjen e ABA/CEELI.

69. Informatat janë siguruar nga intervista me Kenneth Roth, Drejtor Ekzekutiv, Human Rights Watch, 16 maj, 2000.

70. Shih Paul B. Shpigel dhe Petter Salama, Lufta dhe Moraliteti në Kosovë, 1998-99: Një dëshmi epidemiologjike, Lancet, vol. 355, 24 qershor 2000, në 2204-09.

71. Shih 15 Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Kërkesat reale: Dokumentimi i Shkeljeve të të Drejtave Ndërkombëtare Humanitare në Kosovë, 1999, (2000).

72. Intervistë me Len Rubenstein, Drejtor Ekzekutiv, Mjekët për të Drejtat e Njeriut, 8 maj 2000.

73. Intervistë me Diane Paul, ish-pjestare e Human Rights Watch, 12 maj 2000.

SHTOJCA 2

Kosova – fakte dhe shifra

Sipërfaqja: 10.887 km²; (12,3% e Republikës së Serbisë).

Popullata më 1981 (regjistrimi i fundit): 1,9 milion (175/km²),

77,5% shqiptarë,

13,2% serbë,

3,7% myslimanë boshnjakë dhe malazezë,

2,2% romë,

1,7% malazezë,

0,8% turq,

1,1% të tjerë.

Popullata më 1998 (vlerësimi): 2,2 milionë (>200/km²),

90% shqiptarë,

7% serbë.

Gjuhët: Shqip, serbisht.

Fetë: Islamike, ortodokse serbe.

Statusi administrativ: De jure, Krahinë në Republikën e Serbisë, të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Gjatë periudhës 1974 - 1990 e ka patur një nivel të caktuar autonomie përbrenda Serbisë.

De facto, nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, që nga qershori i vitit 1999.

Kryeqyteti i krahinës: Prishtina (më tepër se 300.000 banorë).

Oytetet e tjera të mëdha: Prizreni (70.000), Peja (60.000), Mitrovica (58.000), Gjakova (46.000), Gjilani (40.000).

GDP?/per capita i paraluftës: 400 \$ US (vlerësim, i cili nuk e merr parasysh sektorin e madh joformal). Rreth një e treta e per capita GDP-së mesatare të RFJ-së.

Resurset natyrore: Plumbi, zinku (miniera e Trepçës), bakri, argjendi, ari, linjiti.

Prodhimet bujqësore: Gruri, misri.

Lumenjtë kryesore: Sitnica, Drini i Bardhë.

Maja më e lartë: Gjeravica, 2522 metra.

SHTOJCA 3

Marrëveshja e Rambujesë

Përmbledhje

Kjo është një përmbledhje e draftit të propozuar përfundimtar të Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, e cili u arrit në Rambuje, më 23 shkurt 1999. Teksti i plotë mund të gjendet në shumë adresa në Internet, si për shembull në:

<www.usip.org/library/pa/kosovo/kosovo_rambtoc.html>

Teksti e përmban kornizën dhe tetë kapituj.

Korniza parasheh të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, dispozita të veçanta dhe barazi juridike për bashkësitë kombëtare, deri në shkallën në të cilën këto dispozita të veçanta të mos i rrezikojnë të drejtat e bashkësive të tjera kombëtare apo “soveranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë” (shprehje kjo e cila në tekst përdoret disa herë). Kjo e përmban po ashtu të drejtën për vetëqeverisje demokratike për qytetarët e Kosovës. Në Kornizë thuhet që përdorimi i forcës në Kosovë do të ndërpritet menjëherë, dhe që secili person ka të drejtë të kthehet në shtëpi të vet dhe ta meremetojë pronën e vet. Në të specifikohet e drejta e hyrjes së organizatave ndërkombëtare për ndihma. Personat e ndaluar pa aktakuzë, ose ata të cilët mbahen “lidhur me konfliktin” do të lirohen (sipas kapitullit 7, brenda tri javësh), dhe do të mundësohet puna e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Me përjashtim të personave “të cilët kanë bërë vepra të rënda penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare,” të gjithë të tjerët do të lirohen në bazë të një amnestie të përgjithshme, dhe askush nuk do të denohet për vepra të ndërlidhura me konfliktin. Liria e shtypit do të jetë e garantuar.

Kapitulli 1, Kushtetuta, e thekson që “Kosova do ta qeverisë vetveten në mënyrë demokratike,” ndonëse RFJ-ja do t’i ruaj kompetencat në këto fusha: integriteti territorial, ruajtja e tregut të përbashkët në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë,

politika monetare, mbrojtja, politika e jashtme (ndonëse Kosova do ta ketë të drejtën që të hyjë në marrëdhënie të jashtme në ato fusha të përgjegjësisë që janë ekuivalente me kompetencat që u takojnë Republikave sipas Kushtetutës së RFJ-së), doganat, taksat federale, zgjedhjet federale, dhe në “fusha të tjera të theksuara në këtë Marrëveshje.” Marrëveshja e saktëson strukturën e vetëqeverisjes në Kosovë: Kuvendi me 120 anëtarë (80 të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe 40 nga bashkësitë kombëtare, sipas kritereve të përcaktuara; ligjet që miratohen nga Kuvendi nuk do të mund të ndryshohen apo modifikohen as nga autoritetet federale dhe as nga ato republikane), Presidenti i Kosovës i zgjedhur nga Kuvendi, Kryeministri dhe Qeveria të miratuara nga Kuvendi, Organet Administrative në të cilat bashkësitë kombëtare do të jenë “të përfaqësuara në mënyrë adekuate në të gjitha nivelet,” Kryeprokurori, Sistemi i Gjykatave i cili përbëhet nga Gjykata Kushtetuese me gjyqtarë nga të gjitha bashkësitë kombëtare, ndërsa një pjesë tjetër zgjidhet nga lista e përpiluar nga ana e Kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale. Kapitulli i saktëson detyrat e këtyre organeve. Po ashtu, këtu elaborohen edhe të drejtat e bashkësive kombëtare, duke e përfshirë edhe të drejtën për t’i zgjedhur “institucionet për t’i rregulluar çështjet e veta” në Kosovë, për ta “mbrojtur dhe ruajtur identitetin e tyre kombëtar, kulturor, fetar dhe gjuhësor” në mënyra specifike të përcaktuara dhe duke u mbështetur në “standardet ndërkombëtare dhe në Aktin Final të Helsinkit,” për qasje të lirë në media, si dhe për t’i financuar aktivitetet e veta përmes kontributeve të anëtarësisë. Kapitulli më tej i thekson të drejtat dhe përgjegjësitë e komunave të Kosovës. Parashihet, po ashtu, një përfaqësim minimal i qytetarëve të Kosovës në Kuvendin Federativ dhe në Kuvendin Kombëtar të Serbisë.

Kapitulli 2, Policia dhe Siguria Civile Publike, e përcakton që të gjitha organet e zbatimit të ligjit duhet të veprojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me procedurat e rregullta. OSBE-së dhe misionit të saj implementues (Shih Kapitullin 5) i jipet roli qendror në vëzhgimin dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, së bashku me të drejtën për të nxjerrë edhe udhëzime detyruese. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e ligjit do të bjerë mbi njësitë e policisë komunale, të udhëhequra nga eporët vendorë. Policia do të rekrutohet në nivelin lokal. Do të formohet Administrata Gjyqësore si dhe Akademia Policore, Komisioni i të Drejtës Penale, si në nivel të Kosovës, ashtu edhe në nivelin komunal, me qëllim të vlerësimit dhe të dhënies së rekomandimeve lidhur me punën e policisë. Zyrtarët republikan dhe federativ për zbatimin e ligjit do të mund të veprojnë në Kosovë vetëm në rastet e veçanta të ndjekjes së ndonjë personi që dyshohet të ketë bërë ndonjë shkelje të rëndë

penale, dhe atë vetëm në rrethana të veçanta. Policia serbe e kufirit dhe zyrtarët federativ e të doganave do të mbeten në vendkalimet ndërkombëtare të kufirit. Kapitulli i përmban, po ashtu, edhe rregullat e ndalimit dhe të burgosjes.

Kapitulli 3, Organizimi dhe Vëzhgimi i Zjedhjeve, i përcakton kushtet e zgjedhjeve dhe kërkon nga OSBE-ja që t'i mbikëqyrë përgatitjet dhe mbajtjen e zgjedhjeve, si në nivelin e Kosovës, ashtu edhe në nivel komunal, si dhe që ta formojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i Komisionit do të vendos për kohën dhe mënyrën e zgjedhjeve, mirëpo zgjedhjet e para duhet të mbahen brenda nëntë muajsh nga momenti i arritjes së marrëveshjes. Komisioni i miraton rregullat dhe rregulloret e procesit zgjedhor. Me tutje, janë të theksuara përgjegjësitë e Komisionit, si dhe përbërja e tij - Kryetari i emëruar nga Udhëheqësi i Zyrës së OSBE-së, si dhe përfaqësuesit e të gjitha bashkësive kombëtare dhe të partive politike në Kosovë.

Kapitulli 4, Çështjet Ekonomike, fillon me konstatimin që ekonomia do të funksionojë në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë. Në këtë kapitull përcaktohen kriteret për mbledhjen e tatimeve. Këtu bëhet përcaktimi i përgjegjësisë së autoriteteve federale për ta distribuar në Kosovë pjesën proporcionale të të hyrave federale, garantimi i lëvizjes së lirë të personave, mallrave, shërbimeve dhe të kapitalit në dhe nga Kosova, si dhe garantimi i mundësisë për lidhje të kontratave ndërkombëtare për projektet e rindërtimit, po qe se kjo kërkohet. Ky kapitull, po ashtu, merret edhe me çështjen e ripërcaktimit të pronës dhe të mjeteve, në përputhje me distribuimin e ri të kompetencave ndërmjet nivelit federal dhe të atij të Kosovës, dhe e mundëson formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, i cili do t'i gjejë zgjidhjet për to. Kapitulli bën fjalë në mënyrë të përgjithshme edhe për kornizën e ndihmës humanitare, rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik. Koordinimi i ndihmës ndërkombëtare i referohet BE-së, ndërkaq UNHCR-së i jipet roli kryesor lidhur me ndihmën humanitare si dhe me lëmenj të veçantë për të cilët parashihet ndihma ndërkombëtare, për shembull, për rindërtimin e shtëpive dhe të infrastrukturës, si dhe për zhvillimin e kornizës institucionale dhe legjislativë për ndihmën sociale dhe ringjalljen e ekonomisë vendëse.

Kapitulli 5, Implementimi I, e përcakton strukturën dhe procesin e zbatimit civil të marrëveshjes. Nga OSBE-ja dhe BE-ja kërkohet që ta themelojnë një Mision Implementues (MI). Detyra të MI-së do të jenë mbikëqyrja dhe udhëheqja e zbatimit të pjesëve civile të marrëveshjes, marrja pjesë në mbledhjet e donatorëve, koordinimi i aktiviteteve të organizatave civile të cilat ndihmojnë në këtë zbatim, dhe të ushtruarit e funksioneve që i përkasin policisë dhe forcave të sigurisë. Shefi i Misionit

Implementues do ta udhëheqë, nga zyra e Presidentit të Kosovës dhe nga Parlamenti i Kosovës, Komisionin e Përbashkët me përfaqësuesit nga niveli federativ dhe republikan, dhe me përfaqësuesit e të gjitha bashkësive kombëtare në Kosovë. Këshille të përbashkëta po ashtu mund të themelohen “për zgjidhjen joformale të ngatërresave,” në nivel të Kosovës dhe në nivelin lokal. Kapitulli i përsërit dispozitat zgjedhore nga Kapitulli 3, si dhe rolin e OSBE-së. Më tutje, nga autoritetet federale kërkohet që, nën mbikëqyrje të OSBE-së, ta bëjnë regjistrimin e popullsisë në Kosovë. Aprovohen të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që janë në përputhje me marrëveshjen, “përpos dhe përderisa të zëvendësohen me ligje dhe rregullore të miratuara nga organet kompetente.” Po ashtu, shfuqizohet gjendja e jashtëzakonshme.

Kapitulli 6, Ombudsmani, e parasheh ekzistimin e një Ombduspersioni i cili do ta mbikëqyrë mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe të të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive kombëtare. Ombudsmani do të propozohet nga ana e Presidentit, nga lista e kandidatëve të propozuar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe do të zgjedhet nga Parlamenti i Kosovës me mandat tre vjeçar. Ky nuk duhet “të jetë qytetar i asnjërit nga shtetet apo entitetet që kanë qenë pjesë e ish-Jugosllavisë, dhe as i ndonjë shteti fqinj.” Ai apo ajo mund të veprojë sipas iniciativës së vet ose në bazë të ndonjë pohimi për shkelje të të drejtave të njeriut të cilat janë përmendur më lart, dhe do të publikojë vlerësime në formë të raporteve me shkrim. Përcaktohet edhe procedura për mënyrën e veprimit në rastet e mospërbushjes së rekomandimeve të Ombudsmanit.

Kapitulli 7, Implementimi II, i përmban dispozitat e implementimit ushtarak. Ky i referohet sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së. Kapitulli fillon me kërkesën e cila i bëhet Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që në bazë të Kapitullit VII ta miratojë një rezolutë në mbështetje të kapitullit për implementim, duke e përfshirë këtu edhe kërkesën për themelimin e një force ndërkombëtare shumëkombëshe për zbatimin e këtij kapitulli (KFOR). Ky i bën thirrje NATO-s që ta udhëheq këtë forcë, ndërkohë që do të mund të marrin pjesë edhe shtete të tjera. Palët ndërluftuese pajtohen që të heqin dorë nga të gjitha llojet e armiqësive. Kufiri ndërkombëtar i RFJ-së do të demilitarizohet me përjashtim të rojeve kufitare. Kapitulli e parasheh mënyrën se si forcat e pranishme në Kosovë do të rivendosen, tërhiqen apo demilitarizohen. Brenda afatit kohor prej pesë ditësh forcat ushtarake jugosllave do të risistemohen nëpër 13 rajone të Kosovës, e i cili proces saktësohet në Aneksin e kapitullit. Brenda tridhjetë ditësh do të përpilohet plani i detajuar për tërheqjen e tyre nga Kosova. Brenda 90 ditësh do të tërhiqen gjysma e personelit dhe e pajimeve ushtarake, si dhe “të gjitha mjetet përkatëse ofensive.” Po ashtu brenda 90 ditësh, kompetencat lidhur me depot

ushtarake do të kalojnë në duar të KFOR-it, ndërkaq, brenda 180 ditëve do të bëhet tërheqja e plotë e të gjitha forcave ushtarake jugosllave. Të vetmit pjesëtarë të forcave jugosllave të cilët do të mbesin do të jenë rojet e kufirit, dhe këta do të jenë të kufizuar në numër, në vendqëndrim, në detyra dhe në pajisje. Forcat ajrore si dhe ato të mbrojtjes kundërajrore duhet të tërhiqen brenda dhjetë ditësh. Kapitulli e përmban edhe planin kohor të kantonizimit (në 37 vende, e që saktësohet në Aneksin A), si dhe tërheqjen e forcave jugosllave të sigurimit në afat prej më së tepërmi një viti, e i cili mund të vazhdohet, me vendim të komandantit të KFOR-it, edhe për një vit tjetër. Nga “forcat e tjera” (me çka kryesisht mendohet në UÇK-në), kërkohet që “të përmbahen nga veprimet armiqësore, stërvitjet e formacioneve ushtarake, organizimit të demonstratave, dhe nga çdo lëvizje në të dyja anët e kufirit, apo nga kontrabanda nëpër kufijt ndërkombëtarë si dhe nëpër kufijt ndërmjet Kosovës dhe pjesëve të tjera të RFJ-së.” Kërkohen, po ashtu, edhe mosmbajtja e armëve në zona të caktuara dhe demilitarizimi në afatin e përcaktuar nga komandanti i KFOR-it. Brenda pesë ditësh ata duhet t’i braktisin të gjitha pozicionet luftarake dhe t’i caktojnë vendet për grumbullimin e armëve, në të cilat brenda 30 ditësh do të grumbullohen të gjitha armët e rënda. Demilitarizimi i plotë duhet të përfundohet brenda 120 ditësh. 30 ditë pas hyrjes së marrëveshjes në fuqi, i gjithë personeli i cili nuk është me prejardhje vendore duhet të tërhiqet nga Kosova.

Mandati i KFOR-it, më tutje, përcaktohet kryesisht që “t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme për t’iu përmbajtur” kapitullit. Kjo e nënkupton të drejtën për “reagim të shpejtë ndaj çdo shkeljeje, po qe se është nevoja edhe duke e përdorur forcën ushtarake.” KFOR-i, po ashtu, e merr përsipër edhe detyrën që t’i mbështesë organizatat e tjera për zbatimin e pjesëve të tjera të marrëveshjes, duke e përfshirë këtu edhe krijimin e sigurisë. Statusi juridik, të drejtat dhe detyrat e KFOR-it, janë të saktësuara në Aneksin B. Kjo e nënkupton respektimin e ligjeve të RFJ-së, përjashtimin nga rregullat për pasaporta dhe viza, të drejtën për t’i mbajtur uniformat dhe emblemat e NATO-s, flamujt e vendeve të tyre, imunitetin ligjor, përjashtimin nga taksat dhe obligimet e tjera, përdorimin falas të infrastrukturës dhe të objekteve të tjera komunikuese, si dhe të drejtën për ta angazhuar në punë personelin lokal. Shtojca, po ashtu, e përmban edhe klauzolën, sipas të cilës “personeli i NATO-s me automjetet, anijet, fluturaket dhe pajisjet e tjera, do ta ketë të drejtën e kalimit të lirë dhe të papenguar, dhe, po ashtu, edhe qasje të papenguar në të tërë RFJ-në.” NATO-ja “do të jetë subjekti i vetëm i cili do ta ketë kompetencën për t’i përcaktuar rregullat dhe procedurat lidhur me komandën dhe kontrollimin e hapësirës ajrore të Kosovës, si dhe të 25 kilometrave të zonës së përbashkët të sigurisë.”

Do të themelohet, po ashtu, edhe Komisioni i Përbashkët Ushtarak, i kryesuar nga komandanti i KFOR-it apo personi i autorizuar prej tij, dhe nga komandanti ushtarak i Jugosllavisë, ministrat e brendshëm republikan dhe federativ, përfaqësuesit ushtarak të forcave të tjera, përfaqësuesi i Misionit Implementues dhe “persona të tjerë që do të caktohen nga KOMKFORI, duke e përfshirë këtu edhe një apo më tepër përfaqësues të udhëheqjes civile të Kosovës.” Ky do ta këshillojë Komandantin e KFOR-it, dhe do t’i shqyrtojë ankesat ushtarake, si dhe çështjet e problemet që kërkojnë që vendimet të mirren nga komandanti.

Kapitulli 8, i përshkruan mënyrat se si mund të bëhen ndryshimet në këtë marrëveshje, dhe e deklaron që pas tri vitesh duhet të mbahet një konferencë ndërkombëtare “për ta përcaktuar mekanizmin lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës, në bazë të vullnetit të popullit, opinioneve të autoriteteve relevante, angazhimeve të palëve për jetësimin e marrëveshjes dhe Aktit Final të Helsinkit.” Kjo konferencë, po ashtu, “do të angazhohet për një vlerësim të gjithanshëm të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje,” dhe “do t’i shqyrtojë propozimet e secilës palë për masa plotësuese.”

SHTOJCA 4

Marrëveshja Ahtisaari - Chernomyrdin

Përmbledhje

Marrëveshja - apo plani i paqes - iu prezentua udhëheqjes së RFJ-së më 3 qershor 1999, nga ana e Presidentit të Finlandës, Martti Ahtisaari, i cili e përfaqësonte Bashkimin Evropian, dhe nga Viktor Chernomyrdin, përfaqësues special i Presidentit të Rusisë. Marrëveshja u pranua edhe nga Qeveria Federale e RFJ-së dhe nga Kuvendi i Serbisë, dhe kjo e përbënte bazën e dispozitave të detajuara në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e që u miratua më 10 qershor 1999.

Ky është një dokument i shkurtër, në të cilin janë radhitur dhjetë parimet e domosdoshme për arritjen e marrëveshjes. Të përmbledhura, këto parime janë:

Ndërprerja e menjëhershme dhe e verifikueshme e dhunës dhe e represionit në Kosovë;

Tërheqja e shpejtë e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare;

Një prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë, nën mandatin e OKB-së;

Një pjesëmarrje substanciale e NATO-s në çështjet e sigurisë, nën një komandë dhe kontroll të njësuar, me kompetenca për ta vendosur një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe për ta lehtësuar kthimin e të gjithë personave të zhvendosur dhe të refugjatëve;

Një administratë e përkohshme “nën të cilën populli i Kosovës do të gëzojë autonomi substanciale në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë”;

Një numër i vogël, për të cilin do të arrihet pajtimi (“qindra, jo mijëra,” bazuar në fusnotë), i personelit jugosllav e serb mund të kthehen, që në bashkëpunim me misionin ndërkombëtar t’i shënojnë dhe pastrojnë zonat e minuara, dhe që të kenë prani në objektet e trashëgimisë serbe, si dhe në vendkalimet kufitare; Kthimi i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur, nën mbikëqyrjen e UNHCR-së;

Fillimi i procesit që do të shpie drejt marrëveshjes për një kornizë të përkohshme për vetëqeverisje, respektimit të plotë të Marrëveshjes së Rambujesë, të parimeve të sovranitetit të RFJ-së, dhe të demilitarizimit të UÇK-së;

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit, duke e përfshirë këtu edhe paktin e stabilitetit për Evropën Juglindore;

Nënshkrimi i shpejtë i marrëveshjes tekniko-ushtarake, e cila, ndër të tjera, do t'i saktësojë procedurat e tërheqjes dhe modalitetet e kthimit të personelit në përputhje me parimin 6. Tërheqja do të përfundohet brenda shtatë ditësh; armët e mbrojtjes kundërajrore do të tërhiqen jashtë zonës së sigurisë prej 25 kilometrash brenda 48 orësh.

SHTOJCA 5

Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit

Rezoluta 1244 (1999)

Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e 4011-të, më 10 qershor 1999.

Këshilli i Sigurimit,

Duke i patur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe përgjegjësinë parësore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare,

Duke iu referuar rezolutave 1160 (1998), të datës 31 mars 1998, 1199 (1998), të datës 23 shtator 1998, 1203 (1998), të datës 24 tetor 1998 dhe 1239 (1999), të datës 14 maj 1999,

Duke shprehur keqardhje që kërkesat e këtyre rezolutave nuk janë zbatuar në tërësi,

I vendosur për ta zgjidhur situatën e rëndë humanitare në Kosovë, Republika Federale e Jugosllavisë, dhe për ta siguruar kthimin e lirë dhe të sigurt të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre,

Duke i dënuar të gjitha aktet e dhunës kundër popullit të Kosovës si dhe të gjitha aktet terroriste nga cilado palë,

Duke e rikujtuar deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 9 prill 1999, në të cilën shprehej brengosja për tragjedinë humanitare e cila ishte duke ndodhur në Kosovë,

Duke e rikonstatuar të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur për tu kthyer në shtëpitë e tyre në siguri,

Duke e ritheksuar jurisdikcionin dhe mandatin e Gjykatës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë,

Duke i përshëndetur parimet e përgjithshme për një zgjidhje politike të krizës së Kosovës, të miratuara më 6 maj 1999 (S/1999/516, Aneksi 1 i kësaj Rezolutive), dhe duke e përshëndetur, po ashtu, pranimin nga ana e Republikës Federale të Jugosllavisë të parimeve të parashtruara në pikat 1 deri në 9 të dokumentit të paraqitur në Beograd më 2 qershor 1999 (S/1999/649, Aneksi 2 i kësaj Rezolutive), si dhe pajtimin e RFJ-së me atë dokument,

Duke e konfirmuar zotimin e të gjitha shteteve anëtare për sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RFJ-së dhe të shteteve të tjera në rajon, siç është parashtruar në Aktin Përfundimtar të Helsinkit dhe në Aneksin 2,

Duke e konfirmuar angazhimin nga rezolutat e mëparshme për një autonomi përmajtësore dhe vetadministrim domethënës për Kosovën,

E konstaton që gjendja në rajon vazhdon të paraqesë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

I vendosur për ta garantuar sigurinë e personelit ndërkombëtar dhe zbatimin nga të gjitha palët e përfshira të përgjegjësive të tyre në bazë të kësaj Rezolutive, dhe duke vepruar për këto qëllime sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. E merr vendimin që zgjidhja politike e krizës së Kosovës do të mbështetet në parimet e përgjithshme në Aneksin 1 dhe, në shtjellimet e mëtejme, në parimet dhe elementet e tjera që kërkohen në Aneksin 2;

2. E mirëpret pranimin nga ana e RFJ-së të parimeve dhe të elementeve të tjera të cekura në paragrafin 1 të dhënë më sipër, dhe e kërkon bashkëpunimin e plotë të RFJ-së për zbatimin e tyre të shpejtë;

3. Kërkon në veçanti që RFJ-ja t'i japë fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueshme dhunës dhe represionit në Kosovë, dhe që ta fillojë tërheqjen e plotë dhe të verifikueshme sipas fazave të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare sipas një orari të caktuar me të cilin do të sinkronizohet vendosja e pranisë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë;

4. E konfirmon që pas tërheqjes, një numri të personelit ushtarak dhe policor jugosllav dhe serb, për të cilin do të arrihet pajtimi, do t'i lejohet kthimi në Kosovë, për t'i ushtruar funksionet në përputhje me Aneksin 2;

5. Vendos që në Kosovë ta dërgojë një prani ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, nën mbikëqyrjen e OKB-së, me pajisjet përkatëse dhe personelin e kërkuar, dhe e mirëpret pajtimin e RFJ-së për një prani të tillë;

6. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Këshillin e Sigurimit, ta caktojë një Përfaqësues Special për ta kontrolluar veprimin e pranisë civile, dhe kërkon, më tutje, që Sekretari i Përgjithshëm ta udhëzojë Përfaqësuesin e tij Special që të bashkëpunojë në mënyrë të afërt me praninë ndërkombëtare të sigurisë, ashtu që të sigurojë që të dyja palët do të veprojnë për të njëjtat qëllime dhe do ta përkrahin njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë;

7. I autorizon shtetet anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare për ta vendosur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, siç parashihet në pikën 4 të Aneksit 2, me të gjitha mjetet e nevojshme për t'i përmbushur përgjegjësitë e veta të parashtruara në paragrafin 9 më poshtë;

8. E pohon nevojën për vendosjen e hershme dhe të shpejtë në Kosovë të një pranie efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, dhe kërkon që palët të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e tyre;

9. Vendos që përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare të sigurisë e cila do të vendoset dhe do të veprojnë në Kosovë do t'i përfshijnë:

(a) Pengimin e ripërtëritjes së armiqësive, ruajtjen, dhe kur është e nevojshme zbatimin e detyrueshëm të armëpushimit, si dhe sigurimin e tërheqjes dhe parandalimin e kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Federatës dhe të Republikës, përpos asaj që është paraparë në pikën 6 të Aneksit 2;

(b) Demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës, siç kërkohet në paragrafin 15, në vazhdim;

(c) Krijimin e një ambienti të sigurtë, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen të sigurt në shtëpitë e tyre, ku mund të funksionojë prania civile ndërkombëtare, ku mund të krijohet një administratë kalimtare dhe ku mund të shpërndahen ndihmat humanitare;

(d) Garantimin e sigurisë dhe të rendit publik, përderisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;

(e) Mbikëqyrjen e procesit të deminimit, përderisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;

(f) Përkrahjen, si të shihet e përshtatshme, dhe bashkëpunimin e afërt me punën e pranisë civile ndërkombëtare;

(g) Kryerjen e detyrave vëzhguese në kufi ashtu siç kërkohet;

(h) Sigurimin e mbrojtjes dhe të lirisë së lëvizjes për vet praninë civile ndërkombëtare dhe për organizatat e tjera ndërkombëtare;

10. E autorizon Sekretarin e Përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave të tjera relevante ndërkombëtare, ta krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, ashtu që ta vendosë një administratë të përkohshme për Kosovën, nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbajtësore në kuadër të RFJ-së, dhe e cila do ta mundësojë një administratë kalimtare, ndërkohë që e bën formimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës;

11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë:

(a) Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtësore në Kosovë, deri në zgjidhjen përfundimtare, duke e marrë parasysh në tërësi Aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);

(b) Kryerjen e funksioneve themelore civile administrative, aty ku ka nevojë dhe për aq kohë sa kërkohet;

(c) Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke e përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve;

(d) Bartjen e përgjegjësiave të veta administrative në institucionet që do të themelohen, duke e mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes;

(e) Të ndihmuarit e një procesi politik, me qëllim të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke i marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);

(f) Mbikëqyrjen, në një fazë përfundimtare, të kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike;

(g) Përkrahjen për rindërtimin e infrastrukturës kyçe, si dhe për pjesën tjetër të rindërtimit ekonomik;

(h) Përkrahjen, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare humanitare, e ndihmës humanitare dhe të ndihmës në raste të fatkeqësi;

(i) Ruajtjen e ligjit dhe të rendit, duke e përfshirë këtu themelimin e forcave policore lokale, dhe në ndërkohë, përmes vendosjes së personelit policor ndërkombëtar i cili do të shërbejë në Kosovë;

- (j) Mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut;
- (k) Garantimin e kthimit të shpejtë dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre në Kosovë;
12. E thekson nevojën për operacione të koordinuara të ndihmave humanitare, dhe që RFJ-ja ta lejojë hyrjen e papenguar në Kosovë të organizatave për ndihma humanitare, si dhe që të bashkëpunojë me organizata të tilla, ashtu që të sigurohet shpërndarja e shpejtë dhe efikase e ndihmave ndërkombëtare;
13. I inkurajon të gjitha shtetet anëtare dhe organizatat ndërkombëtare që t'i kontribuojnë rindërtimit ekonomik dhe shoqëror si dhe kthimit të sigurtë të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur, dhe në këtë kontekst e thekson rëndësinë për thirrjen e një konference ndërkombëtare të donatorëve, posaqërisht për qëllimet e cekura në paragrafin 11 (g) më sipër, dhe atë sa më shpejtë që të jetë e mundur;
14. Kërkon bashkëpunim të plotë nga të gjitha palët, duke e përfshirë këtu edhe pranimë ndërkombëtare të sigurisë, me Gjykatën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë;
15. Kërkon që UÇK-ja dhe grupet e tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës t'i ndalin menjëherë të gjitha aksionet ofenzive dhe që t'i përmbushin kërkesat për demilitarizim, siç është paraparë nga kryesuesi i pranisë ndërkombëtare të sigurisë në konsultim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm;
16. E merr vendimin që ndalimet e parapara me paragrafin 8 të Rezolutës 1160 (1998) nuk do të zbatohen për armët dhe pajisjet përkatëse që përdoren nga prania civile ndërkombëtare dhe e sigurisë;
17. E mirëpret punën e Bashkimit Evropian dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare për ta zhvilluar në qasje gjithpërfshirëse për zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e rajonit të prekur nga kriza e Kosovës, duke e përfshirë këtu edhe zbatimin e një Pakti të Stabilitetit për Evropën Juglindore me pjesëmarrje të madhe ndërkombëtare, ashtu që demokracia, përparimi ekonomik, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal të zhvillohen edhe më tutje;
18. Kërkon që të gjitha shtetet në rajon të bashkëpunojnë në tërësi në zbatimin e të gjitha aspekteve të kësaj rezolute;
19. E merr vendimin që prania civile ndërkombëtare dhe e sigurisë, e cila është themeluar për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, të vazhdojë me punë edhe pas kësaj periudhe, përpos nëse Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe;

20. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që në intervale të rregullta t'i raportojë Këshillit për zbatimin e kësaj rezolute, duke i përfshirë këtu edhe raportet nga udhëheqësit e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, dhe që raportet e para të dorëzohen 30 ditë pas miratimit të kësaj rezolute;

21. E merr vendimin që të mbetet aktivisht i angazhuar në këtë çështje.

Aneksi 1

Deklaratë e Kryetarit mbi përfundimin e mbledhjes së Ministrave të Punëve të Jashtme të Grupit G-8, të mbajtur në Qendrën Petersburg, më 6 maj 1999.

Ministrat e punëve të jashtme të G-8-shit, i miratuan këto parime të përgjithshme për zgjidhjen politike të krizës së Kosovës:

Ndërprerja e menjëhershme dhe e verifikueshme e dhunës dhe represionit në Kosovë; Tërheqja e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova;

Vendosja në Kosovë e një pranie efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, e mbështetur dhe e miratuar nga Kombet e Bashkuara, e aftë për ta garantuar arritjen e qëllimeve të përbashkëta;

Krijimi i një administrate të përkohshme për Kosovën e cila do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të siguruar kushte për një jetë normale dhe në paqe për të gjithë banorët në Kosovë;

Kthimi i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur, dhe ardhja e papenguar në Kosovë e organizatave për ndihma humanitare;

Fillimi i procesit politik drejt krijimit të një marrëveshjeje të përkohshme politike e cila e mundëson një vetëqeverisje përmbytësore për Kosovën, duke i marrë parasysh në tërësi marrëveshjet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të RFJ-së dhe të vendeve të tjera në rajon, si dhe demilitarizimin e UÇK-së;

Qasja e gjithanshme ndaj zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të përfshirë nga kriza.

Aneksi 2

Për të lëvizur drejt zgjidhjes së krizës së Kosovës, Marrëveshja duhet të arrihet në bazë të parimeve të mëposhtme:

1. Ndalja e përnjëhershme dhe e verifikueshme e dhunës dhe represionit në Kosovë;
2. Tërheqja e verifikueshme e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova sipas një orari të shpejtë;
3. Vendosja në Kosovë e një pranie efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurisë nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, e cila do të veprojë sipas kapitullit VII të Kartës së KB-së, e aftë për ta garantuar arritjen e qëllimeve të përbashkëta;
4. Prania ndërkombëtare e sigurisë e cila do të ketë pjesëmarrje të konsiderueshme të forcave të NATO-s, duhet të vendoset nën një komandë dhe kontroll unik dhe të autorizohet për ta krijuar një ambient të sigurtë për të gjithë njerëzit në Kosovë si dhe ta lehtësojë kthimin e sigurt të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre;
5. Krijimi i një administrate të përkohshme për Kosovën si pjesë e një pranie ndërkombëtare civile, nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përm-bajtësore në kuadër të RFJ-së, do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Administrata e përkohshme duhet ta sigurojë administrimin kalimtar në kohën që e krijon dhe e mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës;
6. Pas tërheqjes, një numri të personelit serb dhe jugosllav, të caktuar me marrëveshje do t'i lejohet kthimi në Kosovë për t'i kryer funksionet e mëposhtme:
Ndërlidhja me misionin civil ndërkombëtar dhe me praninë ndërkombëtare të sigurisë;
Identifikimi/pastrimi i fushave të minuara;
Mbajtja e një pranie pranë objekteve të trashëgimisë serbe;
Mbajtja e një pranie në vendkalimet kryesore kufitare.
7. Kthimi i lirë dhe i sigurtë i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur, nën mbikëqyrjen e Zyres së Komesariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), dhe ardhja e papenguar në Kosovë e organizatave për ndihmë humanitare.

8. Procesi politik drejt krijimit të një marrëveshjeje të përkohshme politike e cila do ta mundësojë një vetëqeverisje përmbytësore për Kosovën, duke i marrë parasysh në tërësi marrëveshjet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të RFJ-së dhe të vendeve të tjera në rajon, si dhe drejt demilitarizimit të UÇK-së. Negociatat ndërmjet palëve për arritjen e një zgjidhjeje nuk do të duhej ta vonojnë apo pengojnë krijimin e institucioneve demokratike vetëqeverisëse.

9. Qasje e gjithanshme ndaj zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të përfshirë nga kriza. Kjo do ta përfshijë zbatimin e një pakti të stabilitetit për Evropën Juglindore me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare, në mënyrë që demokracia, përparimi ekonomik, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal të zhvillohen edhe më tutje.

10. Pezullimi i aktiviteteve ushtarake do ta kërkojë pranimin e parimeve të cekura më lart, përveç marrëveshjes për elemente të tjera të kërkuara, të caktuara më parë, e të cilat janë saktësuar në fusnotën e mëposhtme. Më vonë do të arrihet shpejt një marrëveshje ushtarako-teknike, e cila do t'i përcaktojë, ndër të tjera, modalitetet plotësuese, duke i përfshirë këtu edhe rolet dhe funksionet e personelit jugosllav/serb në Kosovë:

Tërheqja

Procedurat për tërheqje, duke e përfshirë këtu edhe orarin e detajuar dhe në faza, si dhe përcaktimin e zonës neutrale në Serbi përtej të cilës do të tërhiqen forcat;

Personeli i cili do të kthehet

Pajisjet të cilat do t'i ketë personeli i cili do të kthehet;

Kushtet e referencës së përgjegjësive të tyre funksionale;

Orari i kthimit të tyre;

Përcaktimi i zonave gjeografike të veprimit të tyre;

Përcaktimi i rregullave të marrëdhënjeve të tyre me praninë e sigurisë ndërkombëtare dhe misionin civil ndërkombëtar.

Shënime

1 Elemente të tjera të kërkua:

Një orar i shpejtë dhe i saktë për tërheqje, i cili, për shembull, nënkupton 7 ditë për tërheqje të plotë, dhe 48 orë për tërheqje të armëve për mbrojtjen kundërajrore në një zonë të ndërsjellë të sigurisë prej 25 km;

Kthimi i personelit për t'i kryer katër funksionet e specifikuar më lartë do të bëhet nën mbikëqyrjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe numri i tyre do të jetë i kufizuar (qindra, jo mijëra);

Pezullimi i aktiviteteve ushtarake do të bëhet pas fillimit të verifikueshëm të tërheqjeve;

Diskutimi dhe arritja e një marrëveshjeje ushtarako-teknike nuk do ta zgjasin kohën e përcaktuar më parë për përfundimin e tërheqjeve.

SHTOJCA 6

Puna e Komisionit

Anëtarët e Komisionit janë mbledhur pesë herë. Mbledhja e parë është mbajtur në shtator 1999, në Stokholm. Në këtë mbledhje u arrit pëlqimi për Deklaratën e Misionit.

Mbledhja e dytë, ajo e dhjetorit 1999, është mbajtur në Nju Jork. Para kësaj mbledhjeje është mbajtur seminari nën organizimin e Shkollës Juridike të Universitetit të Nju Jorkut.

Mbledhja e tretë e Komisionit është mbajtur në Budapest, ku seminari u organizua nga Universiteti i Evropës Qendrore dhe nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur.

Mbledhja e katërt është mbajtur në Firencë, me ftesë të Universitetit të Nju Jorkut. Mbledhja e pestë dhe e fundit është mbajtur në Johannesburg. Instituti i Afrikës së Jugut për Çështje Ndërkombëtare si dhe Universiteti i Uituatërsrandit ishin nikoqirë dhe organizatorë të seminarit, në të cilin fjalën e hapjes e mbajti Dr. Nelson Mandela.

Përpos mbledhjeve, kryesuesi dhe bashkëkryesuesi kanë bërë udhëtime të shumta për t'u takuar dhe për të biseduar me figurat kryesore gjatë konfliktit. Dy takime të tilla janë bërë në Kosovë.

Mbledhje janë organizuar, po ashtu, edhe nga institucione të tjera, për shembull nga Fondacioni Carnegie për Paqe Ndërkombëtare, Fondacioni Amerikan për Paqe dhe nga Shkolla e Londrës e Ekonomisë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të vendeve fqinje si dhe të OJQ-ve që veprojnë në Kosovë.

Deklarata e Misionit

Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën do t'i shqyrtojë zhvillimet kryesore të periudhave para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, duke i përfshirë këtu edhe shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në rajon. Komisioni do të bëjë analiza të hollë-

sishme dhe objektive të opsioneve për zgjidhjen e krizës të cilat Bashkësia Ndërkombëtare i kishte në dispozicion. Përqendrimi kryesor do të jetë në origjinën e krizës, përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund konfliktit, dhe në rolin e OKB-së dhe të NATO-s në intervenimin ushtarak. Ky do t'i shqyrtojë pasojat e krizës së refugjatëve, duke e përfshirë edhe ndërhyrjen e Bashkësisë Ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës. Objekt shqyrtimi do të jenë, po ashtu, edhe pasojat e konfliktit në rajon dhe në vendet përreth. Komisioni do ta bëjë, po ashtu, edhe vlerësimin e punëtorëve humanitarë, të OJQ-ve dhe të medias gjatë luftës në Kosovë. Në fund, Komisioni do t'i identifikojë normat e të drejtës ndërkombëtare dhe të diplomacisë të cilat erdhën në shprehje gjatë luftës në Kosovë, si dhe përshtatshmërinë e normave në fuqi dhe të institucioneve për parandalimin apo ndërhyrjen në kriza të ngjashme në të ardhmen. Komisioni do t'i shqyrtojë po ashtu, edhe statusin përfundimtar të Kosovës, mësimet e nxjerra për Kosovën, si dhe mësimet e nxjerra për të ardhmen.

Anëtarët e Komisionit

Kryetar

Richard Goldstone, Afrikë e Jugut. * I lindur më 1938. I diplomuar më 1962 në Universitetin e Uituatërsrandit, profesionin e avokatit e ushtroi në Shoqatën e Avokatëve të Johannesburgut. Më 1976 emërohet këshilltar i lartë, ndërkaq më 1980 Gjyqtar i Gjyqit Suprem, Transval. Më 1989, emërohet Gjyqtar në Degën e Apelit të Gjykatës Supreme, ndërkaq, në korrik 1994 emërohet Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut. Gjatë periudhës 1991–1994 shërbeu si kryesues i Komisionit të Afrikës së Jugut për hetime lidhur me dhunën dhe kërcënimet publike. Nga 15 gushti 1994, e deri në shtator 1996 ishte Kryeprokuror i Gjykatave Penale Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën.

Bashkëkryesues

Carl Tham, Suedi

I lindur më 1939. Diplomoi në Universitetin e Stokholmit, më 1963, dega Letërsi e Histori. Gjatë periudhës 1969–1976 ishte Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Liberale të Suedisë. Anëtar i Parlamentit nga 1976 e deri më 1982, Sekretar Shteti në Ministrinë e Punës në periudhën 1976–1978, dhe Ministër i Energjisë gjatë asaj 1978–1979. Nga

1979 e deri më 1981 ishte Këshilltar Special i Ministrisë të Punëve të Jashtme, dhe në periudhën 1981-1982 Sekretar Shteti në Ministrinë e Jashtme, i ngarkuar për ndihmat zhvillimore. Më 1983 bëhet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Suedeze për Energji, ndërkaq më 1985 Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Suedeze për Asistencë Ndërkombëtare (SIDA). Nga 1994 e deri më 1998 ishte Ministër i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë Social-Demokrate. Tash është Sekretar i Përgjithshëm i Qendrës Ndërkombëtare Olaf Palme. Ndër publikimet kryesore: E Majta e Re - E Vjetër, 1967, 1969; Universitetet në Shoqëritë e Arsimuara, 1971; Kushtet e Mirëqenies, 1971; Barazia e cila Është Tretur, 1973; Kthimi i Baticës, 1994.

Anëtarët:

Grace d'Almeida, Benin

I lindur më 1951. Diploma nga e Drejta Private, magjistratura nga e Drejta Private, dhe diploma nga Etude Approfondie nga e Drejta Afrikane në Universitetin e Parisit. Më 1978 Mbrojtës Ligjor në Benin. Më 1990 themelues dhe kryetar i Shoqatës së Avokatëve “Femrat e Beninit.” Pjesëtar i Këshillit të Lartë të Republikës së Beninit 1990-1992, Profesor i Drejtësisë që nga viti 1993. Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Beninit në vitet 1995-1996. Nënkryetar i Këshillit Suprem të Gjyqtarëve; më 1996 profesor i Drejtësisë në Universitetin e Beninit. Hulumtime dhe botime lidhur me të drejtat e fëmijëve në Benin, formimi i Qendrave të Ndihmës Juridike në Afrikën Frankofone dhe “Pengesat Strukturale për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Femrave në Benin” (për Bankën Botërore”).

Hanan Ashraui, Palestinë¹

Hanan Mikhail – Ashraui, e lindur në Nablus, Palestinë, më 8 tetor 1946. Diplomoi dhe magjistroi në Gjuhën Angleze për Arte në Universitetin Amerikan të Bejrutit, dhe doktoroi në Gjuhën Angleze (Letërsia Mesjetare dhe Krahasuese) në Universitetin e Virjiniias, Charlottesvil. Profesoreshë Fakulteti në Universitetin Birzeit në Bregun Perëndimor, të okupuar nga Izraeli, 1973-1995, e themeloi dhe e drejtoi Degën e Anglishtes 1978-1984. Anëtare e Komitetit Politik të Intifadës 1988-1993, Zëdhënëse Zyrtare e Delegacionit Palestinez në Procesin Paqësor të Lindjes së Mesme 1991-1993,

¹ Fatkeqësisht, angazhimet e saj rreth iniciativës për paqe në Lindjen e Mesme e kushtëzuan që Dr. Ashraui të marrë pjesë vetëm në mbledhjen e parë të Komisionit, kështu që ajo nuk mori pjesë në hartimin e raportit.

Kryesuese e Komitetit Përgatitor, themeluese dhe Komisionere e Përgjithshme e Komisionit të Pavarur të Palestinës për të Drejtat e Qytetarëve, 1993–1995. Pjesëtare e zgjedhur e Këshillit Legjislativ Palestinez më 1996, shërbeu si Ministreshë e Arsimit të Lartë dhe të Hulumtimeve, 1996–1998. Më 1998 e themeloi dhe ishte Sekretare e Përgjithshme e Iniciativës Palestineze për Afirmimin me Dialog Global dhe Demokraci, “Miftah.” Ndër të tjera ka botuar “Kjo Anë e Paqes,” “Nga Intifada tek Pavarësia” dhe “Poezia dhe Proza Bashkëkohore Palestineze.”

Akiko Domoto, Japoni

Akiko Domoto është lindur më 1932, në Kaliforni; fakultetin e shkencave shoqërore e përfundoi në Kolegjin Kristian të Femrave në Tokio, më 1955. Nga 1959–1989 ishte gazetare, drejtuese, dhe folëse në Sistemin Transmetues të Tokios, ku përgatiste dokumentarë si “The Baby Hotel Series” (1980–1981) dhe “The Age of Child Slavery” (1989). Më 1991 e fitoi Çmimin e Lidhjes së Transmetuesve të Qytetarëve të Japonisë, Çmimin e Konferencës së gazetarëve Japonez, dhe Çmimin Special të Fondacionit të Programit Kulturor. Anëtare e Dhomës së Këshilltarëve të Japonisë bëhet më 1989, dhe që nga atëherë ka vazhduar të punojë në këtë post. Themeluese e Rrjetit Ndërkombëtar të Fëmijëve më 1991, dhe e Rrjetit Ndërkombëtar të Grave Japoneze për Ambientin Global, më 1992. Më 1994 Këshilltare për IUCN – Unioni Botëror për Konservimin. Tani shërben si këshilltare rajonale për këtë Asociacion dhe Zëvendës Presidente dhe Presidente e Organizatës Globale Legjislative për Ambient të Ekuilibruar (GLOBE). Nga publikimet veçohen “Ngritja e qytetarëve të Tokës: Lidhja e OJQ-ve dhe e Politikës” (1995), dhe “Kërcënimet e Ngritjes Globale për Diversitetin Biologjik” (bashkëredaktore, 1997).

Richard Falk, SHBA

Richard Falk është Alber G. Milbank Profesor i Të Drejtës dhe Praktikës Ndërkombëtare, si dhe profesor i Politikës dhe i Çështjeve Ndërkombëtare në Shkollën Woodrow Wilson, në Universitetin Princeton, në Princeton të Nju Xhersit. I lindur në Nju Jork, më 13 nëntor 1930, ka diplomuar në Ekonomi në Shkollën Warton të Universitetit të Pensilvanisë më 1952, magjistroi në Drejtësi në Shkollën Juridike në Yale më 1955, dhe doktoroi në Drejtësi në Harvard më 1962. Anëtar i Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar të Oqeanëve; Këshilltar i Etiopisë dhe i Libërisë gjatë procesit gjyqësor të Afrikës Jugperëndimore para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë; Drejtor i hulumtimeve të Ekipit të Amerikës Veriore rreth Projektit të

Modeleve të Rendeve Botërore; drejtor i hulumtimeve në Projektin e Qytetërimit Global të Ardhshëm; është Zëvendës President nderi i Shoqërisë Amerikane për të Drejtën Ndërkombëtare. Ndër botimet kryesorë hyjnë: Mbi Qeverisjen Njerëzore: Drejt Politikës Globale; Revolucionaritetet dhe Funkcionalitetet; Premtimet e Rendit Botëror; Armët e Pambrojtura (bashkëautor); Të Drejtat e Njeriut dhe Sovraniteti Shtetëror; Studimi për Botërat e Ardhshme; Ky Planet i Rrezikuar; Krimet e Luftës (bashkëredaktor); Rendi Juridik në Botën e Dhunës; dhe Lufta e Vietnamit dhe e Drejta Ndërkombëtare (katër vëllime, botues dhe kontribues).

Oleg Grinevski, Rusi²

Ambasadori Oleg Grinevski është diplomat pranë Institutit të Monteresë për Studime Ndërkombëtare, SHBA. Është lindur në Moskë, më 3 qershor 1930. Studimet pasuniversitare dhe doktoratin i ka mbaruar në Institutin e Moskës për Çështjet Ndërkombëtare. Në shërbimin diplomatik hyri më 1957. Pjesëmarrës i negociatave për Traktatin e Ndalimit të Provave Bërthamore më 1963, dhe për Traktatin për Mosrritën Bërthamore, të vitit 1968, ishte Zëvendëskryesues i Delegacionit Sovjetik në SALT I, dhe në negociatat ABM 1968–1972. Drejtor i Departamentit për Lindjen e Mesme, dhe më 1984 kryesues i Delegacionit Sovjetik në Konferencën e Stokholmit për Mirëbesim dhe Masa të Sigurisë. Më 1989 emërohet kryesues i delegacionit të BRSS-së në Konferencën e Vjenës për Reduktimin e Forcave të Armatosura Konvencionale në Evropë (CFE), si dhe në Konferencën Evropiane për Mirëbesim dhe për Masat për Ndërtimin e Sigurisë në Vjenë. Më 1991–1997 ishte ambasador i Rusisë në Suedi. Ndër botimet e tij janë edhe dy libra për diplomacinë e Petrit të Madh dhe tre libra për Politikën e Jashtme Sovjetike.

Michael Ignatieff, Kanada

Shkrimtar me qëndrim në Londër, historian dhe njeri i medias. Është lindur në Toronto, në Kanada, më 1947. Doktoroi historinë në Harvard, hulumtues i lartë në Kolegjin Mbretëror, Kembrixh, dhe profesor e lektor me korrespondencë në Kolegjin St. Antony, Oxford, në Universitetin e Kalifornisë në Berkli, në Notër Dam, në Universitetin e Londrës, dhe në Shkollën e Londrës të Ekonomisë. Ka botuar, ndër të tjera, trilogjinë e librave rreth luftërave etnike dhe dilemat kundruall intervenimit perëndimor: “Gjaku dhe Përkatësia: Udhëtimi në Nacionalizmin e Ri” (1993); “Nderi

² Për fat të keq, sëmundja e rëndë e ka penguar Ambasadorin Grinevski që të merr pjesë edhe në mbledhjet e tjera të Komisionit, përpos mbledhjes së parë, kështu që as ai nuk ka marrë pjesë në këtë raport..

e Luftëtarit: Lufta Etnike dhe Ndërgjegja Moderne” (1998); “Lufta Virtuale: Kosova dhe Përtej” (2000).

Mary Kaldor, Mbretëria e Bashkuar

Mary Kaldor është lindur më 16 mars 1946. Ka diplomuar në Politikë, Filozofi dhe Ekonomi në Oxford më 1967. Vijuere e Institutit Ndërkombëtar për Kërkime Paqësore të Stokholmit 1967-1969, dhe Konsulente më 1969-1971. Që nga viti 1969 ka patur pozita të ndryshme si hulumtuese, bashkëpunëtore dhe bashkëpunëtore e jashtme në Institutin për Studimin e Organizatave Ndërkombëtare, në Institutin e Studimeve Zhvillimore dhe në Njësitë e hulumtimeve shkencore politike në Universitetin Sussex. Më 1999 Drejtoreshë e Programit për Shoqërinë Civile Globale në Qendrën për Studime Globale të Qeverisjes, Shkolla e Londrës e Ekonomisë. Bashkëdrejtuese në Asamblenë e Qytetarëve, Helsinki, dhe Drejtuese e Fondacionit të Uestminsterit për Demokraci. Botimet: “Tregtia e Armëve dhe Bota e Tretë” (1971) (bashkëautorja kryesore), “Lufta Imagjinare: të Kuptuarit e Konfliktit Lindje-Perëndim” (1990), dhe “Luftërat e Reja dhe të Vjetra: Dhuna e Organizuar në Epokën Globale” (1999).

Martha Minow, SHBA

Doktoroi Shkencat Juridike në Yale, magjistraturën në Harvard, ndërsa fakultetin e mbaroi në Universitetin e Miçigenit. Që nga viti 1981 është profesoreshë në Shkollën e Drejtësisë në Harvard. Paraprakisht ka shërbyer si nëpunëse juridike tek Gjyqtari Thurgood Marshall dhe tek gjyqtari David Bazelon. Ka qenë në bordin drejtues të shumë organizatave joqeveritare dhe të fondacioneve, përfshirë edhe Ballafaqimi me Historinë dhe Vetveten, një organizatë që merret me aftësimin e mësuesve dhe me zhvillimin e planprogrameve që e kanë për qëllim parandalimin e konflikteve dhe të urrejtjes ndërgrupore. Botimet: “Ndërmjet Hakmarrjes dhe Faljes: Ballafaqimi me Historinë pas Gjenocidit dhe Dhunës Masive” (Beacon Press, 1998); “Jo Vetëm për Mua: Identiteti, Politika dhe Ligji” (Nju Pres, 1997); “Ndryshimi Rrënjësor: Përfshirja, Përrjashtimi dhe Drejtësia Amerikane” (Cornell University Press, 1990).

Jacques Rupnik, Francë

Është lindur me 21 nëntor 1950. I ka mbaruar studimet në Histori në Sorbonë dhe për Politikë në Institutin e Studimeve Politike në Paris, ka magjistruar në studimet

sovjetike në Universitetin e Harvardit (1974), dhe ka doktoruar në Histori, në Historinë e Marrëdhënies Ndërkombëtare në Universitetin e Parisit (1978). Bashkëpunor hulumtues në Qendrën Kërkimore Ruse, në Universitetin e Harvardit 1974-1975, specialist për Evropën Lindore në BBC World Service, 1977-1982, dhe drejtor i kërkimeve në Fondacionin kombëtar të shkencave politike (Centre d'études et de recherches internationales) si dhe profesor në Institutin e Studimeve Politike të Parisit 1982-1996. Drejtor Ekzekutiv i Komisionit Ndërkombëtar për Ballkan në Fondacionin Carnegie për Paqen Ndërkombëtare 1995-1996. Profesor i jashtëm në Kolegjin për Evropë të Universitetit në Burges, si dhe njëri nga botuesit e tremujores Transeuropéenes. Më 1990-1992 këshilltar i Presidentit të Çekisë Vaclav Havel. Botimet: "Historia e Partisë Komuniste Çekoslloake" (1981), "Evropa Tjetër" (1989), "Nga Sarajeva në Sarajevë: Dështimi Jugosllav" (1992), "Ballkani, Peizazhe Para Betejës" (1996). Ai ishte edhe hartues i "Paqja e papërfunduar" (1996).

Theo Sommer, Gjermani

Është lindur më 1930 në Konstancë, Gjermani. E studioi Historinë, Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Suedi, në Universitetin e Tybingenit, dhe në Universitetin e Çikagos. Teza e doktoraturës ishte "Gjermania dhe Japonia ndërmjet Fuqive të Mëdha 1935-1940" (e botuar më 1962). Më 1960 mori pjesë në seminarin ndërkombëtar veror të Henry Kissingerit në Universitetin e Harvardit. Ndërmjet 1967 dhe 1970, asistent i shkencave politike në Universitetin e Hamburgut. Më 1958 emërohet Redaktor i rubrikës së jashtme në "Die Zeit," ndërsa Zëvendës Redaktor më 1968. Shef i planifikimit të stafit në Ministrinë e Mbrojtjes më 1969-1970; Më 1973 kthehet në "Die Zeit" si Kryeredaktor, dhe bëhet botues më 1 tetor 1992. Shkrimet kryesore të tij kanë të bëjnë me çështjet ndërkombëtare, çështjet strategjike, problemet gjermane dhe evropiane. Botimet: "Karta Kineze" (1979), "Ndërrimi i Aleancës?" (1982), Shikimi Prapa në Ardhmëri" (1984), "Udhëtimi në Gjermaninë tjetër" (1986).

Jan Urban, Republika Çeke

U lind në Hradec Kralove, Çekosllovakia, më 27 mars 1951. Diplomoj më 1974 në Histori dhe Filozofi, në Universitetin Charles të Pragës. Ishte njëri nga themeluesit e rrjetit të vetëm ndërkombëtar për ndërlidhje të gazetarëve disidentë të asaj kohe në Çekosllovakia, Poloni, Bashkimin Sovjetik, Hungari, Jugosllavi dhe në Republikën Demokratike Gjermane. Njëri nga themeluesit e "Lidove Noviny," më 1987. Aktiv në Lëvizjen e Forumit Qytetar e cila e solli ndryshimin e regjimit në nëntor 1989, dhe

shërbeu si lider i këtij forumi gjatë katër muajve të fundit para zgjedhjeve të para të lira të qershorit 1990. Një ditë pas fitores në zgjedhje i ka lënë të gjitha funksionet politike. Pjesëtar me korrespondencë në Shkollën e Nju Jorkut për hulumtime shoqërore më 1990, dhe në Universitetin e Kembrijit, në kuadër të kolegjit Imanuel, në Programin e Sigurisë Globale, më 1992. Po ashtu, profesor me korrespondencë edhe në Fondin Marshal të Gjermanisë, më 1994.

Ndihmësit e Komisionit

ABA/CEELI e ofroi bujarisht drejtorin e vet Mark Ellis, si këshilltar juridik të Komisionit. Që nga 1 Janari 2001 z. Ellis do ta merr postin e drejtorit të Asociacionit Ndërkombëtar të Avokatëve në Londër. Drejtore e sekretariatit të Komisionit është Pia Ovelius, zyrtare e lartë e Zyres së Kryeministrit të Suedisë, e cila bujarisht e dha pëlqimin që ta ndihmojë Komisionin. Kontakti me media dhe me publikun në emër të Komisionit është drejtuar nga Anki Ud, gazetar i lirë. Raporti final është redaktuar nga Liam Mahony, lektor në Universitetin Princeton. Komisioni i shpreh falënderime të veçanta Liam Mahonit, i cili me një shkresë fare të shkurtër e pranoi redaktimin e të tërë raportit.

Në Johaneshburg, hulumtuesit e zyrës së Gjykatësit Goldstone dhe të Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut – Nicole Fritz, Estelle Dehon dhe Tung Chan – kanë dhënë ndihmë administrative për Komisionin në redaktimin e këtij raporti. Ekipi statistikor në Washington: Scott Carlsson, drejtor i Projektit të ABA/CEELI-t për dokumentimin e krimeve të luftës dhe për Kosovë; Charles Rudnick, zëvendës dekan për të Drejtën Ndërkombëtare në Kolegjin Chicago-Kent të Drejtësisë; Randy Clark, nga Kolegji Chicago-Kent i Drejtësisë; Wendy Betts, ndihmës drejtore e Projektit të ABA/CEELI-t për dokumentimin e krimeve të luftës dhe për Kosovë.

Komisioni ju shpreh falënderime të ngrohta të gjithë këtyre personave dhe të gjithë të tjerëve të cilët e mundësuan këtë raport.

Kontributet financiare dhe të tjera

Një kontribut i madh financiar u dha nga Qeveria e Suedisë. Ky është plotësuar me kontributet financiare nga Qeveria e Kanadasë, Fondacioni Ford, Fondacioni Carnegie dhe Fondacioni Susakawa për Paqe. Kontribute në formën e mikpritjes së mbledhjeve të Komisionit dhe të mbajtjes së seminareve për Komisionin janë dhënë nga Unioni Bashkëpunues Suedez, Shkolla Juridike e Universitetit të Nju Jorkut,

Fondacioni Carnegie për Paqe, Fondacioni Soros, Universiteti i Evropës Qendrore, ABA/CEELI, Instituti për Paqe i Shteteve të Bashkuara, Universiteti i Vituatërsrandit, dhe Instituti për Çështje Ndërkombëtare i Afrikës së Jugut.

Veprimet e mëtutjeshme

Pas prezentimit të Raportit Sekretarit të Përgjithshëm Kofi Anan, më 23 tetor 2000, dhe Kryeministrit Goran Person më 24 tetor 2000, Komisioni do të organizojë seminare të tjera për ta vlerësuar pranimin e raportit. Puna e Komisionit formalisht përfundon më 31 dhjetor 2000.

Kontributet speciale kanë dhënë:

Komisioni i shpreh falënderime të veçanta një numri të madh personash që ofruan ndihmë, këshilla dhe/ose raporte për nevojat e tij.

Profesor Diane Orentlicher, Universiteti Princeton, SHBA; George Wood, webmaster; Magnus Engelbrektsson, hulumtues; Kryetari i Departamentit Jan Lundin, Zyra e Jashtme Suedeze; Oleg Levitin, Kolegji Mbretëror, Londër; Sussan Woodward, anëtare inordinare në Kolegjin Mbretëror, Londër; Sekretari i dytë Jonass Veiss, Ambasada e Suedisë në Moskë; nënkryetari Ildikó Nagy Moran, Universiteti i Evropës Qendrore, Budapest; Ken Kid, Shkolla Juridike e Universitetit të Nju Jorkut; Tracey Mitchell-Björkman, dizajner i llogotipit; lektori universitar Inger Österdahl, Universiteti i Upsalës, Suedi; Cindy Thermoshusien dhe Laura Samartin që i ndihmuan senatorit Domoto, Mari Peterson, reportere e lirë, Sue Hughes, copy editor dhe Josh Kaldor-Robinson.

Konsultimet

- Fisnik Abrashi, BBC, Kosovë;
- Ljubica Z. Acevska, Ambasadore e Maqedonisë në SHBA;
- Z. Erahman Ahmeti, Rezallë, Kosovë;
- Sevdie Ahmeti, Komiteti për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Kosovë;
- Martti Ahtisaari, Kryetar i Finlandës;
- Z. Yasushi Akashi, Qendra për Diplomaci Preventive, Japoni;
- Sven Alkalaj, Ambasador i Bosnjes dhe Hercegovinës në SHBA;
- Dr Abdullah Al Ashaal, Studiues Vizitor në Shkollën e Drejtësisë të Universitetit të Nju Jorkut;
- Kerstin Asp-Johnson, Ambasadore e Suedisë në Finlandë;
- Z. Lloyd Axworthy, Ministër i Jashtëm, Kanada;
- Yll Bajraktari, Forumi, Kosovë;
- Patrick Ball, AAAS, SHBA;
- Nina Bang-Jensen, Koalicioni për Paqe Ndërkombëtare;
- Göran Berg, Ambasador i Suedisë në Itali;
- Håkan Berggren, Ambasador i Suedisë në Danimarkë;
- Mats Bergquist, Ambasador i Suedisë në Mbretërinë e Bashkuar;
